BKSH

SHKRIMTARËT SHQIPTARË

PJESA I (1462-1878)

BKSH

BKSH

LIBRA SHTETI PËR SHKOLLA TË MESME – Nr- 4

Shkrimtarët Shqiptarë

PJESA I. (1462-1878)

★

Për klasën e tretë e të katërt të kursit të naltë

BKSH

BOTIM I MINISTRIS S'ARSIMIT

BOTIM I MINISTRIS S' ARSIMIT

TIRANË, 1941-XIX

Mbledhë e punue, nën kujdesin e **Ernest Koliqit,**

nga **Namik Ressuli.**

SHYPSHKROJA «GURAKUQI» — TIRANË

BKSH

KAPTINA I.

Dokumentet e para të gjuhës shqipe

1. — FORMULA E PAGZIMIT (1462)

Ky âsht, për sa dihet deri sod, dokumenti mâ i hershmi i shqipes së shkrueme. Kryeipeshkvi i Durrsit, Emz. Pál Engjëlli, krahu i djathtë i Skandërbeut, mbas njij vizite baritore rreth djoçezit të vet, tue vërtetue shum mungesa në popull e në klér, çpalli nji letër qarkore *(Constitutiones)*.

Letra, shkrue latinisht, âsht nënshkrue në Kishën e Shejtes Triní në Mat, ditën 8 Nanduer 1462.

Ndër sa mësime, qi Kryeipeshkvi u drejton Meshtarvet, ka edhe këtê : I porositë t' a këshillojnë popullin e padijshëm, qi kur në rasën e njij rreziku s' mund t' a bijnë foshnjen te kisha për me u lám me ujin e Pagzimit, t' a pagzojnë ata vetë në shtëpí, tue përdorun formulën liturgjike :

,,*Unte' paghesont premenit Atit et birit et spertit senit*"
(Un të pagëzonj p'r emnit (t') Atit e t' Birit e t'Shpertit Shenjt)

Dokumenti gjindet si dorëshkrim në bibljotekën Laurentjane të Firencës [1]). E hetoi mâ i pari edhe e botoi (v. 1915) historjaku i përmendun rumun Nikolla Jorga.

Dokumenti ká ket shenim të katalogut : *Ashburnham 11, 1167, (f. 3-4).*

2. — FJALORTHI I ARNOLDIT VON HARFF (1497)

Kalorsi gjerman Arnold v. Harff niset prej Koeln-i në vjetin 1496 për të vizituem tokët e shêjta të Palestinës; udhtim, qi ai kreu në trí vjetë. Tue i rám rruga këndej kah Shqipnija, prekë disa limane të bregdetit t' onë; edhe, mbas gjith gjase, ndërmjet Ulqinit e Tivarit, vêhet e shkruen do fjalë shqipe, qi i hŷnë në punë për rrugë.

Fjalori i vogël përfshîn vetëm 26 fjalë, 8 fraza e do numrorë, të cilvet u vên për brí veshtrimin përgjegjës në gjuhën e vet.

boicke	(bukë)
vene	(vênë)
oie	(uj)
mische	(mish)
jat	(gjathë, djathë)
foeije	(voe, vé)
oitter	(uthër, uthull, ufull)
poylle	(pulë)
pyske	(pishk, peshk)
krup	(krypë)
myr	(mirë)
kyckge	(keq)
megarune	(me ngranë)
pijne	(pím)
tauerne	(tavernë, pijetore)
geneyre	(një nier)
growa	(grua)
denarye	(denari)
sto	('shtu, po)
jae	(ja, jo)
criste	(Krisht)
dreck	(dreq)
kijrij	(qirí)
kale	(kál)

BKSH

elbe	(elb)
fijet	(fjetë)
mirenstrasse	(mirë ndesh të rasha)
mireprama	(mirë mbrama)
meretzewen	(mirë se vjen)
ake ja kasse zet ve	(a ké gjâkafshë (të ré ?)
kess felgen gyo kaffs	(qish vlen kjo kafshë)
do daple	(do t' a bléj)
laff ne kamnijss	(lajm një këmishë)
ne kaffs	(një kafshë)

. . .

nea	(nja)
dua	(dy)
trij	(trí)
quater	(katër)
pessa	(pêsa)
jast	(gjashtë)
statte	(shtatë)
tette	(tetë)
nante	(nandë)
dieta	(dhieta)
nijtgjint	(njiqind)
nemij go	(një mijë)

3. — UNGJILLI I PASHKVET (Shek. XV. (?)

Në bibljotekën Ambrozjane të Milanit mbrenda njij dorëshkrimi greqisht të shek. XIV. u diktuen dy pjesë të vogla në gjuhën shqipe. Këto dy coptime nuk kanë ç' të bâjnë me dorëshkrimin ku gjinden. Në njênën faqe të fletës *(verso)* âsht përkthimi i vjershavet 62-66 të kreut XXVII- t' Ungjillit të Shën Mateut. Copa ka në krye titullin greqisht e mbaron me nji përshëndetje urimi, shqip, qi kori kishte zakon t' i siellte Ipeshkvit, mbassi djakoni këndonte ungjillin. Në faqe tjetër *(recto)*

BKSH

janë nj' a dy rreshta notash muzikore (kangë Pashkësh), me tekstin greqisht nën ta. Ngjitë me fjalë greqishte vîjnë fjalët përgjegjse shqipe, qi të mujte melodija me u këndue edhe shqip.

Këto dy copa janë shkrue me shkroja greke; por, prejse shkrimtari shifet fort i pakujdesëshëm si në gjuhë, si n' orthografí, këndimi në nđonji vend del i mbyllët. Përkthimi nuk



Fyt. 1. — **Ungjilli i Pashkvet**

(Fotografí prej origjinalit)

âsht besnik; kështu qi shkrimtari shton, lên jashtë e i zâvendson fjalët me greqizme. Gjithnji, nën pikpamje gjuhsore, dokumenti ka nji randsí krejt të posaçme, mbassi ky na jep pasqyrën mâ të vjetrën e djalektit tosknisht.

Fragmentat u botuen për herën e parë nga z. Lambros

në vjetin 1906 ; e vetëm në vjetin 1930 Don Nil Borgia bâni nji botim të plotë të tekstit me fototypí e zhvillime. Botuesi, i rrêjtun prej kodit së bibljotekës, ku u hetue dorëshkrimi shqip, kujtoi, se edhe copat shqipe do t' ishin si ai i asaj kohe, d. m. th. i shek. XIV. Por albanologu i Sorbonës, Mario Roques, mbas studimesh të kryeme rreth si, tue thirrë në ndihmë edhe gjyqin e paleologvet tjerë, caktoi, se dokumenti do t' ishte mâ i vonë; shum me thânë, i gjymsës së mbrame të shek. XV., ase i fillimit të shek. XVI.

Këndimi i faqes A) *(verso)*

1. pri Shin Matthé
2. Ungjíll... Evag shintë e premte e madhe.
3. E më nesër — që nesër — që ishte më prempte, u mb-
4. lodhi e prifterij edhe farisej e thanë Pilatit:
5. Zot, kujtuam se ai u plan, edhe kur kje gjáll
6. tha se per tre dit prieremi. Urdhero
7. ashtu, (i) nqiellshi zot, t' u mbillet varri, mos pi-
8. qej e vinin nate, *ai avtu mathitai* e vjedhin
9. ata: pra thon (ë) lausi se u ngre së vdekurit.
10. E ishtë ma kejq së prapa e kejqja, se para.
11. Pra tha Pilati: kini kustodi, prini, mbi-
12. li varrën si e pat, sfragjisni gurin me të
13. gjithë kustodie. Shum vjet, Zoti nun.

A = *pri:* prej. - 3. *që nesër*: përsritun gabimisht. - *u mbëlodhi:* trajta pësuese, ku qindron ende skajimi, të cilin shkoi tue e përpî refleksivi *(u)*. Ndeshemi shpesh edhe ndër tjerë të vjetër. - 5. *u plan*: greq. *gënjeshtár.* - 6. *priremi:* siellem, kthehem. Verbi ka diftongun në rrajë, si e gjêjmë të përdorun edhe gjetiu ndër të hershëm. - 7. *(i) nqiellshi: qielluer. divus.* - *mos piqej:* ndoshta: *mos të piqen, mos të bashkohen.* - 8. *nate:* natën. - *ai avtu...* greqisht: t' atij dishepujt, *nxansit e tij.* - 11. *kustodi:* fjalë latine për: *rojtar, gjindarm.* - *prini, mbili varrën*; shkoni, mbyllnie vorrin. - 12. *si e pat:* si t' a dijni – *sfragjisni:* greq. vulosni. 13. *Shum vjet* etj. Urimi i fundit si thám nuk ka ç' të bâjë me pjesën e Ungjillit

Këndimi i faqes B (*verso*)

Krishti u ngjall së vdekurit, mortje mortnë e shkejli (i), e ata që janë ta varr (i) gjellna (u) dhuro (i).

4. — NËSHKRIMET E PJANËS

Jo se janë nji gjâ e madhe, por prejse âsht mirë të dihen, mâ së forti për të pám si ndër kohë të hershme u sprovuen Shqiptarët me e shkrue gjuhën e vet, qe këtu, nj' a katër nëshkrime të vogla qi mund të këndohen edhe sod në Piana dei Greci, ngjat Palermit, qendër besnike e Italo-shqiptarvet.

1. CHI Bȣȣ PR...GNȣ FJALȣ: *Ki* (ky) *bëë* (bërë...(?) *një fjalë.* Asht gdhênun mbi patvallen (trau kryesuer) e derës së kishës së Z. Rruzare në Pjanë, dhe ká datën 1728.

2. — AS TRUARAE GAEZUARAE: *As truarë, gëzuarë*, d. m. th. Ngushlluem pa qenë porositun. (it. *Non raccomandato, consolato).* — Gjindet i shkruem brî sqytit të Matrangajvet.

3. — CUJTOU SECHÈE TAE VDECH, TAE SILLEX BOTA E: *Kujton se ké të vde (ç) e të sillesh botë* (e do të kthehesh në pluhun.) — Gdhênun mbi vorrin e *Dorangrich*-vet, në Kathedralen e Shën Mitrit.

4. — MORTIA JOTE GJEGHA IME: *Mortja jote gjella* (jeta) *ime.* Mbi gùr, qi mblonte dikur vorrin e njênit ndër vllazën *Kaliman;* tash vendue mbi nji altar të kishës së Shën Mitrit. Nëshkrimi i përgjegjet së thânmes liturgjike: *Mors tua vita mea;* qi shenjon ngadhnjimin e Shelbuesit përmbi fuqín e vdekjes.

B. — *Mortje mortnë.* E para âsht nji ablativ mjeti: *me morden e vet, nepër dekën e vet.* E dyta âsht kallxore, e ligshtueme skajimesh, si shpesh ndër të hershëm: *morden, dekën* (mujti). — *e ata që janë:* për t' u ndreqë anakoluti: *atirve (atynve) që janë.* — *ta varri:* *ta* për *te vorri*, d. m. th. *të vdekunvet.* — *gjellna:* gjellën, jetën u fali.

5. — FJALORTHI I MAZRREKUT (1633)

Imz. Pjetër Mazrreku, Krye-ipeshkvi i Tivarit, në nji ligjiratë mbajtun në Romë rreth vjetit 1633, mbi kombin Shqiptar, sidomos mbi banorët e malevet të Dukagjinit, ndër tjera thotë, se „populli i këtij kombi âsht teprica e Macedonvet të vjetër. Ka nji gjuhë të ndryshme prej gjuhësh tjera, me shum fjalë italishte e greqishte; po thom disa ndër fjalë italishte“. E këtu numron 32 emna shqip, qi i bân si të rrjedhnn nga italishtja:

Bukë	(a bucella)	*pulpë*	(polpa)
kál	(cavallo)	*shpatë*	(spada)
mashkull'	(maschio)	*sqyt*	(scudo)
femenë	(femina)	*ark*	(arco)
pulë	(pollo)	*shëgjetë*	(saetta)
kangë	(canto	*grunë*	(grano)
qiell	(cieli)	*mel*	(miglio)
gjind	(gente)	*lepur'*	(lepre)
populľ	(popolo)	*kapruell*	(capriolo)
lëqê	(lago)	*faqe*	(faccia)
kambë	(gamba)	*shenj*	(segno)
karthë	(cartha)	*nye*	(neo)
shembelëtyrë	(similitudine)	*frashen'*	(frassino)
mrekull'	(miracolo)	*qarr*	erro)
		grigjë	(gregge)
		peshk	(pesce)
	troftë	(trotta)	

e shum tjerë.

JUSTIN RROTA

KAPTINA II.

Shkrimtarë të vjetër të veriut

NJOFTIME TË PËRGJITHËSHME

I. — Të gjithë prodhimin letrar shqiptar, që nga shekulli XV e gjër në ditët t' ona, për lehtësi studjimi e veçanerisht për arësye historike, e kemi ndarë në dy grumbuj të mëdhenj : a) Prodhim letrar shqiptar përpara Lidhjes së Prizrendit *dhe b)* Prodhim letrar shqiptar pas Lidhjes së Prizrendit.

Grumbulli i parë nis që prej gjysmës së shekullit XV dhe arrin pothua gjer tek fundi i XIX shekull, edhe përmbleth të gjithë veprimtarinë kulturore e letrare që u zhvillua në qëndra të ndryshme të Shqipërisë s' atëherëshme, d. m. th. në një Shqipëri që nuk ekziztonte edhe si shtet.

Grumbulli i dytë përkon me lëvizjen e parë e kuptimplote të zgjimit kombtar ndër Shqiptarët jashtë e mbrenda Shqipërisë, dhe përmbleth të gjithë prodhimin letrar që nis që prej Shoqrisë së Stambollit — e cila, siç dihet, themelohej pikërisht me qëllim që t' i japë gjuhës shqipe një alfabet të caktuar e të shtypë libra e fletore të çdollojëshme për përhapjen e kulturës e të ndjenjës kombtare në vëndin t' onë — dhe arrin gjër në ditë të sotme. Prandaj i kemi caktuar si kufij nisjatorë — në sensu lato, *kuptohet — këtij prodhimi* Lidhjen e Prizrendit, *e cila qe mëma, të thomi kështu, e Shoqrisë së Stambollit.*

Po nga këta dy grumbuj, i pari, përgjithësisht, as që munt të quhet letrar *me kuptimin më të kulluar të fjalës :*

a) pse këto shkrime që përmbleth ky grumbull nuk janë shkruar me ndonjë qëllim krejt estetik *a* letrar, *po janë pothua të gjitha, me përjashtim të një grumbulli të vogël krejt laik, shkrime fetare të punuara nga priftërinj katholikë e orthodoksë me qëllim propagande a mësimi të fesë ;*

b) pse këjo lëvizje, ase më mirë, këto lëvizje kulturore përpara Lidhjes së Prizrendit nuk kanë pasur as njesi, as vazhdimsi, as edhe ndonjë përhapje nëpër gjithë Shqipëtarët e atëhershëm. Ato kanë qënë fenomene kulturore sporadike, krejt krahinore.

Veç asaj, ky prodhim na paraqitet edhe i përçarë e pa farë lidhjeje. Prodhimi letrar që lindi, p. sh., në qëndra të veriut nuk ka të bêjë fare me prodhimin letrar të jugës. E kemi ndarë prandaj edhe këtë studim në dy pjesë : 1) Shkrimtarë të vjetër të veriut, *2)* Shkrimtarë të vjetër të jugës.

Sado që i tërë ky grupi i parë, me pakë përjashtime, nuk ka vlerë letrare a estetike, vlen prap se prap të studjohet e të njihet, pse edhe ky është pasqyra e gjëndjes mëndore, shpirtrore e kulturore e Shqiptarëve më parë se të fitonin një ndërgjegje kombtare. Pastaj ka vlerë të madhe për ne, jo vetëm pse na thotë kur nisi të shkruhej gjuha shqipe e kur filloi pikërisht një farë lëvizje kulturore, sado e përçarë dhe me prirje të ndryshëme, në vëndin t' onë, po edhe pse na jep një fazë të vjetër të gjuhës s' onë, ashtu si flitej në ato kohë të lashta.

II. — Pas dokumentevet gjuhësore që pamë më lart, nga pikëpamja e vjetërsisë vëndin e parë e zë prodhimi i shkrimtarvet të veriut. Ky prodhim u lint e u zhvillua në Shqipërinë e sipërme dhe qe pema e priftërinjve t' atëherëshëm. Ai përfshin të gjitha shkrimet e këtyre auktorëve kishtarë — të botuara më të shumtat përjashta, prej Propagandës Fide, tjerat mbrënda Shqipërisë — duke filluar nga më i vjetri që njohim, d. m. th. nga libri i Gjon Buzukut, *me datë 1555, e duke ardhur dalë nga dalë gjër afro në ditët t' ona : plot pothua 350 a 400 vjetë punë.*

Shkrimtarët më kryesorë të këtyre shkrimeve janë : **Buzuku, Budi, Frangu i Bardhë, Bogdani** *e* **Kazazi,** *si edhe disa që nuk ishin t' origjinës shqipëtare, ndër të cilët më të përmëndurit* **Nilo Catalano** *e* **Francesco Maria da Lecce.** *Sado të huaj këta të dy jetuan e punuan në Shqipëri, dhe shkruan vepra shqipe po me ato qëllime e po me ato cilësi që i shkruan shokët e tyre shqipëtarë.*

Vijnë pastaj plot shkrimtarë të tjerë, veprat e të cilëvet do të formojnë t' ashtuquajturën „letratyrën agjografike", *letratyrë që vazhdon edhe sot pranë letratyrës kombtare. Po ky prodhim i funtmë nuk munt të na interesojë, ashtu si na interesojnë veprat e pesë shkrimtarëve të parë, pse nuk ka ndonjë vlerë nga pikëpamja e vjetërsisë.*

Tri janë „karakteristikat" kryesore të prodhimit letrar të veriut, që e dallojnë nga prodhimet letrare shqipëtare të tjera përpara Lidhjes së Prizrenit.

a) lënda është gadi krejt fetare, pse u shkrua me qëllim kryesor që të mbajë të gjallë e të forcojë në katholikët e veriut fenë katholike, e cila nën pushtimin otoman kish nisur të shkatërrohej e të çdukej ;

b) është i math, ndoshta i tepërt, influksi latin e italjan, mbassi auktorët e këtij prodhimi ishin lidhur ngusht me kishën e perëndimit, duke qënë nën urdhërat e saj, dhe kishin kryer studjimet e veta përtej Adriatikut, në Itali.

c) gjithë për arsyet e sipërme, alfabeti i përdorur prej tyre është po thua ai i tipit latin-italjan.

Pa dyshim ky prodhim verior është më i rëndësishmi i prodhimeve të pjesës së parë të letratyrës shqipe, si nga pikëpamja e sasisë dhe gjërësisë si dhe nga pikëpamja e lëndës dhe e mbrëndisë. Këta shkrimtarë të vjetër të veriut nuk janë vetëm të parët që filluan një farë lëvizje kulturore në vëndin t' onë, nuk janë vetëm të parët që i dhanë shqipes një alfabet — alfabetin latin — po janë edhe të parët që mendojnë e punojnë për atdhenë e gjuhën e tyre, për Shqipen e Shqipërinë. Madje

nga këjo pikëpamje kombtare ky prodhim munt të lidhej drejtë për drejtë me atë që erdhi pas Lidhjes së Prizrendit, po t' ishte mâ e madhe vlera estetike e qëllimi i përbashkësisë shqipëtare. *)

NAMIK RESSULI

1. — GJON BUZUKU — Meshari (1555)

Asht auktori mâ i vjetri, përsa dihet deri sod, i gjuhës shqipe. Vepra e tij: „*Meshari*", botuem në vjetin 1555, gjindet, nji copë e vetme në gjithë botën, në bibljotekën e Vatikanit [1].

I pari shqiptár, qi dha lajmin në vjetin 1740, se ky mo-

*) Po japim një listë kronologjike të shkrimtarëvet e të vepravet që i përkasin këtij grumbulli: **Gjon Buzuku** një „*meshar*" (1555); **Pjetër Budi**, „*Dottrina Christiana*" (1618-a)........). „*Rituale Romanum*" me një „*shpjegim të meshës romane* (1621), „*Speculum Confessionis*" (1621); **Pjetër Maserech** „*një listë etimologjike fjalësh*" dorëshkrim, 1633; **Frangu i Bardhë** „*Dictionarinm latino-epiroticnm*" (1635): **Bernando da Quinzano o da Verona** një përkthim të Doktrinës si pas Bellarminit (1675 ?) (nukë gjendet më); **Pjetër Bogdani** „*Cuneus prophetarum*" në dy botime (1685-a, 1691); **Nilo Catalano**, një fjalor shqip-italisht e italisht-shqip, dorëshkrim (përpara 1694); „*Cunvendi i Arbënit o Concilli Provintjaal*" (1706); **Francesco Maria da Lecce** një fjalor, dorëshkrim (1702) („*Osservazioni grammaticali*" (1716); një *Fjalor italisht-shqip* që ruhet në Grottaferrata, dorëshkrim (1710); **Gjon Kazazi** „*Breve compendio della Dottrina Cristiana*" (1743); „*Pun t' nevoishem*" (1828); **Z. Guagliata** „*Dottrina e kerscten*" (1845); **V. Basile** „*Ruga e Parrisit*" (1845); **E. Radoja** „*Jezu Criscti n' zemer t' Mesctaarit*" (1862); **Nji Frat** (âsht At Dario Bucciarelli) „*Udha e Sceites cryc*" (1862); **Giulio Buffoli** „*Fjalor italisht-shqip*" dorëshkrim (1862); **B. D. Francavilla** „*Confessione pratiea It. — Ep.*" (1863); **G. Bruschi** „Môj majit" (1864); **Fr. Rossi** „*Vocabulario Italiano-Epirotico* ed *Epirotico-Italiano*" 1866-1875; **T. Marcozzi**, „*Urat* (1867); „*T' vërteta t' pasosme*" (1867); **E. Radoja** „*Msime t' nevoiscme per me dasct I. K.*" (1870). Mc themelimin e shtypshkronjës së Jezuitëvet në Shkodër (1870) botimet fetare vazhduan dhe vazhdojnë edhe në ditët t' ona. Krahazi me këto botime panë dritën edhe veprat „profane" të shkrimtarëve fetarë e laikë që përgjithërisht punuan e jetuan në kryeqytetin e veriut.

1) Libri ká shënimin e katalogut: *R. G. Liturgia. III. 194.*

nument i çmueshëm gjindej në Romë, kje Imz. Gjon Kazazi, prej Gjakove, Krye-ipeshkvi i Shkupit. Aso kohe Kazazi e hetoi librin, jo ku âsht sod, por në bibljotekën e Propagandës. Prej gëzimit muer dhe e përshkroi me dorë nji copë të faqes së fundit e i a dërgoi të vlertit italo-shqiptár, At Gjergj Guzetës, në Palerm.

Libri, si âsht sod, ka 94 fletë (188 faqe); por, prejse janë bâ shum gabime në njehsimin e parë, numri i vërtetë i fletvet do t' ishte: 110. Blênit i mungojnë 16 faqet e para e ndonji tjetër nepër tê.

Landa e librit âsht krejt fetare, e përfshîn mâ fort pjesë liturgjike, mbas këtij rendi: Oficja [1]) e Zojës Marí, 7 Psalmet pendestare, Litaníť [2]) e Mëdhaja, pjesë Rituali e Katekizmi. Mâ se gjymsën e librit e zânë Meshët e motit kishtár.

Përveç kryesinash së faqevet e titujsh, qi janë latinisht, gjithshka tjetër âsht shqip. Gjuha e Buzukut âsht shqipja e djalektit gegnisht. Por takojmë aty-këtu edhè ndër fjalë e trajta, qi sod përdoren në tosknishten e jugut e t'Italo-shqiptarvet. Për arsye sidomos të landës së vishtirë, shkrimi âsht i përlyem me fjalë italishte, dishka me slavishte e fort pak me turqishte.

Sa për auktorin e Mesharit, nuk dihet tjetër, veç shka mund të nxieret prej parathanjes së shkurtë, të cilën, simbas zakonit të kohës, e ka vendue në fund të librit. Asht pra, nji prift katholik, gegë, êmnit *Don Gjon, i biri i Deä Buzukut.* Prej djalektit e dishmon vedin, se âsht malsuer i krahut të Mbi-Shkodrës, ndoshta i malsis së Krajës.

Libri i Buzukut âsht shtypun dý shtyllash, në format qm. 20 X 14, me shkroja stilit gjymsë-gotik. Për të shprehun tingujt e posaçëm të shqipes, qiti në punë disa shkroja t' alfabetit të vjetër të slavishtes (alfab. cirilik). Mbas gjith gjase, libri u shtyp në Venedik — ndoshta në shtypshkrojën e njij farë *Kamil Zanetti* në bashkëpunim me *Shtjefën Shkodranin.*

Dhetë muej e gjymës ngjati libri me u punue: 20 Mars 1554 deri 5 Kallënduer 1555.

---

1) *Ofice:* fjalë kishtare ; radhë psalmesh e të lutunash.
2) *Litaní:* të lutuna për të kërkue mëshirën e Perendís.

Vepra e Buzukut deri më sod nuk ka mujtë të rishtypet. Janë botuem vetëm copa të nxjerruna prej si. Libri krejt i fotografuem gjindet ndër duer të pak vetve.

Randsija e këtij monumenti âsht fort e madhe, në daç për trajtat e fjalorin, në daç për historín e djalektevet të shqipes; mbassi në kohën e tij ndryshimet ndërmjet gegnishtes e tosknishtes nuk ishin aq të mëdhaja.

Nga vepra e Buzukut



Fyt. 2. — Fotografija e Parathanjes së librit të Buzukut

a) — Parathanja e Librit

U Doni [1]), Gjoni, i biri i Bdek [2]) Buzukut, tue u kujtuom [3]) shumë herë, se gluha [4]) jonë nuk' kish gjâ t' ëndigluom [5]) nsë Shkruomit Shenjtë, e nsë dashunit [6]) së botës sanë, desha me u fëdigun' [7]), persa mujta me ditun, me zdritun pak mendet' e atyne qi t' e ëndiglonjin', perse ata të mund' merrnë [8]), sa i naltë e i mujtun' e i permishërietshem âsht' Zotynë atyne qi t' a duonë me gjithë zemer'.

U lus, ënbas sodi ma shpesh të veni më kishë ; perse ju kini me gjegjun, [9]) ordhënin' [10]) e Tinëzot. E atë në ëmbaroshi, Zotynë të ketë [11]) mishërier ënbí ju ; e ata qi u monduon' djeri tash ma mos u mondonjën'. E ju t' ini të zgjedhunit' e Tinëzot, e perherë Zotynë ka me klenë me jú : ju tue ëndjekun të drejten' e tue lanë të shtrembënen' [12]). E këta ju tue bam, Zotynë ka me shtuom [13]) ënder jú, se të korrët táj t' ënglatet ndjeri' së vjelash, e të vjelët djeri nsë ënbjellash.

---

1. — N' origjinal *Donih.* Si mund të shifet në *fac-simile*, Fyt. 2. nuk dihet pse Buzuku u shton fjalvet qi sosin në zânore, mâ rráll edhe në fillim, aspiranten *h*. Në leximin e copavet, për lehtësim e kjartsí, e lamë jashtë ; sikurse edhè shênjojmë me nji hijezë suprimimin e gjithatyne *è*-vet, të cilat u a shton bisht mbas fjalvet sidomos qi dalin në bashkëtingllore. 2. — B d e k : *Dominicus*, sod *Dedë*. 3. — t u e u k u j t u o m ; Kemi në Buzukun, gjithkund diftongun e vjetër n' *uo*, i cili, dalë dikur nga *o*, shkoi tue u shëndrrue me kohë n' *ua*, *ue*, *u*. 4. — g l u h a ; mâ poshtë k l i s h a : dy grupet e hershme *gl*, *kl*, të cilat mund të ndiehen edhè sod në Çamerí e ndër Shqiptarët e Sicilís, të zbutuna me kohë n' *g-j*, *kj*, mandej në tosk. n' *gj*, *q*. 5. — ë n d i g l u o m : prej lat. *intelligo*-kuptoj, marr vesht. 6. — n s ë d a s h u n i t : asnjansi i adjektivavet e i pjestorevet, shpesh ndër të hershëm, përdoret në vend t'emnit, si këtu për : *dashní*. 7. — m e u f ë d i g u n' : fjalë venecjane për : *me u mundue*, *m' u orvatë*. 8. — a t a m u n d m e r r n ë ; ligshtuem skâjimit *ín (marrin)*. Ligshtim, qi e bâjnë shpesh të vjetrit edhe ndër emna, si : *Zotnë*, *motnë*, për *Zotin*, *motin*. Këtu plotso kuptimin : *marrin vesht*. 9. — m e g j e g j u n : *me ndigjuem*, *me ndiem*. 10. — o r d h ë n i n, sod *urdhnin*. 11. — Z o t y n ë t ë k e t ë. Në Buzukun, e vetëm në këtê kemi shpesh të tashmen e lidhores për t' ardhëshmen ; pra këtu *Z. ka per të pasun mishërier mbi (për) ju*. 12. — t ë s h t r e m b ë n e n' : ndërsa toskët gjithnji mbajnë ketë trajtën e Buzukut, gegët kanë : *të shtrembtën*, përveç krahinës së Kelmendit, e cila ka me tosknishten edhè : *i verbën*, *i shkjepën*, *i shkurtën*, etj. 13. — K a m e s h t u o m : *ká*

E u ma duo t' ënbaroj vepëren' teme, Tinëzot tue pelqyem. Ëndë vjetët 14) M. D. L. IIII. njëzet dit ëndë Mars ꝁûna ënfíll e ënbarova ëndë vjetët M. D. L. V. ëndë Kallnduor V. dit.

E se per fat 15) në keshë kun(d) ënbë ëndonjë vend fëjyem, 16) u duo tuk të jetë fajtë, ai qi të jetë ma i ditëshim 17) se u, ata faj 18) e lus t' a trajtonjë ëndë e mirë. Perse nuk çuditem, se në paça fëjyem, kjo tue klenë ma e para vepër' e fort e fështirë per të vepëruom ëndë gluhët tanë. Perse ata qi shtamponjin 19) kishnë të madhe fëdigë, 20) e aqë nuk' mund' qellonjin 21) se faj 22) të mos banjin'; perse perherë ëndaj ta nuk' mund' jeshe, 23) u tue ënbajtun' një klishë ënbë dy anët 24) më duhé 25) me sherbyem.

E tash u jam ënfalë gjithëve e lutëni Zotnë endè per muo

b. — Të mbytunt e botës nd' ujë

E tue pám Zotynë, se fort u bâ njerí 1) diekeq 2) perënbí dhét, sa, qishdo të kujtuom kujtonjin', por per të keq kujtonjin' per gjithë mot ëndë zemrë të tyne; e u penduo Zotynë se kish bam njerin' perënbi 3) dhét, e tue pasun' qyrë 4) motnë qi kish

---

me ju dhânë të mbarën tue shumuem gjân e jetesën, (qi) se të korrunt të jét aq të madh, sa të shtyhet deri së vjelunash e të vjelunt deri së mbjellunash.
14. — Ëndë vjetët: Ndër të hershëm; sidomos Buzuku, ndërton me hjektoren prepozitat (*mbë, ndër, për, mbi, nën, nepër*, etj.) të cilat sod i ndërtojmë me kallxoren. 15. — E se per fat: Italjanizëm: *(e se per caso) në rasën qi, për në kjoftë se.* 16. — fëjyem: *gabuem.* 17. — i ditëshem: sod kemi trajtën mâ të shkurtuemen, *i dijshëm.* 18. — Ata faj: *gabim*; gjetiu e ka mâ fort në gjinín mashk. si e kemi në përdorim sod. 19. — ata qi shtamponjin... qellonjin... banjin: Nji varg imperfektash, qi janë edhe sod në përdorim në Toskni, n' Itali e në Malsi të Mbi-Shkodrës (krahu i epër). 20. — fëdigë: *mùnd.* 21. — qellonjin: i a *mërrij (njaj qellimi).* Në ketë kuptim këtu sado qi verbi sod, simbas krahine, merr edhè tjera veshrime. 22. — se faj: prap lidhsa *se*, si nalt, për *qi.* 23. — jeshe për *ishe*, si *keshe* për *kishe.* 24. — ënbë dy anët: *në shërbim të klishës* edhe njiherit me u gjetun pranë shtypit të librit. Po Zot, ku do të két kênë ky vend? 25. — duhé: *duhej*, njekështu gjithkund Buzuku vehtjen II. t' imperfektit pësues e ka me skajimin *é*, ndërsa gegnisht âsht *ej*, e tosknisht *esh.*

b. — 1) *nierí:* Do të pritshim *njeríu*, mbassi kështu e përdorë zakonisht Bz. 2. — diekeq. E kanë edhe tjerët, të cilën fjalë shqipe e kemi zâvendsue sod me turqishten *sherr.* 3. — perënbí. Gjithkund Bz. *mb*-en e shkruen *nb*; e po nisi fjala me të ka per t' i vû para gjithmonë nji *hen* (ęn). 4. — qyrun. Njikështu, me aferezë, e shkruen gjithkund ketë fjalë *(këqyrun).*

me ardhun', i u dhimti ëndë zemër' të ti 5). E tha Zotynë: U të perfaronj 6) njerëzit', qi u kam bâtë, ën faqëjet së dheut, ën njerëzishit djeri' zojtë e qiellet, perse u pendohem ata se i bâna.

E Noeu gjet hír perpara faqes' *(së)* Tinzot. E këto janë farët e Noeut: Noeu, nieri i dërejtë e i ënbarë e parët ëndë farët të tí, eci me Tënzonë. E leu 7) tre bij: Sem, Ham e Jafet.

E u pega 8) dheu perpara faqes' *(së)* Tinëzot, e u ënbush dheu plot me të keq. E pá Zotynë dhénë, se ish pegám, perse gjithë mish, qi ish perënbi dhét qelbé 9) së pegani. E tha Zotynë Noeut: Të sosunit' ën gjithë korpi erdh perpara muo; perse u ënbush dheu ën gjithë së keqi ën faqëjet së tyne, e hinje 10) se û duo të perfaronj ata ën dheut. Të bâjnsh një barkë ën drûsh së pinit, e të bajnsh vise 11) ëndë barkët, e t'a pegullonjsh 12) per jashtëna e per ënbrenda me pegullë. E ënbë ketë mëndyrë 13) ata *(të)* banjsh: Të glatët' e sáj 14) të jetë treqind pasha, e të gjanët' e sáj pesëdhjetë, e të naltët' e sáj tridhjetë pasha. E të bâjnsh një fenestrë ëndë barkët, një pash ënbë e sosunit' persipri: e deren e barkës' t' e vesh pranë: e të bâjnsh poda perposh 15) të dytë e të tretë. 16) Perse u duo të siell diten' e gjyqit perënbí dhét me ujëna me perfaruom gjithë korp 17) e mish, qi ëndë të të jetë shpírt i gjallë, qi per nden' qiellt të jetë, e gjithë q' ish perënbí dhét, të bdiret'. E û të vê 18) një besë me ty: e të hîjësh ëndë barkë ti e bijtë e tú, e gruoja jote e gratë e d' bijet 19) tyne me ty. E ën

---

5. — n ë z. t ë t í. Në vend të pronorit të drejtë *(i vet.)* Bz. këtu sikurse edhe gjetiu shpesh, përdorë diftuesin (i tij), si jugu, qi të parin s'e ka mâ aspak. 6. — t ë p e r f a r o n j, për futurin: *kam për të përfaruem*. 7. — E l e u: Me kuptim aktiv tranzitiv. 8. — E u p e g á: *U ndŷ*. 9. — q e l b é: *qelbej*. 10. — h i n j e: *qe*. Fjala qindron në ditë të sodit në Krajë (Ljare) Bg. ká *njè*, i cili s'njeh të sodshmen *qe*. Trajtën e vjetër e kemi ndër të përbâmet: *njekësajt, njetu, njatje*, etj. 11. — v í s e; këtu për *vêse*, (lt. *mansiunculae)*. 12. — t'a p e g u l l o j n s h: *pegullë = peshkve, (bitumen)*. Bg. ka: *pjegull*. 13. — m ë n d y r ë. Kështu e ká gjithkund, si Shkodra sod; në vend të f. *mënyrë* (nga it. *waniera*. Meyer EW.) 14. — t ë g l a t ë t, etj. prap nji varg adjektivash asnjanës në vend t'abstraktit *gjatsi*, etj. 15. — p e r p o s h: *nentê, poshte*. 16. — t ë d y t ë e t ë t r e t ë: për t'u lidhë me f. *poda*. 17. — g j i t h ë k o r p. Mënyrë e zakonshme në Bz. për: *çdo korp*. 18. — e û të v ê n j ë b e s ë: *Kam për të vû*, etj. 19. — d' b i j e t. Bz. e për-

gjithë kafshëshit së gjalla 20) dy e dy t' i bâjnsh bashkë e t' i shtiesh endë barkët, ata me ty të gëllinjën' : e të gjithë të jenë mashkull' e femën'. Ansosh qi fluturonjën, si e sia 21) do farë të jetë : e ën shtâsëshit qi gjáll janë perënbí dhét, si e sia do farë dy ën gjithë farëshit të hînjën' me ty, t' ushqehen'. E të marrsh ën gjithë gjellëshit qi mund' bahet 22) e t' a shpiesh me vetëhën' ëndë barkë : e të jetë ty e atyne per gjellë. E bâni Noe gjithë ish i ordhënoi Zotynë.

E tha Zotynë Noeut : Hîn' ti e gjithë shtëpia jote ëndë barkët ; perse û ty të pae 23) të dërejtë perpara muo 24) ndë ketë farë.

E u bâ shiu perënbí dhét katerdhjetë dit e katerdhjetë net. E atë ditë të vetëme hîni Noeu, Semi, Hami e Jafethi, bijtë e tí, e gruoja e tí e gratë e d' bijet *(të)* tí me ata bashkë ëndë barkët, e ën gjithë shtâsëshit ën qishdo farë u gjet, ën gjithë govedashit, si qishdo farë u gjet, e ën gjithë zojshit qi fluturonjin ; ká dy e ká dy. E i ënbërsheli Zotynë 25) per qark me ujëna të diluvit e me mot të keq.

E u bâ diluvi katerdhjetë dit perënbí ujënat, e u shumuon' ujënat e u ëngriten' 26) fort nalt perënbí dhét, u forcuon'. E barka por ëngrihé perënbí ujënat. Aqë u shumuon' ujënat ëndë forcë të tyne, sa ënbëluon' gjithë majet' e malet *(të)* nalta, qi perënden' qiellt ishnjin'. Pesënbëdhjetë pasha perënbí gjithë mal të naltë u ëngritin' ujënat'. E aty u bduor gjithë mish e korp, qi perënbí dhét u gjet : zojtë, shtasët, govedat' 27), bi-

---

dorë deri në teprí *apokopen ;* sidomos në rasën e dytë të shumsit: *njerzet, përindet, pleqet.* etj. = Prej kësi shpërdorimi na ka mbetun në gjuhën e shkrueme: *Këtyne, atyne.* 20. — E ën gjithë k. Hjektore partitive shumës me skajimin nye të rregullët *(shit, së).* 21. — si e sia do; sod *se e cila do.* 22. — Kishim pritë shumsin e këtyne tre verbave, qi lidhin e plotsojnë : ën gjithë gjellëshit. 23. — të pae: *të pásh.* Kështu i përdorë shpesh verbat me aoristin sigmatik : *Un rae, lae, dhae, thae,* ctj, (për : *rásh, laçë,* etj.) 24. — perpara muo. Sod : *përpara meje.* Ndeshemi në Bz. i cili rekcjonin e prepozitavet shpesh i ka ndryshej prej të soçmit: *Kundra, afer muo, permbí mazit, jashtë ferren, per shpirtit* etj. 25. — i ënbersheli = *i mbylli Z., i rrethoi.* 26. — u ëngriten = *u çuon.* 27. — govedat.

shët', e gjithë shtasë, qi perënbí dhét kle, e gjithë nierí. E gjithë ato kafshë, qi shpírt të gjallë patnë ëndë vetëhen', me gjithë ato qi ënbë të thatë klenë, u dbuorë [28]) e u perfaruon' e kun gjâkafshë e gjallë ënbë ketë shekull' nuk' ënbet, mâ se [29]) Noeu e ata qi me tê ishnë ëndë barkë.

E u ëngritin' ujënat' perënbí dhét njëqind e pesëdhjetë dit.

c) Gjyqi i Salomonit

Ënd' ato dit erdhnë dy grá të keqia tek Salomoni. Tue klenë perpara ati, tha njana ënsosh: U të lus, zot, ti m' ëndiglojnsh: U e këjo gruo ishnjim ëndë një shtëpí; e na tue ënbetun' bashkë, u leva një djalë. E ënbassi û leva, të treten' ditë bâni djalët' [1]) edhè këjo gruo; e ishnjim [2]) të dý vetem' [3]), e s' ish kush me né ëndë shtëpí mâ se na të dý [4]).

E vdiq djalët' e kësáj gruo natën'; perse ajo, tue ënfjetun, e ënbyti ëndë gjumët. E u ëngriti mjesnatet, e muor djalët' tem qi ish ëndaj muo, e û, sherbëtoreja [5]) jote, ënflênë; e ajo e shtiu [6]) ëndë gjí të sáj, e vû djalët' e sáj ëndë gjí tem, qi ish vdekun. E û, tue u ëngritun' ëndë natanet [7]) me dhânë gjítë djalit tim, e gjeta vdekun'. E atë paçë qyrë mirë ëndë natanet, e pae se nuk' ish biri em, qi û keshë lénë [8]).

Slav. baktít, gjâja e gjallë, sidomos lopët. 28. — u dbuorë. Kështu përorë ka njejsin edhe për shumsín. 29. — Mâ se: *posë, përveç.*

c) 1. — djalët'. Mâ poshtë ka: *djalët e gjallë, ata d.* etj., si t' ishte nji asnjanës; por ka edhe, si pám: *d. tem âsht ata, qí âsht gjáll, e yjti âsht ai qi âsht vdekun.* 2. — ishnjim. Vre imperfektin pësues në *nja*, si jugu e pjesa e epër e Malsis së Mbi-Shkodrës. 3. — të dy vetem'. Mâ e rregulltë e caktuemja: *të dyja vetëm.* 4. — mâ se na dy: *posë se na të dyja.* 5. — sherbëtoreja. Kohën e shkrimtarvet të hershëm duket se nuk kishte rám, aq nemose sá sod, skajimi i së pacaktuemes *(e)*, në të caktuemen. Me gjithkëta, prap sod mund të ndiehet në M. e Shk.: *qyqeja*, më ka tretë *fijeja, deleja, faqeja*, etj. 6. — e shtiu. Gg. kanë nisë me e hundzuem ket verb *(shtîni)* mjesa Ts. e mbajnë gjithnji këtê të Buzukut *(shtiem, shtiu).* 7. — ëndë natanet: *Ndë natet, nade,* (jo *nadje).* 8. — kish lénë. Gjithmonë me kuptim kalues, edhe këtu.

E u pergjeq ajo jetëra gruo: Jo, por djalët' tem âsht' ata qi âsht gjáll, e yjti âsht' ata qi âsht' vdekun'. E ajo thoj': Jo, por ai qi âsht' vdekun' âsht yjti, e i gjalli âsht emi. — E në ketë mëndyrë qërtonjin' [9] të dya perpara rregjit.

E tha rregji: Këjo thotë se: Djali em âsht' ai qi âsht' gjallë, e biri yjt vdiq. E këjo thotë: Jo, por djali yjt vdiq e emi gjëllín [10]. Birimë shpatën' muo!

E i përûnë shpatën' rregjit perpara. E tha rregji: Dáni djalët e gjallë per vjedmis [11] ën dy pjesësh, e epëni njanën' gjimsë njanës e t' jetrën' s' jetrës'.

E tha gruoja, qi djalët ish i sáj [12], rregjit; perse i u dhimti zemëra perënbí djalët të sáj. Zot, û ty të lus, epia djalët' e gjallë asáj e atë mos bân t' a ënvrasën'.

E ajo jetra thoj: As muo, as ty të mos epet'; por lê t' a dánë!

E u pergjegj rregji e tha: Epëní djalët' e gjallë, e mos e ënvritini; perse këjo âsht' e ama e tí!

E gjegj' gjithë Izraeli gjyqin' qi rregji gjykou, e ënbasandaj druonë [13] ën faqejet së rregjit, perse pánë se urta [14] e Tinzot ish ëndë zemrë të tí me bâm gjyq.

ç) Gostari i pazemrë

Ish një njerí i begatë, qi ënvishé ëndë skarlat [1] e ndë petëka të mëndashtë, e per gjithë ditë bân' gostí të mëdhá. E ish një i vobeg qi e kluonjin' Lazar, qi dergjé [2] ënbë derët të tí, gjithë varrë e plagë, tue deshëruom me u ëngînjun ën fermishit, qi per ëndën tryezë të bëgatet binjin'; e qentë vinjin' e i lypinjin' varrët' e ti.

---

9. — Qërtonjin: *xêheshin në fjalë, grîheshin* (lt. *contendebant*). 10. — gjëllín: *gjallon, jeton*. 11. — per vjedmis. Kështu e ka gjithkunjd e vetëm Buzuku, fjalën *mjedis, mjes*. 12. — qi dja·lët ish i sá., Anakolut i vrashtë, në vend të: *Gruoja, i së cilës ishte djali, tha*. 13. — druonë: dreshten, ndoshta kontrakcjon i: *druonjin, druojn*. 14. — urta. Kështu zakonisht për: *urtija*.

ç) 1. — ënvishé ëndë skarlat: *veshej* etj. *Skarlati*, pelhurë e mëndashtë e kuqe, si gjaku. 2. — qi dergjé: *qi dergjei*, ishte i smundë.

E u bâ [3]) sá vdiq i vobegu e kle shpùm ën qiellshit ëndë gjí të Abrámit; e vdiq edhè i bëgati e kle ënbëluom ëndë ferrët. E tue ëngritun sŷtë e tí, tue klenë ëndë mundime, pá [4]) per së largut Abramnë e Lazarin' ëndë gjí të tí; e ai tue thirrë, tha: O ati Abrám, kí mishërier ën meje [5]), e dergo Lazarin' të lagnë gishtin' mâ të voglin ënd'ujë, perse ai a të më freskon gluhën teme, perse û vinj munduon ëndë ketë flakë. E tha Abrámi: Bír, kujtou se ti ëndë gjellët tande pësove mirë [6]), Lazari fort keq; e tash, hinje, se ai ëngushëllonet', e ti jé munduom [7]). E perënbí gjithë këto kafshë ëndër ju e ëndër né [8]) âsht forcuom një e madhe gropë; qi [9]) ata qi ën nesh duonë me ardhun' tek ju [10]), s' mundnjën' as andej këhâ tek na.

E ai i tha: U ty lus, ate û të dergoj ëndë shtëpí të tim et, perse û kam pesë vëllazen', ai me u deshmuom të vertetën' atyne, perse edhè ata mos vînjen' ëndër këto vise të munduome. — E i tha Abrámi: Ata kanë Moyzesnë e profetët, e lê të ëndiglonjën' ata. — E ai i tha: Mos, atë Abrámi, perse, ne voftë kush ën së vdekunishit, atyne kanë me u besuom, e ata të pendonen' [11]) së keqes. — E i tha: Ata, në mos ëndigloshin' Moyzeut' e Profetëvet, edhè ne ëngjallë [12]) kush ën së vdekunishit, të mos besonjën'. *(Buz. f. 34 b.)*

---

3. — E u bâ: *E ndodhi.* Bz. këtu përkthen fjalë për fjalë lat. *Et factum est.* 4. — pá; me skajim të hangun, për: *pau;* ndiehet edhe sod në të folmen popullore, por qi s' do të ndiqet në gjuhën e shkrueme. 5. — ë n meje. Hjektore e thjeshtë, fort mâ bukur se me thânë, si sod: *Kij m. për mue.* Për t' u vrejtë mirë trajta e pacaktueme e peremnit: *Meje, teje, këtynve, atynve, neve, juve,* qi këndohen gjithmonë ndër të vjetër; ndërsa sod, të bje me këndue: *Mejet, tejet, këtynvet,* etj. 6. — pësove mirë. Verbin *pësoj,* e përdorë edhe në kuptim të mirë, vetëm pse ndjekë me nji herë mbas kuptimi: *i keq.* 7. — munduom. Mâ nalt kemi pá, se gjithëkund Bz. e ka ket verb me *o* në rrâjë: *mondoum,* pa nji arësye. 8. — Ënder jú etj. Në veshtrimin origjinar (*inter*), *ndërmjet.* 9. — qi ata qi ën nesh: *Kështu, në mënyrë qi etj.* 10. — tek ju... tek na. Gjithkund gadi Bz. e ka prepozitën *te (tu)* të forcueme me *k*-ên eufonike. 11. — ata të pendonen. E tashmja e lidhores për t' ardhëshmen: *s'kanë për t'u penduem.* Kështu edhe mâ poshtë *të mos besonjën (s'kanë me besue).* Sa për trajtën pësuese të verbit *(pendonem)* vre, si e përdorë në mënyrën e jugut. 12. — edhe ne ëngjallë. Këtu ka marrë trajtën vepruese për pësuesen: *edhe ne u ngjalltë.*

d) E gjykuemja për dekë
(C o p ë e l i r ë) [1]

Ënd' atë mot vot' Jezu ënbë malit të ullînjet e përap' ëndë natanet herejet erdh më klishë, e gjithë populli vinjinë te ai, e ai tue ëndenjun' ata ënpson'. E shkruosit' e farizejt' i suollë' perpara një gruo gjetunë me tjeter' burrë: e, si perpara e suollë', i thanë: Mjeshter, këjo gruo u gjet me tjeter' burrë. E ëndë ligjit, a s'ordhënoi Moyseu, se gruoja, qi të gjindë ënbë ketë mëndyrë, ajo t'ish me gurë ënbëluom? E ti, qish na thuo?

E këta e thoshnë me e tentuom, e perse a të mund' a paditnjin'.

E Jezu, tue u prunjun' pështjerë, po shkruoj me gisht ënbë đhét. E ata tue mos pushuom së pvetuni, ai u ëndëreq e u tha atyne: Ai qi âsht' ën jush pá kuat, ai të jetë mâ i pari me qitun' gurë ënbë tê.

E per së dytë u prunjë *(e)* shkruon' ënbë dhét. E ata tue gjegjun' por iknjin' ká një ká një, tue xânë ënfill ën pleqshit, djerie vo' në, e ënbet vetem' Jezu e gruoja, qi it' perpara tí. E si u ëngriti Jezu e s'pa kan' mâ se gruon', i tha: Gruo, kû janë ata qi ty paditnjin'? E askush nuk' të gjykou?

E ajo i u përgjegj, tue i thashun': Askush, Zot!

E i tha Jezu: As û nuk të gjykonj. Ec', e mâ mos u kuatëno!

(Buz. 55. a.)

---

1) Këjo copë âsht pa spjegime dhe u lîhet nxânsvet t'a spjegojnë.

2. -- PJETËR BUDI — Veprat (1618-1621)

Imzot Pjetër Budi prej Guri të Bardhë, katund në Mat, lindi në vjetin 1566. Mësimet e para i muer privatisht, tue ndêjun aty-këtu me Ipeshkvîj të vendit; ndërsá këndimet e nalta i kreu në Kolegjën Ilirjane të Loretit. I rí, 21 vjeç, bâhet Meshtár, e me atë fíll të Parët e dërgojnë në Misjonin e Kosovës; ku punon, gjithkund i dám në shêj për zellin e veprimit, nji herë si Famullitár, mandej si Vikár i Përgjithët i Serbís: gjithsejt 17 vjetë.

Në Korrik 1621 emnohet Ipeshkëv i Zadrimës. Në vjeshtën e këtij vjeti gaton planet e kryengritjes për me i dalë Shqipnija dore Turkut, mbassi aso here ky ishte i penguem në luftën kundra Polonije 1).

Veprimtarija e Budit âsht përnjimend e çuditshme. Nj' a 5 a 6 herë nget në Romë; ku për me e kjám te Papa gjendjen e mjerueshme të Shqipnís, vuejtjet e popullit e të kishvet, qi ndrydheshin nën thundrat e barbarit; ku për të nxjerrun lêje e mjete me i shtypë librat e vet. Ishte në valën e veprimit, kur nji dekë e papritun i a shkurtoi jetën. Tue kalue në të vueme Drinin, u mbyt n' uj në vjetin 1623.

Botimet e tija — flasin vetëm për ato qi kemi në dorë sod — përkthime a origjinale, kapen deri në 800 faqe; ndër të cilat mund të kundrojmë fizjonomín besnike të gjuhës së përdorun nga Shqiptarët e Gegnís në fillimin e shek. XVII.

1. — Vepra mâ e njohtuna âsht: „*Doktrina e kërshtenë*" 2), përkthim i asaj së Sh. R. Belarmini-t. Katekizma tregohet me

---

1) Letra qi aso here prej Rome Budi i shkruen Kard. Gozzadini-t, tue e lutë t' i a njohtonte Papës, Palit V, mendimin e planet e luftës, ka nji randsi të madhe historike. Kqr. «*Perparimi*» 1914.

2) Qe titulli i vërtetë: „DOTTRINA Christiana Composta per ordine della fel. me. Di Papa Clemente VIII. Dal R. P. Roberto Bellarmino Sacerdote della Compagnia di Giesu *Adesso Cardinale di santa Chiesa del Titolo di S. Maria in Via*. Tradotta in lingua albanese DAL REVER. DON PIETRO BUDI da Pietra Biancha. In Roma, Per Bartolomeo Zannetti. 1618. Con licenza de Superiori.

pyetje e përgjegje, ndërmjet Priftit e Xhakonit, e përfshîn gadi 170 faqe frm. XII. ; mbas të cilavet vijojnë deri në f. 228, do vjersha të përshpirtëshme : d. m. th. 19 poezí dá në strofa katërshe tetërrokshe, me rrimën e ndërlikueme (*alternate*). Subjekti i këtyne âsht i ndryshëm, veç gjithmonë fetár. Për këto poezí kalxon në parathanje, se shumicën, i ka gjetun të shkrueme prej „Atit shumë ncë ndérshim e ncë devotshim frat Pálit prej Hasí" ; të cilat, gjithsejt me të vetat, përbâjnë 2800 vjerrsha. — Kjo vepër kje botue së pari në v. 1618. Nga ky botim i parë, qi e zbuloi tash së voni Z. M. Roques në bibljotekën e Vatikanit, gjindet vetëm nji copë [3]). Libri u rishtyp edhè tri herë tjera (1636, 1664 e 1868) gjithnji në shtypshkrojën e Propagandës në Romë.

2. — Për randsi, kohë e vllim vjen në të dytin rend vepra : *Speculum Confessionis ;* libri në frm. XII v. 1621 u botue në shtypshkrojën e Bartol. Zannetti-t, në Romë e ka 408 faqe. Asht përkthim i librit omonim t' Atit Emer. de Bonis. Qe titulli i gjatë i veprës, të cilin, mbas atij latinisht, e ep të përkthyem edhè shqip. „Pasëqyra e t' Rrëfyemit *e Atit Emerio de Bonis me sá tjera kafshë shumë të frujtuoshime të shpirtit, per ndimë të giuhusë Arbëneshë e aq mâ teper per t' atynet qi s' janë të zotë me ndëgjuom ncë tjera letërash, nkthyem gjuhe ncë lëtine mbë gjuhu t' Arbëneshe, Zotit Dom Pjetrë Budit prej Guri cë Bardhë, Upeshkëvi cë Zadrimës.*

Për ket libër kujtohej deri vonë, se përveç njaj cope së bibljotekës *Mazarine* të Paris-it (N. 24582), nuk njifej tjetër ; ndërsa Z. M. Roques hetoi edhè dy copë tjera në bibljotekën e Vatikanit [4]).

3. — Budi, tue pasë para sysh mâ së forti kulturën e klerit, botoi edhè : *Ritualin roman* (latinisht) me rubrika e zhvillime shqipe. Libri në format VIII. të vogël, ka 360 faqe. Asht botuem në Romë në vjetin 1621 ; edhe ka dhâne pelqimin e të shtypunit Imz. Simon Gjeçi, Ip. i Sapës.

---

3) Shenjimi i Katalogut të Bibl. âsht ky : *Bibl. Vat. R. I. VI. 449.*

4) Roma, Bibl. Vaticana, *R.I.V. 2213. — R. G. Liturgia. V. 35. int. 3.*

Njitë mbas këtij libri âsht lidhun edhè nji fashikull 16 faqesh, gjithnji n' at format, shtypë kryekëput me shkroja kursive. Zhvillon Meshën romane, e duket si t' ishte nji shtojcë e pjesës së parë, por prap, fashikulli duket nji vepër e pamvarshme nga e para, mbassi numrimin e faqevet e ka krejt në vedi [5]).

Libri me shtojcë, deri qi e hetoi Z. Mario Roques, në vjetin 1932, nuk dihej prej kuj se gjindej kund.

Nga veprat e Budit


Terecumenduom nduratte gizza-
tzne chit amarrene mee
zgiezune.

VElla zenistee dascivne cteffse-
scimitte biytee Christiit, di-
sabere tue cuituom tevdier-
rete egizzachie temaz [illegible] scint se-
see chiubaa ende po bab te zgizzeuitte
ndegiubutane maakech mezuune se
ndoogny tyeter dore gimaie pmby-
geet: etue paam asclu ende se keta dit-
sitte eleterorete bolle chi [illegible] ndore
asclu giaacasce mëdimuë elane sckret
egiaa maa spondimogmene, maa ske-
see tieter chisc mezaam vecise bina
mbaze [illegible] skroita
mbeginbutane [illegible] docapitiy te
Ditese g88chit chy gieta schruom atit
sciume nze ndecusim ene [illegible]
frat Paallit prei basti tezytle ende me
dote tyera te nCluome dissabere tue
A [illegible] schruom,

isckruom, cuurt tuepaam se isene pte-
maze ndime esruite sepijrtit taty Po-
pulli, eachie maa tepere te dissa Priff-
tene chi desceroine mei pasune, bina
pbizze ditecaapak tue ncluom, sckra-
na ende sua tetyera cassice saamuyla
nzeziera giubuse tue inkzz8em mbe-
giubu tane, endeevone mbassi andei
ndaasce erzze mbe Rome keasCte gur-
ra egralle egizzeberevet, tuepaam se
giubazone at ndoognie leterete mp-
luom se caa metezyt temundeey nder-
ta meu ndimuom jeeya e Christit, tu
nassyll mund achiesaamundankzze-
na kette scinte Doctrine giuhezeleti-
ne mbeginbu Tarbenesce, sipndimette
aty populli, asclu ende me nzierre pa-
kete giumenee disaue chi pak mot gi-
zze tervite eytenee [illegible] esckuone ndeie
mbre[illegible], paamos lane ndoognie tep-
mendume temire mbas vetebet: tezy-
ne ndoonese mepakfegide mbasie mba-
roiua mba scort chidisa edergoua disa
mbet ketu, endevone ctur maa pngee
tueevuum voe, ppakfyalle chimeduk-
ne sesyesene mire, chisc ndoszkeba nde-
gnietias fienee pare chochia, evente-
saat

Fyt. 3. Nji fac. simile e parathânjes së Doktrinës (botim i vjetit 1861)

5) E vetmja copë e këtij libri të Budit gjindet në Romë, në Bibljotekën e Vatik., e ka ket shenjim: *R. G. Liturgia. V. 51. el V. 35. int. 1 et 2.*

a) Detyra e të dhjetavet

E prifti mbet e i tha, se: Pa i nçto endè mâ ndonjë fjalë këtij urdhëni 1) qi të mund ndëgjohet endè mâ mirë.

E gjakoni, posikundrëse e kish gjetunë ndë një të shkruom, mbet e i tha, se, Zotynë i mëshëriershimi jet e thotë, se: O njerí, ti mirë e di se unë ty, jo veç se të kam bâm e krijuom e dhânë vertutnë 2) e mentë e shqisetë, e dhén me punuom e qétë me të ndifunë 3) e me të punuom, e gjithë shtâsët e kruatyrët' e tjera me të qenë per ndonjë ndimë e me të sherbyem; po ashtû endè t' ap ndë kohot 4) shín' e diellin' e voesen' e brymen' e të vrantit' e të këthielltit' mb' atë herë kur ty të duhet'.

Práshtu, kùr të mirë tue dijtun' se gjithë kafshët janë të miat, e û t' i kam dhanë, endè po t' i ap, e t' i nçtonj e t' i tepëronj per gjithë ditë; ashtû endé unë duo të kiem pjesë prej teje, fëdiget e djersëshi cë tù. E jo ndonjë pjesë të madhe, si kanë zakon gjindja e danjën vëllá me vëllá, o i ati me bijt e vet, o ndonjë zot i kësaj jete, qi ká zakon e i merr punëtorit gjymsen o të treten e gjithë frujtëvet (*të*) dheut e (*të*) bashtinës (*së*) vet; po unë duo qi ju të zini fíll mâ parë e të merri me të bekuom nandë pjesë, e muo m' epni të dhjeten, si të bukës e të vênës, ashtû endè të vojit e të pemëvet e të linit e të leshit e të djathit e të tëlyenit e të gjithë frujtevet e të dobívet tjera, qi u kam dhânë e kini permbí faqe të dheut.

E jo me të dhimtun, o me të mshuom 5), po me gjithë zemrë e vullëndet; perse kështû tue bâm, gjith motnë e jetës kini me gjellmë 6) mirë, e me qenë ndë të bekuomit. E frujtet tuoj kam me u a nçtuom e me u a tepëruom; ashtû qi nder

---

1) P a i n ç t o... k ë t í j u r d h ë n i. Asht folun deri tash mbi të pestin urdhnim të Kishës, d. m. th. mbi detyrën t' i lahet kësaj e dhjeta. 2) v e r t u t n ë = *vertytin*, në kuptimin e *fuqivet trupore*. 3) m e t ë n d i f u n = *ndihun, ndîmuem*. 4) n d ë k o h o t. Këndo: *ndë kohët*. 5) m e t ë m s h u o m: *tue fshâ, tue shuem, tue kjâ me lot për faqe*. 6) m e g j e l l m ë. Fytyra e fjalës në tekst epet kështu: *kinimegielm*. Kuptimi na duket, se i përkrahet këndimit t' onë: *kini me gjellmë, me gjallue, me gjellitë*.

to t' ini gjithë herë gjinde e ngushëlluom me gjithë nduorshi 7) cë frujtevet e të kënaqëvet.

Mâ, ndë mengofshi kënco fjale e kënci urdhëni, qi të mos m' epni muo të dhjetten e gjith kafshëvet, posikundrëse thashë persipëri, kam me ndêm doren e me u marrë endè ato të nandë pjesët e tjera, e me u lânë pá njanët e pa tjetret. Ashtû qi jeten táj t' a shkoni fort idhun e helmuom permbí faqe të dheut. Endè mos t' i marrsha ndë koho të tyne, të lâ qi t' i mbëljedhsh bashkë me sa fëdigë e t' idhun ; anì nd' e vonë, ndo të bânj qi të dergjésh 8) e t' i hásh mbë brînjë 9), pa ndiem ndonjë shij e dëshír prej ncosh ; ndo të bânj qi per të çpejtë t' i lâsh shkret, e të tjerë mbas mortje cote të t' i gëzonjën : E t' i, per lakëmí tande, mbas gjithë kënco damesh, ke endè me pasun per bashtinë mundimet e ferrit per gjithë jetet *(së)* jetës.

E këjo kafshë kish t' u goditëte mbë shumë vise per të vertetë ; perse sá e sá herë shterngon Zotynë shín, e s' e lâ me rám ndë kohot qf duhet ; e sá e sá herë e lëshon mb' azë herë kur âsht per dam, e jo per ndonjë dobí. A sá herë lëshon breshnin e thermon gjithë kafshët, ndo brymen e merdhif' gjithë frujtet ; ndo njegullen me vrug e ndrynkë 10) e çartë gjithë bulqit ; e kështû, per ketë mkat qi s' paguhet e dhjetta e Tinëzot e Kishës, posikundrëse ai vetë ka urdhënuom, thotë, se vînjën gjithë këto dame, qi thashë persipëri, endè sá e sâ mâ shumë të tjera të pánjefuna ; ashtû qi, ndo i kalben bulqít, duoj ndë lamë 11), ndo u çarten vênët 12) e u venë poshtë ; ndo

---

7) m e g j. n d u o r s h i. Edhe këtu shkrimi âsht mjaft i dyshimtë: *me gjithë duorncize*. 8) t ë d e r g j é s h. D. m. th. *të pësojsh ndonji smundë*. 9) t' i h à s h m b ë b r î n j ë. D. m. th. *rát mbë të shtrueme*. Fraza do të jét marrë nga goja e popullit. 10) Shkrim i mbyllët. Në tekst fjala âsht prû kështu : *«endryuk eciart»*, Verbi duket të két lidhní me v. ts. *ndryqen* = *mrrudhem*, *përthahem*. Ndo mund të këndohet edhè : *e ndryku e çartë* = *ndryshku*, tue përkthye fjalën latine *rubigo*, e cila përveç vështrimit të parë *ndryshk* (hekurit, etj.), don me shenjue edhè nji lëngatë, qi u bjen grunajvet ; it. *ruggine*. 11) b u l q í t, d u o j n d ë l a m ë. Fjalën *bulqí*, të cilën e përdorë pa dá këtu, e merr në kuptimin, si e kanë katundarët e disá krahinave : *të mbjellunat*, *bereqetet*. Ashtu edhè *duojët* janë dorsat e kollomboqit, sidomos, të lidhuna tue c korrë n' arë. 12) v ê n ë t për : *vëneshtat*. A se, e ka përgjithësisht për fjalën *vendet*.

bje zjarmi e i djeg, ndo u bje lëngimi qévet e kualet e dhendet e gjâs së gjallë, ndo nja dam, ndo një tjetër, aspak këjo kafshë, kurraj me të mirë nuk i shkon atij qi âsht verbuom aqë fort ndë lakëmí të mallëkuome, e aspak s' do me paguom të dhjeten shintes Kishë, posikundrëse âsht urdhëni e vullëndetja e Tinzot.

(Nga vepra «DOKTRINA E KËRSHTENË»)

b) Të mbraztit e jetës

«Këtu duo të thom pak fjalë ncë permenduni cë mortsë e madhështie e ncë pánjofuni cë njerëzet» 1)

O i páfati nieri 2)
Gjithë ndë të keq harruom;
I dhâni ndë madhështí,
Me mkat pshtjellë e ngatërruom.

Ndo plak jé, ndo i rí,
Perse s'shtie të kujtuom,
— I vobeg, ndo zotëní —
Nceje jé i krijuom ?

Balte e dheu cë zi,
E jo ari cë kulluom ;
As Engjishi cë Tí,
Ndo guri cë paçmuom.

Kaha të vjen ndore ty,
Me të madh më u levduom,
Ndë sqimë 3) e ndë madhështí.

---

1) n c ë p e r m e n d u n i etj. = *mbi kujtimin e dekës, mbi kreni e padije të njerzvet.* D. m. th. ignorancë, pse s'duen me i dijtë do sende. 2) Per të plotsuem numrin e nevojshëm të tetërrokshit, si tinglli i gjatë ká vlerën e dy rrokeve, sikurse edhe *ë*-ja, njehet mâ të shumën si rroke e vërtetë, në daç mbrenda, në daç në fund të vjerrshës. 3) s q i m ë : *kreni, lavdí.*

Lavdinë tand të levduom
Ti pa vênë rè vetë;
Ame cote idhënuom,
Kúr leve ncë ket' jetë.

Aty s' prûne begatí
As vistár të levduom,
As urtí e diekeqí,
As gurë të paçmuom.

Atŷ s' prûne madhështí,
As dinje me ligjëruom;
As vertyt, as frimëní,
As vetiu me ndihmuom.

Atŷ s'prûne zotëní,
Kual të bukur, as të çpejtë;
As dinje gjak e gjení
As të mirët', as të keqtë.

Po leve gjithë mëndryem [4]
Ame nconte idhënuom,
Tue qám mallëngjyem,
Me një zâ të helmuom.

Se tjeter s' dinje me bâm,
As vetiu me nimuom;
Gjithë zhyem e pegám,
As dinje me ligjëruom.

Veçëse me thirren váj'
Me një zâ të helmuom,
Këjo tjetër nukë mbáj,
Veçë se me kallëzuom.

Se erdhe mbë këta jetë,
Të pakë me kundrështí,
Gjithë váj e shigjetë
E plot me anmiqësí. . .

---

4) mëndryem = *i ndýt.*

Nde e vonë, o i mjerë,
Mâ idhun' e helmuom,
Dám këнco jete jete c'errë
Kie me qenë menguom. . .

Endè, mos mos i zê besë
Këto fjalë me e shkruom;
Pa hînë ndë kuvenesë,
Ndë vetëhe tu' u kujtuom.

Tue vûm ré vetë,
Sá gjind e trimëní
Njofunë mbë ketë jetë
Dergjenë ndë vorr të zí.

Kû janë ata pleq bujarë,
Qi qenë përpara né;
E ata trima sqimatarë 5)
Të shpejtë, e si rrufé?

Kû janë ata djelm të rí,
Të bukur, të lulëzuom,
Qi pate pá me sŷ,
Me ta folë e ligjëruom?

Kû janë ato zotënî,
Qi dojin me zotënuom,
Ndë sqimë e ndë madhështi
Ketë jetë tue e shkuom?

Kû janë ata Perandorë,
Gjithë shekulli nalcuom,
Mbë krye me një kunorë
Gurëshi çë páçmuom?

Ku janë ata letërorë
T'urtë e dies të ndëgjuom;
Të bardhatë, posi vdorë,
Letëra tue këнduom?

---

5) *Sqimatarë:* krenarë, madhështorë.

Kû janë ato grá e vasha,
Ndë sqim' e ndë madhështí.
Me petëkat të mëndashta,
Nalcuom mbë zotëni?

Gjithë mortja i rrëzoi,
Sikúr i pret me shpatë;
Per të rí si shukoi
As' të vobeg, as t' begatë.

Forca gjậ s' u vëjeu,
As e madhe zotëni;
As vistarí s' i shperbleu
As urtë 6), as diekeqí. . .

Práshtû, o i kërshtênë,
E i Tinëzot kushdo jé,
Shpëresenë mos e vênë
Kafshëvet mbë ketë dhé.

Se janë gjithë ngënjime,
E të mbrazta mirëfilli;
Gjithë plot me mallënjime,
E të zeza, si thëngilli.

(Nga «DOKTRINA E KËRSHTENË»)

c.) — Këtu thomi mkat c' Adamit e nc' Evës, përindët parë

Kish' të djeg' me ligjëruom 1)
Se jam gjithë ndë të zí,
Ditë e natë tue kujtuom
Të lumtë 2), qi pat njerí.

Aj Adami i levduom
Me Evenë, dy të rí,

---

6) *As urtë:* urtí.

c) 1) Kish' të djeg: *Kam deshir të flakët..* 2) Të lumtë As-njansi për abstraktin: *lumnín.*

Mbasi qénë krijuom
Pak mbetnë ndë nierëzí.

Perse s' deshne me ndëgjuom
Urdhëninë, qi qe dhânë,
e Sinëzot urdhënuom,
Njaji peme mos me ngrânë.

Se mb' at herë, qi t' a zîni
Ndore ncoje me ngjënuom, 3)
Me vdekunë mortjet kini,
Kënci shekulli me shkuom.

Mâ ata, tue qenë
Dy të bukur e të rí,
Si Sinëzot ishnë dhânë 4)
Pá mkat, pá majshtrí.

N' atë paq të ngushëlluom
Tri horë e gjymzë e mbi, 5)
Nde e vonë, si â shkruom,
Erdh diálli me mjeshtrí.

Me ta tue ligjëruom,
Si një gjarpenë i zí,
Ndjer' i bâni me ngjënuom,
E i shtiu ndë mëní.

ç) — Thotë, se Adámi, mbassi fëjei me Even, ke ishin mshehen' ndë mjedist' pemëvet (të) Parrisit, gjegj' zanë e amblë të Tinëzot, qi tha, se «*Adam, ubi es?*»

O Adami i helmuom,
Me Evenë dy të rí,
Mse ini mé larguom? 6)
Pa deli, t' u shoh me sy!

---

3) Ndore ncoje me ngjënuom. *Këso peme, kësi lloji.* 4) Si Sinëzot ishnë dhânë. Sikur ishin krijuem (falë, prej Tinëzot). 5) Tri horë e gjymzë e mbi: *Mâ shum, mbí se trí horë.* 6) mé larguom: *Mé (té)*, për: *meje (teje)*.

I cilli, tue ndëgiuom,
Mâ qish me thânë s' dij',
As kish kaha me shpëtuom,
As faqe perpara tij.

Frike tue cokëlluom,
Gjithë zemëra i u ngrîj;
Ke hîni me responduom,
Fjala mbarë nuk i vîj'.

Tue thanë, se: U mzí,
O Zot' im i ngushlluom,
Zânë t' a gjegjem ty,
E s' kucoj me t' u kallzuom.

Se dueshunë jam, e s' dij,
Kû të mshihem me shpëtuom,
Turpnë e mbarrenë vetij,
Zoti im, tue e shukuom.

d) — «E Zotynë Adámit mbet e i tha, se:»

Anì qish flet, i helmuom,
O kush të msoj ty,
Ti me ndiem të zbuluom,
Ndo turp e mbarre vetí;

Veçë, ndë kie ngjenuom
Pemet, qi të paçë thânë,
Ncoje fort me larguom,
Me dorë me mos e zânë?

E Adámi fort gjëmoi
Ndë zemerë tue thânë:
Eva muo m' a levdoi
E më nziti me e ngrânë.

Qi e urdhënove muo
Ndima ime me më qênë,
Ajo me dënoi muo,:
Këjo mâ s' âshtë rrênë.

Anì Evës i jerdh korí,
E i foli me ndishqi :
Qish kje këjo punë, morí, ?
Mse hîtë ndë mëní ?

E cija i ligjëroi,
Plot me váj, tue thânë:
Muo gjarpëni më msoi,
E më nziti me e ngrânë.

Aty të madhe furí,
I Madhi Zot kallëzoi,
Kúr u nkthé me mëní,
E gjarpënin e mallkoi.

Ashtu endè persëri
As Adamit s' i a vonoi,
Po m' Parrísit të tí 7)
Jashtë e qiti e e vdoi. 8)

Ndeper vepërat e tí,
'Ndè dhén e mallëkoi,
E me sá kundrështí
Gjellenë i a permetoi.

(Nga «DOKTRINA E KERSHTENË»)

e) — Të rrekumenduem e të poresitun Upeshkëpinjet e Vikarinjet e gjithësá tjerë Prelatë gjinden ndë gjuhu tanë 1) t' Arbëneshë

Të Ndritëshim e shumë të Ndershim Zotëní e shokë e vëllazen, tue dashun me u nëkuom 2) sá tentacjonesh e fëdigësh, qi më kanë gjetun mbë ketë udhë 3), druo se ká me (*i u*)

---

7) Po m' Parrisit. *Hjektore dasije.* D. m. th.: *Por prej Parrisit*
8) e vdoi: *E dboi, e qiti jashtë.*

e).1) ndë gjuhu. Budi, e vetëm ky, sidomos në ketë fjalë *ë*-n e shkruen me *u*. Mâ poshtë ka *gjuhus* për *gjuhës*. 2) me u nëkuom. Kështu e ka gjithkund, e jo veç Budi, por edhe tjerët, për të soçmen: *Me u ankuem.* Vre mandej, si vijon gjithnji edhe në ket auktuer diftongu i vjetër *uo*. — sa tentacjonesh. Kupto: *Idhnime, kundërshtime, vishtirsí e múnd.* 3) mbë ketë udhë. *M'at*

BKSH

dukun kújnaj se duo me u levduom... mirë tue pám Zotnija i Juoj [4]) se jashtë këncosh [5]) endè sá tjera letëra me dorët të shkrueme gjinden mbë sá vise, i dëshmonjën se sá i madh ká qenë gjithëherë kujdesi e dëshiri i zemrës sime per ndimët të Patrjes e të gjuhus per të mësuom.

[...] Të cijën kafshë [6]), endè sa tjera plagë të shpirtit tue i kujtuom veçë se kur mplasa [7]) vikarí e famullí a sa tjera ashtu kafshë, qi per shumë mot mbajta në Shurbít [8]), e u dásh andej, erdhshë mbë Romë; ke [9]) me fjalë e me të shkruome s' mengova me avizuom e me bâm me dijtun Shintin Atë Papë, Pálin V. e gjithë të Ndritmen Kolegjen e Gardinajvet; të cijët, mbassi e ndegjuonë mirë kafshen, permetuonë me vûm roe pakzë, se me qish mëngjí e rremendje [10]) munë bânet. Mâ [11]) ndë e vonë, disa û tue qenë vetem e pá vesht aqë ndjerë nd' anët [12]), disá tue mos qenë kush ndimë, ish mos [13]) kundershtarë e shtiekëqi, asndonjë kafshë s' u mbaruo, jashtë anco Doktrine, qi me sá fëdigë e t' idhun mbëzi i bâna me e shtampuom. Të cijën, mbassi e dergova, kúr tue pám, se asndonjë tjeter ndimë s' jésh i zoti me bâm, mplasa gjithë kafshët, e, veshun si Pelegrî [14]), vojta kaha munda me mbërrîm: Vizitova viset e devotshime të Shintet [15]), e mbusha kushtimet e bâme [16])

---

shleg a rasë, kur vojti në Romë, për me i rá mbrapa të shtypunit të libravet shqip *(Doktrina, Pasqyra,* etj.) 4) Z o t n i j a i J u o j. Ndërtim mbas veshtrimit *(constructio ad sensum).* 5) j a s h t ë k ë n c o s h. Për: *kësosh.* Hundzimi i ablativit, me të cilin âsht mbushun Buzuku, shkon tue u rrallue tash në Budin e ndër shokë e diftohet mâ fort ndër peremnat (*këncish, anco*) e në nenin *nce.* Për t' u theksue âsht edhe shëndrrimi i *s*, në *c*, ndër trajtat sidomos të naltpërmenduna. 6) T ë c i j ë n k a f s h ë. Për: *të cilën k.* E kështu gadí në të gjith librin e ka ketë trajtë. 7) k u r m p l a s a. Kupto: *Lëshova, laçë m' anesh.* 8) n ë S h u r b í t: *në Serbít.* Edhe Bogdani e thrret simbas gabimit të kohës kështu Kosovën. 9) k e m e f j a l ë. Këndo: *Kû me fjalë.* 10) *mengjí: Bár, mjekim.* 11) Mâ ndë e vonë. *Por ndë e vonë,* së mbrami. d i s a... d i s a. Lidhsa përgjegjse *(korrelative): si ...ashtu; haj... haj.* 12.) p a vesht djeri nd' anët. Plotso: *I pa marrun vesht krejt, plotsisht; pa i dijtun të gjitha.* 13) i s h m o s. Për: *në mos; për mos me thânë...* 14) P e l e g r î: *Shtegtár i përshpirtshëm.* 15) *të Shintet.* Gjinore shumës e sinkopueme: *Shintëvet.* 16) m b u s h a k u s h t i m e t e b â m e. D. m. th: *Çova në vend, përplotsova kushtet, qellimet e bâme.*

atŷ e ndjerë m' Shën Jakobt e Galicjes. E andej, mbas 18 muojsh, persërí mbë Romë tne nkthyem, gjeta leterrë e Atit [17]) shum ncë Ndershim, Fra Gjoani Koleshit, Upeshkëpi cë Arbënit, se Doktrina ajo [18]), ndonëse me pak fajt tem e të shtampatorëvet, asgjâmangu káme qenë ndonè gjâkafshë per ndimët të atí kërshtenimi. Të cijën kafshë tue e gjegjun [19]), mb' atë ças u mbushë *(shë)* endè mâ teper plot me dëshír qi endè mâ me qishdo copë letrë me i ndimuom ; e aqë mâ teper gjâkafshë per *të Rrëfyemit*, qi dijë, se mbë disá vise mâ u harruo e, ke s' u harruo endè, po pak e rrallë sherbenet si do ligja.

Të cijën kafshë tue e kujtuom, mora per disá dit *(e)* nkëtheva një Konfesionare giuh cë latine mbë giuhën tanë t' Arbëneshë ; e mbassi e mbarova, suplikova e u lutshë Shintit Atë Pálit V. qi persipëri, a të bânte aq hír, si *Doktrinen* me e shtampuom me spenxe të vet. I cilli, mirë tue e ndëgjuom [20]) kafshen, i a dergoi ndë dorët të Mjeshtrit të Pelasit [21]), e Mjeshtri i Pelasit, tue e vûm roe, i shtiu shkag, se qênka kafshë plakë, e jo aqi e mirë. S' desh m' e perzânë [22]), po më tha me kthyem e me bâm nji tjeter ; të cillë mbas disá ditsh endè atë si e mbarova, tue më dukun kafshë fort e shkurten e e mbershelë [23]) per gjûhu tanë, s' më pelqei, po mora endè këta të treten ; të cijën per sá dit mbassi e mbarova, here cë keqe [24]) ndë e vonë s' gjindéj [25]) asndonjë Doktuer këtû gjûhe sonë, qi të kish m' e pám e m' e provuem, si â zakoni.

E kështu, mbas sá helmi e nc' idhuni, ndë e vonë m' u desh me votë jashtë Romen ke nja frat gjûhe s' onë, andej Rantesjet, anës së Krues.

---

17) g j e t a l e t e r r ë. Për kallxoren e caktueme: *letrën*. Kështu thomi edhe sod: *Të birë e Pjetrit; zjarrë e votrës.* 18) s e D o k t r i n a a j o. Nënkupto: *në të cilën letër thonte, se...* 19) t u e e g j e g j u n. Në veshtrimin e Buzukut: *me ndiem, tue ndëgjuem.* 20) t u e n d ë g j u o m: *tue kuptuem;* simbas veshtrimit origjinár të fjalës, kah ka dalun *(intelligere)*. 21) P e l a s i t. *Palacit, pallatit.* 22) s' d e s h m' e p e r z a n ë. *Nuk desh me e pranue, me i dhânë pelqimin.* 23) e m b e r s h e l ë: *E mbyllët.* 24) h e r e c ë k e q e: *Për fat të keq.* 25) s' g j i n d é j. Në Buzukun kemi pá, se ky e shkruen ketë trajtë me zânoren e fundit *(é)* të gjatë, si Budi, por pa skâjim.

[...] E kështu nde e vonë, kúr mâ tue kujtuom me e mplasun gjithë kafshen e me shkuom, Zotynë m' a di, e m' âshtë per dishmí, Zotëní e shokë e vëllazen, e se nd' aqë veç kúr të gjejshë mb' anët 26) të djatht (*të*) nji kështll qi më tha: se: Sá mâ të fëtigesh, aq mâ mirë kié me i mbaruom gjithë kafshët. Të cijin zâ, o këshill, aq bukur nçelë qi e gjejshë e e ndëgjova, sá mb' atë ças pernjiherë tue mpshîm lotët e tue dhânë lavdin Tinzot, e Zotnjës së bekuome, u mbush (shë) gjithë plot me gazmend e me ngushëllim e me shpëresë me i mbaruom gjithë kafshët.

E kështu, mb' atë ças vojta xûna fíll persërí sá mâ per të çpejtë qi munda. Shkrova e i ndëreqa mâ mirë gjithë kafshët, qi keshë shkruom e bâm gatí mâ mpari; edhè mâ teper nçtova *Rubriket e Ritualit* (*të*) Romës, ne gjithsá tjera urdhënime ká ndë vetëhe, me shpëresë endè ato bashkë me tjerat me i shtampuom, sikundrëse thashë persipëri.

Të sijat, sikundrëse ashtu ish vullëndetja e Tinëzot, posá pernjiherë tue i mbaruom, veçë kúr të mbërrie i ndëjyemi 27) Dom Simonë Ngjeçi, prej Lezhe, me lypun Upeshkëpín e Zadrimës. Të cijën këtu mirë tue e njoftun njerí të dijtëshem e plot me leter, mb' atë ças i a dhánë e s' i a menguonë: E, jo veçë se Upeshkëpín qi lypi, po ashtu endè gjithë këto letra e të shkruomet e mí, më të cijat i kishe mâ shurdhuom e merzitun, atij i 'a dhánë e i a rrekumanduon, me i pám e bukur me i provuom se po si jesën, 28) o per qish ndimë kanë me qenë t' atij populli. I cilli ka pak per gjithë ditë bukur tue i vûm roe fjalë per fjalë e puntë per puntë 29), per një herë tu' i mbaruom, mbet e tha, se: *A Domino factum est istud, et est mirabile in oculis nostris.* 30)

Anì mb' atë ças muor penden e kalamarrë 31), e jo veç se

---

26) kur të gjejshë: *Kúr gjegjësh.* 27) i ndëjyemi: *i mjeri, i pervajtnemi;* ndërsa toskët e kanë gjithnji: *i ndyeri, i ndjeri.* 28) se po si jesën. N' origjinal: *se pa si jesen.* Kupto: *Për me i pá, si janë*, etj. 29) puntë per puntë. Ital. *pikë për pikë*, 30) *Vetë dora e Zotit e ká punuem, edhè âsht nji gjâ e mrekullueshme për sŷ t' onë.* 31) kalamarrë. tal. *calamaio*, = gota e ngjyrës.

me dorët të vet shkroi e i bâni ketë dëshminjëní, qi â vûm persipëri, po ashtu endè vetë hîni ke Mjeshtri i Pelatit 32) e mbë sá vise tjera, ke qe zyra, tue i lutun, qi per gjithë arrsye të shtampohet, se ká me qenë per të madhe ndimë e të nçelët sŷtë e shumëvet.

[...] Prashtu, o Zotëní e shokë e vllazen, tashti endè sa âsht moti e koha, éni nqohemi e nçelnjem sytë pakzë vetë ndë vehte, mos na gjênjë mortja me sŷ të mbërshelë e tue fjetun ndë gjumët të pakujdesit, me vdjerrë Rregjënín e qiell'et...

(Nga parathânja e veprës
«PASQYRA E TË RRËFYEMIT»)

3. — FRANG BARDHI — Fjalori (1635)

Imz. Frang Bardhi leu kah mbarimi i vjetit 1606 në Kallmet të Zadrimës, nga shtëpija e përmendun e Bardhejvet, e cila i fali hjerarkís kishtare shum Ipeshkvîj e Priftën, përveç sa Kapidanash ushtrije, qi sherbyen nën flamurin e Venedikut.

Kushtue edhe Frangu qyshë i rí udhës së Meshtarís, shkon për t' u pajisun me këndimet e nevojshme, së parí në Kolegjën ilirjane të Loretit, e mandej në Seminarin e Propagandës në Romë — themeluem pak vjetë para prej Papës Urbanit VIII. nergut për gatimin e klerit të vendevet të hueja.

N' atë ndërkohë ungji i tij, Imz. Gjergj Bardhi, ishte Ipeshkëv në Zadrimë; edhe, nji vjetë para se me u dhânë fund këndimevet, Frangu i ynë u kthye ngutsisht në Shqipní. Shkaku kje, pse shì ndër ato ditë kishte vdekë Imz. Pjetër Mazrreku, Kryeipeshkvi i Tivarit; e mbassi Roma dërgonte Gjergjin atje me i a marrë kambën, shuguronte ndërkaq Frangun Ipeshkëv, për me i a zânë vendin ungjit në Selín e Zadrimës. Kjo Ipeshkvî përshînte aso here dŷ djoçeze: *Sapën* (Zadrimën) e *Sardën* (Shurdhahin).

32) M. i Pelatit. Mâ nalt: *Mjeshtri i Pelasit*, qi ká në dorë censurën e libravet.

Në të nisun për në Shqipni ep dorën e pelqimit për ri-shtypjen e Doktrinës së Budit. Kalon nepër Venedik, ku ndalet nj' a dý jàvë, sa me shtypë nji vepër të veten të vogël, latinisht, qi e kishte gatuem në Romë. Ishte kjo nji përgjegje, qi i bânte njij Ipeshkvi boshnjak, njij farë Gjonit Tomak Maranaviç, i cili kishte pasë guximin, në nji shkrim të vetin, me e qitun Skanderbegun, boshnjak e shì fisit të Marnaviç-vet. 1)

Vjetin 1636 pra Imz. Frang Bardhi kthehet, Ipeshkëv i ri, në vend të vet, ku merr në dorzim prej ungjit djoçezin. Plot zéll veprimi, i shpërvielet punës, kërkon gjithkund fushës e malit vathën e vet, tue i dhânë rregullisht vjetë për vjetë raportat e duhuna Propagandës në Romë. Këta mund të këndohen edhè sod në bibljotekën e këtij Kongregacjoni, ku gjinden sende fort të randsishme për historín e dheshkrojën e Shqipnis.

Mjerisht veprimi i gjáll i këtij Prelati nuk e pat të giatë: vetëm 7 vjetë. Kaloi në jetën e vërtetë rreth fillimit të Korrikut në vjetin 1643.

Fjalori. — Qyshë student në Loret kishte bâ mendim me shkrue ndogjâ shqip, për t' i ardhun në ndihmë vendit të vet. Për ket qellim u vû e rreshtoi nji fjaluer latin-shqip, për me i a lehtsue, sidomos klerit shqiptár zyrën e vet, mbassi ky për faj të rrethanavet, nuk gjindej i gatuem sa duhej në gjuhën latine. Edhe kështu, kur kje në Romë, trimnue e levdue prej Eprorësh e kołegësh, me gëzim të madh të vetin e botoi veprën : DICTIONARIUM LATINO-EPIROTICUM 2).

Fjalori i Bardhit 224 faqesh në format XII përmbledh afër 5000 fjalësh. Fjalës latine ndonji herë i vên për brî edhe atê

---

1) Qe titulli i veprës: GEORGIUS CASTRIOTUS Epirensis vulgo Scanderbeg Epirotarum Princeps fortissimus ac invictissimus Suis Patriae restitutus *Per Franciscum Blancum*, Venetiis, Typis Marci Ginammi. MDCXXXVI. Të këtij libri, 76 faqesh në VIII. janë hetue deri sod ndër bibljotekat e Europës, nj' a katër copë. Kopja e Bibliotekës së Vatikanit ka ket shenjim: *Barber. Z. IX. 2.*

2) Titulli i plotë i Fjalorit të Bardhit: DICTIONARIUM LATINO EPIROTICUM Una Cum nonnullis usitatioribus loquendi formulis Per R. D. Franciscum Blanchum Epirotam Coll. de Propag. Fide Alumnum. Romae, Typis Sac. Congr. de Propag. Fide. 1635. Superiorum permissu.

italishten ; ndërsa shqipen shpesh e forcon edhe me fjalën turqishte. Përzien aty këtu edhe fjalí të shkurta e mënyrë të thânuni. Në mbarim të Fjalorit auktori ka bâ edhe disa shtesa : 1) rendi i numrorvet themelorë e rreshtorë ; 2) emna gjaku e gjinije, (mashkullorë e femnorë) ; 3) „emënat e gjytetevet e të Kështjell'et (t') Arbënit", etj. përveç emnash, krejt latinisht ; 4) adverbat, me shembuj ; 5) Prepozitat ; 6) Interjekcjonet ; 7) Fjalë t' urta, ase Proverba (113) — mâ i pari përmbledhës shqiptár ! — Vîjnë mâ në fund disa mënyrë të të përshëndetuni me nji djalog të shkurtë. E mbyllë me nji vrejtje përsa u përket gabimevet të shtypit.

Me gjith të meta, sidomos në mënyrën e përpilimit e zgjedhjes së fjalvet, qi mund të két **Fjalori** i Bardhit, prap, për né sod ka randsí të madhe ; jo veç pse ky âsht mâ i pari fjaluer i shqipes, por edhe pse shum fjalë me kaq na i ka pështue prej errsine së harresës, a nemose, na e ka trashiguem veshtrimin e vërtetë të tynve.

Me rishbotimin foto-mekanik të Bardhit, krye nepër zéll të Mario Roques në Paris 1932, i âsht bâm shqipes nji sherbim fort i madh.

a) Nga Parathânja e Fjalorit

[...] Prashtu u lus, të dashunit' e të vërtytshimit' e mí, për të mirë táj, qi të vîni kryet e mentë me gjithë zemërë e fuqi këtij Dicjonari, e të mos e lëshoni ndoret e mendjet, ke due [1]) t' a merrni vesht e të zîni qish thotë e qish mbson. E unë u permetonj [2]), qi per të vertetë, në daçi pakëz' me u fëdigun', kini me zânë kësi libri, nde mos tjeter, me ndëgiuem [3]) qish urdhënon Kalandari, ò Ordinari e gjithë Rubriken' [4]).

[...] Ndjeri tash ini skuzuem nder këto kafshë me të paditun' të trashë, se s' patme ndimë, e s' patme liber, ku (të)

1) k e d u e. Këndim pakëz i dyshimët. Teksti ká : c h e t u e t a m e r n i v.
2) u p e r m e t o n j. Si gjithmonë për : *premtoj.* 3) m e n d ë g i u e m. Në kuptimin e parë : *me marrë vesht.* (lt. *intelligere).* 4) R u b r i k e n'. Kallxore, tue e bâ me u mvarun prej : *me ndëgiuem.*



DICTIONARIVM
LATINO-EPIROTICVM.

A

AB altera parte.	MBe tieteret ane.
Abraham.	Abrahami.
Abſcondere.	*Me mbſceſune.*
Abſens.	*Largh.*
Abſit.	*Chiofte largh.*
Abſolutus.	*Mbuſciune.*
Abſque.	*Paa.*
Abſque manibus.	*Paa duer.*
Abſtinentia.	*Tepercuerm.*
Aures.	*Veſcete.*
Accipitrariorũ præfectus.	*Crȣetee giatoreuet.*
Accuſare.	*Me padituné.*
Auicula.	*zog'bȝ.*
Acidia.	*Priteſia.*
Acidus.	*Pritues.*
Acies.	*Trimenia.*
Acinaces.	*Sepata.*
Actor.	*Baaſſ.*
Auere.	*Memprejune.*
Aquirere.	*Membeleȝe begatij.*
Ades dum.	*Eia tas.*
Adeps.	*Temaimite*

A Adx-

Fyt. 4. — Fotografí e njij faqje të Fjalorit ori gjinal të Bardhit

zinjimi; ma tash e kini perpara syvet ndë se mundeni me zânë e me marrë vesht ngiûhet zë latine [5]) qish u âshtë nevojë. Prashtu, nde mos dashi me u nçuem e me u lodhun' pakëz', u thom, t' e dini, këndý tutje as në ditet së gjyqit, perpara faqes së Tinzot, s' kanë me u vejyem mbosit [6]) e skuzet'.

[...] S' desha me lânë pá u bâm me dijtun', sikundrëse, mbassi e sosa, e pr' udhë e vûna ketë Dicjonárth, e shpuna [7]) Këshilltarít (të) Kuvendit shint (të cijt janë Gardhinaj) [8]) me ma shtampuem. I cili, si e pá, i ndý fort mirë [9]) se e keshe nkëthyem ngiûhet së latine mbë f' Arbëneshët; e më permetoi me folë e me m' a rakomanduem qt të shtampohet'. Ashtu nder pak dit [10]) foli zotnivet Gardhinaj'et, të cijt, mbassi e ndëgiuen' të bâmen [11]), e derguenë Mjeshtrit (të) Pellasit [12]), me e pám e me e provuem, e urdhënuenë me e shtampuem.

Prashtu unë u bâna e u shkrova ketë letër', qi âsht perpara kësáj mbë giûhët latine, me të cijët u dedikova e u fala ketë librezë, posi âsht zakoni i latinj'et, e me të pervutë u porosita të nevojshimin dhén e Arbënit, posi munden me pám kush ndegion latin.

Mâ tjeter ç' ju thom s' kam, veçse u lus gjithëve me të prûnjët', të më ndëjeni [13]) e të më skuzoni, perse s' mujta mâ mirë me e nkëthyem, me e mbushun' e me e ndërequn'; disa tue kjenë gjithë herë nzânë ndë leter' e ndë studje, e disa [14]) tue mos pasun' shumë mot me ká me razënuem [15]) e me folë mbë giûhët tanë, posi kùr harruem, s' erdhnë nder mend shumë êmëna e shumë fjalë me i vûm Arbënisht. E zinima besë, se

---

5) n g i û h e t z ë l a t i n e. Me nye (së) të tepërt, marrë për analogjí me adjektiva tjerë. 6) m b o s í t. Fjalë e bukur, prej së thâmes; *me i rá mboh.* 7) e s h p u n a: *e çova*, 8) G a r d h i n a j. Për: *Kardinaj.* 9) n d y m i r ë = *i erdhi mirë.* 10) n d e r p a k ë d i t. Prepozita *nder* në veshtrimin e parshëm *(intra): mbrenda pakë d.* 11) e n d e g i u e n t ë b â m e n. = *Mbassi e moren vesht punën.* 12) M j e s h t r i t t ë P e l l a s i t. *Mjeshtri i Palatit të shêjtë* në (Romë), i cili ka mbi veti cenzurën e libravet. 13) m e t ë p r û n j ë t' t ë m ë n d ë j e n i: *Me përvûjtni të më falni* (të më ndieni). 14) d i s a... disa... I kemi pa edhè në Budin këto lidhsa korrelative, për: *diku... diku; hem, hem.* 15) m e k á m e r a z ë n u e m. Br. ankohet, pse shum kohë s' kishte pasë atje në vend të huej *«me kê me bisedue»* shqip.

hîna me e lânë e me mos votë paret' [16]) me tâ ; ma mbë tjetëret anë kujtova e më ndý mâ mirë me nkthyem gjâkafshë, se asgjâ ; perse, nde mos gënjehem, më ndjet [17]), se nder t' errëtit pakë dritë vëien e kushton shumë.

Vullëndetnë e kujdesnë veç' Krijuesi i qiell'et m' a di, Vëllazenit' e dashun', si e kam, nde më lântë [18]) fuqia, me dhânë doren' e me ndimuem së pafates dorës s' Arbëneshë. Prashtu, perzinima [19]) ketë fëdigë sa âshtë e sido âshtë, posikur t' ish kafshë e madhe e e vëjyejtishime [20]), e mos u vinjë fështirë me uruem per mue. Itëni shëndosh !

Prej Rome, dit ndë Máj 30, ndë vjetët të Krishtit 1635.

Sherbëtori i Zotënisë sáj
Unë D. Frangu i Bardhë, Shkollár [21])
ndë Kolegjë t' shintes Fé.

b). Kuvend burrash !

1. — *Të përshëndetuna*

Mirë se të gjâj, Zot.
Mirë se u gjânj, Bujare, o Fisnikë !
Mirë se u gjâj, Trimat e mirë !

Të përgjegjuna

Mirë se të sjellëka e djathëta e Tinzot ! *(Ndo)*
Endè tý të dhashtë paq i lumi Zot !

---

16) m e m o s v o t ë p a r e t' : *Mos me vijue.* 17) m ë n d j e t. E kanë edhe tjerët për : *Më duket, më gitet.* 18) m ë l â n t ë f. E mbajtem gabim shtypi trajtën e tekstit: *me rante.* 19) p e r z i n i m a. *Perzâ* per = *pelqej.* 20) e v ë j y e j t i s h i m e : *E viejshme, e vlefshme.* 21) S h k o l l á r. Kështu thirreshin dikur ndër né, ata qi ndiqshin shkollën, nxansit (it. *scolaro*).

c). Të pyetunat e të responduemet Arbënisht:

— Ku ve, vëllá hoj!
— Prej Stambolli, endè i pelqeftë Tinzot, qi âshtë mbë qiellt
— Qish do me bâm nd' atë pjesë dheu?
— Kam me shitun' e me blém disa robe.
— Qish të rí âshtë nd' ato anë tuej (a) andej?
— S' dij qish deshëron me ditun', qi të të tham.
— A ké ti shoq?
— Jo, veç vetem' ershë [1]).
— A do me ardhun' me mue?
— A âsht larg konaku yt?
— Ngiat âsht: këtu tash t' a deftonj!
— Eja m' a defto, ké Tenzonë! [2])
— Çou nalt, e it këtu.
— S' dij mbë qish anë âshtë.
— Shuko mb' anë të djathtë prej së dalët së diellit.
— Ashtë nja shtëpí e naltë, posi kështjell.
— Po duket. A âshtë ajo?
— Vertet' thue [3]), ajo âshtë? Ngiat âshtë, o jo?
— Ec me Tënzonë! [4])
— U atje s' vinj!
— Qish dro, hoj! Perse s' vjen?
— Nata e mirë të kjoftë!
— Endè tý mâ mirë!
— ...Kjoftë levduem Zotynë, qi më dau nsi!

---

1) Ershë. Për: *erdhêsh*, *erdha*. 2) ké Tënzonë. I lëshon bê në Zotîn. Sod mâ fort me: *pásh*; sado qi ndiehet edhe formula e Bardhit. 3) vertet' thue. Sod mâ fort: *A përimend?* a me të vërtetë? 4) Ec me Tënzonë, për: *shko*. E kanë edhe tjerët e ndiehet edhe sod ndër Italo-shqiptarët.

4. — PJETËR BOGDANI — Kryevepra (1685)



169.

SCALA .IV.

LIGIERATA .VII.

SIBILA

SAMIA.

1 Sibila Samia, leu ndè Isulet Samos, ndè Detit Egeo, ndaj Traciet, ꭓjè reꞔ vjetit ſe Crijuemit ſe ſeecuꭓit, trij mijè dꝟchind, e nande ꞔjetè e dꝟ vjet. Parè Chriſetit 665. vjet. Gindetè ſe ꭓe jo Sibilè ndè venej ꭓeſetu. Ti ò popuʌi Giuꞔijet reꞔuem n'hirit nuꭓè gnioſtè Hꝟjnè tand, pò ende, e pèr chieꭓè, e me ferra i vunè Cunorè, e i pèrꞔievè ndè tè pijm helminè uꞔuꭓè.

Fyt. 5. — Nji fac-simile prej kryeveprës së Bogdanit «Cuneus Prophetarum».

Imzot Pjetër Bogdani, mâ i vlerti ndër shkrimtarët e hershëm të shqipes, pinjuell i familjes së përmendun të Bogdanvet, leu në katundin e Gurit të Hasit të Thát, në vjetin 1630.

Këndimet e nalta i kreu në Kolegjën ilirjane të Loretit e n' atê të Propagantës në Romë. Kje i laureuem në dy degë: Filozofí e Theologjí. Veprimi i tij zên fíll në djoçezin e Pultit;

por s' ngjatë shum, mbassi, i rí, 26 vjeç, emnohet Ipeshkëv i Shkodrës, tue mbarështrue njiheri për nj' a 5 vjetë edhe djoçezin e Tivarit.

Sundimi kishtár i bjen Bogdanit në nji kohë fort të keqe. Si shkerbé i duhet me marrë malin e fushën, për me i ikë furís së qeverís turke ; e cila mbytte, tue i vû mbë hûj e në litár, sidomos Ipeshkvîj e Priftën e Fretën. Kështu, djoçezin e vet e drejtoi tue ndêjë mâ të shumën jashta Shkodre : në Barbullush, në Shën Gjergjin e Mirditës, në Manatí mbi Lesh, e së mbrami në Rrjoll, ku edhe sod thirren n' emën të tij shpellat, ndër të cilat i u desht me ndêjë mëshehun.

Mbas 21 vjetve kësi sundimi të vështirë, ungji i tij, Imz. Ndré Bogdani, Kryeipeshkvi i Shkupit [1]), për arsye pleqnije, ep dorëhjekjen ; e Selija e shêjtë dërgon atje prej Shkodre Pjetrin, për me i a marrë kambën. Këtû i ep fund Kryeveprës së vet ; edhe, ndërsá gatohet me e çue në shtyp, auktoritetet otomane, të cilat atëherë ishin në luftë kundra perandorís s' Austrís, i vêhen mbë shpinë, edhe të ngratit Bogdan i duhet me e lânë vendin e Shqipnís. Me dorëshkrimet e librit të gatuem shkon së pari në Venedik e prej andej vijon për në Padovë. Këtu i bjen në dorë njij miku të moçëm, Kard. Barbarigu-t ; i cili e priti me dashuní e nderim të madh. Por Bogdani i ynë e kishte gjithnji menden te botimi i librit të vet, kishte „mallnë e shtampës". Me ndihmën e këtij Zotnije mundi, tek e mbramja me e pám veprën e vet të dalun në dritë.

Mbas dý vjetësh mërgimi, skjarue dishka punët, kthehet në Shqipní. Por deka i a këputi fillen e jetës ; edhe Bogdani, mbyllë veprimtarín e vet në Prishtinë, dhetorin e vjetit 1689.

Libri i Bogdanit, shtypun në format të madh — *in folio* — përbâhet prej dý pjesësh, se e cila me titull e njehsim faqesh në vedi. Asht dá dý shtyllash : teksti shqip, me përkthimin italisht përbrî ; përkthim, qi i kje urdhnue prej së Parësh. Para-

---

1) Kryeipeshkëv, njiherë i Ohrit e mandej i Shkupit. Për tê thotë i nipi, se paska pasë shkrue nji gramatikë shqipe, të cilën për rrezik, sidomos t' onin, i treti «si krypa nd' ujë», tue ikun prej salvimesh së Turkut.

thânja âsht vetëm shqip. *Pjesa I.* e librit ká në báll ket titull latinisht: *Cuneus Prophetarum* [1]). Veprën i a kushton Kard. Barbarigut, i cili i a kishte shtypun me shpenzime të veta. Ku parathânja e vrejtjet' shkrue prej auktorit; ku poezít e shkresët e urimit shqip, latinisht, italisht e slavisht qi i drejtojnë miqt, këto gjithsejt zânë 52 faqet e para, (të pa numrueme); mbas së cilash vîjnë 182 faqe me të njehun. Pjesa I. âsht dá në 4 *Shkallë* e se e cila *Shkallë* prap ndër 4-21 *Ligjerata.* Flitet këtu: Mbi krijimin e njeriut, mbi mëkatin e mjekimin e tij; mbi profetít e shkrueme rreth s' ardhunit të Mesís në botë; mbi jetën e Profetvet e paralajmimet e tynve; mbi jetën e ndivesët e Sibilavet, të prume në vjerrsha latine e të përkthyeme lirisht me njimbëdhetë rrokshe shqipe; mbyllet Libri I. me 6 *Ligjerata* përmbi 6 kohët *(jetët)* e shekullit.

Pjesa II. me titullin në báll: De vita Jesu Christi [2]), âsht dâ në *4 Shkallë*, se e cila me kah *3-9 Ligjirata*; të cilat siellen mbi jetën e Jezusit e të Nanës së Tij; mbi mrekullít e Shelbuesit, mbi mundimet e dekën e Tij, mbi të ngjallunt e mbi t' ardhunt e dytë të Tij në botë në mbarim të shekullit. — Para Ligjiratës IV. citatet biblike, të cilat flasin mbi hyjnín e Shelbuesit të botës, auktori, mbassi qi Vepra ka frymë apologjetike, i bjen të shkrueme në 8 gjûhë të ndryshme (latinisht, greqisht, armenisht, hebraisht, arabisht, italisht, e shqip). Me randsí âsht letra, qi vên në fund të kësaj Pjese II. *Mbi vjetërsín e shtëpís së Bogdâjvet.* [3])

---

1) «*Çeta e Profetvet*» Qe titulli krejt: «Cuneus Prophetarun de CHRISTO Salvatore Mundi et ejus evangelica veritate italice et epirotice contexta et in duas partes divisa a PETRO BOGDANO Macedone Sacr. Congreg. De Prop., Fide Alumno Philosophiae et Sacrae Theologiae Doctore, Olim Episcopo Scodrensi, et Administratore Antibarensi nunc vero Archiepiscopo Scuporum ac totius Regni Serviae Administratore. Pars prima. — Patavii, M. DC. LXXXV. Ex Tipographia Seminarii Opera Augustini Candiani Superiorum permissu.

2) *Mbi jetën e Jezu Krishtit*, etj. si në Pjesën I. 3) Mbas gjashtë vjetësh (v. 1691 e prap 1702) prej botimit të parë, Vepra e Bogdanit u paraqit në treg, si nji botim i dytë, me titull të rí, tash italisht: L'infallibile Verità etj. Kjo punë u bâ në Venedik prej njij farë *Girolamo Albrizzi*-t. Perveç titullit të gjatë, Vepra ishte krejt njajo e shtypuna në Padovë.

Në Bogdanin mund të thomi, se kemi mâ të parin shkrimtár të vërtetë të shqipes; për arsye se ky, s' âsht i kënaqun vetëm t' a biejë copën e përkthyeme, a të punueme shqip, sa për kuptim të popullit; por në tê kemi nji shkrimtár mâ të kujdesshëm e me nji styl letrár. Bogdani e ndien e e shijon gjuhën e vet, e na në kurrnji auktuer të vjetër nuk mund t' a nxâm gjûhën t' onë mâ me dobí, se në këtê.

Në shpirtin e Bogdanit, sikurse kemi mujtë të vrejmë edhè në Buzukun, Budin e Bardhin, vlon flaka e dashtnís për vend e gjuhë të vet. Edhe kuptohet prej vedit, sa do të két pësue zemra e njerzvet të shkollës e të ndërgjegjshëm aso here, kah shihshin rrenimin e Shqipnís e rrezikun me hupë kryekëput me gjûhë e kombsí etj. Kështu qi, kur i vjen për shteg, s' e lên pa i shtî në libër shkëndija atdhedashtníje e epizode të jetës shqiptare.

Orthografija e Bogdanit âsht gadi njajo e të hershëmvet; veç se, ndër shkrimtarë gegë âsht i pari qi nisë të bâjë ndryshim grafik ndërmjet *e*-s e *ë*-s.

Botimi në vedí i librit të Bogdanit paraqitet, sidomos për ato kohë, nji vepër luksi, stolisë me fotografija e me shkroja të mëdhaja nisjare, të punueme mjeshtrisht. 1)

---

1) E përkohëshmja «Lajmtari» *ka fillue në Nrin 1. Vjeti 50, Kallënduer 1940 të botojë veprën e Bogdanit ndër fletë të veçanta (në fund) krejt ashtu si doli prej pendës së këtij të dijtuni shqiptár, me të njajtat parathânje, poezina dhe stolisje mjeshtrore, me të cilat qe shtypun në Padovë në vjetin 1685, dhe me komentime e spjegime fjálësh e frazash, të daluna jashta përdorimit ase të dyshimta, të bâme nga At Mark Harapi.*

Deri sot janë botuem („Lajmtari“, *Vjeti 51, Fruer 1941) faqe 71 (të numrueme veçanisht jashta tekstit të zakonshëm të Revistës), kështu qi veprën e Bogdanit e kemi të ribotueme deri në mbarimin e Ligjiratës V të Shkallës I.*

NGA KRYEVEPRA E BOGDANIT

a) — Urim Auktorit

Shumë *(të)* Ndriçimit e shumë *(të)* Ndershimit
Zotit, Zotit, Timzot per ndér, Zotit
PJETER BOGDAN
Argjupeshkëpit *(të)* Shkupsë
Kushërinit tim
(*të*) dashunit.

*

Duel n' Gurit 1) bukuria,
Zâna, si nji sut' e naltë, 2)
Qi s' kish mbrenda Veneqia,
Të Peshtrikut 3) muer maltë.

Djelz' e vashaz' endè grá
I sherbejnë ndë robí
Tu' kënduem aqa, sá
Gjithë zemërat i çkrí' 4).

Aleksandr' i Madh Darinë,
Skanderbeg' shitoi Mbëretnë ;
E ndoq Sauli fort Davidnë,
Mbyti Gjudit' 5) Holofernë.

Të shekullit per të pasë
Të gjânatë rregjiní 6),
Janë levduem pa masë,
Sa me kallëzuem s' dí.

---

1) n' Gurit. Hjektore e thjeshtë, me hundzimin e vjetër *(në, ën, n)* përdorun fort prej shkrimtarësh së hershëm. Kështu Buzuku sidomos: *Kíj mëshrier ën nesh. Pat të dhimbtun ën si. Kam gjegjun (ndiem) ën kësi nieri. Porsi ere ën arë e (sicut odor agri) Bog. Kësi trajtimi e bukurije nshtati kje J. K.* Këtu: *Duel nga Guri* (i Hasit). 2) sutë. Nji farë drêni. 3) Peshtriku. Mal në Vlahnjen e Hasit, kah ishte Bogdani. 4) i çkrí. Për nevojë të rrimës, cungue skajimit: *shkrîn.* 5) Gjudit'; me skâjimin e hângun, për nevojë vjerrshe, si mâ nalt. Pra: *Gjudita, Aleksandri, Skanderbegu.* 6) të gjânatë rregjiní. Mbretní të hapta.

Kardinal' [7]), o Zoti ynë,
Gjithë nalt, sa Qiellt' i shkove;
Me të mirë tat [8]), Zotynë
Si levdohetë na mpsove.

Shqip, latin e Taljaní,
Gerqisht' endè Dalmatí [9]).
Jevreisht' e e Arapí,
Armenisht endè Sirí.

Këndoi Zâna maje mal'et
Anì zûnë me lodruem
Tek i thonë „Vrapi i kaul'et“,
Ndë zemerë fort gëzuem.

Tuf' e tufë tu' mbëledhë
Me zymbyla nji kunorë,
Drandafille bashkë dredhë,
Ndë këshet [10]) me gjithë dorë.

Lulesh: ani me i a falë
Blegëtorijesë Zânë,
Qi, ndë valle kúr të dalë,
Të na ndritnje dhenë tânë.

Prizerenë çelepí [11]),
Gjithë nd' armë mbukuruem,
Prej Goré [12]) dimisqí [13])
Trim i fortë me leftuem.

---

7) K a r d i n a l. Titulli mâ i nalti në hjerarkín kishtare. 8) M e t ë m i r ë t a t. Trajtë djalektare e Malsís së Mbi-Shkodrës, e pronarit asnjanës: *Me të mirë t' and.* 9) D a l m a t í. Numron këtu gjuhët, (8), qi gjinden të shkrueme në libër të Bogdanit. *Dalmatí*, mbas gjase don me e marrë për *kroatishte*, por prap âsht e tepërt, mbassi kjo gjuhë mbrendë në libër nuk rreshtohet me tjera; në mos pasët dashtë me çekë vjerrshat e urimit në fillim. 10) k ë s h e t: Flokët e gravet, mbledhun gungë mbi krye. 11) ç e l e p i. Trq.; shqip: *Xehe, vend metalesh.* 12) G o r é. Mal në zâ i Prizrendit. 13) d i m i s q i. Trq. shpatë Damashkut, e përmendun, e punueme mbi çelik me shkrola ari.

Kúr del ani, e soditen
Tregj të rí endè të vjeter,
Trimënia ke shetiten,
Thue, s' ká dheu tjeter.

Shkodra, ngulë ndë konfí 14)
Fush' e malet' i pushton,
Me të forta zotëní
Lesh, Zadrimen' e zapton.

Ndë leqên' me gjithëduer
Peshku, trofta endè blí,
Per ditë, kush votë, muer
Gjindsë (*s'*) vet në shtëpí.

Shkupja, gjytet Perendeshë 15)
Ndë rrazë te Lubotenit
Qi Rregjina Rodopeshë 16)
Trajtoi moter Prizërenit:

Argjupeshkëpí e ré,
Endunë per breg Vardari,
I shkon delli, ndeper dhé,
Rembje, shtambje 17), rgjandje e ari.

Grigja të njehunë s' ká,
Lesh e safian e dyllë;
Perse kush e mbële (dhë) s' ká,
Bleta shkret i kerkon pyllë'.

Këte (j) det (në) nd' Urumelí
Shkodra Prizerenë ká
Shoqe: Nd' Arbën' e Sherbí
Trí gjytete të medhá. 18)

---

14) konfí: *Kufi*. 15) Gjytet P.: Marrë, si të gjith të hershëmt, si femnuer: *Gjytetja*. 16) Rodopeshë. Emën mytologjik nga mbretnesha *Rodope*, e shoqja e mbretit të Trakës, *Enit*. E cila, për ndeshkim të zotavet, mbassi deshtën me u bâ vetë, burrë e grue, hyjní, kje shëndrrue e bâ mal, tue i dhânë êmnin e vet vargut t'atyne maleve. 17) shtambje. Lat. *stamnum* = kallaj, shtam. 18) trí gjytete. D. m. th. *Shkodra*, *Shkupi* e *Prizrendi*.

Nalt' mbë mal sjellë kunorë
Dore sonë s' Arbëneshë;
Turkut votunë ndë dorë,
Me të madhe sod' shpëneshë.

Tý lus, O Shenë Mrí,
Qi rri n' kishë (n') Prizërend 19),
Bân të dalë persërí
Kryq e flamburë me rend.

Zot Shelbuesi barí
Rruzullimnë t' a pushtonjë;
Gjithëkush donji selí
Mbë qiellt' ani t' a gëzonjë.

Këndoi
LUKA BOGDANI

b) Të prîmit' perpara letërarit 1)

[...] E madhe dobí e frujt âshtë prá, me ndërequn' ketë Shkallë t' urtisë e me të shkruem bukur me sqyrëtuem e me dijtun', se si (*i*) duhet nierit (*të*) temelitun' me u percjellë 2), sa âshtë mbë ketë jetë, me frujtit e shpirtit (*të*) vet endè të popullit; të mos lânë dijen' e giûhen' e dheut me u dvarun', posi lefton gjithë dheu e shekulli per të vet; po, tue u nalcuem prej urtishit, andej t' a ketë udob të fluturuemit' mbë qiellët e ndë Parrisit.

[...] Per nji zet e nji vjet, mbassi bajta barren' e Upeshkëpís' (*së*) Shkoders' e kujdesn' e Tivarit, dhânun n' aministracjon', kjeshë prej Shêjtit Atë Papë, Inocenti XI., vjetit 1677, bâm Argjupeshkëpi i Shkupsë e Aministratori i gjithë rregjënisë (*së*) Sherbisë, per të lutunat' (*e*) (*të*) fort (*të*) Ndriçimit

---

19) qi rri në kishë (n') P. Ka paıa sŷsh poeti Zojën e mrekullueshme të këtij vendi: *Auxilium Christianorum.*

b). — 1) Ital. *Prefazione al Lettore.* 2) me u percjellë: *me u persjellë, me u sjellë.*

e fort (*të*) Ndershimit Tinzot, pomendun' per ndér, Andre Bogdanit, tim ungji ; i silli mâ para kje Argjupeshkëpi i Ohërit, anì bâm Argiupeshkëpi i Shkupsë e i dheut (*të*) Sherbisë : Ashtu qi t' i gjindeshe afer' ndë mort' ndihmëtár, tue mos kjanë mâ i zoti me i u pruem 3) atij kërshtenimi, perse kishte per pleqëní kapercyem 80 vjet ndë lëngime të forta. Ky zot fort i urtë më dha fort zemer' me votë paret 4) ndë ketë veperë, endè tue më ndimuem pa kuer 5) fort ndë shumë fjalë t' Arbënesha, të sijat i kish' udob e per duer, tue pasun' bâm endè aj nji Gramatikë fort të godiçime latin e shqip. Ma 6), mbasi dviq 7), 13 dit ndë Deçembre 1683, m' u desh mue ndepeŕ punë të ushtëris' ndenë Beçit, shum' herë me ngrehun' e me çkrehun' librarinë teme, tue jau porositun' kjorëvet 8), gozhduem arkëvet e lidhun' thasëvet, e vetë tue ikun' malevet; aqa, sá Gramatika ndë këto të perzieme ntreti si krypa nd' ujët.

[...] Mboh nuk' i bie, se nuk' permetonj 9) me nxjerrë me ketë fëdigë kafshë të ré, tue mos kjanë mirë ndë kafshë të Fésë me u larguem se i kanë të tjerë mpsuem 10) e kallëzuem. Ma as marre nuk' më ndjetë 11), se ndjek të dijtëshimit', tue pasun endè shoqi shoin ndjekun'. (...)

Ashtu endè prej meje bukurín e giuhës, nuk e ké ndjerë nd' anet 12) ; perse, tue kjanë unë prej Guri ndë Hast', Sanxhakjet së Dukagjinit, Djoçezit së Prezërendit, m' âshtë dashun', me djersë të mëdhá, shumë fjalë me ndërequn ndë dhét (*të*) Shkoders' ; e tue kjanë vepëra fort e naltë e e hollë, giuha jonë, qi me dijet dvuer endè fjalët, fështír mundet' gjithë punët ndjerë ndë skâjt me i çtjellë 13). Prashtu leftova me ecun' njij udhe së ndermjetshime tue më rám ndë mend kanka e

---

3) m e i u p r u e m: *me i ardhë në ndihmë.* 4) m e v o t ë p a r e t. Këto trajta kanë përgjithësisht ndër të vjetër si verbi, si adverbi., për të soçmet : *me vojtë para.* 5) p a k u e r: *pa masë.* 6) *M a.* lt.: *por.* 7) d v i q. Metatezë, si e ka edhe mâ poshtë d v u e r, për: *vdiq* e *vduer.* 8) k j o r ë v e t; *raftavet.* 9) p e r m e t o n j; sod : *premtoj.* 10) s e i k a n ë. Plotso: *prej shka*, *prej se.* 11) n u k m ë n d j e t ë. E kanë edhe tjerët për t' onen: *më duket*, *më gítet.* 12) n d j e r ë n d' a n e t. Mâ pertej ká: *ndjerë ndë skâjt*, me të njajtin kuptim. 13) m e i ç t j e l l ë: *me i shtjellë.* Ndiehet edhe sod bashkë me: *çpejt*, *çpue*, *çdeshë etj.*

poetës : *Ornari res ipsa negat, contenta doceri.* E ku të mos mundemi me petkut' shqerrë [14]) të giuhës' sanë me mbëluem jeten' (*e*) Jezu Krishtit (*të*) Bekuem, asgjâmangu t' Lumit, qi leu ndë Grasht e vdiq mbë Kryjt [15]), nuk ka me i ndŷm mbarre [16]), endè arbënisht me u veshun', ndë nji dhé të vobeg, çperblém [17]) me gjak të vet të paçmuemit.

[...] Andaj kanë me u dukun' zgedhësit [18]) disa fjalë të shkurtëna e jo fort të çtjella. E sija punë vjen per dý arrësenjë : Njana, perse nuk' po mundej ndë shtampet me dalë shtylla kundruell' e njimendë e e goditçime [19]) me tjetëret ndë fjalët e ndë vjerrsh', tue tepëruem diku nji njanet giuhë, diku nji fjalë, o mâ shumë tjetëret ; e kështu, tue kapercyem shoqeja shoqen, nuk po vejinë me rend e me godi, si po deshëruekeshe. E dyjta, perse per të sherbyem dheut, deshërova mirëfilli, qish po flasnë italjanisht, bukur' të kumbon e të kallëzon [20]) arbëninisht' ; ashtu qi nieri pa mashtrí, jo veç të marrë vesht shqisen' e fjalëvet [21]), po endè të jetë i zoti me xânë giuhen', i Arbëneshi italjanisht, e italjantë arbënisht, tue u sherbyem [22]) posikur t' ish nji Kalepí [23]). Andaj, endè âshtë dalë [24]) vepëra pakëz' e hollë, ma teper' ndë punë të Teologjísë, per t' a marrë vesht ; endè po drue, se jo gjithëkuj e pelqyeshime, tue votë unë mbas disa fjalësh plaka, të mos harrohej e të dvarej giuha.

E tue dashun' i Lumi Zot, qi këjo veperë mâ të delte mbë dritë, zû Nazëri [25]) i Shkupsë fort me më perzánë, ndeper ata veshtirí të perzjarshime, qi këso kohëje zûn' fíll' nd' Unge-

---

14) shqerrë. Shkon mbas typit të mâparshëmvet, prej: *me shtjerrë*, (me shkye.) 15) ndë Grasht... mbë Kryjt. Vre këtu përdorimin e perpikët të prepozitavet *ndë, mbë.* 16) me i ndym mbarre: *me í ardhun marre, turp.* 17) çperblém. Trajtë mâ afër amës, kah ka rrjedhun (blém) Sod: *shpër-blyem* (lt. *redimere).* 18) zgedhësit: *lexuesit.* 19) e goditçime. D. m. th. *e përkueshme*, tue pëlqyem, për kah rreshtat, teksti shqip me atê italisht. 20) të kumbon e të kallëzon. Diftorja në vend të lidhtores: *të kumbojë* etj. 21) shqisen e fjalëvet. Për: *kuptimin, veshtrimin e fjalvet.* 22) tue u sherbyem. Italjanizmë *(servirsi).* 23) Kalepí. Fjaluer shum gjuhësh, nga emni i auktorit të parë latin *Calepinus.* 24) âshtë dalë. Mbas slavishtjet, e cila, si verb ndihmtár, ka vetëm *jam.* 25) Nazëri: Ministri a sundimtari turk,

rít. Prashtu, tue mos lânë mbrapa fëdigen' teme, mora liberë 26) e vojta në Veneqí.

[...] Më duel puna fort mbarë e per të çpejtë. E ndone 27) nuk gjeta karateritë arbënisht, posi paçë deshëruem, u sherbyesh' asgjâmangu me disa letëra 28) të Gerqisë, tue besuem, se zgedhësi 29) ynë i Arbëneshë, me urtí të vet, gjithë fjalët' ka me i venduem ; posi bâjën Françezët e Tudhesqitë 30), të sijtë ndryshej shkruejnë se si zgedhin'.

Të lutemi prá letërari 31) em i urti, të më ndëjejsh 32), nde gjeç fjalëzë, qi të trazon veshët' ; perse, as dielli pa hije, as hâṇa pa njegullazë mbë faqe nuk' âshtë : Po vên' roe, se kush na ka pushtuem e ndë kujët dhé jemi, ani 33) me zemerë anëko, posi tha *Ovidi lib. 3. Elegia I* :

„*Si qua videbuntur casu non dicta latine,*
In qua scribebam, barbara terra fuit".

c). — Pak Astrologjí

Per të folë mâ per të çtjellë 1) permbi vertyt të yj'et 2) e të Pjanetëvet, thonë astrolojtë : Mbassi të lenjë nierí, hâna ká forcë e (e) ruen ndjerë mbë kater vjet ; e ajo fëmij kurraj nuk' jet m' paq, posi hâna luen. E këtyne vjet' e u thonë : *Kerthînjënia.*

Kater vjetsh e ndjerë mbë 14, e ka nden pushtet Merkuri, e bânjën' porsi Merkuri ; e atyne vjet' : u thonë : *Fëminjënia.*

Katetmbëdhjetë vjetsh e ndjerë mbë 22, e ka nden pushtet Veneri. E atëherë hîn me dijtun shekullin', e deshëron me

---

26) l i b e r ë. Për: *liberr'*, si e ka ngjeti ; trajtë e shkurtueme e kallxores *(librin)*. 27) n o n d e. Kështu gjithkund Bogdani për : *ndonse*. 28) d i s a l e t ë r a; mâ nalt pat k a r a t e r i t', marrë të dyja për të soçmen : *gërmat* ase *shkrojat*. 29) z g e d h ë s i ; mâ poshtë : z g e d h i n. Krejt si në latinishte : *legere (poma, flores)*. Këtu : *zgiedhsi, kënduesi, lexuesi*. 30) T u d h e s q i t ë : Teḍeshkët. 31) l e t ë r a r i „Si në krye, në veshtrimin e fjalës : *lexues, këndues* (it. *lettore)*. 32) t ë n d ë j e j s h : *të ndiejsh*, për t' u krahasue me *ndjenjat* e djalektit të jugut. 33) E ká gjithnji ketë fjalë për : *mandej, pastaj*.

c). — 1) M â p e r t ë ç t j e l l ë. Këtu : *mâ veçanísht*. 2) y j' e t. Ves shqiptimi i Kosovës, uhajtun nga slavët për : *hyjvet*.

zânë e me u bâm i urtë; e atyne vjet' e u thonë: *Djelmënia.*

Njezetedý vjetsh e ndjerë 41, i ka nden pushtet Dielli, e u ep gjithë fuqín e tyne; e ata vjetë janë mâ të mirët, e u thonë: *Trimenia.*

Katerdhjetenji vjeti ndjerë mbë 56, janë nden Martin', e prashtû aso kohëje nierí âsht' mâ i idhun', se askurraj; e i thonë: *Burrënia.*

Pêsëdhjetegjashtë vjetsh ndjerë 68, i ka nden pushtet Gjovi; e nierí ka kujdesnë (e) shpirtit e ka urtí të mirë, e apen [3] kshille të mira: e atyne vjet' e u thonë: *Pleqënia.*

Gjashtëdhjetetetësh ndjerë 98, i ka nden pushtet Saturni, e nieri âsht' plot me kelbazë e kujdes, e âsht gjithë i merziçim e i padurueshim. Atyne vjet' e u thonë: *Pleqënia e mbetun*; e gjithë qish teper' gjáll, âsht', posi thotë Profeta: *Mund e të dhimtun'*.

(SHKALLA I. LIGJ. IV. 42-48)

ç). — Disa çudí të Natyrës e të Mjeshtrís

Shumë duer mrekullísh gjinden', disa të natyrës, o së pamasi, së madhi ose së vogëli [1]), posi kje *Polifemi,* nierí per mrekullë i madh: pat mballë nji sŷ të vetem'; posi endè kallëzon Virgjili, *lib. 8. Aeneidum,* per Gjigantet' e Siçiljes'; të sijt', tue gjëllitun' ndaj Malt' (e) Etnesë, kahë del ajo flakë e tmershime nzjarmi, tue qitun' jashtë aqa pluhenë e hîn, sa endè nder dit tona mbë malet' (e) Arbënit reshi hî fort shumë. Ata Çiklopë kjenë të parët' njerëz, qi punuenë hekur' etj. *Hekurinë punuem kishinë Çiklopëtë nd' atë të madhe shpellë* [2]).

Orjoni kje nji gjigant aqa pa masë i madh, sa sod ketë ditë ndë Gjirit' vorri i tij pushton [3]) 46 kút' per së giati. *Mi-*

---

3) a p e n. Shumsin, tue pasë ndër mend: *njerzit.*

ç). – 1) s ë p a m a s i etj.: *për pamasë madhsije, ja vogëlsije.* 2) h e k u-i n ë... Përkthen hekzametrin e Vir. Kan. VIII. 424. 3) v o r r i... p u s h t o n. Për: *vorri i tij zên, mbushë, zapton.*

loni, kusár i fortë, kje dy kutash së vetëmi i madh [4]); kahë ani duel fjala: *Mâ i vogel, se Miloni!*

Pigmejtë, qi gjëllîjnë ndë mâ të mëdhá Male t' Indistanit, bânjën' luftë per herë me gorrilat; shumë herë tue mbetun' pushtuem. Së sillëshit [5]) aj qi ëmbrrîjte me kjanë trí kambë giatë, kje mbajtun' per gjigant. Prashtu thuhej: *Nder Pigmejt nuk' âsht mbarre me kjanë i vogel'.*

Masimiljani kje aqa i madh, sa bylezikët' e së shoqes' i sherbejin [6]) per unazë. *Fileta*, poetë, kje aqa i hollë, sa i duhej me mbajtun' plumb ndë këpucat, të mos e bânte era.

Ndë nji dhé ishin' do prozhma, të sijtë ndërroheshin' ndë shumë fëtyra: herë të giatë, herë trí skanjesh, herë rrotullare. Shumë herë ani, ndë disa pjesë dheu ka reshun' lesh, gjak, tamblë, mish, gurë, baltë e dhé, posi kallëzojnë shumë letërarë.

Të tjera mrekullí janë të mbshefuna të barënavet, të gurëvet, të zogj'et, të peshkut, (të) lisavet e të kroenavet, së sijash janë plot letërat', mâ teper të mjekívet. — *Remora*, peshk i vogel', ndalen nji galé, e silla me vela çelë e me remba ve' tue vozitun'.

Jo posi lunderë ndalen kur prej së dalit Era [7]) *çtrîm tortatë* [8]).

Ndë mjedist, Remora, Ujënavet.

Të tjera mrekullí janë të zanatit; posi janë ato shtatë mrekullí të shekullit. Nder të sijat, mâ i madhi mrekull, âsht: *Gjytetja e muret e Bagdatit* [9]), temelisun' mb' atë vend, ku Nembroti [10]) tratoj Sogjen e Babelit [11]), kahë ani muer êmënit' [12]): *Bagdad*. Muret e kësaj gjytet (je) kjenë giatë gjashtëdhjetë milja; gjânë, pêsedhjetë pash; e nalt, dyqind pash. Kje trajtuem tu-

---

4) d y k u t a s h s ë v e t ë m i. Plotso: *i madh dy kutash së vetëmish.* Rasa të vijueme, si ato: *Prej bjeshkëshit, së naltash.* 5) S ë s i l l ë s h i t. Hjektore partitive: *Ndër të cillët, prej së cillësh.* 6) i s h e r b e j i n'. Nga e pakryemja, *sherbenja*, si e kemi pá edhè në Buzukun. 7) E r a: *Euri*, *Shiroku*. p r e j s ë d a l i t. Plotso: *Prej së dalit së diellit, lindjet.* 8) ç t r î m t o r t a t ë. *Shtrîm litarët e barkës.* 9) t ë B a g d a t i t: *Të Babilonjes.* 10) N e m b r o t i. I nipi i Kamit. 11) S o g j e n e B a b e l i t: *Pyrgu, ase Kulla e B.* 12) m u e r e m ë n i t. Këtu asnjanës, si mâ të shumën ndër të hershëm.

llash e kelqereje, lidhun' endè me nji dorë pjegulle [13]), së sijet asi kohëje kjenë shumë leqêngja plot. Kopështînjet' e bahçet, qi kjenë permbí muret e arkivojet [14]), ishin' mâ të nalta, se gjytetja. Pat njiqind dyer, gjithë rembje, për mrekull punuem. Kje rrethuem me nji fosë ujënash [15]), posi nji lym i perkuershim [16]), mbi dy të tjerë [17]) lymënash së mbëdhejsh, qi i shkojinë per ngiat, qi kjenë Tigri e Eufrati. Aristoteli thotë, se mbassi kje hîm Dariu regj mbrenda, mbas trí ditë u ndie kundruell gjytetsë, se ishin' mbrenda anëmijtë.

Kolosi Rhodio kje nji statue rembje, shekruem [18]) diellit, aqa e madhe, sa kapercente gjithë sogjet e gjytetsë. E marinarët, qi vinjin' së largu, pakeshin' fanálë [19]), qi kishin' zakon me vûm mbë krye të tinaj me flaka të ndezuna, njiqind e pêsdhjetë lege [20]) : mâ shumë, se pesë dit larg. E çprishi nji tremek. Kur kje mârrun' Rhoda prej Turshit, kje prej kësish mârrun rembja e tinaj permbí nandëqind deve.

E treta mrekullí kje : *Piramida* e Misirit : Ndë trajtim [21]) të mrekullueshim të sajnaj kjenë nzânë, per njizet vjet, njiqind e shtatëdhjetë njerzë.

E katerta mrekullí kje : *Mausoleu* i Artemisiesë rregjineshë. Ky vorr, temelitun' permbí gjashtëdhjetë e gjashtë shtylla mbukurueme [22]) e nder njanët e nder tjetëret [23]) ishin' shtatëdhjetë e kater kambë larg. Çoi ketë mrekullë rregjinesha persipëri [24]), per të pomendunit' të Mausoleut, burrit (të) vet, qi vdiq i njomë [25]).

---

13. — nji dorë pjegulle. Vre se Bogdani me shokë e kanë shpesh ketë fjalë *dorë*, për: *farë, soj.* Krhs. me të soçmet: *Këso dore, gjinduerësh, âsht dora e njeriut.* Pjegullë: *serë, pisë, zyft.* 14. — arkivojet: Brêza të gjânë muri në trajtë të harkut (qemerit). 15. — nji fosë ujënash: *nji gropë* (buçigá) *ujnash.* 16. — nji lym i perkuershim: *Nji gjymsë lumi.* 17. — mbi dy të tjerë: *Përveç dy tjerësh.* 18. — shekruem: *Shuguruem, kushtuem.* 19. — pakeshin' fanalë: *Shihshin fenerët.* 20. — dhjetë legë: *masë udhtimi.* 21. — Ndë trajtim: *Në godí.* 22. — mbukurueme: *Të punueme.* 23. — nder njanët e nder t. *Ndërmjet njanës e ndërmjet tjetrës.* 24. — persipëri: *Regjinesha e sipërthânun.* 25. — i njomë: *I rí.*

E pêsta mrekullí kje : *Kisha e Hânës'*, e silla kje trajtuem prej Amazonash, grá [26]). Kje giatë : katerqind e njizeteshtatë kambë ; gjânë : dyqind e njizet shtylla, giatë shtatëdhjetë kambë, falun' prej shumë duerësh rregjënish së peganësh.

E gjashta kje : *Nji Shembeltyrë e Jovit*, bâm gjithë me avoj [27]), aqa e madhe, sa kje bâm ndêjun' ; jose [28]) nuk' kish mujtun' m' e nzânë Kisha.

E shtatta mrekullí âsht : *Sogja e Farit*, ndë gjytet (të) lymit Nil. Ndjerë këtu mrekullít' e Natyrës' e të Mjeshtërís'.

(SHKALLA II. LIGJ. I. 2-12)

d) Virtyti e burrnija e Malsorit

[...] Shofëm nder këta Malësorët tanë gjithsej mâ të shëndoshë e të fortë, se gjytetasit'. Këjo punë âshtë, perse vollëndohen' [1]) së paku. Me nji thembër bukë melakuqe [2]) e nji të pím ujë, kacenjën' posi drêjtë.

Herodjani *(Lib. 2 Caesarum)* shkruen, se Perandori Çezar August' deshëronte fort me pasun' nd' ushtërí të tinaj t' Arbëneshët' ; perse thoj', se pësonjën' shumë e nuk' druen per hû e per het [3]) ; e se janë mâ zemërorë, se të tjerët'. Posi duket se bâni Leka i Madh, Skanderbegu, e 300 Maqedonas kunder të panjefunat ushtërí të Ksersit ; e nd' e vonë (si persipëri) Malësorët' tanë, të sijtë, kurraj nuk' pervîhen' ndjerë nd' anët [4]) Sanxhakëvet, qefalí [5]) të nji kaqi të madhi mizuer [6]), qi bân me djersun' gjithë shekullin'... Ma kthejmë mbë ligjiratët tanë, qi të dashunit' të mos na largonjë [7]).

(PJESË II. SHK. I. LIGJ. VIII. 9-10)

---

26. — A m a z o n a s h : Grá luftare mytologjike. 27. — m e a v o j : *Me fildish*. 28. — j o s e : *Për ndryshej*.

d). — 1. — v o l l ë n d o h e n' s ë p a k u : *Kondendohen, kënaqen me pak*. 2. — m e l a k u q e. Gjiní bime ; it. *sorgo*. 3. — p e r h û e h e t. Shkrue kështu prej pasigurije, për : *û* e *et*. 4. — n u k p e r v î h e n n d j e r ë n d' a n ë t : *Nuk përvûhen, nuk shtrohen krejt*. 5. — q e f a l í : *kryetarë, zyrtarë*. 6. — m i z u e r. Nënkupton *Turkun*. 7. — q i t ë d a s h u n i t' t ë m o s n a l a r g o n j ë. Shenjojmë ndiesít e atdhetarizmit: P*or, t' i lâm, thotë, të mos të na tresë larg dashtnija e kombit*.

[...] Kush mundet me i ram mboh, se mâ i vobek kje Vuça Pasha, i silli, per të mbëledhë nji ushtërí 12 mijë vetësh, nuk i mbastuenë shumë miljonj ár, se Kelmendasitë tanë, të sijët me nji zâ : „*Eja kush kush âshtë trim !*“ mbëledhun’ afer’ 500 vetë, vránë Vuça Pashen’, vjetit së Krishtit 1639. E ndë nevojë, mpsuen me ngrânë lëkuren e qarrit, posi të begatët’ majen’ e miellit ; endè atyne ajo gjellë mâ shije u ká, se Pashallarëvet e Sanxhakëvet mishi i kingjavet (e) vjetavet [1]) (të) njomë ; pa ndiem kurraj të ngînë, tue ngrânë per gjithë horë, e tue votë rreth ndeper rajë të tyne ; posi tha Profeta : *Kanë me ardhun’ rreth gjytetsë e kanë me pësuem ûni, possi qentë, e gjithëherë mâ fort deshërojnë.*

(PJESË I. SHK. I. LIGJ. VI. 15)

---

5. — KUVENDI I ARBËNIT (1706)

Janë aktet e Koncilit ase e Mbledhjes së parë të Klerit të Naltë katholik Shqiptár, qi u mbajtë në Merqî, katund pak mbi qytetin e Lezhës.

Në vjetin 1702, Papa Shqiptár, Kelmendi XI [1]) i urdhnonte t’ Imz. Viskut Zmaieviq, Kryeipeshkvit të Tivarit [2]), t’ u bânte vizitën kanonike të gjitha kishvet e qendravet katholike të Shqipnís. Mbas vizitimit, qi ai kreu mbrenda tre muejve, ky Mkambës i Papës mblodhi në kuvend kryetarët e Klerit, d. m. th. 5 Ipeshkvîjt e djoçezevet të vendit me At Provinçjalin e Françeskanvet.

Mbledhja ndodhi në Dhetuer të vjetit 1703. Vendimet, qi

---

1. — vjetavet : *viçavet.*

1. — Papë Shqiptár me fis e me zemër. Kje i derës së përmendun t’ Albanvet, e cila qiti njerz në zâ për dijtuní e harte. U mundue e u vjefti fort Shqiptarvet, sidomos atyne të venduemvet n’ Italí. Sundoi Kishën v. 1700-1721.

2. — **Imz. Zmaieviq-i** leu në Perast, ndër Gryka të Kotorrit, V. 1670 ; drejtoi si Kryeipeshkëv Djoçezin e Tivarit v. 1701-1713. Prej këtij vjeti deri 1740 kje Krye-ipeshkëv në Zarë. Ju vjefti fort Shqiptarvet emigrantë e me mund të madh i duel me i venduem në Borgo Erizzo *(Thalloczy, Illyr. Alb. Forsch. I. f. 825).*

u muerën në ket Koncil, kjén shkrue në dy giuhë, latinisht e shqip, prej vetë t' Imz. Zmaieviq-it, e i kjén paraqitun Papës, për shqyrtim. Këto akte në vjetin 1706 u botuen në Romë, me shtypshkrojën e Propagandës, nën titullin „CUVENDI I ARBË-NIT o KONCILLI PROVINCJALLI Mbëliedhunë Vjetit mijë shtatqind e tre Ndenë Shqiptarin Klementin XI Papë Pretëmadhin".

Kuvendi i Arbënit u botue për të dytën herë, gjithnji në Romë, vjetin 1868.

Randsija e këtij dokumenti âsht jo vetëm për shka i përket shqipes së shkrueme, por edhè për njohtimet historike, dheshkrojtare etj. qi ka mbrendë.

NGA KUVENDI I ARBËNIT.

Letra percjellse

Mâ të lumit Atit
KLEMENTIT
[të] Njimbëdhjetmi[t]
Papë Prëtëmadhit [1])
Visk Zmajeviqi Arqupeshkup
i Tivarit
Me të prûnjët ndigimi qi i duhet

*

Urdhinove [2]), o i Lumshimi Ati, kinëse [3]) me të vizituemit Apostolik, të vê roe mbi Kishat t' Arbënís së Provincjes sime. Ndigiova urdhënit; suolla dhén [4]); kerkova rruzullimin: pae [5]) plagat e tij. Pae — uh, të dhimbëtunit! — [6]) vûm nden hara-

---

1. — P r ë t ë m a d h i t. Superlativi i: *I madh.* Përkthim i dhunshëm nga latinishtja; e cila kushtesë n'atë gjuhë tingllon kështu: *Beatissimo Patri* CLEMENTI UNDECIMO Pontifici Maximo Vincentius Zmajevick Archiepiscopus Antibarensis Debitae *sùbiectionis obsequium.* 2. — U r d h i n o v e. Shpesh zânorja *i* rrin këtu për *ë*, sidomos ndër sufiksa para *m*, *n*: *i lumshimi*, *urdhinit*, *mujtin*. Kështu edhe Bog. etj. Prap sod, b. f. në Zadrimë: *I kandshim*, *i merziçim*, et. 3. — k i n ë s e: *qi*, *kesh*. 4. — s u o l l a d h é n. Mâ shqip: *I u solla dheut.* 5. — p a e. Trajtë e shkurtueme për: *pásh*, *pava*. 6. — Lt. *Proh, dolor!* — Vre stylin e zgjuem të letrës.

çin [7]) atê, qi nji herë kje dispoti i Provincjavet, Zonjen e gjintvet, ngermuem [8]) me t' idhunit së dhimbëtunit ; shytin e trimavet, shám ; murin e forcës sanë, rrenuem ! Pae gjindët, hîm në vend të shendëmit [9]) ; kishat, të fëlligta ; literët pegám [10]). Mëzi pae vend, kû të mundehi [11]) populli me u mbljedhun ndë panegjyri ! Pae pleqët tue ulëruem ; Meshtarët, sherbëtorët e Hyjit, tue gjimuem ; çobant, vurám ; tretun dhênët, tue u perdám dý udhave : murtajin, qi pa mishërierë çorovitin [12]) gjithë ; e plasjen e mortaisun, qi per të gjânë e per të giatë trimnohej ! [13])

Këto pae, e gjimova ! U perzien shkafët [14]) e mí per të dhimbtunit të popullit tim e m' u shkjyeshin [15]) nd' ato travaja të bijvet, qi po mbytejshin. Përata, thoshë, populli em u bâ rob, perse s' pat dijen. Tue anëkuem kaq të këqija e ngremiza [16]) të pa udhë, shtringoheshe ngremizesh ; po, per sa paçë fuqí, nuk laçë mengjí [17]) per prapë. Nevoja lypë kishte vija [18]) mâ të mira, se vizitimin ; as lij' [19]) moti me e shtŷm. Ma të madhe ndimë kujtonjëte me kjenë ndë të mbljedhunit të Konçilit. Këtu deftova fuqiat ; këtu ngula mendët, tue hîm, pa rrênë, njaj kafshe mâ të randë, se keshte virgjilesën [20]). Po Ai, qi ka prodhuem tjerëvet vëllazënvet tanë, qi ishnjin perdám ndeper ruzullim të Fés, ka ndimuem mue në ket vend. As hesapi [21]), qi kam si çobani i shpirtinëvet, as kujtimi i fort, qi kam per të kershtenët, e as mendët e mija, qi janë të pá tija [22]), s' mujtin me mparuem këta të bâm të randë. Po Hyji, i cilli

---

7. — nen haraçin. Fjalë turqishte. Nën pagë e të dheta, si dikur vendet e robnueme. 8. — ngermuem. *Ndrydhë, vû nën kambë.* 9. — në vend të shendëmit. *Në vendin shêjt.* 10. — pegám: *përlyem, ndŷ.* 11. — të mundehi: *të mundej.* 12. — çorovitin': *prishte, çorodite.* Kaq nemose thomi nga teksti latinisht, sado qi këndimi s'âsht gjithaq i kjartë. 13. — trimnohej': çonte krye e rrenonte furishëm. 14. — shkafët: *përmbrendsat,* (lt. *viscera).* 15. — Edhe ky këndim i dyshimtë; në tekst ká: *m' uschiurin.* 16. — ngremiza: *shtërngesa, ngushtica, gremina (?).* 17. — mengjí: *mjeki, bár.* 18. — vija, për: *Shtiqe, mjete, mënyrë.* 19. — as lîj. Plotso: *as lîjte.* 20. — virgjilesën: *Fuqín.* 21. — hesapi. fjalë turke: *Detyra.* 22. — të pá tija. Vend i mbyllët. Përmbas kontekstit mirret vesht: *mendet e mija të pa-zojat ;* ase, si e ká ***Radoja****, të shkurta.*

ndërron motënat e veset 23), qi ep të rritunit e mbaron gjith punët, Ai e bâni me mbaruem unaj punen kaq të fështirë, sikundërse deshërova.

Nden hie Tande, o i Lumshimi Ati, po gëzon dheu i Arbëneshi, e mbas të sjelltit e motit ngrihet, posi disa mot 24) të kishte kjenë mbuluem me njegullë, tashti, nden Papë t' Arbëneshë, qi latinisht do me thânë, *të bardhë* 25) — âsht dalë mbë dritë, e me zembrë të mirë shkathon 26) me 'rrîjm mbë lumëní të shkueme. Ndjer' se mendeja e Atit, e cija âsht mâ e madhe, se rrethi i shekullit, huron 27) me të dashunit të Tinëzot ketë lumëní të dheut sinë; per të falë të zembrës gazmuese, vînjën, si per dhunëtí, mbë shatorri Apostolikë 28), mbë Kathedrë të qiellshëme së diesë, Dekretat e Sinodit të Provincjes Arbëneshë, kinse, ndë paçin kund faj të padiesë, të ndishkohen 29) me fjalë Tande.

Unë prá, nde paça fjyem me Atëni t' Arbëneshë, vînj ke mjeshtrí [ja] 30) e Pjetrit me u ndishkuem; as kam dhunë 31) me nkthyem ndryshej fjalët. Asgjâ prodhojnë veprat [t'] errtat tona; asgjâ viejnë Dekretat, pa u pështetun Gurit të palkunduni; e sikur të provuem mbë qoshtë 32), të forcohen me Orakulli të pushtetës Sate.

Perzê, pra 33), o i Lumshimi Atë, dhunëtít e nderat [e] prûnjëta, shinjajt 34) e Nacjonit simë, por mâ fort Satë. E, nde pásh, se kund i duhet punt 35), ndo të limuemit, godit e ndëreq me të pahile 36) shentënueshimin gjyqi. Po, se këto pak të fala, qi mbarazohen me vobëzí tanë, me të pafjyemi, hyjnueshmi gjyqi tit, kanë fort me u shumuem. E ndjerkaq unë, me të tjerë vë-

---

23. — v e s e t. Në veshtrim jo të keq, por per: *doket* (lt. *mores)*. 24. — p o s i d i s á m o t: *Porsi d. m.* 25. — Fjala latine: *Albus*, prej kah thohet këtu, se ka ardhë mbiemni i Papës, *Albani*, don me thânë shqip: *I bardhë*. 26. — s h k a t h o n: *i a shpejton* (lt. *accelerat)*. 27. — h u r o n: *uron*. 28. — S h a t o r r i Ap. Për: *Fronin Apost*. 29. — t ë n d i s h k o h e n: *të qortohen, të ndreqen*. 30. — m j e s h t r i (j a) Lt. *magisterium*. 31. — k a m d h u n ë: *më vjen marre, turp*. 32. — m b ë q o s h t ë. Sod edhe *qashtë, qoshtër*; e thirret ai gúr i fort shum *(lapis lydius)*, mbi të cilin heret provojshin vërtetsín e arit, e mbrehshin brisqet e thikat. 33. — P e r z ê. Në veshtrimin: *prano, pelqe*. 34. — s h i n j a j t: *shêjet* (it. *signale)*, 35. — d u h e t p u n t: *duhet pikë*. 36. — t ë p a h i l e: *të papërlyemin, të pagabueshmin*.

llazen të mí, me gjith popullin (t') Arbëneshë, me të lutunat mbashkë lus Hyjin, të ruenjë Tý, PAPEN Arbëneshë PRËTËMADHË, per shum mot Kishës e neve shëndosh e pa [të] keqe [...]

Shkruem ndë Perastit, nd' e dhjetë dit të Korrikut, mbë vjetë të Krishtit njajmijë shtatqint e tre.

JUSTIN RROTA *)

---

6. — GJON NIKOLLË KAZAZI (1743)

a) Jetëshkrimi

Lindi në Gjakovë me 1 të Kallëndorit në vjetin 1702. Studjoi në Fermë e në Loretë *„në Lurijtë"*, ku ndodhej Kolegja Illyrike, në të cilën vijuen mësimet e veta sa e sa brezní shqiptare para tij edhe ndër qindvjett e mâ-vonëshëm. Nga letra papnore e Papës Benediktit XIV me 23 të Shtatorit 1743, njohim titujt e tij akademikë. Kazazi, doktor i theologís e i filozofís, pati zavendsí detyrësh kishtare pranë selís së kryeipeshkvís së Shkupit *(«së Shkupës»)*, qi n' atë kohë vijonte të mbarështrohej nga bashkatdhetarët t' onë. Mbas dorëheqjes së Shqiptarit Mhíll Summa, Roma i ngarkoi detyrën e kryeipeshkvís së Shkupit në nji kohë kur ndodhej n' udhëtim zyrtár tue u êndun nepër krahinat e jugut. Vizita e tij nepër Balkan ka qênë e shkurtun.

Kazazi qe i pari qi pati fatin e bardhë të zbulojë librin e çmueshëm të Gjon Buzukut. Tue vijue punimin në Bibliothekën e Kolegjës së Propagandës në Romë, në vjetin 1740 e gjeti ket monument të gjuhës shqipe. Plot me kënaqsí për ket zbulim të së vetmes kopje të Buzukut, mêrr pendën e i shkruen drejtorit shqiptár të Seminarit të Palermit priftit Gjergj Guzzetta-s. Përshkruen krejt mbas-thânjen e Mesharit të Gjon Bu-

---

*) Studimet, komentimet, zgjedhja e copavet të shkrimtarvet **Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani, Kuvendi i Arbënit,** janë të bâme nga *At Justin Rrota.*

zukut tue e përcjellun me këto fjalë: *„Nji Meshar Shqip fort i vjetër, krejt i grisun nga vjetërsija“*. (*Antichissimo Missale Albanese per antichità tutto stracciato*).

Në vjetin e hypjes në selín e kryeipeshkvís së Shkupit Kazazi kreu nji shërbim të rí tue botue në dhialektin e Gjakovës nji vepër të vogël (46 faqesh :) *„Breve compendio della Dottrina Cristiana — Tradotta in lingua Albanese per l' utilità e istruzione dei Fanciulli di quella Nazione* — Da un *Nazionale* etj. Vepra u shtyp në Romë në 1743 me Shtypshkrojën e Propagandës. Asht ky mâ i pari dokument gjuhësuer i shtypun thjeshtë në të folun të Gjakovës, e cila ka vijue të ruejë për qinda e qinda vjetësh, me gjith vështirësít e ndjekjet e bâme, gjuhën e ndiesít shqiptare.

Në historín e alfabetit të shqipes përmendet ndonji veçorí e orthografís së tij. Edhe pse vijon veprimin e shkrimtarëvet të përparshëm tue shkrue me alfabetin e moçëm të shkrimtarvet të vjetër të veriut, me të citin u botuen të gjitha veprat e Propagandës së Romës, prap se prap Kazazi përdorë tre tinguj të posaçëm të shqipes, nga të cilët dy për *ë*-n (e pá-zâne). Këtê nga nji herë e shkruen si Arbneshët *(Matranga, Mbíshkrimet e Pjanës, Skiroi* e tj.), *ae* e ndër rasa mâ të rralla me nji shênj a presë nën *e*, quejtë *diakritik*. Po ket tingull diakritik e përdorë ndoshta mâ i pari ndër shkrimtarë të vjetër të gjuhës s' onë në të shkruem të tinguilit të soçëm *ç*.

I ngarkuen kohë mbas kohe detyrë kishtare nepër Bulgarí e vise tjera. Arhivat e Vatikanit e të Propagandës së Romës, të cilët përmbajnë sa e sa njohtime të çmueshme të Historís së Shqipnís në ketë kohë, ruejnë edhe letrat e Kazazit, të këtij Kosovari të ndritun, dërgue Selís së Shêjtë, në të cilat përshkruhet gjêndja fatkeqe e përherë e mâ e vështirë e katholikëvet, në Sërbí. — Mbas veprës *Illyricum Sacrum* (Vëll. VIII.) Kazazi vijoi t' a mbajë selín e kryeipeshkvís së Shkupit për dhetë vjet deri në vdekje në 1753. Prej njij dishmije tjetër *(Audienze* VII, 7) shohim se Kazazi vdiq me 5-VIII në 1752. Me Kazazin mbaron perjudha e parë e shkrimtarvet të vjetër të veriut.

b) Lutjet e mëngjezit

(Nga libri i Kazazit)

Po të falem, o Zot i verteti, e po të bindem, e po të due me gjith zembër. Po të falem ndérs se më ké kríuom 1) e më ké çperblém 2) e më ké ruojtun 3) këtë natë prej ndonji mortje së pákujtueshme 4). Tý, o Zot, po t' i falinj 5) gjith (a) kujtimet e mija e po të luttem 6) të më ruojsh 7) sod e për gjith herë prej gjith fajesh e mpkattesh. 8)

Ani mbasandaj thuoj : O Ati ynë, Falemi Mbrí e Besonj mbë Tenëzòn.

Kùr të zánsh 9) fíll me bâm ndonji punë, o zyrë, thuej njekshtu :

O Zotti i math e i verteti, unë po e banj e po t' a falinj këtë punë teme, e këtë mundim tem për ndért tande : epma, o Zot, békimn 10) tand.

Kúr të duosh me ngrënë bukë, thuoj :

O Zotti i mësheriershim, békona neve, e këto nderë e të mira të tua qy (— qi) 11) po duom me i ngrënun, qy (— qi)

---

1) *kríuom :* krijuem. Ke Kazazi vrehen gjurmët e difthongut të herëshëm — *uo* si ke *Buzuku :* me steket*uo*m për : me shtekt*ue*m ; gr*uo*ja për : gr*ue*ja e tj. edhe ke *Budi* (1618, 1621), të cilët i qindrojnë besnikë këtij difthongu, ruejtë sot vetëm në kolonín e arbneshëvet pranë Zarës (Borgo Erizzo) e në Malsín e Krajës.

2) *çperblém :* shpërblyem.

3) *ruojtun :* ruejtun (këq. shen. 1)

4) *mortje së pákujtueshme ;* prej ndonjij vdekjeje së pá-pandehun.

5) *po t' i falinj :* po t' i fali.

6) *po të luttem :* po të lutem.

7) *ruojsh :* ruejsh (këq. shen. 1).

8) *mpkattesh :* mkatesh.

9) *të zánsh :* të zâsh apo të nisish.

10) *békimn :* bekimin.

11) *qy — qi* apo *që*. Ndër disa fjalë të caktueme të vepërzës së Kazazit vrehet tingulli *y* në vend t' *i*-s : të Byrit, Kysha, etj.

të mbahena gjall me të sherbyem tý. Për Emmenit (t') Atit e (të) Byrit [12]) e Shpiertit Sheint. [13])

Kùr të çohesh tryesset, [14]) përsërí thuej:

Po të falem ndérs, o i madhi Zot i pushtueshimi për gjith këtë hae e për të gjith (a) të mirat tua: epnae hírn [15]) e ndihmën tande, qy me tonai të mos të fëjenjim. Për Emmenit (t') Atit etj.

c) Vepër pendimi

Kur të dro [16]) zembëra të mos të jésh ndë ndonji faj, thuej me zembër të penduome:

Banmë mëshërier, o Zot, për të madhet mëshëriert tande: po pendohem me gjith zembër se të kam fëjyem e po përmetonj mâ para me kienë dvekun, [17]) se mâ me të fëjyem: Se po të due, o Zot, me gjith zembër përmbí gjith kafshë.

FILIP FISHTA

---

12) *Byrit:* Birit (këq. shenimin e përparëshëm).

13) *Shpiertit Sheint:* Shpirtit Shêjt. Në qindvj. XV: *Spertit Senit* (këq. fjalët e formulës së Pagëzimit të Pál Engjellit,) f. 3.

14) *tryesset:* tryeset. Kjo trajtë vrehet edhe ke vepra e Zmajeviqit: Kuvendi i Arbënit (1706) e në disa botime të Propagandës së Romës të të XIX qindvj.: *tryessa*, *pjessa* etj.

15) *hírn:* hirin (synkopé, si ke shen. 10: *békimn*. Përdoret si lirí vjershtore në poezí.

16) *të dro:* sot thomi: kur *të qân* zêmra. Këtu mund të ketë kuptimin e: kur të brén dishka përmbrenda zêmre.

17) *dvekun:* metathezë për: *vdekun*, sikur ke êmni: *dvorë*, *vdorë* e tj.

KAPTINA III.

Shkrimtarë të vjetër të jugut

NJOFTIME TË PËRGJITHËSHME

Prodhimi letrar i shkrimtarëvet të vjetër të jugut u lint e u zhvillua në qëndra të ndryshme të Shqipërisë së poshtëme. Një hov të posaçëm pati sidomos rreth akademisë greko-arumune të Voskopojës.

Qyteti i Voskopojës, që sot është vetëm një fshat i vogël e i varfër pa më të voglën rëndësi, qe një herë më një kohë qëndër mjaft e madhe dhe e përparuar, e themeluar dhe e banuar në shumicë prej vllehësh epirotë. Rreth vjetëve 1720 e 1770 u bë një «metropol» i vërtetë i gadishullit balkanik, me lagje e ndërtesa të bukura, me tregëtore e tregje të begaçme, me industri e marrëdhënje tregtare të zgjeruara jo vetëm në Europën qëndrore e veriore (Trieshtë, Venedik, Leipzig, Vjenë) po edhe jashtë Europës, në Egjypt e në Asinë e Vogël, aqë sa një shkrimtar i kohës shkruante për 'të : «urbs amplissima non modo in tota Graecia, sed etiam fere per totum Turcarum imperium. *Pas zhvillimit ekonomik i a arriti shpejt edhe zhvillimi i rëndësishëm kulturor : qisha të shumëta, shkolla, një akademi, një shtypshkronjë — n' ato kohë e vetëmja e tërë perandorisë — biblioteka etj. Shumë njerëz të kulturës greke duallnë nga ky qytet : patriarku Jasaf i Ohrit, metropoliti Dioniz Manduca i Kastorisë, Joan Kalkens, etj. si edhe* Theodhor Kavalioti *e* Danili, *për të cilët do të bëjmë fjalë më poshtë.*

Po, siç thamë, nuk duhet besuar se lëvizja kulturore letrare toske orthodokse u zhvillua vetëm në Voskopojë. Sigurisht edhe në qytete të tjera të Shqipërisë së jugut u çfaqnë lëvizje

të tilla, vetëm që nuk patnë jetën dhe rëndësinë e asaj të Voskopojës ; ase, më mirë, nuk lanë gjurma, a nuk i njohim endè sot këto gjurma, pse nuk janë bërë kërkime si për shkrimtarët e veriut.

Si kohë nisjeje prodhimit letrar në fjalë i kemi caktuar gjysmën e sprasëme të shekullit XVII. Po ky caktim është konvencionar, dhe e kemi caktuar vetëm pse dokumenti i parë i këtij prodhimi është i kësaj kohe. Krejt përkundër, nga sa na jep të kuptojmë «Perikopea ungjillore», *e cila lidhet nga çdo pikëpamje me këtë prodhim ashtu siç lidhet* «Formula e pagëzimit» *me prodhimin e veriut, duhet t' a ngrehim nj' a dy a tre shekuj më lart këtë nisje.*

Shkrimtarët më të përmëndur të prodhimit toskë orthodoksë janë : **Theodhor Kavalioti, „Dhaskal" Dhanili, Kostë Beratasi, Grigor Gjirokastriti, Kullurioti.**

Tri janë edhe karakteristikat kryesore të këtij prodhimi, që e dallojnë prej të tjerëve :

a) *karakteri fetar, po edhe mësimor, i vepravet ;*

b) *influksi i madh grek, mbassi auktorët e tyre ishin lidhur ngushtë me Greqinë, e kishin kryer studimet në shkolla greke.*

c) *përdorimi i alfabetit grek për shqipen.*

Po shkrimtarët e vjetër të jugut në veprat shqipe *që na kanë lënë nuk dëftejnë as doktrinën, as vlerën dhe as ato pakë ndjenja atdhetare që dallojnë vëllezërit e tyre gegë. Ata janë, vërtetë, të parët toskë që shkruajnë gjuhën t' onë, po nuk e përdorin këtë si* qëllim në vetvehte, *po si* mjet, *me anë të së cilës donin të përhapnin njohunít e fés orthodokse.*

NAMIK RESSULI

1. — THEODHOR KAVALIOTI

a) Jetëshkrimi

Jetëshkrime të plota për secilin nga shkrimtarët e vjetër të jugut mjerisht nuk munt të shkruhen èdhe, pse shum pika të jetës së tyre as sot nuk njihen mirë.

Për më të parin a më të vjetrin që njohim, për *Theodhor Kavaliotin*, disa prej këtyre pikave të errëta, për hirë të kërkonjësve të zellshëm, kanë filluar të ndriçohen. Po enigmatik mbetet vëndi dhe data e lindjes së tij. Si pas prof. Thunmann-it, i cili është një nga të parët të huaj që e zë në gojë, ai ish nga Voskopoja e në atë kohë kur i dituri gjerman shkruante (1774) ishte nja 46 vjetësh ; kështu që duke bërë llogaritë e duhura, duhet të ketë lindur në vitin 1728. Po këjo datë, natyrisht, nuk munt t' i caktohet si e sigurtë, pse nuk e dijmë në kishte lajme me të vërtetë të sigurta Thunmann-i, sado që burimi nga i kish marrë këto lajme meriton çdo besim ; as nuk e dijmë në i a ka dhënë atë moshë afërsisht.

Për sa i përket vëndit të lindjes, disa nga jetëshkronjësit e tij të më parëshëm na e japin si *Kavallas* Theodhorin ; kurse disa të tjerë shkojnë edhe më tej : nga shkaku i *trajtavet gegërisht* që kanë spikatur në veprën e mjeshtrit voskopojar, e bëjnë *Kavajas*. Nuk kemi ndonjë kundërshtim për hipotezën e parë, me gjithë se na duket se nuk është e arësyeshme të mos pranohet sa thotë Thunmann-i, mbassi informatori i tij, *Dr. Kostandin Haxhi Xhehani*, që ishte Voskopojar, munt të mos dinte me siguri moshën — gjë që na ngjan të gjithëve —, po s' është e mundur të ketë gënjyer profesorin a të mos ketë dijtur mirë origjinën e një bashkëqytetasi të njohur si Kavalioti. S' është aspak çudi që familja e Kavaliotit të ketë qënë e ardhur nga Kavalla dhe vetë Theodhori të ketë lindur në Voskopojë : në këtë mënyrë pajtohet edhe pohimi i Thunmann-it edhe mbiemëri i Theodhorit *Kavaliot*. Po, sa për hipotezën e dytë që e bën mjeshtrin voskopojar *Kavajas*, këjo nuk munt të meritojë besim.

Trajtat gegërishte që gjejmë në *Fjalorin* e tij nuk janë kriter i mirë për të caktuar vëndin e lindjes për arsyet që do japim më poshtë.

Si do që të jetë, Kavallas a Voskopojar, dijmë se Theodhori mësimet e para i kreu në Voskopojë, ku pati dy mësonjës të njohur, Kalkeun e Sevaston. Më vonë me shpenzimet e korporatës së bakenjve voskopojarë u dërgua në Janinë, në shkollën e të diturit Evgjen Vulgariotit, pranë të cilit, si thotë Thunmann-i, studjoi filosofinë e mathematikën. Pastaj e shohim Kavaliotin të kthehet në qytetin lindor të tij, kur, passi martohet, dorëzohet prift më parë, protopapë i Voskopojës më vonë, dhe emërohet drejtor i shkollës fetare voskopojare, kur u ndërrua këjo në „Nea Akademia“ (1750). Më vonë, për shkaqe që nuk i njohim mirë, largohet prap nga Voskopoja për në Stamboll. Po edhe këtu nuk qëndron shum pse s' andejmi e gjejmë sërish në Voskopojë.

Se kur e kur vdiq, gjër die nuk dihej gjë me siguri. Ca thoshin në Voskopojë më 1786; të tjerë në Venedik; dhe ca na e jepnin edhe si të gjallë më 1808. Sot përkundër, për hirë të zbulimit të bërë [1]), dijmë se vdiq në vëndin ku lindi më 11 të Gushtit 1789.

b) Analyzimi i „Fjalorit“.

Sigurisht nga sa thonë ata që janë marrë me 'të, burrë i mënçëm e me dituri të thellë qe Kavalioti. Shkrimet e tija kaluan kufitë gjër në Rumani për të ndritur Akademitë e këtij shteti. Po mjerlsht këtë diturinë e tij të gjërë e derdhi të gjithë në vepra të huaja, në shkrime greqisht. Në këtë gjuhë Theodhori na ka lënë në dorëshkrim një *logjikë*, një *fizikë*, një *metafizikë* si edhe nji «*Hyrje gramatikës...*» botuar më 1760 në Voskopojë. Po aty edhe vepra që na intereson ne, d. m. th. ajo që njihet shkurtazi vetëm me emërin «Protopiria» e tërë shqip nuk është. Kjo veprë e funtme e shtypur në Venetik në shtampën e Antonio Bortoli më 1770 me të hollat e një Voskopojari

---

1) **Ilo M. Qafëzezi** në rev. «*Leka*», Vj. X, 1938, Nr. 8-9, f. 383.

dorëgjërë, Gjergj Trikupës, në 104 faqet e saja deri në ato, 13-59, mban fjalorin në tri shtylla në radhë alfabetike si pas fjalëve greqisht, së cilës i shtohet çdo herë përkthimi në gjuhët vllahishte e shqipe: Roomaiika, Vllahika. Albanitika"; në të tjerat, me përjashtim të një hyrjeje së shkurtër dhe të disa ksilografive, përmban si lëndë përgjithërisht atë që përmbajnë të gjitha abetaret për fëmij' të asaj kohe: një abc greqishte, një lutje që i drejtohet Sh. Mërisë, një pjesë e nxjerrë prej historisë biblike e të kishës e hartuar me mësalla të shkurtëra, mësalla dhe lutje të shkurtëra dogmatike, këngë kishtare, në mes të cilave edhe një vllahisht, radhën e numravet dhe emërat e muajvet dhe së fundi alfabetin latin, të gjitha këto të shkruara greqisht.

Vetëm f. 13-59 janë ato, pra, që na interesojnë, e që vlejtën t'i sigurojnë kujtim të përjetëshëm auktorit të tyre, aqë sa të mbahej si një para-ardhës i gjuhësisë së krahasuar! Po nuk duhet pandehur se kanë patur a kanë ndonjë vlerë të madhe këto faqe që sajojnë «Fjalorin» e famshëm. Eshtë mjerisht i vogël ky, që të munt të kryente shërbimet e paçmuarshme që kryejnë përgjithërisht fjalorët. Veç asaj nga pikëpamja *thjeshtësisht gjuhësore*, sado që një herë u hyri shumë në punë albanologëve të huaj, si një nga burimet më të para të shqipes e t' arumenishtes, prap vlerë të madhe nuk ka, si ka, për sh. vepra e Buzukut dhe veprat e një pjese të shkrimtarëve të veriut. Eshtë relativisht e re gjuha e Kavaliotit që të munt të na hyjë themelisht në punë për studimin e historisë së gjuhës s' onë. Më tepër se për historinë e shqipes, fjalorthi i Voskopojarit do të shërbejë e do të ketë vlerë vetëm për studimin e dialektit në të cilin është shkruar, mbassi është edhe dokumenti më i vjetër i këtíj dialekti.

Siç dihet fjalët e *Fjalorit* në gjuhën greqishte janë 1170, po fjalët shqipe duke mos numëruar përsëritjet, janë më tepër, pse herë herë për një fjalë greqisht kemi dy ase tri shqip.

Nga tjalët e huaja të përdoruna në pjesën shqipe vëndin e parë nga sasija e zënë ato t' origjinës greqishte e turqishte, pastaj vijnë ato slavishte, nj' a dy italisht, që s' i ka as një fjalor

më i vonëshëm, — *lattugë*, it. „lattuga", *lottoj*, it. „lottare" — dhe një arumenisht : *haliç*, arum. „hâlitsa" = caillon. Po lipset shtuar se fjalët turqishte janë përgjithërisht nga ato që përdoreshin e përdoren pothua në të gjitha krahinat e Shqipërisë e jashtë Shqipërisë, në gjuhë të ndryshme të Balkanit e që janë bërë tashmâ „pasuri balkanike"; gjithashtu fjalët slavishte janë nga ato relativisht të vjetra e të rrënjosura në shqipet. Po çudija është se edhe me fjalët greqisht — gjuhë që e zotronte si një grek — Kavalioti nuk ka bërë ndonjë shpërdorim : ka shënuar vetëm ato fjalë që përdorte ajo krahinë e që përdoren edhe sot në shum krahina të Shqipërisë, sidomos në popullsinë orthodhokse. Kjo jo vetëm që na provon se, me gjithë propagandën e Akademisë, gjuha greqishte nuk mundi të zërë rrënjë të forta n' ato krahina, aqë sa dialektit të tyre t' i ndryshonte fizionominë nga të tjerët, po nxjerr në shesh edhe se qëllimi i Kavaliotit qe të shkruante një fjalor për popullin me fjalët e popullit. Thomi prandaj se këtu qëndron vlera e vërtetë e tij : në sa ky fjalor është „pasqyrë" e atij dialekti, që *duket kthielltazi të jetë të folët e qarkut të Korçës.*

Sa për trajtat që duken „*gegënishte*", si : *i amblë*, *lamsh*, *manë*, *nji*, *njizet*, *hidhënim*, *kumbonë*, *i dejtun*, *shtreit*, *i naltë*, etj. le të mbahet mënt mirë se bri këtyre trajtave „gegënisht" në "Fjalort" gjëjmë „korespondentet" e tyre fonetike toskërisht. Duke u kthyer, pra, tek origjina e Kavaliotit, është e tepërme t' a thomi se këto „trajta gegënishte" janë shum të paka për të na shtytur të besojmë se Kavalioti ish i origjinës gege (Kavajas !) ; a që t' a thomi ndryshe, këto trajta nuk janë nga ato mbí të cilat munt të themelojmë një hipotezë të tillë.

Dy mbesin shpjegimet si më të sigurta të trajtavet gegërishte : *a)* ase Theodhori ka qënë ndihmuar në përpilimin e veprës prej ndonjë gege, ndothta nxënës i tij ; *b)* ase mjeshtri i mënçëm voskopojar ka dashur që fjalori t' u hynte në punë jo vetëm nxënësve toskë, po edhe atyreve gegë, pse shkolla në zë e Voskopojës i thërriste djemët nga të gjitha anët e Shqipërisë. Mundet edhe që të kenë qënë të dyja këto hipoteza shkaqet e vërteta.

2. — MJESHTRI DANJEL (1794).

a) Jetëshkrimi

Lajmet që kemi për Dhaskal Danjelin, kronologjikisht i dyti, në mos i treti, i radhës së shkrimtarëvet të vjetër të jugut, mjerisht janë edhe më të pakta se ato që dalë nga dale u grumbulluanë rreth jetës së Kavaliotit. Jetëshkrimi i tij prandaj munt të përmblidhet, hë-për-hë, në pakë fjalë. Dijmë me siguri se Danjeli qe Voskopojar e këtu e kaloi pothua tërë kohën e jetës, më parë, prej vitëve 1750-1765, bashkë me Theodhor Haxhi Filipin e ndothta me Vithkuqarin, si nxënës i „Akademisë së Re" me Kavaliotin në krye e më vonë si ikonom, jeroqirik e drejtor i kësaj shkolle.

Të panjohuna mbesin dy data të rëndësishme të jetës së këtij shkrimtari të vjetër: data e lindjes dhe ajo e vdekjes. Zoti I. Qafëzezi „hamëndisht" i ka caktuar për të parën vitin 1754 „duke u mbështetur në kritikën e Z. prof. Th. Kapidan" i cili thotë se Danjeli munt të ketë qënë 40 vjeç kur botoi për herën e parë veprën e vet. Po asnjë fakt nuk na ndalon të mendojmë që «ierodhaskali» të ketë qënë më i moçëm kur botoi librin e vet. Sa thotë Kapidan-i munt të merret vetëm si një kufi, përkëtej të cilit nuk munt të hidhemi, mbassi me shum vështirsí Danjeli munt t' emërohej «ikonom, ieroqirik e ierodhaskal» përpara moshës 40 vjeçare.

Për datën e vdekjes, prap shënohet viti 1811 e thuhet për këtë se gjendet në një akt-shitje të shkruar prej dorës së Danjelit në Voskopojë, duke u vërtetuar kështu se gjër në këte vit ai ishte edhe i gjallë. Po nuk kuptohet në se ky vit munt të mirret si datë e vdekjes së Danjelit apo si datë e funtme në të cilën gjejmë edhe shënja të dhaskalit.

b) Vepra

Vepra që na ka lënë Danjeli njihet përgjithërisht me titullin e shkurtër: «*Eisagogiké Dhidhaskalia*», dhe përmban: në fa-

qen e dytë pa numër gjashtë distike romeisht me rimë, të një farë Mihal Skina, prift, që i thurin lëvdata auktorit dhe metropolitit Nektar, dhe nj'a katër vargje të tjera me falënderime e urime për Danjelin e Nektarin. Faqet 3 e 4, edhe këto të pa numëruara, i zë një letër kushtimi n' elenishte të vjetër, drejtuar Metropolitit të Pellagonisë, në të cilën Danjeli nenshkruan: *Danil Mihal Adam*, *Haxhi Voskopojari.* Në faqen 5 e 6 gjenden nj' a 24 distike të rimuara e të shkruara në rend alfabetik, greqishte. Në faqen 7 të panumruar gjenden prap nj' a 14 distike që i kushtohen Nektarit. Nga faqja e parë e numëruar gjer tek e tridhjetëgjashta vjen «*Fjalori*» i radhitur në katër shtylla: greqisht — vllahisht — bullgarisht — shqip, shkruar me gërma greqishte për të katër gjuhët. Për shqipen është përdorur po ai alfabet që ka përdorun edhe Kavalioti. Prej faqes 37-39 gjendet një ligjëratë a një lajmërim drejtuar djemëve që duanë të mësojnë. Faqet 39-53 përmbajnë një „*doktrinë të krishterë*" në trajtë dialogu, faqet 54-59 disa njohuri të ndryshme të fizikës; faqet 60-71 modele letrash e testamentesh, aktesh, prikash etj., faqet 72-83 të katër punët e arithmetikës; faqja 83 porosira për nxënësit; faqja 84 të kremtet e shënjta të vitit, faqja 86 tregon se qysh gjindet moti i ri e i vjetër etj.

Dijmë sot me siguri se vepra u botua dy herë: herën e parë më 1794 dhe të dytë më 1802. Të dyja botimet dualën nga shtypëshkronjat e Venetikut.

Dijmë edhe se pjesa bullgarishte e veprës nuk u shkrua nga vetë Danjeli, po nga një prift bullgar me emërin Stefan.

Duhet shtuar pastaj se, në kundërshtim me emërin qi i ep vetë Danjeli pjesës katërgjuhëshe të librit, aty s' kemi të bëjmë aspak me një «*fjalor*» po më tepër me një «libër bisedimi» me një përmbledhje frazash të përkthyera do si do në të katër gjuhët, të cilat si pas mendimit e shpresës s' auktorit do të mjaftonin t' u mësonin greqishten Vllehëve, Bullgarëve e Shqipëtarëve!

Vlera e këtyre frazave përsa i përket shqipes është shum e pakët: ka ndoshta vetëm atë të dokumentit. Dhe as që munt t' i afërohet veprës së Kavaliotit, e cila, sado e vogël, po është prap se prap një fjalor, i punuar me një farë kriteri shkëncor e jo krejt pa vlerë gjuhësore për ne.

3. — KOSTË BERATASI (rreth vj. 1800)

a) Dorëshkrimi i veprës

Ruhet prej disa vjetëve në Bibliotekën kombtare të Tiranës një dorëshkrim i vjetëruar dhe aty këtje i shqyer, shkruar në gjuhën greqishte në disa pjesë po edhe në gjuhën shqipe me gërma greqisht në më të shumtën e pjesëve të tjera. Duket se auktori i dorëshkrimit është një farë **Kostë Beratasi**, ndothta edhe ai „dhaskal“ a prift — a të dyja këto — dhe ndothta nxënës i Akademisë së Voskopojës, po si do qoftë, ndjekës i kësaj shkolle në drejtimet e veprës së tij. Tjatër lajm të sigurtë nuk kemi, as që janë bërë kërkime të sigurta në këtë pikë.

Dorëshkrimi i Kostës është një farë librë këndimi a më mirë një abetare për nxënësit e shkollavet fetare dhe ka të gjitha karakteristikat e veprave të këtij lloji që qarkullonin aso kohe në qarqet orthodhokse të Toskërisë. Ka vetëm 152 faqe, po vepra e plotë ka pasur 154, pse janë çdukur faqet 57 e 58. Trajta e shkrimit tregon se është e shkruar e tërë prej një dore. Përmbleth këtë lëndë : tabela e Pitagorës, shënime kronologjike që nga viti 1764 gjër 1766 (greqisht), Urata dhe të falura kishe greqisht me përkthimin e tyre në shqip, urata kishe greqisht të këthyera në greqishten e re, shënime kronologjike mbí luftën e Ahmet Pashë Kurtit kundra Mahmut Pashë Shkodrës (1765-1766) me të ngjarat e luftrave të Mehmet beut, të birit të Kurt Pashës me dhëndrin e tij Ibrahim bej Vlorën dhe me Ali Pashë Tepelenën që zgjatnë gjër në vitin 1798 (greqisht), një vjershë fetare greqisht dhe përkthimi i saj në shqip, një fjalor greqisht-shqip prej 1100 fjalësh, pjesë të apostullit në gjuhën shqipe, urata kishe shqip, fjalor greqisht-shqip prej afro 1000 fjalësh, urata shqipe, dy radhë shqip të shkruara me alfabet të ndryshëm për të cilin do të flasim më poshtë, urata kishe shqip, tabellë e 37 shkronjave të posaçme të alfabetit shqip, urata, fjalë t'urta, këshilla fetare etj. greqisht të këthyera në greqishten e re.

Dorëshkrimit datë e prerë nuk munt t' i caktohet hë-për-hë ;

po nga shënimet kronologjike rreth luftërave të Ahmet Pashë Kurtit e të Mehmet beg Kurtit me dhëndrin e tij Ibrahim bej Vlorën dhe me Ali pashë Tepelenën që zgjatën gjër më 1798, duket se është i fundit të sh. XVIII a i fillimit të XIX e jo i vitit 1768 si është pretenduar më parë.

Gjuha e përdorur është ajo që flitet në Berat e rrethet e tij, po e përzierë me fjalë turqisht që sot ase janë shdukur ase dëgjohen rrallë.

Sa për rëndësinë e dorëshkrimit, sigurisht një farë vlere ai e ka : *a)* pse i shtohet një copë tjatër prodhimit letrar toskë-orthodoks ; *b)* pse na jep të kuptojmë që edhe Berati këtej e tutje do të zërë një vënt në historinë e zhvillimit kulturor shqipëtar, ashtu siç e zënë qytete të tjera të Shqipërisë.

Po dorëshkrimi ka posaçërisht vlerë për ne pse na bën të njohim një *alfabet shqip tjatër* që gjër më sot nuk dihej. Ky alfabet, siç thamë më lart, është përbërë prej 37 shkronjash. Prej këtyre vetëm shkronjat *a*, *th*, *l*, *ks*, *o*, *r* kanë një farë shëmbëllimi me alfabetin grek në trajtë e në shqiptim, kurse me shkrimin latinisht përpiqen shkronjat *a*, *e*, *m*, *n*, *o*. Gadi 28 shkronjat e tjera disa i afrohen trajtës së të shkruarit glakolit e cirilik po pa kurrfarë të përpjekuri në punë të shqiptimit.

U besua në fillim se ky alfabet ishte i njëjtë me një tjatër alfabet shqip të vjetër, me alfabetin e mësonjësit elbasanas Theodhor Haxhi Filipit ; po pas një krahasimi në mes të tyre u vu ré se nuk kanë as më të voglin afrim njëri me tjatrin. Të ndryshëme janë prandaj pyetjet që na shtie ndër mënt alfabeti i librit të Kostë Beratasit : Kush qe krijonjësi i tij ? a është përdorur ndonjë herë në ndonjë qark të hapët të Shqipërisë ? nga i ka marrë këto shkronja krijonjësi ? Hë-për-hë duke qënë në fillim të kërkimevet, është e pa mundur t' u përgjigjemi me sigurí këtyre pyetjeve. Sido qoftë, disa bisedime munt të bëhen rreth tyre.

Për sa i përket identifikimit të krijonjësit të tij, një gjë na merr mëndja : që ky krijonjës nuk duhet kërkuar në personin e auktorit të dorëshkrimit. Po të kish qënë vetë i ashtuquajturi Kostë Beratasi krijonjësi i tij, sigurisht dhe veprën e

vet do t' a kish shkruar me këto gërma, siç e shkroi me gërmat e tija mësonjësi elbasanas. Po natyrisht as nuk munt të thuhet se këto gërma u çpiknë aty për aty nga shkronjëtori i vjetër beratas. Nuk ish fëmijë auktori që të loste duke i çpikur pa ndonjë qëllim të caktuar. Pastaj këto shkronja janë shkruar prej një dore së sprovuar me 'to, d. m. th. prej një dore që ishte mësuar prej kohe t' i shkruante.

Për sa i përket përhapjes s' abecesë në një qark të hapët a të ngushtë të Shqipërisë, edhe kësaj munt t' i përgjigjemi në mënyrë pohonjëse. Vetë fakti se këto shkronja janë shkruar prej një dore të mësuar na shtyni të besojmë se ajo dorë do t'i ketë përdorur dëndur e prandaj se ndonjë përhapje — fundi, vetëm në Berat — këjo abece do t' a ketë pasur. Hahn-i, kur bën fjalë për abecenë elbasanase, ndër të tjerat, shkruan: „Thonë se vetëm në Berat kujtohet dhe përdoret prej pak njerëzve". Na vjen një dyshim: mos janë gabuar informatorët e Hahn-it dhe kanë përzier abecenë elbasanase me atë të dorëshkrimit, d. m. th. me atë që përdorohej aso kohe në Berat? Edhe një konstatim tjatër duhet shtuar: me qënë se vepra e Beratasit ka edhe një qëllim didaktik, nuk është çudi që auktori të ketë vënë atë tabelë nërgut që të mësonin nxënësit a lëçitësit edhe shkronjat greqisht me të cilat është shkruar pjesa shqipe e librit. Po atëhere duhet pranuar që ky alfabet ka qënë njohur mirë të pakën në Berat, dhe ka qënë përdorur për shqipen më tepër se alfabeti grek, që fillon të hyjë me Beratasin a me ndonjë shok më përpara tij. Argumentime të gjitha që duhen rrahur e duhen dokomentuar!

N. RESSULI

b) Zonjë Shëmëri përpara Kryqsë

Zonjë shënmëri ([1]) ardhurë,
endenj përpara kryqsë
e mbretëreshë ([2]) engjëjet
zonjë·egjithë dyniasë.

* * *

e kur epa mbërthyerë
shpë timnë ([3]) njerëzisë
e qante ngashëryerë,
memallë njim ([4]) thërriste.

* * *

iudha imallëkuarë
që kallëzoi çifutë ([5])
e erdhë e të rrëmbyenë,
si uqër të pandiesm ([6]).

* * *

të shpunë të të gjykonjënë,
ndë avlli të pillatit.
qiturë shah it jallanxhi ([7]),
që të të turpërojnë.

* * *

të ndynjënë etë pështynjënë,
e të rrah (n) etë shanë
metë math zë thërrisinë,
ati pillatit vrae ([8]).

---

1) Zonj' e Shën-Mëri, zoja nana e Krishtit.
2) e mbretëreshë e engjujvet.
3) shpëtimn'e: shpëtimin e njerzisë.
4) me mallënjim.
5) q'e kallëzoi te çifutët.
6) si uqër të pandjenjë, të pa-mshirë.
7) *shahit jallanxhi:* dëshmonjës të rremë.
8) *atij Pillatit vra-e!:* vraje i thrritshin Pilatit.

BKSH

. . .

vallë çu pate bërobir (9),
a ç të ligupunove (10).
që mbë kryq të mbërthyenë,
e vdekë (11) që të dhanë.

. . .

o bir i im idashurë,
e djali im i ëmblë.
qysh i duron mundimetë,
rah urë (12) përçmuarë.

. . .

du ar ekëmbë plagosurë,
me goe (13) të këqia
ekurorënë prej drize,
që ta vunë mbë krye.

. . .

me shish brinjënë shpuarë,
derdhurë gjak e ujë
çë këjo gjakësi që bëtë
ô çifu të (14) pabesë.

. . .

o të arnisurit (15) e zotit
që ai u dhanomnë (16)
që le se si besuatë (17)
po dhe këto ia bëtë.

---

9) ç' u pate bërë o bir ?
10) a ç' të ligë u punove ?
11) e vdekje.
12) rrahur e përçmuarë.
13) me gojë.
14) o çifutë të pabesë.
15) Të mohuarit.
16) *ju dha nomnë (ligjën) :* i u dha nomin.
17) s' i besuat.

.
. .

për të mirat qu ([18]) pat bërë,
ngah era ([19]) ushëronte
të verbërë të shqepërë ([20])
ulogër esakatër.

.
. .

e u ngjallë të vdekurë,
të shih ni ([21]) të besoni.
eju karshi ([22]) atyreve,
vdekëjënë e dhatë.

.
. .

mbë të mbërthyerë të ti,
dielli uerrëcua
e hënëza bashkë metê
dhe ajo uh elmua ([23])

.
. .

se qysh ai qi pat bërë,
mbë kryq vdekëjë muar.
vetëmë një rëzillëku ([24])
e jo perëndillëku ([25])

.
. .

e dridhish qi ell ja ([26]) e dheu,
gur tu ([27]) dërrëmuanë
e ju qysh sumenduatë ([28]),
mbarë ([28]) sa ti mesoni.

---

18) që u pat bërë
19) ngahera, përherë.
20) *të shqëpërë :* të shqepëtë, të çalë, të shkepët.
21) të shihni.
22) *karshi :* përdrejt, për çpërblim.
23, *u helmua :* u helmue, i rá keq.
24) *vetëm njerëzillëku :* vetëm Krishti-njeri
25) *e jo perendillëku :* e jo Krishti perendi.
26) qiellja, qielli.
27) gurët u dërmuan.
28) *mbarë :* ndobare, së paku.

BKSH

∴

ele ju tarrënisurë ([29])
se mbetë të pabesë
po ku shtë ishën pjetri ([30]) që të tha,
do të vdes me ty bashkë.

∴

e tarrënisi ([31]) e të la,
vetëmë me të tjerët.
të gjithë ik në ([32]) etë lënkanë
ndër duar të të pabeset.

∴

që ata tëh elmuanë ([33]),
kur thirre et më vjen ([34]).
muarrë h elm ([35]) e uthullë,
e ta vunë ndë gojë.

∴

po ti sikundër qëe thëno bir ([36]),
si perendi të ngrihesh
të ngjallesh prej të vdekurish,
të shpëtojç njerëzinë.

∴

ata që të besuanë
se erdhe utrupëzove.
e u bëre njeri për ta,
e gjithë këto i vuve.

---

29) *t' arrënisurë:* të bërë hasha, mohues.
30) ku është i-shën Pjetri.
31) *të arrnisi:* të mohoi.
32) *iknë:* ikën e të lanë.
33) *të helmuanë:* të farmakosnë.
34) *et më vjen:* uj më pihet!
35) helm.
36) qe e thënë o bir.

. . .

megjak të shënjtëruarë,
që për ata derdhe,
që ti shpëtojç ([37]) pej shejtanit,
e përsëri ti shpiesh ([38]).

. . .

ndër paradhisht e ndë konakt ([39])
tek ivure përpara
që të të lavduronjënë ([40])
ndë jetë të posaçme. (*)

---

4. — MARKO BOÇARI (1809)

a) Dorëshkrimi i Fjalorit

Në Bibljothekën Kombtare të Parisit, në ndarjen e dorëshkrimevet, në pjesën *Supplement grec*, nën numrin 251, gjëndet një vllim i vogël, 12 centim. X 18, 5, lidhur me lëkurë.

Në këtë vllim janë qepur bashkë dy dorëshkrime, i pari prej të cilavet ësht ay që na intereson, **Fjalori i Marko Boçarit**, kapedanit shqipëtar nga Suli.

Ky fjalor fillon në faqe 25 dhe vete gjer në faqen 136; mbi fletën e parë këndojmë këto tri radhë:

„*Ce lexique est ecrit de la main de Marc Botzaris a Corfou 1809 devant moi*". Pouqueville [1]).

---

37) t' i shpëtosh.

38) *t' i shpiesh*, t' i çojsh.

39) ndë banesë, ndë strehë.

40) të të lavdërojnë, të të lavdojnë.

(*) Ky shëmbull nga dorëshkrimi i Kostë Beratasit u nxuer nga e përkohëshmja «*Leka*», Vjeti X. 1938, Nr. 8-9, faqe 375-381.

1) Ky fjalor është shkruar me dorën e Marko Boçarit, në Korfuz, 1809 përpara meje. (Pouqueville.)

Një shënim na thotë se dorëshkrimi „I është falur *Bibljothekës së Mbretit* (emri i atëhershëm i Bibliothekës Kombtare) prej Pouqueville-it, ish konsull i përgjithshëm i Francës në Janinë. Maj 1819. Pouqueville.“

Me ketë mënyrë konsulli i Napoleonit, ay të cilin Ali pashë Janina e quante Qafir Pukovil, veç libravet të tij mbi Shqipërinë dhe Greqinë, na la, duke e ruajtur, edhe një dorëshkrim shqip.

Ky fjalor paraqet një interes fjesht kureshtije, si një kujtim i të famëshmit kapedan Suliot, pa ndonjë rëndësi letrare ase filologjike të vërtetë.

Fjalori s' ka ndonjë radhë alfabetike; fjalët janë radhitur pa rregull, shkruar me shkronja greqishte, pa orthografi, pa shënja mbi të zëshmet, thjesht dhe pa mjeshtëri, si ç' i kishte hije një trimi luftar.

I pari, me sa dijmë, që ka bërë fjalë për këtë dorëshkrim është historiani grek *Spiridon Lambros*, më 1895, në numër të Këshëndellavet të gazetës *Estia*, duke botuar tekstet e faqevet 25 (e para) dhe 69, të tërë, dhe 4 radhë nga faqja e fundit 136 dhe një fac-simile fotografik të faqes së parë. Ky artikull i historianit grek është rishtypur dhe në LOGOI KAI ARTHRA, 1878-1901, t' auktorit (Athinë 1902) në faqet 533-538.

Pjesa e dytë e vllimit me Nr. 251, mban tekst dhe copë gramatike greqishte, të përkthyer dhe të shpjeguar shqip. Teksti greqisht është shkruar mirë dhe jo shëmtuar; pjesa shqipe është me një palë letra më vehte, të shpikura prej auktorit i cili mbetet i panjohur, se, as libra, as katalogu i Bibliothekës nuk kanë ndonjë shënim mbi ardhjen e këtyre faqeve. 2)

LUMO SKENDO

---

2) Fjalori i Marko Boçarit u botue edhe si libër i veçantë në vjetin 1926 në Tiranë me kujdesin e Lumo Skendos. Botimi i këtij përmbledh 84 faqe me 4 fac-simile të faqeve të ndryshme të dorëshkrimit të fjalorit.

b) Vrejtje psikologjike mbi Fjalorin e Boçarit [1])

Fjalori i vogël që na ka ruajtur trimi Suliot ka, jo vetëm një rëndësi gjuhësore për të folët e Çamërisë, po edhe një interes psikologjik nga disa mësime që dalin prej tij, mësime të dhëna prej mbledhjes dhe kombinimit të fjalëvet, e prej mënyrës me të cilën jipet kuptimi i frazavet. Këto fraza kanë dalë prej një farë metode ndjenje, një mendimi të pshehtë, që çfaqet befas, i lindur prej individualítetit të luftarit, ase, më mirë edhe prej shpirtit të një race.

* * *

Në faqen 27, fjala greqishte *agon* që do të thotë *luftë, luftim, përpjekje*, është përkthyer me kuptimin *punë*, sikur të punuarit është më e madhja luftë dhe luftim për Shqipëtarin, rreziku që duhet t' i ndruhemi, kanosja e mvarur mbi kryet t' ënë.

Akue, grika, turke (f. 32,) *ngjëkoju, kupto, Turk!* I trashë, kokëtrashë, halldup, a s' kanë qënë sinonime për të rrëfyer përfaqësonjësin e racës anadollake, atë që kupëton rëndë?

Varvaros (f. 35) *kokëtrashë*. Nuk munt të gjendet përkthim metaforik më i bukur: t' i hollojë mëndjen dhe ndjenjat njeriut që të bëhet dhe i qytetëruar.

Dhimios, ehthros (fr. 37) *xhelat, hasm*. Afrim i tmerrshëm: armiku është pa mëshirë, smiri i tij vete gjer sa të më rjepë lëkurën.

Qira timia (faqe 52) *zonjë timisur*. Ky kujdes për të vënë pranë fjalës *„zonjë“* mbiemrin *„timisur“* e nderuar, a nuk jep mentime të pikëllueshme, sikur ideja e një gruaje natyrisht duhet të jetë ndarë prej respektit, prej nderimit? Gruaja me njomësinë e ndjenjavet, me dashurinë që ka në zëmër, me tërhekjen fizike të bukurisë, është një element qytetëronjës dhe zbutës, një objekt kulti, e respektuar dhe e nderuar.

---

1) Këto vrejtje dhe shenime u nxoren nga e përkohëshmja «*Diturija*», Tiranë, Volum II, 1927, Nr. 12, faqe 387.

Alveri aspro (f. 67) *miell të bardhë.* Endër e kotë, padyshim, se, në cilin mulli të bluajë, me ç'mjeshtëri, me ç'durim t'a sitnjë?

Thiridha ohi (f. 69) *penxhere jo.* E ç' e do? Për shëndet? ç' rëndësi ka? ç'vleftë munt të ketë jeta e njeriut? Rri pra në t' errët, pa dritë, pa diell, pa erë, mbrënda në pluhur e në tym.

Tiri kallo (faqe 71) *djathë i mirë.* Do me thënë jo baxho, pa gjalpë dhe pesëdhjetë pë1 qint kripë, po një gjë e shijshme, e butë dhe e mirë për qiellëzën, të munt të hedhë pak pëlqim në jetën e ashpër.

Apothiqi (f. 74) *oda e stolisur.* Gjëja, plaçka tregëtare, sendet që munt të shiten dhe të kthehen n'ergjënt, në para, malli, me një fjalë, qënkan e vetëmja stoli e një shtëpije. Odat e tjera, atje ku rrimë, ku shkojmë jetën, s' paskan nevojë të jenë të bukura si tregtorja.

Katharon krevati (f. 83) *pastruar shtrat.* Një tragjedi epike me dy fjalë: një shtrat pa pleshta, pa morra, pa çimka, të shpëtuar prej këtyre armiqve jetikë të lëkurës së mjerë. Ke një *dyshek të butë*, ke një *çarçaf të bardhë*, e mjafton. Pastaj burri, trimi, a nuk duhet që të përbuzë çdo pastërtí, çdo hollësí e çdo kujdesje të trupit? Vërtet xhamadani, silaheja, jeleku duhet të jenë t' artë. Po këmisha, fustani, n' është e mundur, duhet të jenë të zez, me lyrë.

Ormi ekdhiqisis (f. 85) *mbi té marr hak.* Guido Reni në një pelhurë të famëshme të pinakotekës në Bologne na rrëfen një shënjt që bie me një vrull rrufeje prej qielli. Fraza lapidare e Boçarit na sjell përpara syvet një pamje të keqe, dora e mëngjër në perçet, e djathta ka ngritur jataganin.

A kakos (f. 92) *fare i keq.* Pe mëshirë, pa dhëmbshuri.

Allatizo sarka (f. 92) *krip kurm* (kufomë). Shprehje me figurë: *e kripi, i a kripi lëkurën.*

Faqí arkivi (f. 97) *groshë të shtrënjta.* Bereqeti s' u bë, të lashtat s' patën shi, misri kur u vual mezi po nxjerr farën. Na edhe grosha (thjeri) që ësht' e shtrënjtë. Një perspektivë zije, urije, vuajtjeje përpara syvet.

Jenome anthropos (f. 110) *bënem njeri.* Mësonj mënt, fitonj cilësi morale, jam i zoti të munt vetëhen, të duronj dhe të kundërshtonj, marr virtyte për begatín e frymës dhe t' inteligjencës? A po bëhem trim, i zoti për luftë, vras armikun, shuanj atê që është më i math, më i ditur, më i pasur se unë?

Skotinon thelima (f. 117) *i zi dashuri.* Edhe dashurija, ndjenja më e butë, më e njomë e zëmrës, duhet që të jetë e zezë, e egër e ashpër.

Pethami ji (i f. 120) *pëllëmbë dhé.* Dy faza që vargohen me një ironi të çudiçme: varfëri e madhe që e bën kashtën kaq të çmuar, dreka e rrallë, dhe pëllëmba tokë për një varr, për të mbyllur jetën dhe vuajtjet.

---

5. — GRIGOR GJIROKASTRITI (1824)

a) Jetëshkrimi

Mbi jetën e Grigor Gjirokastritit nuk janë zbulue deri sot lajme të plota e të sigurta. Dijmë vetëm se ka qenë nga Gjinokastra, nga qyteti ase nga ndonji krahinë a fshat i saj. Kur plasi kryengritja e Eubesë kundra Turqisë në Prill të vjetit 1821, Grigori ishte epishkop i asaj ujdhese dhe, mbassi, si duket, pati gisht n' atë lëvizje, u-zû prej qeverisë turke dhe u-burgos n' Eubé me shum kryengritës të tjerë. Si u-lirue nga burgu mbas dy vjeç, i shkroi qeverisë së përkohëshme greke, të formueme atëherë në kryengritje e sipër, për t' i caktue ndonji shërbim, që t' a shihte ajo të dobishme për interesat e vendit. Prej kësaj letre, ku veç të tjerave tregon mundimet që kishte vuejtë për dy vjet në burg, kuptojmë se Grigori kishte bâ studime të rregullshëme teologjike e se ishte nji levit i diçëm, qokatar e i virtytshëm. Mbassi qeverija greke, duket nga disa kundërshtarë të tij, nuk i dha përgjigje, as nuk i caktoi ndonji shërbim, Grigori vojti e zû vend në Korfuz, ku ndêjti për katër vjet në mes të fshatarëvet e njerëzvet të tij që gjindeshin atëherë n' atë ujdhesë. Titullin e kishte Epishkopi i Eubesë. Më 1827,

në Shtatuer, Patriarkija e Stambollit tue çmue virtytet e nalta të tij e zgjodhi dhe e emnoi kryepishkop t' Athinës. Por në këtê seli të re Grigori nuk rroi shum kohë, se vdiq mbas gjashtë muejsh.

b) Vepra e Grigorit

Aso kohe, kur gjindej Grigori në Korfuz, ishte formue n' atë ujdhesë shoqënija biblike e Jonisë, e cila si mbas shembëllës së shoqënisë biblike protestante kishte qellim të përkthente në greqishten e re Shkrimin e Shenjtë e t' a përhapte leximin e tij në popull. Në Korfuz u-mblodhën atëherë shum njerz të diçëm, Grekë e Shqiptarë, t' ikun nga Suli, nga Parga e nga viset e tjera, që ishin pushtue prej Ali Pashë Tepelenës. Dekani i gjith kësaj lëvizje letrare në Korfuz ishte Andrea Idhromeni ase Papandrea, Shqiptar nga Parga. Ky ishte nji levit me dituri të gjânë, sikurse duket prej shkrimevet të tij në nji gjuhë greqishte të pastër e të naltë.

Grigori, si njeri me kulturë që ishte, muer pjesë në këtê shoqëni dhe vû ndër mend me e përkthye në Shqipet Dhiatën e re, për t' a përhapë këndimin e saj ndër Shqiptarët e Korfuzit e të Shqipnisë përtej. Përkthimi në shqipet u-bâ prej greqishtes dhe si tekst u-muer përkthimi i greqishtes së re të Maksim Kalipolitit, që ishte në përdorim aso kohe, i botuem në Gjenevë më 1638.

Botimi i parë i këtij përkthimi shqip ka dalë në Korfuz më 1824, që âsht fort i rrallë dhe ka vetëm Ungjillin e Mateut; botimi i dytë duel prap në Korfuz më 1827 me të tanë Dhiatën e re, i treti n' Athinë më 1858. Të përkthimit të Korfuzit kemi dy botime, njênin në nji blê të vetëm dhe tjetrin në dy pjesë, nga të cilat e para përmbleth të katër Ungjijt dhe punët e Apostujvet, pjesa e dytë ka Letrat dhe Zbulesën. Në të dyja botimet âsht teksti greqisht në nji shtyllë dhe në tjetrën përkthimi shqip. Në këtë përkthim âsht përdorë alfabeti greqish i formuem prej të 24 shkronjave greke me shenja të veçantai mbi disa shkronja, për të shqiptue tingujt e shqipes, që nuk ka greqishtja.

Botimi i Athinës ndryshon prej atij të Korfuzit vetëm nga teksti greqisht, i cili n' atê të Korfuzit ka nji greqishte popullore, kurse n' atê t' Athinës përdoret gjuha e pastër greqishte; përkthimi shqip âsht po ai në të dyja botimet. Si i pari, si i dyti botim, veç titullit greqisht, ka këtê titull shqip: **«Dhiata e Re e Zotit sonë Jisu Kristoit mbë di gjuhë, do me thënë gërqishte dhe shqiptarçe»**. Botimi i Korfuzit ka këto fjalë (në greqishtet): *me kujdes të Grigorit, Epishkopit t' Eubesë.* Prej këtyne fjalëve, Kamarda në gramatikën e tij thotë se përkthimi, nën drejtimin e shqyrtimin e Grigorit, âsht hartue prej shum njerëzve të diçëm. Mirë po nuk përmendet emni i ndonjij tjetri që ka punue me Grigorin në këtê përkthim. Prandaj Grigori jo vetëm që ka pasë drejtimin e shqyrtimin e punës, por edhe ka marrë pjesë aktive në këtê përkthim, tue pasë, duket, ndonji shok. Sido me qenë, kjo vepër e Epishkopit t' Eubesë ka nji randësi të veçantë në historin' e letërsisë s' onë, pse âsht i pari përkthim në shqipet të Dhiatës së Re. Prej albanologëvet përmendet me të madhe ky përkthim dhe ka qenë nji burim i mirë për ta në studimin e gjuhës shqipe.

c) Nga Ungjilli i S. Llukës, Krye XV. 11.

E tha: një njeri qish di djelm. E m' i riu nga ata i thotë së jatit: nemë pjesën e gjërit që më bie, e u ndau atyre gjënë. E pas jo shumë ditet i mbëjodhi gjithë m' i riu e iku, e vate ndë vënt të largë; e atje përhapi gjën' e tij ndë punëra të liga. E si e prishi ai gjithë, u bë u e madhe mb' atë vënt, e ai nisi të mos qish.

E vate e u kolis më një nga fshatarët e atij vëndit, e e dërgoi atë ndë çiflikë të tij të ruan derratë. E qish dëshërim të ngos barkun e tij nga lentëtë që hajnë derratë, e nuk i jipte njeri atij. E si erdhi ndë vetëhe të tij tha sa rrogëtarë ndë shtëpi të babait sim kanë bukë që u tepëron, e unë këtu vdes urijet.

Do të ngrihem të vete te babai im e t' i thom: baba, fëjeva kontrë qiellit edhe kontrë teje. E më nuk jam i zoti të

quhaem biri it, bëmë posi një nga rrogëtarët e tua. E u ngre e erdhi nde babai tij; e si ké akoma larg nga ai, e pa atë babai tij, e i erdhi qeq për të; e u lëshua e i shtiu duartë mbë qafë të tij, e e puthte atë.

E i biri i thotë atij: baba, fëjeva kontrë qiellit edhe kontrë teje, e nukë jam i zoti më të quhaem biri it. E babai u thotë shërbëtorëvet së tij: kreni jashtë më të mirat rroba, e vishnie atë, e viri unazë mbë dorë të tij, e të mbathura në këmbë të tij. E bini viçn' e ushqierë me grurë e therie, e të hamë e të gëzonemi. Se kuj biri im ke i vdekurë e pa rroi, e i humburë e u gjënt, e nisnë të gëzonishnë.

E biri m' i madhi tij ké mb' arë, e mbë të kthierë, po që u afërua shtëpisë digjoi të kënduara e vallëra. E si thirri një nga kopijtë e pieti çdo të jenë këto. Edhe ai i tha atij, se vëllai it erdhi e theri babai it viçn' e ushqierë me grurë, sepse e priti atë me shëndet.

E ai u zemërua e nuk duan të hin brënda, e babai tij doli jashtë e i lutej atij. E ai u përgjegj e i tha babait së tij: ja kaqë vjet të punoj ti e ndonjë porsí nukë të shkela, e mue nukë më dhe kurë një qeç, të gëzonem me miqt' e mi. E kur erdhi kuj biri it, që të hangri gjënë me gra të liga, i there atij viçn' e ushqierë me grurë.

Edhe ai i thot' atij: bir, ti kurdo me mua bashkë je, e gjithë të miatë të tuatë janë. Po ishte e udhësë të bëjëmë gosti e gëzim, sepse kuj vëllai it ké i vdekurë e pa rron, i humburë e u gjënt.

ç) Gjuha

Sikurse duket nga teksti, gjuha që ka përdorë Grigor Gjirokastriti në Dhiatën e Re âsht toskënishtja, e medje ajo që flitet nëpër viset e Gjinokastrës. Grigori âsht mundue të përdori nji gjuhë të thjeshtë shqipe, që të mund të kuptohet prej popullit, për të cilin e kishte caktue veprën e vet; e prandaj, për t' ja mrrimë këtij qëllimi ka përdorë edhe disa fjalë turqishte e greqishte, sikundër duket nga gjithë vepra e tij. Po

me gjithë këtê, tue këndue njeriu të tanë veprën, gjên fjalë frazeologjí e të lidhuna fjalësh, që janë krejt shqip. E për këtê punë e tanë *Dhiata e Re* e Grigorit âsht shum interesante dhe nji thesar i çmueshëm lande për studime gjuhësore. Tue e krahasue gjuhën e gjithë veprës me toskënishten e sotme gjêjmë disa trajta fjalësh, që nuk përdoren sot në gjuhë të shkrimit. Po ftillëzojmë këtu trajtat e fjalëvet që gjinden në këtê tekst:

* * *

Qish = *kish, kishte. Kjo trajtë përdoret edhe sot në gjuhë të të folunit.*

Di = *dy. Si dihet, në gjuhë të Gjinokastrës, d. m. th. në labërishtet, nuk përdoret zanorja* y.

Së jatit. *Nyja* së *në vend të* të-s *që përdoret sot haset shpesh herë në gjithë tekstin.*

Gjërit; *thohet* gjë-gjëri *e* gjë-gjëja, *d. m.* . *ala* gjë *âsht mashkullore e femnore, sikurse edhe shum fjalë të tjera në shqipet, si* koll-i *e* kollë-a, qiell-i e qiellë-a, *etj.*

E pas... ditet. *Këtu kemi trajtën* ditet, *që përdoret në Shkodër, në vend të* ditës. *Kjo trajtë më* — et *përdoret shpesh në këtê vepër.*

I mbëjodhi, *në vend të* i mbëlodhi. *Edhe kjo trajtë përdoret shpesh në tekst.*

U e madhe = *uri e madhe. Kemi këtu trajtën* û-uja *që sot përdoret mâ fort në gegënishtet.*

U kolis = *u-ngjit. Kjo âsht fjalë greqisht.*

Të ruan = *të ruante. Trajta e shkurtën e vetës së tretë të njëjsit të kohës së pakryeme, që edhe sot përdoret dendun në të folun:* kish = *kishte,* bëj = *bënte,* shkoj = *shkonte, etj.*

Të ngos = *të ngoste* = *të ngopte, të ngrinte.*

Babait sim = *babait t' im. Përdorim i shpeshët i nyjes* së, *si e pamë mâ nalt.*

Vdes urijet = *vdes prej urisë. Kemi këtu rasën rrjedhore të thjeshtë, që përdoret sot shum në shqipet. Këtu kemi trajtën e shkodranishtes më* — et, *sikurse edhe mâ nalt:* ditet.

Quhaem = *quahem, quhem.*

Bëmë = *më bân. Mënyra urdhënore me përemnin vetuer mbrapa, frazë elegante që përdoret shpesh në toskënishtet:*

thuajmë, epmë, dëgjomë; *kështu edhe në shumësin:* èpmani, thomëni, epuani, *etj.*

Ké = *qé. Kjo formë e foljes me shkrojëu* k *haset shpesh herë në këtê vepër.*

Qeq = *keq. Edhe kjo trajtë me* k *e kësaj fjale gjindet prorë.*

Kreni = *nxirni, qitni.*

Kuj = *ky.*

It = *yt.*

Nuk duan të hin = *nuk donte të hinte.*

Qeç = *keç, edh.*

A. XHUVANI

BKSH

KAPTINA IV.

Shkrimtarë të vjetër myslimanë

NJOFTIME TË PËRGJITHËSHME

Prodhimi letrar mysliman u zhvillua, si e thotë kthielltas titulli, ndër myslimanë, pothua edhe këta të gjithë toskë, edhe pati si përfaqësonjës më të dëgjuar **Muhamet Çamin** *(sh. XVIII) nga Konispoli,* **Nezimin** *(1754) dhe* **Sulejman Ramazanin** *nga Berati dhe* **Hasanin e Zyko Kamberit** *nga Kolonja. Sigurisht do të ketë pasur edhe të tjerë, po kërkime sistematike nuk janë bërë gjër më sot as për këtë prodhim.*

Ky prodhim letrar mysliman dallohet nga dy të parët :

a) *pse veprat e këtyre shkrimtarëve janë pothua krejt laike, mbassi laikër qenë ata vetë, me përjashtim të* «Ervehesë», *gjër më një farë pike «epikureane». Si pas modës s' atëherëshme shum nga «bejtet» e tyre, kur rrahin argumente akseptike — natyrisht një akseptizëm krejt orientale — u janë kushtuar dëfrimeve që bëheshin n' atë kohë në qëndrat më kryesore të Toskërisë.*

b) *pse arabo-turk është influksi që zotron në këto shkrime. Madje shum herë aqë i math është ky influks sa që nuk munt të kuptohen mirë prej leçitësve që nuk njohin Arabishten, Turqishten e Persishten.*

c) *pse për alfabet kanë përdorur atë arabisht-turqisht.*

Larg nga çdo frymëzim a ndjenjë atdhetare, këto «bejte», me përjashtim të «Ervehesë» *— që është ndoshta e para vepër shkruar në gjuhën shqipe me pretendime estetike, sado që auktori nuk i a ka arritur qëllimit të vet — kanë vetëm një vlerë historike për ne. Po nuk duhet harruar se lëvizja myslimane*

është e para lëvizje laike *e kulturës shqipëtare, dhe sikur vjershëtorët e saj t' ishin kujdesur më tepër për lërimin e qërimin e gjuhës dhe për shtypjen e vepravet të veta, do t' a kishin prirë të pakën nja dyqint vjetë lëvizjen e Stambollit.*

N. RESSULI

---

1. — MUHAMET ÇAMI (shek. XVIII)

a) Jetëshkrimi

Muhamet Çami prej Konispoli jetoi në qindvjetin e tetëmbëdhetë. Mjerisht nuk kemi kurrfarë njohtimesh për jetëshkrimin e këtij paraqitësi mâ të vjetër të prodhimit letrár në jugun e Shqipnís. As Jan Athanas Vretua, i cili u muer me vepërzën e tij *Erveheja*, nuk âsht në gjendje të shkruejë ndonji gjâ të caktueme për Muhamet Çamin. Nuk mund të na api të tjera njohtime përveç atyne qi i ka rreshtue në parathânëjen e botimit të parë t' *Ervehés*, qortue e smadhue, shtypë në Bukuresht para nji gjysmë qindvjeti e mâ (në vjetin 1888) «... *me ndihmën e të gjith mëmëdhetarëvet*».

b) «Erveheja».

Erveheja e Çamit, nji novelë krejt morale 221 tubëzash katërshe, gjasëramjeje së ndërlikueme (rimë alternative), — âsht njij heri edhe mâ e para novelë e shkrueme në gjuhë shqipe. Në dorën e parë të punimit pati nji titull arabisht: *Revza,* qi në gjuhë shqipe do me thânë: *Lulishtë.* Mâ të vonëshmit, në përpunim të vepërzës e në smadhim të saj nji qindvjet mbrapa *Hajdar Gjinokastriti e Jan Vretua* e quejtën **Ervehé.** Asht ky êmni i kreshnikes së novelës, rreth së cilës vjen tue u shtjellue historija e pikllueshme e provët e njij grueje së salvueme me ngjarjet mâ të dhimbshmet e të prekëshmet me të cilat âsht mbushë plot nji pjesë e jetës së saj të vështirë. Ndera e saj aq e çmueshme, âsht në rrezik nepër stuhí e valë të jetës, të

cilavet u bân báll përherë e pá-thyeshme, tue i qindrue me nji kreshnikí të páshembull idhealit të BESËS e të NDERËS.

* * *

E vërtetë se ndër shkrimtarët mâ të vonëshëm të kombit t'onë, bje fjala ke Dora d' Istria, në studimin *Kombësija shqiptare mbas kangëvet popullore*, kthye në dialektin e italo-shqiptarëvet nga *Kamarda*, kjo nderë e njij bije së Çamërís kujtohet prej saj në nji veshje mâ letrare se ke Muhamet Çami e me nji thekësim të dukëshëm, ngjyrë e romantizmit të kohës. Landa e nderës së vajzavet të Çamërís, rimirret edhe nga Poeti i ynë kombtár Fishta, në kangën XVI të *Lahutës së Malcís* (vargjet 525-575). Shpesh herë ke vargjet e Ervehés së Çamit, në pjesën teknike apo në veshjen e jashtëme të thurjes së tyne, kah lexojmë, kemi rasën të vrejmë aty-këtu nji farë randimi fjalësh a vargjesh, tërhjekë ashtu zvarë në nji tetërrokësh, i cili prá, âsht edhe vargu mâ popullori i yni. Ndër mungesa të tija po marrim si pikë të parë këto, për t' i përcjellë ndër fletët e këtij shqyrtimi edhe mungesë të tjera t' Ervehés, bje fjala mënyrën e thjeshtësís së kalamajvet në shtjellimin e ngjarjevet të novelës. Auktori i Lahutës së Malcís me të njajtin varg tetërrokësh këndon jo Ervehén e Çamit, vajzën e pá cak e të pá atdhé, të bín e botës ; por nji vashë Çamërije. Me tê Kangëtari i epopés kombtare shtje në kryevepër të vet, bashkë me *Tringën e Bajraktarit*, elementin e grues e të bís shqiptare, fytyrën e saj idheale. Le të vlejë si shembull i shijimevet rythmike e i gjuhës së popullit, ndonji pjesë nga kjo kângë, qi pávdekson vajzën e Janinës, të këtij kryeqyteti të Çamërís, e cila zgjedhë mâ parë vdekjen me nderë, kapak florini — si thotë populli i ynë, — se sa të bâhet flija e lakmíve të Pashës së Tepelenës. Auktori i Lahutës këndon ket shoqe t' Ervehés ndër tubëzat :

«Varza ká e varza s' ká ;
Por si ká nji vajz' n' Janinë,
Kurkund shoqen s' i a ké pá
Kah bje-diell e serotinë.

Synin diell, ballin si hâna,
Ardhun shtatit, si selvija,
Eufrozinë e quejti nâna,
Augur t' mir' me e pas' Shqipnija».

Goja e Poetit t' onë nepër vallen e zânavet, mbas flijimit të kësaj bije shqiptare e cila:

«... mêrr e hidhet n'uj prej trapit,
edhe zhduket n' fund t' liqênit,»

pavdekson nderën e saj në këto katër vargje të mbrame:

«Doli fjala nepër dhé:
Njikso varzash ka n' Shqipní,
Qi për erz edhe për fé
T' rijt' e jetën i bâjn' flî».

Ká dishka tërhjekëse në ketë tragedí, e cila nepër flijim vjen tue i mbrue përherë e mâ tepër ndiesít e bukura shqiptare të ruejtjes së nderës a t' erzit, të këtij virtyti qi e ruen aq me kujdes Erveheja e Muhamet Çamit.

* * *

As Ervehés nuk i mungoi ndonji gjykim i letrarëvet. Ndër shqyrtues të huej shkrimtari *Lulori*, [1]) në shtyllat e së përkohëshmes politike e letrare «*La Nazione Albanese*» (me 30 të prillit 1904, nr. 8), ke pjesa *Letteratura Albanese*, tue vijue t' i bâjë shqyrtimin esthetik *Ervehés*, pranë njij përkthimi përmbledhës të novelës shqipe në gjuhën italishte, shkruen se *Erveheja* âsht e njij kuptimi artistik të zgjedhun edhe të prekëshëm. Lulori vijon t' a vêjë *Ervehén* deri diku në krahasim me nji nga novelat e Boccaccio-s, ke i cili kallxohen ngjarjet e Markezanës së përshpirtshme të Saluzzo-s. Lulori shton: *Sikur t' a kishte lexue Petrarka* Ervehén, *ndoshta njij heri do të kishte qá për mj.rimet qi e mbuluen, nji për nji sikur qau për rasën*

1) Luigi Lorecchio.

e Grizeldës edhe ndoshta do t' ishte gjetun t' a përkëthejë në gjuhën latine novelën a Muhamet Çamit, sikúr bâni me përkthimin latinisht të kësaj novele të Boccaccio-s.

Çami âsht e përkundërta e ndonjij vjershtori të jugut të Shqipnís qi jetoi në ket qindvjet e në qindvjetin XIX. Historija e fillimit të Letërsís s' onë, — së cilës i bâni nji vizatim sido Hahn-i e mbas tij P. E. Pavolini, — kjo histori rreshtue prej këtyne dý pendavet, ndalet t' analyzojë vjershat e ndonjij shkrimtari të këtij grupi në të cilin hŷn edhe Muhamet Çami. Shkrimtarët e mbípërmendun analyzojnë vjershat e *Nesim Beut (Përmetit)*, shkrue në frymë e mbas shijes së lindorëvet. Hahn-i, kah bjen shembuj prej *Nesim Beut*, u kërkon ndjesë lexuesvet për nji farë lirije qi po merr tue u paraqitë në veprën *Albanesische Studien* (Jena-Wien, 1858-54) edhe landë qi nuk âsht, sigurisht, e natyrës, e prirjevet dhe e karakterit shqiptár. Historija e zhvillimit letrar të jugut kujton, pranë Muhamet Çamit, ndonji epikurjan të kohës, të cilët janë pa dyshim randësije letrare jo aq të madhe, bje fjala *Hasan Kamberi*, *Zyko Kamberi* e *Sulejman Ramazani*. Këtyne u pëlqen të thurin vargje dithyrambike, pranë gotave të vênës e të rakís e ndër gostít e teprueme, ndër drekë e darkë lukuljane.

c) Mbrendija e novelës

Erveheja qe nji grue e pá shoqe. Bukurija e saj ishte «*posi hëna kur ep dritë*». Kishte «*mënt shumë*» dhe ishte «*një zonjë e lëvduarë*» në çdo fjalë e punë. Burrit të saj i ra puna të largohej. I lên në rojë shtëpín e gruen e vet të vëlláit i cili, i këshilluem prej «*të paudhit*» apo «*qoftëlargut*», si e thrret Çami me këta dy emna shpirtin e keq, e paditë të kunatën për të thyemt e kunorës së martesës. Dalin dishmitarë në rrênë. Si mbas ligjës së vendit grueja dënohet prej gjyqit si e pá-nderëshme të mbulohet me gurë. Në kalim andej pari nji bujár kalorës, e shpëton Ervehén e, si i ndëgjon nji nga nji të këqijat e saja sikúr i ngján, e çon në shtëpí të vet.

Këtu po vijojmë me nji pjesë të kallximit, si na e paraqet Vretua në botimin e parë të vjetit 1888:

. . . .

Në shtëpi të tij e shpuri
Me të shpejtë q' atë natë,
Gjithë plagëtë ja zuri,
Ju pakësuan' dhëmbjatë.

Dhe e shoqeja ja priti
Me njëqint lloje të mira,
E pastroi dhe e ndriti,
E bëri posi pasqira.

Mori shëndet u shërua
Ashtu, sindëkur [1]) që duhej ;
Përsëri u zbukurua,
Sa që dot me gojë s' thuhej.

Kaqë fort u zbukurua,
Më mirë se ç'qe më parë,
Sa bujari u çartua, [2])
Dashurija e muar zvarë. [3])

Një dit' i lutet, i thotë :
«Nukë vjen të martonemi, [4])
T' ëmbëlë të shkojmë motë,
Sa të rrojmë dhe të jemi».

Ajo përgjigjet' i thotë :
«S' kam bënë të ligë kurrë,
Ishte turp në gjithë botë,
Që të marr burrë mbi burrë.

Këtë turpë mos m' a duaj
Eja kujto Perëndinë.

---

1) *Sindëkur* — sikur ; 2) u prish mendësh, u çapërdis ; 3) *heq zvarë a po xvarë* — e muer rrshânë. Këtu : e kapi dashtënija ; 4) polygamija, zakon linduer, ka qenë e përhapun edhe ndër né. Me krijimin c Shtetit Shqiptár u ndalue me ligjë.

Këtë fjalë mos m' a thuaj,
Të kesh nder ndë njerëzinë.

Mua shpirtin m' a shpëtove
Prej atij togut me gurë, 1)
Për nd' atë jetë ndërtove
Të gjer' e të madhe urë.

Mua shpirtin m' a shpëtove
Dhe gëzove shpirtin tënt,
Nderinë tënt e lartove,
S' të bje t' a flaç atë kuvent.

Ngaha Zoti k' shtu t' a diç
S' t' a humbet atë të mirë,
Ti vetëhenë mos t' a priç
Me këtë fjalë të ndirë».

Bujari kur i ndigjoi
Një nga një gjith' ato fjalë,
Frikën e Zotit kujtoi,
Në gjyq të tij kur të dalë.

Ani 2) i thotë Ervehesë:
«Falm'u e lutm'u për djalë
Ti që paske kaqë besë,
Perëndija të m' a falë».

. . . .

(Tubëzat 61-72)

Ke shtëpija e bujarit ishte nji shërbtuer i cilí, përbuzë prej kësaj grueje së nderëshme, ahmerret në nji mënyrë të pá-

---

1) *tog, togu, togje gurësh* — grumbuj gurësh. 2) *Ani* — mandej, pastaj

shembull. Shërbtori mbytë djalin e bujarit tue e paditë Ervehén si mbytse. Me 'i mij përpjekje të vështira Erveheja mundet së mbrami t' a bindi zotnin për páfajsín e vet. Fjalët e çiltërta [1]) t' Ervehés u besuen prej atyne dy prindëvet fatzez, për ket shkak nuk u qau mâ zemra mbi tê. Vetëm e larguen Ervehén nga shtëpija tue i falë 400 florij.

Udhës tue shkue, mbí breg të detit, shef tue u mbledhë njerz. Ishin tue çuem nji njeri për t' a varë. Pyetë shkakun e këtij dënimi e i diftojnë se kishte pasë vjedhë n' arkën e mbretit 400 florij. Erveheja, pa u mendue gjatë, paguen 400 florijt tue e shpëtue ket njeri nga litari. Vjedhësi nget mbas saj t' a falënderojë. Si të mos kishte veprue kurrgjâ, i u përgjegj Erveheja: „Unë të hollat qi i pagova n' arkë të mbretit, nuk t'i uhajta ty, por Perendis". Ky njeri i marrun mendësh prej këtij veprimi e prej bukurís s' Ervehés, i u lut qi t' a pranonte të lidhi fat me tê. Mbassi Erveheja nuk i përgjegjet dishirit të tij, plot me zemrim ky shpirtëzí nget deri ke limani edhe i a shet Ervehén si robneshë njij kapidani anije. E përkrahun prej fuqís hyjnore edhe në ketë rasë Erveheja u qindron të gjitha cenimeve të nderës e të jetës në nji mënyrë kreshnike. Kapidan e anijetarë gjêjnë ndeshkimin e merituem. „Zoti i jetës" qi e merr në mprojtje Ervehén, çon nji tufâ të mnerëshëm. Mbytën të gjith, tue shpëtue si për mrekullí vetëm Erveheja. Veshun si shërbtuer kërkon të shkojë ke mbreti. Me nji herë i difton këtij të thyemt e anís „atje n' anët të detit". Mbreti e pret mâ së miri. Për mâ tepër e bân zot anije edhe ep urdhën qi të caktohet nji vend për tê, si mbas dishirit të këtij *njeriut të Perendís.*

„Si i mirë" *(tubzë 149)* jetoi mb' anë të qytetit në nji shtëpí të vogël. Mbreti tue u ndodhë në shtrat të vdekjes, thirri pranë vedit parësín e qytetit *(tubzë 153)* për të zgjedhun të njij trashigimtari. Kënaqet kúr merr vesht se të gjith njij goje e caktojnë *njeriun e mirë* të zâjë fronin ky njerí qi tash sa kohë kujdesohej aq fort për popull tue sherue të smunët. Si

---

1) e sincerta.

vdiq mbreti *(tubzë 156)* Erveheja i zûni vendin. Mbretnoi urtisht e vijoi të shëndoshi të smunët për hír të Perendís.

Porsa zbret në nji mëngjes në kopësht, po shef tue ardhë prej limanit disa njerz: i shoqi me të kunatin, bujari me shërbtorin edhe me *Barabën*, qi e shpëtoi prej litarit. *(Tubzë 160)* Erveheja i shëroi, mbassi i diftoi seicili prej tyne fajet e veta. Në ketë mënyrë, në pranín e të shoqit zbulohen vepruesit e vërtetë të fajevet, për të cilat Erveheja kishte qenë paditë (*Tubëzat 168-210)*. Si i u zbulue se kush ishte, u a fali të gjithëvet fajin, i lëshoi fronin burrit të vet *(tubëza 215)* edhe i la të jetojë pranë vedit të gjith këta shpifësa të penduem.

Trí tubëza karakteristike të novelës, para mbarimit, përshkruejnë gjendjen shpirtnore të të gjith atyne qi ndodheshin pranë këtij akti të mbramë të ngjarjes dramatike t' Ervehés:

Ndë sallë ata që qenë,
Këto punë kur i panë,
Të habitur gjithë mbe'në
Dhe lavdisnë Zo'n e thanë:

«Sa të çudiçimë punë
Që pam ne me sy këtunë!
Kështu e drejta mbretëron,
Lum ay njeri që duron!

Dh' e vërteta kur thuhetë,
Ndjenetë dhe çpagùhetë.
Lavdi paç, i Madhi Zot,
Madhje që dëftëve sot!»

(Tubëzat 219-221).

ç) Vrejtje e shenime

Në thurje të ngjarjes janë për t' u kujtuem disa shenime të vogla. Ngján shpesh herë qi mbas-ardhësit e njij vepre, tue dashtë me e përmirësue, — sikúr ka mujtë të veprojë Hajdar Efendiu e sidomos Jan Vretua, e kanë randue me të meta. Dijmë

nga pohimi i Vretos se ky *„e qeroi“* (*tubzë 224*) nga fjalët e hueja ketë novelë *„të shkrueme nga Muhamet Çami“* (*tubzë 224*) e „të mbarueme nga Hodo Kastra“, don të thotë kështu për Hajdar Gjinokastritin apo Hajdar Efendín (*tubzë e mbípërmendun*). Në historín e gjuhës këto *pastrime* fjalësh e shprehjesh, bâ nga mbas-ardhësit, nuk mund të kqyren kurrsesi me sy të mirë n' atë rasë kúr këto ndryshime të bâme të mos bihen pranë fjalës e frazës së përparëshme ndër shënime përbrî apo në fund të fletës. Në ketë rasë do t' a kishim ruejtun trajtën besnike e *të pá-qerueme* të të parit dokument letrár të Çamërís. Vetëm nji fletë të kësaj vepre Jan Vretua na e ruen në trajtën e përparëshme. Po atë fletë mund t' a lexojmë në nji pjesë të parathânëjes së Vretos, e cila — âsht lânë jashtë prej ribotimeve mâ të vonëshme t' Ervehés së Muhamet Çamit.

Në gjykimin e veprës janë për t' u bâm disa vrejtje: Ke Erveheja ngjarja vjen tue u shtjellue në nji mënyrë — nga nji herë tepër të gjatë. — Disa pjesë paraqitën në nji trajtë mjaft parake në thjeshtësín e kalamajvet t' asaj moshe s' etshme për pralla plot ndeshtrasha. Katërqind florîjt e tubzës 96 qi i u dhán Ervehés prej bujarit e me tê muer rrugat, ajo shumë vjen e pëlqen pikë për pikë me florijt e tubzës 103, të cilët i paguen për të dënuemin në litár, vjedhës i të hollave të mbretit. Në tufânin e detit të gjith, detarë me kapidanin e anís në krye, u mbytën, tue shpëtue Erveheja e *gjâja* e saj. Grueja i paraqitet mbretit të vendit me „petkat e njëj të miri“, d. m. th.; veshun si trim me „kësulë, tirq, gunë“, me „pafka të gurta të ngjeshura“ e me „leshra të hedhur sup më sup“. Dashtë e pá dashtë tubëzat 142-143, n' âsht se në natyrësí të vetën mund të mbahen të mjaftueshme duhet t' i tresin çdo gjurmë mbretit se ajo âsht grue! Afër njij mbarimi mjaft të çuditshëm, auktori i novelës shqipe na i paraqet ndër kambët e Ervehés, me të njajtat sëmundje të sŷvet: të shoqin e Ervehés, të kunatin, bujarin e miqt, tue mos e lânë jashtë as Barabën, të dënuemin për litar. N' ata të parë asnji prej tyne nuk e njofin Ervehén. Paraqitja e tyne n' at mënyrë na kujtojnë sa romana e vepra letrare të mesjetës, me të cilat âsht mbushun plot fillesa e historís së letërsís së disá kombeve t' Europës.

Për të mujtë me pasun ndonji njoftim sa mâ të plotë për historín e kësaj vepre së herëshme të Letërsís s' onë, po ribotojmë me orthografí të soçme pjesët mâ në shêj të parathânëjes së *Jan Athanas Vretos:* N' ato pjesë qi po i lâmë jashtë, Vretua humbë ndër shqyrtime e krahasime të kota të gjuhës, sëmundje e sá shkrimtarëvet shqiptarë të kohës, të cilët pa pregatitjen e duhun të shkencës filologjike, kqyrshin me u marrë me gjuhësí:

«*Ku dhe kur u lint Muhamet Çami edhe kur vdiq, s' goditi të piqim Çam që t' a dijë. Nga sa pyetëm së largu, kaqë mësuam, se qe nga Konispoli edhe rrontej ndë brest të parë t' ënit. (Kështu shkruente në vj. 1888). Këtë vjershën e tij për të vuarat t' Ervehesë na e tha* **Resul** *Efendiu* **Gjirokastriti** *shkruarë me shkronjëza arabishte prej* **Hajdar** *Efendiut nga Gjirokastra, i cili është vjershëtor* (1888) *dhe rron plak i shkuarë, dhe na e këndoi* Avni efendiu *gjith' andej nga Gjirokastra e e ngritëm me këto shkronjëza, që janë të plota edhe shkruhetë me to gjuha* (e) *jonë Shqipja fare mirë e i dëftenenë gjithë tiparet' e fytyrat' e ngjyrat' e saj sikundër duhetë.*

«*...Gjendetë, na thanë, dhe* (*dorëshkrimi, kopja*) *e Muhametit ndë Çamëri, po s' ndodhi të gjenim ndonjë që t' a kish, e ta ngrijëm dhe até të shihim sa dhe ku ndërron.*

«*Kjo vjersh' e Muhametit, që muarmë, shkruarë prej Hajdar efendiut, t' ëndurit e ka, si na e gjykon mëndja neve, fort të bukurë: pa ndërti të përsipërme, që prish bukurin' e naturësë, as një, edhe pa barrë të tepërë, që bje rëndësi e mërzitje, aspak; tregim' i një puneje çon deshirë t' ëmbël të tregimit* (*të*) *tjatrësë pas që nga krej e gjer ndë funt tfaqenë njëra pas tjatrësë pa-pandehuraj pa ngatërrim dhe bëhënë një vark i drejtë edhe dëftënënë si ç' munt t' i gjanjenë njeriut, nukë (vete) gjër ndë të mos besuarë...*

«...Besa, nderi, mirësija e Ervehesë dëftenenë të patundura ndë gjithë të vuarat e saj gjer ndë vdekje pa përdukje, *edhe kur ju çperblenë pe* (— prej) *kudesësë të* (të) *pa-pamit e të panxënit në mëndjet të njeriut e të pa-treguarit dot Zotit* (të) *jetësë, e ja pru hera të mundetë të këthenje atyre, prej të cilëvet*

voj (— vuajti). *Edhe të shoqt (t') Ervehesë besa më njëriatrinë e nderi e mirësija gjith' ashtu dëftenënë, dhe mbë së fundi kurorenë pe kujdesës të* (të) *Madhit Zot me gjithë të mirat e bënënë të lumurë. Kështu pra* përrall' e Ervehesë nukë tregonetë si përrall' e pabesuarë për të shkuarë kohënë, po epetë pasqyrë bese e nderi e mirësije e ëmbëlë...

«*Të metë të madhe vjersh' e Ervehesë, si ç' e ka shkruarë Hajdar efendiu, ka këtë që ishte mbyturë ndë fjalë të huaj*(a) *arabisht e persisht edhe pak elenisht e turqisht, si ç' dukenë, për dëftim, ndë dymbë-dhjetë radhë që e pru fjala të shkruajmë më poshtë edhe të shumatë pa fare ndonjë shtrëngim, se të shqipja ndë atë dëftesë janë, edhe disa ndiku thuhenë tej e këtej ndë atë shkronjë përsëri...*

«...*Vjershesë (s') Ervehesë të metën e të mbyturit ndë fjalë të huaj(a), deshëm t' i a ngremë; edhe kështu ja qëruam fjalët' e huaja ndë shum vise* (don të thotë: pjesë apo vende) *erdhëm ndë shtrëngim t' e mbrujmë së rithi,* (— rishtas) *edhe kështu ndë fjalë ndërron, po ndë punët tërazi s' ndërron aspak. Ndërron edhe ndë funt, se Hajdar efendiu e mbaron dyke kërkuarë ndjesë prej atyre që të këndonjenë e dyke uruarë ata me këto radhë :*

«Vështroni një herë hiqmet 1),
Punërat' e Perëndisë
Haku 2) njerinë s' e humbet,
Turku preps 3) t' a inandisë 4).

Hiqajeja 5) u mbarua,
Që kish gjithë këto derte 6),
Muhameti u kujtua,
Shqip i bëri këto bejte 7)

---

1) *Hiqmet-i*, arab. E mirë pa-pandehuraj *(Vreto)*. Shqipja e qindvj. XVIII e sidomos e qindvj. XIX âsht fort e trazueme me fjalët turqishte e arabishte. Edhe nji hymën i kësaj kohe, gati populluer, kushtue shën Nkollit, i kënduen ndër kishët e Shkodrës, fillonte me vargun: «*Sa hyqmete e mrekullí* e tj.» 2) *Hak-u*, arab. I drejti, Zoti, Perendija *(Vreto)*; 3) *Preps* greq. *prépei* — ka hije (Vr.); 4) *inandisë*, tyrq. *inamorem* (besonj), *inandê* (besonj), prej së cilës bënëtë *inaudis* (Vr.); 5) *hiqajet*-i, arab. — tregim, përrallë (Vr.) 6) *dert*-i, turq. Plënk ndë zëmërë, pësim (Vr.); 7) *bejtë*-i, arab. vjershë, a (Vr.).

«Hiqajeja e zemanesë 8)
Kundrë që u duk merami 9)
Ki 10) bejti i Ervehesë
Bina 11) nga **Muhamet Çami.**

«Nga dora nishan 12) na mbeti
Kundrë náj mori fiqiri ; 13)
Tri hise 14) krej Muhameti,
Një hise **Hajdar Fakiri.** 15)

«Çdo mumim 16) që t' i këndojë,
Të na japënë rahmetë ; 17)
Haku mos t' a turpërojë,
Qoftë rahat 18) në dí jetë.

«Që n' ezel 19) të vdekurinë,
Një milion vjet të këtë,
Bejti ja ngjall umërinë 20)
Dhe i këndojmë rahmetë.

«Mesajih e dërvishanë, 21)
Që Mexhlis'n 22) e zbukurojnë,
Në teqera në mejdanë 23)
Bejte gazele 24) këndojnë.

. . . .

---

8) *Zemane* a po *zeman*, arab.: kohë, mot *(Vreto)*; 9) *meram*, arab.: *qellim (Vr.)*; 10) ky ; 11) *bind*, arab. *ndërtim*, (Vreto) — këtu : hartue ; 12) *nishan*, tyrq. *shinim* (Vr.) ; 13) *fiqir*, arab.: *mendim, mendje* (Vr.) ; 14) *hise*, arab. *copë, pjesë* (Vr.) ; 15) *fakir*, arab. *i varfër, i vobektë, i gjorë, i ngratë*, (Vr.). 16) *mumim*, arab. *drejtëbesonjës, besëdrejtë*, por ata që këndonjënë vetëmë ndë vivlla të besësë, për besë-drejtë kanë vetëm' ata që janë ndë besët të tyre. (Vreto). 17) *Rahmet*, arab. *ndjesë, t' ardhur keq* (Vr.); 18) *rehat, rahat*, arab. *rehje* (Vr.) ; 19) *ezel*, arab.: *krye e pa-anë e motit*, e jetësë, krye e pakrejmë Vr.); 20) *ymerë* (pas Gjirckastritvet, që nukë thonë dot *y* — *umerë)* arab. *rrojtje, jetë ;* 21) *dervish*, persisht: *i rënë në derë, i mjerë, i ngratë, i gjorë, litpës, uronjës, prift* (Vreto) ; 22) *mexh (i) lis*, arab. *mbledhje* (Vr.) 23) *mejdan*, yrq. *shesh ;* 24) *gazele*,,. një lloj kënge (Vr.) ;

Pesë tubëzat e mbrame (222-226), qi janë sikúr mbas-thâ-nëje e veprës, mbasi përsërisin shka âsht thânë parandej, mbarojnë me këto dý tubëza *urimi* e kërkimi ndjese :

At' i dashurë **Mehmeti** [25])
Q' e shkroi shqip të parë herë,
Dhe doret shënim na mbeti,
Qoft' i ndritur e i ndjerë !

Vëllaj **Hodua**, q' e mbaroi,
Pastë pleqërit të mirë !
Lutet' **Vretua** q' e qëroi,
Dhe kërkon pe syresh hirë.

FILIP FISHTA

---

2. — NEZIM BERATI (1754)

a) Jetëshkrimi

Nesim beu, ase si e quajnë përgjithërisht, *Nezimi*, ishte i biri i Ibrahim bej Beratit dhe kish lindur aty nga fundi i shekullit XVII në fshatin Frakull e jo në Përmet siç është besuar gjër më sot. Datën e vërtetë të lindjes së tij nuk e dijmë, por duke marrë parasysh se i ati i kish vdekur më 1672, lipset që data e lindjes së Nezimit të caktohet përpara këtij viti. Prej vitit 1682 gjer më 1697 Nezimi qe nxënës i njërës nga të dyja *medresetë* që kishte atëherë Berati. Që në djalëri nisi të shkruajë vjersha në gjuhën shqipe dhe në gjuhët lindore, pse në këto gjuhë ka qënë shum i mësuar. Madje si vjershëtar Nezimi pati edhe një *„rival"* tjatër në Berat, duam të thomi myftinë e qytetit, *Mulla Alinë*. Ky rivalitet nxehu aq tepër popullin sa e ndau në dy parti, njëra në favor të Nezimit, tjatra të

---

25) *Mehmet Çami*, i përmendun në tubzën 222. Këtu Vretua shkruen se... Çami *e kujtoi* prrallën e Ervehesë, tue i shkrue ai vetë trí pjesë e nji pjesë Hodo (= Hajdar) Kastriti (= Gjirokastriti).

myftiut. Më së fundi fiton Nezimi, po grindja i bie në vesh Sheh Islamit, i cili, i zëmruar nga turbullimet e qytetit, e pushon nga puna myftin «bejtexhi».

Ndonjë lajm tjatër për jetën e Nezimit nuk dijmë hë-për-hë. Dijmë vetëm se miqësi të ngushtë pati ky me një nga pashallarët e Elbasanit, me Sulejman Pashën, në shtëpi të te cilit qëndronte herë pas here, kështu shpjegohet perhapja e shumtë e „bejteve" të tija ndër myslimanët e këtij qyteti dhe të atyre të Shqipërisë së mesme, „bejte" të cilat në gojën e Elbasanasve muarën trajtat e këtij dialekti, ashtu siç i shohim dhe te libri i Hahn-it. Dijmë edhe se popullarësija e poetit i tërhoqi vërejtjen Ismail Pashë Vlorës, sundimtarit të Vlorës, të Beratit e t' Ohrit, i cili i a raportoi Sulltanit si të dyshimtë për idetë e tija politike. Kështu Nezimi u internua në Stamboll dhe u burgos. Vdiq në burg më 1754. Varri i tij gjëndet edhe sot në Stamboll, si dhe guri i varrit me një mbishkrim.

b) Vjershat e Nezimit

„Bejtet" që përbëjnë «**Divanin e Nezimit**» nuk u botuan kurr, po ruhen edhe sot në dorëshkrime të ndryshme. Vetëm Hahn-i botoi për herën e parë në vëllimin e dytë të veprës së tij nj' a tetë prej këtyre bejteve. Po Nezimi si poet njihet edhe prej albanologëve të tjerë.

„*Këngët e Nezim beut* — shkruan Camarda — *i përkasin më tepër poezisë eruditike a letrare se sa poezisë popullore, po kësaj i afrohen si për thjeshtësinë e mendimit e të frazës si për shkurtësinë e hartimeve*". Eshtë mirë të shtohet edhe se si pas thënjeve të Hahn-it „*Nesim Beu ka qënë më i famëshmi poet modern i gegëve myslimanë të qëndrës, ndër të cilët vazhdimisht përsëriten gojarisht këngët e tija. Sikur mos të ishin shëmtuar aq shum këto këngë me fjalët e huaja arabisht, persisht e turqisht, Nezimi munt të mbahej në një farë mënyre si Anakreonti i Shqipërisë*".

Edhe Gustav Meyer-i na kujton se „*një mbledhje e gjërë e poezivet të Nezimit shkruar me gërma turqishte thuhet se*

gjendet në duarët e një beu nga Elbasani. Ato të bo'uara prej Hahn-it janë shkruar me shpirtin erotik dhe janë shum larg shijeve t' ona artistike. Shpirtit të bejteve të Nezimit që na kujton Turqinë e Persinë i shoqërohet edhe trajta gjuhësore, pse fjalët shqipe janë përzjerë me një sasi aq të madhe fjalësh turqisht, persisht e arabisht sa që vetëm kush njeh gjuhët orientale munt t' i kuptojë këto vjersha".

Nga pikëpamja thjeshtësisht estetike këto bejte nuk kanë as më të voglën vlerë. Sido qoftë, auktori i tyre duket të ketë qënë një „improvizator" i aftë, ashtu siç janë me qindra këngëtorët t' anë anonimë, pse dëften një lehtësi të madhe në ndërtimin e vargjevet e të strofavet.

Nga pikëpamja gjuhësore prap nuk kanë ndonjë vlerë : vetëm dy a tri janë trajtat që na tërheqin vrejtjen, po edhe këto nuk janë të sigurta, pse këngët e Nezimit, siç thamë, nuk njihen në origjinalin e tyre. Kështu pra vlera e vërtetë jo vetëm e Nezimit po e të gjithë këtyreve shkrimtarëve myslimanë është më tepër historike.

---

2. — SHKRIMTARË TË DORËS SË DYTË

Përveç katër shkrimtarëvet : *Muhamet Çami*, *Nezimi*, *Sulejman Ramazani* dhe *Hasan Zyko Kamberi*, që u përmëndën në periudhën e parë të **Njoftimevet të Përgjithëshme** të kësaj kaptine, janë për t' u përmëndur edhe :

a) Dy libra fetare në vjershë, që këndohen prej bektashinjvet dhe që janë të shkruara prej *Dalip* dhe *Shahin Bej Frasherit* ; e para libër ka emrin *Hadika* dhe e dyta titullohet *Muhtarname*. *Hadikaja* është një përkthim nga libra e Fuzulliut dhe thuhet se është shqipëruar me shkronja turqishte, dhe fjalët turqishte, persishte dhe arabishte janë mjerisht më të shumtat se shqipet [1]).

---

1) Marrë nga e përkohëshmja «Diturija» viti i II. Nr. 8, Qershor 1927, faqe 295.

b) Një *Hadika* tjetër në vjershë, prej Haxhi Çiçkos nga Korça, dorëshkrim, që thuhet se gjëndet sot në Teqenë e Melçanit, shkruar nj' a 60 e ca vjet më parë.

c) Veprëzat e Hafëz Ali Ylqinit, vdekur në vitin 1913: *Hoda rabbin terxhymesi* (shqip me shkronja turqishte), e lithografuarë pa vënd shtypi, por duket se është shtypur në Stamboll në vitin 1880 ; një *Abetare shqip* (me shkronja arabisht) ; *fjalori shqip-tyrqisht* 133 faqesh me 5500 fjalë ; *fjalori tyrqisht-shqip* 435 faqesh me 18.000 fjalë.

ç) *Manzumet-yl-mevlud, fi efdalil mevxhud, bilisanil arnaud,* (shqip me shkronja turqishte), lithografuar në Stamboll me lejen Nr. 109 të Ministrisë s' Arsimit. Vjershëtori shqiptar është „Muhamet Tahir bin Halil nga Kosova, Vëlçetrin Kasaba, katund Popovë“.

KAPTINA V.

Prodhimi letrar përpara Lidhjes së Prizrendit

NJOFTIME TË PËRGJITHËSHME

Me prodhimin letrar mysliman mbyllet periudha, a grupi, a pjesa e parë e letërsís shqipe. Si munt t' a ketë kuptuar lehtë lëçitësi, nga sa parashtruam më lart del si përfundim se këto fenomene kulturore që përbëjnë këtë grup nuk patnë atë përhapje të duhur, atë përhapje të përgjithëshme në vëndin t' onë Qenë pra dhe mbetnë lëvizje thjeshtësisht krahinore e jo shqipëtare *me kuptimin politik dhe gjeografik që i japim sot kësaj fjale.*

As shkrimtarët e veriut, as shkrimtarët e jugut, as edhe shkrimtarët myslimanë nuk qenë ata që u përpoqnë dhe patnë ndër mënt t' i japin atdheut të vet një letërsí dhe një alfabet të përgjithëshëm, një alfabet shqip *me vlerën më të kulluar të kësaj fjale, i cili të përdorej si prej toskëve ashtu edhe prej gegëve, pa dallim krahine.*

Të parët që u kujtuan për një punë të tillë qenë: elbasanasi **Theodhor Haxhi Filipi** *dhe vithkuqari* **Naum Veqilharxhi.** *Këtyre jo vetëm që u përket merita të kenë bërë përpjekjet e para për krijimin e një alfabeti të përgjithëshëm dhe të përbashkët shqip, por edhe merita tjatër: të jenë të parët këta, që u hapin udhën Shqipëtarëve të tjerë për përpjekje të tilla. Rëndësija e tyre prandaj është shum më e madhe nga ç' e kanë shkrimet e thata e të vobegta që na kanë lërë. Për këtë arësye këta dy etër të vjetër të shqipëtarizmës e të bashkimit kombtar do të zënë kryet e letërsís s' onë të re dhe*

do të jenë para-ardhësit e asaj periudhe a grupi të dytë që nis të lëvizë e të rritet e të madhohet me hov të turrshëm e të shkëlqyer që nga Shoqërija e Stambollit, *po që rrënjët i ka më lart: në* Lidhjen e Prizrendit.

N. RESSULI

---

1. — THEODHOR HAXHI FILIPI (shek. XVIII.)

a) Jetëshkrimi

Theodhori i Haxhi Filipit, ase siç e quanin Elbasanasit «*Dhaskal Todhri*», ishte nga një derë e mirë elbasanase dhe me shum të ngjarë lindi në këtë qytet aty nga «e katërta dhjetvjetë» e shekullit XVIII. Që në vogëlí i ati e dërgoi për të studjuar në shkollën e famëshme të Voskopojës. Si kreu mësimet, u këthye në Elbasan dhe u emërua «dhaskal» i shkollës greke t' atij qyteti. Qe edhe predikator i kishës orthodhokse dhe epitrop i manastirit të Shën Gjonit. Ndoshta për të plotësuar dëshirën e vendasvet që donin t' a dëgjonin Meshën në gjuhën shqipe, përkëtheu nga greqishtja shum libra liturgjike. Nga sa na thotë Hahn-i, i cili qe i pari që u interesua për 'të, Theodhori nuk kishte shqipëruar vetëm *Dhjatën e Re*, po edhe atë të vjetrën. Mjerisht të gjitha këto dorëshkrime u zhduknë prej familjes së tij, e cila e trëmbur nga kolera që ra aso kohe në Elbasan, i dogji.

Pas vitit 1801, në moshë të shkuar, Theodhori shkoi në Europë dhe atje me ndihmën e tregëtarëvet Voskopojarë të merguar treti dhe bëri gati shkronjat e alfabetit të çpikur me qëllim që të shtypte dorëshkrimet e veta. Kur po këthehej në Voskopojë, në shtypëshkronjën e së cilës do të botonte veprat, qeraxhinjt vllehë frashallinj u vunë re barrëve që ishin të rënda dhe duke i pandehur plot me të holla e vranë të mjerin dhaskal natën në gjumë e sipër në mal të Dhiavatit përmi Resnen.

Si datë të vdekjes i është caktuar viti 1802 a 1803, pse në kishën metropolite t' Elbasanit gjënden disa akte të shkruara e të nënëshkruara nga dora e Theodhorit duke filluar që nga viti 1768, po këto nënëshkrime nuk i gjejmë më pas vitit 1801.

Me vdekjen e Todhrit edhe vepra e tij mbeti e pakryer. Të vetëmet shkrime që na kanë mbetur janë: një përkthim i plotë i «*Liturgjisë së Shin Gjon Gojartit*» botuar pjesërisht në revistën «Kopështi letrar» (1918) nga z. Lef Nosi; ca përkëthime të tjera fetare të trazuara edhe me përkthime të bëra prej priftërinjësh të padijtur; dy fragmente njëri prej të cilëve është një përkëthim i një cope t' ungjillit si pas Shën Janit dhe tjatri një copë nga i „Horologiumit" të botuara që të dyja nga Hahn-i në veprën e tij, i cili i nxori nga dy radhonj, njëri me shtatë dhe tjatri me dymbëdhjetë fletë, që mundi të shtjerë në dorë kur qe në Elbasan më 1850; si edhe disa fletë të shkëputura fshehurazi nga disa dorëshkrime të manastirit të Sh. Gjonit prej Dr. Pekmezit.

b) Alfabeti i Theodhorit

Në kundërshtim me mësonjësit voskopojarë t' Akademisë së re, Todhri nuk deshi të përdorte për shqipen alfabetin grek, po çpiku për 'të ai vetë një alfabet krejt të posaçëm dhe këtu qëndron gjithë rëndësija e punës a më mirë qëllimi i mjeshtërit elbasanas. Ky alfabet përbëhej prej 57 shkronjash dhe është padyshim më i përsosuri e më i ploti i alfabeteve, të vjetër e të rinj, për të shënuar në shkrim secilin tingull të gjuhës shqipe. Siç na dëshmon Hahn-i, alfabeti në fjalë pati një farë përhapjeje jo vetëm n' Elbasan po edhe, nga sa duket, në Berat e në Voskopojë, i përdorur nga tregtarë, me të cilin mbanin llogaritë e veta, dhe për letërkëmbim nga sa familje.

Doktor Hahn-i e pandehu shum të vjetër këtë alfabet aqë sa nuk vonoi t' a quante «*pellasgjik*». Po më 1901, Dr. Pekmezi u dërgua prej Akademisë së Vjenës n' Elbasan për studime dialektologjike dhe me një porosi të veçantë për studimin e shkrimit të vjetër të këtij qyteti. Pas hetimeve të tija dhe të profesorëve të tij, rezultoi se alfabeti nuk është aqë i lashtë sa pandehej, po i çpikur vonë prej një njeriu me dituri të thellë. Kështu, z. Pekmezi, duke i rrëzuarë të tëra theoritë e përparëshme përfundon duke thënë se, „*alfabeti i vjetrë i Elbasanit*

është alfabeti greqisht kursiv të shekullit XVIII, i stilizuar individualisht".

Përveç fragmenteve shqipe që na ka lënë Todhri, në një vepër greke të manastirit të Shën Gjonit, gjejmë edhe një hymn të gjatë, hartuar greqisht, me të cilin mjeshtri nderon shënjtorin.

Siç e shënuam edhe më lart, shkrimet që na ka lënë Todhri, mbassi janë shum të pakta e mbassi nuk u shtypnë kurr në kohën e tyre, sot nuk kanë as vlerë letrare as vlerë gjuhësore. Por ajo që e nderon auktorin e këtyre shkrimeve dhe që e vë në krye të letërsís s' onë të re është *qëllimi* me të cilin u shkruanë „qëllimi që e shtyti „dhaskalin" elbasanas të veprojë".

Dëshira e Todhrit, duke përkthyer vepra kishtare në gjuhën t' onë ishte sigurisht e dyfishtë: a) të trajtonte një gjuhë letrare të përbashkët; b) t' i vinte një garth të fortë propagandës greke. Ndothta do t' i ketë shkuar nëpër mënt edhe mendimi í një kishe orthodhokse kombëtare, që të përdorte gjuhën shqipe në liturgjinë e saj.

c) Nga përkthimet e Theodhor Haxhi Filipit

1. Këto fola juve, qi të mos skandalísi. [1]

2. do t' ju banjnë syrgjyn [2] juve, po do vi koho, qi kushdó qi t' ju vrasi juve, do t' i duket' si kur i banj kurban [3] perëndisë.

3. e këto do ju banjnë juve, se nuk më njófën as mu, as babanë.

4. po këto fola juve, qi kur të vinjë kohoja t' i kujtoni ató, qi ju thashë unë këto, nuk ju a thashë përpara, se ishje me mu.

5. ma [4]) nashti po shkoj ke ai, qi më dërgói, e njeri nuk më pyet, ku shkon;

---

1) *skandalisi:* shkandulloheni, të mendoni keq.
2) *syrgjyn, do t' ju banjnë s.:* do të ju mërgojnë.
3) *kurban:* fj. turqisht: *flí.*
4) *ma:* por.

6. po pse ju thashë këto fjalë juve, u helmutë fortë.

7. po unë të dreitën them juve, qi ju bahet' mirë juve, qi të shkoj unë, se në mos shkofsha unë, hiri nuk vjenë më ju, ma në rofsh, do t' e çoj' hirin më ju.

8. pra si të vii ai hiir, do shajë dynjanë për gjynaftë, 5) ne për dreitënitë, ne për gjyqet.

9. e për gjynaftë, pse nuk mbesojnë më mua.

10. për dreitënitë, se ke 6) babai do shkoj, nde nuk më shifshni ma,

11. e për gjyqet, se arhondi 7) kësaji dynjáje ushaa.

12. kam ne shum' për t' ju thánë juve, po nuk mundi mbani mendë nashtí.

13. po kur të vinjë ai shpirti drejtënisë, do ju thek më çdo vërtetní e nuk ka me folë prej vetiu, po sa të ndëgjojë do flasë nde do rëfejë të për t' ardhmit' juve.

14. ai mu do laftojë, se prej meje do dalë, nde do kallëzoj juve.

15. gjith' qysh ka babái të miat' janë, prandaj thashë, që prej meje do dalë e t' ju kallëzojë juve.

16. ne pak herë 8) pra nuk më shifni, përsi 9) ne pak herë pra do më shifni, se do shkoj ke babai.

17. pra thanë çirakëtë shoq me shoq çasht 10) këjo qi na thotë, ne njiçik 11) pra nuk më shifni, pra ne njiçik do më shifni; nde se do shkoj ke babai.

18. pra thoshin ça (shtë) këjo çikë që na thotë; nuk e dimë se qysh na thotë kështu.

19. u kujtua Krishti se do t' e pysin e ju tha vetë, po pytni pse thashë, qi ne njiçik pra nuk më shifni, përsi ne njiçik pra do më shifni.

---

5) *gjynaf:* fj. turqisht, *mëkat*, *faj.*

6) *ke:* te

7) *arhondi:* zotnija, zoti.

8) *ne pak herë:* edhe pak kohë.

9) *përsi:* përsërí, prap.

10) *çasht:* shka âsht, ç' âsht.

11) *njiçik:* pak.

20. vërté, vërté themi juve, se do qani e do vaji [12]) ju, ma dynjaja do gëzojë, e ju do helmohi, po helmi jujë do kthehet' më gëzim.

21. gruja kur lindi idhënohet' se i erthë sahati sajë, ma si lindi fëminë, nuk e kujton ma të feshtirët, prej gëzimit se leu njerí më dynjatë.

22. ashtu ne ju, nashti idhëní keni, po persí dukem, ndër ju e do ju gëzohet' zembra jujë, qi atë gëzim sont [13]) ju a marri njerí.

23. pra m' at' herë mu mos më pytni për gjanj, vërté, vërté themi juve, qi sa t'i kërkoni babait me emënit tim ju a ep juve.

---

2. — NAUM VEQILHARXHI (1845)

a) Jetëshkrimi e vepra

Mjerisht një jetëshkrim të plotë të këtij shkrimtari e patrioti të vjetër nuk e kemi èdhe. Dijmë vetëm se lindi në fshatin Bredhas të Vithkuqit aty nga fillimi i shekullit XIX, a nga fundi i pjesës së prasëme të shekullit XVIII. Dijmë edhe se jetoi pothua gjithënjë përjashta atdheut, në vise të ndryshëme të Europës si në Bukuresht e në Stamboll, ku qe për ca kohë si nëpunës (veqil-harxh) i Patrikanës. Madje në Stamboll Naumi ndërroi jetë dhe thuhet se u helmua me urdhër të Patrikanës për propagandën shqipëtare që zhvillonte.

Si dihet, Naumi nuk përmëndet si shkrimtar në historinë e letërsis s'onë, se i tillë me të vërtetë nuk qe; po zë një vënd të ndriçëm në këtë për ndjenjat patriotike si edhe për përpjekjen më të parë që bëri t'i japë gjuhës shqipe një alfabet origjinal.

Vepra e tij ka këtë titull: *„Fare i ri — abetor shqip — për — djelm nismëtorë — nxjerë e vënë ndë dritë tani herën — e parë — për djem të vegjël — me një të zgjedhur nga disa*

---

12) *do vaji :* do të vajtoni.
13) *sont ju a marri :* nuk Ǝund të.....

gjë të mirash — e të fitimshme prei — Naum P. Veqilharxhit — Bredhasi — nga Bythkuqi i Kolonjës — Mot' i dytë 1845".

Lënda që përmban është fare e thjeshtë, e mbledhur nërgut për djemët e vegjël dhe për të gjithë ata që donin të mësonin gjuhën e tyre kombtare.

Përveç këtij abetari vlen të përmëndet edhe një letër që Naumi i dërgoi një nipit të tij në Vjenë, në të cilën na dëshmon faqeza ndjenjat e larta patriotike të këtij Kolonjari të moçëm. Abeceja e Naumit është e përbërë prej 32 gërmash, po nuk është e plotë si ajo e Todhrit, se për tingujt *s*, *r*, x, e *zh*, nuk ka shënja të veçanta.

Fatkeqësisht as alfabeti i Elbasanasit as edhe ai Vithkuqarit nuk patnë një përhapje të përgjithëshme në vëndin t'onë. Mbetnë për tërë jetën „përpjekje sporadike", që dalë nga dalë ranë në harresë. Këjo punë rrodhi jo vetëm pse gjëndja e jonë politike e vajtuarshëme kur lintnë abecetë nuk e lejonte, po edhe nga shkaku i vështirësivet që paraqiste botimi i një libri me gërma të tilla. Kështu që munt të thomi se vetëm me shoqërinë e Stambollit fillon me plot kuptimin e fjalës të shkruhet shqipja jo vetëm me një farë dëndësije e vazhdimsije, po edhe të hyjë zyrtarisht në radhën e gjuhëvet letrare.

Vërtetë, përpjekjet e Todhrit e të Veqilharxhit nuk patnë përhapje të madhe, po qenë ato që hodhën hapat e para. Që nga ajo kohë krahasi botimeve fetare të veriut nisin edhe botimet „profane", të botuara shpesh herë me qëllim të dyfishtë: „të caktonin në shkrim gjuhën shqipe dhe të përhapnin ndjenjën kombtare".

N. RESSULI

b) Shembull nga Abetori *)

1) Barka e Noes

...Mbi malet e më të lartëra. Ashtu gjithë gjëtë e gjalla vdiqnë e ngordhë, e gjë tjetër smbet vexh Noes e fëmijës ti edhe xhkish mbrënda ndë koritë marë, që atë mbë kohë mbushnë tyke shtuar.

2) Pyrgu i Vavillonit

Me kohë djemt' e Noes u stuan aqe sa nuku mundnin të ronin mbë një vënt. Atyre ju hyri mbë mëndje që të bëjnë një gjë, që edhe gjer sot njihet e duket — marësira e tyre fare e pamenxhme. Zunë të ndërtojnë një murnimë (kala) që të lënë emërat e tyre të pa haruara, edhe të bëjnë një gerbje (1) aqe të lartër, që të mundnjën të shpëtojnë nga mbytmja, ndë u ngjaftë ndo një herë tjetër, edhe...

1) : ketë kuvënt Gërbje që do të thotë, pirg edhe kullë si e themi sot, e kam gjetur mbë një vënt të shkruar pa andaj evura që të ikënj nga ethëna Pirg e kullë që janë që të dya kuvise të huaja. Po jy o djelm, miri atë që të njihëni për më të mirë.

---

3. — KOSTANDIN KRISTOFORIDHI (1868)

a) Jetëshkrimi

Kostandin Kristoforidhi ka lemë n' Elbasan mbë 1830, e disá të tjerë thonë në 1827, e âsht nga lagja e Kalás. Përmbiemnin e vërtetë të derës, Kostandini e ka *Nelko*, e s' e di njeri mirë, si ka qenë puna qi e ka lânë e ka marrë përmbiemnin *Kristoforidh*. I ati quhesh Anastas Nelko dhe e ama, Vasilija Josif, e ishin të dy prej dyersh të para.

---

*) Nga faqja 33 e *Abetorit*. Nxjerrë nga «*Bibliographie Albanaise*» prej Emile Legrand (1912), faqe 80.

Kostandini, vëllai i dy motravet, u-rrit e u-zburrit me kujdes të math, nga do qi ta ngasish punën. Mbassi mbaroi n'Elbasan shkollën Fillore, u-nis e shkoi në Janinë e hyni në Gjymnasin grek të Zozimejvet, qi ishte me emën atëherë ndër shkolla të mesme greke. Këtu qe urdhën së nalti, duket, të njifet mirë me Albanologun Dr. Hahnin, konsullin e Austrís në Janinë, e i bâni këtij, zbashku me nji farë Apostoli nga Permeti, mësime në shqipet, toskënisht e gegënisht.

Mbë 1851 ka mbaruem Gjymnasin e nuk dihet se si u-nis e shkoi në Maltë. Këtu, nji konsull angles, qi i kishte ranë rruga nji herë për Elbasan e ishte njoftun me të jatin e Kostandinit, i ka ndifun shum të mësojë edhe 2 vjetë në një Seminar Protestanësh, italisht si thonë. Me të mbaruem këtu, âsht këthyem n' Elbasan, qi të përçmallet me prindët, pas kaqë vjetësh, e mbë 1853 ka hymë mësues në shkollën greqishte të Tiranës. Këtij viti i vdiq i ati përpara e pastaj e ama. Këto vdekje të serueme (të shkreta), njana pas t' jetrës, e vranë Kostandinin fare, se ngeli pa bir njeriu në shtëpí, e kështu, i u-ngrit mâ këtu n' Elbasan. Prandaj, me lejen e së motravet, qi ishin dhânë, me kohë, nëpër dyer të mëdha, n' Elbasan e në Berat, shiti ç' pati e ku pati e bâni mend të hyjë në nji shkollë mâ të naltë e të zgjanojë mirë e mirë rredhin e ditunís.

Kështu, mbë 1854, kur kishte plasun lufta e Krimés, me zemrë nëpër kambë, largohet nga Elbasani e merr rrugën e Durrësit, për të shkuem nji herë në Patré të Greqís, ku gjindesh ai konsulli angles, qi e kishte mik shtëpije, si thamë. Me të sosun në Durrës, u-poq, për fat, me nunin e vet, Mimë Xhufkën, i cili merresh këtu me tregëtí të madhe. Nuni, bâni si bâni, ia mbushi mendjen e nuk e la të largohet nga Durrësi; po, me ato të holla qi kishte, shtoi edhe sa vetë, e i çili, dorë për dorë, nji tregëti të mirë. Pas 6 muejsh qëlloi e vdiq nuni, e kështu e prishi punën qi pati e mori udhën e shkoi ke miku në Patré, se e dinte syth (mirë fare) qi ky, edhe kësaj here, s' do të linte gjâ pa bâmë për t' i mbaruem punë. Miku vërtet e priti me gëzim e e çoi në Krimé, si përkëthyes (dragoman) të Shqiptarëvet, qi luftojshin me rrogë n' ushtërít angleze.

Këtu vuni pare të madhe, se merrte nji lirë Anglije në ditët, e, me këto të holla, u-nis e shkoi në London për të ndjekun mësime të nalta. Këtu ka ndejtun 3 vjetë, si thonë, e ka kërkuem nga Shoqënija Biblike, si njeri qi i digjesh zemra të punojë për gjuhën e vet, të përkëthejë shqip librat e shejta. Shoqënija këtê e kishte në rregulloret, po deri atëherë s'i kishte dhânë udhë kësaj pune. Andaj i merr Kostandinit drejtimin e e la punën ta thërresi me nevojë. Prej Londoni, nuk e dijmë ç'e shtyni qi ia mbajti për Tunis, ku ka hymë, me rrogë të majme, mësues i Greqishtes e i Italishtes në nji shkollë greke. Këtu e solli puna të njifet mirë me nji Grek të pasun e i mori të bijën për grue, me pajë e pëlqí, sa të thuesh, e me pare të madhe. Tue qenë në Tunis, shoqënija qi thamë, e lidhi të përkëthejë shqip librat e shejta e me 30 lira Anglije në muej. Ç'e lëshoi qielli, s'e priti dheu, ka thânë ai motit! Kostandini këtê po priste; e po e vriste mendjen si t'ia gjejë udhën, t'i shtrohet punës me kothòm (themel) për lëvrimin e zbukurimin e kësaj bukuri gjuhe, qi ishte lânë mbas dore e kishte mbetun si florini në baltët!

Për këtê arësye nuk i qe mjaft mundi, qi kishte bâmë deri atëherë në punën e gjuhës, po këto 20 vjetë, pothue, qi i shërbeu shoqënís, i u-desh të lëshohet se sa herë në Shqipní; e, tue pasun për qendrë Beratin, për Toskënishten, e Shkodrën, për gegënishten, vite rrjeshtë, humbi nëpër male, mâ të shumtën, atje, si ajo puna e bletës, qi breth lule mbë lule, i ra pas thesarit të gjuhës, mblodhi fjalë e të folme, qi s'ishin pamë ndonji herë ndër shkrimtarë përpara, foli gojë më gojë, me vjetë, me Shqiptarin vetë e nga goja e 'tij mësoi gjuhën e vërtetë.

Kështu pra Kristoforidhi, armatosun kand e kand, për 20 vjetë, të thuesh, qi i shërbeu kësaj shoqënije, nxori nga dora gjith'atë mal pune, qi mori mbi vete, e kreu nji vepër, qi s'e dij a e ka shoqen në Letërsí t'onë; e këtê e thomi mâ tepër, se në punën e vet të madhe, nuk pati, pothue, fare ndonji shtresë e themel për të mbështetun godín e 'tij, përveç disa shkrimesh të vjetra, me nji gjuhë të hershme, qi s' ndëgjohesh mâ. Edhe këtê punë, me durim të hekurt, me ditunín qi kishte e me mendjen e vet të hollë, e kreu për faqe të bardhë.

Këto 20 vjetë afër, qi bâni përkthimin e libravet të shejta, shoqënija e preu punën nji herë, e Kostandini atëherë shkoi e nyni përsëri mësues në shkollën greqishte të Tiranës. Shkoi nji vit, e shoqënija e thirri së rish tue dashun, duket, të ketë edhe nji përkthim toskënisht të Dhiatës. Me të mbaruem këtë, e ndaloi nga puna e herë t' jetrë s' e thiri mâ. Atëherë Kristoforidhi ka hekun shum keq në Stamboll, në punë ekonomije; se, përveç qi ngeli pa punë, po, me nji sëmundje të randë, qi kishte kaluem përpara, i u-desh të prishi ç' pati e ku pati; e kështu, me nji valle fëmij si ishte, ra shum ngusht në dhé tëhuej. Kam ndëgjuem nga goja e z. Lef Nosit se, me këtê ngushticë të madhe, âsht kujtuem e i ka shkruem Nos Mimë Nosit këtu, qi të kujdeset ta fusi mësues në shkollën greqishte të Kalás. Nosi s' e bâni të gjatë, po e thiri me nji herë, me gojë të lagjes, dhe e vuni mësues në shkollën, qi zumë me gojë, ku ka mësuem greqishten e mathematikën shqip.

Si mësues lagjeje ka qëndruem deri mbë 1888 e atëherë ka hymë anëtar në Gjykatoren e Elbasanit e këtê punë e Zyrë e ka pasun deri sa vdiq mbë 24 Shkurt 1895. Vdekja s' i ka ardhun nga pleqënija aqë, sa nga nji sëmundje e lodhëme (e mërzitëshme) qi i mori barku ujë; e u vorrue në Kishën e Shën Mëris në Kalá (Elbasan).

Sikundër e rrëfen edhe puna vetë, Kostandini ka qenë i punës e i zyrës, plot goja, e me vullnet, qi rrallë fort e gjën ke njeri. Ishte gjithë guxim, se, pa bir njeriu, mâ të shumtën e herës, qi t' i drejtojë udhën, djal i ri fare, âsht lëshuem në luftën e jetës e dijti e luftoi. Si njeri, qi s' i bânte bef syu, i ra botës an' e mb' anë, e pa e mësoi e vuni mend shum. Ishte i shoqënis e i shkueshëm me të gjithë. Flakë në shpirtit e zjarr në gojë, nuk pushoi, sa qe gjallë, së leçituni, me zânin e Stendorit, si nji herë motit, se sa e mira gjâ âsht malli e dashunija mbë vend; e kështu, shtiu n'Elbasan themelet e forta të njij edukate kombëtare të vërtetë e të qëndrueshme. E prej këndej pastaj, këjo rreze drite ndriti Shqipnin e Mesme të gji-

thë e ndezi horë zemrat e njerëzis për vend të vet. Ka qenë i hollë nga mendja e i prefët nga gjykimi e s' ishte nji punë ta zije me fjalë, se përgjigjen ta kishte mu ke buzët. I qante zemra për ata, qi fati s' i pa me sy të mirë, e, posi puna e njerësvet të mëdhej, shum herë, nuk u-mendue kurr për plang e për shtëpí, po, ç' pati e ku pati, e dau me buzëplasnin e të vorfnin.

Me këto të mira, qi i fali natyra, kuptohet vetiu se i hyni në zemrë gjithë njerëzís, e, i math e i vogël, parësí e vegjëlí, e kishin për nder e e pyetshin për mend. E drejtë, të thuesh, ishte për t' u çuditun me këtê njeri ; se, ta lâjsh mb' nj' anë ditunín qi kishte, po fliste e shkruente me Shqipen edhe gjuhë të tjera, si Italishten, Frangjishten, Anglishten, Gjermanishten, Rusishten, Bullgarishten, Turqishten, Arabishten e Greqishten.

Si shkrimtar qëndron në ball t' atyne burrave, qi punuen heret për gjuhën t' onë, edhe tëhek vallen e gjithë shkrimtarëvet, qi erdhën mbas këtij, me sa thelloi e i hyni gjuhës në shpirtit, në punën e fjalës e në punë t' enduni e teknike. Njizet vjetë, po thue, rrjeshtë, sa qe në punë të shoqënís, s' i zuni kamba vend, po, mal mbë mal e fushë mbë fushë, mblodhi, me kujdesin mâ të math, thesarin e gjuhës. Pa farë brumi, të thuesh, në dorë e pa ndonji shtresë të madhe, si ishte atëherë gjuha e jonë pa hymë në rrugë, qysh prej së vogli, i u-përvesh punës me gjithë mend e me zjarr të math ; e kështu, punoi e rrogoi, e u gjëfqye (u këput së punuemi) nji faqe njeriu, po thue, e ia mërrini mâ në fund të diktojë fjalën shqipe virgjin, të brimojë e të pikasi, nji për nji, bukurít e hollësít e gjuhës, të ngjeshi e të trajtojë për bukurí nji të folme të harrueme e të lânë mbas dore, e ta bâjë gjuhën t' onë me të vërtetë gjuhë shkrimi e këndimi !

Mjafton t' i a lëshojmë syt *Fjalorit* qi bâni, e do të shofim, aty për aty, se ç' mortní fjale (sa shum e shum fjalë) e ç' thesar të paçëmueshëm së folmesh të holla, si trendëlina e malit, ka mundun të mbledhi nga goja e popullit e të na lâjë kështu nji pekul, qi s' e ngren gjâ.

Po *Gramatika* e 'tij greqisht e shqip ? Këjo âsht themeli

e brumi mâ i ardhëm për të hartisun njeriu mbas-këndaj nji gramatikë *për të qenë e të mbështetun në natyrën e vërtetë të gjuhës s' onë.*

T'i shkojmë nji sy me kujdes mâ së fundi *Dhiatës* e çdo vepre t'jetrë, qi nxori në dritë, e të mendojmë e të gjykojmë se ç' gjâmë pune ka qitun nga dora, me nji gjuhë qi s'e gjeti, të thuesh, dhe e krijoi vetë !

b) Veprat e Kristoforidhit

1) Të botueme sa qe gjall

1) **Dhiata e Ré** e Zotit edhe Shëlbuesit t'ynë Izu-Krishtit, Punët e Apostujvet edhe Sbulesa e Gjon Hyj-ditunit, këthyem prej Greqishtes vjetërë shqip, ndë gjuhë gegënishte prej Konstantin Kristoforidhit, Elbasanasit. Konstantinopol 1868. (Këto janë botuem përsëri mbë 1872.)

2) **Katër Kateqisma** gegënisht për çunat e vogjilë etj. Konstantinopol 1867. (Këjo veprë e voglë âsht shtypun përsëri mbë 1884.)

3) **Psalltiri** këthyem toskënisht pas Evraishtësë vjetërë etj. 1868.

4) **Historija e Shënjtësë Shkrojë** për djelmt, gegënisht etj. 1870.

5) **Abetar shqip**, gegënisht, etj. 1872.

5) **Allfavitar shqip**, toskënisht, etj. (Kohën e botimit s'e ka e duket ka dalë në dritë po mbë 1872.)

7) **Istoria e Shkronjësë Shënjtëruarë**, toskënisht, etj. 1872.

8) **Psallteri**, gegënisht, etj. 1872.

9) **Dhiata e Zotit** dhe Shpëtimtarit tënë Jisu-Krishtit, toskënisht, etj. 1879. (Nji pjesë e kësaj âsht botuem përëri mbë 1886.)

Dhiatën e Ré e gjithë po thue veprat e veta Kristoforidhi i ka toskënisht e gegënisht ; e këtê e bâni e para, se ia donte puna, qi të përhapen librat e shejta kudo në vendin t' onë e t'i kuptojë gjindja mirë ; e pastaj këto 2 dhialekte, Toskënishten e Gegënishten, i dinte mirë.

Dhiatën e Ré toskënisht s' e ka shtypur me Abeçén latine, po me shkroja greke ; se me këtê mënyrë, ia mbërrinte qëllimit sa mâ mire ne Toskeni, me atë propagandë qi ishte bâmë atë kohë ndër të Krishtenë Orthodhoksë, mbi kurris të lëvizjes kombtare qi sapo kishte filluem atëherë.

10) **Të Bërëtë edhe të Dalëtë** toskënisht, etj. 1880. (Këjo veprë âsht shtypun përsëri mbë 1884.)

11) **Gramatika e gjuhës shqipe,** si mbas dhialektit toskënisht, 1882.

12) **Të Bërëtë të Dalëtë** edhe Nom' i dytë etj. 1894.

13) **Të Bërëtë të Dalëtë** edhe Nom'i dytë, Fjalë t'Urta, Isaia, toskënisht. etj. 1884.

2) Veprat e botueme mbas vdekjes

1) **Fjalori i gjuhës shqipe,** greqisht, shqip, etj. — Athinë 1904.

Fjalori, qi nga veprat e Kristoforidhit qëndron mu në ball, në dorëshkrim ka qenë me fytyra deri diku, si puna e Fjalorit frangjisht të Larousse-it. Nji gjâ pastaj, e cila ka shum randësi, âsht qi shkrimtari këtu na thotë për çdo fjalë edhe vendin ku e ka marrë.

2) **Gjahu i Malësorvet, Hieja e Tomorrit.** etj 1884.

Këjo veprë âsht botuem toskënisht, gegënisht e në dhialektin e Shqipnis së Mesme. Teksti toskënisht u-botue mbë 1902, ke „Albania", në Bruksell e në London, teksti qi âsht në dhialektìn e Shqipnís së Mesme, u-botue mbë 1918 në „Kopështi Letrar", n' Elbasan, edhe teksti gegënisht ndodhet pa u botuem në dorë të Z. Lef Nosit.

3) **Jetë-shkronja e njerëzvet ndriçim** — Janë Gutembergu — etj. 1885. (âsht botuem mbë 1918 ke „Kopështi Letrar", n' Elbasan.)

4) **Systema Diellore** etj. (Âsht botuem mbë 1918 ke Kopështi Letrar", n' Elbasan.)

5) **Nji letrë** qi ia ka dërguem Kristoforidhi, mbë 1888, Nikolla Naços, kryetarit të shoqënis «Drita», në Bukuresht.

3) *Veprat qi s' janë botuem*

1) *Landë e ndryshme gramatikore*, mbledhun mbë 1884, për të plotësuem, mundet, gramatikën e vet e për ta botuem përsëri.

2) *Mbledhje fjalësh* turqishte, greqishte, latinishte, sanskritishte e slavishte, qi kanë hymë në gjuhë t' onë, a kanë nji rrânjë me fjalët shqipe, si mbas mendimit t' auktorit.

3) *Ndreqje*, në dhialektin toskënisht të Shqipnís, *të kangëvet 1-13 të librit të De Radës* „Rapsodie d'un poema Albanese". Firenze 1886.

4) *Ligjërata* qi ka mbajtun për vdekje, për njerës me emën në lagjen e Kalás.

5) *Nji vjershë* e bukurë për Kryet e Motit.

c) Alfabeti i Kristoforidhit

Kristoforidhi ka qenë i mendjes, sikundër edhe e bâni, qi neve na duhet nji Alfabet krejt latin e jo i përziem me shkroja greke e të tjera, si ka qenë Alfabeti i Stambollit; e këtê mendim e kishte, se gjithë bota e qytetnueme nji kësi Alfabeti ka, e kështu mund të shtypi njeriu libra shqip në çdo vend qi të ndodhet. Ky ka qenë shkaku mbasandaj qi edhe Kongresi i Monastirit mâ vonë po këtê Alfabet ka pëlqyem e ka futun në punë. Përveç kësaj Alfabeti i Kostandinit, të gjitha shkrojat, të thuesh, i ka të thjeshta e të vetme, nji ashtu si e kërkon natyra e punës vetë, qi, për nji zâ, të kemi nji shkrojë të vetme e jo dy. Kështu, përveç *dh*-ës e *th*-ës, qi janë shkroja greke, ky alfabet âsht fjesht latin, e ka këto 36 germa: a, b, d, *delta*, *theta*, e, ç, f, g, g', h, i k, k', l, (ll), l', m, n, n', o, p, r, r, s, s, *) t, u, u, v, y, z, z, ts, ts, ds, ds.

Kristoforidhi, përveç Alfabetit latin, ka shpifun edhe nji alfabet të dytë, me shkroja greke fjesht, me disa ndryshime; e kejo i u-ka dashun për të gjitha, po thue, shkrimet toskënishte, qi t' ia mërrijë kështu qëllimit sa mâ mirë, në punën e

*) Gërma *s*, *ts*, *ds* (të dytat) kanë sipri nji theks hundak për së mbrapshti.

të përhapunit të ndjejës kombtare, ndër Orthodhoksë të Toskënís, me edukatën e ditunín greke qi kishte këjo anë përtej Shkumbinit.

ç) Orthografija e Kristoforidhit

Në punën e orthografís, Kristoforidhi, aty këtu, si mendojmë, shkon pas gjurmavet të shkrimtarëvet të vjetër, si të Budit e të Bogdanit, të cilët i ka studijuem mirë, si duket. Me këtê mënyrë kështu, bân nji arhaizmë pa nevojë e nuk shqepet nga trajtat e herëshme, të cilat, nga nji anë, mund të jenë të drejta, si mbas Linguistikës, po sot mâ janë vjetruem dhe e randojnë shum punën e orthografís, po të ngulim kambë e t' i përdorim. Zanoren *ë*, fjala vjen, si në Toskënishtet, si në Gegënishtet, e përdor me hepé (me dorë të madhe) e vend e pa vend, si puna e Naimit dhe e Vretos. Qi të kemi pastaj nji fotografí, si të thom, e fytyrë të vërtetë e besnike të gjuhës s'onë, në punë zâni e fonetike, dallon, me sheja të veçanta, me kujdesin mâ të math në të shkruem, zanoret e gjata, zanoret e shkurtëna edhe hundaket.

d) Copa të zgjedhuna

1) Nga Dhiata e Ré

(Si mbas Mattheut Krei 6, paragr. 5-22)

Edhe kur të falesh, mos ij porsi hipokritëtë: sepse ata duenë me ufalunë tue ndëitunë ndëpër synagogat e ndëpër kandet e rrugavet, për me udukunë te nierëzitë. Për të vërte po u thom juve, se ata e kanë marrë pagën' e vet. Po ti, kur të falesh, hyn ndë shtëpit tande, edhe mbyll derënë tande, e i ufal t'yt-et qi âshtë pshefas, edhe yt-Atë qi shikon pshefas, ka me ta paguem mballa-faqe. Edhe kur të faleni, mos thoni fjalë të tepëra, por si gjintarëtë: sepse ata kujtojnë se me fjalëtë e shumëta kanë me undëgjuem. Mos u përgjani pra atyneve; sepse Ati juei e di se qish lypsetë juve, para se të lypni prei ati. Kështu pra faluni ju:

„Ati ynë qi je ndë qiell ushenjtënoft' emëni yt, si ndë qiell, edhe mbë dhet. Bukënë t'onë të përditshmen' ep-ña neve sot. Edhe fal-na detyrëtë t'ona, sikurse edhe na ua falimë detorëvet t'anë. Edhe mos na shtierë ndë ngasëje, por shpëto-na prej së keqit: sepse joteja âshtë mbëretënia, edhe fuqia, edhe lafti ndë jetët të jetëvet. Amen."

Sepse ndë ua falshi nierëzëvet fajet' e atyneve, ka me ua falun' edhe juve Ati juei qiellori: por ndë mos ua falshi nierëzëvet fajet' e atynene, as Ati juei s'ka me u falunë fajetë tueja.

Edhe kur të agjinoni, mos bâhi të vranëtë porsi hipokritëtë: sepse ata prishinë faqet' e veta, qi të dukenë te nierëzitë se agjinojnë. Për të vërtet po u thom juve, se ata e kanë marrë pagën' e vet. Por Ti, kur të agjinojsh, lyei kryetë tat, edhe lai faqet' e tua: qi të mos dukesh te nierëzitë se agjinon, por te yt-Atë qi âshtë pshefas: Edhe yt-Atë qi shikon pshefas, ka me ta paguem mballa-faqe.

Mos mbëlithni thesore mbë dhet për ju, atie ku krymbi edhe ndryshku i prish, edhe atie ku viedhësitë germihin' edhe viedhinë: por mbëlithni thesore ndë qiell për ju; atie ku s'i prish as krymbi as ndryshku, edhe atie ku viedhësitë nukë gërmihinë, as viedhinë. Sepse ku të jetë thesori juei, atje ka me qenun' edhe zemëra juei.

SHËNIME:

1. *Synagogë-a:* vendi i të falunit ndër Israelitë. 2. *mballa-faqe:* për ball, në shesht, sheshit, faqe botës. 3. *Gjiintarëtë:* gjithë kombet jashtë vathës së Krishtënimit, në të përhapunit e kësaj feje në kryet e herës; Idhulltarët, Paganët. Emni (mbiemën bâmë emën) vjen prej fjalës *gjint, gjind-i = gjindje, popull, komb.* 4. *Lyei kryet tat....:* kur agjinoni, rrini si njerës e lamë e shplamë e jo me faqe pa lamë e me krye keq e keq-e gjithë hî, për t'i u-rrëfyem botës se agjinoni. (Këtê zakon të keq e kishin, kur agjinojshin, Israilitët).

2) *Nga Sbulesa e Gjon Hyj-ditunit*

(Krei 21, paragr. 1-15.—)

Edhe pashë nji qiell të ri edhe nji dhe të ri: sepse qiell' i parë edhe dheu i parë shkoi: edhe deti nuk' âshtë mâ. Edhe unë Gjoni pashë qytetinë shenjt, Jerusalemën' e re, tue sdripunë prej qiellit kah Hyji, bâmë gati porsi nusen' e stolisëne për burrin' e vet. Edhe ndëgjova nji zâ të math prei qielli qi thoshte: Nje tenda e Hyjit bashkë me nierësitë, edhe ka me ndenjunë bashkë me ata: edhe ata kanë me qenunë populli i ati, edhe Hyji ka me qenunë bashkë me ata Hyji i atyne. Edhe Hyji ka me mpëshimë qishdo lot prej syvet atyne, edhe vdeka s' ka me qenunë mâ: as vajë, as të thërritunë, as të dhimbunë s' ka me qenunë mâ: sepse të paratë shkuenë.

Edhe tha ai qi ishte ndenjunë mbë shkampt. Qe të gjitha tek i bâj të ra. Edhe më thotë, Shkruei: sepse këto fjalë janë të vërteta edhe të zâna besë. Edhe më tha, ubâ: unë jam Allfa edhe Omega, e filluemeja edhe e mbaruemeja. Unë kam me i dhân' ati qi ka et prej gurrës ujit gjallë të jetësë dhunëti. Ai qi mund ka me trashiguem të gjitha, edhe kam me qenunë tek ai Hyj, edhe ai ka me qenunë tek unë bir. Edhe frikësit' e të pa-besët' e të ndytët' e gjak-bâmësit' e kurvarët' e magjistarët' e idhullatrët e gjithë rrenësitë kanë me pasunë piesen' e vet ndë kënetët qi digjetë me ziarrin e me surfullë, qi ajo âshtë vdek' e dytë.

Edhe erdhi tek unë nji prei shtat' engjujvet qi kishinë të shtatë kupatë mbushunë me të shtatë plagët' e mbrapëme, edhe foli bashkë me mue, tue thânë, Eja, të diftoj tyi nusenë, gruen'e Qengjit, edhe më pruni me frymë mbë nji mal të math e të naltë, edhe më diftoi qytetin' e math Jerusalemën' e shenjtënueshime, tue zdripunë prej qiellit kah Hyji, qi kishte lavdin' e Hyjit: edhe të ndritunit' e asai gjante me gur fort të nderëshim, porsi gur Iaspide qi shkëlqen si krystallë. Edhe kishte nji mur të math edhe të naltë, edhe dy-mbë-dhetë dyer, edhe mbë dyert dy-mbë-dhet' engjuj, edhe emëna shkruem përsipër, të cilatë

janë të dy-mbë-dhetë faravet e të bijvet Israelit. Prei së lemesë diellit tri dyer: prei anësë borësë tri dyer: prei anësë mies-ditësë tri dyer: prei së perënduemesë diellit tri dyer. Edhe muri i qytetit kishte dy-mbë-dhetë themele, edhe nd' ato ishin' emënat e të dy-mbë-dhet' apostujvet Qengjit. . . .

SHËNIME:

Sbulesa: Sbulesë *ase* Apocalypsis *(greqisht) do me thânë të thotë njeriu mâ përpara e të profetizojë ç' ka për të gjajtun. Auktori i Sbulesës âsht Shin Gjoni, nji nga të 12 apostujt, dhe e ka shkruem mbë 95 mbas K., tue qenë i mërguem n' ujdhesët Pathmos. Në këtê vepër na kallzon mâ përpara triumfin e ngadhnjimin e plotë të Kishës mbi gjithë kundërshtarët e Krishtënimit; e, me këtê volí, përpiqet auktori t'u a mbushi mendjen besnikëvet se sa nevojë të madhe po kanë të qëndrojnë si burrat në fét, me gjithë të vuejtmet e të ndjekmet e mëdha, qi po hekin, në daçin të trashigojnë jetën e pasosme.*

1. Edhe pashë nji qiell të ri....: *erdhi Krishti e shpërbleu njeriun prej mëkatit, e bota e vjetrë ndërroi faqe e u-përtëri, e vendin e 'saj e zuni nji botë e ré, shpirtënisht e moralisht.* 2. Edhe unë Gjoni pashë qytetinë shenjtë....: *Këtu Theologu kupton Kishën triumfuese e ngadhnjimtare, sikurse do të jetë ditën e gjyqit, kupton botën Kristjane në jetën e pasosme e në lumnín e amëshimit.* 3. Nje tenda e Hyjit....: *Kisha e Zotit e amëshimi.* 4. Edhe Hyji ka me mpëshimë....: *në jetën e pasosme s'ka për të pasun mâ as vaj, as dhimbje, as të thërritun e as vdekje, sepse faqja e parë e jetës së njeriut kaloi e ndashti erdhi lumnija, me të përtërimen e njerëzimit, erdhi drita e amshimit.* 5. Edhe tha ai qi ishte ndenjunë mbë shkampt: *Ky âsht Krishti.* 6. Unë íam Allfa edhe Omega: *jeta fillon ke unë e mbaron po ke unë, unë jam të filluemit e të mbaruemit, unë jam* causa efficiens et causa finalis. 7. Unë kam me i dhan' ati qi ka et....: *Atê qi dishiron me të vërtetë, unë kam për ta bâmë të lumtun për jetë; e jo se ka ndonji të drejtë për këtê të mirë po se më leu mue në zemrë t'ia bâj këtê nder.* 8. ndë kënetët qi digjetë me zjarr: *të vuejtmet e randa të skëterrës.* 9. Edhe erdhi tek unë nji prei shtat' engjujvet....: *këtu kupton të shtatë*

të këqijat e plagët e mëdha, qi do të lëshojë Perendija, kohë mbas kohe, mbi njeriun, deri sa të vijë dita e gjyqit. Disa nga këto plagë e shprovime të randa, si mbas theologjís, duhet të kenë shpërthyem deri mbë sot mbi robin (njeriun). Lufta qi po tund e themeletis botën sot, a mos âsht nji ndër këto shtatë rrebeshe e stuhí të mëdha?! 10. Më pruni me frymë.....: *më ngriti nëpër erë e më çoi mbë nji mal të naltë me shpirt e me mend e jo me trup. 11.* Edhe më diftoi qytetin' e math, Jerusalemën' e shenjtënueshime....: *Si puna e Dantes në kangën e 30-ë të Purgatorit, ku përmes figurash natyrore, qi s' t' i merr mendja, përpiqet shkrimtari të na dëftejë se si i u-ka shpallun Beatriçja në parajsë, nji ashtu edhe Shin Gjoni në Sbulesët kërkon të na bâjë ta shofim me sy Kishën ngadhnjimtare; do me qenë sikur të na e bâjë ta prekim me dorë lumnín e Besnikëvet të Krishtit n'atë jetë mbas ditës së gjyqit, tue na vumë përpara pikturën e madhënueshme t'Jerusalemit, nji ashtu si e ka pikësuem profeti Jezeqiel.*

3) Nga Punët e Apostujve

(Mbë Korinthianët I. Krei XIII, paragr. 1-13)

Ndë folsha gjuhënat' e nierëzëvet edhe t' engjujvet, e të mos kemi dashuni, ubâshë si ramë qi kumbon, a si qymballë qi gjimon. Edhe ndë paça profezi, edhe të dij gjithë mpshefësinat' edhe qishdo farë të dituni, edhe ndë paça gjithë besënë, kaqi sa të shkul vendit male, e të mos kemi dashuní, s' jam asgjâ. Edhe ndë dafsha gjânë t' eme për me ushqyem të vobekëtë, edhe ndë dhânsha ndër duer korpinë t' em për me udiegunë, e të mos kemi dashuní, s' më vëjen gjâ.

Dashunia ka zemërë të gjânë edhe bân të mira: dashunia s'ka zmir: dashunia s' âsht' e rrëmbyeshime, s' madhështohetë, s' bân punë të shumtutë, s' lypën të vetatë, nukë zemërohet, s' mendon të keqenë: s' gëzohetë për të shtrembëtënë, por gëzohetë për të vërtetënë. Të gjitha i bar, të gjitha i beson, të gjitha i shpëren, të gjitha i duron.

Dashunia kurrë s'bije për dhe: por të tieratë, a profezia

ndë qofshinë, kanë me mbetunë mbë-nj' anë: a gjuhëna, kanë me pushuem: e të ditunë, ka me mbetunë mbë'-nj'-anë. Sepse na pak gjâ dimë, edhe pak gjâ profetizoimë: por kur të vijë e plota, atëherë ka me mbetunë mbë-nj'-anë e paka. Kur ishiem foshnjë, flisiem si foshnjë, mendoheshe si foshnjë, kujtoheshe si foshnjë: por kur ubâshë burr, i lâshë mbë-nj'-anë punët' e foshnjësë. Sepse tashti shofimë ndëpër pasqyrë si mbë t' errët, por atëherë kemi me pamë faqe mbë faqe: tashti ngjof pak, por atëherë kam me ngjofunë, sikurse ungjofa.

Edhe tashti mbet besa, shpëresa, dashunia, këto të tria: por mâ e madhe se këto âshtë dashunia.

SHËNIME:

1. Ndë folsha gjuhënat' e nierëzëvet....: *Sikur të flas në gjuhët mâ të bukur të botës, sikur të flas në gjuhët t' engjujvet, në mos paça dashuní në zemrë, jam posi puna e ramës qi kumbon e posi puna e qymballës qi gjëmon: dhuntít e ndryshme d. m. th., qi kemi prej së nalti, asnji randësí s'po kanë, në mos qofshin bashkuem me dashuní; sepse këjo vetëm âsht ajo, qi e shpije njeriun ke Zoti dhe e bân të hyjë në jetën e pasosme.* 2. Qymballë: *veglë muzikore e Israelitëvet, si puna e tamburës.* 3. Edhe në paça profezi: *në paça hirin e të profetëzuemit.* 4. Edhe në dhansha ndër duer....: *edhe në rança dëshmor tue u-djegun në zjarr (sikurse bijshin dëshmorë, mâ të shumtën e herës, të Krishtenët e parë për punë feje).* 5. Dashunia s' âsht e rrëmbyeshime: *dashunija nuk e lê njeriun të rrëmbehet e të marri t'jetrin nëpër kambë.* 6. S' lypën të vetatë: *Kur njeriut i vëlon dashunija në zemrë, s'kërkon t'i prijë vetes* vetëm *e të mos i dali nji bulë gjaku nga hundët, si puna e atyneve qi mendojnë veçse për vete.* 7. I bar të gjitha: *i mban të gjitha e s' prish punë me njeri.* 8. Dashunija kurrë s' bie për dhe: *dashunija nuk humb kurrë e s' e prish gjâ; këjo qëndron edhe në jetën e pasosme.* 9. Por të tieratë, a profezia ndë qofshinë....: *me fuqí e hir profetëzimi, me gjuhëna, qi di njeriu, e me shkencë e ditunì, të gjitha këto, në ditën e Kishës ngadhnjimtare, n' amëshim, do të mbeten mbë nj'anë e s'kanë për të hymë në punë përpara Dijes së Madhe, përpara Zotit.* 10. E plota: *jeta e pasosme.* 11.

Mendoheshe si foshnje: *mendojshem si foshnja. 13.* Sepse tashti shofimë ndëpër pasqyrë si mbë t'errët.....: *Perëndín në këtê jetë e shofim si mbë t'errët e vetëm përmes krijesavet, nëpër të cilat mezi ndrin ndonji rreze e përsosmenís së 'tij; e në jetën e pastajme, kemi për ta pamë të gjithë e sy mbë sy. 14.* Tashti ngjof pak.....: *N' atê jetë kam për ta njoftun Zotin paq (mirë fare), nji ashtu si më njofti Zoti mue. L5.* E tashti mbet besa. ....: *Qi të trashigojë njeriu jetën e pasosme,* sine qua non, *janë besa, shpresa e dashunia, e përmbi të gjitha dashunija.*

4) Nga Psallteri:

Psallm' e Davidit 103.

Beko Zotinë, o shpirti em: edhe gjithë të përmbrendëshimet' e mia, emënin' e ati të shenjtënueminë. Beko Zotinë, o shpirti em, edhe mos harro gjithë të miratë, qi të ka dhânë: ate qi fal gjithë pa-udhënit' e tua: ate qi shëndosh gjithë sëmundjet' e tua: ate qi shpërblen jetënë tande prei prishëjesë: ate qi të kunorëzon me ndëjesë e me përdëllime: ate qi ngin dëshëriminë tand me të mira: dielmënia jote dotë përtërihetë porsi e shqipesë.

Zoti u bân dreitëni e gjyq gjith' atyneve qi u bâhetë pa udhë. I diftoi udhët' e veta Moiseut, edhe punët' e veta të bijvet Israelit. Zoti âshtë i dhimpshim e i përdëlyeshim, zêmë-rë-gjân' e përdëllim-math. S'ka me uzemëruem për-herë, as s'ka me mbaitunë mëni për gjithë jetënë. Nukë na e bâni mbas pa-udhënivet t'ona, as na e shpagoi mbas fajevet t' anë. Se sa i naltë âshtë qielli prei dheut, kaqí i math âshtë përdëllim' i ati mb' ata qi e kanë frikë. Sa dan të lemit' e diellit prei të perënduemit, kaqi largoi prei nesh pa-udhënitë t'ona. Sikurse i dhimbet' atit për dielmt, kështu i dhimbet' edhe Zotit për ata qi e kanë frikë. Se ai ngjef krijesënë t'onë, e mba mend se jemi baltë. Ditt' e nieriut jani porsi bari: porsi lulja e fushësë, kështu lulëzon. Se shkon era mb' ate, edhe s'âshtë mâ: edhe vendi i ati s' e njef mâ. Por përdëllimi i Zotit âshtë jetë mbas jete

mb' ata qi e kanë frikë: edhe dreitënia e ati mbë bijt e të bij-vet qi ruejënë dhiatën' e ati, edhe mbanë mend urdhënimet' e ati për me i bâmë.

Zoti bâni gati shkambin' e vet ndë qiell, edhe mbëretënia e ati zotënon mbi të gjitha. Bekoni Zotinë ju engjujt' e ati, të fortë me fuqi, ju qi bâni fjalën' e ati, ju qi ndigjoni zanin' e fjalës' ati. Bekoni Zotinë, ju gjithë fuqiat' e ati: ju punëtorët' e ati, qi bâni dashunimin' e ati. Bekoni Zotinë, ju gjithë punët' e ati, mbë çdo vend të pushtetit ati. Beko Zotinë, o shpirtti em.

Psallmë 104.

Beko Zotinë, o shpirti em: fort umadhënove, o Zot Perëndia em: je veshunë me lavdurim e me madhëni. Ai qi heth përmbi vetëhe dritënë, porsi petk: ai qi shtrin qiellinë, porsi kurtinë. Ai qi mbulon me ujë të naltëtë vendet' e vet: ai qi bân retë qerren' e vet: ai qi ecën mbi fletët t' erënavet. Ai qi bân engjujt' e vet fryma, edhe shërbëtorët' e vet flakë ziarrmi. Ai qi themelon dhenë mbi qindrim t' ati, për mos me utundunë jetë mbas jete.

Mbulove ate me abyssënë, porsi me petk: ujënatë qindruenë mbi malet. Prei qirtimit t' yt iknë: prei zanit bumbullimësë s' ate uhoqnë me nxitim. Hipnë ndë malet, sdripnë ndë fushat, nd' ate vend qi i themelove. Vune sinuer qi s' kanë me e kapërcyem, as s' kanë me u këthyem, për me mbuluem dhenë. Ai qi dërgon bunime ndër shpellat, qi të shkojën' ujëna ndërmiet malevet. Pinë ujë gjithë bishat' e fushësë: gomarët' e egrë shuejënë hetëjen' e vet. Afër' atyneve kanë të ndenjunitë shpezët' e qiellit, edhe apinë zâ ndërmiet degavet. Ai qi ujit maletë prei të naltëvet vendevet vet: prei pemësë duervet tua nginjetë dheu. Ai qi bân me bimë bar për bagëtit, edhe barishtë për shërbimin e nieriut, qi të nxierri bukë prei dheut, edhe venë qi gëzon zemërën' e nieriut, voj për me shkëlqyem faqenë, edhe bukë qi forcon zemërën' e nieriut. Unginë drut' e Zotit: dulenjat' e Libanit qi mbolli: atie ku bâjënë fole zoqtë, bredhatë janë të ndenjunit' e leilekut. Malet' e naltë janë për dhit e egra: gurëtë janë pshtetëje për lepujt e butë.

Bâni hanënë për motet: aielli ngjef të perënduemit' e vet. Lishon errësinë, e bâhetë natë: nd'ate shkojënë gjithë bishat' e pyllit. Këlysht' e leonëvet ulurijënë për me rrëmbyem, e me lypunë prei Perëndiet ushqimin' e vet. Por sa len dielli, mbëlidhen' edhe bien' e flenë ndëpër shtrofkat e veta. Del nieriu ndë punët të vet e ndë mundimt të vet, ngjer mbramanet.

Sa të mëdha janë punët' e tua, o Zot! Të gjitha i bâne me dituni: dheu umbush me krijesënë tande. Ai det' i math e i gjânë: atie gjindenë shtërpij qi s' kanë të ngjehunë, shtazë të vogla bashkë me të mëdha. Atie shkojënë barkatë: atie âshtë ky Leviathani, qi krijove për me lueitunë nd' ate. Gjithë këto shpërejënë mbë ty, për me u dhânë ushqiminë mbë kohë. Kur u ep, mbëledhinë: kur hap ti dorënë, nginjenë së mirash: por kur këthen ti faqenë mbë-nj' anë, përzihenë. Kur u ngre frymënë, ngordhinë, edhe këthehenë ndë baltë të vet: kur u dërgon frymënë tande, ndërtohenë, edhe përtërin faqen' e dheut.

Qoftë lavdia e Zotit për gjithë jetënë: ugëzoftë Zoti për punët' e veta. Ai qi shtie sytë mbi dhet, edhe bân ate me udridhunë: ai qi përket maletë, edhe nxierrinë tym.

Kam me i kënduem Zotit sa të rroj: kam me i psallunë Perëndisë sa të jemi. Mendimi em për ate dotë jetë i amblë: edhe unë dotë gëzohem për Zotinë.

Ushofshinë fajtorëtë prei dheut, edhe të pa-udhëtë mos qofshinë mâ. Beko Zotinë, o shpirti em. Allelluia.

SHËNIME:

1. — Umadhënove: *u-ngrite shum nalt e të quejtën njerëzija të math e të shkëlqyeshëm.* 2. — Ai qi bân engjujt' e vet fryma,......: *ernat (frymat) janë lajmëtarët (engjujt) e 'tij, ernat d. m. th. na lajmërojnë ç' do Zoti, edhe shkreptimat (flakë zjarrmi) janë shërbëtoret e 'tij.* 3. — Ai qi themelon dhenë......: *ai qi e ka ngulun e mbështetun dheun mbi themelet e veta.* 4. — Mbulove ate *(dheun)* me abyssënë *(humbnere)*: *mbulove e rrethove dheun me detin.* 5. — Prej qirtimit: *prej urdhënit.* 6. — Prei zânit bumbullimës s' ate: *Fjala e jote, o Zot, gjëmòn e*

ndëgjohet si punë bubullime, nji ashtu si të ndëgjuen Israelitët tue folun me Mojsiun mbi malin Sinaj. 7. — Hipnë ndë male, sdripnë ndë fusha: *kupton të krijuemit e botës.* 8. — voj për me ushqyem faqenë: *voj për me të mbushun e ardhangun nga faqet e me të dhânë shëndet.* 9. — Libani: *mal i Palestinës.* 10. — Dullenjat qi mbolli: *këto dullenja janë bir mbas biri në Liban, e kështu Davidi thotë se i mbolli Zoti.* 11. — Gurët janë...... : *shpellat e vogla janë shtrofkat e lepujvet të butë.* 12. — Bâni hanënë për motetë: *si e dajmë na kohën sot në muej, Israelitët kishin hanën e thojshin «hanë e parë, hanë e dytë etj».* 13. — Leviathan: *nji farë egërsine e detit, qi s' dihet se cila âsht.*

5) Nga Historija e Shenjtësë Shkrojë

Profetënitë

Gjithë këto shenje i sgithshin' e i diftoishinë profetënitë. Shumë fjalë qi kanë folun' ata, gjindenë shkruem ndë Bibllë. Puna e atyne ishte me mësuem popullinë të ngjifinë Perëndinë, edhe të ndalinë të këqiatë qi bâheshinë shumë herë edhe prei mbretënish edhe prei priftënish. Perëndia ngriti të tillësh nierës ndë mbëretënit të dhetë faravet Israelit e të Judësë, edhe prei dorësë madhe edhe prei dorësë vogëlë. Isaia edhe Danieli ishin prei dyersh mbëretënie. Ieremia edhe Ezekieli ishinë prei rranjësë priftënie. Elia e Elisha e Ionai e Mikai ishinë prei dorësë miedisëme. Amoshi ishte nji lopar.

Kur ishte mbëretënia e Babyllonës e vogël' edhe pa emënë, Isaia profetizoi se kishte me ushtuem e me umadhuem shpeit, edhe kishte me pushtuem shumë dhena; edhe së mbrapëni kishte me uprishunë prei nji bir mbëreti kah Persia, qi dot'ia thoshin' emëninë Kyrus.

Ieremia profetizoi për të prishunit' e Ierusalemit prei Haldeanëvet, edhe diftoi përpara, sa viet kishte për të mbetun' i shkretë Ierusalemi: edhe shtynte popullinë ndë pendesë, për mos me u ardhunë prishia.

Ezekieli profetizoi për Israelitët, se kishinë me i shkulunë prei dheut atyne, e kishinë me i ngulunë ndë Armeni, e kishinë

me mbetun' atie nji qind viet, edhe ai vetë, sikundrë edhe gjith' Iudejtë, shpëreishinë për të prishunit' e mbëretënisë Babyllonësë prei anësë Perëndisë ; edhe ai u tha atyne, të mos presinë se dotë ngrifetë për-së-ri mbëretenia e Israelit, por të presinë se edhe sa nierës qi të kenë mbetunë ndë dhe t' atyne, shpeit kanë me ardhunë mbrapa atyne ndë dhe të huej. Por Israelitëtë nuk' i besuen' Ezekielit, porsi populli i Iudësë qi nuk' i pat besuem Ieremisë.

Ato fjalëtë qi kanë folunë profetënitë janë fort të mëdha. Ieremia ndë nji vend flet mbë këte mëndyrë : «Sdrypa ndë shtëpi të tiegullarit : edhe qe te po bânte punë mbi rrotovilet. Edhe i uprish e na qi po bânte prei balte, n' dorë të tiegulla-rit : edhe për-së-ri e bâni ate nji tietër' enë, sikundrë i pëlqeu tiegullarit me e bâmë. — O shtëpia e Israelit, nukë mundem unë me u bâmë juve, porsi kyi tiegullari ? thotë Zoti. Qe porsi balta n' dorë të tiegullarit, kështu jeni edhe ju n' dorë meje, o shtëpia e Israelit». (Ieremia 18. 3-6). Nji herë ai bleu nji shtambë balte prej tiegullarit, edhe e theu përpara pleqvet Isra-elit, e përpara priftënavet, edhe tha, «kështu thotë Zoti i fu-qiavet : Kështu kam me thyem këte popull' edhe këte qytet, porsikur me thyem kushi enën' e tiegullarit, qi s' mundetë me e ndrequnë mâ për-së-ri : — edhe shtëpiat' e Ierusalemit, edhe shtëpiat' e mbëretënavet Iudësë kanë me undyem, bashkë me gjithë shtëpiatë qi kanë diegunë qem mbi kulmit atyne gjith' ushtërisë qiellit, edhe qi u kanë prumë dhunëtia të stërpikuni perëndinavet tierë». (Ieremia 19. 11-13).

Por mâ të mëdhatë profezia ishinë për t' ardhëmen' e Shël-buesit. «Për të cilinë bâjnë dëshmi gjithë profetënitë». *(Punët* 10..43 : *Sbulesa* 19..10). Kishinë profetizuem, se ai dotë dilte prej fëmijvet Davidit. *(Isaia* 11..1 : *Ieremia* 23..5.) Edhe ishte sbuluem e shpërfaqunë, se ai dot' ishte edhe Perëndi edhe nieri. Isaia fliste për ate kështu, «Perëndia i fortë, Ati i jetësë pa-sosëme, Kryet' e paqtimit». *(Isaia* 9..6.) «Zoti drejtënia jonë». (*Ieremia* 23..6 : 33..16.) Emëni i ati dotë thohei Emmanuel, a Perëndia bashkë me ne : (*Isaia* 7..14.) Edhe ati i veishinë gjith' emënat' e hyjënisë. Ai i uduk profetit Isaisë mbë nji të pame,

sikur ishte porsi nieri, por me madhëni porsi Perëndí. «Pashë Zotinë tue ndenjunë mbi nji shkamp të naltë e ngritunë nalt, edhe shkëlqimi i ati mbushi tempullinë. Sipër ati rrijshinë Serafimë, gjithë-se-cili kishte ka gjashtë fletë: me të dyjat mbulonte faqen' e vet' edhe me të dyjat mbulonte kambët' e veta, edhe me të dyjat fluturonte. Edhe niani i gërthiste tietërit, e thoshte, Shejt, shejt âshtë Zoti i fuqiavet: gjithë dheu âshtë plot me laftin' e ati (*Isaia* 6..1-3.)

Profetizuenë për Messinë, se dotë lente ndë Bethleem: e se dotë bânte mërekullí të mëdha, dot' u çilte sytë të verbënavet, e dot' u epte veshëtë shurdhavet, edhe se „i çali dotë hofte porsi dreni, edhe gjuha e të bëlbënit dotë këndonte": (*Isaia* 35..5,6.) se ai dot' u epte zanin e mirë të vobegëvet, e dotë shëndoshte zemër-thyemitë: (*Isaia* 61..1.) edhe se dotë kulloste grigjen' e vet porsi bari: edhe dotë mbëlithte qengjatë me krahin' e vet, edhe dot' i mbante ndë gjij të vet. (*Isaia* 40..11.) Profetënitë kanë profetizuem për pësimet e për vdekën' e Shëlbuesit, kaqi sbulutë e kaqi këthiellëtë, sa kur këndoim' ato profezia, na dukenë se po flasinë për disa punë qi ishinë bâmë, e jo për ato punë qi kishinë për me ubâmë. Kishinë folunë përpara për atê, se ai dot' ishte „njî nieri me shtrëngime, e i provuem me sëmundie"; se ai „dot' ishte plaguem për fajet t' ona, e hiekunë keq për pa-udhëniat t' ona"; „se dot' ipte shpirtin' e vet ndë vdekët, e dotë numërohei me të pa.udhët, edhe ai dotë barte fajet' e të shumëve, edhe dotë bânte laimësi për të pa-udhët". Mbë këte mëndyrë flet për vdekën' e ati: „upru porsi qengj mbë të therunit, edhe porsi dash pa zâ përpara ati qi e qeth, kështu nukë çeli gojën' e vet". (*Isaia* 53.) Edhe gjith' ato punë qi koditnë mbë vdekët t' ati, e mbë të vorruemit t' ati, e mbë të ngjallunit t' ati, e mbë të hipunit ndë qiell, janë folunë fort këthiellëtë. Zanë n' gojë edhe Shpirtinë Shejt qi qe zotnuem, edhe thonë përmbi të gjitha, se ka me ardhunë nji kohë, qi „dheu ka me umbushunë me të ngjofëmen' e Zotit, porsi ujënat qi mbulojnë detinë". (*Isaia* 44..3: *Ioel* 2..28, 29: *Isaia* 11..9.)

Kështu i pëlqeu Perëndisë me i lishuem nji rreze drite po-

pullit vet, për ato punë qi kishinë me ubâmë për shpërblimin e math. Edhe kështu besëtarëtë ngushulloheshin' e forcoheshinë ndë besët ; por të pa-besët ishinë lânë mbë-nj-anë pa përdëllim e pa ndëjesë.

SHËNIME:

1. — Ndë mbëretënit të dhetë faravet Israelit e të Iudësë: *Iakobi ka pasun 12 djem, nga të cilët kanë dalë të 12 farat e Israelit (populli i Israelit.) Me të vdekun Sallomoni, mbë 975 p. K., hypi në shkampt i biri Roboami, i cili mshoi (randoi) shum mâ tepër se i ati mbi popull, në punën e rregullavet e të pagesavet. Atëherë gjindja u-da mbë dysh edhe 10 fara zgjodhën për mbret Ieroboamin, të birin e Nabatit, e trajtuen mbretënín e Israelit, e të dyja farat e tjera t' Iudës e të Beniaminit qëndruen me Roboamin e ngrefën mbretënín e Iudës.* 2. — Prei dorësë madhe edhe prei dorësë vogëlë : *prej parësís e vegjëlís.* 3. — Babyllona : *Kryeqyteti i mbretënís së Haldeanëvet.* 4. — Prei nji bir mbëreti kah Persia... : *Kyrus-i e prishi mbretënín e Babyllonës mbë 538 p. K.* 5. — Për të prishunit' e Ierusalemit... : *Ierusalemi u-prish edhe u-rrënue prej Nabukodonosorit, mbretit t'Asyrís.* 6. — Tiegullar : *shtamar.* 7. — Rrotovile : *vegla me të cilën bâhet shtama.* 8. — Edhe shtëpiat' e Ierusalemit, edhe shtëpiat' e mbëretënavet... : *Kupton pushtimin e shkatërrimin e Ierusalemit prej Nabukodonosorit e prej Romanëvet, kur do të ndyhen e do të pugahen, me njerës vramë ndër 'to, shtëpít e mbretënvet t' Iudejvet e të besnikëvet.* 9. — Bashkë me gjithë shtëpiatë qi kanë diegunë... : *zakoni ishte qi kemin e digjshin për mbi nji shtyllë, mbrenda në nji ênë.* 10. — Edhe qi u kanë prumë dhunëtia të stërpikuni... : *kupton Iudejt, të cilët, tue u-krypun me idhulltarët, kishin marrë, deri diku, edhe zakonet e 'tyne fetare edhe stërpikshin flín mbi altar me gjakun e berrit, qi thershin.* 11. — Edhe dotë bânte laimësi për të pa-udhët : *do të hynte në mest, do të ndërmjetësonte ke Zoti për të na shpëtuem.*

6) *Nji letrë e Kostandin Kristoforidhit*

drejtuem Nikolla Naços, Kryetarit të Shoqënis «Drita» në Bukuresht

Elbasan, mbë 25 Kalënduer 1888.

Zoti i nderçëmë Nikolla Naço,

në Bukuresht

Kartën' e Zotërisë sate shkruarë mbë 16 të Vjeshtësë tretë e prita me gaz të math, bashkë me atë mora edhe tetë kora të Shqipërisë për t' i përndarë, po ata dhjet' Abetare që më shkruan se po t' i dërgonj, s' më kanë rënë n' dorë ngjer mbë sot, as s' kanë për të më rënë, sepse mirretë vesh se i ka ndaluarë gjymryku i Stambollit, a gjymryku i Selanikut. Zotëria jote, kur do të më shkruajsh, a të më dërgojsh ndonjë vivli, a tjetërë gjë, të m' i dërgojsh me anë të Trieshtësë nga Austria me udhë të hekurit, që të dalënë në Durrës të Shqipërisë pas adresësë që po ta mbyll brênda në kartët t' ime.

Sot shtatë tetë viet, kur qeshë unë sëmurë në Stamboll, dërgova Jano Vretonë në Vllahit e në Misir për të kërkuarë ndihmë mb' emërit t' im, që të shtypetë *leksikoja e gjuhësë Shqipesë* që jam munduarë 20 viet për atë punë, edhe kam mbëledhurë 40.000 fjalë shqip : edhe umbëlothnë katërëqind napoleona t' artë mb' emërit t' im, edhe uvunë në Bankët të Bukureshtit, sepse nukë dilin' aqë para për të shtypurë leksikonë ; atëherë pa pyeturë mua, pa shkruarë mua, pa dhënë zë mua, vëllezërit' t' anë Shqipëtarëtë që gjendenë në Misir bashkë me vëllezëritë t' anë që gjendenë në Vllahí, ngrehnë shoqërin' e Shqipesë në Bukuresht, edhe bënë dasme e gosti, e gëzim të math, dhe thërritnë bij e bija, vëllezër e motëra, nipër e mbesa, kushrinj e kushërira, miq e miqësí, po kryet' e punësë t' anë e gjuhësë Shqipesë nuk' e ftuanë, po ç' bënë ata ? Muarnë ato para që qenë mbëledhurë mb' emërit t' im për të shtypurë leksikonë, edhe shtypnë ca vivlia shqip, ato që kanë shtypurë ngjer mbë sot, zunë të bëninë mur pa vënë themeli më përpara, nuk' umenduan' ata vëllezër të bekuarë se muri pa themeli nukë

qëndron, po rëzonet' e shëmbet e bie përdhe, nuk' e zunë kalinë nga freri, po nga bishti që shpëton e ikën.

Shqipëria ka shumë njerës të diturë që kanë kënduarë në Elladhë e në Evropë, edhe duanë të shkruajnë vivlia Shqip, po nuk' e dinë Shqipenë mirë, sepse Shqipeja është më e gjërë dhe më e thellë se Gërqishteja, që flitetë sot: këta njerës të diturë presënë të shtypetë leksikoja e Shqipesë, që të mësojënë mirë gjuhën' e Shqipesë, edhe të zën' e të shkruajnë gjithë çëfarë vivliash shqip, përandaj thashë përpara, se zunë të ngrehënë shtëpi pa vënë më përpara themeli.

Desha t' u flas juve shumë fjalë, edhe t' u shkruanj juve për shumë punëra, sepse unë jam i rrahur' e i djegur' e i pjekur' e fort i stërviturë në punët të shqipesë, edhe kam njëzet viet, që po shkruanj gjithënjë gjuhën e Shqipesë, edhe kam shtypurë përmbi njëzet copë vivlia shqip gegërisht e toskërisht, po s' janë fjalë që të shkruhenë të gjitha në kartë, në paça fat të vinj në Bukuresht, atëherë dot' ua them gojë me gojë.

Përmbi gjithë këto, sido të jetë puna, ashtu qoftë, neve këtu në Shqipërit kemi dëgjuar' e kemi marrë vesh se Shoqëria e Shqipesë që qe ngrehurë në Bukuresht, sot gjëndetë ndarë dyshë, edhe çë kanë gjajtur' e çë kanë koditur' e çë kanë bërë ndër vëllezërit, se si, e se qysh, të tëra i kemi kupëtuar' e i kemi dëgjuar' e i kemi marë vesh, edhe e dimë se janë ngrehurë dy shoqëri në Bukuresht, njëra quhetë *Dritë* e tietëra *Dituri*, edhe e dimë se njëra shoqëri vete kundër Shoqërisë tiatërë, edhe e dimë se *Dituria* do të shkruhenë vivlia me Alfavitën' e Jano Vretosë që janë gjysëmat' e shkronjavet Gërqisht, e gjysëmatë Llatinisht, edhe duanë që të hapënë skolira ndëpër gjithë Shqipërinë nga Shqipëtarëtë vetëmë, e të mos përzihetë tietërë komp mb' ato: po shoqëria e *Dritësë* do të shkruhenë vivlia shqip me Alfavitënë Llatinisht, edhe duanë që të hapenë skolira shqip në Shqipërit me anë të Rumunëvet e me ndihmë të Vllehëvet. Ndë më pyetshi mua, unë pëlqej më fort Alfavitënë llatinisht, sepse me atë Alfavitë munt të shtypenë vivlia shqip kudo, sepse gjëndenë mbë çëdo vënt që të kërkojsh, edhe është një Alfavitë i kuptuar' e i njohurë nga të tërë kombet' e Evro-

pësë, po ndë dashtë njeri të shtypë ndonjë vivlí Shqip me Alfavitën' e Jano Vretosë, nuk i gjen ato shkronja as mbë ndonjë vënt, po gjan të derthnjë shkronja të ra, e të prishnjë dy tre qint lira t' arta ; edhe ajo që do Shoqëria e *Dritësë* të hapenë skolira në Shqipërit me anë të Rumunëvet e me ndihmë të Vllehëvet, nukë më duketë se është keq për Shqipëtarëtë, sepse Shqipëtarëtë vetëmë s' munt të hapënë skolira, përveç kësaj Vllehëtë s' kanë ndonjë sy të lik, a ndonjë mendie të keqe për Shqipëtarëtë, sikundër kanë Grekëtë që duanë të pushtojn' e të urdhërojënë Shqipërinë, po edhe ndë paçinë Vllehëtë një të tillë mendie s' munt ta nzierënë mbë krye, as s' munt ta benjënë dot, sepse kanë ndë mest Bullgarin' e Maqedhoninë, që ndan Rumaninë nga Shqipëria, përandaj s' kam ndonjë frikë nga Rumunëtë, sa kam nga Grekëtë që janë fëqinjë me Shqipërinë, edhe po përpiqenë me nat' e me ditë qysh t' i bënjënë për vete.

. . . .

. . . .

Po e mbyll brënda në kartët adresënë t' ime qysh të më shkruani, edhe të ma dërgoni kartënë me ënë të Trieshtësë nga Austria me udhë të hekurit edhe m' u përgjigji pa mënuarë kohënë që poqe për t' ardhurë ndë Bukuresht, të bënem gati e të vinj e ndë mos, të më shkruani shpejt, që të vështronj punën t' ime.

Të falem me shëndet e të përqafonj vëllazërisht. U falem me shëndet gjithë vëllezëret që gjëndenë në Bukuresht.

Un' i dashuri miku juaj
Kostantin Kristoforidhi
Elbasanasi

SIMON SHUTERIQI

4. — PJETËR ZARISHI (fillim i shek. XIX.)

a) Jeta e Veprat

Ky nxânës i Kolegjës së Propagandës në Romë, doktuer i mâ vonëshëm në theologjí e në filozofí dhe mësues shqipeje i kardinal Mezzofanti-t në ket kryeqytet, leu në Blinisht të Zadrimës. Mbassi ndêi për disa kohë si Sekretár i Ipeshkvit të Zadrimës, u emnue prej Selís së Shêjtë Abat në Mirditë. Ky shkrimtár i fillimit të Shekullit XIX âsht nji nga punëtorët mâ të herëshëm t' asaj krahine e, bashkë me Leonard de Martinin, thomi se janë punëtorët e parë të vjershës së rregullshme në Gegní e të vargjeve të shum-farëshme, të pá-njoftuna deri m' atëherë ndër letrat shqipe. Sikur do të mundet me u pá nga punimet e tija, të botueme e të komentueme pjesësisht në ketë rasë, shtjellimi i lândës së poezívet të Zarishit nuk ka qenë gjithkund fetár e se, b. fj. kânga e shtëpís së Gjomarkajvet, ajo e Shebes e ndonji tjetër, jânë krejt originale a vetëm prodhim i fantazís së tij. Thuhet se sikur Abat i Mirditës i u vû punës në përpilimin e njij fjalori në gjuhë t' onë e të njij gramatike, vepra të cilat mbassi mbetën në dorëshkrime deri vonë, në nji pjesë edhe humbën, si b. fj. fjalori e gramatika e tij. Shkrimtarët e kohës si Dora d' Istria, e cila shkroi mbi Zarishin në *Revista Europea* të vj. 1872, vjershtori shkodranë Zef Jubani apo Zefi i Ndokillís [1]) n'*Osservatore Triestino* të vjetit 1872 e Leonard de Martini në veprën e botueme në Venedik në vjetin 1881 «*L' arpa d' un Italo-Albanese*», shkruejnë me radhë mbí ket humbje të veprave të Zarishit e mbí nji dorëshkrim vjershash të cilat De Martini i muer përsipri t' i rregullojë e t' i shtypë. Nga mâ të vonëshmit qi shkruen mbi Zarishin kujtojmë,

---

1) Mbi Zef Jubanin ase Zef Ndokillijaj (1871) do të flitet veçanisht në ket libër, në ketë kaptinë të prodhimit letrar përpara Lidhjes së Prizrendit.

përveç franceskanit Justin Rrotës, i cili nisi t' a shtypi veprën, edhe Zef Skiro-in 1).

Shkrimtarët e mbípërmendun Dora d' Istria e Jubani lajmojnë botën letrare t' asaj kohe se, nën drejtimin e De Martinit, të përkëthyeme italisht e të komentueme prej tij vjershat e Zarisbit do të dilshin në dritë mbrenda njij kohe së shkurtën.

Por vepra e Zarishit endè nuk u botue, mbas të gjitha këtyne pritjevet, nga De Martini. Dorëshkrimi i këtij 14 faqesh, bashkë me atê të Zarishit 96 faqesh, sot ndodhen në Bibliothekën Françeskane të Shkodrës. De Martini vetë e mâ vonë *Hylli i Dritës* (Shtatuer 1936 fq. 429) na difton se në vijim të punimit, Prenk Bibdoda, i cili n' atë kohë ndodhej në Stamboll i mërguem (në 1872-73) i a kërkon dorëshkrimin e Zarishit. Për nji farë «metempsyhoze letrare», shkruen mâ vonë plot me zêmrim De Martini, dorëshkrimi i Zarishit prej Prenk Bibdodës kaloi ndër duer t' Abatit të Mirditës Doçit, i cili nuk bâni kurgjâ, por *taliter qualiter* i a këthei dorëshkrimin Prenk Bibdodës e ky i a dha për botim në 1914 drejtimit të *Hyllit të Dritës*. *Hylli* në Kallnduer të vj. 1914 (fq. 123) nisë botimin e dorëshkrimit: *Vjersha të Don Pjetër Zarishit* tue i përcjellë ndër sa tjera edhe me ket shenjim :«.... Në të Përkohëshme t' onë, prá mâ së pari janë tue dalë në dritë vjershat e Zarishit, qi kanë nji randësí për Historí të letërsís së gjuhës shqipe».

Në ket botim *Hylli i Dritës* nuk i u përmbajt rendit të vjershavet në dorëshkrim. Kangët ndjekin ket rend : I) *Bylbylit;* II) *Kanga e Shebes;* III) *Iste confessor* (përkthim) fq. 123-125 ; IV) *Derës së Gjomarkut* (I. II.) fq. 319.322. Me mbylljen e *Hyllit* në Korrik të vj. 1914 vjershat e Zarishit mbesin të pabo-

1) *Ky në veprën* Della lingua Albanese e della sua letteratura, *botue në vjetorin e Institutit linduer të Napullit në 1918 e rishtypë ke* Studi Albanesi *(Rome, vol. II, 1932 fq. 74-127), veprës së Zarishit i a kushton disa radhë, të cilat i shohim të nevojshme me i prû në ketë rasë : «Ma sebbene non iscarseggino affatto di voci straniere*, specialmente turche, *tuttavía sono destinate a fare una profonda impressione, allorché verranno stampate* le robuste poesie e le magnifiche traduzioni di Mr. D. Pietro Zarishi *da Blinishti nella Zadrima, il quale fu alunno del Collegio di Propaganda nel 1837, etj.»*

tueme deri me Shtatorin e vjetit 1936. Për tre numra me radhë *Hylli i Dritës* i vj. 1936 (Shtatuer-Nanduer), e vijon pjesësisht punën e fillueme.

Në botimin e *Hyllit të Dritës* të vj. 1936 dorëshkrimi mêrr rendin e vet të natyrëshëm si ke Zarishi (96 faqesh) ashtu edhe ke pjesa e vogël e përshkrueme prej De Martinit (14 faqesh). Kângët e botueme në ketë rasë, përveç atyne qi u përmenden, janë: *Të vërteta morale* (a t' amshueme), *krijimi i rruzullimit* (gjithsejt njimbëdhetë). Për nji dijeni sa mâ të plotë të landës së dorëshkrimit të Zarishit po kujtojmë përmbledhtas rendin e kângvet të tija: Vijojnë tingëllime për nderimin e Bibdodës (fq. 29-34 e dorëshkrimit). Ndjekin dý tingllime tjera fq. 35-36 të njij lânde tjetër, për të vijue prap kângën mbi derën e Gjomarkut (prej fq. 37 të doreshkrimit): «*Nji Derë paska gjith Arbnija*». Këtu kemi 15 strofa apo tubëza katërshe gjasëramjeje së ndërlikueme (alternative). Ketë pjesë dorëshkrimi fq. 37 deri ke fq. 40, botue në *Hyll të Dritës* 1914, e kemi ndër vjersha tetëshe të matuna mirë. Tue nisë prej faqes 41 — pjesa e pá botueme deri tash, — gjithnji ndër tubëza katërshe, në vjersha tetë-rrokshe me gjasëramje si të përparëshmet, levdohet Mirdita e shtëpijat e saja „*guri së dhênun*", këndohet veshja e Mirditasvet «*jashtë krenije*», squetsija apo si i thotë auktori „*veletija*" e burravet dhe e gráve të Mirditës e zêjet e tyne. Këndohet nji pjesë e lagjes qi del të luftojë e tjetra kah ruen gjân e gjallë (fq. 42 e dorëshkrimit.) Në fq. 43-46 vjen kânga: *Me të kuej dorë bylbyli kndueka*. Prej fq. 47 nisin disá tingllime përmbajtjeje fetare: mbi shën Pjetrin (47-48), përkthimi i kângëvet latine *Stabat Mater* (fq. 49-54), *Dies Irae*: „*Dita (e) gjygjit ditë idhnije*" (fq. 55-58 përfshise); *Deus tuorum* etc.: *Zòt, ushtarëve tu, qi bote* (fq. 59-60). Vijojnê disa vjersha 11 rrokshe të pá titull: „*Kur frymë e vnerëshme po mos t' a zatesin — Kur tallaze mizore t' a vallojnë* etj". Ndër faqet 63-64 vjen nji lyrikë e vogël: „*Haide, mot...*" pjesësisht po të njasaj përmbajtjeje së lyrikës së Brancatos: „*Aj fíll ujë...*"

Faqet 65-66, botue në *Hyll të Dritës* 1914: *Iste Confessor*, pêsë tubëzash safike, janë nji përkthim i kësaj kânge kishtare

latine. Faqet 67-68 përmbajnë nji përkthim të kangës latine: «*Ave, maris stella!*» fjalë qi nisin me vargun shqip 6-rrokesh:

„*Falem, detit drita!*"

Kjo kângë shqipe âsht e përbâme prej gjashtë tubëzash. Tue nisë me fq. 69 deri ke fq. 72 përfshîse, vijojnë disá tingllime, të cilat kishin për të mujtë të titullohen si mbas vargut të parë të çdo tingllimi. Bje fjala i pari nisë me vargun 11 rrokesh:

„*Ndjen veshi, syni shef, zêmra drejtohet*".

Vijojnë disa tingllime, tue theksue ndër to disa ngase apo tundime të njeriut, në frigë të bjeri ndër gabime. Përmbajtja e tyne âsht morale, por zgjedhja e disá fjalëvet nga ndonji herë t' i vret veshët.

Faqet 73-74 janë mâ fort provë të bâme prej Zarishit të shkruejë e t' a mbushi me qortime, sidomos fletën 73 të dorëshkrimit. Në fq. 75 vjen nji vjershë safike — *e para vjershë safike e letrarëve t' onë këndej Adriatikut.* Vjersha: „*O gloriosa Virginum*", e frymzimit fetár, nisë me vargjet shqipe 11-rrokshe të kumbueshme e të bukura:

O Virgjin Mrija (e) lume mbi gjith shoqe
Maje qíllës njitun yll e hanë i shtrove,
Díllin e mujte, rrezet si i a hoqe,
Taftin[1]) *e mblove.*

Mbas këtij hymni në fq. 76 të dorëshkrimit vjen nji kângë tetë-rrokshe: „*O m(b)i virgjinat e lumnueme*". Në vijim të dorëshkrimit (fq. 77) vijnë disá maksime ndër tubëza të shkurtëna dý, trí vargjesh. Kjo pjesë e maksimevet në dorëshkrim âsht plot me qortime e të prishuna e prandej leximi i tyne âsht përherë e mâ i vështirë; kështu të thomi edhe për faqen qi ndjekë (78). Fleta tjetër përmban dý ttngllime, përmbajtjeje didaskalike. Edhe këtu vijojnë qortimet e Zarishit. Faqja 81 ká nji vjershë 8-rrokshe, gjithnji me qortime e të prishuna. Në fq. 82 vjen përkëthimi i hymnit kishtár latin: *Veni, Creator* etc:

---

1) *Taftin* — turq: fronin.

„Eja Shèjt, o shpirt krijimit etj“ pêsë tubëzash. Në fq. 83 kemi nji kângë trí tubëzash, nisë me vargun: *„Hajnin larg tuj neveritun“*. Në fq. 84 vijnë katërmbëdhetë distihash: *Te Deum laudamus: „Ty, Zot i naltë, t' levdojmë“*; faqja 85, tetë distihash nisë me vargun: *„për okolle gjith dylnjanit“* (i pesëmbëdheti distih). Faqja 86, nandë distihash, nisë me vargun: *„Por po t' lusim falna neve“*. Në fq. 87 vjen nji vjershë fetare trí tubëzash mbí J. Krishtin. Faqja 88 âsht e përbâme prej njij vjershe tetërrokshe katër tubëzash, nisë me vargun: *„Po diftona, ti shën Mrija“*. Kështu edhe fq. 89 ká të njajtat tubëza e të njajtën masë si faqja e përparëshme, këndue për nderim të shêjtit të cilit njeriu i bán êmnin. Faqja 90 pesë tubëzash katërshe, âsht si shumica e këtyne fletëve të fundit, plot me qortime. Faqja 91 nisë me vargun: *„Zoja shën Mri, nanë dashtnimit“* (katër distihash). Faqja 92 nisë me vargun: *«Rini prendvera qe rini»*. Faqja 93 nisë me fjalët: *„Shpërblen dita natës“*. Kanga e mbrame e fq. 94-96 âsht ajo e njij fisi të Mirditës: *Shebja*, e botueme prej Hyllit të Dritës në Kallnduer të vj. 1914 (vj. I. nr. 4 fq. 124-125).

Hylli i Dritës në rasën e vijimit të botimit të këtyne kangëvet, shkruen për nji pjesë të landës së këtij dorëshkrimi, për 11 tingllimet mbí krijimin e rruzullimit, se këtu vrehen sprovët mâ të parat e Zarishit për trajtimin e tingllimit klasik. Gjykimin e përfundon kështu: *„Këtu mendimet janë shprehë në nji gjuhë, për atë kohë mjaft të qortueme. Sikurse edhe fajit të kohës do t' i a pështesim turqizmet, tepër të randa për veshët t' onë sod“* (H. i Dr. 1936 nr. 9 fq. 430).

Nxânësi i Zarishit *Pjetër Dragusha* në nji biografí qi i bân letrarit në vjetin 1855, e paraqet Zarishin si nji njerí gjakxehtë apo nervoz. Ky njij heri si Sekretár e si Mësues i Seminarit të Nenshatit vjen në grindje me Ipeshkvin françeskan Gjergj Labella-n. I ndeshkuem prej Kongregacjonit të Romës, e kalon të gjith jetën ndër bjeshkë t' Oroshit. Lutjet e mâ vonëshme qi i u bân Kongregacjonit nga ana e disa vehtjeve të randësíshme për t' i a lehtësue fajin, nuk patën kurrfarë fryti. Kongregacjoni i Shejtë e emnoi vetëm Abat të Mirditës. Aty në

fillim qe në përpjekje miqsore me Kapidanat e Mirditës, për nderimin e të cilvet këndon dý kangë. Edhe me ta mâ vonë u zû. I ndjekun prej tyne u detyrue të jetojë në Kallmet, ku vdiq në 1866. Dragusha, nxânës i tij, shkruen për tê tue e levdue në nji mënyrë të posaçme dhuratën natyrore të fjalës së Zarishit. Difton se fuqija oratorike e tija ishte kaq e madhe, sa qi ndigjuesit nga ndonji herë, të mallëngjyem nga fuqija e fjalës së tij, derdhshin lot.

b) Derës së Gjomarkut *)

(*Dorëshkr. i Zarishit fq. 29, botimi i Hyllit të Dritës 1914, fq. 320*)

N' at gjí gurit emnuem prej qershijet
Me shum hyner 1) saraje po qindrojnë ;
Rreth e rreth qesin rreze bukurijet :
Habitun jesin sŷt kah t' i shikjojnë.

Gjak i zgjedhun e me nâm prej moçmijet
Ditt e veta me dyzen 2) mund i shkojnë :
Zoti e goditka me gjithnduer ganijet 3),
Edhe për hyqëm 4) Pêsë Bajrakë i shtrojnë.

Larg të pámit malet rreth s' ja 5) lankan ;
Po larg e njofkan Kralat e Sulltani,
E, prej magbullit 6) erz, nishán i dhankan.

---

*) Në ket botim copash të zgjedhuna nga vepra e *Zarishit* Vjersha, kemi para sysh, përveç botimit të parë të kësaj kânge në të përk. *Hylli i Dritës* (Korrik 1914 fq. 321), pranë tij edhe dorëshkrimin original të Zarishit, (sot në Bibl. Franç. të Shkodrës), si edhe për kangë tjera nji pjesë të vogël (14 fq.) përshkrue nga L. De Martini. 1) *Hylli* shkruen *hyjner*. Fjal. i Bashkimit në fq. 164 shkruen: *Hyner*-i, turq. = *Përdhânë*, *ciltí*, attributo, dote ; 2) turq. për *gëzim* ; 3) turq. *ganillek e gani* Bashk. *Plotní*, *abbondanza* (fq. 120) mund të thuhet mâ drejtë : *me të gjitha të mirat* ; 4) turq. për : *sundim*, *pushtet*; 5) *Hylli i D.* 1914 (fq. 321) *s' po lankan*, ndërsá në dorëshk. lexojmë : *s' ja.....* ; 6) turq. : *pëlqimit*.

U përpiqka (m') pushkë e shpatë si luâni ;
Prej azganllikut 7) Kapidan i thankan
Me aferim 8) për gjith ânësh i rridhka zâni.

* * *

Turku Shqyptarín qyshse (e) ka zaptue 9)
Shqyptare ogjaqe bit se 10) kan shafitun 11)
Tetë jânë, o nandë faqesh 12) tuj zabitnue 13)
Dera e jote, o Kapidan, veç 14) â rritun. 15)

Gjith me t' mirë t' (t') Parvet rreshti t' ka lulzue,
Erz e gjâ (e) dije pa'n boll me raditun,
E nâmin oxhakís me (e) themelue,
Urtís gjurmat e trimnís tuj skalitun 16).

Q' ashtu, Bibë, m' krah baftit ti ndaj bîne,
E larg t' Parvet pá masë ystin e shtove,
E vilatit bazretin 17) ja përtrîne.

Ti njimend ndermjet territ dritë e vetun,
Ti lule ndermjet dimnit na 18) qindrove :
Tý t' paçim, se m' tý shpresa e jonë ka metun !

---

7) turq. *krenarí, mburrje* ; 8) turq. *të lumtë! të qoftë pırolla !* por kjo fjalë turqishte e njohtun aq mirë në të folun të popullit, përdoret nga nji herë edhe në veprat e tashme letrare. B. fj. në «Lahutën e Malcís :» «*Aferim ! tha Palokë Gjoka*» ; 9) turq. *zotnue, pushtue* ; 10) e përdorun edhe sot në Mirditë: *bân se, të thuejsh, po thuejse, gadi ;* 11) ital. *calmare ;* 12) ke *Hylli i D.* (fq. 321), me ndryshim nga fq. 30 e dorëshkr., lexohet :... o nandë *faqe se tuj zabitnue* ; 13) turq. *sundue ;* 14) Hylli : *xeç* ; 15) n'original vargu âsht kështu : «*Dera jote, Kapidan, veç â rritun*» ; 16) *skalitun*, fjalë greqishte e përdorun edhe në të folun t' Elbasanit për të dhênun në gúr. Nji kësi punimi në drû quhet *thadrim.* Fjal. e B. e të Cord. qesin vetëm êmnin *thadër :* nji farë teske së ngushtë me dy tefa, njênin si çdo teskë e tjetrin si daltë (fq. 472). Leotti ká edhe verbin : *thadronj :* scolpire ; *Hylli* ket verb *skalitun* e shkruen : *shkellitun ;* 17) turq. *të pámt, fytyrën* ; 18) n' original të Zar. gjithkund : *nda.*

c) Nji derë paska gjith Arbnija

(Dorëshkr. i Zarishit fq. 37, botimi i Hyllit të Dritës 1914, fq. 319).

Nji Derë paska gjith Arbnija
Derë oxhake 1) vaku 2) s' hershëm :
E Gjomarkut janë Nipnija,
Asht Bib' Doda trim i ndershëm.

Ndë 3) çifleqe të vilatit 4)
Mâ i lum kush se ti nuk gjindet;
M' kamë tu' t' ndêjun larg itatit 5)
Për t' madh t' ândin gjithkush bindet 6).

Kúr lazem 7) të bân ushtrija,
Rrebshëm 8) fort e njeshke shpatën :
Mames n' prêh'n u dridhka fmija,
Gjithkahë t' shkelish reshë krajatën 9).

Kúr në paqë m' a paske vêndin,
T' duerve 10) t' (t') Parvet man usullin :
Hak 11) vorfnimit bân kuvêndin,
Ndaj tý paja s' ká magbullin 12).

---

1) Turq. Fjal. i Bashk. fq. 310 bjen edhe adjekt. *oxhaklli* për ital.: *nobile*, fisnik, bujár, derës së parë. Për *oxhak* Bashk. bjen fjalët shqipe: *corâni*, *shtëpi fisnike, derë e parë;* 2) turq. *vakt*, = për: *kohë, mot*; 3) rregullisht Zar. e shkruen për *në;* 4) turq.: vilajet, provincë turke. Pjesëtim administrativ i perandorís otomane si krahinë a prefekturë; 5) turq. *nderim*; 6) çuditet; 7) turq. *nevoja*. Populli i ynë njef thânëjen: *nevoja s' ka gjygj*. 8) në dorëshkrim të Zarishit (fq. 37) âsht kështu, ndërsá H. i Dr. 1914 fq. 319 shkruen *krebshëm*; 9) *krajatë-a*, ital. *sventura*, synonim: *e zezë* (Cord. Diz. it.-alb. fq. 83); 10) H. i Dr. (fq. 319) e ka: *të kremve* e tj. Mbi sa qortime të dorëshkrimit të Zarishit e lexuem në ketë mënyrë. Edhe sot kemi thânëjen: *ky njerí âsht dore s' onë*. Kuptimi në versjonin t' onë duhet të dali kështu: *ti mban rregullën* (osullin apo usullin) *trashigue prej fisi apo prej duerve të të parvet;* 11) turq. Këtu *e drejtë* apo *arsye*. *Ndaj* (d. m. th. *prandej*) për ket arsye nuk të pelqen me mbajtë *paje* a krah. Emnin *usull* Leotti në Diz. fq. 1561 e zhvillon me fjalën italishte *condizione*. Kjo fjalë së paku kah veriu i Shqipnís, as nuk mund t' i

Larg e nget 13) ushtimën toka
Qet prej nâmit qi më paska ;
Vijnë Nishânet troka-troka 14)
And prej 15) Kralash shum i raska. 16)

Mbreti dhénat sá pó i shtrote,
I Bibës erzi nalt shikjohet ;
Kush Mierditën 17) s' e trazote
Osull rishtas mrend' s' i këndohet 18).

Krala 19) motit. kishim 20) trima ;
M (b) etne e vejë m' ato Arbnija 21) :
Hajde t' këndojmë plima-plima 22)
Kthei me Bibën 'nde kralnija.

---

afritet në kuptim. Ndër shkrimtarët mâ të përmendunt të Shqipnís, ka kuptimin e emnavet *ligjë*, *rregull*. B. fj. Gjergj Fishta thotë në prrallën e kandëshme *Dijsia : «I preu petkat ndër terzi.- me ka 'i pllambë e mâ tehrí ; - S' ka pasë dalë usulli i' rí»*. Për t' a kuptuem mâ mirë ket varg të mbramë të Fishtës do dijtë se në kohë të zotnimit otoman në Shqipní, nji Komisjon i Shkodrës ka pasë caktue, si mbas gjendjes shoqnore, disá *ligjë a rregulla* se ç' prikë a ç'pajë do të sjellin nuset e sesi mbas *usullit* - sa pllambë tehrí do të kishin veshjet kombtare t' asaj kohe. Në rasa shkeljeje të këtyne *usullevet*, Komisjoni për ndeshkim i pritte me gërshânë këto veshje kombtare gjithmonë shum të kushtueshme ; 12) turq.: *pelqim* ; 13) pranë ; 14) *troke-ja* (Cord. Diz. alb.-ital. fq. 226) : *la campanella delle pecore*. Kuptimi : Nishanat e dhânun prej mbretënvet të hijeshojnë krahnorin edhe napin nji tingllim si të lingavet të vogla kah ti hecë ; 15) botimi i Hyllit të Dritës fq. 319 : *And prej* etj. Në dorëshkr. në fillim të vargut âsht shkrue e prishë adj. *gjith* e mbí tê shkrue *and prej* : 16) këtu kjo trajtë habitore e këtij verbi ka kuptimin qi i ep fjalori i *Bashkimit*, përpiluesi kryesuer i të cilit Dodë Koleci rat kujdesin të grumbullojë sidomos edhe kuptimet e së folmes së Mirditës. Prá kuptimi i këtij verbi âsht *me grumbullue* (Bashk. fq. 377) ; *i rraska i grumbullueka* ; 17) *Mierditën* për *Mirditën* apo *Mirëditën*, trajtë e randësishme për gramatikën historike të gjuhës s' onë. Mierdita = *Merdita* (në të folun të kësaj krahine) e *Mirëdita* në gjuhë shkrimi ; 18) kuptimi, jo aq i kjartë, âsht ky : *Mirëdita gëzonte pavarësi, nuk e trazonte qeverija otomane as nuk i detyronte këtij vêndi malcuer ligjë të reja.* Kanuni i Lekës ishte fuqiplotë. Verbi *me këndue*, si mbas frazash, ka *nuanca* kuptimi. Thuhet b. fj.: akcilit i këndojnë ket smundje : 19) me ndryshim nga dorëshkr. i Zar. (fq. 39), H. i Dr. (fq. 319) boton : *krah* motit ; 20) H. i Dr. : *kishin* ; 21) edhe këtu Hylli i Dr. 1914 (fq. 319) përshkruen nji varg të pá-; kuptim, tue i vû vetë botuesi nji pikë pyetjeje : «*Met e vejë, met*... (?) *Arbnija*» Kuptimi duhet të jetë ky : Dikur kishim trima mbretën (krajla), si b. fj. Skandërbeun ; por me mbarimin e tyne Arbnija pá këta mbretën mbeti e vejë 22) palë e palë.

Mblodh Mierditën Kapidâni ;
Çon nji fjalë 23) e rend 24) Kabashi,
(M') taborr mbledhun, viket zâni 25)
Hasmit mrendë, o djelm, i rashi ! 26)

Me terr tokën nâta mshili
Dyndën, nisën, turrshim 27) çojnë ;
Vetë Bib' Doda karejfili
Prin asqerit, t' a trimnojnë. 28)

Ç' keni, Luras, bjeshkatare,
Qi po i bâni me gjak faqet ?
Kapidani nda 29) i xuer fare
Ofshe 30) ! gjân e gjallë, e rraqet !

Për gjith vend e vûkan pritën ;
Janë konaqe t' hallakata ;
Kúr po kndojnë gjelat dritën,
Kërset pushka, vrinkllo(n) shpata 31).

Dalin 32) trimat, llakorë 33) ndjekin :
Armët përzihen, me gjak lahen ;
Shoqi-shoqin e përpjekin ;
Metë t' dý lagjesh trimat kjahen.

---

23) ke H. i Dr. (fq. 320) *çon fjalë ;* na i shtuem num. *nji* si mbas doreshk. fq. 39 ; 24) H. i Dr. : *e rredh Kabashi.* Na duket se në doreshkrimin e Zar. âsht *rend.* Kuptimi i këtij verbi âsht ai i jugut të Shqipnís edhe në trajtë, ndërsá ke shkrimtarët e veriut njifet verbi tjetër : *rrân* — nget, vrapon ; 25) n' original fq. 39 : «*Ndë taborr vikatte zâni*». Po n' at vend me nji ngjyrë tjetër (shkrue sigurisht mâ vonë), âsht shtue : ,,*Taborr mbledhun viket zâni*". Për t' a kuptue mâ mirë tekstin shtuem ndër kllapa *(m')* ; 26) Zarishi herën e parë shkruen : ,,H a s m i t a l l a m (b) rend' i rashi !" mandej e qorton po n' at mënyrë si e ka H. i Dr, (fq. 320) ; 27) Hylli i Dr. shkruen *turrthin. Turrshim* = me turr, si na duket se e ká doreshkr., përdoret po në ketë trajtë ke fjal. i Bashkimit (fq. 170) *për turrshëm*, ital. : *impetuosamente ;* 28) e intereresantshme âsht kjo tubzë me u këqyrë me ndryshime të bâme n' original prej vetë Zarishit : ,,*Me terr tokën mshili nâta — Dend ushtrija turrshim shkojnë : — Kërset pushka vrinkllo(n) shpata — Gjelat ditën kúr po këndojnë*". 29) na ; 30) H. i Dr. *Ofshê ;* 31) Krahasoni-je me shenimin 28 të kësaj kange ; 32) Hylli (fq. 320) boton : *Duelen ;* 33) Këtu në doreshkrim âsht shtue emni : *hasmin*, turq. për *anmikun.* 34) Në

Ky rrenim 34) e pat lazêmin :
Luras Kolën vrá na kishin.
Erz me lypë e mbledhkan gjêmin.
Erz pá marrun s' pán ku rrishin.

At-herë qiellja ndërmjet hîni,
Disí 35) t' keqen me shafitun;
Shí e krisëm e përtrîni
Ndoshta 36) pezmin me (t') pá-di(j)tun 37).

Gjithnduerësh hypi kaq ushtima
Pezull malet 38) dhén lodrojnë ;
Për kjahmet u muer trishtima
Nderi Ndândshejt, ku pushojnë·

FILIP FISHTA

---

5. — EJELL RADOJA (1862)

a) Jetëshkrimi

Qe edhe ky prift shkodranë, lé në vjetin 1820 e vdekë në vj. 1880, nji asi nxânsish së Kolegjës së Propagandës qi mâ fort se kurrkush punuen për gjuhë e kulturë të vendit t' onë.

Famullitár i qytetit të Shkodrës e Vikár i Përgjithshëm i djeqezit, dijti me ia gjá e ndoshta edhe me ia dalë krye-ipeshkvit të vet, t' Emz. Karlit Pooten, përkah rrebtsija e pápërkulun në dishiplinë kishtare e në të mprojtun të bestarvet të vet kundrejt qeverís anadollake. Prandej edhe thonë se — shka nuk ishte punë e rrallë n' ato kohë — qe helmatisë. Duel për t' u shëndoshë në Venedik, por gjâ s' i vlefti e atý vdiq në moshë endè të mirë pêsëdhetedyvjeçare.

---

doreshkr. të Zar. âsht — po në ket kuptim *rendím*. Zarishi shkruen *nda* për *na*, *r* e *rr* nga nji herë nuk e dallon mirë. Ndryshimi mâ i kuptueshëm në gjuhe shkrimi âsht bâ prej Hyllit të Dr.: *rrenim* ; 35) Mbí adv. *ndoshta*, prishë prej vetë Zarishit, âsht vû adv. *disí* ; 36) Hylli i Dr.: *Ndo se* ; 37) Pjesët e vûme ndër kllapa i shtuem për nji kuptim mâ të drejtë. *Hylli* n' at doreshkrim mjaft t' errët boton: „*Ndo se pezmin me paditun*" (fq. 320); 38) Në veshtrim të fytyrëshëm për malcorët.

Shkodra mbarë n' atë rasë diftoi nji nderim të jashtzakonshëm si për çdo njeri mâ të madh, ashtu edhe për nji prift të fjeshtë. Kúr mrrîjti në qytet lajmi i vdekjes, u mbyllën tregtoret katholike të mbarë tregut e gjith popullsija rrâni në salikime të madhnueshme në kishë kathedrale.

Kishte qênë njeri shum zelltár, si për fé ashtu për atdhé; ai qe ndër shkastarë mâ të mëdhaj t' atyne shkollave të para qi u hapën për popull pranë shtëpís famullitare, e vetë s' pritonte me i dhânë mësim moshës së njomë; e mësues e drejtuer qe edhe në Seminarin e Shkodrës përpara se të këtheheshin Jezuitët.

Me dy Jezuitët *Bruschi* e *Jungg*, italjanë, me françeskanin italo-shqiptár *De Martinin*, me tjerë françeskâj, me t' Emz. *Krasniqin*, me *P. Babbin*, me *Ndré Logorecin*, e me ndihmë të pámêshme të Propagandës përtrîni letërsín agjografike shkodrane. Trí vepra na kanë mbetë prej dore së tij: *Jezu Krishti në zêmër të meshtarit* (1862), e përkthimi i rí i tekstit të Konqilit I. krahinuer shqiptár me do shtesa *(Konqili i Dheut Shqypnís bâmun në vjetë 1703 në kohë të Papës Shqyptarit Klementit të Njimbëdhetit*, botue në Romë në 1872, por punue qýsh në 1867 1). Botoi edhe nji „*Dotrina e kërshtenë me msime e me spjegime*" (Shkodër, 1876), qi âsht i vetmi katekizëm i vjetër shqip origjinal e jo përkthim.

Stylin e ká të rrjedhshëm e krejt mbas natyrës së fjeshtë së shqipes popullore; din me i a gjá tekstit përkah madhnija e naltsija, por pá ndërlikime e pá errsí; edhe kur ia shef gjasën me lânë servilitetin e përkthimit për të shtî ndonji frazë shqipe të bukur e të gjallë, ase për të skjarue e për të fjeshtue perjudhën, nuk priton me e bâ; kështu qi përkthimi i tij lexohet me shum andje; mjerisht, si koha, iu duk elegancë me e lulzue shqipen e vet me fjalë turqishte të tingllueshme.

Kështu me arsye vj. 1873, kundrejt do kritikave qi i kishin qênë bâ përkthimit të tij, mund i shkruente t' Emz. Pootenit: „Shkëlqesa e Juej më vête fáj se Konqilin e Arbënit nuk e

1) Kqyr f. 61 të këtij vllimi, ku flitet për përkthimin e parë të këtij libri.

përktheva *ad litteram*. Përkthimi *ad litteram* për kêdo âsht punë qi s' bâhet. Pak libra kanë dalë në gjuhë shqipe; por n'u rrijshim fjalvet të t' Emz. Krasniqit, t' A. Bruschi-t e të tjervet qi mend kanë e me mend flasin, asnji libër shqip nuk ká dalë në dritë shkrue mâ bukur se përkthimi i im".

b) Nga „Konqili i Dheut Shqypnís"

Kënduesit mikut dashtunit

Jetë të gjatë e shëndet prei Zotit

Fort i Ndritshmi e i Ndershmi Zotní Karlo Pooten, Arqipeshkëv i Tivarit e i Shkodrës, m' a vûni në qafë „ketë barrë të randë" me sjellë në gjuhë tonë Konqilin e Dheut të Shqypnís, ashtu me i këthye shqip disa „Emernáme" [1]) të Papës Benedetit të Katermbdhetit, e të Kuvendit Shêjtë të Propagandës, tui më bâ me dijtë me letër shkruem prei Tivarit, qi aj m' a vûni „ketë barrë të randë": besa e randë m' u bâ; jo pse dojshe me i ikë mundit e mërzís, ndò pse pritojshe, o frigoheshe me shkrue Shqyp (mirë a keq ti me urtí t'ande ké me gjikue); por pse, sikúr mirë e din tine vet, gjuha e jonë tui kênë e vorfen, sidomos në hesape [2]) të Fés, e në punë të holla, drojshe, qi mos t'i trazoj vesht e Shqyptarve të mij, të cillët janë msue hêm me këndue, hêm me shkrue mâ shpesh në gjuhë të jabanxhívet; e kështû kishe frigë, qi mos të biret mundi êm, si krypa nd' uj. Nonse kishe mbî shpinë kujdesin e këtij Dioqezit lanun mue në besë gadi tamam për nji vjetë; nonsè kishe mbí krye kujtimin e kësaj Famullí, të cillës gadi dhetë vjet po i shërbej me krah të dashtunve shokve të mí, tui i pasë shërbye përparandej për pêsë vjet porsi i parë, e Mjeshtër Kolegjës Xhakojvet: gjenè me qéf, e me gazmend i hina kësajë punë, qi më kjè porositë, të cillën me ndimë të Madhit Zot edhè e mbarova.

---

1) *emername-ja* — turq., dekret.
2) *hasap-i* — turq., llogarí, punë.

Po të kalxoj të drejtën, o miku i êm i dashtun, qi tui shkrue Shqyp, shum herë si tundim më vîte nepër mend ky soj mendimit: „ká m' u gjetë ndokush ndër Arbnorë, qi nuk ká për t'a pëlqye ketë punën t' ême"; por ça mendojshe me vetvedi, se me ja bâ vullëndetin Kuvendit të Propagandës, e Arqipeshkvit të Shkodrës, e me vijtë mbë ndonji farë mënyret kësajë së dashtunes Shqypní, i urti s' thotë kurr se âsht múnd i tretun, e mot i bjerrun: atëherë zemra e jême shëndoshej, e paqohej, e trimnoheshe mos m' u mërzitë tui shkrue, si dò, në gjuhë tonë, edhè pse kjo ndër disá sende fort kollaj nuk përgjegj Latines.

Nuk të thom, se në ketë Librë shkrue mjeshtrisht prei Vinçenc Zmajevikut Arqipeshkvit të Tivarit, këndohen fjalë të moçme, e të zgjedhuna: besa une, si flasim shqypen në Shkodrë, ashtû me të paktën forcë t'êmen jam mundue me shkrue, tuj çalltisë, 3) nderi 4) kû kam mujtë, m' u shporrë fjalve të gjuhvet të hujavet, e tuj bâ gajret edhè, qi fjalët qi këndohen këtû, të jénë marrun vesht prej Shqyptarit të soçëm. Mue, si Shkodran, e mâ fort si Meshtár, më thérë zêmra me diftue mârren tonë, qi na gjuhën e kena lânë per nji gjâ të harrueme (belda 5) edhè faj shum s'kena pasë për punë të zâmanevet 6) të vshtira, e per mungim të gajretit 7); këndej shum fjalë të moçme na kanë hupë, e na duhet disa fjalë me i marrë uhá (mjaft zí) prej gjuhve të jabanxhívet, pá të cilat, na Shkodranët sidomos s' kena çajre, e derman 8); qynqi 9), domosdo, janë bâ bidát 10) ndër né.

---

3) *çalltisë (me)* — m' u mundue, m' u rrekë, m' u rropatë, m'u kujdesë.

4) *nderi* — deri, ndjer.

5) *beldà* — turq., ndoshta.

6) *zaman-i* — turq., stinë, kohë.

7) *gajret-i*, turq., zemër, trimní, qindresë.

8) *çajre-ja*, turk., mjekim, mjet, shpëtim; *derman-i*, turq., po me atë kuptim si „çajre", por të dysharitunit (qi ndiehet edhè sot në gojë të popullit) i jep fuqì mâ të madhe shprehjes.

9) *qynqi* turq., mbassì, qyshë se (me kuptim shkaku).

10) *bidàt-i* turq., taksë e ré, zakon i rí, zakon qi tashmâ mirë a keq ká mbetë.

E për punë të fryit 11), qi mundet m' u xjerrë kahë âna e shpirtit prei këndimit të këtí Librit, une kujtoj qi i urti e merr-vesht prei vetvedit. Konqili i Dheut të Shqypnís, qi duel prej djersve t'Ipeshkvijve Shqyptarve Babave t' onë, qi, bashkë me meshtarë, e mbajtne nder të vshtira e mundime të panjehuna Fén e Krishtit n' Arbëní, âsht porsì nji qíri ndezun në dorë tonë, me të cilin, tui i njoftë na varrët e kësaj së vorfnës Shqypní, mundena, ndihmue prej hirit Tenzot, me e njallë për-sërí, me ndritë, e me ja nkëthye námin e hershëm. Kjo mirë lypet prej nesh, qi ja duem, e ja dishrojmë erzin, e lumnín. Papa i Romës Benedetti i Katermbëdheti, i cilli mbas Papet Shqyptarit Klementit të Njimbëdhetit i ká dijtë nevojët tona (si-kursè na i kanë dijtë edhè Papët tjerë, e sidomos i soçmi Pio i Nandi), mbassi e pat vû-orôe mirë Konqilin tonë, fort e lav-doi në Ferman të vet „Inter Omnigenas", e me pushtet Apos-tolik urdhnoi m' u mbajtë unjî prei nesh. Na do t'i dijmë edhè Emernámet, qi janë bâ për dhé tonë: këto prej Romet na kanë ardhë; e dihet mirëfillit, qi msimet e Romës, tui kênë kjo shty-la e mjeshtra e së vërtetës, janë të dlira.

Dote Zoti i mshírshëm, qi kjo e dashtun Shqypní (uh! tepër vorfnue e mjera prej gjindësh të sagllamshëm! 12) të lul-zojnë 13) me dije, me urtí, me dashtní, me shêjtní, e me tjera të mira, e gjith mbarë të dishmojnë Fén e vertetë, qi e pat dishmue në kohë të Skandërbegut, qi kjè drita e lumnija e jonë.

Ti, o miku êm i dashtun, në gjetsh gjâ në ketë Librë, qi nuk të pëlqehet në hak 14) të gjuhës, më fal e më ndîj. Menden t' a çila, zêmrën t' a zblova. Tjetër s' kam shka me të thânë,

---

11) *fryjt* — frytit.

12) *sagllamshëm (i)* — i fuqishëm.

13) *të lulzojnë* — të lulzojë; trajtë shkodrane, solecizëm tue përdorë shum-sin në vend të njêjsit.

14) *në hak* — turq., e drejtë; këtu: punë.

veç se une lus Zotin për tý, qi me të ruejtë për mot të gjatë, e me na dhânë forcë me bâ mirë në ketë jetë abollà 15) të shoqnohena në Rregjiní të Parrizit.

Në Shkodër me 10 dit në Maj 1867. 16)

D. ENJËLL RADOJA
(Cameriere d' Onore di Sua Santità 17)

Zef Valentini

---

6. — LEONARD DE MARTINI (1868)

a) Jetëshkrimi e veprimtarija e tij kulturore-shoqnore

Ky Arbnesh leu në Greci të Puljes kah vjeti 1830. Mbassi veshi petkun e të Vobegtit t' Asizit, vijoi studimet pregatitore për misjonet françeskane përjashta si nxânës i Kolegjës së Shën Bartholomeut n' Isola 1).

Në vjetin 1865 erdhi për herën e parë në Shqipní të veriut me detyrë misjonare. T' a përmendim veprimtarín e tij të flakët t' afër dyzetë vjetvet an' e kand nepër Shqipní, âsht nji për nji si t' ishim tue përmbledhun nji pjesë të randësishme të historís së Françeskanvet ndër né.

De Martini qe nji nga bâtorët (faktorët) besnikë të rimkambjes politike edhe shoqnore t' atdheut të të parvet e nji ndër flamurtarët e bashkëpunimit të përzêmërt me Italí. Qe ndjekësi i politikës së Françesk Crispi-t, të këtij njeriu të shtetit i cili, si na e njofton edhe Petrotta, e nderoi De Martinin në nji mënyrë të posaçme 2).

---

15) *abollà* — qi

16) *me 10 dit në maj* — kjo âsht trajtë e bukur popullore fjesht shqipe.

17) ket titull nderi pat D. Ejlli.

Vên ré. sidomos shprehjet e dashtnís për Shqipní e zellin për gjuhën kombtare, sidomos në nji kohë kúr pak kush mendonte për to, e kúr nji auktorit qi jetonte në Shqipní i lypej guxim për të folë këso dore; nuk âsht çudí qi Turqit t' a kén pasë mëní priftin atdhetár e të ia kén bâ vorrin.

1) *P. Marcellino da Civezza*, auktori i veprës «Storia Universale delle Missioni francescane», na njofton mbí ketë gjâ në *Cronaca*, ku botoi edhe dy tingllime të De Martinit; 2) *P. G. Petrotta* në «Popolo, Lingua e Letteratura Albanese» fq. 289.

Vepra e tij fetare e kombtare u përkrah në nji kohë nga dy themelues të Shkollës së Motravet Stigmatine të Shkodrës, misjonarë françeskanë: Gjampjeri prej Bergamo-s, pro-prefekt apostolik i Françeskanve të Shkodrës e nga pro-prefekti apostolik i Epirit Bernardini prej Portogruaro-s. Në qe se për Gjampjeri-n në të përkohëshmen e Firencës *Stella Cattolica* e në fletoren *Osservatore Romano* u shkrue se qe: *„... il benemerito iniziatore delle scuole feminili in Albania“*, - për De Martinin mund të shtohet se qe udhëzuesi i vajzavet shqiptare n' atdhén t' onë kah rruga e artit e e përparimit të vërtetë. Po theksojmë disá rasa në lidhje me ket pohim.

Në historín e dramës së përshpirtëshme e të dramës baritore në Shqipní, De Martini qe mâ i hershmi qi përpiloi nji këso veprash 3). Natën e Krishtlindjes së vjetit 1880 u çfaq në Shkollën popullore të Françeskanvet të Shkodrës nji dramë e tija. Këtê De Rada e çmoi si nji vepër „plot me të vërteta e natyrësí 4)“.

Kujdesi i De Martinit si krijues e rregullues i shkollavet popullore mashkullore e femnore të Shqipnís, përmendet edhe në historín e vjetve të para të themelimit të Shkollës Françeskane të Shkodrës (vj. 1861), atëherë Shkollë Fillore e Qytetse, si edhe në vijimin e veprimit të Shkollës Femnore Françeskane të Shkodrës. Prej njij botimi italisht të kohës: *Stigmatimet në Shqipní* (shtypë mâ vonë edhe ke fq. 159-164 e *Arpës* së De Martinit), shofim përmbledhtas nji shtjellim të fillesës së kësaj Shkolle. Ardhja e Stigmatinevet në Shqipní nga Firenca, ku qe vendi i studimevet të të bijavet shqiptare për pêsë vjet, bjen piknisht me 2 të Qershorit 1879. Në jetën e veprimtarís së programit françeskan: *Për Atme e Fé*, përmbí të gjitha me botimet shqipe ndër fletë fluturuese e ndër akademí shkollore, De Martini vijoi të mbajë ndezë zemrat e rinís shqiptare. Poeti i ynë Kombtar e kujton me evarí ket veprim në nji nga vargjet e veprës melodramatike: *Shqyptarja e qytetnueme*: 5)

---

3) Këq. *F. Fishta*: Anthologjí Shqipe vëll. II fq. 165; 4) këq. *De Rada* Antologia Albanese fq. 74. 5) Kangë melodramatike; çfaqë e botue në rasë të pêsdhetëvjetores së të ndërtuemit të Shkollës së Stigmatinevet në Shkodër.

Zana e Madhe

...Tash ndër mend po m' bjen, oj zojë,
Se disa ndër këta Fretën,
Qi n' Shqypní kushtue kan vetën
Fés e Atdheut, na njoftë i kina
Edhe m' brej, aha e çetina,
T' Helikon's nepër rudina,
Kthellt' me lvore tu' i zgavrrue,
Emnat na u a kemi shkrue,
Qi n' harres' kurr mos me u qitë.

Ora e Shqypnís

E vërtetë. Malit tu' u njitë,
Kam pá shkrue m' trup t' nji blîni :
AT LEONARDIN DE MARTINI :
Emni i atij në zâ vjershtarit,
Qi me shkrue nisi má s' parit
Kângë në t' amblën gjûh' t' Shqyptarit;
E qi i pari pat guximin,
N' shkrim Europ's m' i a lshue kushtrimin
Kundra dhun's e pádrejtsís,
Qi po i bâhej Shqyptarís,
Tue e lân' nën zgjedh' t' Turkís.

Shkolla Femnore Françeskane gjeti nji pritje aq të përzemërt nga të tre elementat e Shkodrës. Veprimtarís s' udhëzuesvet kah përparimi, — në radhën e parë De Martinit, — kësaj veprimtarije do t' i dihet ngjallja e interesimit të bujarëvet shkodranë, të cilët nuk prituen me i lëshue ndër duer t' Emzot Karl Pooten-it, shumën e bukur *të dymbëdhetë mijë frangavet,* — tue u bâ në ketë rasë pionerë t' arsimit shqiptar. Pranë motravet italjane, dý motra shqiptare : Marjana Gera e Konçeta Kurti, mbasi bléjnë shtëpín e njij plake të Shkodrës, njohtë nën emnin „Shtëpija e Koprraces", hapin mâ të parën Shkollë Femnore

me rende e program të caktuem. De Martini përpiqet të mbajë mbë kambë lidhnín shpirtnore ndërmjet të njij shkrimtares së shqueme të gjakut t' onë Dorës d' Istria e të vajzavet shqiptare të shkollës së mbípërmendun. Fletoret e të përkohëshmet e kohës na njoftojnë se si De Martini i dërgoi, n' emnin e të bijavet shqiptare, Elenës Gjika (njohtë në botën e letravet si Dora d' Istria), nji pêndë të çmueshme, në punim filigrani, përcjellë me përshndetjet mâ të përzemërtat për ket letrare, nderë e kombit t' onë. Vjersha e shkrueme italisht, mbaronte me këto vargje :

«E un picciol dono, in ver ; ma fa palese
Quanto t' ama e ti cole ogni albanese». 1)

Shërbimi i De Martinit nuk u kufizue vetëm në naltësimin kulturuer të fêmnës shqiptare. Mbassi i u vû me nji kujdes të jashtëzakonshëm nxânëjes së kthelltë të gegnishtes, tue u marrë kryesisht me njoftjen e dhialektit të Shkodrës, — la mbas dore dhialektin e përparshëm italo-shqiptar. Detyrët e tija për do kohë janë, përveç Shkodre, diocezet e Zadrimës e të Lezhjes. Tue u ndodhë në përpjekje të pá-dáme në këto rasa me popullin t'onë e tue shërbyem për do kohë si mësues e si sekretár i Princit të Mirditës, pat rasën me i u vû të nxânunit të gjûhës së popullit.

b) Veprimtarija letrare e kryevepra e tij «Arpa»

Monastiri françeskan i Troshanit, — ky tempull arsimi e qendër e zhvillimit shpirtnuer të sa shkrimtarëve shqiptarë nga Urdhni i Shën Françeskut, — bâhet për disa vjet qendër e tija letrare. Së paku nji pjesë e mirë e prodhimevet të tija letrare janë të shkrueme në Troshan. I a nisi përkthimit të lyrikëvet italjanë. Kështu mâ vonë, me nji fryt të madh erdhi tue shtje-

---

1) *Tingllimi* «për nderim» ishte i datuem prej Shkodre, me 2 të Prillit 1881. Vijojshin treqind nënshkrime nxânsesh shqiptare.

llue në nji mënyrë mâ të zgjedhun e të rrjedhëshme subjekta letrarë, punue si mbas qellimeve t'artit të vërtetë. Në 1868 përkëthen vjershën e T. Grossi-t: *Vaji i hapses*, tue i a kushtue Dorës d' Istria. Nji mot mâ vonë vijon ushtrimin e vështír të përkthimevet t' auktorëvet italjanë, në nji gjuhë deri atëherë të pá-lavrueme. Përkthimi i nji pjese të *Hymneve të përshpirtshme* të Manzoni-t (Këshndellat), âsht i njij mjeshtrije së rrallë e edhe sot, kúr gjuha âsht në shkallë mâ të zhvillueme, disa përkthime shqipe të De Martinit kishin për të mujtë me zânë nji vend të mirë në grumbullin e përkthimevet të zgjedhuna. (Le të vlejnë si shembull fq. 337-347 t'*Arpës*). Në 1869 De Martini botoi parafrazin e *At' ynës* e të *Falemi Mris* e *Dekalogun*. Në 1875 përkthei shqip tubëzat e Metastasio-s mbí «*Via Crucis*». Këtij përkthimi i paraprîni nji kushtim i t' êmz. Pjetër Severini-t, të cilin Lekë Gruda (Luigj Gurakuqi) në veprën *Vargënimi në gjûhë shqipe* (fq. 119) e bjen si të vetmin shembull të njij «tingllimi me bisht» qi njifet në gjuhë shqipe. Edhe sot mbas afër 70 vjeç, kúr De Martini si sekretár i Pjetër Severinit i a kushtonte ket tingllim bashkë me përkthimin e veprëzës së Metastasio-s, mund të shijohet për bukurí qi ndrŷn në vetvedi:

Tingllim-Shtojcë

Mâ e madhja dit' mot.motit prap e mrrini,
Gjith hije e gjith gazmend po vjen ndër né;
I nalti Zot dórën e vet na shtrîni,
U zdrip prej qiellit Fjala e u duk mbí dhé.
Leu Nieri, i shkret' e i vogël si kërthini,
Nierin prej *zaptit* (t') ferrit me shpërblé:
Oh t'lumtit na [2]) qi jetën na përtrîni,
Mjer kush s'i din të mirat e [3]) ksaj Fé!
Aq ditë me shêj â kjo, qi s'kam harrue
T'parin zakon m' i a falun Severinit,
Qi na vorfnoi . . . massi ka dek' e shkue!

2) Kështu ke botimi i L. Grudës, ndërsa ke *Arpa*: . . . *lumtë na*; 3) mbas L. Grudës, ndërsa ke Arpa: *të ksaj* e tj.

Po i miri nuk des kurr, as kurr s'harrohet;
E prá n' Zadrim', se t' rrjedhe vala e Drinit,
Do t' lypet, do t' përmendet, do t' vajtohet!
Prandej mue máll po m' çohet
E tý n' Parrîs s' po kam çka me t' fatue,
Veç se nji kang' sot m' epet me t' kushtue.
Ket kâng' qi e kam ndërtue
Përmbi ket Djal' qi né na bje Shelbimin 1),
Hatroje, o i lum: se kjo përmênd Mundimin 2),
Bilé 3) kalzon Dashtnimin,
Qi bâni t' Bir' n e Zotit me u mishue
E për mkatnorët me dek' mbi kryq gozhdue!
At bejt' përditë tuj kndue
Arbnori i kshtên', mâ mir' me Fé forcohet,
Me Fé jeton, anì m' at jet' lumnohet.

Në vjetin 1881 i fali letërsís s' onë nji libër të çmueshëm 442 faqesh. Vepra e botueme në Venedik, (në shtypshkrojën e Ancora-s), prî nga vargjet italishte: *„non mi arrise una sorte più lieta — a cantar più sublime canzon"*, u quejt: *L'ARPA d' un italo-albanese.* Aty u përmblodh gadi mbarë prodhimi i tij letrar e politik. Vepra âsht e ndáme në dý pjesë. Pjesa italishte 174 faqesh, përveç diftojsit, përmban poezí të ndryshme të hartueme prej tij në ketë gjuhë. Nji pjesë e mirë e këtyne kangëvet italishte janë të rasës edhe vlejnë me na dhânë ndonji dritë njoftimesh se cili qe rrethi i tij i shkëlqyeshëm i njerzvet qi ai desht e nderoi. Me nji hov lyrik të ndieshëm nji «brindisi sveliarino» i drejton vllaut t' urdhnit Giampieri-t, përmend parandej, tubëzat safike plot enthuzjazëm:

E' bello, è divino convivere insieme,
Uniti e concordi diversi fratelli!
I giorni nudriti d' amore e di speme
Son giorni piu' belli.

---

1) Shpëtimin; 2) mundimin e J. Krishtit; 3) për mâ tepër.

Tue e ndie vehten të grishun me i vleftë atdheut të dashtun, të cilit i fali n' atë kohë të parë, ndoshta kângët mâ të hovshmet e mâ të bukurat, i këndon këtij apostulli të zgjimit të femnës në Shqipní:

Il vincol d' amore ci stringa piu' forte,
Magnanimi e ardenti corriamo l' agone;
In meglio volgiamo l' Albanica sorte
E' nostra missione.

E De Martini në ket luftë vehten e ndien të pá-lodhun tue kqyrë me i nzitë vëllazënt kah zgjimi e jeta, tue pasë si rreze shprese kujtimin e Fatosit të dikurshëm ndër né:

Seguiamo l' Eroe d' un giorno si bello
Ei duce ne incita nell' arduo cammino:
E avranne Albania, qual astro novello,
Novello destino.

Lyrikat e tija sentimentale i përcjellë nji fllad i ambël i njij pranvere letrare të bukur. Mbí kufomën apo metin e njij bije, nepër gojën e njij nane së mjerueme, De Martini lëshon lulet e bukura të kujtimit e të përmallimit të mbarë Shkodrës, e shtangueme prej asaj vdekjeje (fq. 60). Tue marrë si landë rrethet e qytetit të Shkodrës ke rrapi i Zef Zorbës, nepër nji melodí orjentale na bâhet si t' ishim tue ndigjuem ndonji nga ato lyrikat e bukura e plot lyrizëm të Viktor Hugo-it.

Duket si mos të donte me e harrue n' *Arpë* të veten as mâ të voglën gjurmë të njij zgjimi kulturuer të Shkodrës. Prap e shofim De Martinin, ndjekësin e këtij veprimi përparimtár tue këndue me arpë të vetën për nderimin e drejtorit të parë të Kolegjës e të Konviktit Saverjan të Shkodrës, drejtue prej etenvet Jezuitë.

Dhanëtít e kujtimevet kombtare, si ajo e mikut të tij Bernardit, i cili i falë nji fytyrë të Skanderbeut, e shtŷn ket poet françeskan në nji akrostih të thrrasë zânën e vet edhe t' a bekojë bashkë me emnin e Shqiptarit të Madh dhe emnin e tij.

U bâni vend katër tingllimeve „të të riut epirotas *Orlando Penotimar*-it“, tue e mëshehë nën at *anagramë* [1]) emnin e vet: *P. Leonard MARTINO.* Kjo kunorë tingllimesh na çon mendjen ke kvadri i shkëlqyeshëm i Paolo Veronese-s, qi sot ndodhet në Palazzo Ducale të Venedikut — kujtim i çaseve mâ të vështira të rrethimit të parë të Shkodrës. De Martini gjên fjalë nzituese për vehte tue mos u vû vesh fjalëvet prozhmuese të botës e tue kqyrë të shkojë mbas shembullit të Poetit të hyjnueshëm: „*Non ti curar di lor, ma guarda e passa*“.

Dy dokumenta, dý letra të De Martinit, drejtue *kajmekamit* të Lezhes, janë nji ndriçim i njij flete së historís së ré të Shqipnís përpara çpalljes së pávarësís shqiptare. Fjala e tij, e drejtueme në nji kohë të vështirë të zotnimit otoman, qet në shesh karakterin e këtij Shqiptari të fortë, qi me vend e rasë din t' a shqiptojë si kush fjalën e vet t' auktoritetshëme, përcjellë me vrejtjet e njij njeriu qi din t' u flasë n' atë gjuhën e fortë edhe të mdhajvet (fq. 99-114) kundra ushtarëve të pádishiplinuem të Turkís.

Pjesa e dytë „*Bejta arbnore*“ nisë me tingllimet e *Ndue Bityqit*, këtij djali të Kosovës shqiptare, e me përgjigjen e De Martinit. Vijnë me radhë disa lyrika përmbajtjeje kristjane. Me to bâhen mâ të parat ushtrime të gjinivet të ndryshëme të kângëvet e të vargjevet. De Martini qe nji mjeshtër i rí i vargut të gjuhës s' onë edhe nuk kemi dyshim të pohojmë se u bâ shkollë për nxânsit e tij të shkëlqyeshëm si për Auktorın e Lahutës së Malcís e tjerë. Aty n' ato lyrika t' Arpës së De Martinit kemi nji visár mendimesh të zgjedhuna, plot njomsí pranverore, shembuj të bukur shprehjesh në gjuhë arbnore nepër pendën e këtij krijuesi të vërtetë të njij gjuhe poetike në letërsín e shkrueme të Shqipnís së veriut. Ndër fletët e Arpës kemi edhe nji mbledhje, për mos me thânë nji grumbull ushtrimesh të mira, krejt të mira të tubëzave e të masavet metrike të shumfarëshme, të cilat edhe nga pikëpamja teknike i afrohen përsosmenís. Shumica e tyne âsht e vjetvet 1869-73.

---

1) *Anagramë:* shndrrim i germavet të njij êmni: Bje fjala anagrama e *Lazër Shantojës* âsht *Athanas Ziler.*

Prî prej fjalës s' artë latine : „*Post nubila Phoebus*", ky poet i rilindjes kombtare prej Shkodre (në vjetin 1877) përshëndetë tetë Shqiptarë qi shkojnë në Firencë me veshë petkun e të Vorfnit t' Asizit „sikur Shqiptarët e motit". Mbas tubëzave të njij kânge lyrike në ketë rasë, ndjekin dý vargjet e përkëthesës :

«Po gazmohet Shqyptarija,
Përse prap i vjen lumnija!»

De Martini në vijim këndon nji varg hymnesh originale edhe të përkthyeme. Disa nga këto hymne, mbas njij gjysme qindvjeti e mâ, këndohen edhe sot aty këtu nepër Shqipní ndër sa rasa apo kremtime. Nga këto kemi edhe disa përkëthime të poetënvet italjanë Parzanese e Manzoni, tue u bâ në ketë rasë provët e para të përkthimevet shqipe të këtyne shkrimtarëvet ndër kohë mâ të vonëshme. Mjeshtrija e De Martinit edhe sot, në këto lamije përkthimesh ruen nji vend të posaçëm. Edhe të soçëmt mund të nxanë shum nga ky artist i vërtetë i vargut t' onë. Nga latinishtja De Martini përkëtheu nji hymën në lavd të Nanës së Krishtit. (Nënshat 1878). Ky hymën i Marinonit i ep shkas shtypit t' Italís s' asaj kohe të shkruejë haptas për poetin shqiptár.

* * *

„*Nata e Këshnellavet*", si i thotë vetë auktori në nji shënim zhvillues t' Arpës (fq. 406), âsht drama e shêjtë e çfaqun nga nxanëset e Motravet Stigmatine të Shkodrës „*mutatis mutandis*". Kjo dramë e parë e kësaj gjinije në gjuhë t' onë, u botue ndër faqet 309-328 t' Arpës. Françeskani Giampieri, në nji letër drejtue auktorit (me 8-I-1881), bashkë me disa fjalë përgëzimi i diftoi përmbledhëtas përshtypjen qi i bâni në popull kjo çfaqje. Ndër sa tjera i shkroi : „Pata rasën të shof shum vetë tue qa n' at çfaqje". Në historín e shkollavet të Shqipnís, në lidhje me çfaqjet akademike e filodramatike në gjuhë shqipe e në gjuhën italishte përmenden lokalet e vogla të rregulltarëve të Shkodrës (prej 20-II-1779) Historija e theatrit në Shqipní, Shkodrës i lëshon rendin e parë. Në Kolegjen Saverjane kroniku i historís s' arsi-

mit në Shqipní, kujton shfaqjen e njij farse të *Cesari*-t; *„Macco“* (10-II-1880) e nji vepër dramatike të *Pashk Babbi-t* (përkthim nga italishtja:) *„I biri i çëfutit“* (19-II-1882). Mâ vonë në vj. 1890 saloni i bukur i Kolegjës Saverjane të Shkodrës, pajisë me skenarë të bukur nga piktori Fr. Moscheni e nga Piktori Kolë Idromenoja, së pari me çfaqje në gjuhën italishte e mâ vonë në gjuhë t' onë, vijoi rrugën e fillueme prej De Martinit. Mbas kësaj drame vijnë disa hymne originale e përkthime. Për *Këshnellat* e Manzoni-t, të përkthyeme „në gjuhën e Skanderbeut“ (janë fjalët e De Martinit), kushtue „Princit të Poetënvet Arbneshë Hjeronym De Radës“, nji prej lavruesvet të letravet Luigj Mazza, bâmirës i madh i arsimit të vendit t' onë, italjan për kombësí e njoftës i gjuhës shqipe, dha ket gjykim: „...Se il Manzoni ancora vivesse, non solo avrebbe a *regalarle di buone busse*, com' Ella dicea, ma anzi n' andrebbe lieto in veder trasportata in un linguaggio si difficile e con tanta fedeltà la sua ammirabile lirica“ (prej njij letre së tij të vj. 1878). Le të lexohet si provë nji tubëz e këtij kymni të njoftun në botën e letravet:

„Si gúr qi â shkep' prej kulmit
Njaj malit nalt me shkrepa
E shtŷn teposht' dërmorja,
E tuj platos' ndër thepa
Bân tokën me shungllue,
Vjen vrap tuj rrokullue,
Bjen malit n' fund e rri...“

* * *

„Kanga symbolike e vajit të Shqipnís“, përkthye në Troshan (me 8 të Gushtit 1868,) *Vaji i hapses* i Grossit, ribotue ke *Arpa* (fq. 352-357), nji përkthim i bâm mâ vonë edhe nga Nd. Mjedja, âsht tinglli vajtues i njij zâni të njij poeti, qi shkon tue ndjekun me dhimbje jetën e kombit të vet nepër vuejtjet e ndryshme. *Kanga llafexhore* e vjetit 1868 e *Zogu në kafaz të horrjatit*, e vjetit 1878, përcjellë me shenime të nevojshme, na zbulojnë karakterin e këtij françeskani. Motivet qi ky muer,

BKSH

u ripunuen edhe nga të tjerë. Poetënt e njoftun të letërsís së ré kombtare Ndré Mjedja, Gjergj Fishta e ndo 'i tjetër, pjesë pjesë: në varg, në mendime e në trajtë e kanë ndie ndikimin letrar të De Martinit i cili ka qenë mësues i tyne.

Pjesët e mbrame t' Arpës: *Pak prozë e shenime*, na bâjnë t' a njofim mâ mirë auktorin, ndonji fletë të historís së ré të Shqipnís e rrethin e De Martinit përgjithësisht.

Nji nga dishiret e tija kryesore qi e ka përcjellë gjatë veprimit letrar e politik, ka qenë: Pavarësija e Shqipnís. Ai dritën e vendit t' onë e lirín e tij e ká parapá nepër mjet rrugës së dijes. Me nji herë mbas korolarit të shenimit të mbramë (fq. 428) mbas tubzës italishte, me të cilën në përseritje e mbyllë vëllimin, tue lypë lëmoshën e të gjithvet për SHKOLLËN SHQIPTARE, — thotë me vargun e profetit (Isa. 5,13): „*Propterea captivus ductus est populus meus, quia non habuit scientiam*". Po ket ankim, shkruen De Martini, na e paraqet edhe Pjetër Bogdani para dyqindvjetash. Ky prîjs françeskan dritën e bardhë të Shqipnís e shef nepër arsim: me themelimin e njij Kolegje a Probandati Serafik të Troshanit, pranë njij bibliotheke e cila, tue pasë nji numër të mjaftueshëm librash, të mundet me kohë t' u shërbejë edhe instituteve tjera të Shqipnís.

Në vjetin 1896 botoi në Shkodër nji hartim poetik: *Arbënorve të kërshtênë, të Grishiun Festuer* e nji mot mâ vonë poemthin herojkomik: *Çashtja shqiptare-lindore e Kryqsata e ré*, ndá ndër trí pjesë.

Fantazija krijuese e De Martinit i bân të kandëshme e t' argtueshme vjershat e tija. Kemi ndër to at hov poetik e si drejtim letrár nji romantizëm të plotë, me njato trandje ngjyre kombtare, të cilat vijnë tue i ngrohun vargjet e tija e nepër të zemrat e lexuesvet. Për Shqipní në këto lamije qe pa dyshim shembulli i vjershtarëve t' onë të ríj, si nga pikëpamja teknike e vargut, si nga ajo e rythmit, e njasaj muzike së kandëshme, vetija kryesore e njij pjese së kangëve të De Martinit.

Shum vjet para vdekjeje pushoi së kënduemi tue i kalue në qetësí vjetët e mbramë në nji kuvend françeskan jo larg prej Napullit me 12 të Korrikut në vjetin 1923.

c) Nga prodhimi i De Martinit

1) Pater Noster

Tingllim (1869)

At' ynë e Zot qi n' qiell rri tuj sundue
Me dije e me pushtet gjithçka krijove,
Emn' i yt gjithkund, si duhet, kjoftë adhrue ;
Dërgona rregjinín qi na premtove.
U bâftë vullndesa e jote e pá-mbarueme,
Mbí dhé, si n' qiell u bâftë gjithçka urdhnove ;
Bukën qi korp e shpírt bân me jetue
Epna për ditë, e mos na lên ndër prove.
Fajet qi bâjm' përherë, ti o Zot, na i ndîje,
Na i fal *kusurat* [1]), me mishrier *resiti*, [2])
Si na po ndiejmë anmiqt qi na kan fye.
Larg nesh tundimat [3]) me dor' t' ande priti ;
Librona prej gjith s' keq e n' ket shkretie
Epna ti ndimë prej s' nalti, e mendt na ndriti.

2) A v e M a r i a

Falemi, o virgjin Mrí, o Vajzë fatmire !
Hír-plote, si me lule â plot prendvera ;
Zoti â me Tý ; ti jé békue e dlíre,
E zgjedhë ndër gjith grá tjera :
Ndër gjith grá tjera prej s' Tenzot shenjue
Njeri m' u veshë në krahnuer t' and t' kullue.
O Shêjtja Mrí, o Nana e Hyj't t' adhruem,
Lutu për né qi për gjith dit' gabojmë ;
Lute, sa t' jemi gjáll t' And-Bír t' Lumzuem.
E kúr ket jetë t' mbarojmë :
Kúr të mbarojmë ket jetë, o Shejtja Mrí,
Ket shpirt na merr, të gzojmë gjithmonë me tý.

---

1) *Kusurat* për fajet, pjesën tjetër të gabimevet ; 2) shlyeji ; 3) *tundimat* për tundimet, sikur *kusurat* (këq. shen. 1) për *kusuret*.

3) *Zogu në kafas* 1) *të Horrjatit* 2)

Apolog (1878)

Avaro autem nihil est scelestius.
ECCL. 10.9.

Uom peggior dell' avaro non v'è.
CANTO POP.

Çka ké, zog-o, qi rri idhun,
Çka ké, zog-o, qi s' këndon ?
— Jam ktu mbrend si qen i lidhun
Më kján zêmra e më loton.

. . .

Po m' shkon moti tuj gjimue,
Mjeri un se çka m' ká gjet !...
Jo, ktu s' mundem me këndue,
Se kam zêmrën kah pëlset.

. . .

Sado i bukur, sado i mirë
Ky kafas ndokuj i u duk,
Për zog t' malit â i vështirë,
Hahet helm mâ shum se buk.

. . .

Çka ké, zog-o, qi rri idhun,
Çka ké, zog-o, qi vajton ?
— Jam trí vjet si qên i lidhun,
Shpirti e jeta më lingon,

. . .

M' apin veç pak uj e mel,
Mel e uj me t' vogël mas ;
Si nji dit', nji tjetër del
Mâ s' po muj, jam kah pëlsas.

---

1) Ndër pjesë tjera e quen *kuvlí.*
2) *Horrjat,* fjalë turqishte për: *dorë-shtrêjtë, dorë-rrudhët.*

*
* *

Po t'm'i dhânken gjith të mirat,
Për ket zog kjoshin haram ;
Me m' i fal' gjith xhevahirat,
Nuk po i due, i· qes nën kâm'.

*
* *

Rásh në kurth' me tradhití,
Më kan zanë e shtî ktu mrên [3]) ;
E pa ndér e pa njerzí
Zoti i shpís më mba si qên.

*
* *

Mirë e kam! Mbassi e kam pamun
Nji zog tjetër qi pat hikë,
Qi pat hikë e shkoi tuj kjámun,
Un jam bâ me u pré me thikë.

*
* *

Tashti u rrêjsh e krejt gabova,
Gjith gabimin vetë e shof ;
Dikuj *hatrin* por ndigjova
E prej *hatrit* jam tuj cof'.

. . . .

4) Don Shtjefnit Masrekut — për ditën e emnit

Kangë Llafexhore [1])

(Kangë karakteristike e cila çekë nji zakon shqiptár)

Ti Don Shtjefën qi rri n' shkrep,
Me zahmet [2]) e me gazep [3]),
Shpejt nji Dash të mirë na rep.
Festën t' ande qi âsht sot
T' a gëzojshim për shium mot,
Raki e vên' si t' kemi plot.

---

3) *Mren* për trajtën e gjuhës së shkrimit: *mbrendë, mbrenda.*

1) Turq.: *llafexhuer, ore* — ital. *giocoso, ciarliero ;* 2) turq.: *zahmet — vështirësí, mund.* 3) *gazep-i*, turq.: *mundim.* Mbassi i a drejton fjalën njij do-

BKSH

Jé xhymert 4) e jé bujár,
Shyqyr 5) Zotit jé Shqyptár,
Erzin t' and kurr mos e dár. 6)
Pra mos t' dhimbet nji ferlik,
Për dashtní t' ka ardhë ky mik
Me t' bâ nderë e jo me t' fik'.
Si t' késh mish, vênë e rakí,
Mbrapa, ishalla, për dhuntí
Na çîon Zoti nji tepsí.
Na çion petlla e makarona ;
Edhe 'i bibë, ne kjoftë, e dona,
T' i mbarojm këto zakona.
Mbassi t' hámi, mbassi t' pími,
Mbí sexhadë pështetun rrimi,
Rrijm' tuj pí duhan sa t' kími.
Si âsht adeti n' Shqyptarí,
Këqyr shpatullan 7) ti qi dí,
T' na kalzoj' çka bân vakí 8).
Bashk' me mue mandej qindro,
Un' këndoj e ti këndo,
Si k'ndon zogu i veres-o.
Gjith ky qéf e ky dyzen'
Dit' e mot ka m' u përmêndë
Nepër turq e për t' kërshtênë.
Gajret prá... Pse fort priton?
Nuk po e shef se â tepër von' ?
Me marrë Dashin pse nuk çion ?

---

rështrêjti, sikur shifet prej frymës së kângës, doemos se detyra e Don Shtjefën Nënshatit t' a largojë prej vathit të vet nji Dash. (De Martini për tallje e shkruen me germë të madhe), âsht nji pësim për kët prift të famullís së Nënshatit. De Martini nuk priton në nji skicë në krye të kangës të na paraqesi vathin e priftit të Nënshatit, përcjellë me këto fjalë: *Vathi (i) Dom Shtjefnit Masrekut në maje të Shkrepit të Nënshatit.* 4) *Xhymert-i* turq. për *dorëdhanës.* Mbiêmni këtu âsht përdorun ironisht pranë mbiêmnit *bujâr ;* 5) *shyqyr Zotit*, turq. për — *falemi nderës Zotit ;* 6) Bardhi (1635) në fjaluer të vet: *me u bdár* — me hupë. Zadêja n' *Orën e Shqipnis këndon :* „Valle valle, shtojzovalle — mos na lêni né *me u dár*". 7) *Shpatullen.* Besëtytní popullore: nepërmjet shporevet e shpatullavet me e këndue t' ardhëshmen. Edhe n' Lah. e Malcis e vrejmë ket zakon: „*Kqyre al shpatull, Soko Tona*" ; 8) turq. *vakí*,ja — çdo të gjájë.

Ahi medèt qi t' kam levdue !
Tash po e shiof se kam gabue
Me vrá vehten jam pendue.
Ti prá s' kênke aspak bujár,
Por serráf e tahmaçiar,
T' kalzoj vet' qi jam Shqyptár.
Lavd e t' shiám t' i 9) bâna pshesh ;
Por, aman, mos m' u kërvesh, 10)
Sot me tý kam dasht' me kjèsh'.
Pse, ha-dreq, kjo pun' nuk bân,
Gjith at harxh dy vet' s' e hán
Ti' Nënshiát e un' Troshiân. 11)
Me pasë barkun si sanal, 12)
Jo m' kên' ujk qi rri në mal,
Ksaj davá âsht zor me i dal'.
I laç' prrallat s' âsht gjâ ndér
Me bâ gostën me teftér :
Veç po t' thom edhe nji hér :
Festën t' ande qi âsht sot
T' a gëzojshím për shium mot,
Me shëndet e pare plot. 13)
T' i çioft' Zoti gjith të mirat,
T' i largoft' gjith të vështirat ;
Ashtu paç, si t' késh dishirat.
Edhe t' falët njekaq békima, 14)
Kaq nafaka e kaq gëzima, 15)
Për sa t' zeza hjek Zadrima !...

---

9) *T' i bâna përshesh*, t' i përzjeva ; 10) thuhet mâ mirë : *kerlesh*. Në ketë trajtë e ka edhe Fjalori i Bashkimit (fq. 191) për ital. : *rabuffarsi*. Trajta të tjera të kësaj foljeje : *ngërleshem, ngërdheshem* (Bashk. 293) ; 11) trajta popullore të shkurtueme, aspak të mira për t' u ndjekë në gjuhë shkrimi. Jo pra : *Ti Nënshat*, por : ti *në* Nënshát e unë *në* Troshan ; 12) lirí poetike për : *sanall*. Edhe Gjergj Fishta në satyrën e Tartufit : „*Tartufi plak krye-tul e bark-sanall*". (Anz. e Parn.) 13) Vjershtori, kishim me e thânë me nji fjalë popullore se *e ká vû ata uj në zjarr* t' a nguci Don Shtjefnin, si shifet prej këtij urimi (këq. edhe shen. 8) ; 14) bekime ; 15) gëzime.

Tjetër gjâ s' dij me t' fatue ;
Sall Parrîzin kam harrue. [16]
Ti e di rrugën n' daç me shkue.
Borxhin [17] t' êm un' qe, e mbarova ;
Mir' o keq kët kângë t' a çiova ;
Tash po m' fal se të shiurdhova.

Në Troshian, 26 të Dhettuerit 1868.

FILIP FISHTA

---

7. — ZEF NDOKILLIJA (1871)

a) Jetëshkrimi

Lé në Shkodër rreth vj. 1818 prej shtëpije së parë të katundit të Jubanit (prandej njifej edhe me mbiemnin *Jubani)*, kreu do studime të mesme në Maltë e u bâ mandej „dragoman" i konsullatës frange të Shkodrës.

N' atë zyrë pat rasë me bashkëpunue me të përmendunin Konsull *Hecquard*-in, i cili, tue gatue librin e vet mbi Shqipnin veriore, interesohej mâ së forti për landën folkloristike, edhe bânte udhtime të shpeshta nepër Malsi, i shoqnuem prej Jubanit e prej Halil Koplikut. Për tê mblodh Zefi nji shumicë kangësh popullore, nga të cilat disa, të përkthyeme besnikisht gjinden në veprën e Hecquardit ; shumica i humbën, mjerisht, në të vershuem qi damtoi qytetin e Shkodrës në vjetin 1866. Tjerat i botoi në Trieshtë në vj. 1871 në librin e vet „*Raccolta di Canti Popolari e Rapsodie Albanesi*".

Libri, përveç përmbajtjes s' interesantshme, ka ndonji randsi përse âsht botuem me alfabet latin, mbas njij systemi të sajuem prej vetë auktorit ; përpara tij vetëm pak botime të A. L. de Martinit (në shtypshkrojën e Lloyd-it të Trieshtës) e ndonji librec i Propagandës kishin bâ ndonji këso provësh.

---

16) porosí ironike e dukëshme ; 17) detyrën.

Qe njeri shum zelltár për çashtjen kombtare, ndër mâ të parët të qarkut laik Shkodranë, e ndër mâ të parët mbledhsa shqiptarë të kangvet popullore, mbassi Thimi Mitko vetëm mbas shtatë vjetësh i botoi të vetat.

Vdiq Jubani në vjetin 1880. Nji jetëskkrim i përmallshëm i tij duel në vjetin 1920 në revistën shkodrane „*Agimi*" prej pende së njij zelltari të gjuhës, shoqit të tij, Mati Logorecit.

Muer pjesë edhe në redaktimin e vllimit përkujtimtar „*Gli Albanesi a Dora d' Istria*" qi Shqiptarët e evarshëm i kushtuen shkrimtares së famshme atdhetare.

b) Kangë

kushtue për Zonjën Dora d' Istria

begtaresha [1] prej fisi të Zotnive të Shqypënisë

Tin' [2] je nji yll, e na shndrit Arbënín,
Me dije, me t' mira, e me bukurí :
Me dashtnín t' ande je tui n' ([3]) përtërín
Nji gazmend të madh e nji lumëní.

Drita (e) mendes s' ate âsht tui lulësue,
Si drita (e) syvet tú âsht sjell' mbi ne.
Perendija për t' mir' t' on' t' ka krijue,
E me sjellun mbar' dhén t' on' ke le.

Ndër yjtë tinë pra je rregjinesha,
Qi ty Dora D' Istria t' emënojn.
Prei Shqypënijet je Begtaresha,
Qi gjithkund e këtune [4]) të nderojn.

---

1) *begtaresha :* vajzë beglerësh.
2) *tin' :* tine, ti.
3) *n'* = *na :* me leje poetike tepër të guxueme.
4) *këtune :* këtu.

Po, shpënesa e amël' je për né,
Pse zemra (e) jote ashtë fort e mirë.
Sjélli syt' tu, e mos harro ket dhé,
E t' késh edhe për né t' madh dëshirë.

Shkodër, në Fruer 1868.

Sepi 5) Ndokë (Antoni), Elis Jubani

ZEF VALENTINI

---

8. — NDUE BITYÇI (1874)

a) Jetëshkrimi

Lé në djecez të Shkupit me 8 Mars 1847, dymbëdhetë-vjeçár hŷni në Kolegjë Papnore Shqiptare porsá të themelueme në Shkodër, i treti nxânës qi pat ajo Kolegjë. Për dhetë vjetë i kreu me shkëlqim studimet e gjata kishtare e meshtár i rí 22 vjeç u kthye në vend të vet.

Prift zelltár e puntuer, famullitár e mësues shkolle në katër anët e arkidjecezit të hapët të Shkupit, prej Janjeve e deri në Shkup, shembull jete së ndershme meshtarake, nderim të madh kishte prej popullsije qi bânte bé në „*axhën Don Ndue*“ 1).

I shtitruem në Kolegjë Papnore me studime të mira klasike, njoftës i mirë i gjuhës, i pajuem me prirje poetike prej natyre, duel nji poet i çmuem e i papushue.

„Kalendari i Veprës Pijore“, tue e vû në radhë me shkrimtarët, bâmirsat e atdhetarët mâ në shênjë të vendit, kështu e gjikonte:

„D. Ndue Bityçi gjindet në rresht të poetënvet mâ të mdhaj qi e kanë begatë fort letërsín t' onë. Patër Leonard Martini shkruente për tê tash nj' a tridhetë vjetë: „Bityçi âsht nji ndër nxânës shqiptarë mâ t' aratisun, 2) të rritun në shkollë të Je-

---

5) *Sepi :* Josepi, Zefi.
1) „Axhë“ e quejnë priftin Kosovarët.
2) *I aratisun :* i punuem, i livruem. *eruditus*, i shtitruem.

zuitve të Shkodrës; poet i çmueshëm qi genín e bukur të véten i a kushtoi nderimit të Muzavet amtare, sidomos mbas të dukunit të të parave poezíve të mija. Poezínat origjinale e të përkthyeme të qituna deri tash prej Bityçit kishin për të bâ nji blê të trashë... ndër këta ká edhè nji vepër të gjatë, në vjersha shqiptare «*Psalmet e Davidit*»... Shijimi poetik qi gjindet te ky shkrimtar âsht fort i knaqshëm, e kishte për t' u lypë qi *Vepra Pijore* t' i dalë në krye dishirit e zellit qi ká, me i mbledhë krejt e me i botue vjerrshat e këtij poeti kosovar, pse kishin për të qenë pasuní e vërtetë e letërsís s' onë".

Edhè ai së pari ndoq prirjen e kohës tue „e stolisë" gjuhën e vet me fjalë turqishte, por mâ vonë muer pjesë në fushatën puriste të shkrimtarvet gegë, kështu qi poezít e tija të vjetvet të fundit nuk dallohen fort prej gjuhe së shkrimtarvet modernë.

Vdiq n' atë vjetë të vajtueshme 1917 qi letërsís shqipe i pat rrembye atë livrues tjetër të madh t' Imz. Prengë Doçin. Pasunín e vet e fali zêmergjânë për Misjonin Shetitës Shqiptár qi shkonte tue përtrî moralitetin e tue pajtue gjaqe nepër krahina të Shqipnís.

Prift i rí tue qênë në famullí të Pejës, kishte fillue me njoftë të vlertit 3) e At Leonard de Martinit qi tash 40 vjet qitte endè shqip poezí fort të çmueme. Për me i bâ zêmër (pse e dijnte se edhè për ketë ndihmë kanë nevojë shkrimtarët e ríj) e për m' u përgzue me tê, i a çoi prej atij qyteti ket tingllim:

„Ç' far' zâni a kyne qi n' Troshan tuj nisun
U hap në Shkodër, n' Përzerend, e mrrîni
Deri n' Pej' 4) t' egër, e në zêmër m' hîni
Me mekam 5) t' ambël t' fjalve n' kangë ujdisun?

3) *Të vlertit:* vlerën, vleftën.

4) *T' egër:* adjektiv gjeografikisht e historikisht i përshtatun për bukurí: Peja âsht e rrethueme prej malesh t' ashpra tepër, edhe në shekullin XVIII qe votra e beglervet të rrebët të derës së Begollejvet (të quejtun edhe Pejollë) qi sunduen krahina të hapta në Shqipní veriore deri në Shkodër.

5) *Mekam:* melodí.

Kush mujti giûhën në harres' t' braktisun
N' rybe [6]) me e rritë kaq fort? e kush e mshîni
Marren prej neve, qi der sot na grîni.
E na pat lânun në terrin' t' batisun? [7])

Ti, o Leonardo; zâni i yt po ndihet
Porsi bylbyli qi këndon n' prendvére
Kùr soset dimni, e aklli e bora shkrîhet.

Zânin prá çoje qi e ké nis' kaq mbarë,
Bylbyl i rí; tý kan' Shqyptar't me t' ndérë [8])
Ndër bejtaxhít [9]) bejtaxhí má i párë.

Në Pejë 1874.

E At Leonardi tue mbajtun mjeshtrisht fjalët e mbrâme a bashkërámet e këtyne vjershavet, kështu prej Troshanit i përgjegjte bylbylit të Kosovës:

Falemi nder's Bityq! Por sá kam *nisun*,
A thue se aty njimend zâni i êm [10]) e *mrrîni*,
E kângës s' shkret' tingllima [11]) athue se t' *hîni*
Bash zêmrën me t' gazmue [12]) e me *t' ujdisun?*

---

6) *Rybe:* shkallë e naltë.

7) *Batisë* (me): me farue, me rrênue. N' ato kohna idhnimi e turpi mâ i madhi i atdhetarvet shqiptarë, sidomos kundrejt të huejvet, ishte ky qi mos me pasë nji letërsí të veten, kaq sa në Kongres të Berlinit, kundrejt lutjevet e protestavet të Shqiptarvet mâ se nji herë u ndie ai kundërshtim: po çfarë kombi â ky qi s' ká as gjuhë të shkrueme as letërsi të veten? Prandej çdo Shqiptár i mirë ndiente atëherë nji farë miradieje së thellë për ata qi gjuhën e lavrojshin me letërsí: ky âsht edhe nji ndër meritime mâ të mëdhá qi do t' u njifet shkrimtarvet italo-shqiptarë, sidomos De Radës e De Martinit, qi me vepra të veta, të njoftuna edhe ndër të huej, ato moskuptime filluen me i davarítë.

8) *Me të nderë:* me të nderue; v. o. se verbat e nxjerrun prej emnash me anë të zânores thematike „*ue*", janë mâ të vonshëm, ndërsá motit përbâheshin mâ fjeshtsisht pá zânore thematike, sikurse në ketë shembull.

9) *Bejtaxhí:* vjerrshtár; rroken e gjatë *xhit*, lexoje si dy rroke.

10) *Zâni i êm:* bâhet elizjon (tepër i vështír) ndërmjet trí zânoreve *i í e.*

11) *E kângës së shkretë tingllima* — ndërto: tingllima e kangës së shkretë.

12) *Gazmue* — trirrokshe: gaz-mu-e.

Dojshem, por s' muj, arbnorën giuh' t' *braktisun*
M' e njall' me shpirt ; se ashtu, si trim qi *e mshîni*
Berrin n' goj' t' ujkut qi e pat vjedhë e *e grîni*,
Kishin me pshtue dhén t' onë aq fort t' *batisun !*

Por zâni i êm, qi i përvajtueshim *ndihet*
Posì bylbyli qi gjimon n' *prêndvérë*,
Njaj Knduesit t' fort, si ti, qi n' kang' po *shkrîhet*

Zêmrën barè kesh 13) t'nxejn ; oh 14) at' her' gjith *mbarë*
Shqypnija e ngrat' kishte m' u nkthye me *ndérë*,
Kishte me i ardh' prap nami e rybja *e parë*.

Në Troshan 1874.

b) Nga prodhimi i Bityqit

1) Aladros Spanjolit *)

tingllim

Para kan' lumnat me bâ rrug' përpjetë 1)
Zjermi me lagun, ujnat kan' me terë,
Me lshue terr dielli, me zdrit' 2) toka e shkretë, 3)
Me lulzue dimni, me resh' bora n' verë.

---

13) *Kesh :* kish.

14) *Oh* : „h" âsht shkrue vetëm për arsyena orthografike, por nuk shqiptohet, kështu qi mund të bâhet elizjon „o-at".

*) Ishte ky Aladro Kastriota, ish-ambashator familje bujare spanjolle të lidhun me Katriotajt me anë martese ; gjatë lëvizjeve të Rilindjes Shqiptare desht me bâ për vehte Fronin e Shqipnís edhe pat nji partí mjaft të fortë e të gjânë ; porse, më si duket, ndër antarë të tij disá synojshin mâ së forti fitimin vehtjak. Kundra kësish e ká poeti. Tingllimi i parë âsht nji shembull hartimi letrár asish qi në gjuhë të hueja — e sidomos n' italishten — gjinden mjaft shum, por në letërsín shqipe àsht i vetmi ; âsht i punuem me mjeshtrí të madhe, ashtu qi gjith ai varg të del shum i kandshëm e i gjallë.

1) *Me bâ rrugë përpjetë* : me ecun ; thân'je konkrete e prandej letrarisht e bukur, pse e shijshme e e gjallë.

2) *Zdritë :* shndritë.

3) *Me zdritë toka e shkretë :* vre kundërshtimin e bukur ndërmjet verbit „*me zdritë*" e adjektivit „*e shkretë*".

Pá krih' 4) kan' njerzit me flutrue të létë,
E shpêndt m' u ngrehun rrshân' në pluhën 5) t'mjerë,
Ujku me kînjin bashk' me ndêjun pshtetë, 6)
E n' dét baktija, peshqit n' fush' të blerë.

Se tine 7), Aladro, kû kujton me mrrî,
Të Skanderbegut me përtrîmun taftin 8),
E mbret m' u bâmun, o Spanjol, n' Shqypní.

Shporru ksaj mendje, n' mos daç fik' me mbetën ; 9)
Lypin për vedi do tradhtuesa baftin,
E rreth të siellen me ta thith' kuletën.

2) *Gjujtarit të parevet*

tingllim

Hapshëm langoni, por tuk pat hetue
(E kan' langonat hundën t' holl' për erë)
Qi 10) kishte mujtun pare mir' me gjue,
E lshoi shpejt vrapin, me mrrî për nji herë.

E qet t' lig 11) vedin : „Heqim 12), thot', po due",
(Heqim me i shndoshun kulet' zezën t' shtjerrë)
Tui rrit' rrezikun n' mos t' ish shpejt shikjue 13)
Për kshtu m' e mbluemun ndjetin t' zí me nderë 14).

---

4) *Krih* : krahë.
5) *Pluhën* : pluhun
6) *Me ndêjun pshtetë* : it. „*seduti*" ; idyl i bukur pak fjalësh.
7) *Tine* : ti.
8) *Taftin* : selí, fron.
9) *Me mbetën* : me mbetun.
10) *Qi* : se.
11) *Të lig* : të smundë.
12) *Heqim* : mjek.
13) *Shikjue* : vizitue ; ndërto : mos të shikjohej shpejt.
14) *Ndërto* : për me e mbuluemun kështu me nderë qellimin e zí. Më si duket Bityçi në ketë kohë e pranonte parimin e shkollës së Xanonit mbas të cilit ndërtimi i zhdrejtë i periudhës i jep hije mâ të randë poezís.

Anì te Aladra nget' e shkon në Francë
(Veshun e mbathun mir' me i zânun besë) 15)
E kû pat dijtun se mund t' ha ndoj plancë 16).

Pare na gjuete prej Aladros mirë
E prej do tjerve, tui na ndiell' ngatrresë
Të shpifunijes me zanát të fshtirë 17).

ZEF VALENTINI

---

9. — THIMI MITKUA (1878)

a) Jetëshkrimi

U lind Thimiu në Korçe në vjetin 1814. Mësimet e para i kreu në nji fshat të Manastirit, e pastaj i u desht të fillonte jetën êndacake të Shqiptarvet të vorfën t' asaj kohe qi në mërgim kërkojshin jetesë e liri ; prej Athine e në Filibé (Filipopoli të Bullgaris) e prej Bullgarije e n' Austri. Në Vjenë, me të vllán qi — me sa tjerë Shqiptarë aso kohe punonte si rrobaqepës — punoi po n' atë mjeshtrí shum vjet. Mâ vonë themeloi nji sipërmarrje tregtare të madhe në Beni Suef t' Egjyptit e aty vdiq në vjetin 1885.

U bâ kështu nji ndër shkastarët mâ të parë e mâ të mdhaj t' asaj lëvizjeje atdhetare kaq të gjallë, vepruese e bâmirse qi e dallon atë koloni shqiptare deri më sot.

Andej shkruente e mirrte udhtimin pa u lodhë për dobi të çâshtjes kombtare. S' la njeri të kohës së vet qi të mirrej me kulturë a me politikë shqiptare, pa hŷ në marrëveshtje me tê. Miqsi të madhe kishte sidomos me De Radën (me të cilin bashkëpunoi në „*Fjamuri i Arbrit*" — e me Dhimitër Kamardën ; gjithnji me Dora d' Istria, me Francesk Krisp-in e me Zef Schirò.

---

15) *Me i zânun besë*: qi Aladrja t' i zênte besë. Vrejtje e bukur mbi hollsí të «gjuetarit».
16) *Plancë*: kafshatë të mirë, të majme.
17) *Të fshtirë*: të keq, trathtár.

Mbas mendësís së tij politike, shpresa e Shqipnís ishte te bashkëpunimi e ndoshta te bashkimi me Grekë, porse gjithnji tue mbajtë të veçuem individualitetin e Kombit Shqiptar me anë të gjuhes e të zakonevet; po ket mendim ai shprehë në parathanje të „*Bletës*" së vet. Por mandej ndodhjet e vj. 1879 mbas Kongresit të Berlinit e qitën në shesh lakmín e pa ngishme të Greqis, qi, tue harrue meritimet qi patën Shqiptarët ndaj tê, donte pa tjetër me greqizue gjysën e Shqipnis; e Mitkua ndrroi mendim, kapi pendën e i a nisi fushatës kundra Grekut të pa êvari e të dalun rodi, për nji Shqipni si ethnikisht ashtu politikisht të dame prej Greqije; dokumenta të bukur të këtij drejtimi të ri t' atdhetarit të drejtë kemi ndër letra qi i shkruente në 1879 Françesk Krispi-t, italo-shqiptarit të madh qi deri atë ditë kishte qenë njij mendimi me tê. 1)

Si veprim atdhetar ai kishte marrë edhe gjith punën vigane qi kreu — ndër mâ të parët — në të mbledhun të visarit kombtar të kangvet, të prrallavet, të proverbavet e të prodhimevet tjera të mrekullueshme të popullit t' onë. Me to ai do të provonte të drejtën e Shqipnís për t' u quejtë komb.

E njimend jo vetëm desht t' i botojë ndër dy vllime „*Bleta Shqipëtare*" (1878) 2) e „*Mbleta e Vogël*" (e pabotueme, e, mjerisht, e humbun), por — kundra dishirit të natyrshëm të të çdo shkrimtari qi don vetë me shfrytzue prodhimin e mundit të vet — landën e vet të pasun s' u a kursei miqvet, shqiptarë e të huej, qi të mund t' i qitshin në dritë për mâ të madhin lavd të gjenís së Kombit.

Kështu veproi me V. A. Dodoni *(Mjalt' e Mbletës")*, botue në 1898 e me Gustav Meyer-in *(„Albanesischen Studien"* fash. VI)

Vepra e botueme „BLETA SHQIPTARE", mbas njij parathanjeje, do rregullash shqiptimi t' alfabetit greko-shqiptar të

---

1) Gjinden ndër letra të Krispi-t qi ruhen n' Arkiv të Deputacjonit Mb. të Historis Kombtare të Palermit.

2) U botue me alfabetin greqisht, por në vjetin 1924 u përshkrue me shkroja t' alfabetit të sotëm, u përkthye shqip dhe u radhit nga Gjergj Pekmezi në Vjenë. Botimi i Vjenës ka 304 faqe.

Kamardë-s qi ai përdorë, e nji përkthimi po të Kamardës, të disa copve të Dora d' Istria-s mbi kombsín shqiptare ndër kangë popullore, përmban mâ se 500 proverba e kashalashë (enigma), nji varg përshëndetjesh e emnash njerzish; kangë popullore tosknishte e gegnishte, me shenime historike; dymbëdhetë prralla, e së fundi nji fjalorth mâ se njimijë fjalësh.

Me të drejtë thonte de Rada se „Thimi Mitkua Korçar qe guri i temelit i rindërtimit t' atdheut të vet. Leu prej shtëpije në të cilën dashtënija vepruese e atdheut të shkretë îshte porsi trashigim. Dhânë mbas tregtije në mërgim... kurr s' i a ndau synin fatit të Shqipnis së vet. Në „*Bletën Shqiptare*" kemi, të thuesh, si në gji të nanës, gjithshka atdheu ka ruejtë prej qenës së vet fisnike, kah mund të përtrihet e të ringjallet".

ZEF VALENTINI

b) Nga «Bleta Shqipëtare» (faqe 7.)

Istorishte e pashpallurë 1)

Ndë Varmash, një kryefshat të nahíes Përmetit, Vasil-Janua me të vëllanë Kriston, ishnin të dashurë të fshatarit tyre Ismail-beut, kushëriut Mahmut-beut Vlorës, i cili Ismail-bei ishte e para derë e atij vendi. Kaqë të dashurë ishnin, sa edh' ata edhe fëmij e atyre hynin e delënin ndë njëriatëri çpenguarë. Vasili hinte ndë harem të béut çlirëtë, edhe zonja e quante atë bir. Një herë Vasili, një orollogë të mirë, edhe një unazë të vëjejturë që kish, e që i a lypi Beu me para, i a fali atij. Pas hohe, i vëllai i Beut i lypi Vasilit mushkën e tijë, Myzeqaren, shumë të mirën, e ky s' deshi të i a sheesë përse i duheej aio për vetëhe të tij. Andaj i vëllai i Beut i vuri mëllë, e beu i math s' dinte gjë fáre. Një mbrëma adhá Vásilit, kur ky do të veente ndë shtëpië passi mbylli dyqanin e tijë nek' shkonte për anë xhamiës mbë t' errëtë, i vieen sëqetëthi një plump dyfegu e i merr brezin vetëmë, paa cënuar' atë ndë misht. Edhe ky ndë

1) Koha e ksaj ngjarjeje âsht pak vjetë mbas mbarimit t' Ali Pashë Tepelenës.

cast i vërtiti dyfegun, e i ra mbë flakë edhe e vrau, paa diturë se cilin mvrau. Poqë i gjau këjo e keqe, Vasili, tuke dredhurë frikë morri udhën dëreit' e vaiti mevrap ndë pallas të Beut për të umpruarë; përse ndë veente ndë shtëpíë të tijë, munt t' e plakosënin arëmiqëtë e t' e shuanin me gjithësei. Hyrë ndë pallas të Beut Vasili, u rrëfeu se mvrau një njeeri, tuke uluturë atyre që t' e 'mpronjën. E ata e përitën mirë, e i thanë të mos trembet, amà edhe nukë dinin se cilin kish mvrarë ay. Nukë shkoi shum' or' edhe e nxunë se i mvrari ish i bir' i zonjës, e vëllai i Beut. Vasilit, kur dëgjoi këtë, i uerrën sytë, e i unxi jeta, e ullaos, u bë si i vdekurë së keqit, që i arth për një të tillin të dashur e shpëtimtar që mvrau vet' ay, pastaj edhe së tremburi që utrëmb tepërë, tuke qënë ndë këmbët të atyrevet, që duheej me udhë të lypin gjakun prej atij. Po edhe zonja edhe Beu, me gjithë të madhen të keqe që i gjeeti, i than' atij me zemërë e me vëllazëri, se i a kanë falurë gjakun, edh' e kan' atê paskëtai për bir' e për vëlla, sepse u a vrau njerinë paa dashurë. Pa kur dëgjuan fara e miqësía e Beut, u lishuan të gjithë posi të tërbuarë, që të zënë Vasilin, e t' a diegin e t' a piekin me gjithë ç' kish. E zonja edhe Beu i qerton ata të marrë, e u përflet, e u thotë se ajo Vasilin paskëtaj dot' e keetë ndë ven të të vrarit. Edhe nga ana tietërë dërgoi trimma të ruanjën shtëpiën e Vásilit, për sigurië. Trimatë 'ngritën fëshehurazi tër' ato plaçëka të vëjejtura që kish ay, e i a suallën nde Beu, semos i a bënin rrëmujë ata. Pasandaj, tuke parë Beu, se Vasili nukë dotë kish qendrë më ndë Varmash, e nisi e e dërgoi me trimat e me mushkat e tija në Mahmut Beu ndë Vlorë me porosi të madhe që t' a keetë si vëllan' e tijë. E nga gjëja e tijë vetëmë, 500 kreerë bakëtish edhe shtëpia i humbën. Mahmut Beu e përiti mirë, i fali një shtëpië, edhe 500 berra ndë ven t' atyre që humbi edhe e duante e e rruante si një vëlla me vërteta. Po kur arrëmiqët e Vasilit nga Varmashi i vajtin edh' atie, 150, veta, edh' i lypën atë Mahmut Beut me pismë, edhe me frikësime, atëhere umentua aty për barën të madhe që kish përpara kushëririt tijë, edhe ndeerëjës tijë sapër mpështetëjën edhe të mprojturit e Vasilit e mbë tietërët

anë as me arrëmiqët e Vasilit duante të keetë sheer, edhe e nisi edh' ay Vasilin e e dërgoi ndë Korfus me të mproiturë e me sigurië. E sapër shtëpiën edhe berrat që i kish falurë vetë Beu, i dha fialën atij, se ishin edhe paskëtaj të atija, edhe gjëja e atij, makar let' e sheesë, makar let' i mbanjë.

---

10. — PASHK BABI (1882)

a) Jetëshkrimi

Shkodranë, leu në 1843; hyni në Kolegjë Papnore Shqiptare në moshë mjaft të pjekun tetëmbëdhetëvjeçare e për pesë vjet kreu studimet teknike meshtarake.

Gjith jetën e shkoi famullitár nepër katunde të ndryshme e sidomos në Sheldî, kaq sá njifej në qytet me mbiemnin „*Prifti i Sheldîs*".

Por edhe mbíemën tjetër kishte trashigue prej Vasës, t' et, qi shiste „sheqera" e ai u quejt „*D. Pashko Sheqeri*"; mbíemën shum i përshtatun për at njeri të bâshëm, të tanë zemër e dashtní për popull të vet e për miq, gojambël në të folun, në predikim e në shkrim.

Aji mâ i pari nisi me radhitë në regjistra famullitare të Sheldîs kronikën e ndodhjevet të Vendit, kështu qi ato letra janë bâ nji xehe për historí t' atyne kohnave kaq t'interesantshme.

Mâ i pari tekst shkolluer qi u botue në dhé të Shqipnís, âsht vepër e tija: „*Vakinat* (ndodhjet) *e ligjës së hershme e të ligjës së ré*" të botueme për nxansit e Kolegjës Saverjane në vj. 1882. Libër klasik për kah styli kallximuer i gjallë e të tanë shîje shqipe; mjerisht ká fjalë turqishte me shumicë, por këto nuk e prishin aspak bukurín e perjudhës, qi, po të zâvendsohen me fjalë shqipe, mbetë shembull proze ngjyrëplote dhe e kandshme. 1)

---

1) Ndër copa qi këtu do të riprodhojmë, fjalvet turqishte të pánevojshme kemi për t' u shtue ndër kllapa fjalët qi mund t' i zâvendsojnë shqip.

Prej dore së tij duel edhe nji ndër mâ të parat vepra dramatike qi u shfaqën në Kolegjë Saverjane „*I biri i çëfutit*“, kështu qi ndoshta ai mund të quhet mâ i pari dramaturg i ynë.

Pasunija e mrekullueshme e gjuhës për kah skâjet e sidomos përkah frazat qi i japin nji gjallsí ngjyrash tepër të kandshme bisedimit e kallximit, styli klasikisht i fjeshtë e popülluer e përnjiheri dajmas fisnik e i naltueshëm, fuqija e periudhës nepër ndërtim e nepër theksim mjeshtruer, ndiesija e masës qi e drejtoi ndër shkurtime për të shkaktue lëvizjet psikologjike mâ të përshtatuna, e bâjnë Babin nji ndër kallximtarë mâ të mirë qi ká letërsija e jonë, e, ndër prozatorët shkodranë të kësajë perjudhe, atê qi ka mâ shum vlerë letrare.

Asht për t' u vajtue se tepër i harruem ka mbetë ndër kohë të vona, ndërsa populli i Shkodrës endè sot e lexon me andje, e nji gjykues i hollë lande letrare e vênte me D. Ndré Mjedjen në radhë „t' auktorvet qi, mbas gjykimit të të gjithve, janë riprodhues fare të zgjedhun të të folunit popülluer e të kulturuem përnjiheri, mbassi me kulturë të përgjithshme bashkojshin në shkallë të rrallë ndiesín e gjuhës me njoftjen e popullit e të të shprehunit të tij“ ; kështu qi veprat e tija do të njehen „libra xhevahire“. 2)

b) Nga „Vakinat“ e Babit

1) Dera e çilun 1) *e Abramit (f. 23)*

Njat herë kur kapë të xétit e fortë të ditës, kishte vojtë Abrami e xânë vend nen hije të nji landet, qi e kishte në himit 2) të çadërs (shatorres) së vet. Po shef për giat 3) ka vín tre udhtarë. U çue me të shpejtë me ju 4) dalë para, e si u përmbyz

2) Cordignano-Lingua albanese ; fq. XVIII e 89.

1) *dera e çilun :* frazë konkrete e bukur në vend të neologjizmës abstrakte „mik-pritja“.

2) *në himit*: në të hîmit.

3) *për giat* : për ngiat, s' afri.

4) *ju* : solecizëm shkodrane : *u.*

për dhé në hitát (nderim) të tyne, i tha atí qi ju duk si mâ punëmadh [5]) ndër to [6]): Zotní, për në do me ma shikjue hatrin (dashtnín), mos e lên për mbrapa [7]) hysmeçarin (shërbëtorin) tand. E pá e lëshue fjalën [8]), siellet prej të treve, e ju tha: Pushoni nên ketë hije. Une tash po u bije uj, e po ju láj kambët, e po bije nji grimë bukë, t' u vijnë kyved (fuqí): e mbrapa tesh po kaloheni [9]). Porsá mbaroi fjalët, hîni në çadër me të shpejt, e i tha Sarës grues së vet me qitë do pagaçë me mâje miellit [10]). Aj vetë vojt e xuer nji viç mâ të mâjm e e mbyti, e pá vanesë aspak e zjeu. Muer tëlyen [11]) e tâmbel [12]) e pagaçët, e ato mish viçit të ziem, e ju vû sofrën atyne. Sa kjene ato tuj hangër, aj vetë kishte ndêjë në kambë për afër sish, hazër (gati) për shkado qi ju duhej atyne, me ju bâ hysmet. Mbassi mbaruene së hangunit, në nisunit me dalë, i pari ndër ato tre shtegtarë i tha: Kam me t' ardhë mot shi njikëso zamanit (stine). Sara atëherë ká për të pasë nji djalë. U kujtue Abrami qi Zoti vetë m' esapi (dukë) të nji shtegtarit, me dy ênjej për mbas vedi, kishte ardhë tuk aj, e prej si kishte dashtë me kênë pritë në konak (bânë) për bukë. *)

---

5) *punëmadh*: adjektiv konkret i gjallë: njeri i randsíshëm.

6) *to*: solecizëm shkodrane: *ta*.

7) *mos e lên për mbrapa*: mos kalo tue e lânë mbas shpine e tue përbuzë derën e çilun të tijn; frazë e shkurtë e plot fuqí.

8) *pá e lëshue fjalën*: të thuesh për mos me u lânë kohë atyne me qitun shkaqe.

9) *kaloheni*: niseni.

10) *maje millit*: pjalmi, plajmi, it. „Fior di farina".

11) *tëlyen*: gjalpë.

12) *tambël*: qumësht.

*) Kallximi i shkurtë e të tanë ngjyrë, përveç interesës qi ká sidomos për né si shembull mikpritjeje, âsht nji idyl ndër mâ të bukurit qi ká letërsija botnore si përshkrim jete patriarkore së fjeshtë; kujto idylin e Ovidit e të Zanella-s mbí mikpritjen e Baucit e të Filemonit.

2) Dashtnija qi pat Rut për vjehërr të vet (f. 81)

Asi zamanit [1]) qi gjygjtarët e kishin dá guivnimin e popullit Israelit, bâni vakí nji zí e fortë për ato vende, e nuk gjindej buka. Për ketë sebet (shkak) duel njêni prei Betlemit me shkue me nguië në dhé të Moab me gjithë grue e dy djelm qi kishte. Emnit atí i thoshin Elimelek. E grues tij i thoshin Noemi. Atje mbas do ditsh diq Elimelek, e dhetë vjet përmbrapa diqne edhe të dy të birët e tí, qi kishin pasë marrë për grá dý bija të dheut Moab. Noemit, si mbet e vejë e pá djelm, ju mbush mendja me këthye prej dheut vet qi kish lânë. Të dý rejat e veta [2]) të cilave ju thoshin për emën Orfa njênës, e tjetrës Rut, e përcuellne.

Mbassí bâne nji copë rrugë të madhe, ju tha atyne Noemi: Tash shkoni prej shpijet [3]), Zoti ju dhashtë nafakë e të mira, sikur jeni mundue si me djelm të mij, ashtû me mue. E ato dënesne e u derdhne në váj [4]), e tuj kjá me lot për faqe i thane: Na po vîjmë mbas tejet në dhé tand. Por ajo jau priti: Shkoni, bijat e mija; e shka keni me bâ ju tuk une? Une jam e vorfën e halli (e zeza) i juej mâ zí ma bân mue. Atëherë ato brín [5]) e vajtuen, e kján, e dnesne. Ne mbrâmë asai qi i thojshin Orfa ju mbush mendja mbas fjalve së vjehërrs e u dá prej sojet e shkoi në konak të vet. Por tjetërs qi i thojshin Rut kurr s' ju lodh mendja me u shkoqë sojet e i tha: Kûdo të shkojsh ti, edhe un kam për t' ardhë, e kudo të xâsh ti vend, njatŷ edhe une rri. Populli i jot ká për të kênë populli i jêm, e Zoti i jyt, Zoti i jêm. E atŷ kû të desëșh ti kam për të dekë edhe une, e n' atë vênd kam për t' u vorrue.

Noemi nuk desht me ja prishë mâ, e bashkë muerne rrugën prej Betlemit.

---

1) *zamanit:* kohe.

2) *e veta*: solecizëm shkodrane: *e saja.*

3) *prej shpijet*: kah shtëpija.

4) *u derdhne në váj*: sá e gjallë e e përmallshme kjo frazë!

5) *brin*: bri*ën.

Ishte shi aj zaman qi kishte fillue me u korrë elbi. E i tha Rut së vjehërrs: A më lëshon të dal në fushë me mbledhë kallxí mbas korrcaresh? E ajo i tha: Po, shko bija ême. E ajo duel. Kúr [6]) Zoti i príni asajë [7]) n' arë të njênit qi i thojshin për emën Booc, e ishte nieri zenjin (i pasun) e ilaká me Elimelek, me mbledhë kallxí. Booc, si vojt aso ditet me pá puntorët, ju tha atyne: Zoti kjoftë me ju. E ata ja kthyen: Zoti të dhashtë békim. Mandej, si i vojtën sýt e pá Rut, pëveti: Po e kuja âsht kjo vajzë? I thonë ato: Kjo âsht ajo bija e dheut të Moab, qi ká prû Noemi me vedi; na ká lutë me e lânë me mbledhë kallxít mbas korrcaresh, e qe në nadje e deri tash âsht këtû n' arë, e s' ká shkue tu shpija asnji grimë herë.

Booc siellet prej Rut e i thotë me të mirë: Po ndigio, moj bí, rri bashkë me hysmeçare të mija, e merri mbrapa, kû të korrin ato; une ju kam vû leçí, kush [8]) mos me t' u bâ havale (me të merzitë); edhe kúr të vijnë ed [9]), shko kû janë ênët e pi njashtû si të pijnë gjindja e ême. E ajo përmbyset para si për dhé, e i tha: Po e kah e kam une qi me gjetë hatër e nderë para sŷve tuej, une qi jam nji grue e ardhun prej tjetrit dhé? Ai i tha: Më kanë bisedue të gjith si ja ké bâ tande vjehërr për mbas deket të fatit tand. Zoti ta shpërbleftë të mirën tande! I tha prep mandej: Kúr të bâhet vakti (koha) i bukës, avitu këtu e ha buk me né, e njyje kashatën tande n' ufull [10]). E si erdh koha e bukës, vojt e xû vend përbrî korrcaresh, e hângri shka i vûne para, e tepricat i ruejti. E me shpejt u çue [11]) si mbaroi, e mblodh kallxí deri në kohë

---

6) *kúr:* kùr qe.

7) *Zoti i príni:* thân'je e përshpirtshme e bukur mjaft, në gjallsí të vetën.

8) *kush:* kurrkush.

9) *ed:* et.

10) *n' ufull:* kështu e lypte zakoni për puntorë kinse për me u a shue eden e me u dhânë fuqí.

11) *e me shpejt u çue:* element i bukur për përshkrim të karakterit të vejushës së ré t' urtë e puntore, sikur ai tjetri qi u përshkrue sipri: „s' ká shkue tu shpija as nji grimë herë; shum mâ mjeshtrí âsht në letërsí qi elementat e karakterit të dalin si pá dashtë prej kallximi, se sá tue bâ në fillim si nji përshkrim gjatë e gjatë.

të mbrames. Booc ju kishte lânë fjalë gjindës së vet me i lëshjue prej dorcave do kallx vetë ato, e mos me i mbledhë, t' i mbledhin ajo për vedi pá turp [12].

E si i shîni kallxit prej mbramjet, gjet elb mirë fort. E ja çjoi së vjehërrës së vet me gjith teprica të sofërs. Ne nesër në nadje, e ne mbas-nesrit ajo shkoi në fushë me hysmeçare t' atí zotnís Booc, deri qi mbaroi elbi e gruni, e hini në hamár [13].

Nuk u shtŷ fort shum, e i tha Booc ksaj Rut: Bij, shehri (qyteti) të gjith e ká marrë vesht se jé grue me erz (nderë), e pá nji të keqe qi me tu shá. E aj zotní e muer për fat të vet, e ajo kje grueja e tí. Zoti martesën e tyne e prûni për së mbarit [14], e ju fali nji djalë e ja njitne emnit Obed. Obed kje i jati i Izaj, e Izaj kje i jati i Davidit, e prej Davidit duel Shelbyesi.

3) Tobija i verbët e Tobija i rí djali i Tí (f. 124)

Ishte Tobija nieri i Zotit; gjân qi kishte vetë, me të vorfnit e dáte e bark-ûnshuemit [1] i epte bukën, e të lakuriquemit me petka të veta i veshte shtatin e i mblote marren. Premtoi Zoti, e shi tui bâ vepra të mira verboi sysh.

Gjith farë hallesh (të zezash) e kishin marrë. Me vedi tui mendue se dita e dekës i âsht afrue fort, e thirri të birin për afër vedit e për mâ të mbrâmen fjalë i dha do mësime... edhe e nisi në Rages, shehër i lergë, për me nxjerrë nji borxh të hershëm. Por i biri, të cilit ja kishte njitë [2] n' emën t' et Tobí, desht me gjetë nji shog për rrugë, i cili ta dije at rrugë qi dote me bâ e ta çiote në vend. Si duel me ket mende [3] prej

---

12) bâmirsija qi nuk i rândohet të vorfnit, âsht mâ e bukura bâmirsí qi del vetëm prej zemre së mirë pá qellime të dyta; edhe të del i gjallë me nji fjalë karakteri bujár e atnuer i këtij burri.

13) *hini në hamâr*: frazë e gjallë në shkurtsin e vet; *me hí* âsht verb qi i përshtatet të gjallit, por përshkrimi i gjânavet të pá jetë me ciltina njerzore i jep gjallsí të madhe të folunit.

14) *e prûni për së mbarit:* e bâni të lume; edhe kjo thân'je konkrete. Edhe ky kallxim njehet si nji ndër idyle mâ të bukra të letërsís botnore, për fjeshtësí të bashkueme me përmallshmení.

1) *bark-unshuemit:* t' unshmit, porse mâ realistik.

2) *ja kishte njitë:* me ja njitë âsht, si me thânë, fraza teknike shkollore, për të vûmt e emnit ase mbíemnit.

3) *mende:* qellim; kujto këtu se nji bukuri e veçantë poetike âsht ajo e

shpijet, hasi në nji djalë të rí të páshëm 4), qi ishte shpërvjelë 5) e bâ hazër me u nisë për rrugë të lergë. Ishte ky Enjelli Raffael. Ky nuk e dite se âsht enjell prej Zotit, u përshndet me tê, e i tha: Djalë i mirë, a mund e díshë rrugën qi çion në Rages? E ai i tha: Po, e dij. Atëherë Tobija i prini atíj, e e muer e e çioi tu i jati. Tobí plaku i tha atíj: A mund na çiojsh ti têm bír në shpí të Gabelos në Rages? E ai i tha: Une kam me ta çiue, edhe kam për ta prû. Atëherë ju tha të dyve Tobí plaku: Shkoni prá, e gjâ e keqe mos ju gjetët, Zoti rrugës kjoftë me jú, e enjelli i tíj ju percjelltë 6).

Të parën natë t' asai ditë qi u vune për rrugë, prekne 7) tu nji uj qi i thonë Tigri 8). Tobija u ul në breg për me lá kâmbët. Kúr duel nji peshk i madh për bind 9) me e përpî Tobín. E muer mndera, e briti: Zotní, ky po lëshon në mue! Enjelli i tha: Shtjerja duert ndër verza 10), e mos u trem, e hiqe prej vedit. Ja shtîni duert, e e xuer në të térun. Atëherë i tha Enjelli: Çile në bark ket peshk, e rueja zêmrën, e tamthin, e mushknín, pse janë të nevojshme ato për iláqe. Mandej do asi peshkut e poq, e e muerne me e hagër rrugës, e tjetrën e krypne për me e hagër sá herë qi rrugës të ju bijte nevoja.

Kúr prekne tu nji shehër, i tha enjellit Tobija: Ku po do ti të xâmë vend na: I tha enjelli: Asht këtu nji nieri qi i thonë

---

fjalvet me kuptim mâ të përgjithshëm në vend t' atyne me kuptim mâ të përcaktuem, pse ato i lânë lexuesit mundsín për t' u endë mâ gjânë me fantazí.

4) *i páshëm:* d. m. th. i bukur, veçse jo me atë bukurí të njomë qi âsht e veçantë e grues edhe e fëmís, por me atê qi i përshtatet burrit; nuk thohet „*burr i bukur*" por „*burr i páshëm*".

5) Të moçmit kishin zhgunë të gjânë e të gjatë, e prandej për udhtim shpërvieleshin.

6) Shum dramatik ky urim në gojë të plakut qi thotë nji gjâ të vërtetueme pá e dijtë vetë, ndërsá lexuesi e din mirë.

7) *prekne:* mrrîjtën, por mâ konkret, e prandaj mâ bukur.

8) Asht nji ndër dy lumejt qi përmbajnë „Mesopotamín", qi greqisht d. m. th. Ndërlumna.

9) *për bind:* për mrekull, për çudí, por disi edhe për tmerë.

10) *verzat:* janë dy si kapakët qi mbyllin grykën kah marrin frymë peshqit, ndër dy anët e qafës.

Raguele, sebeti 11) i jyt, i cili nuk ká tjetër por nji vajzë të cilës i thotë emnit Sara. Lypja t' et sai, e ai ká për ta dhânë për grue. Ja kthei Tobija: Kam marrë vesht se ajo ká xânë 12) shum burra, e qi ja ká mbytë djalli. Ani drue edhe une mos të më gjêjnë rreziku i tyne, e mbasi prindja ême 13) tjetër s'kâ posë mejet djalë 14), e keqja ême ju afron ditën e vorrit 15) prej dhimbet të zêmrës. Por enjelli Raffael i tha: Po më ndigio, e une tash po të kalxoi se kush janë ato qi i kà djalli në hyqym (pushtet). Njato i ká djalli në hyqym qi kúr martohen e tresin Zotin prej mendjes vet, e e lagojnë prei vedit 16). Por ti kur të lidhesh me tê në martesë, për trí dit tjetër nuk ké për të bâ, veç me ndêjë me tê tuj u lutë 17), e djalli ká për tu lague.

Shkuene në shpí të Raguelit, i cili, si e njofti Tobín, i priti me gzim fort e me lezet (të knaqun), e me lot për faqe ja lshoi duert qafës 18) Tobís, e puthi, e i tha: Ti kjosh békue, bíri êm, qi jé pinjolli i nji nierit mirë e i pá kurr shog 19). Anna, e shogja e tíj, e Sara e bija kjajshin me tê 20). Mandej Raguele ju bâni gostë, e kúr desht me i vû në sofër, Tobija i tha: Une sod ktu as kam për të hagër as kam për të pí, për mos m' u gjegjsh përpara sikúr due un, e në mos ma dhaç fjalën se ké për të ma dhânë tânde bí Sarën për grue. Raguelit ju lidh fjala gojë 21), por enjelli i tha: Mos të bâhet vesvese

---

11) *sebeti:* ilakaja, fisi.

12) *ka xânë:* âsht martue.

13) *prindja:* kolektiv: dy prindët e mij.

14) vjen si me thânë: „tjetër djalë s' ká posë meje"; porse n' at ndërtim të jep përshtypje se jo vetëm tjetër djalë, por as tjetër gjâ të mirë nuk ká.

15) njinji si *„ditën e dekës"* por mâ tragjik prej konkretizme.

16) d. m. th. se s'mendojnë veçse për gëzime, e jo për detyrët e shèjta të màrtesës.

17) për të pasë ndimën e Perendís në të kryem të detyrvet.

18) e përqafoi, me fraza përshkruhet mâ bukur.

19) qi s' e ká pasë kurr shoq as ndoshta s' ká për t' a pasë; frazë e fuqishme pse e shkurtë, por gjithnji e qartë.

20) Sá njomsi familjare në ketë idyl!

21) *gojë:* në gojë; edhe kjo nji frazë e bukur.

me ja dhânë pse ky ja ká frigën Zotit [22]). Atëherë Ragueli u bâ razí (pranoi), e ja muer të bís dorën e djathtë e ja vû Tobís në dorë të djathtë tuj thânë: Zoti i Abramit, i Izaakut e i Gjakobit kjoftë me jú [23]), aj ju bashkoftë e békimin e vet jú ju dhashtë [24]). Mandej u vûn, e ndêjen në sofër. Tobija e Sara trí dit u lutne para Zotit, e djalli nuk pat kyved (fuqí) për të keqe të tyne, e iku. Për mbas rixhajet (lutet) Tobís, enjelli shkoi në Rages vetë e foli me Gabelo, e ja xuer paret tana.

Si shkuene dý javë, i tha Ragueli Tobís: Xên vend këtu edhe disá dit. Por Tobija ja kthej: Une e dij se êm át eême âmë tash kan fillue e njehin ditt [25]), e jan në kujdes të fòrt për mue. Ragueli atëherë ja lshoi të bín Sarën, edhe gjysën e gjith gjâs vet ja dha, e i tha: Enjelli shêjt i Zotit me jú kjoftë për udhë [26]), e në konak ju çioftë shndosh, e pá kurrnji të keqe! Kúr u kapne në gjysë të rrugës, Tobija me Raffaelin shkoi përpara, e i tha ky Tobís: Kúr të hîjsh mbrendë në shpí, fërkoja sŷt e tyt tet me at tamth peshkut qi ké me vedi, e ai ká për të pá dritën e qiellës [27]), e si të shofë tý, ká për të ju knaqë zêmra [28]), e për t' u gzue.

Aso heret prindja e Tobís ishin në nji kujdes e në nji zellnen (pikllim) të fort se nuk ju kishte kthye i biri. E âma e tíj derdhte lot e s' ju térshin kurr sŷt [29]), e thojte: Uh, uh, bír, pse me të çiue na lerg, bír, drita e sŷve tonë, shkopi i pleqsís

---

22) e prandej Perendín s' ká për t' a fye tue tërhjekë ndeshkimin e tíj.

23) Abrami, Isaaku e Jakobi (i quejtun edhe Izrael) qénë të parët e popullit t' Izraelit të cilit i përkitshin gjith këta njerz.

24) Nji bukurí të fjeshtë patriarkore ká ky përshkrim i ceremonís së martesës, të tânë i frymzuem prej dashtnije së përzemërt atnore.

25) Mà mirë se me këto pak fjalë s' mund të bâhet përshkrimi psykologjik i pritjes së mallit.

26) sh. n. (6).

27) jo vetëm dritën, por dritën e qiellës! sá të bukura i ká shqipja këto fraza, sikurse atë tjetrën „sŷt" asc „flokët e ballit," „duert e shtatit" etj.

28) mirë drita e qiellës, por knaqa e tij me mujtë me pâ djalin e vet përsërí.

29) kinse s' pushonte, por sá mâ me gjallsí bâhet përshkrimi pá humbë në fjalë të gjata!

onë, ngushllimi i rrnesës onë, uzdaja e barkut onë 30). Pse me të çiue na lerg sŷve tonë? Se mundohej Tobí plaku me e pajtue, dobí s' bâte 31); zêmra e sai në pajtim kurrsesi nuk bite. Dit nuk i shkote pá dele e pá shikjue rrugën për të giatë përmbí nji sukë ku mundej me pá lerg fort 32). Te e mbramja e pá për së lergut, e e dajti se âsht i biri zêmra e vet 33), e u lshue vrep e i kalxoi Tobís plakut 34): Yt bír po vjen 35)! Porsá fjala giati 36), e ja mrrini qêni qi kishte pasë marrë Tobija me vedi, e kishte gá para, e lojte bishtin prej qefit 37). U çiue në kambë i jati, e i muer dorën nji fmije 38), e i duel para të birit, e kapi grykë, e e shtërgoi për zemer të vet, e puthi ai edhe e ama, e prej shendit filluene me kjá të dy. Edhe të birit ju gî 39) zemra fort se e gjet babën e vet jo veç gjallë por edhe në shndet.

Si u përmbyzne para Zotit e e avruen 40) e ju falen nderës se kishte kujtue aq mirë për to; Tobija i biri, Tobís plakut me tamth peshkut i fërkoi sýt e babës së vet, njashtu si e msoi

---

30) *e barkut:* e shtëpís, e brêzit; ndryshej s' kishte për të vajtue nâna malsore e jona, qi me nji máll të pákufí e me nji shqiptim të thekshëm përsëritë atë thirrje si nji váj të gjatë *bír, bír.*

31) vêni ré gjallshmenín e këtij ndërtimi.

32) sikurse i kishte thânë zemra djalit, e sikurse e lypte nji zemër nâne.

33) *i biri zemra e vet: i dashtuni bír* âsht thânj'e ekzakte në daç, por shum e ftofët kundrejt kësaj mâ konkrete.

34) sá mirë n' at ças për dashtní të djalit nuk e harron dashtnín për shoqin plak të jetës së vet e s' pritet pá e bâ shoq të këtij gëzimi.

35) jo: *po vjen yt bír;* por *ýt bír* po vjen; besoi se kjo pikë âsht nji ndër mâ të bukurat qi ká mujtë me krijue fuqija e rrallë e gjûhës s'onë.

36) kinse; mâ shpejt se bâm na tue përshkrue kështu shkurtazi; por, than'ja e përmbledhun vlen mâ tepër, sidomos në nji pikë ku dramaticiteti s' e duron mâ të gjatën.

37) këtu përsosmenija e kësaj pikture flamande mrrîn në kulm.

38) doemos, tue qênë i verbët; por tue e përmendë këtu të bâhet se e shef hovin e mallit qi s' e lên plakun me pritë por e shtyn, njashtu si mundet djalit me i dalë para.

39) Fjalë konkrete gjithnji të reja e gjithnji me bukurí të ré!

40) *avruen:* adhruen; detyrën e miradís në gëzim këta njerz të mirë nuk e harrojnë; kjo matuní në të gjitha sjelljet (vêni ré si u ruejt hjerarkija tue e puthë djalin nji herë baba e mandej nana?) i jep nji këthielltí këtij tregimi, ku llárr ká mrrîjtë edhe arti grek.

ênjelli Raffael. Sí shkoi gadi nji gjysë sahatit, filloi e i rá prej sŷsh nji teshë e bardhë sikur me kênë këmishë voejet 41), e me nji herë ju çil perdja 42) e pá. Kur e páne punën e tíj, e baftin qi pat prej Zotit, të gjith Zotit nderë e lavd i thâne, e Tobija çili gojën e tha: Tý po të békoi, Zoti i Israelit 43), pse me dorë tande vetë ma ké çue travajën, edhe vetë sojet më ké xjerrë, e une tash po e shof tem bír Tobín përsrí! Mbas shtatë ditësh, përmbrapa Tobís, ja mrrîni edhe Sara, e shtatë dit rresht bâne gostë, e të gjithë patne gzim e shend, n' ato dit 44) të madh fort.

Tobija i rí i bisedoi prindve vet se sá fort i ishte gjetë 45) e sá mukajet (kujdes) i ishte bâ shoqi qi kishte pasë për rrugë, e po i pvetë: Na si do të ja shpërblyejmë atíj, o shka mundet me u gjetë qi mos me i ndêjë të miravet tija për nên të drejtë? Po shka; po të tham, baba i em, qi t' i vêhesh fort 46) tuj ju lutë a thue se e ká në begení gjysën e gjâs qi na ká ardhë, e ta marrin aj për vedi. I jati bashkë me të birin Tobín i bâne zâ, e e dáne më njênën anë 47), e po i luten njashtu si ishte ndjeti i Tobís rí. Atëherë ênjelli Raffael çili gojë 48) e ju tha ai ktyne: Zotin e qiellës békoni, e atij epni laudin, se ka shikjue prej jush me mishrir të vet. Dobí âsht urata qi përzihet me njinesë e me elmoshë, mâ shum nafakë se me vû hazna (visare), e se grumbujt e florîjve 49). Kúr ti e thojshe uratën tande

---

41) âsht ajo si lëkurë e bardhë e e hollë qi gjindet nên gërvozhë.

42) edhe ketu si shprehet mirë të hjekunt e pengimit qi s' e lênte me pá!

44) sh. n. (23,'

44) pse gjithnji ishin ditë të vështira për popullin e tyne e prandej ajo matuní e tyne qi thamë, nuk i lênte me shfrye në gëzim gjithsesi.

45) frazë e bukur e shkurtueme e shkodranishtes qi d. m. th. i u gjet gadi për ndihmë kurdo qi lypej.

46) t' insistojsh; fjalë po me atë kuptim e me atë përfytyrim *(in-sistare*, m'u vû aty e mos m' u dá), por mâ e gjallë se e jona e mâ e kuptueshme për né.

47) se kështû e lypë urtija: kuvendi âsht i burravet!

48) kinse deri atëherë e kishte mbajtë gjithmonë të mbyllun tue mos diftue të qênët e vet.

49) *me vû*: me grumbullue, me shtî n' arkë, në kavaveta, por me fjalë mâ të fjeshta e mâ të përgjithëta; përkundrazi fuqija e fjalës shkon tue u shtue në progresjon me anë të frazës së dytë piktoreske „grumbujt e florijvet".

me lod për faqe, e të dekunit i vorrojshe 50), une para ja qitshe Zotit uratën tande... 51) E për tash Zoti nisë më ká, tý me të bâ derman, e Sarën me e pshtue prej djallit; përse un jam Raffaele, njêni asi ênjejsh qi Zotit para i rrijnë. Kúr ja ndiene kto fjalë mbetnę pá gojë, e tui u dridhë rán me ftyrë për dhé 52). Enjelli atëherë ju tha: Pagja kjoftë me jú, frigë mos kini, pse, për sa kjeçë me jú, kjeçë pse kshtu Zotit i rá në hatër (desht Zoti), atê bekoni e lavdet e tija këndoni 53). Sá giati fjala e u zhduk sŷve të tyne. E ato Zotit i dhânë bekimet e qitne në mejdan (shesh) mrekullít e tija. Si i jati, ashtu i biri errnuene prep shum fort pá ju prishë zemra e tyne kurr, e kúr ju erdh dita e mbrame mbyllne sŷt e vet e diqne të hatruem (dashtun) prêj Zotit. *)

c) Nga drami „I BIRI I ÇËFUTIT"

Duka e Parë

Zef Jaku (tregtár) tuj shkrue, e Prêla (shërbtori malsuer) me nji letër në dorë.

Prêla. T' u ngjatët jeta.

Zefi (tue shkrue në nji 1) pá e bâ hesáp 2). Une po të porosis sa mâ fort qi të mundesh...

Prêla. A po ndije, zotní? *(Çon mâ fort zàn'.)*

Zefi. Po lê të mbaroj. (*Si herën e parë*).

---

50) Ket shërbim u a pat bâ ai bashkatdhétarvet të vet kur tirani i huej e ndalonte, e mun tue e bâ i kishte punue rreziku e kishte verbue.

51) Gadi si tue thânë: un jo, por ju e kini meritimin.

52) Fuqija e ndiesivet fétare në shpirtën të fjeshtë e të shëndoshët.

53) Sá e bukur kjo drejtsi e matun e këtij të qênuni të naltë qi lavdet u a sjellë njerzvet të drejtë qi ndihmën e Hyjit e kanë meritue e Hyjit qi desht me u a dërgue nepër veprim të tíj.

*) Kjo copë, e përmbledhun prej Babit prej Shkrimit të Shêjtë, n'origjinal të vetin, njehet si nji ndër shembujt mâ të shkëlqyeshmit e stylit kallximuer; përmbledhja e hijeshija e gjuhës së këtij shkrimtari janë vepër mjeshtrore e pá shoqe, të cilën kush nuk do me tretë në marrína t'artit të prishun do t'a két para sysh.

1) *në nji:* páprémas.

2) *pá e bâ hesáp:* pa i vû ré.

Prêla. Kom [3]) nji tanden fort për yzyr letër [4]).
Zefi. Sá çasi. (*Pa e shikjue*).
Prêla. Sá çasi edhe nji sahat (*me vedi*). S' ko [5]) ç' tham ; punën tême e bona [6]). Çdo t' i dalë nuk ká pse ankon me mue.
Zefi. Qe prá : mbarova.
Prêla. (me vedi :) Mo' e' qê' [7]).
Zefi. (mbyllë letrën, e vulosë, e tuj e shkrue për-jashta thotë me vedi :) Zotnís... (*Mandej çohet e tuj ja dhânë Prêlës* :) Merre, paradite ké me e çue në shpí t' advokatit t' êm. (*Ja ep*).
Prêla. Po mirë. Qe edhe nji tjetër ; na' : prej Gallipolit (*shqipton malcorisht „Gallipòllit" ; e ja lëshon në dorë*).
Zefi. Prej Gallipolit... Po kû jé ká herë [8]). Edhe e di bile se âsht për yzyr e më duhet.
Prêla. S' ko' pasë si mâ parë me të kalxue... më fal fajin (*me e bâ hokë*).
Zefi. Jé sherr. (*Me buzë në gaz çilë letrën*).
Prêla. Kjosh me nderë zotnija e jote,... se njatje s' jam.
Zefi. Katërmbëdhetë Novembre !... [9]) Pêsë dit vanesë... Po kush ta ká dhânë e kúr ?
Prêla. Kúr ta ko' prû. Edhe vrap bilè.
Zefi. Elè po këndojmë. (*Këndon pá zâ*).
Prêla. Adet i zí boll [10]) âsht (*me vedi*) me i këndue letrat pá zâ... Nabarè për farë nierzijet.
Zefi. (çon zân tuj e këndue). Tue shkrue po nise... për Hingliz barra e vojit, e malli tjetër i joti. (*Ndalet prej këndimit*) Zotit i kjoftë lavdi.

---

3) *kom* : kam.
4) *për yzyr* : për ngut ; ndërto : kam nji letër t' anden fort për ngut.
5) *ko* : kam.
6) *bôna* : bâna.
7) *mo' e qê'* : mos eh qên.
8) Tek e mbrâmja.
9) Aso kohe fillonte m' u zhdukë fjala „vjesht' e dytë", pá pasë hŷ ende neologjizma „nanduer".
10) Zakon i keq mjaft.

Prêla. Zoti do ta bije mbarë, pse je nieri i mirë. Mos bo' gajle, ti gjith herë ké me u rritë mâ fort... Po të kalxoj un.

Zefi. Na, Prêlë. (*I jep pare falë.*)

Prêla. Po bâj séri... (*tuj e marrë*) do me më marrue. (*Tuj e kqyrë :*) Gjysë groshi ! Po mirë, mirë. Edhe për mue kujtoi Zotynë.

Zefi. (këndon për së dytit edhe sá çasi letrën, e tuj e mbyllë :) Ti më ké prû lajm të mirë, e po me vojtë ajo barrë pá farë damit...

Prèla. Atëherë tash më falë edhe mâ randë, as ashtu ?

Zefi. Me qéf bilè ; kúr të ma bijnë Zoti ndonji fitim pá dam të kujin, due të kénë mirë edhe gjith sá ma bâjnë shërbimin pá hile.

Prêla. Për kah besa s' und ma dalë, kujtoj, për në konak tand [11], kushi. Ani të gjith mirë i due, të due tý, të due fëmijn tonde...

Zefi. Po njimend... a kanë bâ ato kolecjon ?

Prêla. Jo, t' u ngjatët jeta.

Zefi. Po pse ? (*shikjon sahatin.*) Ká vojtë nandë.

Prêla. S' po diej... prishaqéfas diç jonë.

Zefi. Si ?

Prêla. Po ta thom, mos me më qitë [12] : une e ko' pá Lekën ke kján.

Zefi. Leka kján ?

Prêla. T' boj rixhá [13] mo' me më qitë : se më ká vû i shkreti léçí [14] kúj mos me i ftue [15].

Zefi. Kalxo si âsht ; kush e ká ngá, Jaku a Pjetri ?

Prêla. Si kujtoj, Jaku. Por aman, mo' më shtjer në keq !

---

11) Për kah besa ndaj shtëpín t' ande, s' mundet, kujtoj me m' a dalë.

12) në qoftë se s' po më qet, mos difto se unë e kallxova.

13) të lutem.

14) porosí.

15) *ftue :* diftue.

Zefi. Ato qi duhen aq fort! E ja kanë shoqi shoqit hatrin. Po si âsht puna?

Prêla. Si âsht puna?... Diç do të jétë njimend... qi... edhe vetë mund bijsh më to.

Zefi. Duhet me e dijtë. Thirrma Jakun.

Prêla. Amana Zotní...

Zefi. Jakun po tham! Jakun, merr vesht? (*çon zân'*).

ZEF VALENTINI

BKSH

KAPTINA VI.

Prodhimi letrar i Arbëreshvet t' Italisë

NJOFTIME TË PËRGJITHËSHME

Kur përdorimi jo i njëj alfabeti kombëtar, por i gjuhës amtare vetë ishte në Shqipëri një faj i rëndë, dhe kur armiqtë mundnin me çdo mjet e çdo formë propagande, të ndalonin e të mbytnin çdo përpjekje përparimi qytetar e kulturor të popullit shqiptar, idea e kombit dhe e atdheut, së bashku me traditën më të mirë të gjuhës, gjente strehë të sigurtë midis Arbëreshvet, të cilët n' Italí munden të zhvillojnë lirisht gjuhën e etërvet të tyre.

Një ideal i qëndruarshëm e një qëllim fort bujar i përcaktuar ka frymëzuar shkrimet e veprat e të gjithë shkrimtarëvet e poetëve shqiptarë të Italisë, që nga më të moçmit gjer në ata të ditëve të sotme: ruajtja e gjuhës shqipe si mjet i volitshëm i ruajtjes së kombësisë.

Po për këtë ideal e po për këtë qëllim punuan bashkërisht me shkrimtarët e me poetët, të gjithë ata burra veprimi, ata shpirtëra fisnikë si: **Andrea Reres, Gjergj Guzzetta, Françesk Saluto,** *e të tjerë, të cilët, duke themeluar kolegje, institute e Seminare për Shqiptarët e Italisë, — në pjesën më të madhe edhe sot në lulëzim e sipër, — siguronin për shekuj vatra të vërteta kulture, doktrine, studimesh shqiptare, dhe sajonin shkolla të vërteta letrare shqiptare, prej të cilave duallën turma studjozësh, shkrimtarësh, poetësh, patriotësh të shkëlqyer e të pa lodhur.*

Me anë të veprimit të këtyre Institutеve, me të vërtetë fatmira, dhe sidomos t' atyre dy më të çquarave, Kolegjit të Sh. Mitër Koronës *e të* Seminarit Shqiptar të Palermit, *tradita atdhetare e letrare trashëguar nga themeluesit e parë të Kollonive shqiptare të Italisë ka mundur të përballojë shekujt dhe ka mundur t' arrijë ndër ne edhe e gjallë, pjellore e plot me jetë.*

Prej atyreve kanë dalë emrat më të dashur për Shqiptarët e Italisë e për popullin shqiptar, nga **Lukë Matranga, Jul Variboba, Nikoll Figlia,** *ndër më të moçmit, te* **Jeronim De Rada, Gabriel Dara, Anton Santori, Zef Serembe** *dhe* **Dhimitër Kamarda** *gjer te ata të sotmit,* **Zef Schirò, Nil Borgia, Agostin Ribecco** *e* **Gaetan Petrotta** *e në shumë të tjerë.*

Pas vdekjes së Gjergj Kastriotit, si u copëtua njësija e kombit e themeluar me aqë mundim nga Kreshniku i ynë, si u shpërnda njerëzija e jonë e si u fundos populli shqiptar në vrellë të barbarizmit e të neveritjes turke, zhduket në tokën e Skenderbeut çdo gjurmë kulture e lirije dhe krahinat e mrekullueshme të vëndit t' onë fatkeq bijen në më të mjeruarshmin pushim shpirtëror moral e lëndor.

Në ketë shkatrrim të përgjithshëm, Shqiptarët mundën sa kaqë herë të ringjallin, sidomos me priftërit e tyre, një traditë kulture shqiptare, gjithënjë në lidhje midis Shqiptarvet të Shqipërisë e të Shqipëtarëvet t' aratisur në Itali.

Shumë elemente kemi për të treguar se kurr Shqiptarët e Italisë nuk i këputën marrëdhënjet e tyre me vëllezërit shqiptarë t' Atdheut të shtypur.

Posa të vëmë re, kupëtojmë se me qëllime të njënjëjta priftërit shqiptarë përtej e përkëtej Adriatikut, përpilonin e shtypnin librat e tyre fetare, të shtyrë nga një qëllim i vetëm i përbashkët për të ruajtur me kujdesinë më të madhe gjuhën e për t' a shpëtuar nga prishja e dalngadalshme e nga hyrja e fjalëvet të huaja.

Lukë Matranga, *krye-prift i Piana dei Greci në Siqeli, më i moçmi shkrimtar italo-shqiptar, duke botuar* Katekizmin *e tij në vjetin 1592 kënaqej (sikundër që e pohon në kushtimin*

që i bën kryepishkopit të Monrealit) që djemt e vajzat e qytetit të tij të venin duke përsëritur nepër rrugët vërtetësitë e fesë në gjuhën amtare arbëreshe.

Më 1609 **Andrea Reresi** *një siqeljan-shqiptar, fisnik e i pasur, themelonte me pasurinë e tij në Mezzojuso Manastirin e famshëm Bazilian për murgë shqiptarë, të cilët, të pajisur me përdëllim e me doktrinë të mundnin t' u sillnin dobi jo vetëm bashkëkombasve të tyre të Siqelisë, por edhe popujve fatkëqinj t' Epirit me anë të kathedravet e të shkollavet, sikundër ay vetë e kishte lënë të shkruar në testament.*

Ndërkohë **Gjergj Guzzetta,** *shqiptar nga Siqelija, me veprat* e *me shkrimet e tija ngrihesh në mbrojtje të Kombit shqiptar, dhe kërkonte çlirimin e tij prej Turkut nga Karli i III, Mbret' i Dy Siqelive, prej të cilit arrin të sigurojë mjetet për të themeluar atë Seminarin shqiptar të Palermit (1734) që do të bëhesh për shekujt e pastajmë e gjer në ditët e sotme vatra e kulturës dhe e atdhetarizmit shqiptar, çerdhja e të gjithë atyre shkrimtarëve e atyre poetëve të shquar që nderojnë njëkohësisht kolloníi shqiptare të Italisë e Shqipërinë.*

Dhe veprimtarija e mrekulluarshme, zhvilluar ndër ato kohë nga Gjergj Guzzetta në dobi të popullit shqiptar, pati një jehonë kaq të madhe edhe ndër Shqiptarët e Shqipërisë sa që Gjon Battista i Nikollë Kazazit, krye-pishkopi i Shkupit, kur në vitin 1740, me çudín e tij të madhe, gjeti në Bibliothekën e Propagandës në Romë, fort të vjetrin Meshar shqip krejt të grisur për vjetërsi *të Gjon Buzukut, përshkrojti me dorën e tij një eksemplar të faqes së fundit, i lumtur që t' i a dërgonte dhuratë të përshndritëshmit At Gjergj Guzzettës, themelues i Seminarit shqiptar të Palermit,* prototyp *(si shkruante vetë Kazazi)* i njerëzve zemërbardhë e i shpirtit e i bujarisë së kombit shqiptar.

Lulëzonte në këtë kohë në Siqeli e në Kalabri një veprimtari e gjallë studimesh e prodhimi poetik e letrar shqiptar.

Pal Maria Parrino, *dishepull i dashur i At Gjergj Guzzettës përpunonte studimin e tij madhështor historik mbi Shqipërinë* De consensionibus Albanensis cum Romana Ecclesia,

mbetur dorëshkrim në Bibliothekën e Seminarit të Palermit, i të cilit ka qenë Rektor i parë.

Nikollë Figlia *(1737) nga Mezzojuso e* **Nikollë Brankati** *(1741) nga Piana dei Greci pasuronin poezinë popullore fetare në Siqeli, kurse* **Jul Variboba** *(1762), njëri nga të parët nxënës të kolegjit italo-shqiptar të Kalabrisë, shkruante poezitë e tija origjinale fetare dhe veprën e tij kryesore* „Gjella e Shën Mërisë“.

Duhet të kujtojmë shkrimet e **Nikollë Ketës**, *që aty nga mbarimi i shtatëqindit, u muar me gjuhën e me historinë shqiptare; ashtu edhe veprat e* **Anton Santorit**, *të* **Zef Krispit**, *të* **Vinçenc Dorsas**, *të* **Zef Serembes** *dhe mbi të gjithë studimet e gramatologjisë shqipe të* **Dhimitër Kamardës** *dhe veprën shum të çmuarshme të* **Gabriel Darës**, *auktorit të* „Këngës së sprasme të Ballës“.

Ësht e tepërt të përmendim sa di çdo shqiptar mbi veprimtarinë e mbi shkrimet e mbi flijimet e **Jeronim De Radës** *e të* **Zef Skiróit** *për zgjimin politik, qytetar e kulturor të popullit shqiptar dhe sesi veprimtarija e tyre u zhvillua në bashkëpunim të ngushtë me veteranët e me dëshmorët e çështjes kombëtare, për të mundur kështu një turmë bijsh shpirt-mëdhej të Shqipërisë, përtej e përkëtej Adriatikut, të kurorëzojnë në Nëndorin historik të vitit 1912 përpjekjet e dëshirat e gjith Shqipëtarëvet pa përjashtim.*

Kjo gjë — thoshte Arbëreshi Pjetër Chiara në vitin 1869 — nuk i dihet as politikës as fuqisë s' armëvet, por vetëm dy Fuqivet të një rendi të lartë : letërsísë dhe gjuhësisë.

ROSOLIN PETROTTA

Burime :

- Chiara Pietro «*L' Albania*» Palermo 1869.
- Dora d'Istria «*La Nazionalità Albanese secondo i canti popolari*» Cosenza 1867.
- La Piana Marco «*Il Catechismo Albanese di Luca Matranga*» — Rivista «Roma e l' Oriente» Anno II. aprile-settembre 1912.
- Petrotta Gaetano «*Popolo Lingua e Letteratura Albanese*» Palermo 1932.

1. — LEKË MATRANGA *) — Katekizma (1592)

Prifti italo-shqiptár, D. Lekë Matranga, lindun në Piana dei Greci (Sicili), rreth vjetit 1560, tue dishruem me u ardhun në ndihmë me mësime të mbara vllazënvet të shpërndám ndër krahina t' Italís së jugut, përktheu shqip nji katekizëm të vogël të spanjollit A. Ledesma S. J.

Dorëshkrimi i Matrangës ruhet sod në bibljothekën e Vatikanit 1) në trí kopje, në format të vogël, qm. 14.50 gjatë për 10 gjânë, ka gjithsejt 174 faqe. Kopja e parë e katekizmës ka në të hŷm nji letër kushtese me randsí historike, nënshkrue ditën 20 Mars 1592. Mbas kushteset vjen nji kangë e përshpirtëshme shqip me përkthimin latinisht. Nisë mandej katekizma me pyetje e përgjegje shqip, ndërlikuem me përkthimin italisht. Kopja e dytë dhe e tretë nuk kanë gjithaq ndryshim prej së parës ; ndryshimi âsht vetëm n' orthografí e për punë se këto dý nuk janë të përcjelluna nga përkthimi italisht.

Mbassi kopja e tretë kishte në fund ketë shenim : *Originale dello stampato*, ishte gjith gjasa, se katekizma do të kishte qenë shtypun ndonji herë. Edhe njimend, albanologu Mario Roques në vjetin 1932 mujti me e gjetun, gjithnji në bibljothekën e Vatikanit, nji kopje të shtypun të librit të Matrangës 2). Libri ka ket titull : *Embsuame e Chraesterae/Baeaera per tae Urtaenae Atae Ladesmae/sciochiaeriet Iesusit./E prierrae laetireiet mbae gluchae tae arbaerescíae paer Lecae Matraengnae/ Imbsuam i Cullegit Graec të Romaesae* 3). Vijon përkthimi italisht i titullit, me emnin e shtypshkrojsit : *Guglielmo Facciotto 1592.*

Katekizma e shtypun e Matrangës ka gjithsejt 28 faqe formatit XII.

Gjuha e Matrangës âsht tosknishtja e hershme, me karakteristikat e nëndjalektit të Çamerís ; mbassi kolonija e Pianës

*) Shqiptarët e Italís emnin *Lekë* e kanë për *Lukë* dhe jo për *Aleksandër*.

1) Dorëshkrimi ka ket shenim : *Cod. Barber. latin. 3454.*

2) Katekizma e shtypun ka ket shenim : *R. G. Teol. V. 1265.2.*

3) Këndim i titullit : *E mbsuame e krështerë, bërë për të Urtënë Atë Ladesmë, Shoqërijet Jezusit ; e prierë lëtirejet mbë gluhë të arbëreshë për Lekë Matrëngnë i mbsuam i Kulegjit grek të Romësë.*

njehet e dalun shi nga kjo krahinë e Shqipnís, e themelue në Provincën e Palermit qyshë vj. 1485. Me gjithkëta, kemi në shkrimet e Mt. elemente gjuhsore të djalektit të Shqiptarvet t' Italís, sidomos për shka i përket fjalorit e fonetikës.

Libri me gjithë greqizme, tepër të vrashta e nga ndonji herë të panevojshme, prap e ka atë randsín e vet gjuhsore; mbassi na ep pasqyrën e tosknishtes së hershme.

Orthografija e Matrangës âsht shum e mbyllët; se auktori, vetëm me gërmat e alfabetit latin, tue bâ grupe, shpesh të pakuptim, mendoi të shprehte gjith tingujt e shqipes.

Nga vepra e Matrangës

a) Fëtesë e përshpirtëshme

Gjithëve 4) u thëres kush do ndëljesë 5),
të mirë të krështé 6) burra e grá, 7)
mbë fjalët të t' inë Zot 8) të shihi 9) meshë,
se s' ishtë njerí nesh çë mkatë s' ká;
e lum kush 10) e kujton se ká të vdesë,
e mentë bashkë mbë t' ëne Zonë i ká,
se Krishti ndë parrajsit i bën pjesë
e bën për bír të tíj 11) e për vëllá.

---

4) *Gjithve u thëres.* Vre se Mt. nuk thotë: *gjithëvet*, për arsye se ky përemën nuk merr kurr trajtat e caktueme. Me ketê shkon: *tanë*, *disâ*, *të dy*, *të tre*. Për t' u theksue âsht puna, se A., tue shkue mbas njij soleçizme popullore, ndërton me dativ *(gjithve)*, verbin *thrres*, qi këtu lypë rasën IV. Ky verb, vertetë, se merr edhe r. III, por vetëm atëherë, kur ka veshtrimin: *i lëshoj zâ*, *i bâj zâ ndokuj;* kurse këtu ka veshtrimin: *ftoj*, si: *thrres mikun* (jo: *mikut) për darkë.* Arsyeja e këtij shpërdorimi spjegohet në faktin, se tue u dashun nji caktim mâ i plotë ndër këso fjalísh, e n' anë tjetër, si thám, tue u mungue këtyne trajtat e caktueme, përdoret dativi. Kështu ndiehet: *Tę tanve na qiti jashtë; të dyve na la në pendesë; unë po ju fali të gjithve.* 5) *ndëljesë.* Prej lat. *indulgentia*, zbrû sod në f.: *ndjesë.* 6) *krështé* krështerë. 7) *grá.* Mâ poshtë: *ká vëlla*, *njerí*, *bír* etj. Në Mt. kemi zânoret e gjata, bjerrë sod gati në mbarë tosknín. 8) *të t' inë Zot.* Mt. në gjith librin e vet nuk ká *y:* tingull i shëndrruem n' *i*, sikur ndiehet sod në krahinën e Mirditës e gadi gjithkund në djatektin e jugut. 9) *të shihi.* Shkurtim i gojës së popullit për: *të shihni;* 10) *lum kush.* Ndër të thânme enfatike, si këtu, lêhet jashtë neni. Plotso: *Asht i lum kush.* Kështu thomi: *Mjerë kush bâhet për tê!* 11) *e bën për bír të tij.* Në vend. të pronorit refleksiv të drejtë, *të vet*, qi ka humbë kryekëput në djalektin e jugut.

b) Të falemi, Perendeshë! 1)



degni
acciò siamo fatti delle promissioni di Chri-
sto, amen.

Të falemi peraendexae, aemae e eleimosinit,
ghela e ambla e pandeschija jonae, tae
falemi tij tae, thaeresaemae nae tae dbua
mitae bigl. tae, euaesae tij xeratignae
ma tue, eghiumuarae e tu, e claarae
adae, catae gropae tae lotet, xpeito adae
ti ccia paracalesn paer nee e prijr neeue
sijtae e tuu tae eleimosinit e pas, catij tae
sbuami daeftona yisus chrixnae pemae
nae e beecuame tae xcaefit tue o, e para
ponesme o e lipisurae o, e aemblae, virgj-
arae xanmarij paracales paer nee, xeita

Nji fac-simile i librit të Matrangës.

Fyt. 6. — Nji fac-simile i *«originale dello stampato»* të Matrangës, dorëshkrim i botuem nga M. La Piana në *«Roma e l' Oriente»*. (Rivista e Monastirit të Grottaferratës — Viti II prill-shtatuer 1912)

Falemi, Perendeshë, ëmë e eleimosinit, 2) gjella 3) e ëmblë e pandohija 4) jonë, të falem. Tíj të thëresëmë 5) na të dbuamitë 6) bil të Evësë, Tíj sherëtinjëmë 7) tue gjumuarë e tue klárë ndë këtë gropë të lotet 8). Shpejto, adhá, 9), ti çë parakalesën 10) për né, e prír 11) neve síjtë 12) e tú të eleimosinit, e pas këtij të zbuami 13) dëftona Ijsus Krishnë, 14), pemënë e békuame të shkefit 15) t' it, o e paraponesme 16), o i lipisurë 17), o e ëmblë Virgjërëshën Mëríj, parakales për né, shejta 18) ëmë e t' inë Zot, se të bënemi prepsatorë për të taksurat 19) të Krishtit. Amin.

c) Të tetë të lumetë 20)

M. (jeshtrë) — Për çë shërbesë 21) u tipos njeriu ? 22)
I mb. (suam) — 23) Pse të dé 24) e të shërbenjë t' ënë Zonë ndë ketë gjellë, prá t' e 25) shohë e t' e trashëgonjë ndë t' jetërët.

---

1) Të késh para sysh *fac-similen*. N. 6. 2) *Falemi P.* Verbit i mungon grimsimi përemnuer *të*, sikur e ka mâ vonë. Edhe na sot, në nji të thirrme analoge, e hám e thomi: *Falemi, Mrí*, në vend: *Të fal. M.* Mandej, për t' u theksuem âsht thirrtorja *(perendeshë)*, përdorë mirë prej Mt. në trajtën e pacaktueme, si e lypë gjuha, kur si këtu, êmni mos të jét i përcjellun nga ndonji atribut; kurse këtu sod na thomi gabimisht: *Falemi, Rregjinesha.* Krs. *Falemi, Mrí* e jo *Fal. Mrija.* 2) *ëmë e eleimosinit.* Grq. *e mëshirës.* 3) *gjella :* jeta. Fjalë gjithnji në përdorim ndër It.-Shq. kurse na kemi vetëm adjektivin e verbin: *I gjallë, me gjallue.* 4) *e pandohija jonë.* Grq. *përbûjtore*, këtu: *shpresë.* 5) *të thërresëmë.* Me zbutim të mbaresës së verbit *im*, zbunim, qi e kanë shpesh shkrimtarët e hershëm edhe ndër emna. P. sh. *Zotin, Zotën, Zotnë*, (tënë Zo'n). 6) *të dbuamitë bil :* Bij dalë a qitë jashta vendit të vet, (lat. *exules).* 7. *Tíj sherëtinjëmë* : fshâmë, me kuptim tranzitiv. 8) *të lotet* : të lotvet. Sinkope e zakonshme ndër të vjetër. 9) *adhá.* Greq. *por, pra.* 10) *çë parakalesën.* Greq. *lutesh.* 11) *e prír* : siell. Në Buzukun e në Bogdanin e gjetiu edhe në Mt. verbin e kemi me diftong në rrâjë: *prierë.* 12) *sitë* : sytë. 13) *të zbuami* : *mbas këtij mërgimi.* Zbuami : *dbuami;* si: *dborë, zborë.* 14) *J. Krishnë* : Nga : J. Krishtin. 15) *të shkefit.* Greq. *golle, zgavrrë, lundër ;* këtu : *bark.* 16) *o e paraponesme.* Greq. këtu marrë për : *e dhimbëshme.* 17) *e lipisurë.* Greq.: *e mishirshme, zemërbutë.* 18) *shejta.* Nga : *shêjte* në të pacakt. do të pritshim : *shejteja*, a nemose : *shejtja.* 19) *prepsatorë, për të taksurat.* Greq.: *të denjë për premtime.* 20) *Të lumetë.* Adjektivi femnuer për abstraktin : *lumnít.* Krs. me të soçmet : *të mirat, të këqijat, të zezat*, etj. 21) *çë shërbesë.* Ndërsa gjetiu e ka ketë fjalë mâ të shumtën në kuptimin : *send, punë*, si e kanë edhe sod Shqipt. e It., këtu e merr mâ haptas; për: *qellim.* 22) *u tipos.* Greq. *u krijue.* 23) *I mbsuam*, për : nxânës. 24) *pse të dé :* qi të doe. Djalektare e Pjanës. Krhs. *vé orè ;* mandej : *lé, pé* (me zanore të çiiun, për: *lae, pae*, etj. 25) *prá*, për : *mandej.* E kanë edhe tjerët : *t'e shohë, t' e thash.* Sod këta të ndeshun përbân bashkimin : *t' a, m' a.* Gjithnji por, të bjen me e ndiem në trajtimin origjinár *(e mora, t' e mora)* edhe në ndonji krah të Malsis së Mbi-Shkodrës.

M. Sá shërbisë janë hrí [26]) të krështerit, se të vinjë [27]) ndë të sosurit të tij [28]) e të lefterosetë ? [29]).

I. Mb. Katër : Besa, pandohí [30]), të dashurë e të bëmë të mirë. [31])

M. Thuaj të tjerat shërbisë, çë mbahenë mbë të bërët të mirë, o mbë të mbsuamet të krështerë ?

I. mb. — Të tetë të lumetë :

1. Lumtë ata çë janë vabëk [32]), pse e tireja ishtë perendia e qiellvet.
2. Lumtë ata çë janë të butë, se ata janë të trashgonjënë [33]) dhénë.
3. Lumtë ata çë kláně, [34]) pse kanë të jén fëqerë. [35])
4. Lumtë ata çë kanë û e et për ligjtë, pse ata kanë të jénë glirë [36]).
5. Lumtë ata çë kanë lipësí [37]), pse ata kanë të jénë lipisurë.
6. Lumtë ata çë janë qëruarë zëmëre, pse ata kanë të shohën t' ënë Zonë.
7. Lumtë *(të)* mbaqëruamitë [38]), pse kanë të kluhën bil të t' inë Zot.
8. Lumtë ata çë psonjënë të përzëna per ligjtë [39]), pse e tireja ishtë perëndia e qiellvet.

---

26) *janë hri.* Greq. *nevojë.* 27) *se të vinjë.* Lidhsa me kuptim qellimuer: *pse.* 28) *ndë të sosuritë të tij.* Emnin e ka nxjerrë nga v. = *sosi*, tue i dhânun kuptimin final *(qellim).* Përveç kësaj, mbas emnit të caktuem, kishim pritë nenin e caktuem *(e).* 29) *të lefterosetë.* Greq. *të librohet, të shpëtojë, të shelbohet.* 30) *pandohí*, Grq. *për bûjtore ;* këtu për: *shpresë.* 31) *të bëmë të mirë.* Në njehsim, mbas *besa*, kishin vijue edhe tjerët mâ mirë në të caktuemen. Sod thomi: *Feja, shpresa, dashtënija e veprat e míra.* 32) *vabëk :* vobeg, skamnuer· 33) *janë të trashgonjënë.* Futur: *kanë të trashegonjën.* Shembull i vetëm me ndihmtarin *janë*, në vend të të zakonshmit ndër It.-Shq. *kanë të.* 34) *klânë :* klájnë. 35) *fëqerë.* Mbas tekstit it. këtë fjalë, të panjoftun prej leksikografëvet, e merr për: *ngushlluem.* 36) *glirë.* Gegët e hershëm kanë : *M' u nginjun, m' u ngîm.* 37) *lipësí.* Greq. për: *mishirë, dhimbë.* 38) *mbaqeruamit.* Nga fjala *paq* me *m* protetike. Lat. *pacifici.* 39) *të përzëna per ligjtë :* kundërshtime, salvime

II. — Të shtatë të bëmetë të eleimosinit

1. Japsh të hánë të vabëgjet të urtë [40]).
2. Të japsh të pijnë atire çë kanë et.
3. Të veshnjësh të xheshuritë [41]).
4. Të mbëljethsh piligrintë [42]).
5. Të sinodepsnjësh [43]) të sëmurëtë.
6. Të sinodepsnjësh të filakosmitë [44])
7. Të këlaç ndë botë [45]) të vdekuritë.

III. — Të shtatë të bëmetë të eleimosinit të shpírtit

1. Të japsh kshíll të mirë të tjerëvet.
2. Të mbësojsh të pándlëguashëmitë [46]).
3. Të mundojsh [47]) të mkatënorëtë.
4. Të ofiqesh njerëzitë [48]) e tiranisëm [49]) e të helmuam
5. Të ndëljesh [50]) të pësuarët e të sharat çë ké pasurë.
6. Të durojsh me durim pirasmotë [51]) dhënë së tjerësh [52]).
7. Të parakalesnjësh [53]) t' ënë Zonë për të gjallët e për të vdekurit.

---

40) *të vabegjët t' urtë:* Skamnorvet t' uritur (t' ûnshëm) 41) *të xheshuritë:* Të xhveshurit, të zhdeshunit. 42) *Të mbëljethsh:* Të përbûjsh shtegtarët. E ka edhe it. *raccogliere i p.* Për t' i u vû shênjë diftongut të verbit *(mbljedhë);* fort t' arsyeshëm, mbassi kênën e tij t' a vërteton trajta e aoristit, i cili bân: *mblodha*, e jo: *mbledha*. 43) *Të sinodepsnjësh:* Grq. *Të perciellesh, të shkojsh me pám.* 44) *të filakosmite.* Grq. *Të ruejtun, të burgosunt.* 45) *të kellaç ndë b.* Verbi *(këllas)* përdoret në Pjanë me kuptimin: *shtîj në dhé, rmoj të vdekunit.* 46) *të pandlëgluashmite:* të padijshëmt, nga kuptimi origjinár i v. *i ndelgoj* (intelligo). 47) *të mundojsh.* Për: të monojsh, (it. *ammonire* = këshilloj, qortoj, mësoj). 48) *të ofiqesh* It. *officiare:* me bâ nji shërbim të mirë, me ngushlluem. 49) *e tiranisëm.* Grq. *e ndrydhun, e shkelun.* 50) *te ndeljesh.* Lt. *indulgeo,* zbrû në shqipen në verbin: *ndiej,* (fali). 51) *pirasmotë.* Grq. *tundimet, dhûnët.* 52) *dhënë se tjerësh.* Shembull i rrall i hjektores *(alb. personae-agentis)* pa parafjalën *prej.* 53) *të parakalesnjësh.* Grq. *thrras në ndihmë, lutem.*

ç) Të gjallunt e kurmit 54)

(Copa të lira)

M. — Çë shërbesë ishtë të anastisuritë të kurmit e e pásosmeja gjellë ?

I m. — Ishtë, se ditënë e gjiqit kemi të anastisemi gjithë me shpírtit e me kurmit, e kanë të venë të mirëtë të shohënë e të trashëgonjënë t' ënë Zonë e të këqietë ndë pisët me djallashit.

M. — Kush vete ndë dhëmburat të kathartirit?

I m. — Ata shpírtra çë vdesënë ndë hírt të t' inë Zot e s' kanë shpërblierë gjithë qish për mkatët të tire ; e pastaj çë paguajtëshinë të dhëmburatë detirë, venë ndë parrajsit. Amin, ashtu kloftë.

d) Ëngjëli i t' inë Zot

Engjëli i t' inë Zot përshëndeti Mërín, e Krishti u zú ndë barkut të saj për Shpírtit shejt.

Thuhetë : të Falemi, Mërí.

Mbë të ditët të rárë :

Hënjë vasha e t' inë Zot, kloftë bërë mua per si fjala jote. Falemi Mëri, hírplota.

E mbë të tretët :

E fjala u bë mish e mbet me né.

e) Imprimatur

Shejti Atë Papa Piu i pesëti, dha katërzet dit ndëljesë gjithë atirëve çë t' e mbësonjënë, e atirëve çë e zënë mentë e mirë ktë mbësuame të krishterë, për gjithë çë të bënjënë, etj.

JUSTIN RROTA

---

54) Këto copa lihen pa spjegime, qi t' i analyzojnë vetë nxansit.

2. — NIKOLLË FIGLIA (1691-1769)

a) Jetëshkrimi dhe vepra e tij

Dita e lindjes së këtij shkrimtari italo-shqiptar nuk dihet me siguri, por thuhet se lindi në vjetin 1691, në katundin Mezzoiuso të Sicilís. Dita e vdekjes dihet se qe 18 Nandori i vjetit 1769.

Shqiptarët e ikun në shekullin e XV nga Shqipnija themeluen në krahinën e Palermit kolonít: Piana dei Greci (mâ e madhja e të gjithavet) Kuntisa Entellina, Palazzo Adriano dhe Mezzoiuso. Prej banorvet të Piana dei Greci u themelue mâ vonë edhe katundi i afërm Shën Kristina.

Nikollë Figlia qe auktor poezísh të shenjta shqipe, mâ të shumtat përkthime ase parafraza poezísh siciljane ase italjane, përpiloi edhe nji *Doktrinë të Krishterë*, të përmbledhun dhe të përshtatun për arbreshët e ritit grek në katundin e vet të lindjes, ku veproi si krye-prift afëro 42 vjet, mbassi pat qenë për nji kohë mjaft të gjatë si kryeprift edhe në katundin Chieuti, qi âsht nji koloni shqiptare e Kapitanatës. Këtu u gjet nji dorëshkrim i randësishëm qi përmban shkrimet e tija. Prej këtij dorëshkrimi profesor Michele Marchianò nxorì landën e këtyne veprave: *Canti popolari albanesi* (1908), *Poesie sacre albanesi.* (1908) dhe *Il Cristiano Albanese.*

Shum prej poezive të shenjta të Figlia-s dhe të Brankatit (për të cilin do të flitet mâ vonë) u botuen prej Marchiano-it në veprën e përmendun mâ sipri *Poesie sacre albanesi*, me nji parathanje të gjatë, ku janë përmbledhë lajme jetëshkrimore mbi Figlia-n dhe mbi disa shkrimtarë të tjerë të kolonive shqiptare t' Italís.

Titulli i plotë i Doktrinës së krishtenë të Figlias âsht ky: **„I CRISTEU I ARBRESC" mbësuarë në Mistiriet Kliscesë sceitë.** Me nji herë mbas titullit vijnë këto fjalë: *Miestri Protopapaj i Munzifsit pien, e diagli përghieghiet ngáa të Diel.* Vepra âsht nda në katër pjesë dhe në fund gjindet data 19 Nanduer 1736, nga kryeprifti i Shën Nikollës arbresh të Mezzoiuso-s.

Figlia i përpiloi vjershat e veta dhe përktheu katekizmin në djalektin, qi në kohën e tij flitej në Mezzoiuso dhe vepra e tij ka nji randësi, pse na vlen si dokument të djalektit të njij kolonije arbreshe të Sicilis, ku mjerisht tash gadi nji shekull gjuha shqipe nuk flitet mâ.

KARL GURAKUQI

b) Pjesë të zgjedhura *)

1) «I Cristéu 1) I Arbrésc»

mbësúare në Mistíriet 2) Klíscësë 3) scéitë. Miestri Protopápaj i Munzífsit pien 4), e diagli përghiéghiet ngáa 5) të Díel

Bijr iée ti i Cristée?

Ei 6) Zot 7), për hijr sin Zot.

Psè na bëë 8) të lehscimë 9) in Zot?

Sat e scerbéjme 10), e dúajmë 11) mirë ne ctë jetë, e pastáj te trascëgognemë ne Parraísit.

Saa caa te díe 12) gnë i Cristée cuur i vien ndëlghími 13)?

Cátre scerbisë 14) e iánë Besa 15), sprënza 16), të dasciurit mírë sin Zonë, e të bëgnë te mírënë.

Cë scégn iép se iée i Cristée?

I bëgn críchien 17) scéjta.

Bëne Bíjr sa t e 18) scioh?

---

*) Këto pjesë të zgjedhura të Figlia-s e të Brankatit i nxorëm drejtë për drejtë nga dorëshkrimi kieutian, tash pronë e Ministrisë s' Arësimit, pse nga krahasimi i këtyre me ato të botuara nga Schiro-i, shihet se ka miaft ndryshime shkrimi.

1) *I Cristeu:* i krishterë. 2) *Mistiriet:* mshehtësítë (fjalë e përdorur prej Budit). 3) *kliscësë:* kishës, vërë trajtën më të vjetër *kl.* 4) *pien:* pyet. 5) *ngáa* çdo. 6) *Ei:* po. 7) *zot:* zot, zotni. 8) *na bëë:* na bëri. 9) *të lehscimë:* të lindeshim. 10) *sat e scerbéjmë*: na themi: që t'i shërbejmë. 11) *e dùajmë*: t' a duamë. 12) *caa të díe:* është futuri i vjetër i trajtuar prej verbit me pasë + [illegible]dhore; këtu me kuptimin: *sa duhet të dijë.* 13) *ndëlghími:* kuptimi, d. m. th. kur është në moshë që nis të kuptojë, të arsyetojë. 14) *scerbisë*: ka kuptime të ndryshëme; *punë, çështje, gjë* etj. 15) *Besa*: me kuptimin: *feja.* 16) *sprënza:* shpresa. 17) *críchien*: kryqin, po këtu i gjinisë femnore. 18) *t e*: t' a.

D. M' emrit t' ét, e të Birit, e të sceitit spirt.
M. Sáa Mistírie ianë tech Crichieja Sceitë ?
D. Di, se iánë trij Fáchie, e gnë vétme in Zot.
M. E i díjti [19]) ?
D. Se léu, e vdích për gneríjnë.
M. Saa vo jáne fáchiet scejtes Triádhë [20]) ?
D. Tríj. I játi, i Biri, e spirti scéit.
M. I jati ist [21]) in Zot ?
D. Ej Zot.
M. I Biri ist in Zot ?
D. Ej Zot.
M. I spirti scéit ist in Zot ?
D. Ej Zot.
M. Jánë tre Zotra ?
D. Jo Zot, po tri fáchie e gnë vétme ist in Zot.
M. Persé cto tríj fáchie iánë gnë vetmë Zot ?
D. Persè të trè cánë gnë të cléne [22]) e gnë të Mírë.
M. Práa si ianë tré, në ghith jánë gnë ?
D. Përsé i Ati s' ist leére caa [23]) gnérij, i Bíri istë léere cáa i Ati, e i spirti sceite ist sielë caa të di.
M. Dij ti Bijr të levdosc scéjten Triadhë ?
D. Ei Zot, Dox [24]) paste i Ati, i Biri, e i Spirti scéit, si cle [25]), ist, e të jéte për ghith monë.

2) *Kënca é scén Mriis Rodhári it* *)

Rodhustáne trëndafile
ti m' iee Virghiera scën Mríi
káa vo kopshti s' in Zot síle
as mëë të búkura bëë si tíj.
Mori e scliédhur liumë e liumë

19) *i díjti* : i dyti ; Arbëreshët nuk e kanë tingullin *y*. 20) *Triadhë* : triní. 21) *ist* : është. 22) *të clénë* : të qënë, qënja. 23) *caa* : nga. 24) *dox* : lavdi. 25) *cle* : qe.

*) *Rodháriit*: e rruxares, uratës etj. 1) *rodhustane :* trëndafil i bardhë. 3) *vo* : një pjesëzë e përdorur si lidhëse fjalësh. — *síle* : sillet, vjen. 4, *bëë* : bën. 5) *sgliedhur* : e zgjedhur, si pas kuptimit ital. «eletta», që na nuk e përdorim.

BKSH

çe le ti t' ëmblënë fiáljë
çë Rodharin mir désh sciumë
tilkjna zëmrrë đálj' e dálë.
Sa t kuljtonem nat e dit
kto mistírie páa vo sosmë
bëri Kríshti, Bíri it,
sa t liron néve të mavrismë.
Me atë búzëzë plo gàs
çë më telkj gnë mucatruam
sa t lëërë jétënë e t' mos ngas
Ziárr' e Pisësë pa vo sciuam.
Ti Parráisit mádhe Zonjë,
bën çë kurora çë spendonjmë
t' jéet për liusmë të t dërgonjë
gjith njerii saa do këndonjën.
Tat na jémi sarakjínës
ktiij Rodhárii o mëmza jonë
ndihna ti mos na u líps
sa t vée shpírti me t' in Zonë.
Rridhi gjith' o të krështée
gjegjij t' ëmblën Armonii;
me née bashk Engjul mbi dhée
fálem thonë Zonjë e Shën Mërii.

---

8) *tilkjna*, hiqna. — *zemrrë*, për zëmrën: vré këmbimin e *n* në *r* zëmr-në. — *dalj' e dalë*, dalë nga dalë, pak nga pak. 9) *sa t culjtonem*, që të kujtonjë. 10) *paa sosme*, të pasosura, të përjetëshme. 11) *it.* = i yt. 12) *liron*, lironte — *të mavrismë*, të zestë. 13) *plo*, plot. 14) *ce telkj*, tërheq, shtërngon, detyron, ital. „*costringe*". — *gnë mucatruam*, një fajtor. 15) *t' mos ngas*, të mos preki. 16) *ziárr'*, akuz.: ziar-në, ziarin. — *e Pisësë*, skëterrë, ferr. — *pa sciúam*, e pa shuar, shkon me *ziarr' : ziárr' e pa sciúam të Pisësë.* 17) *Parráisit madhe zonjë*, kupto = ti, o zonjë e madhe e Paraisit, 18) *bën*, bëj. — *kurora*, këtu me kuptimin: kurora e uratës, e rruxares, e pra rruxarja vetë. — *çë spendonjmë*, me kuptimin italisht: „*sgranare il rosario*"; na thomi: „me hequn tespie" a „me thânë uratë" e pra: *bën çë kurora çë spendonjmë* = bën që rruxarja që heqim, a që thomi. 19) *t' jeet*, të jetë. — *për liusmë*, si një lutje. — *të t' dërgonjë* që të dërgojë. 20) *gjith njerij* = çdo njeri. — *saa do këndonjën*; kupto: sa të jenë prej tyre që këndojnë, ital. „*ognuno di quanti cantano*. 21) *Tat*, të tu. — *sarakjinës*, robë, skllavë. Ndoshta prej Saraqenëve, nën të cilët ishte e përhapur skllavërija. 23) *mos na u lips*, mos na mungo. — *t vée*, të vejë, të shkojë. 25) *rridhi*, rrithni, vraponi, brithni. 26) *gjegjij*, ndëgjoni. 27) *engjul*, ëngjejt; ndreq: „ëngjul mbi dhée me née bashkë thonë..." 28) *falem*, të falem, të falemi, „Ave".

3) Durtílja *)

Mori e sgledhura ndër Zonja
ktë vo t' ártënë kurorë
cilnë na dhuruam n' dorë
ti në kjiel ngríjna neve.
Vash' e kukje e rodhustanë
m' rruasc il' o diel hënë
gílji i bárdhë, e trëndafíle
s' in Zot nuse, ëm', e biljë.
Prind si tí s' jam lipism
kij kuides për née mavrísm;
zëmra jote lipisiáre
líggat tona s' varenj fáre.
Po t' ndëliém një ditë na thërret
te Parraísi ku na pret.
Sosi kënka me haidhíi
Zonjësë vírgjërë S. Mríi.

NAMIK RESSULI

---

*) *Durtîlja*, dhurata. 1) *cilnë*, të cilën. 4) *ngríjna*, këtu me kuptimin: na i ruaj, e na i këthe. 6) *il*, yll. 7) *gilji*, zambak. 8) *biljë*, bijë ; këtë varg ndreqe : *qe je nuse, ëm, e biljë e s' in zot.* 9) *lipísm*, të mëshirëshëm ; këtë varg kuptoe : s' ka prind të mëshirëshëm si ti, d. m. th. ti je edhe më e mëshirëshme se prindët. 11) *lipisiâre*, e mëshirëshme. 12) *liggat t' ona*, të këqijat t' ona. — *s' varenj fare*, mos të vërejë, mos të shohë fare. 13) *t' ndëliém*, të ndëjemë, nga mëkatatat. 15) *sosi*, mori funt, mbaroi. — *kënka*, kënga. — *haídhíi*, gëzim. 16) *zonjësë*, e zonjës,... shkon me „kënka".

3. — NIKOLLË BRANKATI (1675-1741)

a) Jetëshkrimi

Gjer disa vjet përpara pandehej se vjershëtori fetar arbëresh Nikollë Brankati kish lindur në vitin 1752.

Pa shkruante më 1907 Zef Skiroi se *Nikollë Brankati nga Piana dei Greci kish vdekur bekimplotë, në moshën afër 38 vjetsh, ditën 24 Qershor 1790.* [1])

Si pas këtij mendimi Poeti i ynë duhej të kish jetuar midis vjetve 1752 e 1790, d. m. th. në pjesën e dytë të shekullit të XVIII.

Veç se këjo ishte në kundërshtim me sa kishte shkruar më përpara Dhimitër Kamarda në *Ligjeratën paraprake mbi Shtojcën e Provës së Gramatologjisë* rreth vjershave qi njiheshin si *të njëj prifti Nikollë Brankati nga Piana dei Greci që jetoi në pjesën e parë të shekullit të kaluar* (XVIII). [2])

Dhe me të vërtetë, kur midis vitit 1908 e 1911 Prof. Mikel Markjanò, italo-shqiptar nga Makja, botoi këngët fetare dhe katekizmin e Dorëshkrimit kjeutjan, të gjetur prej tij në 1901, dhe që përmbante vjershat më të vleftëshme të Filjes e të Brankatit, lajmëronte se ky Dorëshkrim ishte i pjesës së parë të shekullit të XVIII, dhe pikërisht i vitit 1737, dhe se përmbajtja *ësht në pjesën më të madhe edhe më e vjetër.* [3])

Me këtë zbulim kupëtohej vetvetiu se Nikollë Brankati *vdekur bekimplotë më 1790, në moshën 38 vjetsh,* nuk mund t' ishte auktori i vjershavet të dorëshkrimit kjeutjan.

---

1) Giuseppe Skirò — *Canti Sacri delle Colonie Albanesi di Sicilia* — Napoli 1907, faq. XII.

2) Camarda Demetrio — *Appendice al Saggio di Grammatologia comparata sulla Lingua Albanese* — Livorno 1866, faq. 168-shenim (a).

3) Michele Marchianò — *Canti Popolari Albanesi*, Foggia 1908.

Michele Marchianò — *Poesie Sacre Albanesi*, Napoli 1908.

Michele Marchianò — *Il Cristiano Albanese* — Rivista «*Bessarione*» studimesh orientale, Roma, viti 1911.

Gaetano Petrotta — *A proposito di un catechismo albanese del sec. XVIII* — Rivista «*Roma e l' Oriente*» Mars 1912 — Grottaferrata, Shkurt-Mars 1912.

Me anë kërkimesh ndër arkivat e Kathedrales së Piana dei Greci e të Famulltarisë shqiptare të Palermit, të bëra me shum durim nga Zef Skiroi e nga Gaetan Petrotta, mundemi të sigurohemi se poeti i ynë i lëvduar fetar prej Siqelije ka qenë *Gjergj Nikollë Brankati*, prej njëj familjeje së përmendur nga Piana dei Greci, lindur atje më 1675, i cili, si mori udhën e priftërisë dhe u bë doktor në Theologji, për zotësin e tij në dituri, për vlerën e tij dhe për zellin e tij priftëror, në moshën 42 vjetsh ish zgjedhur kryeprift i qytetit të tij, duke filluar nga detyra me 2 Gusht 1717, siç shihet nga Aktet kishtare.

Datat e lindjes e të vdekjes së Kryepriftit të Piana dei Greci At Nikollë Brankatit (1675-1741) dhe ato të kryepriftit Nikollë Filjes prej Mezzojuso (1682-1769) i bëjnë këta dy arbëreshë të ndritur të Siqelisë, dy vërsnikë, dhe spjegojnë se si ndodhen të bashkuar në dorëshkrimin kjeutjan shkrimet e vjershat e dy krerëve të shquar të rilulëzimit letrar e poetik siqeljan shqiptar, vërsnikë e ndofta dhe bashkëpunëtorë të të famëshmit At Gjergj Guzzettës (1682-1756), përtëritës i madh i traditës shqiptare, të cilët, më të plotësuarit e apostulatit të tyre priftëror, duke përdorur gjuhën *kombëtare*, si ç' kishnin zakon të thoshnin aso kohe, i ngrinin një përmendore të çmuarshme gjuhës s' onë të moçëme dhe i sillnin nji ndihmë të shquar letërsisë s' onë kombëtare.

Të gjitha vjershat fetare popullore italjane a siqeljane që qarkullonin atëherë ndër banorët e Siqelisë, At Brankati i përkthente ase i parafrazonte në vargje shqipe që shquajnë për bukuri të trajtës, për pastërti të gjuhës e për metrıkë të rregulltë, dhe ay vetë u a mësonte t' i këndonin besimtarëve e sidomos fëmijve të famulltarisë së tij. Këto vjersha pastaj nga goja në gojë ase të shkruara nga njeri e nga tjetri arritën gjer në ditët e sotme.

Vjershat e At Brankatit u gjetën midis dorëshkrimeve të Imzot Zef Krispit e të Kamardës, i cili disa syresh i botoi, dhe në dorëshkrimin kjeutjan, që pastaj u botuan nga Markjanoi, por në pjesën më të madhe ishin mbledhur nga goja e popullit e nxjerrë nga dorëshkrimet e vendit prej të mirënjohurit

Zef Skiro, që i kishte botuar herën e parë më 1907 për t' i përdorur populli i Piana dei Greci, dhe pastaj më 1923, në vëllimin e vleftshëm „*Këngë gojëdhënore dhe të tjera Prova të Kollonive Shqiptare të Siqelisë*".

Gjergj Nikollë Brankati ka qenë edhe auktor vjershash të bukura e të këndëshme origjinale, ndofta edhe profane.

Vetë Skiroi mendonte se mund t' ishte e At Brankatit Kënga Dasmore „*Daghandishe hiridhone*...4) dhe i mburr vjershat e tij duke thënë: „Ay dijti t' i ndryshonte me kaq shije e me kaq art hartimet e huaja, që merrte si bazë, sa që i bënte si të vetat dhe i siguronte vehtes një nga vendet e para midis vjershëtorëvet shqiptarë, sa edhe të Mëmëdheut". 5)

ROSOLIN PETROTTA

b) Pjesë të zgjedhura

1) Ai fill ujae

1. Ai fiill ujae
Çae barae lipiin,
ku del, ku hiin
e n' lule shkon
me t' math gaezim
duket se thot:
— Lumi in Zot
çae mae buron

. . .

2. E filomela
çae dit e nat
kaendon gaelatae,
as paps ditsa

4) **Giuseppe Schirò** — *Canti Tradizionali* — Napoli 1923, faqe 344-345.

5) ibidem, Introduzione, faqe CIX.

b) *Strofa 1:* shkrojat *ae* janë në vendin e *ë*-s së pazâshme. — *lipiin*: lëpinë por me kuptimin *lag*, *ujit* sipas italishtes *lambe*. *Strofa 2*: *filomela*, fjalë greqishte'

I jep laevdii
Zotit math,
çae gjell' e krah
e zae i dha.

. . .

3. Po eera ç' ushtin
e mbi gjith shkon,
grah e gjaekon
me gojae plot:
Sa fusha rraha,
sa lule shoh,
hiir isht çae njoh
kaa in Zot.

. . .

4. Kjo trundafile
plo ves e mbledhur
e gjith e sgledhur
vetiu thot:
Stoliit çae u kam,
tae kukje llojée
tae bukur hjée
mae dha in Zot.

. . .

5. Ashtu vet xhilji
margaritaar,
çae rgjaend e aar

---

qi d. m. th. *bilbil.* — *gaelatae*: glatë, gjatë. — *paps*: fjalë greqishte për *pushon. ditsa*: grumbulli i shkrojave *ts* përdoret në vend të shkrojës së sotshme *c*; pra *ditsa* = dica — *krah*: krahë, qi i dha jetë e krahë.

Strofa 3: *grah e gjaekon*: ushëtin, bërtet.

Strofa 4: plo: plot: — *e mbledhur:* e mbledhur në vet-vehte, it. *in se raccolta.* — *sgledhur:* e zgjedhur. — *llojée*: farë, mënyrë. — *hjée:* ka kuptimin *bukuri, shije, shkelqim, hijeshi.*

Strofa 5: *xhilji*: lili, zambaku. — *çae u do kam*: çdo që kam; ësht nda fjala çdo në dy pjesë. — *dha*; këtu mungon trajta e shkurtën e përemnit vetor *më* qi sot përdoret rregullisht.

Po n krahae vae,
pa folae thot:
— N' i bukur jam,
çae u do kam
dhá kush mae bae.

. . .

6. Nae ti vaefsh ree
tae madhin diell,
me dritae çae siell
gjithve ra thot:
— Me kakj haidhii
mae llambarisi
e mae kjindisi
i madhi yn' Zot.

. . .

7. Ulj ata sii
e vaerae rée
káfshat nae dhée,
se me njae zae
me gluhae tae tire
gjithae gjaekonjaen
e báshk e laevdonjaen
atae ç' i baeae.

. . .

8. Gjith ato zoga
çae fluturonjaen,
gjé çae kaendonjaen,
nae mos e dii:

Strofa 6: *nae ti vaefsh rée*: në venç ré ti, në kqyréç. — *me dritae çae siell*: me dritën që sjell. — *haidhii*: hijeshim. *llambarisi*: ndriçoi, më bëri të shkelqyeshëm.

Strofa 7: *sii*: sy.

Strofa 8: *gjë*: dëgjo, ndiej! shkurtim në thirrje i urdhnores gjegj! — *dzakon*: zakon.

BKSH

kta bukur vjershae
e ktae dzakon
neve e uron
po njae Peraendii.

. . .

9. Ka guri i gjallae,
nae ti e ndaelgon
ziarri çae shpaeton
gjithve na flet :
— i baeri gjith
kto-vo shkaendijae
aqae mij e mijae
kush bae ktae jetae.

. . .

10. Ashtu gjith jeta
nae çae profthas
njeh e lojas
e t' theet laefton :
— Vetaem in Zot
Stis e gromis,
rreh e lipis,
e po e laevdon.

. . .

11. Vetaem njeriu
ktae Zot tae math
s' e ndèr ditsath ;
po maekatron.

Strofa 9 : *ndëlgon* = i përgjigjet verbit t' onë *dëgjoj*, por këtu do të thotë *kuptoj*.

Strofa 10 : nae çae profthas : në çdo gjë që ngjan. *njeh e lojas* : mendon. *T' theet* : të thotë. — *laefton* : lufton, lëfton, përpiqet. — *stis e gromis* : fjalë greqishte *ndreq* e *rrëxon*. — *lipis* : mëshiron (fjalë greqishte).

Strofa 11 : s' e ndér : s' e nderon. — *ditsath* : ndopak. — *maekatron* : mëkatnon, bën mëkatë. — *akjae* : aq ; ndërto : e sado që bëri aq shum ; këtu nënkuptohet kryefjala Perendija. — *kulish* : këlysh.

E n' do akjae baeri
paer ktae kulish,
si kuur t' mos ish
glat e harron.

.
. .

12. Si madhet ujaet
nae njae suvalae
tae paeshtronjae malae
çae n' dejtit rrii ;
Njeriu me mkat
do t'vrasae e t'mundnjae ;
e s' aen e tundnjae
njae Peraendii.

.
. .

13. E kuur gjith jeta
tae vetmin Zot
me zaemra plot
tae ndernjae kaerkon,
ky dalae truush
t' aen Zot t' vet,
kuj ndeer nget,
po e dhunon.

.
. .

14. Si fluturidhe,
çae flaka djek,
krahaet i pjek
dritae mae dritae ;

Strofa 12 : *suvalae* : dallgë, tallaz, valë. — *të paeshtronjae* : të mbulojë. — *në dejtit* : në mes të detit. — *s' aen* : s' mund.

Strofa 13 : *dalë truush* : i prishun mentsh. — *kuj* : të cilit. — *dhunon* : përbuz.

Strofa 14 : *fluturidhë* : flutur, por me mbrapashtesën greke *idhë*. — *ftesë, mae ftesë* : bije prej nji faji në tjetrin. — *ndaelesae* : ndjesë. — *pjerrt* : ktheftë, nga verbi *prirem* qi d. m. th. *kthehem*.

ashtu ka t' digjet
ftesae mae ftesae,
po vo ndaelesae,
n' mos pjerrt ndo ditae.

(Nga *«Canti Tradizionali»* —
Schirò, f. 145-149).

2) Puhizae e hollae

1. Puhizae e hollae,
çae s' ké vo fis,
mos m' e shungllis
ktae t' aembael gjumae
tae djalit t' im,
mae t' bukur sy;
se me dhrosi
m' e nglinja shumae.

. . .

2. Tae lume zoga,
mae mos kaendoni,
se ju mae sgjoni
gjellaezaen t' ime.
Mos çingaerrini,
se n' kashtae u shtrua,
e nae sanua
tae m' flaerae do.

. . .

3. O ju delmerae,
kaejo s' isht herae
ç' ae ato flojerae
tae fryni ju:

---

2) *Strofa e 1: puhizë:* erë e lehtë, fllad, puhi. — *shungllis*: turbulloj, trazoj. — *dhrosi:* fjalë greqishte, *vesë, ushqim, shujtë.*

Strofa e 2: gjellëzë: svoglim i fjalës *gjellë*, qi d. m. th. *jetë.* — *sanua*: sanë, bár i thatë.

Strofa e 3: *o ju delmerë*: barij. — *flojerë*: zanamare, zamare, fyell.

paerse daemton
ky i math gaezim;
se djalin t' im
mua m' e sgjon.

*
* *

4. I maekatruam,
n' arshe ktu sot,
me syt plo' lotae,
shumae tae vjen ;
se Zotit djalae
nae i lypsh' ndaelesae,
sa ti ke ftesae
gjith tae ndaelen.

(Nga *«Canti Tradizionali»* —
Schirò, f. 228-229).

---

4. — ZEF BARÇA (1753 ?)

a) Jetëshkrimi

Mbi Zef Barçen dimë vetëm se kish lindur në Palazzo Adriano (Siqeli) dhe asgjë tjetër.

Kemi të atij vetëm një këngë didaskalike me pesë tetëshe, që ish hartuar më 1753, siç na siguron Zef Schiroi që pati në dorë dorëshkrimet.

Këjo datë na auktorizon të mendojmë se vjershëtori kish lindur nga fundi i shekullit të XVII e, dhe në qoftë se e studjojmë me kujdes frymëzimin fetar e moral të këngës së tij, dhe përmendjen e mëkatarit për pendim e rrëfim, dhe kujtimin e vdekjes, nuk ësht vështirë të nxjerrim si përfundim se Zef Barça mund të ketë qenë një nga kleri i Palazzo Adrianos dhe

---

Strofa e 4: *i mëkatruam*: mëkatar. — *ndëlesë*: ndjesë, falje. — *ftesë*: faj. — *ndëlen*: ndjen, fal.

që pra të quhet një bashkëkohës e mbase një shok i kryepriftit Nikollë Filjes nga Mezzojuso e i kryepriftit Nikollë Brankatit nga Piana dei Greci.

Përmbajtja e këngës, stili didaskalik, gjuha e thjeshtë, teknika e goditur e vargut tregon kulturën, shpirtin fetar dhe dashurinë për gjuhën e nënës së Barçes që me të drejtë e vënë (ndonëse me një vjershë të vetëme) në shkallën e Filjes e të Brankatit. Nuk mund të mos ketë të ngjarë që vepra të tjera të tijat duke shkuar koha të kenë humbur ase të jenë përzier me vepra të shkrimtarëve të tjerë.

b) Njeriu ç' i harroshaem...

Njeriu ç' i harroshaem rron nae jetae,
po tae kjeshur e gaze aí baen glat;
po gjellae dishiron edhe' shaendetae,
e kúrr ndo herae n' vetaehenae u mat.
Tae kujtonet se e pret gjella e vaertetae,
se kaeshtu' thot ai çae truu sae pat:
„Ji mál, se si njae lum kjaeroi shket,
e se nj' saemundae t' vret, a njae djovatae.

Andai tae thom u: — Kujtou paer tíj!
Urt isht. Shaerbe' t' aen' Zonae e mos u máj:
i marrur si kê klaenae ti mos íj;
te klisha hír e lip ndaelésae e klaaj,
e paer tae miraet t' at kujdés po kíj,
dhe tuke klár maekataeshit u laaj;
shpirtaerat gjekj çae po tae truhen tíj,
çae digjen e kaeshtu' tae thonae nae vâj:

I. — *Harroshaem*: haraç, harrues; it. *spensierato.* — *sae*: nuk e, s'e. — *jip mál*: kij kujdes, vên mend, vên re. -- *kjaeroi*: fj. greq. *kohë.* — *djovatae*: shetitje, baresë.

II. — *Paer tij*: për vehte. — *maekataeshit*: prej mëkatesh. — *gjekj*: ndigjo.

Kujtou, njerii çae rron, kujtou paer mua,
paer mua çae mae grisi kí kjen dhee.
Paer mua mikjaeria edhe' u harrua,
e jam si kur se jetaen naeng e pee.
Gjindaeja e jime shpejt u ngushullua,
se petkun t' im po deshaen prae haree;
e kur u vdikja nga njerí u gaezua...
Baenmae tae mirae tí, se kjaero kee.

O mjeer kush i ngraenae isht nga dheu i zii,
çae sbier gjithae kjishae e sa do kaa!
Aì po baenet njize botae e hii
e gjithae ątae çae baeae mb' at' anae e klaa;
i thahen ato buzae edhé ata sii
e ndaer tae kekje gjaendet tae maedhaa,
ndaer helme tae pathaenshaeme e stihjii,
edhe' prae vetaehenae mìsht e haa.

O vllá, tae keesh paer mua lipisii,
e baen si kúr se t' jesh vaertata vllaa;
liromae e mae shpaeto nga kto hjidhii;
kujtou se jam te zjarri e se po klaa
e se pushim ngae gjênj edhe' se s' dii;
daefto' se zaembra e jote naeng u thaa,
e baen si kuur se tae tae jeesh gjaerii,
si edhe' prer tíj do t' parkales u praa.

(Nga «*Canti Tradizionali*» —
Schirò, f. 78).

ROSOLIN PETROTTA

III. — *Mikjaeria*: miqt, — *naeng*: nuk. — *pé*: vehta e parë e së kaluemes për *pásh*; karakteristikë edhe sot e djalektit të Kuntisës Entelina e të Palacit Adriano, kurse banorët e Pjanës e kanë si na sot. — *haré*: gr. *gëzim*.

IV. — *Sbier*: humbë. — *gjithae kjishae*: gjithë qyshë, çdogjâ. — *njize*: shpejt. — *stihjí*: gr. kuçedër, djáll.

V. — *Lipisí*; mëshirë. — *hjidhí*: idhní. — *parkales*: lutem.

5. — JUL VARIBOBA (1762)

a) Jetëshkrimi

Jeta e këtij vjershëtari të vjetër arbëresh — mâ i pari ndër Arbëreshët qi botoi nji libër vjershash në gjuhën arbëreshe — mund të përmblidhet në dy fjalë, mbassi njoftimet qi kemi për tê, janë të pakta e shum të meta.

Dijmë vetëm se lindi në Mbusat në krahinën e Kosencës, por nuk dihet me siguri se në cilin vjet; sipas kërkesavet të bâme, data e lindjes mund t' i caktohet rreth vjetvet 1725-1730. Mësimet e para i kreu në Kolegjën shqiptare të San Benedetto Ullano; pastaj u kthye në vendin e lindjes së vet, në Mbusat, ku u bâ prift. Si i tillë u çque për zéll fetar, aq sa quhej prej grave të fshatit „prift i shenjtë". I shtytun nga zelli i vet fetar dhe nga dashunija e zjartë qi qysh në vogjli ndiente për Shën Mërín, themeloi për ndér të kësaj nji Kongregacjon për vajzat e fshatit, të cilat u quejtën „*Të bijat e Mërís*".

Jetën e kaloi plot me trazime, të cilat i shkaktonte vetë nga natyra e jashtëzakonshme qi kishte. Shum anekdota tregohen rreth tij, të cilat na shpjegojnë karakterin e çuditshëm. Prindët e kishin djalë të vetëm dhe për të mbajtun emnin e familjes gjall, dojshin me e martue. Nji ditë kur kishte caktue ditën e martesës, na vishet si dhandër dhe i dërgon fjalë shtëpís dhe fshatit qi të dilshin me e pritë, por me çudi të madhe, në vend të nuses, pán nji trupore të Shën Mërís, të mbajtun në krahë nga disa burra. Juli, i gëzuem, nxori unazën e nusís dhe i a vûni në gisht Shën Mërís për të tregue se ajo do t' ishte nusja e tij e përjetëshme.

Mâ vonë e lên katundin e vet dhe shkon në Romë, ku qe i nderuem e i çmuem për mirësín e urtësín e tij dhe aty qëndroi deri sa vdiq si sekretar i njij urdhni fetar. Ktu shkroi veprën GJELLA E SHËN MËRIS VIRGJËR, për hir të së cilës i kujtohet dhe sot emni.

Ditën e vdekjes së Varibobës nuk e dijmë, por thuhet, prap në mënyrë prralle, se dha shpirt nji ditë n' altar kur po mëshonte; diftohet se trupi i tij mbeti nji pëllambë përmbi dhé deri sa erdhën dhe e vorrosën.

KARL GURAKUQI

b) Analizë e veprës

Variboba na ka lënë panegjirike e shkrime të ndryshëme në gjuhën italishte, po emëri i tij mbahet mënt e nderohet vetëm për një prej këtyre që shkroi shqip: „*Ghjella e S. Mërijs Virghjer*". Këjo u botua nga vetë auktori në Romë më 1762.

Librin e Varibobës e hap një letër në prozë drejtuar Sh. Mërisë. Në këtë letër ai, me stil të lehtë e të këndshëm e me atë „humorin" e tij të zakonshëm, i shpjegon Virgjëreshës se cilat qenë arësyet që e shtytnë t' i kushtojë veprën e tij: *a)* pse në gjuhën shqipe don Juli nuk njihte ndonjë „*rimm' e arberesh*" „*ci ti rifien ghjth ghjellen t'ande, ghjth ghareet, edè duluret, e ghosdat ci ti spuan zamëren, cuur isce ndi chit jett*"; dhe *b)* për t' i kërkuar „*grazie*", „*glimosen*" për mëkatat e djalërisë, kur, pa u dhënë rëndësi këtyre, a duke i pandehur të lehta, lëçitëte „*rima ghjth scjortje*" e bënte „*puru latin viersce pir ti chjescur o pir ti chjeltur duun*". Prandaj i lutet që kur t' i vijë „*ghera e morts*" e t' i dalë „*dimoni*" t' a „*ngagljessign pir ghjth mbëcatat*", ajo t' i presë rrugën e t' i dëftejë këtë këngë tjatër që ay ka shkruar nërgut për 'të.

Vjen pas kësaj parathënja tjatër drejtuar atij që këndon.

Pas këtyre fletëve në prozë, mërrijmë tek ajo pjesë e librit që e ka emërin „*Ghjella e S. Mërijs Virghjer*", emër që poeti e përgjithëson për tërë veprën. Këjo dhe „*Ghjella Scin Bambinit*" janë të vetëmet e librit që kanë trajtën e një poemi ku dëftehet, gjër më një farë pike, kronologjikisht, jeta e Sh. Mërisë në të parën, ajo e Krishtit në të dytën; pse pjesët tjera janë vetëm këngë shpirtrore pa ndonjë lidhje të ngushtë me dy poemthet.

Seecila nga këto dy poema ësht ndarë në tri pjesë.

Në pjesën e parë të „*Ghjella e S. Mërijs*", passi këndohen e lëvdohen një nga një të gjitha virtytet e Virgjëreshës, na dëftehet si lindi këjo. Sh. Ana e Sh. Jakini nuk kishin fëmijë. Me lutje e me agjërime e „blejnë" më funt nga in Zot foshnjen e shënjtë në kohën e pleqërisë. Në moshën trí vjeçe, si pas premtimit që kishin bërë, e mbyllin në një kuvënd. Më

vonë një ëngjëll zbret t' i sjellë „*mbasciaten*“ vashës e hapet përnjëherë qielli e vjen Krishti „*ndi skaft saaj*“. Atëhere Sh. Mërija, „*plot si bigljetta*“ shkon tek Elizabeta e i dëften fjalën e ëngjëllit. Bërtet nga gëzimi Elizabeta kur e sheh e e uron e e falënderon pse ajo me ardhjen e saj i shënjtëroi edhe djalin që ka në bark. Sh. Mërinë e „*zë jidia*“ nga përgëzimet e mburrjet e fqinjës e i ngreh një këngë lëvdimi t' ënë Zoti.

Tre muaj qëndroi Virgjëresha *(Pjesa II)* në shtëpinë e Elizabetës e aty „*scërbeu e mbet*“ gjër sa lindi Sh. Jani, të cilin ajo vetë e lidhi e zgjidhi e vetë e mbështuall në fashqe. Passi ngrihet lehona, edhe Sh. Mërija kthehet në shtëpınë e saj. Aty i dëften për herën e parë të shoqt, Sh. Josifit, se e ndjen vehten me barrë. Po në vënt që të gëzohet, një dyshim i fortë i ha zëmrën Josifit. Natë e ditë ai rri me hundë, i hidhëruar e i „*piseruar*“ sa jo më ; po Sh. Mërisë, e cila e kupton shum mirë dyshimin e të shoqt, nuk guxon t' i thotë gjë me gojë. Më në funt ai vëndon të largohet nga shtëpija. Kur ja, pas lutjeve të Virgjëreshës, një ëngjëll i duket në gjumë Sh. Josifit e i shpjegon se si qëndron puna. Zgjohet përnjëherë plaku i urtë e aq fort turpërohet e pendohet sa do të vrasë veten ; pastaj duke qarë i kërkon ndjesë së shoqes.

Sipas dekretit të Mbretit (Pjesa III) shkojnë e regjistrohen e paguajnë taksën. Pastaj shkojnë të kërkojnë një strehë ku të kalojnë natën. Kërkojnë, kërkojnë tërë ditën po më kot ; atëhere hyjnë e strukën në një shpellë. Shpejt Josifi ndes pak zjarr me ca dru e Sh. Mërija vetë fshín e qëron bizhdilinat. Kur ja, në mes të natës, në sa Sh. Josifit i kish qëlluar gjum, lind më në fund foshnja e bekuar. Atë çast të gjithë ëngjëjt zbresin nga qielli e i bjenë më gjunjë Krishtit. Kur zgjohet e sheh se kishte lindur djali, Josifi sa s' prishet mëntsh nga gëzimi : qan e qesh, këcen si gjeli e vrap e rrëmben atë dhe e shtërngon në gji. Pastaj një ëngjëll tjatër fluturon të zgjojë disa barinj duke përhapur lajmin e mirë nër 'ta. Ngrihen me të shpejtë „massarët“ e duke marrë se i cili nga një dhuratë, nisen drejtë shpellës. E me adhurimin e barinjve merr funt poemthi.

Vijnë pas poemthit me radhë vjershat si „*Caglimera e*

Nataleve", „*Baza cuccie e ban nino*", „*Chanca e ti sghjuarit*" e tj.. e pas këtyre „*Gjella Scin Bambinit*", e cila është vijimi i „*Gjellës*" së Sh. Mërisë.

Më në fund vijnë nj' a katër vjersha si „*Thuajm saa durovve*", „*E checchje penn*" e tj. që na dëftejnë „*pasionin*" e Krishtit. Pastaj dhjetë vjersha të tjera, ndër të cilat edhe dy të kushtuara „*Shin Mëriis Boncunsiglit*" e „*Scin Ghjerghjt*" si shënjtorë të adhuruar posaçërisht nga Shqipëtarët, e mbyllin librin.

c) Vlera e veprës

Gjykimet rreth veprës së Varibobës nukë janë të njëjta. Nga më të parët G. Meyer-i e quante atë „klasike mbi të gjitha tjerat". Pas atij me radhë Dorsa, Stratico-i, Chinigo-i, Pavolini e Schiro-i e pëlqyen e e çmuan së tepërmi „Gjellën e Sh. Mërijs" me gjithë rezervat që çfaqin një pjesë prej tyre, sidomos për sa i përket përdorimit me vënt e pa vënt të fjalëve italishte djalektore. Po Petrotta shkruan tekstualisht : „Gjella e Sh. Mërijs Virgjër" dhe vjershat e tjera t' auktorit t' onë nuk janë gjë tjatër veç se një prodhim poetik „modest" të një vjershëtori mesatar popullor, i cili rrallë e për mallë ngrihet nga „banaliteti" i idesë dhe i shprehjes, e cila këjo e funtëmja shpesh herë i afërohet paturpësisë. As nuk munt të thuhet gjër më çë pikë Variboba na jep djalektin e folur në kohën e tij n' atë krahinë ku ai lindi, pse edhe sot, pas afro dy shekujsh, djalektet arbëreshe që fliten n' Itali nuk kanë aq shum elemente italishte sa na jep të besojmë mënyra e shkrimit të tij..."

E vërteta ësht se të dy palët e kanë tepruar në gjykimin e tyre rreth veprës së Varibobës. Me përjashtim të dy „*Gjellëve*", me të vërtetë lëçitësi kot do të lodhej të gjente tek vepra e dom Julit atë gëzim e atë ngushullim shpirtror që japin përgjithërisht vjershat fetare kur janë vepra arti. Ato njëzet vjersha që gjejmë aty, me përjashtim të nj' a dy a trive, nuk janë veç se „vargje në rimë e kurrëgjë tjatër, të shkruara prej një prifti fare „modest" për lëçitësa edhe më „modestë" se ai e ndoshta të trashë e të pamësuar si ishin bashkëfshatarët e poetit. Po

dy „*Gjellët*“ jo! Dy „*Gjellët*“, me gjithë të metat që kanë nga shum pikëpamje — nga pikëpamja gjuhësore, pse plot me fjalë e barbarizma djalektore italishte, si edhe nga pikëpamja e strukturës si poem — dallohen nga pjesa tjatër më e madhe e veprës. Dom Juli, n' atë „modestinë“ e vet kulturore poetike, i pa frymëzuar prandaj prej kryeveprave tjera që me qindra i jane kushtuar fytyrës së dhimbëshme e prekëse së Mërisë, që ësht bërë simbol i mëshirës e i përdëllimit edhe për ata që nuk i besojnë, ka mundur të thotë e të shkıuajë e të përfytyrojë diçka origjinale për 'të. Pa u ngritur në sferat qiellore që e ngreh mëndjen e frymëzimin fytyra hijërore e njerëzore e Sh. Mërisë dhe ajo e Krishtit, ai ka mundur të na japë një Marí grua e mëmë, të përvujtur e të vobekët si qindra, mijëra, gra të tjera të popullit, një Marí që t' ishte pasqyra e fshatarkave të përvuajtura e të vobeka të katundit të tij, një Marí, me një fjalë, *origjinale* në fushën e gjërë të krijimit artistik; e në këtë *origjinalitet concepsioni* qëndron e gjithë vlera e dy poemtheve. Me sa „spontaneitet“, me sa „naivitet“ e thjeshtësi i ka dhënë kurmë këtij krijimi të tij origjinal dom Juli, e vërtetojnë shum vargje të dy „Gjellëve“. Gabrieli i bie „mbasciatën“ e lindjes Virgjëreshës, e poeti thotë:

Ti rispëndove: u jam e virghjër
Si gni e virghjer mund jet am?
Chëjo mbasciat ning ast urat
Pir gni ti virghjër ast maa se namm.

Ajo shkon tek Elizabeta t' i japë sihariqin, e poeti na thotë se u nis „*piot si bigljetta ma tanë zòn*“.

Ajo vjen përpara Elizabetës e këjo në atë thjeshtësinë e saj fshatarake thërret e ankohet nga gëzimi:

Tee u e namura tec u e ghjamura
Si të të rie chjo buk e grign!

pse ç' ësht më e mirë e më e çmuarshme e më e ëmbël se buka e grunjët për fshatarkën me zemër të pastër? E aty në

shtëpinë e Elizabetës Sh. Mërija, jo si një grua e shënjtë e zgjedhur nga vetë in Zot për amë, po si qindra gra të tjera qëndron e shërben, e vetë e lith, vetë e zgjith dhe e mbështjell në fashqe Sh. Janin e vogël, pse kështu do poeti, që edhe e paracaktuar e e zgjedhur për amë nga in Zot, ajo mos të dallohet nga gratë tjera, po të jetë për 'to shëmbull përvuajturije e dlirësije.

Si këto shëmblla gjejmë me qindra në veprën e Varibobës: kur ai na dëften ndonjë ndodhi të Virgjëreshës a të Krishtit, kur na përshkruan ëngjëjt që zbresin nga qielli e i çfaqen natën në gjumë Josifit, të larë e të ndërruar „si dhënder", ase, nga ndonjë herë, kur, prifti i urtë, në atë ekzaltimin e tij fetar, harron se kanë kaluar afër njëzet shekuj e merr pjesë drejtë për drejtë në zhvillimin e poemit. Kështu ai nxehet e zëmrohet me profetitë e plakut Simeon, pse i shkaktuan vuajtje e lotë Sh. Mërisë :

E kam me ti piac Simeon
Caa i sgavon cto profezii
Ti na e gundove e e gheglmove
zognen tann pa riposii...

ase pendohet e turpërohet kur këndon se foshnja e shënjtë fjeti „*mbi trual pa lunzual e pa pagliazz*" :

Oi mieri u si jam cstu !
Dua saccun edhe matarazz !

gjër sa, kur na dëften se si Krishti vihej e fshinte vet shtëpinë, s' e përmban dot veten po bërtet, për pendim :

Craghet e mi via ti ju raagh —
. . . .

Këtij „spontaneiteti", këtij realizmi të sinqertë fusharak, i duhet shtuar pastaj edhe një dell humorizmi, që i bën më të shijëshme e më të këndëshme vargjet e Varibobës. Po humo-

rizmi i dom Julit ësht nga ai i miri, nga ai pa të keq, që na bën të vëmë shpesh buzën në gas. Dëshmonjëse e këtij humori ësht vetë e tërë vepra që ai na la, si edhe ndonjë episod nga i jetës së tij, që na ka mbetur e që na shërben të ndërtojmë karakterin e poetit. Tërthorazi këtyre elementeve të pakta — për sh. anekdoti i martesës së tij — munt të diktojmë lehtë se sa zëmër gëzuar e fjalë kripur do të ketë qënë auktori i „*Gjellës*“

Po që dom Juli do të ketë qënë edhe fort „naiv“ e i thjeshtë, e do të guxonim të thoshnim *i lehtë* nga disa pikëpamje, besojmë se duhet pranuar. E na mendojmë se kësaj *thjeshtësije shpirtrore* i detyrohen disa shprehje, disa aluzione, e disa vargje të veprës së tij, që ne të tjerëve na duken imorale, e që përkundër qenë pema pikërisht e këtij „naiviteti“.

NAMIK RESSULI

d) Pjesa të zgjedhuna nga „*Gjella e Shën Mëris Virgjër*“

I.

. . . .

Aghiera bashch me ceer permìst	1. Ahjera báshk' me çér përmist,
thaan: oi Chrisht kjoccim becúar!	thán: Oj, Krisht, kjoçim bekuar!
se u ncarnàrte e u dinarte	se u nkarnarte e u dinjarte
ti te viccë nder cheto duar.	ti të viçë ndër këto duar! —
*	*
E pùthëtin dheen di Shëmëret.	2. E puthëtin dhen di Shëmëret.
Te dì përmiet sherbien; e been	Të di përmjet shërbien; e bënë
ti, Shën Giusep, bère në dieo	ti, Shën Gjusep, bëre një djep,
saa shen Bambiin të mund'e nzeen.	sa shën Bambin të mund e nxënë.

1) *Me çer përmisl* = me fytyrë përmys. It. *ciera*. — *u nkarnarte* etj. Për it. *t' incarnasti e ti degnasti* = u mishnove e u denjove.

2) *Shëmëret* = të shejtënuemit (it. *santificati)*, prej *Shë Meri;* në Kalabri kanë edhe *shum buri;* — *përmjet shërbien* = shërbyen (punuen) për gjymës, dora doras. De Rada përkthen: *lavorarono a cottimo*.

*

Ma Shen Mëria në fásh të gjeer
si né pandeer me shcrone shum
e rricamarti e lavurarti
të teer ne nat ce së paëtt gjuum.

3. Ma Shën Mëria një fash të gjér.
si një pandér me shkronje shum,
e rrikamarti e lavurarti
të tér një nat çë së pat gjúm.

*

E beri puru shuum scutina
të bardha e fina per chet dialjë,
çë chish të vinn' e të shchëlkjin
si n' iil i kjaar e si christalj.

4. E bëri puru shum skutina
të bardha e fina për kët dialë,
çë kish të vin' e të shkëlqin'
si nj' íll i qár e si kristalë.

*

E gia u kjas ditta e miir
të parturiir chet vilastaar ;
ma në dhicret ce rregji vet
e chish dërgcuar u bandiaar.

5. E gjià u qas dita e mír
te parturir' kët villastár ;
ma një dhikret, çë rregji vet
e kish' dërguar, u bandiár.

*

Ordëni thojë cë nga-nerii
me të gjtth shtëpii chish të partiir;
e te citatta mee e bëgcatta
chish të veej nga dishëndiir.

6. Ordëni thojë, çë nga njeri
me t' gjith shtëpi kisht' të partir;
e te çitata më e bëgata
kish' të vej nga dishëndír.

*

E attie emt' rin e citatten
e casatten chish të shchruan,
pestai Saturit Imperaturit
puru cotten t' i pagcuan.

7. E atje em'rin e çitaten
e kazaten kish' të shkruan ;
pëstaj Saturit (t') Imperaturit
puru koten t' i paguan.

---

3) *Një fásh* = nji brez. It. *fascia*. — *pandér*: nji copë e vogël cohe a stofe, e qindisun, qi e vênë grát para prêhnit. (Meyer e bjen prej lat. *pant (ic) arium*. — *rrikamarti* etj. It. për të kaluemet *la ricamò, la lavorò* = e qindisi, e punoi.

4) *Puru* It. *pure* = edhe. — *skutina* = pështjellsa fëmijsh, shpërgaj, prej gre. *skouti*.

5) *E già*. It. = *e he, e qe*. — *të parturir*. It. për lidhoren: *che partorisse* = të lindte — *vilastar*. De R. perkëthen *virgulto*. Mos të jet *vidhastar*, adj. i emnit *vidhë, vidë?* — *u bandiár*. It. për *si bandì* = u çpallë.

6) *thojë* etj. = thojte, që nga një njeri. — *kish të partir* = kishte për t' u nisur, *nga dishendir* = It. *discendeva* = nga rridhte.

7) *çitaten... kazaten*. It. = qytetin e deren, fisin. — *Saturitl* It. *esattore* = tagrambledhës. — *koten*. It. *cottimo* = të dhetat.

*

Ish Shen Ndree, e boor e shii
punent i szii terriir dheen ;
brésheri i baardh, viaggi i laargh;
Szeppa penson të mos véj.

*

8. Ish' Shën Ndré e bor e shí
punènt i zi terrír dhén ;
breshëri i bárdh, vjagji i lárg :
Zepa penson të mos véj.

*

E Shèn Mëria thooj's ee paguur,
„na rriim sicuur ; via t' vemi.
„Cush ubbidhirti santificarti :
„t' een Szoon me nee e chemi“.

*

9. E Shën Mëria thoj : s'ë' pahúr;
na rrim sikúr ; via, të vemi.
Kush ubidhirdi santificarti ;
t' ën' Zon me né e kemi.

*

Per cheto fiaal i Shen Giuseppa,
i cukj si kjepa u manteljaar ;
Ti Shen Mërrii ulje ataa sii
e szure fiil e thee rruszaar.

*

10. Për këto fjál i Shën Gjusepa,
i kuq si qepa, u manteljár.
Ti, Shën Mëri, ule ata sí
e zure fill e the rruzár'.

*

Ma par se t' nissej, vastaguan
attie ncarcuan me ne spurtùn ;
e trii claudhelje been ne chravèlje
se t' pravonin në mizzicun.

*

11. Ma, par se t' nisej, vastahuan
atje ngarkuan me një spurtun ;
e tri çaudhelje bën një kravelje
su t' pravonjin një micikun.

*

Fashen pështual e za scutina
ckëjo Regina joon e mira ;
si cur e diij si ajo rriij,
e se chish të parturiir.

*

12. Fashen pështuall e ca skutina
këjo Rregjina (e) jón e mira :
si kur e dij' si ajo rrij'
e se kish' të parturír.

---

8) *punent... terrir.* It. *ponente atteriva* = era e prendimit... tmerojte. - It. *viaggio* = rrugë. — *penson* It. *pensa* = *mendou.*

9) *pahúr.* It. *paura* = frigë. — Kush *ubidhirti* etj. It. për *ubbidì, santificò* = kush dëgjoi u shejtërua.

10) *u manteljar* It. për të kaluemen *si ammantellò* = u pështuell në mantel.

11) *Vastahuan.* Gr. *bastáhos* = çdo shtasë samari, barre (mushk, gomar etj.) *spurtun.* It. *sportone* = shportë e madhe, kosh. — *çaudhelje.* It.. *ciadella* = copa buke, koje të rreshkuna. — *kravelje.* De Rada përkëthen *pagnotta* = nji bukë. Kuptimi : prej njaj buke xueren tri copa e i rreshkën. — *se t' pravonjin* = qi t' a kërkojshin, t' a provonjin. — *një micikun.* It. *mozzicone* = një kashatë.

12) *si kur dij'* etj. — sikur t' a dijnte se si, në ç' gjendje ishte.

*

Rrëvuan Betlem, attie u [shcruan
edhe pagcuatin cotten e reend';
Pestai tue ciuar vaan tue chër- [chuar
në zich ricét ma nench e gjeend.

*

13. Rrëvuan Betlem, atje u [shkruantin
edhe paguatin koten e rëndë ;
pëstaj tue çuar van tue kër- [kuar
një cik riçet, ma nënk e gjënd'.

*

Ngrerissur già nduttu ghitin [më theel
mbrenda në speel të pa dritt
Attie të ljeghej atti të dighej
iin Szot i madh cush mai e prit?

*

14. Ngrisur già ndutu hitin [më thell
mbrenda një shpell' të pa drit'.
Atje të ljehej, atje të dihej
in Zot i Madh, kush mai e prit?...

*

Ruaj fertunen! dieljmet e tíeer
bilj cavalieer ljeghen gaidhiaar,
ma chii diaalj mbrenta në staalj
edhe pa drit' e pa ljinaar.

*

15. Ruaj fërtunen! Djelmt e tjér,
bilj kavaljér, ljehen jajdhár :
ma ki dialj mbrenta një stalj
edhe pa drit' e pa ljinár.

JUSTIN RROTA

II.

Sa pir nee Cristi duroi!

Biir si ti vraan,
Mua cu më gliaan
Si spann glipisii
Si ti ndìgu mosgnerii.
Biir sit scënnuan,

---

13) *Rrevuan.* It. *arrivarono* = arrijtën — *një cik* etj. = një grimë strehë (It. *ricetto, ricovero)*, por nuk e gjendëtin.

14) *Ngrisur* = muzgun. — *ndutu* = It. *del tutto* = krejt. — *dihej :* ndjehej. — *kush mai* = po e kush ?

15) *Ruaj fertunen* = vre, kqyr fatin. — *hajdhjar.* Gr. *gatheo* = gëzohem ; këtu : nder andje e m'radi. — *stal.* It. *stalla* = katue, burg bagtish. — *ljinar.* Gr. *lyhnos,* = dritë.

II. — 3) *Spann,* s' patën. — 4) *si ti ndigu mosgnerii* = si nuk të ndihu asnjeri.

Biir sit furnuan !
Cu ti vate ajò beglizz ?
Ci mi jip acchj legrizz?
Ruaj si ti nziitin,
Scìgh si ti pëstiitin !
Si ti baan biir oo
Ghjith chjaagh mie raù oo!
Caa t' erdh chjo curoor ?
Cusc te theri at door ?
Cto chamb ti ngricchjësuara
Ziglia ghosd ti glià ti spuara ?
Edè Zamëren t' e spuan,
Me gni lanz t'e sbugliuan!
Oi biir e saa penn,
Mirrem mua me vetghèn.
Paa biir u si ti rogn
Chit thic si te durogn ?
Me tij biir dua ti scighem,
Ndi chit varr dua ti mbulighem.

---

5) *sit*, si të — *scënnuan*, varruanë, shituanë, të shënduanë. — 6) *furnuan*, mbaruan, si pas kuptimit italisht. — 7) *vate*, vajti, shkoi. — *beglizz*, bukuri. 8) *jip*, jipte. — *legrizz*, gëzim, shend. — 9) *ti nzitiin*, të nxinë. — *ti pëstiitin.* = të pështytën. — 12) *chjaagh*, plagë. — *mierau*, mjera unë. — 14) *te theri*, t' a plagoi. — 15) *ti ngricchjësuara*, kryqëzuara. — 18) *lanz*, heshtë, patërshanë. — 19) *penn*, dhëmbje, vuajtje. — 20) *mirrem*, merrëm. — 23) *ti scighem*, të fshihem. — 24) *ti mbulighem*, të mbyllem.

6. — GJON THOMA BARBAÇI (1742-1791)

a) Jetëshkrimi

Prift dhe Doktor në Theologji, sigurisht i edukuar në Seminarin Italo-shqiptar të Palermit dhe në shkollën e drejtuar nga At Gjergj Guzetta e nga At Pal M. Parrini. Kish lindur në Mezzojuso në Siqeli më 1742. Kish qenë Famullitar në Kishën e ritit grek të Napolit e Prift i „Koortes Mbretërore Maqedhonase të Shqipëtarëvet".

Vdiq edhe i ri, në moshën afër 49 vjetsh, më 3 Shtatuer 1791, në Mezzojuso. Ësht auktor i njëj kënge fetare, shum e njohur dhe në ditët t' ona në Piana dei Greci e në Kolonitë e tjera shqiptare të Siqelisë, dhe që po riprodhojmë më poshtë. Posa të vëmë re rregullsinë e vargjevet dhe stilin e frymëzimin e thjeshtë, por të volitëshëm të kësaj kënge, duhet të mendojmë se Barbaçi nuk ish në fillim të artit të të hartuarit vjersha, dhe se pra duhet të ketë hartuar edhe të tjera vjersha fetare. Veç se nga të tijat vetëm ketë njohim, e cila bëhet edhe më e vlefshme sepse, siç shkrojti Zef Skiroi, që më 1907, paraqet një nga më të rëndësishmet midis dokumentevet krejt të mangëta të gjuhës shqipe të folur dikur në Mezzojuso.

b) O ti çae helme shkove

O ti çae helme shkove
Kopose edhe kekjii
Kij dhimae e lipisii
Maerii, paer mua.

*

Njae hiir prej teje dua,
Lavos ktae zaembrae e thee,
Me thikaezaen çae kee,
Te gjiri shejt.

*

Kaa mot çae ngae rronj drejt,
Çae Birin t' aent u ftesae ;
Ti lip paer mua ndaejesae
Tae lartit Djalae.

*

Aem drit' e ndihmae t'gjallae,
Tae njoh, e po ndae truu
Tae keem helmet e tuu,
Zonjae e dullosme.

*

Me duarae tae frikosme
Ti gjiri i jit, pa hiir,
Ailimano', t' aet' Biir
Kam shkjerrae e vraar !

*

U svisem tuke klaar ;
Tae dhaembem u ngae sosae,
Paerse' mae jep kopos
Maekatia e jime.

*

Çaaj ti kaet' zaembrae t' ime,
Ç' e thaat si hekur aeae ;
Ngae dua t' faejenj u maeae ;
Vdeksha mae mirae !

Strofa 1. — *Kopose*, fj. greke qi d. m. th. ngashrim, pikllim. — *kekji* : të këqija, të zeza. — *lipisii* : mëshirë, dhimbsuní.

Strofa 2. — *Lavos*, fj. greke : *plagos, godit.* — *thee* ; there. — *Thikëzën* : zvoglimi i fjalës *thikë.*

Strofa 4. — *Aem* : epm, më nep, m' ep. — *dullosme* : e dhimbëshme.

Strofa 5. — *Të frikosme* : fj. greke : *i mndershëm.* — *Ailimano'* : i mjeri unë. — *shkjerrae* : grise, shkye, me çjerrë.

Strofa 6. — *Svisem* : shkrîhem.

Strofa 7. — *Aeae* : âsht, â.

*

Me mua te lufta hirae ;
Tae vetaem mos mae le,
Si Zonjae e maemae edhe'
Gjithae e lipisme.

*

Nga kjo jet' e mavrisme,
Me tiij u tae trashgonj,
Tae kjesh e t' zotaeronj,
Kjellmae nae kjell.

*

Do t' thom, kur ti mae siell,
Me gas e me haidhii
Past nder edhe' laevdii
E shaen Maeria !

(Nga „*Canti Sacri*" të kolonivet shqiptare të Siqelis, prej Zef Schiro-it. Napoli 1907, faqe 131).

ROSOLIN PETROTTA

---

7. — NIKOLLË KETA (1742-1803)

a) Jetëshkrimi e veprat

Nikollë Keta lindi në Kuntisa Entelina, në Siqeli, me 1742; ka qenë nxânës i Seminarit italo-shqiptar të Palermit, prift e pastaj Rektor po i këtij Seminari. Vdiq më 1803.

Fytyrë e shum-anëshme dhe e interesançme këjo e Nikollë Ketës, si letrar, si historik, si vjershëtor.

Njeri pa dyshim i pajisur me kulturë shum të gjërë, punëtor i palodhur, kërkues i parreshtur i njohtimeve historike e gojëdhanore, punoi shum në fushën gjuhësore.

Strofa 8. — *Hirae*: hyr, hyn.
Strofa 9. — *Mavrisme*: e mjerë, e shkretë. — *kjellmae*: sillmë, më sjell.

Përpiloi një „*Fjalor italisht-shqip*“; një „*Etimologjik të Gjuhës Shqipe*“ dhe nji vëllim që e titulloi „*Thesar njohtimesh mbi Maqedhonasit*“, vepër historike-ethnografike që ka lidhje me historinë politike dhe kishëtare të Shqipërisë së Kolonivet shqiptare të Siqelisë, e që disa e quajnë një përmbledhje të veprës së madhe të Mësuesit të tij At Pal M. Parrino-s „*De perpetua Ecclesiae Albanensis consensione cum Romana*“.

Gjykimet mbi këto vepra të rëndësishme të Ketës, të gjitha të pabotuara, nukë kanë qenë kurdoherë krejt të favorëshme: veç se të gjith ata që kanë pasur në shqyrtim dorëshkrimet dhe i kanë studjuar, nuk kanë munguar t' i drejtojnë lëvdatë të madhe kujtimit të përkrahsit të ngulmuar e të mirënjohur të studimevet t' Albanologjisë.

Nikollë Keta na ka lënë edhe hartime të vleftëshme poetike që na dëshmojnë kulturën e tij, doktrinën e zotësinë në gjuhën shqipe.

Ka mbetur pa botuar një hartim i tij poetik prej 76 tetëshesh, të përkthyer prej tij vetë n' italishte, që ka për argument krijimin e botës dhe historinë e njeriut, sipas Bibljes, gjer në Përmbytjen e përgjithëshme.

Dorëshkrimi ka mbetur në dorë të vjershëtorit të vajtuar Zef Skiroi. Po e Nikollë Ketës, shkrimtar i vetëm shqiptar gjer tani i njohur prej Kuntisës Entelina, do të jetë kënga didaskalike prej tetëshesh që po riprodhojmë, së bashku me një tingëllim të tyre e me dy katërshe me përmbajtje autobiografike, që paraqesin një provë të plotë me të gjitha veçoritë dhjalektore të gjuhës shqipe të folur edhe sot në Kuntisën Entelina.

b) Nga shkrimet e Ketës

1) Kaa tae vinjae njae ditae...

1. Kaa tae vinjae njae ditae çae t' mae klani,
kuur tae jeem vdekur e ju tae m' vaerreni;
me kriqen kuur tae vinjae edhe' klishani
e katrae vetae juush tae mae rraembeni.

Strofa 1. — *Vaerreni*: vreni, shifni. — *klishani*: kishtari, prifti. — *livani*: kêmi, thimjami.

Mbi f' errtin varrin t' im digjet livani,
e nae t' erraet atje' dot' mae liereni.
Bobo ju, krimba, kuur mua tae hani,
do tae ngordhaeni, thom, helmit çae t' gjeni !

2. Kaha do t' vemi e kaha do t' zaeaem,
tae vdesaem kemi e me t' vaertetae e diim ;
po ktae shaerbes nae krie naeng e vaeaem,
si kuur se nae ktae jetae kemi tae rriim.
Me gjith se e njohim, maekataen s' e laeaem,
edhe' ftesnjaem paer ditae Peraendiin,
akjae se, paer tae kekjet çae po baeaem,
sbuartim Parraisin, Krishtin e Maeriin.

3. Po shpirtaerat e sbjerrae e dii ku rriin ?
Atje' te ku gjith horaeshit po klaan.
Me skjufur e me zjarm j-a stisaen shpiin
atire çae maekataen kurr s' e laan.
Saa mae shpejt po tae baenjaem skomolliin !
Vemi te klisha e vaehemi tae klaam ;
se pak te kaejo' jetae kemi t' rriim !
Nae vemi n' Pisaet, si do t' baenjaem praan ?

4. Oh mjeraet na çae te maekata raam !
Nae Pisaet do tae vemi e atje' do t' rriim,
paerse' maekaen t' aenae ka t' e klaam
se u' krikj e kemi vaenae Peraendiin.
O Virgjaera Maerii, ti ndihna praan
e baen saa t' vinjaem bashk me tiij tae rriim
se nae njae herae na laefshim maekaan,
Perráisin do tae kemi e mirae e diim.

Strofa 2. — *Naeng*: nuk. — *sbuartim*: *humbëm.*
Strofa 3. — *Horaeshit*: ablativ, *nga të gjitha katundet.* — *sitsaen* ndërtojnë. — *skomolliin*: rrëfimin.

5. Nanì çae do tae dii, o i madhi in' Zot,
nae Parráisi tae gjithaeve na paeret?
Posa klemae fajtorae pr'akjae mot,
kaa likjae Paeraendia kuur na vrèt.
Po neve çae na duket se edhe' lot?
Paer nee gjashtae orae Ai nae krikje mbèt!
Andai t' e laeaem maekanae sot si sot,
se hera vjen e Krishti na thaerrèt.

6. Neve thaerret i larti Peraendii
e gjithaeve na kujton tae kemi truu.
T' i lipnjaem praan ndaelèsae njerii!
Paer nee ditaet u sosnae e hera arruu.
Kuur kujtonem, u ljosem si kjaerii,
se kle maekata çae n' Pisaet na shtuu,
se kaa t' na hee nga-dalae dheu i zii,
e se ka t' thahemi si tsopa druu.

7. Ka t' thahemi si druu me tae vaertetae;
ka t' vdesim e naenk diim nae ka t' jeet sot.
Nae ka t' digjemi praan, mirae na mbet!
se kemi ftesur shumae t' madhin Zot.
Kemi ftesur atae çae na dha jetae;
atae çae na duroi paer akjae mot,
e çae jerdhi paer nee te jeta e shkretae,
e klaajti, si edhe' na, tue derdhur lotae.

8. T' aen' Zonae na nae krikj e kemi vaenae,
e sbuartim Parráisin paer kriet t' aenae!
Nae shtrat nanì tae mjeraet jemi shtaenae...
Fukjiit çae kishaem e te ku na vanae?

Strofa 6. — *Arruu*: arrijti, mrrijti. — *ljosem*: shkrìhem. — *shtuu*: shturi, *s*hpuri, çoi. — *hee*: hajë.

Strofa 7. — *Mirae na mbet*: mirë e kemi. — *jerdhi*: erdhi.

Strofa 8. — *Nani*: tani, tashti, tash. — *Kolikji*: *Koliqi* âsht auktori i ksaj vjershe, qi i duhet mveshë me të drejtë Nikollë (Koliqi) Ketës. — *i laenae*: i lànun, i marrë. — *maekanae*: mëkatin, mëkat'n.

Po e kemi gjegjur se na e kanae thaenae
e priftaerat e shejtaerat çae janae,
edhe' e kujton nanì Kolikji i laenae:
T' e laeaem, t' e laeaem, o vllezaer, maekanae!

(Shif «*Canti Tradizionali*»
të Zef-Skiroit f. 74 e vijim).

2) Tingllim

Ky tingllim edhe dy katërshet mâ poshtę N. Keta i shkroi me dorën e vet në fundin e veprës së pabotueme „Thesar njoftimesh mbí Macedonasit".

Farie sae ndeerme nae Kuntisae u bii
Kolae Ketta, vllastaar i t' arbrit dhee;
shkoi nae Palermae praa tek e Arbrit shpii,
ç' e reshti, si zogu rep nae folee.

E veshi e e ngjeshi me zakon, me urtaesii;
paer nae vapaet e paertriijti ndaenae hjee,
si tae veshkurin rremp stolís njae dhrii;
e nanì prift klisha kurorae e vee.

Si zok i sbjerrae praa t' di krahaet çoi
nae Palermae e n' Kuntisae, po ktei e atei;
ndeern' e Arbreshet te gjithae gramaet kaerkoi.

Strofa 1. — *Farie*: prej farës, prej gjinís. — *vllastaar*: pinjuell, filiz. — *e Arbrit shpii*: shtëpija e Arbëreshvet e këtu kupton Seminarin italo-arbëresh të Palermit, qi ka qenë me të vërtetë nji çerdhe e votër e traditavet, të ndiesivet e të kulturës arbëreshe. — *zogu rep*: zogu pa pupla, i repun.

Strofa 2. — *Dhrii*: hardhí.

Strofa 3. — *Gramaet*: shkrimet.

Si krymp mundafshi gjith e svìs vetaehei
e ktae vistaar tuar, kjaendisi e shkroi,
se tae kjosaej gjithae Arbrin ndjeer paertei.

(Shif *«Canti Tradizionali»*
të Zef Skiroit faqe 328).

. . .

Po rraha dhera se t' gjenjae vistare
Paer nae Arbrit, ngukjur gjith maekataeshit s' ime.
Bobo si mae gaenjeu jeta haidhiare!
Mae taksi po akj' ndeer, aar, po akj' gaezime;

kur presnjae praa taë mbljedhae ari vllastare,
e bushtra drrasae mbljodh grisur gjellnae t' ime...
Vajton te varri godha kuntisiare:
Ailimano, ndièi, Zot, ata ftesime.

(Shif *«Canti Tradizionali»*
të Zef Skiroit faqe 330)

ROSOLIN PETROTTA

---

8. — GABRIEL DARA-PLAKU (1765-1832)

a) Jetëshkrimi

Lindi në Palazzo Adriano, në Siqelí, me 15 Korrik 1765. Ka qenë nxënës i Seminarit italo-arbëresh të Palermit dhe pastaj doktor mjeksije dhe drejtësije.

Qe një mbledhës i pa-përtueshëm dhe hartues vjershash shqipe. Nisi përmbledhjen e „*Këngvet të pleqërisë*", që pastaj, e plotësuar dhe e rregulluar nga i biri Andrea, i dha lëndën

Strofa 4. — *Vistaar*: visari, thesari; nënkupton veprën e vet mâ të madhe historike me titullin: «Thesari i njohunivet mbí Makedonasit» (Shqiptarët). — *tuar*: tori. — *kjosaej*: të pasunojë.
Strofa 5. — *Haidhiare*: e gëzueshme. — *më taksi*: më premtoi.
Strofa 6. — *Godha*: shumicë populli. — *kuntisiare*: i Kuntisës, d. m. th. qyteti i lindjes s' auktorit (Kuntisa Entelina në Sicilí). — *ftesime*: faje.

të nipit që pati të njajtin emër, Gabriel Darës, të cilin do t' a quajmë „*i riu*", për hartimin e atij poemthi të vlefshëm e të rëndësishëm që ësht „*Kënka e sprasme e Balës*". Vdiq me 19 Maj 1832.

Po sjellim prej tij ketë këngë fetare, edhe sot shum të njohur ndër Arbëreshët e Kolonivet siqeljane.

b) Ejani, gjinde...

1.

Ejani, gjinde,
Thoni me nee,
Me t' math gaezím
E me haree :

2.

— Po kloft laevduar,
Paer jetae e mot,
Embaeri i lart
I t' madhit Zot !

3.

U dua t' rraefienj
Njae t' math shaerbèsae
Si na e maeson
Shejtia besae.

4.

E baeri Kríshti
Nae Betanii,
At' dit' çae ngjalli
Prap njae njerii.

5.

Lazri u saemuur,
E t' motrat vanae
Te Peraendia
E muarnae e i thanae :

BKSH

6.

Aì ç' do mirae
Si njae gjaerii,
Te shtrati i vdekaejes
Laengon e rrii.

7.

In' Zot i tha:
— tae m' kini besae,
Se naní Lazaeri
Ngae do t' ju vdesae;

8.

Se tek ai,
Paer shumae mot,
Do t' keet laevdii
I madhi in' Zot.

9.

Nae shpii u nkaethien;
Po u baeae maeae e raendae
Tae vllaut e tire
Ajo' saemundae:

10.

Saa frima e drita,
Ohta ju ljos;
Te.duart e 'tire
Gjella ju sos.

11.

Tae mjerat t' motra
U vuun ndae lip,
Tue rrahur gjirin,
Tue shkulur krip.

Strofa 6. — *Gjaerii*: gjiní, farefis.
Strofa 9. — *Saemundae*: sëmundje.
Strofa 10. — *Ohta*: aht, nxehtsina jetsore. — *ljos*: shkrî. — *gjella*: jeta.
Strofa 11. — *Lip*: zí. — *krip*: flok.

BKSH

12.

Praan e varrzuan
Ndae varr tae rii ;
Me njae daerrasae
Varri u mbaellii.

13.

E prap u nisaen,
Me siit ndaer lotae,
Tae gjejaen Krishtin,
E i thanae : — O Zot,

14.

S' maent t' e kish mbjedhur,
Nae kishe klaenae,
Vdekaeja e shkretae
Vaellauthin t' aenae.

15.

E Krishti u tha ;
— Fshini ato' lotae.
E kini besae
Se jam u Zot ?

16.

— Tae kemi besae
Na paer gjith-monae :
Jee i Biri i Zotit,
Si t' Shkruarat thonae.

17.

Dritae nga Drita
Ti jee ndae jetae ;
Jee e Larta Fjalae,
Gjella e vaertetae.

Strofa 12. — *Praan* : pastaj. — *varrzuan* : vorrosen. — *u mbaellii* : u mbyll.

Strofa 14. — *S' maent* : s' mund.

BKSH

18.

E Krishti u tha:
— Mos kini dree,
Se nd' atae varr
Lazri flee.

19.

E me Apostojit
Te varri u kjas;
Baeri tae ngrinjaen
Atae dearrasae.

20.

Me zaeae tae math
Merr e thaerrèt:
— O Lazaer, ngreu;
Eja nae jetae!

21.

Lazaeri u ngre,
E rroi pameta;
Paer di-saa vjetae
Shaendoi te jeta.

22.

Gjith' u thavmasaen,
E lavdae i dhanae
Zotit e jetaes,
E muarnae e thanae:

23.

Kloft i laevduar
Paer jetae e mot
Embaeri i lart
I t' madhit Zot!

(Shif «*Canti Sacri*» të Zef Skiroit; Napoli 1907, faqe 14 e vijim)

ROSOLIN PETROTTA

Strofa 18. — *Dree*; drojë, frikë.
Strofa 21. — *Pameta*: ristas, përsëri, prap. — *shaendoi*: gëzoi, pati shëndet.
Strofa 22. — *U thavmasaen*: u çuditen.

BKSH

9. — ANDREA DARA (1796-1872)

a) Jetëshkrimi e veprat

Andrea Dara ësht një nga fytyrat më të shquara të letërsisë s' Arbëreshvet të Siqelisë, dhe një unazë e çmuarshme e traditës së tyre që nderon familjen fisníke së cilës letërsija siqeljane-arbëreshe i detyron mase pjesën e saj më të mirë.

Bir i Gabriel Darës plakut e at i Gabriel Darës të riut, kish lindur në Palazzo Adriano më 17 Maj 1796. Si kryejti mësimet e mesme në Seminarin italo-shqiptar të Palermit, mori më pas, pranë Universitetit Mbretëror të Palermit, laurën në drejtësi. Vdiq në moshën 76 vjetshe më 2 Príll 1872.

Trashëgoi nga i ati i tij i shquar dashurinë për traditën, gjuhën, letërsinë shqipe ; ndoqi gjurmat e t' et me durim e ngulmë në përmbledhjen e këngëve popullore, të zakonevet, të gojëdhënave të vjetra të Palazzo Adrianos e të kolonive të tjera arbëreshe të Siqelisë.

Andrea Dara ka lënë shkrime të shumta të pabotuara, ndër të cilat një „*Fjalor shqip-italisht e italisht-shqip*“ të pasur nga fjalët e të paraprirë nga një gramatikë e vogël ; përkthimin në shqip të „*Ungjilli i Sh. Matheut*“ dhe një tjetër shkrim mbi „*Zakonet e doket e Palazzo Adrianos*“.

Por vepra e tij që meriton gjithë mirënjohjen e Shqiptarëvet ësht përmbledhja e kujdesëshme dhe e durimshme e të shum këngëve të trashëguara, popullore të vjetra, dhe plotësimi i përmbledhjes së filluar nga i ati, me titullin „*Këngë të pleqërisë*“ që ay i ka rregulluar me kujdes, duke i ndarë në dy serí: një seri e parë prej dyzet tetëshesh, që ay vetë i quajti të hartuara pas ardhjes së Shqiptarëve në Siqeli, dhe një seri e dytë e përbërë prej këngësh e pjesash poetike, që ay, për nga përmbajtja e për nga stili, i quajti të prura nga Shqipërija.

Mbí „*Këngët e pleqërisë*“ të përmbledhura nga i gjyshi e nga i ati, Gabriel Dara i riu hartoi pastaj poemthin „*Kënka e sprasme e Balës*“ vepër *me një interes të posaçëm historik e folkloristik* — shkruan Gaetan Petrotta — *sepse riprodhon jetën,*

mendimet, ndienjat e Shqiptarëve t' ardhur në Itali për të gjetur strehë të sigurtë dhe ku, shkruante më 1906 i nipi i Gabriel Darës, *pasqyrohet krejtësisht shpirti i poetit, kujtimi i përmallshëm i lirisë së humbur, përkujtimi i madhështisë së perënduar, dhe dashurija e zjartë për atdhe, me endërimin që t' a shohë edhe një herë, në një ditë jo të largët, të lirë e të madhe Shqipërinë.*

Nga dorëshkrimet e Andrea Darës kanë nxjerrë njoftime, mund të thuhet, të gjithë ata që pas tij janë marrë me letërsí, me vjershë, me këngë popullore, me folklorë të Kolonive arbëreshe të Siqelisë: nga Zef Krispi, te Dhimitër Kamarda e te Zef Skiroi, siç shkruan vetë ky në vëllimin e tij „*Këngë gojdhënore e të tjera Prova të Kolonive arbëreshe të Siqelisë*" (Napoli 1923 faq. XL.)

I përket prá Andrea Darës një nga vendet e para midis letrarëve arbëreshë të Siqelisë; dhe, me gjith që s' kemi prej tij ndonjë hartim poetik origjinal, e quajmë për detyrë t' a përmendim në këtë antologji me qëllim qi emri i tij të rrënjoset me dashuri në zëmrat e nxënësve të rinj duke botuar vetëm këtë hartim poetik të zgjedhur midis shkrimeve të shumta të tija.

b) E bukura, i varfëri dhe kali

Dual e bukura më derë,
Me poçerezit [1]) plo verë,
E me qelqezitë [2]) në dorë,
Të jipë të pijën varfëritë.

E bukura

— O ti, i mjeri varfërithë,
Çë më vjenë ka amahjezitë, [3])
Mos më pee ti zotin t' im?

---

1) *Poçerezit*: shumsi i fjalës *poç*, nga latinishtja *poculum*. — 2) *qelqezit* nga fjala *qelq* = gotë. 3) *amahjezitë*: fj. greke qi d. m. th. *luftime*; mbaresa *zit* jep kuptimin e rrjedhjes, si b. f. *mbrendazit*: nga mbrenda; *jashtazit*: nga jashta.

I varfëri

— U më pee shumë luftorë,
E t' ëtë zonë nëng' e njoha.

E bukura

Ish një trim' i bukurithë [4])
I bukurith', i gjelburithë,
Me mustaqë te 'ngrehurithë,
Me një kaalë t' ëmbrimurithë [5]),
Me një shalë të mundafshtë,
Me një qengële të viljushtë [6]),
Me një frenëthë hrisoneme [7]),
Me një flamurithë në dorë...

Ajo më paa praa kaalthin,
Çë kish shalëzën nënë barkë,
E me flamurë xarrë xarrë [8]).

E bukura

O ti i shkret', i shhalinosmë [9]),
Ku m' e lee zotin t' ëntë,
Zotin t' ëntë, e zotin t' imë ?...

Kali

U gjithë fushazitë m' i rrodha [10]),
Gjithë përronjëzitë karceva,
E gjithë maljëzit më jeca [11]).
Për në fushat Napulitë,
Ende një humbjezë [12]) si arreita,
Embi një drrasë të marmuri

---

4) *bukurithë*: zbunim i fjalës *bukur*. — 5) *t' ëmbrimurithë*: të zjartë, të gjall, nga greqishtja. — 6) *qengële të viljushtë*: qingël, nënbarkse të kadiftë. — 7) *hrisoneme*: i artë (f. greq.) — 8) *xarrë*: rrëshqanthi, zvarrë. — 9) *i shhalinosmë*: fatmjerë, i shkretë. — 10) *rrodha*: ngarenda, renda. — 11) *jeca*: eca, kalova. — 12) *humbjezë*: prroskë, gropë.

U kumbisa 13) këmbazitë,
Po më shkaan të katerazë : 14)
Qeni turk më raa siprë
E m' i qethi kriezën 15).

(«*Appendice al Saggio di Grammatologia Albanese*», të Dhimitër Kamardës — Prato 1866 faqe 132-133)

ROSOLIN PETROTTA

---

10. — JERONIM DE RADA (1814-1903)

a) Jetëshkrimi

Jeronim de Rada, ase si e quanin bashkatdhetarët e tij *Dçelorm' i Radhanjve*, poeti më i math i Arbëreshëvet përtej Adriatikut, lindi në Makji të Kalabrisë më 19 të Nëntorit 1814, dhe ishte i biri i një prifti, mësonjës i greqishtes së vjetër e i latinishtes.

Kreu mësimet e para e të mesmet në kolegjin e S. Benedetto Ullano-s, dhe doli së këtejmi më 1833 kur nuk i kish mbushur edhe njëzetë e një vjetët. Po nuk u dërgua përnjëherë në Napul për të vijuar mësimet e larta universitare. I ati i tij deshi më parë që i biri të forconte trupin dhe shpirtin n' erën e pastër dhe në qetësinë fusharake të fshatit lindor, prandaj e detyroi të këthehej sërish në Makji, ku kaloi një motmot.

Këjo parantezë pushimi pati një rëndësi të madhe për gjithë jetën e poetit t' ardhshëm, sidomos për veprimtarinë poetike të tijën. Aty për herën e parë nisi De Rada, i shtytur nga një mik i tij, të mbledhë nga goja e fshatarkavet arbëresha këngët e tyre të këndëshme e filloi për të parën herë të shijojë e të çmojë bukuritë e rralla të këtyre këngëve. Gjithashtu

---

13) *kumbisa* : vûna, mbështeta. — 14) *të katerazë* : të katër kambët. — 15) *kriezën* : kryet, kokën.

qe aty që njohu edhe një vajzë të re e të mitur, bijë e një bariu të tij, të cilën Jeronimi e përjetësoi më vonë në vargjet e pavdekshme të së parës veprës së tij „*Milosaat*".

Pas këtij qëndrimi të shkurtër, në Dhjetor të vitit 1834, De Rada lë Makjin për në Napui, ku shkruhet, si pas dëshirës së prindëvet, në fakultetin e Drejtësisë. Po, si duket, këtë shkencë nuk i a kish ënda aspak, as që e tërhiqnin fare lëndët e saja të thata, pse djali i ri në vënt që të ndiqte mësimet e fakultetit, nisi të këndojë e të studjojë me zell të math e me përfitim të thellë letërsitë moderne. Lëçiti kështu Shakespeare-in, Calderon-in dhe veprat theatrore frënge. Pikë tjatër këjo me rëndësi për drejtimin romantik të De Radës.

Pastaj, me përhapjen e kolerës në Napul, në Tetor të vitit 1836 këthehej në shtëpi dhe në vënt që të binte me vehte të ashtuquajturën „librezën e provimevet", pruri një *librezë* tjatër shum më të këndëshme e shum më të hijëshme se e para, „*Milosaat*", që kishte botuar në Gusht t' atij viti.

Kësaj here De Rada në Makji qëndroi dy vjetë. Po nuk ndënji me duar në gji. I shtytur nga buja e veprës së parë, nisi të shkruajë disa pjesë të historive të tija poetike e pikërisht ato me titujt: „*Imotoe*", „*Perrala*", „*Vantisana*", „*Diana*".

Aty pati rasë të njihej edhe me kryetarin e kryengritësvet kalabrezë dhe mënt u-shkua në litar nga qeveritarët borbonë.

Pas këtyre dy vjetëve erdhi prap në Napul dhe kësaj here lidhi këtu miqsí me një farë Benedetto Mussolini, që hiqej si përfaqësonjës i Mazzinit në atë krahinë. Këjo miqsi e re i kushtoi shtrënjtë De Radës, pse jo vetëm që e hodhi një muaj në burg poetin, të paditur si kundërshtar i Regjimit të Borbonëvet, po edhe e detyroi të largohej nga zyra advokatore e të famëshmit penalist Raffaele Conforti-t, pranë të cilit praktikohej. Atëhere, me ndërmjetësinë e një advokati arbëresh, Cesare Marini, hynte, më 1840, si mësonjës në familjen e dukës Spiriti për t' edukuar të vetëmin djalë të këtij zotnije, punë që De Rada e kreu me zell, me nder e me zotsí.

Këta qenë ndofta vjetët më të qetë që kaloi poeti i ynë, pak së paku nga pikëpamja ekonomike. Pranë kësaj familjeje

pati edhe rasë të njohë një vajzë, që, si na thotë ai vetë, ishte fisnike nga gjaku, e që ndofta ka të bëjë me „Gavrilen" e „Milosaave".

Pas shtatë vjetësh këthehet prap në Makji, po qëndron për pak kohë, pse e shohim përsëri në Napul, ku merr pjesë aktivisht në lëvizjet kryengritëse të atëherëshmet. N' atë kohë pa dritën një vepër tjatër e De Radës, „*Katër Historitë e Shqipërisë*", një botim i dytë i „*Milosaave*" mbí disa shtesa e modifikime, si edhe tragjedija italishte „*I Numidi*", përveç shkrimeve që kish botuar e botonte në fletore e të përkohëshme të ndryshme.

Njëkohësisht, kur fillonte plasja e revolucjonit kalabrez e 1844-ës, niste botimin e një flete kryengritse italisht me emërin „*L' Albanese d' Italia*". Si shpërblim i kësaj veprimtarije, më 1849 i dorëzohej kathedra e letërsís shqipe të krahasuar, e krijuar nërgut për 'të në kolegjin e Sh. Adrianit. Po në këtë detyrë De Rada nuk vijoi për shum kohë, pse më 1852, prap për çështje politike, një dekret mbretror e pushonte nga puna.

Më 1 të Frorit 1850 niste një jetë e re për Poetin, niste jeta famıljare, jeta shtëpijake, e ndriçuar nga hyrja e zonjës Madalena Melikji në zëmrën e De Radës. Nga ky bashkim Jeronimi pati edhe katër djem: Zefin, Mikelangjelin, Rodrigun dhe Hektorin.

Po këjo lumtëri, këjo qetësi familjare nuk vijoi shum kohë. Më 1860 i vdiste pa pritur e pa kujtuar më i riu i djemëvet, Hektori, që Poeti e qau e e vajtoi me mallëngjim të parrëfyer.

Pas nj' a tetë vjetëve, ndofta për të harruar vdekjen e djalit, ndofta për arësye ekonomike, pranoi të merrte drejtimin e Gjimnazit të Corigliano Calabro-s, ku si punëtor i palodhur që ish, themeloi edhe një shtypshkronjë, nga e cila dualnë disa vëllime të vargjeve të tija. Për t' u permëndur ndër këto botime janë ca libra të para të poemit „*Skanderbeccu i Pa-faan*".

Po më 1872 një fatkeqsí tjatër i a përvlonte zëmrën: i vdiste Mikelangjeli. U largua atëhere edhe nga Gjimnazi i Corigliano-s e u këthye prap në Makji, ku më 1883 nuk i a vononte fatkeqësija e tretë: djali i tij më i madhi humbte jetën në mënyrë tragjike!

Nisin kështu ditët e zeza për De Radën. Prej asaj kohe plaku i gjorë nuk pa më një orë të bardhë. Njëri pas tjatërit i vdisnin e shoqja, i vetëmi djalë që i kish mbetur, të vëllezërit! Nisnin edhe vuajtjet e tija ekonomike, që e munduan gjër në çastin e funtmë.

Po ky njeri, që pa me sytë e tij t' i çduken e t' i bëhen botë të gjithë t' afërmit e far' e fisi, ky njeri, të cilit shum herë i mungoi edhe kafshata e bukës, nuk u mpraps, nuk u largua, nuk hoqi dorë kurr nga ideali i shënjtë i tij.

Më 1883 themelonte një fletore shqip e italisht me emërin „*Fiamuri i Arbërit*“, numëri i parë i së cilës doli më 20 të Korrikut dhe qe me të vërtetë një „flamur“, një „flakë“ e gjallë atdhetarije e shqipëtarizmi të kulluar. Me anën e kësaj flete lithte De Rada marrëdhënjet me atdhetarët më të shkëlqyer t' asaj kohe, në çdo krahinë a çip të botës që gjendëshin, si me Abdyl Frashërin, Prenk Bib Dodën, Sami e Naim Frashërin, Kristoforidhin, Eftim Mitkon e shum të tjerë, të cilët e ndihmuanë me sa u erdhi n' doresh veprimtarinë e Poetit. Po më 1886, pas tre vjetë luftash dhe përpjekjesh, për arësye ekonomike shuhej edhe këjo flakë...

Megjithatë De Rada nuk e preu punën atdhetare, letrare e poetike të tijën. Të pleqërisë janë një tok botime të tijat, ndër të cilat për t' u kujtuar ësht poemi i funtmë me titullin: „*Uno specchio di Umano Transito*“ që pa dritën më 1898.

Më 1889 e shohim Jeronimin në Romë, ku, me ndërhyrjet e tija, mundi t' a ngjallë sërish të vdekurën kathedrën e gjuhës shqipe të kolegjit Sh. Adrian, duke i u ngarkuar prap këtij ushtrimi i saj. Prandaj vitet e prasme De Rada i kaloi si mësonjës i shqipes herë në Makji herë në Sh. Dhimitër Koronë, gjërsa nj' a motmot më parë se të vdiste e la për gjithënjë vëndin lindor dhe zuri një odë me qirá pranë një ish-pendarit të tij në këtë fshatin tjatër të Kalabrisë.

Kështu dita ditës plaku i gjorë në mes të shiut, t' erës a të borës, ishte i shtërnguar të bënte disa kilometra këmbë për t' u mësuar Arbëreshëve të rinj gjuhën amtare të tyren, pse kolegji ndodhej jashtë fshatit, gjër sa më në funt nj' a pesëm-

bëdhjetë ditë përpara vdekjes ra i sëmurë nga të ftoftit. Po nuk deshi t' i shmangej detyrës dhe pas dy tri ditëve u ngrit. Atëhere sëmundja i u këthye në bronkit, duke i u keqsuar gjithënjë më tepër, dhe kësaj here e detyroi De Radën të bjerë prap në shtrat, nga i cili nuk do të ngrihej më kurr. Më 27 të Fruarit 1903 hynte në heqje. Natën ata që e ruanin e panë të çohej mbì shtrat e të thërriste: *„Gjaku shqipëtar po shkon! Gjaku shqipëtar po niset!“* dhe në mëngjes të 28-ës Përfaqësonjësi më i ndriçëm e më i kulluar i Arbëreshëvet jepte frymën e funtme.

b) Veprat

Nuk janë të pakëta shkrìmet që na ka lënë pënda e De Radës. Poeti i Makjit qe ndoshta më pjellori i të gjithë shkrimtarëve italo-shqipëtarë të tjerë. Në këto shkrime ai derdhi tërë veprimtarinë politike, letrare, filologjike e patriotike të tijën. Po japim prandaj një listë të botimeve të tija kryesore — me përjashtim t' artikujve — të numëruara kronologjikisht: **Odisse,** një poem i vogël në gjuhën italishte me subjekt shqipëtar, botuar më 1832, botim i dytë më 1847; **Milosaat,** botimi i parë më 1836, i dyti më 1847, i treti 1872-73; **Serafina Thopia,** poem shqip, botim i parë më 1839, i dyti 1843; **I Numidi,** tragjedi italishte, 1846; **Quattro Storie o L' Albania** *(Anmaria Cominiate, La Notte di Natale, Adhine, Videlaide)* shqip, 1847; **Principii di Estetica,** italisht, 1861; **Antichità della Nazione albanese,** italisht, 1864, botuar për herë të parë më 1840; **Lettera politica a G. Stamile,** 1865; **Rapsodie,** mbledhje këngësh arbërishte, 1866, botimi i dytë 1883-84; **Gammatica albanese,** me emër të të birit, Zefit, 1871; **Skanderbeccu i Pa-Faan,** libri I, II e III në Corigliano Calabro më 1872-73, libri IV në Napul më 1877, libri V ibid. 1884; **Il collegio di S. Adriano,** italisht, 1876; **Quanto di ottimo vivere sia negli Stati rappresentativi,** italisht, 1882; **La caduta della Reggia d' Albania,** shqip 1885-86; **Pelasgi e Albanesi,** italisht, 1890; **Sofonisba,** tragjedi italishte 1891;

Conferenza su l' antichità della lingua albanese, italisht, 1893; **Caratteri della lingua albanese e grammatica della medesima,** 1894; **Antologia,** 1896; **Uno specchio di umano transito** poem shqip, 1897; **Autobiologia,** italisht, 1898-99; **Caratteri della lingua albanese,** konferencë e lëçitur në XII kongres të Orientalistëve në Romë më 1898.

Po nga të gjitha këto vepra, vetëm tetë janë ato që na interesojnë drejtë për drejtë dhe që vlejnë për të njohur e për të çmuar aftësitë artistike të De Radës: *Milosaat, Këngët e Serafina Thopisë, Katër Historitë, I Numidi, Skanderbeccu i Pa-Faan, La caduta della Reggia d' Albania, Uno specchio di umano transito, Sofonisba.*

Katër të parat janë veprat e djalërisë, në sa katër të dytat veprat e pjekurisë e të pleqërisë. Po le të kuptohemi: me përjashtimin e *Milosaave* e të *Katër Historive,* të gjitha këto vepra kanë të bëjnë, ase më mirë të thomi, janë lidhur ngusht njëra me tjatrën, pse auktori i tyre qe ripunonjës i palodhshëm i të gjitha shkrimeve të tija. Kështu, bije fjala, *Skanderbeccu i Pa-Faan* ësht *pjesërisht* një ripunim i *Serafina Thopisë.* Nga përmbledhja e ripunimi i disa këngëve të *Skanderbeccu-t* doli pastaj vepra tjatër që u quajt *La caduta della Reggia d' Albania.* Gjithashtu nga një punim i dytë i tragjedisë *I Numidi* doli tragjedija *Sofonisba,* dhe më së fundi nga një ripunim i tretë i *Serafinës* doli *Uno specchio di umano transito.*

c) Analiza e vepravet

1) «Serafina Thopia». — Do t' ishte punë e mirë fort për studjimtarin të dinte gjër në ç' pikë kanë lidhje këto vepra në mes të tyre, dhe cilat pjesë janë marrë prej së parës për të plotësuar të dytën. Mjerisht hë-për-hë studjime të tilla nuk mund të bëhen, pse mungojnë botimet e ndryshëme të vepravet deradjane, ase janë fort të rralla.

Sigurisht me këngët e Serafinës poeti pati ndërmënt të shkruante një farë *ditari lirik* të një vajze shqipëtare — si pas fantazisë s' auktorit, të Serafina Thopisë, princeshë e Artës dhe

pastaj e Zadrimës — duke kënduar mbrënda dhjetë këngëve historinë e dashurisë së kësaj princeshe për Bosdar Stresin, dashuri e kundërshtuar prej prindëve të Serafinës, pse dy familjet ishin armike e kundërshtare të njëra tjatrës.

Mirë po këjo histori e kësaj dashurije dhe sidomos ky kundërshtim i martesës së Serafinës me Bosdarin, që duhej t' ishte thelbi dramatik i poemit, na ësht dëftyer në mënyrë aq të çthurur e t' errët, sa me-zi kuptohet prej lëçitësit. Kështu që këjo vepër e dytë e De Radës shpejt ra në harresë, siç ranë, njëra pas tjatrës, edhe të tjerat.

Edhe këtë poemth Jeronimi e ka shkruar në trajtë autobiografike, si *Milosaat*. Madje ësht sidomos nga këjo pikëpamje që ndryshon *Serafina* nga të gjitha ripunimet e dyta e të treta të më pastajme.

2) „Skanderbeccu i Pa-faan" — Përkundrazi *Skanderbeccu* na paraqitet shum më i gjërë se *Serafina*. Poemi ka gjithësejt pesë libra të ndara në 32 këngë ase historí. Veprimi zhvillohet prej vitit 1428 gjër më 1444. Mirë po këtu pa pritur shtjellimi këput e mbyllet. Gjithashtu edhe Skenderbeu, siç lë të kuptojë titulli, nuk ësht aspak fytyra qëndrore e poemit, d. m. th. protagonisti rreth të cilit lëvizin e veprojnë kreshnikët e tjerë dhe rreth të cilit zhvillohet subjekti i krejt veprës. Ai na del në skenë për herë të parë në këngën e pestë të librit të dytë.

De Rada e përpiloi këtë vepër kohë pas kohe dhe e botoi në vëllime të vogëla që nga viti 1873 gjër më 1884 në Corigliano Calabro e në Napul. Po kritika kësaj here nuk e priti me kënaqsí e brohorí si kish pritur veprën e tij të parën, „*Milosaat*", pse poemi ishte fragmentar, i çthurur, inorganik. Prandaj De Rada për të qetësuar kritikonjësit, mblodhi të gjitha ato këngë që kishin një farë lidhje në mes të tyre përsa i përkiste rënjes s' atdheut origjinar të tij në duar të Turkut, dhe i botoi prap me titullin „*La caduta della Reggia d' Albania*" në fletoren politike-letrare shqipe „*Fiamuri i Arbërit*".

3) „Uno specchio di umano transito". — Shum më vonë pastaj, në kohë të pleqërisë, botoi poemin e tij të funtmin, „*Uno specchio di umano transito*". Si thamë edhe më sipër se

ky poem ësht një ripunim i dytë a i tretë, i poemit tjatër djaloshar „*Serafina Thopia*“. Po këtu thurja e subjektit zgjërohet më ; veç asaj lënda nuk ësht shtjelluar në trajtë autobiografike si në „*Serafinën*“.

Përsa i përket mbrëndisë, prap edhe në këtë ripunim na këndohet dashurïja e Serafinës me Bosdarin, familjet e të cilëve ishin prej kohe armike. Madje nga shkaku i kësaj armiqsije Bosdari dërgohet në mërgim. Gjatë këtij mërgimi prindët e fejojnë me një princ tjatër Serafinën, kështu që kur kthehet trimi, triumfonjës pse kishte liruar dhenë e vet nga Turqit, pas pak ditëve kremtohet dasma. Po Bosdari nuk e harron dot të dashurën e zëmrës së vet. Na përshkruan me këtë rasë poeti dëshprimin e lotët e djalit për Serafinën e martuar. Më në funt, pas shum kohe, një zëmër tjatër i hapet kreshnikut : zemra e Olimpís, e kushërirë e Serafinës, për të cilën Bosdari kish vrarë një turk, që e kish dhunuar vajzën udhës. Po edhe këjo dashuri e dytë nuk ësht aq e mbarë për trimin, pse mbaron në mënyrë tragjike. Një natë, në sa përjashta lëshohej një stuhi e tmerrshme, tek niset Bosdari të vejë në shtëpinë e Olimpís, pranë së cilës kalonte netët fshehurazi, një rrufé e lë për dhe të vdekur. Vdes edhe Olimpija, mé vonë edhe Serafina, e këtu merr funt poemi.

4) „Milosaat“. — Le t' i hedhim një sy tani veprës më të parë e më të rëndësishme e të famëshme, „*Milosaat*“.

Janë „*Milosaat*“ ase, si i ka quajtur edhe ndryshe auktori i tyre „*Këngët e Milosaut, të birit të një sundimtari të Shkodrës në shekullin XV*“, një tufë vjershash të këndëshme, ku De Rada shtie se kinse këndon të ndodhurat e këtij trimi shkodran, po në të vërtetë na dëften historinë e një dashurije së tij djaloshare me një vajzë shum të varfër që ai e quan „*e bija e Kologres*“ e që ishte bashkëfshatarja e tij. D. m. th. pikërisht ajo e bija e bariut, fort fisnike në tiparet e në shpirt, për të cilën poeti ndien dashurinë më të parë, atë vit që qëndroi në Makji, passi kish kryer studjimet e mesme.

Në fillim këto vargje përbënin disa „kangjelje“ a këngë të vogla, të frymëzuara prej kësaj dashurije, pa ndonjë lidhje

në mes të tyre. Vetëm më vonë i ra në mënt poetit t' i u japë një „kurnizë", një thurje poemthi, me një argument të vetëm. Po edhe më pas një lidhje të ngushtë këto këngë nuk e patnë; as që përbëjnë një „poemth" me atë kuptim që i japim sot kësaj fjale. Prandaj me plotë arësye auktori i tyre e thirri „*romanx lirik*" këtë vepër, pse e tillë ësht me të vërtetë. Megjithatë, një farë mbrëndije shum a pak munt të nxiret prej këtyre këngëve.

Kënga e parë ësht si një hyrje e poemthit. Aty Milosau — në realitet vetë De Rada — na bën fjalë se si i erdhi frymëzimi për një vepër lirike. Në këngën e dytë na dëftehet pjekja e parë e trimit me të bijën e Kologresë. Në vargjet tjera që vijnë pas na kallxohen fazat e ndryshëme të dashurisë së tyre; dëshprimi i vajzës kur merr vesh se duanë t' a martojnë me një djalë të huaj, psherëtimat dhe hidhërimi i saj për nisjen e papritur të Milosaut, kthimi i këtij dhe vuajtjet e tija pse nuk munt të martohet me vajzën, mbassi ai ësht bir zotnije dhe ajo një fshatarkë e varfër... Po këtu, përnjëherë, si n' ëndërr një katastrofë e madhe e rrëxon rrafsh Shkodrën. Prishen kështu bashkë me 'të edhe klasët shoqërore; prandaj dy të rinjt më në funt martohen e gëzohen edhe nga lindja e një djali. Kënga XXII na e shpreh kulmin e këtij gëzimi. Po ditët e zeza nuk vonojnë. Milosaut i vdes i biri, pastaj gruaja e dashur e tij, më në funt çduket edhe vetë. Dhe këtu merr funt poemthi.

Të gjitha këto në botimin e parë (1836) janë kënduar mbrënda tridhjetë këngëve. Po botimit të dytë (1847) i janë shtuar edhe nj' a gjashtë këngë të tjera. Një veçori tjatër e këtij botimi janë datat fiktive që ka çdo këngë, të vëna me qëllim që vepra të dukej me të vërtetë si një „*ditar lirik*" i shekullit XV, për t' i u përshtatë titullit. Po në realitet ky inovacjon qe i dëmshëm, pse herë herë këto data bjenë në kundërshtim me sa ësht thënë e përshkruar në këngët.

Përveç këtyre 30 a 36 „kangjeljeve", gjejmë pastaj në të dyja botimet disa vargje të tjera fort të bukura që De Rada i quan „vjersha", si p. sh. „*viershi i të biljes Cologrees*" etj. Si

masë për 'to ësht përdorur njëmbëdhjetërrokësi, kurse në „kangjeljet“ përdoret tetërrokësi i përzjerë me shtatërrokësin, gjashtërrokësin, pesërrokësin, etj., pa rimë.

ç) Vlera e „Milosaave“

Nga të gjitha veprat poetike të De Radës, e vetmja që shpëtoi nga kosa e pamëshirëshme e kohës qe pema e parë e tij, d. m. th. „*Milosaat*“. Që posa doli në dritë ky poem i vogël, u prit me bujë të madhe jo vetëm në qarqe italo-shqipëtare e shqipëtare, po edhe në qarqet e albanologëve e të filologëve të mbarë Europës, që atëhere po sa nisnin t' interesoheshin shum a pak për vëndin t' onë. Poetë e letrarë të mëdhenj e në zë i thurën përgëzime e lëvdata kolegut të tyre arbëresh.

Që prej botimit të parë e gjër më sot me qindra kritika u janë bërë „*Milosaave*“. Të gjithë shkrimtarët shqipëtarë a arbëreshë kanë thënë dy fjalë për poetin e Makjit sa herë që e ka sjellë rasa. Ka nga ata që e kanë ngritur në qiell me lëvdata; po ka ngjarë gjithashtu që dikush t' i mohojë çdo aftësi poetike. E vërteta ësht se një kritikë e sosur, një kritikë me kuptimin më të plotë e më modern të fjalës edhe nuk ësht shkruar. As vetë Gualtieri, që pa dyshim ësht studjimtari më i mirë e më i gjërë i vepravet deradiane, pas Marchianò-it, një kritikë si e dëshirojmë na nuk na i ka dhënë.

Arësyet e lëvdatavet të tepërme që i janë bërë veprës së De Radës kuptohen lehtë: janë arësye kombtare, arësye patriotike, arësye politike. Dihet fort mirë se De Rada qe i pari që i fali gjuhës shqipe një vepër me vlerë poetike të vërtetë; dihet edhe se De Rada qe nga më të parët që u përpoq për lirinë e mbëkëmbjen e atdheut origjinar të tij. Ishte e logjikëshme prandaj që vepra e tij të spekulohej e të ngrihej lart, shum më lart nga ç' e meritonte, ashtu si u ngritnë e u brohoritnë veprat e një poeti shqipëtar tjatër, veprat e Naimit. Po pa dyshim kritika e teproi. Do të gabohej shum ai që t' a krahasonte De Radën me një Dante a me një Goethe..., ashtu siç u krahasua në këto kohët e funtme edhe Naimi! Jo, De Rada

s' ka fuqinë krijonjëse as të një Dante-i, as të një Goethe-je dhe as të një Shakespeare-i. As që ka fuqinë përshkronjëse ase ëmbëlsinë e kumbimin e vargut të një Lamartine-i a të një De Musset-i. Ka përkundër gjithë atë ndieshmërí të stërhollë që i dallon bukur mirë poetët e radhës së parë, e gjithë atë origjinalitet shprehjesh e fytyrash e mendimesh që do t' i sigurojë De Radës një vënt të posaçëm në historinë e letërsís s' onë. Madjé ësht ky sensibilitet i stërhollë që i ka lejuar të fiksojë me shkrim edhe ndienjat më të fshehta e më të thella të shpirtit t' onë. E i ka lejuar gjithashtu që pa u zgjatur në fjalë e në përshkrime, të na japë mbrënda dy trí vargjeve tablora madhështore të një bukurije së pashoqe.

Dreq rahjet e deitit
Gkëzoi ditta e kalthërëz...

„*Quel délicieux tableau! Cela a le parfume des idilles biblique et la rêve de langue vierge!*" thërriste prandaj i mahnitur e i rrëmbyer Mistral-i.

Po vlera kryesore, vlera bazë e „*Milosaave*" nuk qëndron vetëm në këtë ndieshmëri të stërhollë, në këtë origjinalitet mendimesh e shprehjesh e fytyrash, po kryesisht n' atë *thjeshtësi*, në atë „*naivitet*", n' atë „*freshkësi*" ndienjash e kallximesh që vlon në çdo faqe të këtij poemthi. Fshatarët e fshatarkat t'ona rrall kanë për të gjetur një poet tjatër si De Radën, që t' i befi në çastet e tyre më të bukura, në çastet e tyre më të përvuajtura e më të këndëshme, n' ato çaste që i shpëtojnë syrit të përditëshëm të njeriut praktik, po që krijojnë e përbëjnë një botë më vehte, një botë ëndrrash e fantazishë, për atë që di t' i kuptojë e t' i çmojë, për Poetin. Një fllad i përmallëshëm miturije, një fllad i lehtë virgjiniteti e dlirësije fryn në të gjitha këto „kangjelje" të De Radës. Na duket, prandaj, se kritikonjësit më të drejtë e më të mirë të tij, ata që e kuptuan që në krye se ku qëndronte vlera poetike e „*Milosaave*" qenë pikërisht ata poetë e letrarë të huaj, bashkëkohëtarë të tij, që në fillim folnë për „*fraicheur*" „*delicieux tableau*" „*calme evange-*

lique" *„parfume des idilles bibliques"* etj. Edhe na sot i çmojmë e i shijojmë *„Milosaat"*, pse ajo nuk ësht pema e një „elaborimi" mëndor e artificjal, nuk ësht pema e një arësyetimi të ftohët e të thatë, po ësht epshi, fshamja e një shpirti që ndien e vuan thellë.

Këtë thjeshtësi, këtë freshkësi, këtë „naivitet" ndienjash e kallximesh De Rada e gjeti dhe e fitoi tërthorazi këngëve të fshatit të tij, pikërisht n' ato këngë popullore që kanë qënë burim i pashterrur për poetët t' onë më të mirë, që nga Fishta e Schirò-i e gjër tek Lasgushi. Madje për këtë arësye De Rada ësht edhe *i tërë poet shqipëtar*, ase një nga më shqipëtarët e më popullorët e poetëve t' onë, ashtu siç ësht Fishta. Prandaj ësht çudi për të bërë se si De Rada, lindur e rritur në tokë e në shkolla italjane, nuk u influencua nga gjithë ai i mrekulluarshëm prodhim letrar shtatë a tetë herë shekullor. Munt të thohet kështu me plot të drejtë se nga pikëpamja e këtij influksi De Rada nuk ësht aspak i biri i shekullit në të cilin rrojti, as i biri i tokës në të cilën pa dritën e parë. Dhe as që ësht biri i asaj shkolle retorike e prolikse që triumfonte aso kohe n' Itali e sidomos në Napul: provë e gjallë tjatër këjo që na dëften se ç' kuptim të lartë kishte De Rada për artin e për poezinë, që kanë qenë dhe do të jenë gjithënjë „intuicjon" frymëzim, ndienjë, krijim, origjinalitet e kurr retorikë e artificjalitet.

Natyrisht këto vetija të rralla t' artit të De Radës i gjëjmë vetëm n' ato pjesë të *„Milosaave"*, që poeti i ka shkruar në frymëzim e sipër, d. m. th. n' ato pjesë, të cilat ai i ka ndierë e i ka jetuar me të vërtetë; pse n' ato të tjerat, ku De Radës s' i ka punuar as zëmra as shpirti, as që vlejnë të përmënden e të merren si të tijat. Madje janë këto pjesë që fatkeqësisht i bëjnë *„Milosaat"* të mos jenë një kryevepër arti e përsosur. Gualtieri duket se fajin e këtyre „të metave" u a heth „përkujdesimeve gjuhësore" që kishte poeti, a me fjalë tjera, hallit të math në të cilin u gjent kur deshi t' i japë gjuhës s' onë trajtë shkrimi e sidomos petk arti, e kur deshi të shprehë me këtë gjuhë, të palëvruar e të lënë pas dore shekuj me radhë,

edhe „nuancat“ më të holla të ndieshmërisë e të mendimit të tij. Një nga meritat e mëdha të De Radës qe edhe këjo: të ngrerë dialektin e vet në lartësinë e një gjuhe letrare. Po nga ana tjatër këto „përkujdesje“ e dëmtuan mjaft veprën e tij, pse herë herë e mbytën ndienjën e frymëzimin e bashkë me 'to thjeshtësinë e „spontaneitetin“.

Po përkujdesimet e De Radës nuk e dëmtuan vetëm nga pikëpamja artistike veprën e tij. Zelli i tepërm dëmtoi pa masë edhe gjuhën e përdorur në 'të. Për çudi De Rada përdor disa ndërtime sintatike që nuk janë aspak shqipe, as janë italishte, a të ndonjë djalekti italo-shqipëtar.

De Rada në shum pika ësht i errët pra; dhe këtë e kanë vërtetuar të gjithë ata që e kanë lëçitur veprën e tij. Po ësht mirë të caktohet se De Rada ësht i errët jo vetëm e vetëm prej „kujdesimeve gjuhësore“ që ka pasur, po pse kërkon më tepër vetë të jetë i errët, a që t' a thomi me një shprehje italishte ësht „volutamente oscuro“. E këtë edhe kritikonjësi më zëmër gjërë nuk munt t' i a falë, siç nuk munt t' i falë „fragmentaritetin“ e tij; pse në kundërshtim me sa ësht thënë gjër më sot, më se „fragmentare“ vepra e tij ësht e copëtuar, kështu që nuk gjendemi shum herë përpara një „fragmentariteti“, se sa përpara një copëtimi, një këputjeje së papritur, shkaqet e së cilës mbesin të pashpjeguarshëme.

Këjo errësirë, ky „fragmentaritet“, që na po e quajmë „copëtim“, shtohet jashtë kufireve në veprat e tija të më pasëshme. Në këto vepra poeti humbet krejt edhe ndienjën e *njësisë*, të *masës* e të *përpjestimeve*. „*Skanderbeccu*“, p. sh., ësht ngarkuar me aq epizode e pjesë të ndryshëme, sa gati gati e mbytin poemin, e çdukin veprimtarinë kryesore të tij.

Një e metë tjatër, për të cilën e kanë qertuar De Radën, ësht mungesa e një rregulle të caktuar për përpilimin e vargjevet të tij. Këtë mungesë do t' a gjejmë më vonë edhe në poetët toskë, kurse poetët e veriut, duke ndjekur metrikën latine-italjane, janë më të përsosur nga këjo pikëpamje. Po faj i math ky i De Radës nuk munt të quhet. De Rada, edhe përsa i përket metrikës, nuk deshi të largohej nga këngët t' ona po-

pullore, të cilat, siç dihet, sidomos këngët toskërishte, në ndërtimin e vargut nuk u përgjigjen rregullave që mësojnë sot përgjithërisht stilistikat. Këto rregulla në realitet nuk janë shqipëtare, po të huaja, dhe me këngët toskënishte nuk kanë të bëjnë fort, sado që vjershërimit shqip i përshtaten shum mirë.

Bisedime të gjata janë bërë në mes të kritikonjësve edhe në se De Rada ësht romantik a po jo. Që De Rada duhet tashmë të klasifikohet në radhën e shkrimtarëvet që i përkasin kësaj shkolle nuk ka dyshim: e mohoi Marchianò-i, po e dëfteu në mënyrë që s' do biseduar më Gualtieri. Dhe me të vërtetë frymëzimi romantik vlon në të gjitha veprat e De Radës. Edhe poeti arbëresh s' dijti t' i shmangej lëvizjes artistike mëndore europjane të shekullit XIX. Po në „*Milosaat*" këjo romantizmë na duket se ësht më tepër e përjashtëme: nuk vete përtej frymëzimit. Poemthe si „*Milosaat*" janë nga ato vepra që dalin jashtë çdo ndarje a katalogëzimi mekanik e materialistik.

d) Nga „Milosaat"

Kangjelji I.

Ljis jettá kishë ndërrúar,
Ui të rii ndë deitit
Kaljthëruar te dit e ree:
Por humbaardh e Anakreontit
Ronej Teemp e moçëme.
Nd' ui një dit vatte te malji
E s' u pruar si kish zakoon.
Vet çë atë s' e thaiti bora,
S' e përgjakku akuli,
Se m' u resht njera çë raa

---

1) *Jetta*, këtu me kuptimin „*bota, dheu, toka*". Me këtë varg poeti do të thotë se kishin kaluar shum shekuj e prandaj bota kish ndëruar lisa; edhe ujërat e detit ishin të tjera nga ato të moçëmet. — 2) *ndë deitit*, në det. — 3) *Kaljthëruar*, kupto: „*jetta kish kaljthëruar*"; italianizmë: „*aveva innazzurrato*" kishte bërë të kaltërt. Po munt të interpretohet edhe kështu: „ui të rii ndë deitit ish kaljthëruar te dit e ree". — *lumbaardh*, pëllumbi, pëllumbi i bardhë. Me këto fjalë nënkuptohet poezija herotike si edhe frymëzimi që i erdhi poetit nga këjo për veprën e tij. — *Anakreonti*, poet lirik grek; ishte nga Theos e jetoi

Tek e bardha shpia imme.
Kuur te dritta dheu me shpii
U sbuljùa je deiti
Si garéa çë delj për siish,
Mua më zëgjoi, tue fiuturúar
Qeljqevet finestërës.
M' u patáksa e ruata jashtin:
Rusht pak skalankuur
Dheut ëën i kiin hjee;
Ljulje ljiu të gapura,
Nd' era i tundën e përzíen,
Nd' at ninulj qeshënjën:
Si attó ljulje qieli:
Ti ruaje e së kultòje
Njé mbuiin njerèzish:

---

gjatë sh. V! p. Kr. — 5) *ronej*, jetonte, rronte. — *Teemp*, për „në Teemp": luginë në Thesalí, në mes të malevet Ossos e Olymp. Nuk kuptohet pse poeti i ka caktuar ketë vënt si banesë pëllumbit t' Anakreontit. — *e moçëme*, shkon me „lumbaardh". — 6) *Nd' ui*, për uj. 7) — *s' u pruar*, nuk u kthye. — 8) *s' e thajti*, s' e thau. — 9) *s' e përgjakku*, nuk e leu në gjak, d. m. th. nuk e vrau. — *akuli*, shigjeta. — 10) *m'*, *më*, përemër epik. — *u resht*, u largua. — *njëra*, gjëra, gjër, deri. — *çë*, që, sa. — 11) *e bardha*, edhe me kuptimin „*e lumja, fatbardha*". — 12-13) Këto dy vargje ndreqi: „Kur u sbuljua te drita dheu me shpí, si edhe deiti". — 14) *garea*, harea, gëzimi. — *siish*, syshë. — 15) *më zëgjoi*,... nënkupto: „lumbardha". — *tue fiuturúar*, duke fluturuar. Vështro këmbimin e *l*-s në *j*. — 16) *finestërës*, dritores. — 17) *m' u pataksa*, këtu me kuptimin „u çova në këmbë me habí, u hodha përpjetë, brofa", po ka edhe kuptimin „u çudita, u habita". — *ruata*, shikova, vështrova — *jashtin*, përjashta. — 18) *skalankuur*, që s' janë pjekur edhe. — 19) *ëën*, t' onë. — *i kiin*, i kishin. — *hjee*, ky varg do të thotë: zbukuronin dhenë t' onë. — 20) *ljiu*, liri. — 21) *nd'*, *ndë*, në se, në qoftë se. — 22) *ninulj*, këtu: lëkundje. — 23) *si atto lulje*..., nënkupto „ishte", prandaj: „si atto ljulje ish qieli". — 24) *së kuljtoje*, s' kujtonje. — *mbuiin*, këtu me kuptimin „*brengë, hall*", prandaj këto dy vargje në gjuhën t' onë i përkëthejmë: „ti shikonje dhe s' të binte nër mënt as një brengë njerëzish (njerëzor)". De Rada e përkëthen „kujdes" it. „cure", po në Piana dei Greci ka edhe kuptimin „*nevojë*". — 26) *Kalëzoret*, gratë që mbledhin kallinjt e grurit n' ara — *dhemát*, duajet, demetat. — 27) *mbain*..., mbanin këngë

Kalëzoret mbë dhemát
Mbain kangjélje. Kaa i gòi
Aghiena ndër t' imme motëra
Kishi' aarrëën ; e mëma imme
Emërin t' im thoi për ndë shpii.
. . . .

Kangjelji II.

Vreshtat iin të verdhulòre ;
Erth kaa malji dhéljpëra
Me të ljodhëta të bíljat,
Porsa paru inë të viélja :
E te ghera çë ndër sheshet
Sqepet dieli si te botta
Ëmma çë këntúan një vale,
Vet Fiokát u m' u hjimissa
E përvéshurëz e ljart
Me kësheen të pieksurith

---

këndonin, — *kangjelje*, këngë. — *kaa*, nga. — *i goí*, i huaji, nënkup. ,,dheu". — 28) *aghiena*, atëherë. — 29) *kishi' arrëën*, kishjam arritur, ardhur. — 30, *thoi*, thoshte. Shum mirë përkëthen Gualtieri : ,,*e riempia la madre del mio nome la casa*".

II. — Me këngën e dytë hyjmë në poemin. Na përshkruhet këtu pjekja e parë e Milosaut me të bijën e Kologresë, pranë kroit të fshatit.

1) *iin*, ishin. — *të verdhulore*, të verdha, pse, natyrisht, nisnin të thaheshin ase ishin tharë. — 2) *dheljpëra...* Gualt. thotë se veçorija e dhelpëravet që gjejnë vrështat të vogla i qe frymzuar ndofta poetit nga Theokriti. — 3) *të ljodhëta*, të lodhura. — 4) *paru*, këtu ,,*kudo*". — 5) *ghera*, ora, koha, hera. — *sqepet*, fshihet. — *botta*, dheu, ajo jetë, jeta tjatër. — *ëmma*, shumës : nënat ; do të thotë se ,,prej sheshevet u fsheh dielli, siç u fshehnë nën dhe nënat". — 8) *Fiokat*, krua pranë Makjës, ku u zhvillua një pjesë e punës që tregohet në këto këngë. — *u*, unë. — *u himissa*, zbrita, shkova. — 9) *e përveshurëz*, me krahët të përveshur, ase më mirë me kuptimin ital. ,,*discinta*". — *e ljart*, e gjatë. — 10) *gësheen*, gërshetin. — *të pieksurith*, të thurur. 11) *jetulëz*, lidhcë. Arbëre-

Ndë një jetulëz të baardh
Ish te kroi një vash : te bali
Një këshiil i kish hjee :
I ljidhur te brezi kaljthër
Skemantilj, i nghit mbë trual.
  Mua saa më ndieti,
Shtuara vasha m' u pruar
Gjiifritur, piono hjee
Me të trëmbur një garee.
  Tr. Vaiz më jep ti një pik uij?
  Va. Saa të duash ti, birë zotti.
  Tr. Kui e bilje jee ti vash?
Mos më jee ti e dheut guaj?
Kuur jesh diaalj e Salonik
Vaitá, vaiza nëng ishin
Ndë katúnd me aqë gadhii.
  Ndë çerët e dhezurës
Vuccën ajo ngrënej.
  Va. Jam e bilje Kologrees.
  Ngrëiti balët e zbuljuar.

---

shat kur janë edhe të pa martuara e kanë zakon të thurin flokët me një lidhcë të bardhë. Passi martohen vënë mbi kokë *kezën.* Marchianò. — 13) ***këshiil***, këtu me kuptimin „*mendim*". Gualt. përkëthen: „...*la sua fronte splendea in un pensier gentile*". — 14) ***kaljthër***, i kaltërt. — 15) ***skemantilj'***, rubë, shami, faculetë. — ***i nghit***, i ngiste. — ***mbë trual***, mbí truall, mbí tokë. — 16) ***më ndieti***, më ndieu, më dëgjoi. — 17) ***shtuara***, me kuptimin „*në këmbë*", it. „*eretta*". — ***m' u pruar***, d. m. th. u këthye nga unë. — 18) ***gjiifritur***, gjí frytur. — ***piono***, plot. — 19) këtë varg ndreqe: „me një garee të trëmbur"; ***trëmbur*** me kuptimin „druajtur", it. „con trepida gioia". — 20) ***zotti***, zotnije. — 21) ***Salonik***, në Selanik. Selaniku, ku poeti shtie se kinse Milosau kish kaluar ca kohë të djalërisë së tij, ishte në kohën e mesëme një qendër kulturore me rëndësi për gjithë Lindjen. — 22) ***nëng***, nuk. — 23) ***gadhii***, dhelka, naze, laika. — 24) ***çerët***, fytyrët. — ***e dhezurës***, e ndezur, e skuqur nga turpi. — 25) ***vuccën***, bucelën. — ***ngrënej***, ngrinte. — 26) ***e bilje Kologrees***, De Rada nuk na i thotë kurr emërin e vërtetë të vajzës, po e thërret gjithënjë kështu. Vetëm një herë e quan „Rin". — 27) ***vìreshin***, vare-

Na vejím assai uudh :
Gjëmbat çë virëshin tek udha
Së gkërvishtëtin at kopílje ;
Me loort të përgjakkura
Kaa balt ú më ja réshta.
Dii buuz të qeeshëme
Njii gherie të baardh
At mbrëma dukëshim.

Kangjeli IV.

Ish e diela menát
E i birí zonjës madhe
Ngjittei tek e búkura
Të m' i ljipën një pik ui
Se ish ett' i diegkurith.
Vetëm e çioi ndë vatërët
Çë kësheen më pieksënej.
Atta dughëshin e s' e thoshin
Vaiza me buzën mbë gkaz :
Ç' ësht ę ikën si airi ?
Tr. Më pressën ndëë roljiet.
Vai. Dii mool t' ardhura
Qëntro, u tij ti rúata.

---

shin. — 28) *kopilje*, vajzë. — 29) *loort*, llërët. — 30-31) Këto vargje ndreqi : „at mbrëma dukeshim dii buuz të qeeshëme njii gherie të baardh“ (të lumtur). Gualt. përkëthen : „Noi, quella sera, sembravam due bocche — sorridenti a un' istessa ora beata“.

IV. — Në këto këngë dhe n' ato që vijojnë poeti na dëften se si piqen herë pas here dy të dashurit, bisedimet e tyre të thjeshta, psherëtimat e tyre... Vër re thjeshtësinë, naivitetin dhe fuqinë skulpturore të këtyre këngëve.

1) *menát*, mëngjes. — 2) *i biri...*, Milosau. — 3) *e bukura*, e bija e Kologresë. 4) — *të m' i ljipën*, t'i lipte, t'i kërkonte. — 5) *ett' i diegkurith*, i djegur etjes. — 6) *çioi*, e gjeti. 8) *atta dughëshin...*, ata dukeshin, po nuk i a thoshin këtë dashuri njëri tjatërit. — 10) *ç' ësht e ikën*, përse ikën. -- *si airi*,

Me një door, ngrëiturith
Mbanej mbii veshín e baardh
Ljesht e sai të shpieksurit ;
Kali jettërën te gjiri
E më golq molëzit,
Më ja e vun ndë doriet
Ndë çerët e dhezurëz.
Thomnie ju të dashurit
Nd' ëmbëlj aqë të púthurit.

Kangjelji XVI.

Airi çë ndréqi moon
Friti kaa deiti :
Te rahji Ljumbárdhavet
Gool më gapi derien,
Daal më muljvi çerien
E më réshti gjumëthin.
Mi. Ruash e ftohëtëza voree,
Se më zëgjon ti më garepsën :
Maria ndër dêgkëzit
Nd' i qikaar i kaa hjee :

---

si era. – 11) *më pressën*, nënëkupto : shokët. — *roljiet*, lojë fort e përhapur nër italo-shqipëtarët, që lozet me një rrotë dërrase (it. „disco"). Për tê thotë De Rada : „Fra gli altri avanzi dell' antico vivere, restano nelle colonie albanesi d' Italia gli esercizi ginnastici a cui si fortifica e diviene bella la gioventú : e fra tutti primo e usitatissimo è il giuoco del disco". – 12) *t' ardhura*, De Rada përkëthen „forestieri" „të ardhura nga jashtë", po Gualt. „mature" „të pjekura". — *qëntro*, qëndro ; vete përpara vargut „*dii mool...*" – *mbanej*, mbante. — 16) *të shpieksurit*, jo të pieksur, të çthurur. — 17) *kali*, futi, shtyri. — 18) *golq*, hoqi, nxori. — 21) *të dashurit*, o dashnorë, it. „innamorati". — 22) *nd' ëmbël*, në ësht aqë i ëmbël.

XVI. — Në sa gjendet larg atdheut, Milosaut i çpifin fjalë të këqija për sjelljen e vashës.

1) *Airi*, era. — 3) *rahji i Ljumbardhavet*, kështu e quan poeti këtë vënt „collina delle colombe". — 4) *gool*, hollë, lehtë. — 5) *më mbuljoi çerien*, më freskoi fytyrën. — 9) *Maria*, koçimarja. — 10) *nd' i qikaar*, në qoftë se i për-

Ti së ljevé ndë dhee të guaj.
Vo. Kuur ljevá të parëzën
Dushku u túnd te Pokfili.
Mi. Të biljën e Kologrees,
Mos ti pee nd' atta përrénje?
Vo. Garepsun dittá me diel
Të shëndosh e të sëmuur.
Te ndîn e qitharies
Me të bardhëthin kopílj
Ljuanej Milórdeza:
Shtrushulonej coghëza
Frighej gjiri e piriej
E m' i shprishej shtekëthi
E mi fjissin siizit.
Mi. Mba tuttié bushtrá voree
Se më ngriin eshtërat.

Kangjelji XX.

Gjiettat iin të mbiitura,
Dieli i sqepur rêshit,
Paa oréks zemër' e gqrâvet,
Kuur u roth një shkuntuljiim.
Kiin ulínjët të múndurë

---

kul. Këto dy vargje (9-10) pakëz t' errëta De Rada i përkëthen: ,,la corbezzola se piega i ramoscelli accresce lor vezzo". — 11) *së ljeve*, nuk linde. — 12) *të parëzën*, herën e parë. — 13) *Pokfili*, krua që gjendet në fshatin e poetit, gërmuar pranë një bregu dhe e hijezuar prej pemësh. March. Me këtë varg De Rada do të na thotë se ,,vorea" (erë e veriut) ishte nga vëndi i Milosaut. — 16) *Garepsur*, nënkup. ,,kish" ase ,,ka". Këto dy vargje ndreqi (16-17): ,,ditta me diel garepsun të shëndosh e të sëmuur". — 18) *Te ndin*, në tingëllimet, it. ,,al suono", krh. kalabrishten ,,*ntinnare*" ,,risonare, squillare". — 19) *kòpilj*, djalë. — 20) *Milòrdeza*, madhështorja, De Rada ,,altera". — 21) *shtrushulonej*, bënte zhurmë, it. ,,strusciare". — *coghëza*, petku, De Rada ,,peplo". — 22) *piriej*, këthehej, po me këtë fjalë De Rada ka dashur të përkëthejë it. ,,torceasi". — 23) *shtekëthi*, viza, e ndara, e flokëve. — 24) *e mi fjissin siizit*, e i flisnin sytë nga gëzimi. — 25) *mba tuttié*, shko tutje, shporru. — *bushtra*, mizore, e pamëshirëshme.

XX. — Papritur një tërmet i math prish Shkodrën. Prishen kështu edhe klasët shoqërore, prandaj dy të rinjt më në funt martohen.

1) *gjiettat*, gjethet. — *të mbiitura*, të mpira, d. m. th. që nuk lëvisnin

Shpiit të savurrosura
Ljëën njeriin të vool e dheut.
Ljeghëmístin frúshkuljit.
Gjínties çë e skotíssur
Silej e përpíqej mb' uudh,
Nd' at nat tę paabés,
Më porséksa vashëzën
At més golëzën
At kriekështënjëzën.
Si më shíghet piot ampnii
Iil çë zëmërat oréksën
Iil çë thot „më mani drittën
„Jetta së sholjâriet"
Bardhulore u më e pee.
Vai. I bardhë biirë buljari
Se ti më mer ti kú më qeel ?
Nëng iam u zonj e mádhe
Si bushtrá ë jot kunát.
Tr. Skutari së thúghiet
Më katúnd : për tei maalj
Priftëra jaan të na martonjën,
U me ákul e prameent :
Ti më ruan kaljíven
E më ljaan të véshurat,
Vét për mua të véttëmith

---

më. — 2) *i sqépur*, i fshehur. — *rêshit*, prej reve. — 3) *oréks*, këtu me kuptimin : dëshirë, andje. — 4) *shkuntuljiim*, lëkundje, tërmet. — *kiin*, shkon me ,,*ljëën*" : ,,kiin ljëën njerin..." — 6) *të savurrosura*, të rrëxuara. — 7) *vool*, „impetus irae", zëmrim. — 8) *ljéghëmistin*, ulurijnë. — 9) *skotissur*, e nxirë, e helmuar. — 12) *më porseksa*, m' u paraqit, ase këtu ,,diktova". — 15) *ampnii*, paqe, qetësi. — 16) *çë zemërat oreksën*, De Rada përkëthen ,,sollevare i cuori", d. m. th. u jep guxim zëmrave. — 18) *së shòljâriet*, nuk bije, nuk shkatërrohet. — 19) *e pee*, e pash. — 23) *ë*, ësht ; ndreq : ,,si ë bushtra jot kunát", — 27) *u me akul...*, kupto : unë kam për të mbajtur (ushqyer) me shigjetë e me parmëndë. — 28) *kaljívien*, kaliben, kasol'en. — *vét*, vetëm ; ,,sola per me solo".

Kangjelji XXII.

Uljem por së dua të fiëë :
Mos mbuliij ti derien,
Të ghiinj êr e déitit
Të më ftoghinj si më ftoghën
Vashazit mbë të skaljissur :
E diéli i paa ftés
Çë më ghiin ndër vatërat,
Ëmmavet i parastén,
Moon çë shkoi je m' i kuljton.
Vaizën me shtaan e bukkur
Të dashúr u më e patta,
Dialj ju ljé çë assai i gjét.
Me garee ndër këtto shpii
Ajo tundën diépëthin,
Breez, e mua më tërjoríssën.
Uljem por së dua të fiëë :
Si drittá ndë qielit
Sîu ndë kurmit e njerîut,
Kuur e shé paa noerii
Ajo shpiis i kaa hjee.
Dit e mia të fanëmira,
Mbii dhee të kuljtoneni
Si kta réhje e ljumërat
Çë të moçëm fanarossen
Para attîre çë të ljéghen.
Uljem po së dua të fiëë.

XX.II — 1) *të fiëë*, të fle. — 5) *mbë të skaljissur*, në të prashitur. — 6) *e diéli*, nënkupto : „e të ghiinj dieli..." — 8) *i parastén*, u rri pranë. — 9) *je*, e ; vete përpara fjalës „moon". — *me shtaan e bukkur*, që ka trupin të bukur. — 12) — *ju ljé*, i lindi. — *i gjét*, i ngjan, i shëmbllen. — 13) *këtto shpii*, me kuptimin „oda, dhoma". — 15) *e*, vete përpara „breez". — *më tërjorissën*, më qëndis. 18) *sîu ndë kurmit...*, po si syri në trup... — 19) *paa noerii*, pa mendime. — 24) *fauarossen*, duken, paraqiten. 25) *para attîre*, përpara syve të atyre. — *çë të ljéghen*, që të lindin. De Rada „come la presenza di queste colline e di questi fiumi che antichi saran veduti da coloro che nasceranno".

Kangjelji XXV.

Dii dit miégqul e shii
Verën doin të na réshtëjin,
Tek e katëra ndër ljëmënjet
Shtrùan dhematë të díeli
U vettëm i ghéljëmúar
Vaita te Shurëza
Uljem te bith e ulîrit.
Kalamees vin tue larissur
Një lojee çiáulas
Saa shtuâra u m' u patàksa :
Te difiza takënej
Topëra e gqrâvet,
Iin këntímme vréshtavet
Dukej jetta e ljeer menátet.
O e bukkúr motëra imme
Jaan rúsh te varri ít ?
Vent të búkkur ndë të dhaan
Ti s' uljé e fanëmiir,
Se së rii mosse me mua.
Ndë pastâi kurmë bugùa
Ndër të véshurat i raar
Ajo ësht e së dii këto fiaalj,
Për oréks çë vuu te ditta,
Më ruatit me ljipisii
Zotti dheravet e shuum,
Kët gjeel të më këpuunj ;
Të më dálj kaa door e tiij.

XXV. — Po ditët e zeza nuk vonojnë as për Milosaun : i vdes i biri, i vdes edhe e shoqeja ! Çudi ësht për të bërë se sa fort i ngjan edhe këjo pjesë e dytë epoemit, *jo e jetuar*, jetës së De Radës ! Si kur t'a kishte parandierë t'arthëmen poeti.

4) *te díeli*, që të thaheshin. — *kalamees*, prej kashtës së grurit, prej amullës së grurit. — *tue larissur*, duke bërtitur. — 9, *një lojee çiáulas*, një tufë sorrash. — 11) *te difiza*, këtu „parku, pylli", krs. kalabrishten „*difisa*": „terreno da pascolo". — *takënej*, tingëllonte. — 12) *topëra*, spata. — 13) *in*, ishin. — *këntimme*, këngë. — 16) *jaan rúsh*, a ka rrush. — 18) *s' uljé*,

Kangjelji XXX.

Friti eer e máljevet
E rëzoi hjeen e ljissit:
Gjakku im te ljumi Vodhit,
Gapni spërvierin
Ushtërtoor, u të më shogh
Skutarin e t' imme mòtër
Te finestëra kuntrêlja.
Mëë attié së zëgjoniem
Ljúljevet çë tundën era
Si suvaalj e pa fërnúam.
Mbljidhen shokët mbrëmanet
Ndë katúnd ndë vatërët,
U mi ljee si ëndërrëz.
S' ëë mëë e Milosaat.

---

e) Nga „Uno Specchio di Umano Transito" *)

Libri i parë

Kent'k e Serafinës

Art ndë veer të vitit 1441

Vash u rrìttësha ghadhiâre
tek vatër e prìndëvet:
si një deegk e àrdhurëz
hjêsore rrìttiet
te kopshté i zottit màdh.

---

s'ungje. — 20-22) ndreq: „ndë ajo ësht pëstâi kurmë bugùa i raar ndë të véshurat". — *kurmë bugùa*, trup i bërë pluhur. — *bugùa*, pluhur. — *i raar*, i rënë. — *ndë të veshurat*, në petkat. — *së dii*, nukë ndjen. — 23-36) ndreq: „Zotti dheravet e shuum, për oréks që vuu te ditta, më ruatit me ljipisii (e) të më këpuunj ket gjeel .." — *Zotti dheravet...*, Zoti i shum botëve. — *për oréks.* këtu: për atë gëzim; De Rada „festività". — *çu vuu te ditta*, kupto: që i ka dhënë ditës. — *më ruatit me ljipisii*, më shikoftë me mëshirë, pastë mëshirë për mua. — *të më këpuunj*, të më këputënj.

XXX. — Larg atdheut, Milosau, në fushë të luftës, u jep funt ditëve të tija. 2) *rëzoi hjeen*, rrëzoi gjethet e lisit, e bashkë me 'to çduku edhe hijen e tij. — 3) *Vodhit*, lum që kinse si pas poetit kalon pranë Shkodrës. — 4) *spërvierin*, tëndën. — *kuntrélja*, kundrejt meje. — *ljuljevet...*, tek lulet, nër lulet, të cilat i tund era. — 10) *e pa fërnúam*, e pasosur. — 13) *u mi ljee...*, unë i lash, u çduka, si ëndërr.

*) Titulli i poemit deradian munt të përkthehet fjalë për fjalë: „*Një pas-*

Vash u rritta e zilísur
nkâ gjitòne e nkâ të ghuaja.
Ndo gjègjia mbî kjeramidhet
brèshër e shii çë çiokulnej,
ndo dërsîja e prëitur
kuntrèlja të kòrravet,
më gkëzonnej zëmëra :
Ashtu diaalj kë sgjuan ndë nàt
mê vattur ndë dètit,
shégh kâ kjèrria e s' ëmes
ìljëzit si ieegh ljineer
sipër çiukat ê ljisvet ;
e dúket ndë Jetë tuttième
prèi dittes me dhàskaljin.
— Ç' ësht (pien) ajò e vèrdhur
si sheshë çë tundiet ?
— Eë sëvâlja embiúar ghënes"
Fanëmira heer e diâljit !
Ndër shtattëmbëdhiet viet
vàita tek më ljâjin shkjëntet

---

qyrë kalimi njerëzor" ; dhe me të vërtetë këtë donte të dëftente poeti : si kalon jeta e një njeriu.

Serafina, „e bija e Andrea Topisë, Dukë i Artës, në Himarë", kallxon si e njohu Bosdar Stresin.

1) *u rrìttèsha*, unë rritëshjam. — 3) *si...*, ashtu si rritet një degë... — *e ardhurëz*, e ardhùr së jashtëmi, De Rada „peregrina". — 4) *hjêsore*, plot hije. — 5) *te kopshté*, te kopështi. — 6) *e zilìsur*, e pasur cmirë, zili. — 8) *kjeramìdhet*, tjegullat. — 9) *çiokulnej*, këtu : të thyhej, të përplasej, it. „frangere". — 12) *më gkëzonnej zëmëra*, d. m. th. si në dimër kur lëshohej breshëri e shiu mbí tjegullat, si në verë kur dërsinja e prëjtur drejtë të korruravet, ishja e gëzuar. — 13) *kë*, të cilin. — *sgjuan nde natë*, zgjuanë natën. — 14) *mê vattur*, për të shkuar në det. — 15) *kâ kjèrria*, lart nga qerria, ku gjendet bashkë me t' ëmën. — 16) *sí leegh*, si turmë, morí, „multitudo". — *ljineer*, dritash, kandilash. — 17) *sipër çiukat*, sipër majavet të lisave. — 18) *nde jetë tuttième...*, e i duket të jetë në një jetë të largët nga dita që rrinte me „dhaskaljin" (mësonjësin). — 20) *pien*, pyet. — *ajo e vèrdhur*, ajo gjë e verdhë. — 21) *si şkeshë çë tundiet*, që duket si një shesh që lëviz. — 22) *ëe sëvâlja*, ësht vala e detit. — *embiùar*, e mbushur, e ndriçuar prej hënës. — 23) *fanëmira heer*, orë e lumtur ajo e djalit ! — 24) *ndër shtattëmbëdhiet viet*, kur ishjam shtatëmbëdhjetë vjeçe. — 25) *ljajin*, lanjin. — *shkjëntet*, rrobat, lëveret.

mua kàtër noree kriatte.
Ndënja u ljàrt, e vettëme,
te hjeet ku mburon Luri
krua kuntrêlja dêtit:
Vrêja e shtuara nën mèrten,
mbâlj kë ná tèrej i kàljthër
skemantìlj me të bardhëu shkjépe,
gjettur ûdhes bardhulore.
　Atti mbî káljìn e baardh
m' érdh Bòsdari Strèsënjet
mosse armìkj të zottit tat;
po vett' ai sâ zëes imme
ì ljevduar nkâ atto krìatte.
Bosdari : Zoonj Vash, kush nd' át mérte
skemantiilj, i raar mêje,
ndëiti?
Serafina: Atto kriatte e ljàitur
bughoit ûdhes ku e çiúan".
U ndëita t' e hiljkjia
kâ fjettat, po më shkáu
prei këshettëthit aprappa
skjepi kë vét kèsh terjorissur.
Ser. Za e ëm t' imin"
Bosd. Mos m' iìj
vash, nkamatte e kjëtiij tharossi
të gjêlës".

---

26) *noree*, me kuptimin „të urta, të matura". — *kriatte*, shërbëtore, it. „ancelle". — *nën merten*, nënë mirtin. — 31) *mbàlj kë*, mbi të cilin, mbi degat e të cilit. — *terej*, thahej. — 32) *shkjepe*, me një shqiponjë të bardhë në mest. — 33) *gjettur*, të cilën rubë e kishin gjetur udhës. — 34) *atti*, aty. — 35) *Bòsdari Strèsënjet*, „i biri i Gjelës, e motra e Skëndërbeut dhe e bija e Gjon Kastriotit, princ i Krujës. — 36) *mosse armìkj*, Stresënjt kishin qënë gjithënjë armiq të t'et Serafinës. — 37) *po vett' ai*, ndreq: „po ai vett sâ i ljevdúar zëes imme nkâ attò krìatte". — *sâ*, sa e sa herë. — *zëes*, shpirtit. — 40) *i raar meje*, që më ka rënë mua. — 41) *ndëiti*, ndehu. — *ljàitur*, passi e lanë. — 42) *bughòit*, nga pluhuri. — 43) *u ndëita*, u zgjata, u shtrita. — *t' e hiljkjia*, t' a hiqnja. 46) *kë*, të cilin. — *tërjorissur*, qëndisur. — 47) *Xa e ëm t' imin*, na t' ëndin e jepmë t' imin. — 48-49) *mos m' iìj nkamatte*, mos jì koprace me mua, mos m'a kurcè. — *tharossi*, thesari.

Ser. Po na 'së dîmi
të ngkrèghëmi paìdhe.
Bosd. Thaan
dhe se mua si një vëlaa
e i të shpiis ku ljeve, as dii,
vash, ti të më keesh kurrài.
Vet së kam prind, jo shòk;
t'assài çë më sossën shoke,
hjees e vettësatte, ljém
këtë si një ahjte të vêrës".
Seraf. Ecc".
Drodhi e dorrokopsi kâljin;
Sâ gjìth ânëshit u e ljuum!
Arat çë kiin sieelj buken,
ljûmet frushul drêhjiim,
zogjëtë ê cincërrat
çë vinjën e veen me verën,
monu fanarëshin te jetta
mêje gjíth e hap't e ljéfter.

NAMIK RESSULI

---

51) *së dımi*, nukë dimë. — 52) *të ngkrèghëmi*, të ngrehimë. – *paidhe*, kurthë. — 53-54) *thaan dhe*, më thanë edhe. — 55) *as dii...*, se ti, vashë, nuk di të më keshë, të më mbashë, si një vëlla... — 58-60) këto vargje ndreqi: „t' assai hjees e vettësatte, çë më sossën shoke, ljem këtë si...". — *t' assai hjees*, t' asaj bukurisë së vetes t'ënde. — *çë më sossën shòke*, që më mbeti e vetëme shoqe në këtë jetë. — *ljem këtë*, lëm këtë „skjep", velo. — *si një ahjte*, që ësht si një erë e lehtë e verës. — 61) *dorrokopsí*, çpoi. — 62) *sâ gjìth ânëshit...*, sa të lumtur e ndienja veten nga të gjitha anët. — 64) *ljûmet*, lumenjtë. — *frushul*, zhurmë e lehtë. — *drêhiim*, De Rada „traenti", që tërhiqnin tatposhtë zhurmën e tyre. — 65) *cincërrat*, gjinkallat. — 67) *monu*, këtu „me zi" it. „appena". — *fanarëshin*, më paraqitëshin. — 68) *mêje gjíth e hap't...*, e cila jetë mua më paraqitej e hapur e e lirë nga çdo anë.

11. — ANTON SANTORI (1819-1894)

a) Jetëshkrimi

At Anton Santori lindi në koloninë arbëreshe të Sh. Katerinës, në krahinë të Cosenza-s, më 16 të Shtatorit 1819. Prifti i fshatit don Mikel Pizzi qe ai që i dha mësimet fillestare të shkrimit e të këndimit, po djali i ri dëftente një zgjuarësí të veçantë e një dell të fortë për vjershë. Si pemë e parë e kësaj prirjeje pa dritën në Napul, më 1839, kur auktori s'i kish mbushur edhe të njëzet vjetët, një përmbledhje e vogël vjershash me titullin „*Canzoniere albanese*". Pas kësaj veprës së parë i u përvesh një romani „të gjerë e gjenial" siç thotë De Rada: „*Sofia Cominiate*". Më 1842 hyri në kuvëndin e Reformatëvet të S. Marco Argentano, „ku pasuroi mëndjen me shum njohuri e dituri të gjërë". Aty nuk vonoi të çmohej e të nderohej prej Urdhërit të Reformës, i cili e ngarkoi me shum detyra të rëndësishme: më parë mjeshtër të të rinjve, pastaj „*definitor*", kustod, etj. Më 1858 e ngarkoi edhe të themelonte një kuvënd në Lattaracco, ku Santori me dy punëtorë dhe me tetë a nëntë „dukate", pas dy vjetëve ngriti një ndërtesë të bukur si pas një vizatimi të vet. Po pas kryengritjes së vitit 1860, i mërzitur nga zilija e shokëvet e la për gjysëm punën e filluar e u këthye në Sh. Katerinë, ku jetoi në vobësi të madhe duke bërë mësime në shkollën e fshatit e duke bërë disa vegje tërë tre a katër boshte, të çpikur prej tij, që i shiste për pak dheçe. Më vonë, i thirrur prej peshkopit Parlatore, drejtoi për nentëmbëdhjetë vjetë rresht famullinë e Sh. Jakut (komunë e Cerzeto-s, Cosenza), ku vdiq më 6 të Shtatorit 1894, në moshën 75 vjeç.

b) Veprat

Si Arbëreshët më të mirë, si De Rada, Dara e Schirò-i me shokë, edhe Santori u përpoq me zell të math për lërimin e begatimin e gjuhës amtare. Përveç përmbledhjes së vogël në vjersha **„Canzoniere albanese"**, që, si thamë më lart, pa dri-

tën në Napul më 1839, ai botoi një këngë me titullin **„vale garees madhe“** (Canto della gioia grande) në fletën e parë të De Radës *„L' Albanese d' Italia“*, **„Il prigioriero politico“**, **„Il Cristiano santificato“**, **„La Figlia maledetta“** roman në gjuhën italishte, e dramën **Emira.** Mbetën pa u shtypur tragjedia **Geroboamo,** një përmbledhje satyrash e këngësh popullore dhe një gramatikë në vjershë.

c) Analizë e vepravet

Vale garees madhe qe shkruar me rasjen e kushtitutës së vitit 1848, që u dha në mbretërinë e Dy Siqilive. „Eshtë një hymn kushtuar lirisë — shkruan Dora D' Istria, si kënga e Kontit Solomos, që Fauriel-i përhapi në botën perëndimore. Duke i dhënë funt këngës auktori kujton vuajtjet e ditët e zeza t' atdheut e uron që të harrohet e kaluara dhe që një falje e gjërë të shuajë kujtimet e grindjevet të më parëshme“.

1. — **Il Prigioniero politico** *(I burgosuri politik)* na dëften historinë e fatkeqësive të një familjeje, të ndjekur nga armiqtë e saj për arësye partije. Një plak, i burgosur politik prej shum vjetësh, me rasën e Kushtitutës, lirohet nga burgu e kthehet në vëndin e vet. Kur i afrohet fshatit, plot mall e dashuri për të përqafuar njerëzit që ka lënë kaq vjetë më parë, dëgjon jonet e përmallëshme të një kënge. Kënga ësht shqipe, përbërë nga tetë strofa gjashtëvargjesh tetërrokëshe. Pas kësaj i a fillon prap një këngë tjatër shqipe, në të cilën poeti, si në të parën, na përshkruan, me zemër të prekur e të mallëngjyer, shkena të natyrës. Si merr funt këjo këngë e dytë, plaku nis të kujtojë një nga një ditët e djalërisë së vet, kur një këngë e tretë edhe këjo shqipe, e më patetike e më e therëshme se të parat, i a fillon poeti e vajton prindët e shuar, pa të cilët e mjerë dhe e errët i duket jeta. Gjatë udhës i burgosuri ndesh në një fshatar. Nga fjalët që shkëmbejnë, ky njeh në plakun të jatin e prandaj at e bir bienë në krahët e njëri tjatërit. Po të burgosurit të gjorë i bie të fikët, e i biri e sjell gjër në shtëpi mbi krahë. Kur vjen në vehte, sheh pranë të birin, të motrën

dhe dy nipa ; për të shoqen e për të bijën merr vesh se kishin vdekur të helmuara nga armiqt e fisit të tij. I dëftejnë edhe se si kish shpëtuar për mrekulli i biri tjatër Marini. Po armiqtë nuk ishin shëmbur. Në sa i ati prëhej, Marini del mbí një breg e ulet pranë një shkrepi duke kënduar një këngë tjatër shqipe, në të cilën shpreh urrejtjen e mërinë për armiqtë e bushtërt. Në këtë kohë e sipër i a mërrin e kushërira dhe e dashura e tij Lavinja, t' a lajmërojë se e kërkon i ati. Po tek çajnë pyllin zbashku, katër armiqë i u vërsulen e i gjuajnë në pushkë. Për çudi asnjë s' plagoset e Marini u turret prapa duke vrarë dy prej tyre. Pas kësaj ngjarjeje armiqtë bëhen më të rrepët dhe Marini betohet të marrë shpagën. Vjen pastaj një këngë tjatër shqipe që Marini këndon prap nga maja e atij shkrepi. Esht një këngë që i drejtohet një vajze, e cila s' digjon t' i përgjegjet dashurisë së trimit. Poemthi merr funt me vdekjen e plakut, në sa shtëpija ësht e rrethuar prej armiqëve, dhe me çdukjen e Marinit, i cili largohet nga fshati për mos të derdhur më gjak, si pas premtimit që i kish bërë t' et më parë se të vdiste.

E tërë këjo vepër ësht shkruar në vargje të zgjidhura italishte dhe ndahet në dy pjesë. Vetëm këngët janë shqipe.

2. Chrështeu i Shëjtëruorë *(Il Cristiano Santificato)*, si e thotë vetë titulli, ësht një vepër fetare 230 faqesh, shkruar për përdorim të fetarëve arbëreshë. Përmbleth lutje e këngë liturgjike në prozë e në vjershë, të përkthyera nga latinishtja e italishtja, si edhe nga djalekti i vëndit. Vjen pastaj një shkurtore e Katekizmit e së fundi *Ligjerata* e *Shkallës IV* nxjerrë nga vepra e Imzot P. Bogdanit shkruar me alfabetin e Santorit. Kanë një farë interesi gjuhësor *„Shënime gramatikore të nevojëshme për leximin e mirë të këtij libërthi"* *(Cenni grammaticali...)*, si edhe alfabeti i përshkruar në 'të, alfabet që dallohet nga të gjithë tjerët e Italo-Shqipëtarëve.

3. Emira ka një rëndësi të veçantë për ne pse ësht e para dramë e shkruar në gjuhën t' onë. Si themel të veprimtarisë Santori ka marrë tmerrin e kusarisë kalabreze dhe shtypjen e kësaj nga ana e Fumelit. Akti i parë hapet me dy vajzat, *Kalina* dhe *Emira*, protagonistja e dramës, pranë krojt të fsha-

tit, e para t' u japë të pijnë dhënëve të saja dhe e dyta të mbushë uj. Gjatë kthimit qëndrojnë rrugës e dëgjojnë këngët e vallet e djemëvet, po n' atë e sipër i a mrrin *Ljegjëresa*, e ëma e Kalinës, e cila i qerton djemtë e vajzat që e shkojnë kohën në dëfrim e valle, në sa kusarët vjedhin e rrjepin nga të katër anët e Fumel-i shkon në plumb pa një pa dy të gjith ata për të cilët ka më të vogëlin dyshim. Vjen edhe e ëma e Emirës *Ljipisia* që përsërit sa kish thënë e para, dhe më pas duket plaku *Mottëmadhi* që flet për Fumel-in dhe dëften se si e vuadhën dhe e rrahën edhe atë.

Aktin e dytë e hap një djalog në mes të *Kalonjerit*, barí derrash e prîs i kusarëvet, dhe *Kalinës*, bareshë dhënësh. Kalonjeri i çfaq dashurinë e vet Kalinës, po këjo nuk e pranon, pse do të birin e *Kronoit*, *Mirianin*, të cilin e donte edhe Emira. Njëkohësisht edhe Kalonjerit, sado që bën sikur e do Kalinën, i digjet zëmra për Emirën, kështu që këjo e funtmja duhet edhe prej të parit edhe prej Mirianit. Zilija e Kalonjerit për Emirën dhe e Kalinës për Mirianin i shtyn këta dy të merren vesh në mes të tyre në dëm t' Emirës e të Mirianit e përcakton zhvillimin e dramës. Më parë Kalonjeri ngut kusarët të djegin shtëpinë e Mirianit e t' i presin bagëtinë, pastaj rrëmben Emirën e kërkon t' a dhunojë. Po *Albenzi*, i vëllaj i Mirianit, që i a mrrinë befas, i heq një dru të shëndoshë sa e lë pa frymë për tokë dhe çliron vajzën. Ngrihet atëherë Kalonjeri e i padit tek Fumel-i Mirianin e t' an e tij Kronoin si vrasësa e kusarë. Prandaj këta kapen e hidhen në burg. Në këtë kohë e sipër edhe Kalonjeri vritet nga vetë kusarët e vërtetë. Pas disa shkenave të tjera, në të cilat përshkruhet pikëllimi i *Calomerës*, s' ëmës së Miriamit e i të gjithë gjërinjve të këtij e t' Emirës, më në funt Fumeli e kupton si qëndron puna dhe i çliron Kronoin e të birin, passi e shkon në plumb kusarin *Ferdlnand Cacarazzo* bashkë me shokët e tij.

Ma aktin e pestë merr funt drama : Emira martohet me Mirianln, Kalina, e penduar, fejohet me Albenzin dhe plaku Mottëmadhi breth për ndihmë në katundet e Arbëreshëvet, e passi mbleth dele, desh e dhi gjër sa i bëri plot njëqind, i a bijë fëmijës së Kronoit.

Në përshkrimin e dasmës s' Emirës auktori ka riprodhuar këngët e ceremonitë e zakonshme të Shqipëtarëvet.

ç) Vlera e vepravet

Nga veprat shqipe të Santorit, prodhimi i tij poetik vlen të studjohet me vërejtjen më të madhe. Mjerisht ekzemplaret e këtyre veprave janë shum të rralla sot.

Marchianó-i e gjykonte Santorin si shpirt „*vario e multiforme*", i cili duke qënë murg, mekanik, mësues shkolle, romancjer, dramaturg, poet lirik, fetar e profan, mëndje e fortë, gadi i pa mësuar, arrin, me sendërgjimet e veta, në lartësinë e poetëve të mëdhenj me aq energji shprehjeje dhe me aqë ndryshmeni lëvizjesh e ritmesh, sa që na pikëllon pa masë humbja e disave nga veprat e tija.

Po ndoshta Marchianó-i, si në shum mendime të tjera, edhe në këtë e teproi. Santori pa arritur në shkallën e poetëve të mëdhenj — madje munt të themi pa të ndrojtur se ësht shum larg këtyre —, ka ca vjersha e ca vargje shqipe, që për thjeshtësinë e freshkësinë e tyre, për ndjenjat e shprehura e për mirësinë e mendimevet na pëlqejnë edhe sot. Dashurija e familjes fshatarake e të përvuajtur, përshkrimi i bukurivet të natyrës, këngët e zogjve dhe drita e venitur e hënës, rrëmbimi idilik i ndonjë dashurije së mitur lindur pranë kroit a në hapësirën e fushavet, pranë dhënëve a thijve, janë notat karakteristike të lyrës së tij. As që i mungon kësaj lire nota humoristike. Edhe në këtë fazë të poezisë Santori ësht i pari që shkruan. Po meriton çdo çmim drama e tij *Emira*, e para dramë shqipëtare, jo vetëm nga gjuha po edhe nga fryma, nga ndjenjat, nga përshkrimet, nga zakonet. Santori në vënt që t' a kërkonte frymëzimin e vet në kryeveprat e letërsís italjane më të re, n' ato të Alfierit me shokë, e kërkoi edhe e gjeti përkundër në modelet e Theokritit e të Tasso.s, pse sigurisht e kish kuptuar se këto i përshtateshin më mirë ambjentit të tij, ambjentit shqipëtar, që ësht sidomos ambjent fshatarak, bujqësor. E këtë herë Marchianó-i ka plot arësye kur na thotë se Santori pas

shum shekujsh na bije ndër mënt e na ngjall artin grek imitonjës të përsosur të natyrës së vërtetë e të mendimit që jeton në 'të. Këjo paraqitje e jetës së fshatit ka më tepër shpirt dhe frymë më t' ëmbël nga idylet e Theokritit e nga eglogat e Vrgjilit". Me një fjalë Santori, thomi na që nuk shkojmë aqë larg sa t' a barasojmë veprën e tij me atë të dy poetëve të pavdekur, tërthorazi këngëve t' ona popullore, u përpoq për atë që u përpoqën dhe që i a arritën të kryejnë n' epikën e në lirikën De Rada, Dara e Schiró-i me shokë.

Vepra tjatër „*Chrështeu i Shëjtëruarë*" si vepër fetare s' ka asnjë vlerë artistike. Romani „*La Figlia maledetta*" ësht shkruar italisht e prandaj nuk i përket këtij prodhimi. Sa për tragjedinë „*Geroboamo*" s' di gjë njeri, as vetë Straticó-i (1896) s' kish pasur mundësi t' a gjente.

NAMIK RESSULI

d) Nga shkrimet e Santorit

1) Fluromë *) *Hënzës*

Hëën e buccur, Szoonj ndë kjel
që ndë nat na bën për Diel,
Ti ndë szëmër na dërgcon
një garee çë na gchëzon
Me at drit ergjentulore
chekj j' ebutt' e ëmbëljore
siit na merr, szenn na nchet
e 's ljodhën viett' e vièt:
te të shoghëmi prisandài
na 's ndendemi currài.
rughemi të di me maal,
dhià si vasha ndë spekjaal.

Hënë e bukur, Zonj ndë qiell
që ndë nat' na bën për diell ;
ti ndë zemër na dërgon
një haré që na gëzon.
Me at drit ergjëntullore
keq j' e but' e ëmbëlore
sít na merr, zën' na nget
e së lodhen vjet e vjet:
të të shohëmi prisandaj
na s' ndèndemi kurraj.
Ruhemi të di me máll,
dhià si vasha ndë speqáll.

---

*) *Fluromë* = Hymn.

5) *ergjëntullore* = t' argjantë. -- *keq* = tepër. — *j' e butë.* = S' âsht apostrofim i trajtës verbore *jé*, por âsht nji *jotacjon* i thjeshtë, si e bâjmë na këndej b. f.: *jerdhi*, *i jati*, *i joni* etj. Prá, këtu: *tepër e butë e embëlore.* — *zën'...* = na nget (na ngucë, na prekë) zânin (zemrën). -- *e s' lodhen* = s' lodhesh. — *prisandaj* = ndërkaq.

10) *s' ndendemi* = s' ngihemi. — *ruhemi* = këqyremi të dy (shoqishojn). — *dhià* = sikúr. – *sqepáll* = pasqyrë ; prej it. *specchio.* — *kur që rrite...* kùr shkon tue u rritun pak ngı pak.

*

Cur çë rrîte pach e pach
gjet një ree çë ncâ një lach
ngchreghet ljart bârdh e bârdhe
e mbion sholjësza e gcardhe
vente t' errët, e të théla ;
e fanaret ndrishe gjéla.

*

Kur që rrite pak e pak
gjet një re, që nga një lak
ngrehet ljart e bardh e bardhe
e mbjon shóllëza e gardhe,
vente t' errta, e të thélla ;
e fanaret ndrishe gjélla.

*

Cur prâ tundulore e piotte
dèlj mbi malj veltehêa jotte,
duche j' eem piotte namuur
çë të bîrit i caa cuur :
e me gjith se largu rrii
e shoccon me szêmèr e sii.

*

Kúr, prá, tundullóre e pjote
del mbí mal vetëhea (e) jote,
duke jëmë pjotë namùr,
që të birit i ka kùr :
e me gjith se largu rrí,
e shokon me zemër e sí.

*

Cur të váchëtasz ncâ véra
truut na veen si frunculèra ;
e ndë shpiit 's na caa ënda
ampnor të rrîmi mbrenda.
e ndër mikjët e ndër gjëriit
dajmi për ndër gjitoniit,
tuche dhèphur ljoddëra e vàlle
o të veshur ndër rusalle
udhët sheshet ti na ndrittën
se të shoghëmi dhià si dittën;
mos të biemi të zënohemi
o gjacun të demëtohemi.

*

Kur të vakëtaz nga vera
trút na vén si frunkuléra ;
e ndë shpít s' na ka ënda
ampnór të rrími mbrënda,
e ndër miqët e ndër gjërít
dajmi per nder gjitonít
tuke dredhur lodëra e valle
o të veshur nder Rusalle,
udhët, sheshet ti na ndritën
se të shóhemi dhiâ si ditën :
mos të biemi, të cenóhemi,
o gjakun të dëmtóhemi.

---

15) *Sholleza* = toka; prej it. *suolo.* — *fanaret* = duket ndryshe, (merr nji fytyrë tjetër, jeta (gjella). Prej Gr. *faíno.*

20) *duke jëmë.* Prap jotacjon : dukesh êmë (nânë). — *pjotë namúr* = plot dashuní. Prej it. *amore,* Kal. *amure.* — *i ka kùr* = Italjanizëm : *ha cura.* — *e si* = e sy.

25) *vakëtaz* = pak si të vokuna. — *frunkuléra* = gëzim zjarmuer, flakadâ. — *ampnòr* = të qetë (it. *tranquilli).* Prej gr. *ampnéo.* — *gjërít* = gjinit, kê kemi gjâ.

30) *dajmi* = dallim. — *gjitonít* = fqîjt. Prej gr. *gentonia.* — *tuke dhedhur* = tue luejtun. — *Rusalle* = Shtriga, magjistare. (Kq. Meyer *Et. W. f.* 369).

35) *ej e pjotë* = e e plotë. — *mëno* = ndalu, rri. Si : *vano.* Meyer e nxjerr prej lat. : *maneo.*

*

Na të fajëmi tue thërrittur:
Rrosh e stosh o ghëën e rrittur
ej e piot, mëno mëno
mosse ashtu, e na giadho.
. . . .

*

Na të fajëmi tue thërritur:
Rrosh e shtosh, o hën' e rritur,
ej e pjót, mëno, mëno
mose ashtu e na hajdhó.
. . . .

JUSTIN RROTA

2) *Miekrari* *)

Nd' uljtare si një nusse
Të uljin, të ndrekjin Sepparielji:
Të shtron mësalin, e ti kërrusse
Si një kokje krikomelji;
Kur me gjishtërat të ngket
Duket se të therin e të vret.
Shiashin merr e fakjen te shëkon
Me za bardulore shëkoom,
Ziljia mëë se aduur dirgkon
Dialóssurëë verroom
Hundin të rëmpen me door
Çë ndë gkushte kaa si boor.
Me një thik prana ti riep
Si një derk ndë magje i vraar,
Sit shtringkofen e ljiotët si kjiep

---

40) *mose* = gjithmonë. — *hajdho* = gëzo. Prej gr. *gathéo.*

II. — *) *Miekrari*, berberi, rruestari. — Këjo vjershë satirike e Santorit ësht nxjerrë nga vepra e Stratico-it, *Letteratura albanese.*

1) *uljtare*, karrigë. — *të uljin*, të ul, të ungj. — *të ndrekjin*, të ndreq. — *Sepparielji*; it. „Giuseppello", Zefi. — *mësalin*, çarçafin, mësallën. — 4) *kërrusse*, mblidhe, zvogëlohe. — 5) *krikomelji*, misri. — 6) *të therin*, të ther. — 7) *shiashin*, fshesën, furcën. — *të shëkon*, t' a shkon. — 8) *shëkoom*, shkumë. — 9) *ziljia*, e cila. — *mëë*, më, më tepër. — *aduur*, erë. — *dirgkon*, fraza „*aduur dirgkon*" ësht ital. „*manda odore*" na thomi „lëshon erë. — 10) *dialassurëë*, diallëzore. — *verroom*, vromë. 11) *hundin*, hundën. — *rëmpen*, rëmben. — 12) *ndë gkusht*, që në muaj të Gushtit e ka të ftohtë si bora. 13) *prana*, pastaj. — 14) *derk*, thi i vogël. — 15) *shtringkofen*, shtërngohen. — 16) *ture raare*, duke

Fakjes posht ven ture raare :
Ai bën se nëngh e diljinkon
Kimen e pret, fakjen punon.
    Thot prodofët ai kur mberon
Piot me gkaz e me haree;
Thot, ndrë tii, ai çë esht ndën:
Të rafëtë dora cë iljisit bëne pre !
Ai pirgjigjet edhe pa gjir :
Sa të veç shënteshim e i miir.

3) Nga „EMIRA“

SHENA E V.

Moriani prâ Emîra

Moriani : Ajo m' u duk, no se e përzenur 1) prei bârit ljík 2) çë u larghua tuttiè me rikazit 3), ndo se 4) hîri se të bëi të hola 5): do të jeet këtèi. Më mënuan këto dèlje ; por nanni lje të zëën 6) te këtò pirraz 7), nd' attè çë 8) atë u te çon 9).

Emira : Ziármi iin !

Moriani : Emîir çë kjé ? 10)

Emîra : Zèshka u 11) !

Moriani : Çë të psoi ? 12) ah ah ah !

Emîra : O çë shtrush 13) çë gjègja ! ti kjeshën e u dridhem.

---

rënë. — 17) *diljinkon*, kupton. — 19) *prodofët*, prodhoftë, paç prodhë ; berberët t' onë thonë „me shëndet !“. — *mberon*, mbaron. — 21) *ndre tii*, ndënë 'tê, me vete. — *ndën*, ungjur, ndenjur. — 22) *çë i ljisit bëne pee*, që më bërë të shoh yjzit, fraza ësht italishte „*mi hai fatto vedere le stelle*“ e përdoret për të shprehur një dhëmbje të madhe. — 23) *pa gjir*, pa hirë. — 42) *sa të veç...*, na thomi : „shkofsh shëndosh e mirë“.

III. — 1) *e përzenur*, e përzenë, e ndjekur. — 2) *bârit ljik*, bariu i keq. — 3) *rikazit*, dërrat e vegjël. — 4) *ndo se*, ase. — 5) *të bëi të hola*, të bëjë dru, të mbledhë shkarpa, karthija. — 6) *lje të zëën*, le të kullosin. — 7) *pirraz*, shkurre, shkurrnajë. — 8) *nd' attè çë*, në sa që. — 9) *atê u te çon*, unë t' a gjëje atë. — 10) *çë kjé*, ç' ndodhi, ç' ngjau. — 11) *Zeshka u*, e zeza unë ! — 12) *çë të psoi ?*, ç' të ngjau, ç' pësove ?. — 13) *shtrush*, zhurmë, it. „fruscio“. —

Moriani : Çë váite të bëje mbrènta [14]) nd' at skjin ? [15])

Emîra : Donja të shèghësha, si gjègja 'akj pëdhestrózzul [16]) e friim [17]) tek ûdha ; mos ish ndo një vargharii [18]) ljëtire ! [19])

Moriani : E si nkë patte njohur kumborën e Massàrés e të Nikókjîrés ? [20])

Emîra : Gjègjënja një trëmbësiim [21]), nkâ çë aan e árthur nkë dii t' e thom.

Mariani : Jo, Emiir. Ai per çë të përzêi [22]) Calonjeri ?

Emira : Pse e shaita [23]), e kèsh ljíkj [24]).

Moriani : Mos u nkùkj : ti bère e pështoi [25]) një ljepur kâ trópa [26]).

Emîra : Një ljèpur ísh ? Mua u ndot [27]) një drankoljee [28]), Popo ! si më tramaksi ! s' múnd mbághem [29]) shtuara!

Moriani : Ulju këtú ndë këta baar, te këjó ûjez [30]) e udhës.

Emîra : (u ulj) : Një ljèpur poka [31]) ish ? kjoft i pîèkur ! Çè bukur gharee çë më thá; psè nënk i shkrèghe ? [32]).

Moriani : T' e kush bëën [33]) të korjúrturit [34]) ndë kísh pássur [35]) duffekun [36]). Mund thuash se kjè Fumel çë sot të ljevrossi [37]) dii u [38]) çë të kèkjie.

Emîra : E si ?

Moriani : Se ai urdënoi të mos kjê linj [39]) duffèk njerii.

---

14) *mbrênta*, mbrënda. — 15) *skjin*, it. „lentisco", nji bimë. — 16, *pëdhéstrozzul*, zhurmë këmbësh, gjurma. — 17) *friim*, frymë. — 18) *vargharii*, çetë. — 19) *ljëtire*, italjane. — 20) *e Massárès e të Nikokjirés*, kështu quheshin dy dele të Morianit, edhe bujqit t' onë e kanë zakon t' u ngjisin emër gjëve të tyre. — 21) *trembësiin*, zhurmë e madhe. — 22) *ai për çë të përzei*, fraza si pas ital. „Ei perchè inseguivati". 23) *e shaita*, e shava, — 24) *kish ljikj*, kishjam ligj, kishjam të drejtë. — 25) *pështoi*, shpëtoi; fraza ital. „tu facesti scappare". — 26) *tropa*, *çuba*; shkurrja. — 27) *u ndot*, u duk. — 28) *drankoljee*, gjarpër. — 29) *mbághem shtuara*, të mbahem, të qëndroj në këmbë. — 30) *ùjez*, buzë, anë, zgrip. — 31) *poka*, pra. — 32) *i shkrêghe*, nuk i re në pushkë. — 33) *t' e kesh bëën*, t' a kishja bërë. — 34) *korjúrturit*, it. „*complimento*", kompliment. — 35) *ndë kesh passur*, se kur të kisha pasur. 36) *duffekun*, pushkën, një nga fjalët e rralla turqishte, që dëgjohen ndër djalektet arbëreshe. — 37) *ljerrossi*, liroi, çliroi. — *dii u*, e di unë, kush e di, nga ç' të keqe, fatkeqsí. — *të mos kjê-*

Emîra : E çë dit sfanifore 40) si u dii 41) edhe u kish ngrissur per mua këjo sod ! Të vëdíssia dores të attiij shokut, ku 42) vettëm kuur pensonj 43) më bessen 44) e prëghen dhruut 45) e zëmra : thomse 46) per kët dít kâ më ljibraarti 47) Sën Mërîa dii u çë pshoin 48) e s' dii sâ mot 49) kaa.

„Njoo 50) u kam mìkj e gjërii, e messe 51) uljem me tá si ndër të shpiis 52) : por mosse kûr u perpokja 53) o ndodhem me tiij, më laftarissën 54) zëmra, më tundet, barku, më ljekossen 55) gjunjët, më mbíghen 56) lorët 57). Një anangkasii 58) si ngkë dii t' e thom më shpettën 59) t' ikinj ; e prà çë jam e vattur 60) më dhembet 61) çë të ljee 62). Parandrékja heer ! 63) natten e ditten kush dii sâ fiaalj sâ të pietura 64) kèsh të të bëja, e prâ kûr m' u perpokje gjith nji-hërie 65) u vuvossa 66). Vettëm mentîrin 67) t' ênd e gjëë 68) ndë më pafte dhëën e mbaanj mosse me mua. Tuffen monosakje 69) kë mê dhee kasë një díttëz 70) e kam edhe këtu.

Moriani : Ku e kee ?

Emira : Mbrênta ndë nëngj 71) të zarìljit 72), ma nanni u thàitin.

Moriani : Shtîri 73) ; çë i do mëë çë búartin 74) êren ?

---

liuj, ne thomi: të mos mbajë pushkë. — 40) *sfanifore*, e zymtë, e keqe. — 41) *u dii*, u gëdhi. — 42) *ku*, tek i cili. — 43) *pensònj*, mendoj. — 44) *më bessen*, si pas ital. „si affidano“ na këtu munt të përkëthejmë, „i dorëzohen“. — 45) *dhruut*, trutë. — 46) *thomse*, ndothta, ndoshta. 47) *kâ më ljibraarti*, nga e cila më shpëtoi. — 48) *dii u çë pshonj*, fshanj ; me këtë frazë Emira do të thotë se ka shum kohë që e pret pa durim këtë ditë, që t'i rrijë pranë Moriani e t'i çfaqë dashurin e vet; „fshanj“ me kuptimin ital. „sospirare una cosa“. — 49) *mot*, kohë. — 50) *njoo*, ja, qe. 51) *messe*, nėr 'ta, në mes të tyre. — 52) *ndër të shpiis*, sikur ungjem me ata të shpisë. — *u perpokja*, u takova, u ndesha. — *laftarissën*, më rreh. — 54) *më tundet*, si pas ital. „mi si commove“, më theket, mallëngjehet. — 55) *ljekossen*, më këputen, më thyhen. — 56) *mbíghen*, mpihen, ngathen. — 57) *lorët*, llërët, llanët. — 58) *anangkasii*, nxitim, ngutsi. — 59) *spettën*, shpejton, shtyn. — 60) *prà çë jam e vattur*, e passi që kam shkuar. — 61) *më dhêmbet*, më vjen keq. — 62) *çè të ljee*, që të lash. — 63) *parandrèkja heer*, na thomi : kaq herë, kush e di sa herë, ase më parë : më parë kësaj here. — 64) *të pìetura*, të pyetura, pyetje. — 65) *gjithnjë hërie*, për një heresh. — 66) *u vuvossa*, heshta, mbeta pa gojë, it. „ammutire“. — 67) *mentîrin*, fytyrën. — 68) *gjëë*, ndonjë gjë, ndonjë send: — 69) *monosakje*, manushaqe. — 70) *kasë një ditë*, parëdije. — 71) *nèngj*, nye. — 72) *të zaríljit*, të gërshetit. — 73) *shtìri*, flaki, hidhi

Emira : Mos kjoft ! báshk me atto shtîja ní [75]) në piés te mêje [76]).

Moriani : Emmi [77]) múa, se t' i mbiedh [78]) mëë të rêa.

Emira : Kam të shpièxin [79]) zuriljin e këshettin ? Esht kèkj e gjàt jèula [80]) ; e ndë gjëntet [81]) e shkon ndo njerii e më shegh ashtu të shekëmìssur... [82])

Moriani : Bêkúat [83]) kjòfsh noree [84]) copìlje ! [85]) kee mëë urtërii se ú. Ez ni [86]) me èngjëlìn shok ku kee të vèsh. Mbettëtim [87]) shuum bashk për nanní, moi me perìkul [88]) të madh të ndêrës [89]).

Emira : Vette, po dii u çë më parathot shpirti ! (mérr ûdhen, e Moriani e resht për ndë fúsht me deljet).

NAMIK RESSULI

---

12. — DHIMITËR KAMARDA (1821-1882)

a) Jetëshkrimi

Duke marrë para sysh gjendjen e jashtëzakonshme që i u êsht ruajtur përhera Shqiptarëve t' Italisë në lidhje me Kishën — kështu shkruante më 1885 Gustav Meyer-i [1]) — dhe duke marrë para sysh nevojën që shfaqej për të pasur priftër thjesht kombëtarë, nuk mund të na çuditi fakti që një numër i madh burrash shum të vlershëm nga pikëpamja intelektuale t' i jenë kushtuar meshëtarisë, dhe që ndër shkrimtarët italo-shqiptarë, pjesa më e madhe të jenë priftër.

Dhe Dhimitër Kamarda bên pjesë pikërisht në këtë varg të madh priftësh të shkelqyer e të mirënjohur italo-shqiptarë të

---

poshtë. —— 74) *buartin*, humbën. —— 75) *shtîja ni*, kupto ; do të më dukej se shtinja njëkohësisht. —— 76) *një piés te mèje*, një pjesë të vehtes s' ime. —— 77) *emmi*, nëmi, epmi. —— 78) *t' i mbiedh*, të mbleth. —— 79) *kam të shdiexin*, do të çthurr, duhet të çthurr. —— 80) *jèula*, „jetula", lidhca. —— 81) *gjêntet*, gjendet. —— 82) *shëkëmissur*, si pas ital. „scamiciata" „discinta", na munt të thomi „e zbërthyer", që nuk i ka teshat në rregull. —— 83) *bêkúat*, e bekuar. —— 84) *noree*, e mënçëme. —— 85) *copìlje*, vashë, vajzë. —— 86) *ni*, tash. 87) *mbettëtim*, mbetëm, qëndruam, ndënjëm. —— 88) *perikul*, rrezik. —— 89) *të ndêrës*, të nderit.

XII. —— 1) Gustav Mayer —— „Della lingua e della Letteratura albanese" —— (Nuova Antologia ; seri e 2 ; Vëll. 50 —— 1885 faqe 585).

rytit grek që shkelqejnë, në historinë e kolonivet shqiptare t'Italisë si për dijturí, si për kulturë, si për përdëllim, si për dashuri për gjuhën e të parëvet e për Atdheun e gjyshëvet.

Lindi filologu i madh arbëresh në Siqeli, n' atë qendrën e lulëzuar e pjellore të shqiptarizmit, që Italjanët e quajnë, nga shkaku i rytit grek që ndjek populli, „Piana dei Greci", por që nga themelimi, më 1487, banorët e saj e kanë thirrur përhera „Hora e t' Arbëreshvet".

I ati i tij, Papa Jan Kamarda, ishte famullitar i qytetit, dhe të gjithë, në Piana dei Greci, i mbajnë në gojë emrin, zëmërbardhësinë dhe dashurinë për traditat: nga këjo familje kaq fisnike dhe e shquar lindën përveç Dhimitrit, që në moshën 23 vjetsh u bë prift, edhe vëllezër të tjerë, Nikolla, më i madhi, prift edhe ky dhe elenist i dëgjuar, pastaj profesor n' Universitet të Palermit, dhe Zefi, më i vogëli, shkrimtar e vjershëtor i këndshëm arbëresh, rreth të cilit kemi për të folur më pastaj.

Si u bë prift Dhimitër Kamarda vetëm një vit u ndal në qytetin e lindjes: më 1845, në moshë të re 24 vjetshe, ay gjendet në Napoli, famullitar i Kishës Greke t' atjeshme, duke marrë pjesë gjallërisht në jetën fetare, letrare e politike.

Ishin kohë, ato, me turbullime të tepërta shoqërore e politike: e gjithë Italija, prej Alpeve në Siqeli, ishte përshkuar nga dëshira e zjartë e çlirimit prej qeverivet absolute, e nga lëvizje e kryengritje të drejtuara për t' i arrijtur njësisë e pamvarësisë së Kombit.

Italo-shqiptarët e Siqelisë e të Kontinentit, përmbi gjurmat e bashkatdhetarit të tyre të madh Françesk Krispit, i qenë përveshur punës së shënjtë të lirisë e të njësisë s' Italisë.

Në Napoli prifti i ri Dhimitër Kamarda, i pajisur me kulturë të fortë klasike e me dashuri të madhe për gjuhën shqìpe, takohet me Jeronim De Radën, me Emanuel Biderën e me të tjerë italo-shqiptarë, që, nga një anë komplotonin për pamvarësinë italjane, nga ana tjetër hidhnim themelet e asaj lëvizjeje së shquar letrare e politike shqiptare që — siç thotë Zef Skiroi 2) — përpjekjet sidomos të De Radës e të Kamardës shë-

2) Giuseppe Schirò — „Della Lingua Albanese e della sua Letteratura" (Annuario 1917-18 e Institutit Mbretror lindor të Napolit).

nuan rifillimin e marrëdhënjeve t' Arbëreshvet me Shqiptarët e Mëmëdheut, dhe krijuan themelet, mbase midis më të fortave, të zgjimit kombëtar shqiptar. Por më 1848 De Rada u tërhoq në fshatin e tij Makja në Kalabri, e Dhimitër Kamarda passi edhe ay dyshohej se komplotonte me liberalët, u zbua prej Qeverisë Borbonike nga Mbretrija e të Dy Siqelive: kështu të dy gjigantët e letërsisë s' onë, passi u njohnë, dhe passi bashkëpunuan për disa kohë për krijimin e një gjuhe letrare shqipe e për formimin e një ndërgjegjeje politike në popullin shqiptar, u ndanë për nga hera, viktima bujare të dashurisë s' atdheut.

Dhimitër Kamarda më parë ish arratisur në Romë ; pastaj gjeti strehë në Monastirin Benediktin të Çezenës, mik tek një siqeljan i dijtur, te Abati D. Domenik Gravina ; më së fundi, më 1852, u emrua Profesor i letërsisë në gjimnazin e Livornos, ku u vendos dhe ku në studimet që i pëlqenin aq shumë e në vepra mirëberësije, shkoi të gjith jetën, duke u bërë më 1875 Famullitar i Kishës Greke s' atij qyteti ; më pas u nderua nga Papa Leoni i XVII me titullin Arkimandrit.

Vdiq në Livorno më 13 Prill 1882 dhe u varros me nderime shumë të mëdha po në Kishën Greke t' atjeshme.

Varri i tij — shkruante F. Gelli më 1929 3) — *dëndur nderohet nga një lule që ndonjë dorë e panjohur i vë, mbase si shënjë mirënjohjeje për ndonjë të mirë që ka pasur dikur prej tij...*

Me një pamje të hijëshme e fisnike — shkruante prap Gelli — me një qëndrim bujar e t' ëmbël, përdëllenjës gjer në kulm, ish rrethuar nga nderimi i devotëshëm i Livornezëvet, pa ndryshim partije, sepse Arkimandriti Dhimitër me sjelljet e tij të thjeshta kish dijtur të bashkonte dashurinë më të gjallë për Italinë.

Por jeta e këtij prifti-atdhetar nuk u përmblodh te studimi e te ushtrimi i detyrës së tij si fetar ; vërsheu në propagandën më të volitëshme të shpirtit shqiptar...

Urtësija e priftit Kamarda u duk pas vdekjes së tij. Nepër kartërat e tij u gjëndën letra të panumërta që i a kishin drej-

---

3) Jacopo Gelli — „Demetrio Camarda creatore della Lingua albanese" („Gazzetta del Mezzogiorno", 4 Shtatuer 1929).

tuar priftër, kardinalë, Ministra të Mbretërisë, Princë, atdhetarë italjanë e shqiptarë, në të cilat Arkimandritit të përulur i kërkonin mendime e këshilla dhe jo vetëm mbi çështje letrare, por sidomos mbi problema politike e fetare të një rëndësije shumë të madhe, që interesonin edhe bregdetin tjetër t' Adriatikut...

Ky ësht me pak fjalë jetëshkrimi dhe fytyra fisnike e Dhimitër Kamardës.

Në Tetor të vitit 1921, në qindvjetorin e parë të lindjes së tij — populli dhe kleri i Piana dei Greci-t, me përfaqësimet e kolonive të tjera italo-shqiptare të Siqelisë, e kremtuan madhërisht datën, duke i bërë nderime të posaçme albanologut të madh italo-shqiptar, me ceremoni fetare e qytetare. Me këte rasë u ngjit në kathedralën e Piana dei Greci-t një rrasë e bukur përmëndoreje me mbishkrim në gjuhën shqipe, të diktuar nga Zef Skiroi, që përmbledh në mënyrë të volitëshme jetën e veprat e Dhimitër Kamardës dhe që po riprodhojmë këtu :

„*Për kujtim të përjetëshëm — të Papa Dimitër Kamar-*
„*dës — Arhimandrit në Livorno — i çili për saa rroi — me*
„*fjalë, me punë e me të shkruara të paharroshëme — i bëë ndeer*
„*vëndit — shëndriti të vjetrën gluhë t' ënë — edhe i shtoi hie*
„*Atdheut t' dashur — gjithë ata çë j-a diin të mirën — kuuj,*
„*paa u lodhur kuurr, natë e ditë u mundua — për t' i dalë zot*
„*edhe fitim për t' i sjellë — të lartës farë shkjyptare, — te*
„*kjintvjeti i parë i t' leemit t' tiij, — në XXIII të tetorit*
„*MCMXXI, vuun këtu këtë rrasë*".

b) Veprat

Me të drejtë Zef Skiroi, — që mundi më mirë se të gjith të tjerët të studjonte me imtësi e të çmonte veprat e Dhimitër Kamardës, — duke bërë mbishkrimin për gurin e mermertë të kathedralës së Piana dei Greci-t, deshi t' u tregonte brezave t' ardhëshëm përpjekjet e parreshtura të bashkatdhetarit të tij të madh.

Dhe me të vërtetë mjafton t' u hidhet një veshtrim të dy vëllimeve të Kamardës, „*Gramatologjija e krahasuar mbi gju-*

hën Shqipe" (Livorno 1864) dhe „*Shtesa*" (Prato 1866) për të kuptuar sa edhe ata që s' janë marrë ndonjë herë me studime gjuhësore — se gjëndemi përpara njëj kryevepre me rëndësi të jashtëzakonshme.

Më tepër se pesëmbëdhjetë vjet punë të rëndë e kërkime mjeshtarake i kushtoi Kamardës vepra e tij, me të cilën ay krijoi bazat shkencore për studimin e fonologjisë, të morfologjisë e të syntaksës së gjuhës shqipe, duke e ngritur këtë në shkallën e gjuhës letrare e duke e bërë, sa më shumë me Jeronim De Radën, vegël shumë të çmueshme të përhapjes së kulturës e s' idesë kombëtare në mes të popullit shqiptar, dhe n' Europë mjet të volitshëm propagande në dobi të Kombit shqiptar, edhè i shtypur nën zgjedhën turke.

„Dhimitër Kamardës, arbëresh prej Siqelije — kështu shkruante G. I. Ascoli më 1877 — i detyrojmë punën më të gjërë të gramatikës së krahasuar që ësht kryer gjer tani n' Itali.

Vëllimi i parë përshkruan e vëzhgon krejt organizimin e gjuhës së Shqiptarëvet... Vëllimi i dytë ësht një antologji shqipe, me ilustrime të shumta filologjike, të paraprirë nga një bisedë e gjatë dhe e çmueshme letrare — historike... Libri i tij i siguron për nga herë një vënd të zgjedhur midis Shqiptarëve, dhe ësht një stoli e vërtetë letërsije filologjike... 4)

Më të përmendurit shkencëtarë të kohës e quajtën të domosdoshëm studimin e veprës së Kamardës për ata që do të dëshronin t' i kushtoheshin gjuhësisë shqiptare.

Ndër glotologët e huaj i çmuan shum kërkimet e Kamardës dhe nxorën mjaft përfitim prej tyre Miklosich-i dhe vetë Gustav Meyer-i.

Shumë ësht përfolur mbi përfundimet në të cilat ka arritur auktori i shkelqyer i gramatologjisë rreth afërsisë së shqipes me greqishten.

Ay, ësht e vërtetë se, i tërhequr nga ideja, që në kohët e tij ish përhapur në Shqipëri e n' Itali e njëj bashkëpunimi të

---

4) G. F. Ascoli —— „Studi critici" 1877.

ngushtë politik greko-shqiptar [5] nuk u kursye të theksonte të gjitha elementet gjuhësore të favorshme për tezën e vet; dhe me të vërtetë ka shkruar: „Nuk e fsheh se mua m' ësht dukur përhera lithka e ngushtë midis gjuhës shqipe e greke... Por vetëm pas gjurmimesh të tjera më të thella e të tërhollta e passi të tjerë më të zotë të kenë shfaqur mendimin e tyre, do të jetë e mundur të gjykojmë sa ësht e tepëruar ase e drejtë, e vërtetë ase e gabuar pandehja e disavet, sidomos në Greqi, që mendojnë se shqipja ësht pothuase një dialekt ì greqishtes". [6])

Gustav Meyer-i, i vetmi albanolog i zoti nga kohët e Kamardës e tehu, gabimisht i a ngarkoi Kamardës ketë thezë të shqipes — dialekt grek, (që Kamarda vetë, siç pamë sipër, tërthorazi e kish gjykuar të gabuar e të tepruar) duke hedhur kështu një hije mbi meritën e madhe e mbi veprën e pavdekëshme të filologut të madh italo-shqiptar.

Gramatologjija e Kamardës, edhe në qoftë se ësht e metë në metodë e në rregull, ësht pa dyshim e denjë për gjithë admirimin t' onë e për gjithë mirënjohësinë e Kombit Shqiptar për pasurinë e seriozitetin e lëndës që përmban, por sidomos sepse fetari i shkëlqyer e atdhetari siqeljan-shqiptar, me dëshirë të madhe e me qëndresë apostulli, i ka ngrehur me atë një përmëndore të pavdekëshme gjuhës s' onë, dhe me përpjekjet e tija fisnike e ka ngritur në shkallën e studimevet shkencore [7]).

„Emri i Dhimitër Kamardës — ka shkruar Mayer-i — meriton të përmëndet e të ngrihet në historinë e shkencavet".

Në çdo kënd të problemevet të gjuhësisë shqiptare Dhimitër Kamarda e ka lënë të këthiellët mendimin e tij, përhera i frymëzuar nga qëllimi fisnik që t' a bënte gjuhën shqipe vegël lartësimi e përparimi të kombësisë shqiptare.

---

5) Pietro Chiara — „L' Albania" — Palermo 1869, f. 31, 63, 73, 78, 85, etj. Dora d' Istria — „La Nazionalità Albanese" — Cosenza 1867, f. 5.

6) Demetrio Camarda — „Saggio di grammatologia comparata sulla lingua Albanese"; Livorno 1864 — faqe 6-7.

7) Gaetano Petrotta — „Popolo, Lingua e letteratura Albanese" — Palermo 1932, faqe 438.

Ndër të parët albanologë, ay e ka vendosur në caqet e drejta çështjen e djalektevet shqipe dhe nevojën për të drejtuar shkrimtarët shqiptarë në sajimin e gjuhës letrare të përbashkët. „N' asnjë Komb — ka shkruar Kamarda — një gjuhë e këtillë e përgjithëshme dhe e përbashkët nuk ka eksistuar në gojë të popullit, e cila për prirje të natyrëshme, duke u folur në çdo vend e kohë, ndahet nepër djalekte. Midis të gjitha Kombeve të kulturuara këjo gjuhë e përbashkët ka qenë sigurisht përhera prodhimi i përpunimit letrar, dhe nuk mund të përbëhet, si të themi, veç se prej lules së të foluravet të ndryshme të vëndit..." 8)

Me qellim që të jepte një provë t' asaj që, sipas mendimit të tij, do t' ishte gjuha e përbashkët letrare, më 1867 botoi vëllimthin „*Fyletia Arbënore prej kanëkatë të Laoshima*" përkthim i studimit të Dora D' Istrias : *La Nationalitè albanaise d' après les chants populaires.*

U muar shum me leksikologji shqipe, dhe po pregatiste një fjalor shqip. Midis dorëshkrimeve të Kamardës që tani gjënden në dorë t' Imzot Pal Skiroit, ësht gjëndur një nxjerrje e Fjalorit italisht-shqip t' At da Lecce-s të vitit 1702.

Përmblodhi vjerrsha profane e këngë popullore fetare shqipe, që pastaj, më 1867, i botoi në „*Shtesë*" të gramatologjisë.

Më 1869 botoi një studim mbi „*Alfabetin e përgjithëshëm shqiptar-epirotik*" dhe më pas „*Tri këngë popullore shqipe t'Epirit*".

La në dorëshkrim një „*Gramatikë shqipe*" me qellim praktik (prap në dorë të Imzot Skiroit) për përpilimin e së cilës, me sa duket, ishte ngarkuar nga Selija e Shenjtë për t' u shërbyer misjonarëve katholikë në Shqipëri.

Më 1870 doli në dritë, nën përkujdesjen e Dhimitër Kamardës një përmbledhje vjershash për nderë të Dora D' Istria-s. Janë 12 hartime poetike të ndryshme auktorësh shqiptarë, ndër të cilat ësht edhe një e vetë Kamardës. Ka qënë një shënjë nderimi që Dhimitër Kamarda, bashkë dhe me shkrimtarët më

---

8) Demetrio Camarda — „Discorso preliminare in Appendice al saggio di Grammatologia Albanese — Prato 1866, faqe VIII.

të njohur e poetët shqîptarë të kohës së tij, ka dashur t' i bëjë për mirënjohjen e madhe që kishte për tê populli shqiptar, fort së shquarës e fisnike shkrimtare, së cilës i detyrohet përhapja n' Europë e njohjes së Shqipërisë, së letërsisë së saj, të shkrimtarëve të saj dhe të drejtës së saj që të lindte e lirë në shoqrimin e Kombevet civile.

c) Zonjës Elenë Gjika

Si fidhova dua të sosë
Un' veldiën 1) e Zonjës madhe,
Që me fjalën sáj' plakosë 2)
Ndë Frangjië e ndë Eladhë
Anëmiqt' Arbniës të shkretë
Tuke thanë 'ntçell 3) të ftetë.

A ma par' se ajo kush fliste
Për të mjetën Shqypënië ?
Vetç 'ndo hér' i dishmi e thriste
Emrit sáj' si n' lashtënië 4)
Lumbërumun 5) ja me trima,
Që përjetë t' lan kuitima.

Pas t' përmadhit 6) Kastriotë,
Që si vdiq' mbet hora 7) e vé,
Sikur' s' ishën ma Ipirotë,
E Shqyptarë tek ai dhé,
Te ku u lindën Pyrro, e Flipi
Biri i thann' sé nqiellshë sdripi.

---

1) *Veldië :* lavdí (metathezë) ; 2) *plakosë :* ndrydh ; 3) *'ntçell :* haptazí, çeltazí; 4) *të ftetë :* të vërtetë ; 4) *lashtëni :* kohë e lashtë, e vjetër; 5) *lumbërumun :* i lumnuem ; 6) *i përmadh :* shkalla sipërore e adjektivit *i madh* = shum i madh ; 7) *hora :* vend, qytet, katund, por këtu ka kuptimin *atdhé.*

Po ashtu kujtuan njerzitë,
Se kta burra janë gjenië 8)
Trimmash t'motçim' e plot erzitë,
Që gjith kosmi 9) i dha lèvdië.
U dëftuan si t' jéra herë
Nipra prinjëve me nderë. 10)

Tani gzou jenia 11) e lashtë
T' namatismet Pelasgove ; 12)
Perëndia kështu t' a thashtë!
Tyj t' ká dalë, si nuk mendove
Kúrr, një bijë, Dora e lumë,
Që t' ndéron ma mir' se shumë.

Ajo ësht' pra Zána e ré
Që Hyj i madhi na dergoi,
Sa t' ndriçoj' ktë t' errun dhé,
Kaha 13) gjindja e sáj' lulzoi,
Urtësia e njerëzia
Që t' priren 'nte Shqypnia. 14)

(„A Dora d' Istria gli Albanesi"
per cura di D. C. — Livorno,
1870, faqe 115-116.)

ROSOLIN PETROTTA

---

8) *gjenië:* gjiní, fis.
9) *kosmi :* fj. greke qi d. m. th. *botë.*
10) *nipra prinjëve me nderë :* ndërto kështu : *nipa prindësh me nderë.*
11) *jenia :* gjinija, fisi (shif numrin 8 të këtyne shenimeve.)
12) *t' namatismet Pelasgove :* i Pelazgjvet me famë.
13) *kaha :* kah, nga, ngah, ngaha.
14) *që t' priren 'nte Shqypnia :* qi të këthejnë në Shqipní.

BKSH

13. — GABRIEL DARA — I RIU (1826-1885)

a) Jetëshkrimi

Gabriel Dara [1]), I Riu, i biri i Ndreut e i Franceska Dara — Dragota, lindi në Palazzo Adriano të Siqilisë më 8 të Janarit 1826 dhe zbriste nga ato familje të moçme e bujare Shqipëtarësh, të cilat qenë nga më të parat që lanë Shqipërinë pas vdekjes së Skënderbeut dhe erdhën e gjetën strehë përtej Adriatikut, n'Itali, po që nuk e buarën kurr kujtimin e atdheut të robëruar.

Kreu mësimet e para në Seminarin italo-arbëresh të Palermit dhe passi u doktorua në Ligjë, hyri për praktikë pranë zyrës advokatore t' ungjit të vet, Nikollë Darës, i famëshëm jurekonsult i Girgentit, i cili më 1848 kish qënë edhe deputet i Parlamentit siqiljan. Këtu Gabrieli i ri u dallua shpejt për zotsinë dhe për shkathtësinë e mpréhtësinë e mëndjes, si njeri i gojës e si studjimtar i thellë e nuk vonoi të nxjerrë në dritë një fletë letrare me emërin „*Palingenesi*", qëllim i së cilës ishte të ngrinte e t' i jepte një hov përmirësimi letërsís italjane.

I frymëzuar nga ndienja të larta atdhetare, qe nga më të parët që muarën pjesë në lëvizjet e ringjalljes italjane. E gjëjmë kështu me kohë në krye të lëvizjevet kryengritëse t' ishullit, si anëtar të Komitetit revolucjonar të Girgentit, bashkë me Bartoli-n, me Gramitto-n e me të tjerë. Prandaj më 1860, si shpërblim, me dekret të Garibaldit, të nënshkruar edhe nga Krispi, emërohej sekretar i përgjithëshëm i Qeverisë s' atij qyteti, në krye të së cilës gjëndej Domenik Bartoli vetë. Më 7 të Shtatorit 1862, prap me dekret të Diktatorit Garibaldi, kalonte si këshilltar i Prefekturës së Palermit; pastaj si nënprefekt i Bobbio-s, i Aosta-s e i Lugro-s. Së këtejmi dërgohej si këshilltar i deleguar i Catanzaro-s e më 1866 po me këtë detyrë shkonte në Trapani, ku pas një viti, 1867, emërohej prefekt i këtij qyteti. Po në këtë detyrë Gabrieli nuk qëndronte më tepër

---

1) Sh., ndër tjerë, Z. Schirò, *Canti tradizionali ed altri saggi albanesi di Sicilia* — Napoli, 1923.

se dy vjetë: Më 1869 për arësye e grindje politike vihej në dispozicjon. Atëherë, më 1870, vinte në Romë e aty niste të drejtonte për disa vjetë (1871-1874) fletën politike „*La Riforma*“ e cila mpronte interesat e së mëngjërtës.

Së fundi Gabrieli largohej edhe nga Roma e kthehej për gjithënjë në Girgenti, e aty, i nderuar për kulturën e gjërë e për bujarinë e tij të lartë, qe herë pas here këshilltar komunal, këshilltar krahinor, këshilltar shkollor e komiser i vjetërsivet. Vdiq në vilën e vet më 15 të Nëntorit 1885.

Gabriel Dara nuk qe vetëm një italjan i mirë, si shumica e këtyre arbëreshëve t' Italisë, po qe i mirë edhe për Shqipërinë, atdheun e tij origjinor. Lindur e rritur n' atë atmosferë romantike të fillimit të shekullit të shkuar, e sidomos i ngrohur n' atmosferën më të nxehtë e më të gjallë tradicjonale të familjes së tij, në të cilën më parë i gjyshi Gabriel Dara plaku, doktor në Drejtësi e mjeksi, kishte bërë një mbledhje këngësh shqipe t'Arbëreshëve t' Italisë, e pas këtij i biri Ndreu e kish vijuar punën e t' et në mbledhjen e këngëve e lërimin e gjuhës shqipe, Gabriel Dara *i riu*, bir e nip i denjë i dy të parëvet, duke ndjekur gjurmat e tyre, jo vetëm që u kujdesua për fatin e Shqipërisë së robëruar, si e dëshmojnë letrat e shkëmbyera me atdhetarët shqipëtarë më të njohur t' asaj kohe, po i fali letërsís s' onë edhe një nga xhevairet më të kulluara: *Kënkën e sprasme të Balës.*

b) Analizë e veprës

Kënka e sprasme e Balës nuk u botua dot prej auktorit të saj. Më 1887 Zef Schiró-i nisi botimin në shtyllat e revistës së tij „*Arbri Rii*“, po vetëm n' atë të Lorecchio-s, „*La Nazione Albanese*“ poemi doli i tërë gjatë vjetëve 1900-1902, e më 1906 në vëllim me vete, në Catanzaro.

Poemi, përkthyer italisht nga vetë auktori e kushtuar të kushëririt Pietër Chiara-s, të cilin e pati edhe si bashkëpunëtor në fletën „*La Riforma*“, ësht ndarë në katër pjesë e nëntë këngë: 3 këngë pjesa I, 1 pjesa II, 2 pjesa III, dhe tri pjesa IV.

Në këngën e parë, që ësht si hyrje e poemit, poeti nën trajtat e këngëtorit të moçëm *Bala,* i a nis vjershës duke i u drejtuar së *bijës së Lalës* — një nga kreshniket kryesore të veprës — dhe na jep të kuptojmë se do të na flasë pikërisht për këtë vashë, emëri i së cilës i shtie ndër mënt një përrallë *„plo ljot“*. Ndiehet që nga vargjet e para të kësaj kënge vajtimi i mallëngjyer i plakut Bala për kohën e shkuar kreshnike.

Kënga e dytë, me emërin *„Peralëza“* nuk ka ndonjë lidhje me këngët tjera. Esht vetëm një përkujtim i kohëve të Skënderbeut e sidomos i tradhëtisë e i pendimit të Mois Golemit. Munt të thomi se ësht e vetëmja pjesë këjo që s' ka të bëjë ngushtë me shtjellimin e mbrendinë e poemit. Aty gjëjmë të gjithë trimat e ushtarët shqipëtarë të mbledhur rreth zjarrit të darkës, me mbretin e tyre, Skënderbenë, në krye. Veç gjithëve, *„ballë-fshehur“* rri i madhi i Golemëve, Moisiu, *„me sit ungjur ndë dhe“*. I llaftaris gjiri i lehtë, pse në zëmër kujtimi i ditës së keqe i ka rënë si gur në det. Si në gjum i kujtohet ëmbëlsija e lëvdimeve me të cilat i faleshin katundet kur arrinte „Drankori Dibrës“, i kujtohet nderimi i ushtërisë, malli i vashave, zulma e këngëve... dhe rri tash i përbuzur e i turpëruar, pse *„e pushtron nata e shkret“*. E kupton mbreti i urtë këtë pendim e duke i u drejtuar të parit të Darenjve i jep të kuptojë të nipit se *„fteseza i të mirëve — spavet bëmshit të nderëme“*.

Në këngën e tretë *„vlastar i ljart i Petës“* Niku — protagonisti i vërtetë i poemit — ungjur mbí zall të përroit, në dritën e hënës, këndon një këngë të mallëshme për të bijën e Lalës, e dëgjon Dara, i magjepsur, dhe e këshillon të heqë dorë nga gratë e huaja. Po Niku i kallxon Darës tërë historinë e dashurisë së vet: si erdhi bashkë me Pal Golemin në tokat e princit të Lalës për të gjetur *„a zulm a varr“* e si e pa për herën e parë të bijën e princit; si luftojnë të dy trimat kundra Turqëve dhe i mundin; si i kërkon princit të bijën Niku dhe si zëmërohet nga këjo kërkesë Golemi, i cili thotë t' i u a lërë armëve fatin e vajzës. Po ndërhyn në mes të trimavet princi i Lalës, me emërin Kaur, i cili ka vëndosur t' i vrasë të dy djemët në gjum, dhe i këshillon prandaj t' a lënë luftën sonte,

pa nesër do të vëndosë ai vetë kuj t' i bjerë e bija. Atëherë, natën, vajza, që e kish kuptuar qëllimin e errët të t' et, zgjuan Nikun dhe e këshillon të largohet fshehurazi. Këtu poeti na përshkruan me vargje të prekshme, lamtumirin e tyre dhe besën që i japin njëri tjatërit. Pastaj na përshkruhet dyluftimi i Nikut me Pal Golemin, prap për punën e vajzës, dhe mrritja e papritur e Skënderbeut që i ndan dhe i merr me vete trimat.

* * *

Në këngën e parë të pjesës së dytë, Niku ngarkohet nga Mbreti të shkojë e të zgjuajë rojtarët. Gjatë kthimit, passi ndesh në Valkalje me Valëzat dhe i qëllon të matet me 'to, i zhytur në mendime vijon udhën, po një zë i papritur e përmënt dhe e bie në vete. Për një herë rrok shtizën e qëndron në përgjim: pas ca hapash ndien dhe sheh një hije për bind të madhe aqë sa nuk e nxinte udha: ishte dervishi Harun, i cili, passi i truhet trimit t' a mbajë kordhën, i thotë se nuk vjen si armik e i lutet t' a shpierë përpara Mbretit. Nisen prandaj të dy dhe vijnë n' ushtëresë. Aty në tëndën e lartë e të gjërë ishte mbledhur në këshill e tërë „*buljëria*". Kështu i jepet rasë poetit të përmëndë një nga një krerët e ushtërisë së Skënderbeut: „*Gropa e Strezi i vrerët, buljari i Sulit Spata i keq, Manëzi që kordhës i kumbisej, Ljeshi grund-ziu me Muzakjin për krahu e me trimin e Enkjëljinës, Kukji, Bezezi e Perljati, Zoti i madh i Xẹndes e madhe, Arianiti mirë-këshilli, Hamëza i mieghuluami, i urti Vrana-Konti, Mirë-shpia e plotë të tjerë*". Kur i sheh dervishi të gjithë këta trima, më parë çuditet nga madhështija e shkëlkimi i mbledhjes, pastaj i bie ndër këmbë me duarët kryq Skënderbeut e me fjalë t' errëta i shpjegon cilat qenë arësyet që e shtërnguanë të vijë gjër mbi malin e Mokreut. Po pas pyetjeve të Skënderbeut, që i urdhëron të flasë shpejt e shkurt, duke u dridhur dervishi i thotë se Ballabani me dymijë ushtarë si pas urdhërit të Sulltanit ësht nisur drejtë maleve të Moresë tek i bëgaçëmi Kauri i Ljaljës që t' i marrë të bijën. Më të dëgjuar këto fjalë, që e goditin thellë, Niku i

Petës del përnjëherë përpara trimave dhe i lutet Mbretit t'i japë urdhër të niset kundra Ballabanit.

* * *

Në këngën e parë të pjesës së tretë shohim Nikun me shokë të turren drejtë armikut e t' a presin këtë në pritën e Valkaljit. Vjen mbí kal në ball t' ushtërisë turke i pari Badheri a Ballabani, që mohoi vëndin e vet Shqipërinë. Këtij Sulltani i kish çuar një letër, në të cilën e porosiste të shkonte t' i merrte të bijën e Kaurit. Kauri për të shpëtuar fronin e vet i përkulet dëshirës së Sulltanit. Qan vajza kur e merr vesh, rreh gjirin, shkul flokët nga dëshpërimi, pastaj fsheh hidhërimin në zëmër dhe i truhet një zogu që të vejë e të lajmërojë Nikun.

Në këngën e dytë gjëjmë pikërisht fjalët që i drejton zogut e bija e Ljaljës, fjalë nga më mallëngjenjëset e librit. Pastaj vajza niset me armikun dhe as që shikon fare me sy vëndet e foshnjërisë, po lutej vetëm duke qarë me ngashërim mbí varrin e s' ëmës. Pas disa ditëve udhë, kur arrijnë një mëngjes në një vënt ku më tepër ngushtohej rruga, Badheri mban kalin dhe qëndron në përgjim ; pastaj, i qetësuar, vijon udhën. Po, ja, më tutje papritur kali qëndron vetë dhe nis të prapset. Duke nëmur trimi i bie, po kafsha e trëmbur prapset më e po atë ças zogu i malit këndon nga të gjithë shkëmbenjt. E dëgjon vajza e duke ulëritur hidhet nga shala e kalit. Ulërimës së saj një ulërimë e gjatë dhe e tmerrshme i përgjigjet nga të gjithë shkëmbenjt e nga çdo shkëmb një ushtar del. Ball për ball Badherit, si re e zezë plot shkeptim, duket Niku e me zë të bumbullimës i bërtet të lërë vajzën e të kthejë kurrizin. Kur e dëgjon tufë tufë shkul mjekrën tradhëtori dhe si i marrë gjëmon e u jep urdhër shokëve të vrasin gruan. Njëzet trima, aqë sa nxinte vëndi i ngushtë, i vërsulen, po vajza e urtë këcen mbí shkëmb dhe nxjerr nga gjiri një thikë për mprojtje. Të rrëmbyer nga bukurija e saj, Turqit, si të magjepsur, nuk luajnë vëndit. Po një prej tyre, më mizor e më guximtar, ngreh krahun mbi 'të. Atëherë një krismë e rëndë dëgjohet e të njëzet ushtarët bienë prapët mbí truall. Pas atyre dyzet të tjerë rrëxo-

hen, në sa pjesa tjatër u a japin këmbëve. Qesh e tallet Niku e i a dëften të vrarët Badherit. Po ky s' përgjegjet e befas ngreh shpatën t' i bjerë. E pret Niku me mburojë e tri copash thyhet shpata, pastaj i pret frerët kalit t' armikut dhe e çpon e e plagos këtë me aqë shpejtësi sa Badheri *„as e sheh as e dëgjon“* e kafsha me frerët ndër dhëmbë çduket si mjegull mbí kufomat e të vrarëvet. Kur sheh veten në mes të t' ikurve Badheri, rreh kryet me grushta e çjerr gjoksin duke sharë e duke gjëmuar nga turpi e nga idhnimi. Po Shqipëtarët dalin nga gryka e egër e duke i ndjekur armiqtë, i coptojnë e i grijnë të gjithë, gjër sa, të shëmbur me gjak, mblidhen rreth Nikut. Passi pushon pak gjëma e luftës dhe ulërimet dëgjohen së largu, vajza këcen poshtë shkëmbit e *„duke qeshur e duke qarë“* i truan nderin e vet trimit.

* * *

Në këngën e parë të pjesës së katërt, përbërë prej pakë vargjesh parandiejmë luftën e katastrofën e Valkalit, që, si e quan vetë auktori, ësht nyja e poemit.

Në këngën e dytë Mara, e bija e Ljaljës, del në çardhak e këndon një këngë — *Këng' e Beratit* — në të cilën vajton të zezat e luftës që u bë rreth këtij qyteti. E dëgjon e vjehërra, zonja Lenë, dhe e qerton duke e pyetur se mos ka parë ndonjë ëndërr të keqe. Pastaj nisen të dyja drejtë kodrave se mos shohin të këthehet Niku. Rrugës ndeshin në një udhëtar të moçëm, i cili me zi mbahej mbí shkop e derthte lotë pa pushuar. Dy gratë qëndrojnë dhe e pyesin pse qan. Edhe plaku fillon t' u dëftejë të zezat e luftës. Po kur e pyet Mara në mos ka parë *„sqifterin e Petës“* Nikun, plaku hesht. Vasha qan e ulërin me të madhe ; pastaj merr malet e çduket. Këtu kënga këputet.

Në pjesën që vijon këngëtori Bala përshkruan edhe ai ngjarjet e luftës dhe rrëfen se si kaloi me trimat e vet nëntë fusha e nëntë male duke vrarë e duke prerë Turq. Po gjatë kthimit ndër qindra mijëra të vrarësh sheh pranë urës një kal të rrëxuar e për dhe pranë kalit një trim me krahërorin të çpuar nga shigjeta : ishte Pal Golemi ! Bala turret t' i japë

ndihmë me shpresë se mos ishte gjallë ; e ngreh dhe e shtrin aty ku bari ishte më i butë dhe i lag faqet me ujin e lumit. Përmëndet Pal Golemi, po e kupton se s' ka shpëtim, prandaj i thotë Balës t' a lërë të vdesë në fushën e nderit. Pastaj i lutet t' i dorëzojë mbretit flamurin, që e mban ndër dhëmbë e t' u thotë ushtarëve të tij se Pal Golemi nuk ka vdekur, po ka për t' u zgjuar sa herë që të dëgjojë britmën e luftës, dhe më në funt e porosit që t' i varë armët e tija në një lis, që kështu nga shkëlqimi dhe nga zhurma e tyre të trëmbet armiku e mos të guxojë t' afrohet. Pastaj mbyll sytë për jetë. Kthethehet Bala nga shokët t' u thotë t' i përgatitin varrin Golemit, kur i sheh këta të bjenë një trim tjatër të plagosur : ishte shoku i të parit, Niku, i cili sa po e sheh Balën i thotë : „Mos më qaj, vëlla, po ktheu n' ushtëresë e thuaj Darës se Niku, dhëndër i ri, u preferoi Valkalin defrimeve dhe valleve. Një qint qënë m' u vërvitën, pastaj Badheri më plagoi nga pas. Thuaj edhe nënës s' ime se Niku iku e s' kthehet më, po një bijë i lë : nusen t' ime. Pastaj ngjitu në çardhak, shko më përshëndet të bukurën e jepi këtë unazë". Kështu flet edhe Niku e shuhet *„si kandili pa vaj"*.

Në sa shokët e Balës bëhen gati t' i varrojnë dy djemët, një vajzë u shfaqet si hije : „O ju trima, u qofsha truar — pyet ajo — mos patë këtej një kalorës të ri, me një krenare të artë, me nji qift mbi 'të ?" Trimat shikojnë njëri tjatërin në sy dhe s' përgjegjen. Vajza zbehet, i vëren një nga një, pastaj këthehet, sheh Nikun të shtritur mbí truall e i bije sipër *„e ftohët si bora"*.

Gjënden dy varre në Valkal : në njërin fle Pal Golemi dhe mbi 'të ka mbirë një lis. Fle në tjatërin Nik Peta : vasha e Lalës i dergjet pranë. E aty mbi një selvi „mbiu edhe një mollë e bardhë. Kur të thahet selvija do të thahet edhe moll' e bardhë.

Kështu merr funt poemi.

c) Vlera e veprës

Për të kuptuar gjenezën e *„Kënkës sprasme të Balës"* a influkset nën të cilat u gjent auktori i saj kur e shkroi poemin, duhen pasur para syshë këta dy faktorë kryesorë : a) *përhapja*

e Romanticizmit n' Itali dhe b) *veprimtarija poetike e De Radës ndër kolonitë italo-shqipëtare.*

— Gabriel Dara, si thamë më lart, jetoi n' atë kohë kur Romanticizmi gjerman frëng e anglijas, duke kaluar Alpet, përhapej e vërshonte mbrënda një kohe fare të shkurtër të gjithë botën letrare të gadishullit italjan. Kjo rrymë përveç një „mënyrës" së vet krejt të veçantë e në kundërshtim të hapët e në kundërshtim të fortë me botën klasike, e përveç „sjelljes romantike", gjë e posaçme e Romanticizmit, vlen në mos tjatër, të përmëndet ndonjë çfaqje e jashtëme e më e thjeshtë e kësaj rryme që karakterizoi më një farë mënyre të gjithë romantikët e kohës: *mbledhja e studjim' i këngëvet popullore, imitimi i tyre nga poetë me talent që fshiheshin nën trajtat e ndonjë këngëtori anonym popullor, dashurija e flakët për atdhe e për të gjitha traditat kombtare, me të gjitha pasojat e saja.* Natyrisht edhe Dara që jetoi në këtë kohë e që u gjent në qëndër të Rilindjes italjane, nuk mbeti jashtë kësaj lëvizjeje së re letrare kulturore. Edhe Dara, si shumë të tjerë të kohës së tij, u tërhoq nga këjo rrymë poetike që hapte horizonte të ra e të virgjëra në fushën e artit.

Po influksi romantik nuk qe i vetëmi që drejtoi e udhëhoqi veprimtarinë poetike të Darës. Më i fortë e më i gjallë qe ai deradian, i cili përmblithte në vetvete edhe të parin.

Ç' bën Dara në përpilimin e poemit të vet? Edhe ai, pas gjurmave të De Radës, po i influencuar edhe prej të gjyshit e prej t' et, i u drejtohet këngëve popullore shqipe e nga këto frymëzohet, duke nderuar masën e thurjen e tyre; edhe Dara, si romantikët e kohës, fshihet nën trajtat e poetit anonym duke na shpjeguar në parathënjen e veprës se ai nuk ësht auktori i „*Kënkës sprasme të Balës*", po ësht ky Bala, shok i moçëm i Skënderbeut, i cili, i ardhur n' Itali, nuk e harroi dot dhenë e mbretin e vet e këndoi këto këngë që u ruajtën në gojë t' Arbëreshëvet gjër sa u mblodhën më parë prej të gjyshit, pastaj prej t' et Darës e më në funt nga Gabrieli vetë. Edhe Dara, pra, bën se kur i zë besë hypothezës së De Radës për sa u përket këngëvet popullore të mbledhura prej këtij në vëllimin

e lartëpërmëndur, e na thotë se si ai këto këngë të mbledhura nga i gjyshi e nga i ati, i rënditi, i qepi, i plotësoi aty këtu gjër sa prej tyre doli një poem i vetëm e i plotë.

Nga sa u tha e u krahasua kuptohet faqeza kështu se poeti i ynë punoi nën influksin e Romanticizmit e sidomos të De Radës. Po duhet shënuar se ky imitim, ky influks, qe i përcipët në veprimtarinë poetike të Darës: nuk shkoi përtej frymëzimit e trajtave të përjashtëme. Duam të thomi se Dara respektoi vetëm një „mënyrë“, vetëm një „modë“ t' imponuar prej romantikëve në Europën perëndimore e të përjetësuar prej De Radës në letërsín shqipe, po nuk e imitoi, nuk e kopjoi edhe lëndorisht këtë. Madje në shum pika ai u largua nga mjeshtri i tij, e në shum pika, sidomos për sa i përket arkitekturës së poemit, ai i a kaloi mjeshtrit e doli mê i përsosur se mjeshtri vetë.

Nga De Rada Dara dallohet për ekvilibrin, për njesinë, për simetrinë e masën e përpjestimevet të ruajtura besnikërisht në përpilimin e poemit. Jo më errësirë, jo më fragmentarietet të pa shpjeguarshëm e copëtim e përleshje epizodesh, vetash e ideshë, po dishka harmonike, dishka të plotë e të këthiellët gjëjmë në veprën e Darës, ashtu si munt të krijojë vetëm një mëndje e matur e e qetë.

E Dara u dallua edhe prej romantikëve tjerë sidomos nga këjo pikëpamje: pse me gjithë frymëzimin poetik që pati prej tyre, prap se prap nuk u largua krejt nga parimet e klasikëvet. Ai në përpilimin e poemit të vet i u mbajt të gjitha rregullave që këta na kanë lënë trashëgim në farën epike: një subjekt të vetëm që zhvillohet mbrënda një kohe së shkurtër, lufta e Valkalit; një kreshnik kryesor, Nik Peta, i rrethuar prej vetash tjerë; elemente të mrekullisë, si ndeshja e Nikut me Valëzat, paraqitja e Dervishit Harun, fluturim i zogut lajmtar etj. Vetëm që auktori ka ditur t' i adoptojë aqë mirë këto rregulla, pa u larguar nga zhvillimi i natyrëshëm i këngëvet popullore, e ka ditur aqë mirë të shtjerë se kinse këto këngë nuk u shkruanë, po vetëm u mblodhën e u qepën prej tij, sa që leçitësit as i vete mëndja që vepra të jetë përpiluar nga një njohës i thellë

i Homerit e i Virgjilit.—Vepra e Darës prandaj doli diçka e re, diçka origjinale në fushën e epikës europjane, pse Dara edhe duke ndjekur rregullat klasike të kësaj fare, nuk e imitoi Homerin ashtu besnikërisht si e kanë imituar kaqë poetë të tjerë europjanë. Me fjalë tjera në këtë rasë Dara, nj' a 30 a 40 vjetë më parë bëri atë që do të kryente më vonë Gjergj Fishta në këtë fushë e për të cilën arësye vepra e poetit të math të veriut ësht konsideruar si krejt origjinale 1).—Prandaj „*Kënka e sprasme e Darës*", për sa i përket strukturës së saj, munt të mbahet si një nga poemat më të plota të prodhimit letrar italo-shqipëtar e shqipëtar.

As e kanë lënë të thatë Darën kujtimet e vepravet kaloriake të letërsís italjane e europjane. Toni kaloriak, — jo imitimi — i këtyre veprave vlon në të gjithë poemin e tij. Ndjenja e nderit dhe e trimërisë, vrapi drejtë aventuravet për të kërkuar zulmë a varr me armët, dyluftimet e rrepta e të furishme në mes t' armiqve a të trimave që i u digjet zëmra për të njëjtën vajzë, bukurija e cilësitë e rralla të këtyre, ndienja e besnikërisë e e lealizmit e sjelljet bujare e të rafinuara të heronjvet, me gjithë vrullin e furín e karakterit të tyre, janë të gjitha nota t' asaj kalorësije, që fisnikëroi më vonë zakonet e sjelljet e egra e barbare t' invazorëve nordikë të fillimit të kohës së mesme në përpjekje me qytetërimin latin. Herë herë ndonjë përshkrim në veprën e Darës, si p. sh. ai i krerëvet shqipëtarë të mbledhur në këshill rreth Skënderbeut, që çohet si vigan mbí ta, ka pushtetin e bukurinë plastike të një përshkrimi homerik. Pse me të vërtetë homerik ësht ky Gropa e ky Strezi i vrerët, ky Spata i keq, bujar i Sulit, ky Manëzi që rri si një shkëmb mbështetur mbi kordhët, e ky Lesh grund-zi në mes të Muzaqit e të trimit t' Engjëlinës, e ky Arianiti mirë-këshilli i urtë e gojë-mjaltë si Nestori.

Po, me përjashtim të këtyre copave fort të rralla, përgjithërisht një e metë vrehet në poemët: mungesa e fuqisë epike.

---

1) Po nuk besonj që Fishta t' a ketë njohur veprën e Darës kur shkroi «*Lahutën*».

Dara, ndofta pse ka dashur t' imitojë së tepërmi këngët t' ona popullore, nuk ka ditur të shkojë, si De Rada në „*Milosaat*“ — vepër lartësisht lirike — përtej thjeshtësisë e spontaneitetit të këtyre këngëve, që, me gjithë bukuritë e paçmuara që fshehin në gjirin e tyre, prap se prap nuk ngrihen dot kurr në radhën e kryevepravet individuale artistike. Ai mbeti pra në lartësinë e këngëtorit anonim; nuk shkoi dot më tej. Heronjt që krijoi fantazija e tij po sa janë vizuar prej poetit, po ai nuk qe i zoti t' i mbarojë, t' i plotësojë, t' i ngjyrojë këta heronj, as diti të depërtojë e të zhvillojë psikën e tyre të pëshjelluarshme. Me një fjalë, vepra e tij paraqet të gjitha vetijat e të gjitha të metat e këngëve t' ona popullore e prandaj edhe kritika, pa teprime, në këtë drejtim duhet t' a shqyrtojë veprën e Darës, e cila, me gjithë të metat, munt të mbahet si një nga më të mirat e prodhimit t' onë letrar.

Për t' u lëvduar ësht pastaj edhe këthjelltësija e gjuhës dariane e shija e bukurija e prozës së tij ashtu si na paraqitet në parathënjen e librit.

ç) Nga shkrimet e Darës

1) Para-thënëme 1) *t' Arbréshëvet* 2)

Prindët t' ân, çë kur, ikur 3) Arbrit, 4) erdhën e stisën 5) katundin 6) i 7) Paláz-Adriánit 8), ndë vitin 1482, ruatin 9) po 10) çeljur 11) ndë zëmmërën, kujtimën 12) e malin 13) Atërîs 14) sbiérr 15).

Veçoritë e alfabetit të Darës janë: *gk* = g, *kj* = q, *ts* = c.

1) *para-thënëme*, parathënje. — 2) *t' Arbreshëvet*, Shqipëtarve. Në kolonitë arbëreshe t' Italisë fjalët Shqipëri e Shqipëtar nuk njihen; përdoren vetëm ato më të vjetërat *Arbër* e *t' Arbresh*. -- 3) *ikur Arbrit*, passi iknë nga Shqipërija; fjalí kohore përbërë vetëm prej participit. Ndër né trajta të tilla ndiehen rrallë, e ndër shkrimtarët aspak. — 4) *Arbrit*, nga Shqipërija; vërè përdorimin e ablativit të thjeshtë, kurse na përgjithërisht sot, sidomos në gjuhën e shkruar, e përdorim këtë rasë te shoqëruar nga parafjala *prej*. Po trajta e parë ndiehet edhe në gjuhën e popullit. — 5) *stisën*, ndërtuan, themeluan. — 6) *katundin*, shum shkrimtarë italo-shqipëtarë e kanë me kuptimin *qytet* „città“, kurse për kuptimin që i japim na përdorin fjalën *fshat*. -- 7) *i*, ësht një nga karaktəristikat e dialektevet italo–shqipëtare përdorimi i nyjës së përparëshme *i* që përciell gjinoren pas një kallxorje, kurse na përdorim gjithënjë *e*. — 8) *Palaz-Adrianit*,

Ati birit, e biri nipit, rëfiejn 16) punët të shkëljkjieme 17) e ljuftat të nderëme, 18) tsiljat 19) u ljuftuan ndë mon 20) e Skënderbegut; se 21) ahíera 22) vetëm për-së-pari, 23) e, aljëmeno, 24) për-së-sprásëmi, 25) gjith Buljëria, 26) gjith trimëria 27) e Arbrit, burra e gkraa; pljekj e të ri, patën një zëmmër, tue dashur ndérien 28) e ljefterín 29) e dheut ç' i ljeu, 30) e çë do njeri desh e deshën të gjith 31).

Andai, 32) asaj 33) përzitie 34) shéite, 35) u ljê fukjia çë për një-zet-e-pes viet frajin 36) mundien 37) e Turkjëvet, e përpiti, 38) njerën pas t' jetërën, 39) ushtrat 40) e Zotit Math, 41) tek-ai 42) çë Europa e përmisëme 43) lavej, 44) sa i gjegjej 45) embrin.

Pas-andai, 46) e pra çë 47) u shua, vit nka 48) vit, te varri çë e mbljodhi, 49) zulma 50) e madhe e ljartit Kastoriotit, 51) u

---

koloni shqipëtarësh në Siqili. — 9) *rualin*, ruajtën. — 10) *po*, gjithënjë, kurse për adverbin lidhor përdor *por*. — 11) *çeljur*, ndezur; këtë kuptim e ka edhe ndër né. — 12) *kuitimën*, kujtimin, shëno gjininë femn. — 13) *malin*, dashurinë. — 14) *Atëris*, atdheut; neologjismë. — 15) *sbierr*, së humbur, bjerrun. — 16) *rëfiejn*, rrëfenin; shum prej këtyre trajtave foljore — po edhe të tjera morfologjike e fonetike — me interes vetëm gjuhësor për lingvistët, ndëgjohen në krahina të ndryshme të Shqipërisë. — 17) *të shkëljkjieme*, e shkëlqyera. Sheno nyjën *të* që përciell kallxoren në shumës në vënt të *e*-së që përdorim na. Adjektivat e prejardhur nga emërat në dialektet arbëreshe trajtohen gjithënjë me prapashtimin *m*. — 18) *të nderëme*, të nderuara. — 19) *tsiljat*, të cilat; Arbëreshët dëndur nuk e përdorin nyjën e përparëshme të adjektivavet. — 20) *ndë mon*, në kohën; kuptimi më i dendur i fjalës *mot* pranë auktorëve ësht *kohë*. — *se*, pse. — 22) *ahiera*, atëhere. — 23) *për-së-pari*, për të parën herë. — 24) *aljëmenò*, mjerisht, fatkeqësisht. — 25) *për-së-sprásëmi*, për herën e funtme. — 26) *Buljëria*, gjithë bujarët. — 27) *trimëria*, djalërija; kuptimi më i dëndur i fjalëve *trim trimërí* ësht *djalë djalërí*. — 28) *nderien*, nderin. — *ljefterín*, lirinë. lirimin. — 30) *ç' i ljeu*, që i lindi, që i polli. — 31) *e çë do njeri desh e deshen të gjith*, e çdo gjë që deshi një njeri e deshnë të gjithë, d. m. th. se ishin të gjithë të një mendjeje e të një vullneti, jo të përçarë. — 32) *andai*, prandaj. — 33) *asaj*, nga ajo. — 34) *përzitie*, bashkim. — 35) *shéite*, *e* shënjtë. — 36) *frajisi*, dërmoi, theu. — 37) *mundien*, pushtetin, fuqinë. — 38) *përpiti*, përpiu, gëlltiti. — 39) *pas tjetrën*, pas tjatrës; vëre ndërtimin e parafjalës *pas* me kallxoren. — 40) *ushtrat* ushtëritë. — 41) *e Zotit Math*, e Sulltanit. — 42) *tek-ai*, në sa. — 43) *e përmisëme*, e përmbysur. — 44) *lavej*, trëmbej, frikësohej, tmerrohej. — 45) *gjegjej*, ndegjonte. — 46) *pas-andai*, pastaj. — 47) *pra çë*, passi. — 48) *nka*, nga; na thomi: *vit për vit*. — 49) *mbjodhi*, me kuptimin ital. „accogliere“. — 50) *Zulma*, fama, buja, emëri, zëri

ftohën edhè shokët e tij; ju ljipsë 52) bésa ; u sgjëljoth 53) nieja 54) e zëmmëravet; kush u shpruar 55) këttéj, kush atei ; 56) zun 57) e suljën 58) ndër tâ ; 59) katûnd mé katûnd, fâr 60) me fare, çet 61) me çet ; e prâ 62) sosi 63) se 64) armiku i kekj ju ngulj ndë mésët, e si ndodhëshin të ndâr, shprishur 65) e gkërisur, 66) i zepsi 67) nën njëi 68) zëgoi 69) hekuri, e pra i xarrisi 70) gjith, 71) te 72) gjith ljivadhet 73) e apoljés, 74) sa 75) të derdin 76) për të huajin gjákun arsitur 77) horës 78) vet.

Çë ahíera embri i Arbrit u harrua ndë mon, 79) e ajo hor e aí gjak, tsiljët kishin thamasur 80) jetën 81) bëmashit 82) urtëris ; 83) kjëntrùan nd' érrët, 84) njëra 85) më naní ; e daft 86) Perëndìa sa të shuhet nëma 87) e moçëme, çë gkërisën 88) gjinden t' ân, ljêr 89) sa te zotroft 90) në 91) shtrëngohëshin 92) prap ndë përzitën të pâr, Krështênj 93) e Maomettan, 94) Katoljik e Orthodhox çë të kljofshin 95) tue lojasur 96) se jan vet 97) t' Arbrêsh!

Por naní prirem 98) atíe nka zura 99).

---

etj. — 51) *Kastoriotit*, Kastriotit. — 52) *ju ljipsë*, i u mungoi. — 53) *u sgjëljoth*, u zgjith. — 54) *nieja*, nyja. — 55) *u shpruar*, u suall. — 56) *atei*, andej. — 57) *zun*, filluanë. — 58) *suljën...*, t' i binin njëri tjatërit, nisnë të grindeshin. — 59) *ndër tâ*, në mes të tyre. — 60) *fâr*, ka kuptime të ndryshme, këtu *fis*. — 61) *çet*, Dara e përkthen me ital. „classe", klasë shoqërore. — 62) *prâ*, pastaj. — 63) *sosi*, mbaroi, puna mori funt. — 64) *se*, që. — 65) *shprishur*, të shpërndarë. — 66) *gkërisur*, të coptuar. — 67) *i zepsi*, i zgjedhoi. — 68) *nën njëi*, nër né parafjala a adverbi *nën* do gjithënjë kallxoren ; kurse këtu gjinoren, ndoshta si pas ital. „sotto di una". — 69) *zëgoi*, zgjedhë. — 70) *xarrisi*, hoqi xvarrë. — 71) *gjith'* të gjithë. — 72) *te*, tek. — 73) *ljivadhet*, fushat, fusha lufte. — 74) *apoljés*, lindjes, Orientit. — 75) *sa*, këtu : që. — 76) *të derdin*, të derdhin. — 77) *arsitur*, mohuar. — 78) *horës*, vëndit. — 79) *ndë mon*, shprehja ësht ital. „nel tempo". — 80) *thamasur*, çuditur. — 81) *jetën*, botën. — 82) *bëmashit*, punë të mëdha historike, shpreh kuptimin e fjalës it. „gesta". — 83) *urtëris*, kuptimi mė i dëndur i kësaj fjale ësht „trimëri" it. „valore". — 84) *kjëntrûan nd' errët*, mbetën n' errësirë, fraza ësht ital. „rimasero al buio". — 85) *njëra*, gjër. — 86) *daft*, dashtë. — 87) *nëma*, mallkimi. — 88) *gkërisën*, copton. 89) *ljêr*, lindur. — 90) *sa te zotroft*, që të zotrojë, për të zotruar ; vër rè se fjalitë qëllimore e lidhore janë ndërtuar në këtë dialekt prej lidhzave *sa të*, në vënt të *që të*, të pasuara nga optativi i foljes e jo nga lidhorja. — 91) *në*, në qoftë se. — 92) *shtrëngohëshin*, na thomi : në qoftë se shtërngohen ; po folja e tekstit si pas ital. „se si stringessero". — 93) *Krëstênj*, të kristerë. — 94) *Maomettan*, muhamedanë. — 95) *çë të kljofshin*, thomi më thjeshtë : qofshin. — 96) *tue lojasur*, duke kuptuar ; folja *lojas*, ka kuptime të ndryshme : *kuptonj*, *mendonj*, *dyshonj*, *përfytyronj*, *vegoj* etj. — 97) *vet'*, vetëm. — 98) *prirem*, këthehem. — 99) *zura*, fillova.

Pas vëdékien e Shkanderbegut, e pas çë [100]) me dhiêt viêt ljuftash e përrenjësh gjakut [101]) më të kulhùamit, [102]) ruatin ndë Krojen ndèrien e ljefterîn Atërîs, më të mirëte më t' urtit [103]) Buljêr, [104]) dëljpëkuar [105]) fljámurat, e të heljmuar, jo múndur, [106]) u shprishën [107]) ndër te hùajit, [108]) tue sbiêrr horën, sa mos t' e nderrojn [109]) me bésën e ndèrien. Ndër këttá, të parëshit, [110]) prindët t' ime, [111]) se [112]) nomotísën [113]) njëra sot, Mbërkuri e Njanji i Dhárënjëvet, gjërinj Kastoriotit për ân [114]) e Voisávës, së jëmës e t' ij, së biljës e Prënkut, [115]) Mirëditëvet *(Filia Principes Tryballorum* — MARINUS BARLETIUS). Por mbi gjith prindët të mî, te të mbljedhurit kuitimat [116]) të moçëme e „KËNKAT E PLJEKJËRIS", lartonen gjishi [117]) jm, Gavrilj i Dharënjëvet, e ati jm Ndriza [118]) (In-Zot i bekoft!) se naforisën [119]) gjëlhën t' ire, [120]) sa të kokjisin, [121]) nca dërmak, [122]) zulmën e gjindes t' ân, për sa [123]) moti i bustër [124]) s' e shkelji, e s' e pështroi. [125])

Gjishi jm mbljodhi për-së-pari [126]) „KËNKAT E PLJEKJËRIS" tsiljat, pas atë, kan kljën piés e piés tipografisur [127]) nka Peshpëku [128]) Crispi, [129]) nka Dimitri Camarda [130]) e nka tiérët, çë kan ndëljgkúar [131]) sa vëljén ndéria e Arbrit.

---

100) *pas çë*, i përgjigjet ital. „poichè". — 101, *gjakut*, të gjakut. — 102) *më të kulhúamít*, vër se se si emri si edhe adjektivi që e pason janë në trajtën e shquar; na thomi: të gjakut më të kulluar. — 103) *t' urtit*, trimat. — 104) *Buljêr*, shumësi i „Buljar"; vër ré këmbimin e *a*-s në *e* në shumësin, karakteristikë e shumë emërave në të folët arbëresh — 105) *dëljpëkuar*, porsi paluan. — 106) *jo mundur*, jo të mundur. — 107) *u shprishën*, u shpërndanë. — 108) *ndër tê húajit*, në dhe të huaj. — 109) *sa mos t' e nderrojn...*, d. m. th. deshnë më mirë të humbisnin vëndin e tyre se sa t' a ndërronin këtë me besën dhe nderin: me besën, pse po të qëndronin në Shqipërin e pushtuar prej Turqëve duhej ndofta të bëheshin myslimanë, siç u bënë shumë prej vëllezërve tjerë që qëndruanë; *nderin*, pse nuk u dorëzuanë. — 110) *të parëshit*, nga të parët, nënkupto „qenë". Vré ablativin shumës në *shit*. — 111) *t' ime*, e mi. — 112) *se*, që. — 113) *nomotisën*, kuptimi i vërtetë ësht „emërohen" si pas ital. „si nominano", po na thomi „përmënden". — 114) *për ân*, na thomi: nga ana. — 115) *Prenkut*, princit. — 116) *të mbljedhurit kuitimat*, emërat verborë pasohen nër ne prej gjinores, këtu prej kallxores, si pas ital.: „nel raccogliere le memorie". — 117) *gjishi*, gjyshi. — 118) *Ndriza*, Ndreu. — 119) *naforisën*, bënë theror, flí. — 120) *t' ire*, e tyre. — 121) *sa të kokjisin*, që të mblidhnin koqe koqe. —

Ndë mésët e shkruamevet [132]) e t' íj më të fëshéhurat e më shtréitat, [133]) ati jm gjéti, pas „*RËKJIMEVET* [134]) *E NIK PETËS E PALJ GOLJEMIT*“ njétër [135]) kënk, tsilja tek e shkruamia dukej kljuar [136]) „KËNKA E SPRASEME [137]) E BALËS“. Ishin do [138]) viêrshe [139]) ç' i xënuan [140]) zëmmërën, pse nxejn [141]) një rëfime [142]) të pljot, të sosëme [143]) e adiásëme [144]) té piesat e s' aj, më mírë edhé se KENKAT E KOSTANTINIT E TË GARENTINËS.

Vrap ati jm ndëljgkoi se këto viérshe cljofshin [145]) do tsopash, mir a ljik, [146]) traposur; [147]) e tue sgkëljedhur, [148]) lojàsi se ljipsëshin shum piés; pse e shkruamëja ngkë [149]) silëj [150]) t' ietër se tri-zét [151]) viershe e të parës piés; akjë së ditës, e pak më shum e së tretës. Më e më u ndënd [152]) ndë këtë drúetin, [153]) tue pâr, ndë këmbën [154]) e fjétës, këtá porosima. [155])

„Bala, ai çë bëë [156]) këta kënka, klje një ushtor i math, „atirve [157]) çë me Gjergjin Mirë-shpin [158]) stisen këtë Katund, „ikur [159]) këttu pas vëdekien e Shkanderbegut, e pas çë ra Kroja, „e, me të, gjith Arbri, ndë duarët e Turkut. Pljekjet e pljakat

---

122) *nça dërmak*, çdo thërrime, thërrime thërrime. — 123) *për sa*, si pas ital. „per quanto“. — 124) *i bustër*, mizor. — 125) *s' e pështroi*, s' e mbuloi. — 126) *për-së-pari*, i pari, ital. „per il primo“. — 127) *tipografisur*, shtypur. — 128) *Peshpëku*, peshkopi. — *Crispi*, mblodhi kangët populllore të kolonivet të Sicilis, të cilat u botuen prej Leonard Vigo-s (Catania, 1857). — 130) *Camarda*, „Appendice alla grammatica albanese“. — 131) *ndëljgkúar*, kuptuar, si pas kuptimit më të vjetër që ka edhe në latinishtet. — 132) *e shkrúamevet*, shkrimeve. — 133) *me shtréitat*, më të shtrënjtat. -- 134) *Rëkjimevet*, renkimeve. — 135) *njétër, një etër*, një tjetër. — 136) *kljuar*, quajtur, titulluar. — 137) *e spraseme*, e funtme. – 138) *do*, disa. -- 139) *viêrshe*, vargje, „versi“. — 140) *xënuan*, prekën. goditën. — 141) *nxejn*, nxinin, përmbanin. — 142) *rëfime*, kallxim. — 143) *të sosëme*, të përkryer. — 144) *adiásëme*, të përkueshëm, të përshtatshëm. — 145) *cljofshin*, na thomi: t' ishin. 146) — *ljik*, keq. — 147) *tuposur*, të lidhura, të shkuara në fill, të qepura. 148) *tue sgkëljedhur*, duke lëçitur, duke lexuar, ashtu si e kanë edhe shkrimtarët më të vjetër të veriut. — 149) *ngkë*, nuk. — 150) *silëj*, sillte. — 151) *tri-zet*, gjashtëdhjetë. — 152) *u ndënd*, u var. — 153) *drúetin*, ndrojtje, dyshim. — 154) *ndë këmbën*, ital. „in calce“, në funt. — 155) *porosima*, vërejtje, oroe. — 156) *bëë*, bëri. — 157) *atirve*, nga ata. — 158) *Gjergjin Mirë-shpin*, Giorgio Buonacasa, i cili udhëhoq Shqiptarët në vj. 1482 për në Palazzo Adriano. — 159) *ikur*, këtu: passi u shpërngulën, emi-

„rëfienjën [160]) njëra [161]) sot (1765) se Bala ish një pljak i gjelj-
„bër [162]) e i rëmashëm, [163]) pa-përzit [164]) me njerëzit, se shkoj [165])
„dit e muaj tue vatur mbi çiukat e maljëvet u faljur [166]) Arbrit;
„e do hêr te velat [167]) e shpatëvet, [168]) tue ligjeruar me vetëhên,
„e tue vaituar shokët e trimërís t' ij, gjakun athún [169]) derdhur
„e naforisur atëris e ljefteris s' aj.

„Her e her, kurë bushtëronej [170]) dimbri, e maljet me fu-
„shat sbardëlonshin [171]) borës, kërrusej [172]) ndë ân vatrës, e
„gkëzonej tue rrëfier vashavet e kopiljëvet punët at' ij moti, çë
„aî e kljuaj „*Moti i math*". Bala, çë thom u, shihet njera sot
„zografisur [173]) te hroaza [174]) nkritur [175]) ndë kljishën e Shën
„Mëris e Hirëvet, përjashta, [176]) fitir [177]) çeljur, hund-ngrehur,
„me shapëkën [178]) të kukje, me majen t' arët ndë karkalin, [179])
„si zakona [180]) e ushtorëvet t' ân".

Tata [181]) s' desh t' ietër; zu e rrioth ljart e posht si kjên ndë
gjên, [182]) tue pier [183]) pljekjëvet e pljakarushavet, ndo dishin [184])
„KËNKAT E BALES" e pak këtu e pak këtie, mbljodhi gkolj nka
gkolj, [185]) më të shumat pies çë ljipsëshin shkruamëvet e prin-
dit; e ja shtoi. Ashtu „KËNKA E SPRASËME E BALËS" muar
kurmërë, [186]) e, do thosha, u shpi [187]) e tër ndë gjith piesat e
s' aj; e ndo ju ljipset donje tzopëz këtu e këtie, dëmi isht [188])
i ljê, pse me trut t' ân mbljonjëm [189]) ata pak të mbrazëta [190]).

---

gruan. — 160) *rëfienjën*, deftejnë, kallxojnë. — 161) *njera*, gjër, deri. — 162) *i gjeljbër*, për të thënë se ish edhe plot gjallësí, plot jetë, i ri. — 163) *i rëmashem*, i ashpër, i vrazhdë. — 164) *pa-përzit*, që s' përzihej me njeri, rrinte i vetmuar. — 165) *shkoj*, kalonte. — 166) *u faljur*, për t' i u falur, për të përshëndetur. — 167) *te velat*, te thellësitë, thellësinat. — 168) *e shpatëvet*, e pyjeve. — 169) *athún*, kot, më kot. — 170) *bushtëronej*, nga „bushtër" mizor: bëhej mizor, italianisën „incrudeliva". — 171) *sbardëlonshin*, sbardhulloneshin. — 172) *kërrusej*, strukej. — 173) *zografissur*, i pikturuar. — 174) *kroaza*, piktura. — 175) *nkritur*, me kuptimin: ruajtur. — 176) *përjashta*, jashtë katundit. — 177) *fitir*, fytyrë. — 178) *shapëkën*, tarogzën. — 179) *karkalin*, stoli sipër tarozgës, ital. „cimiero". — 180) *zakona*, fem. për mashk. *zakon*. — 181) *tata*, im at. — 182) *ndë gjen*, në gjah, në gjahun. — 183) *tue pier*, duke pyetur; shëno përdorimin e dhanores në vënt të kallxores, si pas ital. „chiedere a qualcun..." — 184) *dishin*, dinin. — 185) *gkolj nka gkolj*, gojë nga gojë, talian. „di bocca in bocca". — 186) *muar kurmërë*, italian. „prese corpo". — 187) *u shpi*, u shvillua, u shtjellua. 188) *isht*, ësht. — 189) *mbljonjëm*, mbushim.

U, prana, [191] çë arrëita [192] i treti e i sprasëmi, e kurë gjindia e moçëme s' ish më ndë jetën, pak gjeta e pak i shtova, po sa [193] vetëm „KËNKËN E ZOGHUT“ xën [194] çë mirenxie, [195] se pra, sa sgkeljodha „KENKEN E BALES“ më duku [196] e më duket, ljer [197] e kuluame trush çë pual [198] t' ierat, e se shtonet [199] vetem [200] vendit tek u e kam klitur. [201]

2) KËNKA E SPRASME E BALËS

Nga Piesa e Parë

BALA

Mori, bilj, bilj e Ljaljës,
Mori e bukurëz e mbriturëz,
Psé më síel ndë mon shkuam ?
Njo, miégkula e érrët
Rogkomiset malj, malj ;
Díelit ljér maljit Gkropës
Tundet, kjésh' spati i humbët;
Po, si ti, i bardh, i thielët
Skjépi i kjélit të reshtet
Me një rréth të pa-sosur
I rrimët, si ninëza e jote.

— 190) *të mbrazëta*, zbraztina, golle, it. „vuoti“. — 191) *prana*, passi. — 192) *arrëita*, arrita, mërrita. — 193) *po sa*, i përgjegjet ital. „se non“, veç. — 194) *xën*, nxënë, mësuar. — 195) çë *mirenxie*, që foshnje. — 196) *më duku*, m' u duk. — *ljer*, lindur. — 198) *pual*, polli. — 199) *shtonet*, këtu : lidhet. — 200) *vetem*, vetvetiu. — 201) *klitur*, vënduar.

II. — 1. *Ljaljës*, „Ljalja ish një horë ndë maljët e Morês, e vân t' i jisin (e shkuanë të banonin) çë do t' Arbrésh ikur, kur Baljci i tréti, përzën Turkjëshit, u mbljoth te Malji-i zí. Pas çë do (disa) viét, zoti i Ljaljës ish një Komnen : një këtsish Komnen pât t' ish *(qe)* Kauri, prindi i *Vashës e Ljaljës*, të tsiljës (për të cilën) fljét këjo kënkë',. — 2. *mbritúrëz*, e mëritur, auktori përkthen : melankolike. — 3. *shkuam*, kaluar. — 5. *rogkomiset*, rrëxohet teposhtë. — *malj*, *malj*, mal më mal. — 6. *díelit*, në dhanore si pas ital. „al sole“ ? na thomi: në diell. — 7. *i humbët*, i thellë ; gjíthë frazën ndreqe : spati i humbët tundet, kjesh (në) diell ljêr maljit Gkropës. — 8. *i thielët*, i kthiellët. — 9. *të reshtet*, të shtrihet. — 11. *i rrimët*, i kaltërt. — *ninëza*, bebja e syrit, minza.

Ziarmit i paravérës
Céljen gjith réhjezit,
E kamënoi hi-fitîr
Véte é ljoset me rêt,
Gkëljân kënkës mëruame
Çë síel era për së largu.
Tas, kopiljëzat par-bréz,
Marr nka njera dor me dor,
Të thërrésënjën ndër Válet:
Pa-kuidés këmba e dieljmëvet
Bredhën rënd ndër kankjeljet,
Se kân zëmmërën tek-tî.
Se ti ljulje e hol e maljëvet,
Se ti e para e Vashërîs,
Ets atié, ku te haréa
Dérdhet ari i motit pâr,
E dhrossîs zëmmërëzën
Ëndrës ëmbljës e mennatës!
Ljëja pljakut, ljêja Balës
Ljiset érrëta, shtrushin ljumit,
Çë pataksur maljìt égkër
Punon himën me përrenjët,
Si kufia ime e shkrét
Më punon è përvëljon
Me të moçëmet kuitíma.

---

12. *ziarmit*, nga zjarmi. — *i paraverës*, i prenverës. „Te paravéra, te dita e Rëshait, isht zakon e Arbréshëvet te stolisënjën ljuljesh e kurorësh diert e parathirat (dritaret) e nusëvet; e pra valet vên mbi réhjët e çéljënjën ziarmin i paravérës". — 13. *çéljen*, ndizen. — *réhjezit*, kodrat. — 14. *kamënoi*, tymi. — *hi-filîr*, ngjyrë hiri, i thjermë. — 15. *ljoset*, zhduket, tretet. — 16. *gkëljâr*, i gjashëm, që i ngjan, posi. — *mërúame*, mjeruar. — 18. *tas*, ja, qé. — *kopiljëzat*, vashat. — *paa-brez*, „Vashat t' Arbrésha së nkjéthënjën (nukë ngjeshin) brez, as síelënjën kez; por pljéksënjën (thurin) këshétat me fluturaka (kordele) fitir-çeljur (me bojëra të hapëta). Brézi, kéza e shkjépi përkesënjën të martuamet". — 19. *nka njera*, secila. — 20. *të thërrésënjën*, të thërresin. — 22. *bredhën*, këcen. — *kankjéljet*, këngët, po këtu me kuptimin „këcim, valle". — 24. *e hol*, me kuptimin ital. „delicata": e ajthët, e njomë. — 25. *e Vashërîs*, emër kolektiv, si graris etj., për të thënë „e gjithë vashave". — 27. *dérdhet ari...*, koha e kaluar ësht

Di-zét hér krahu i dimbrit
Râ mbi Honin e mbi Brinjën,
E i pështroi è i sbardhëloi ;
E akjë hêr bljeruar ârat,
Tek argkomazit e Fushës,
Çë kur mbljodhi dhéu i huaj
Të ikurit, pa-fànëmit,
E çë ahiera gkëzim,
Më ngkë shképti kësaj nât
Çë mbi trut m' u kumbís.
Kam te sit, è fljutaronjën
Viet, trima e punë të shkúame,
Sí kur era nderron rét,
E përveshur è xarrísur
I përzê me frimë e gjî.
Moti shkon i pa-ljojasur
Mbi te shkrétin deljmêr ;
Por mbi balët e ushtorit
Bien, si pljumb, këta-vo-dit,

---

gjithënjë koha më e lumtur !. — 28. *dhrossîs*, argto. — 29. *ëndrës*, dhanore për „në ëndrën“ si pas ital. „al sogno“. — 30. *Ljêja*, lërja. — 31. *ljiset*, lisat. — *shtrushin*, zhurmën. — 32. *pataksur*, duke u rrëxuar. — 33. *punon*, bën hulli, brazë. — *himën*, shpatin, pjerrsinën. — 34. *kufia*, mendimi. — 36. *dizet hêr...*, d. m. th. se kishin kaluar dyzetë vjetë. — 38. *Honin...*: „*Honi*, *Brinja*, *Lazi*, *Muzëkat*, *Gkropa*, *Pënoi i Shtogkut*, *Pilia* e të tiera janë gjith émbre çë t' Arbréshët, t' ikur, kjelëtin te horët ku erdhën të jisin, e gjënden këtu e këtié, pse i kuitonjën Arbrin è katundet, nka u nisën. Ashtu, si shkruati Virgilii, bêri Eleni me Trojanët e t' ij, t' ikur ndër Haonët (Çiamët të sonëmet) Liber III Aeneid. „*Procedo et parvam Trojam, simulataque magnis — Pergama et arietem Xanthi cognomine rivum — Agnosco, Scaeaque amplector limina portae*“. — 39. *bljeruar*, nënkupto „u patën bljeruar“. — 41. *argkomazit*, ital. „maggese“: disa prodhime që dalin në muaj të Majit, ase ara a toka e papunuar një vit. — 43. *pafanëmit*, fatkeqët. — 45. *shkepti*, shkrepi. — *m' u kumbís*,, kuptimi ı fjalës ësht „mbështetem“, po këtu si pas ital. „posarsi“; na thomi : më ra nata në krye... — 50. *përveshur*, të çapërdisura, ital. „sconvolte“; shkon më ret. — *Xarrisur*, të hequra xvarë, nënkupto „ret“. — 52. *i pa-ljojasur*, i pakuptuar ashtu siç thomi edhe na : s' e kuptova fare, aqë shpejt më shkoi koha. — 53. *le shkretin*, të vetëmin, pa njeri. — *dëljmer*, bari.

Se me duar të ftohëta
Brënta varrit e shtinjën;
E këta dit ljimontîs
Farmekosëme jam, Vash,
Si vëdékia, Balës.
Psè ki krah, nani i njom,
Shumë hêr stëloi stilin
Nder ushtorët, è bëmat t' ân
Shumë hêr me veljdîm
Van ndër gkëljuh të bukuravet.
  Naní ç' etsënj te shkrétira
E kjëntrova gjal è zî,
Fora e rivet më ljê
I harruar nd' ankon.
  Po ti vet (si rrëmb kjèli
Ljeth è ljeth dimbrit bushtér
Çion të mierin dëljmêr
Sbierr te humbia e Lazit
E e gkëzon me oht è drit)
Ljipsiare këkjes s' ime,
Me mua vien nd' errësir.
  E njato, përpara sivet
Kam buljèrët, të rrenkëtit,
Të vrërët è të heljmuar,
Si m' u dukën për-së-largu

---

57. *e shtinjën*, e shtyjnë. —— 58. *ljimontîs*, papunësije, përtacije. —— 59. *farmékosëme*, të hidhura. —— 60. *Balës*, dhanore; vargjet 58-60 ndreqi: „E këta dit ljimontîs, Vash, farmekosëm jan Balës (për Balën) si vëdékia". —— 61. *i njom*, i ligshtë, i lodhur, i këputur. —— 62. *stilin*, heshtën, patërshanën. —— 64. *veljdim*, lavdim. —— 65. *van ndër gkëljuh*, shprehja ësht ital. „corsero nelle bocche...", do të thotë se vajzat bisedonin, zinin në gojë punët e tyre të shkëlqyera. —— 67. *zî*, si pas ital. „oscuro", i panjohur, i papërmëndur. —— 68. *fora*, guximi, krenija. —— *e rivet*, e të rinjve. —— *ljê*, më lë, më braktis. —— 69. *ankon*, në një cep, në një kënd. —— 70. *vet*, vetëm. —— *rrëmb*, rreze. —— 71. *dimbrit*, në dimrin. —— *bushtér*, mizor. —— 72. *çion*, gjen. —— 73. *te humbia*, te lugina. —— 74. *oht*, ngrohtësi, voksi. —— 75. *ljipisiare*, e mëshiruar, —— 77. *njato*, ja, qé. —— 78. *të rrenkëtit*, të fuqishmit.

Çiukat maljëvet harepsur,
Kur nka deiti ju falja
Për-së-sprasëmi è më ngk' i pash !
Se ju, bilj motit math,
Hapët nj' udhë lamparisëme
Ndër thelat e vitëravet :
Zulma j' uaj kljê diel
Mbi jetën përmisëmen,
E ajo eshtrat ju shkëljkjên
Po si dieli edhe perënduar,
Se me ziàrm è me shkëndilje
Mbljon suvaljat trazuame.
Por ushtorët së duan héljme,
Së duan kljar... Ndo, ti e dafshe,
Embri jit më çeljën
Një përràlëz pljot ljot.

---

81. *harépsur*, të gëzuara. — 82. *ju falja*, i përshëndeta. „Këta fialj na kuitonjën zakonën e t' Arbrêshëvet e Palaz Adhrianit, se nka vit, ndë ver, hipin mbi Maljin i Trëndafiljëvet, è andài, piêrr Apoljes, i faljëshin Arbrit e Koronit i Morés, nka u nisën të ditët t' ikur, tue këntuar kënkën, çë zij fil :

O e bukura Morè,
Si të ljura (të lash) e më ngkë të pê! (pash)
Atié kâm zotin tat,
Atié kâm zonjën mëmë,
Atié kâm t' im vëlézër,
Atié kâm motrat t' ime !
O e bukura Morè,
Si të ljura è më ngkë të pê !

84. *bilj*, bijë. — 85. *lamparisëme*, të shkëlqyershme. — 86. *thelat* thellësitë. — 91. *shkëndilje*, shkëndija. — 92. *trazuame*, të trazuara. — 94. *së duan kljar*, nuk duan të qahen, të vajtohen. — *ndo*, në, në qoftë se. — *e dafshe*, e dashtur. — 95. *jit*, yt.

Nga e dita pies

PLAKU

. . . .
Ndë shpërvièr, i ljârt e i gjër
Rij e mbljedhur buljëria,
Tek matej opoljipsi,
Punët, drèa, druetia e ljuftës.
Ish Gkropa è Strezi, i vrërët
E me tâ buljari i Suljit
Spata i kétij, njohur kënkës
Prei Vashës Mbrétërésh,
Se ja vodhën për dhûn
E ai dhunën lau me gjak.

---

1. *shpërvier*, tënda. — 2. *rij*, rinte. — 3. *opoljipsi*, urti, dije, mëndje. — 4. *punët*, me kuptimin ital. „impresa", ndërmarrjet. — *druetia*, dyshimi. — 5. *Gkropa*, „Zakaria Gkropa kjê një nka më t' urtit buljer, e shok i nderëm i Skanderbeut. Tue ljuftuar i vétëm me të vétëm, vrau më t' urtin e ustorëvet e Amuradit. Gkropa pra çë vëdikj Mbréti, me t' ierët, erdhi e stîsi katundin' i Palaz-Adrianit, é la embrin e tij Maljit i Gkropës, çë nkritet nka ana e Apoljês e katundit". — *Strezi*, „i biri i Gjelës, së motrës e Skanderbéut, kljuar Goiku-Strezi. Kish një vëlâ, çë ja thoin Gjerghi. — *i vrërët*, i vranët, i zymët. — 7. *Spata*, „Ki ish Sgkur Spata, i nipi i atij Njanj Spata, i tsili, pas Tsutsës (Pietër) Ljoshës, zotroi mbi Toskjit e Ipirit, Akarnanies é Etolies afër vitit 1374. Peralëza rrëfien se Sgkur Spata, i nisur nka Sulji, vate sa te kerkojë zuljm e ndêr te Mbretëria e Karljit të ditit çë ja thojn Toku, prenkut i Kjefalonies, Zantit e të Shënt Mavrës. Atje njohu e klje njohur nka Puljëzena, e bilja e Mbrétit, e u déshën, pse ajo ish e bukurë e e ndëljgkuame, e ai trim i urt e i aksëm, sa mos njerî i buljerëvet e Karljit mundëj t' i rrij përpara më këmb e nkaljuar. Skoi i pari vit, e Spata tek-ai çë Karlji bënëj këshil me buljerët e Mbrétëris, u vû ndë mesët e i thâ: „Zoti Mbréti, me thêljim (leje) u të ljip për gkrua s' atë bilj: nđo u ndodhet njeri më i mir se û, û e prés ndë ljivadhin, nd' ân derës e Apoljês tri dit e tri nât, më këmb e nkaljúar". E vate. Priti tri dit e tri nât, e mos njeri buljar u duk. Tek e katërta nat, Sgkuri vodhi vashën Mbrétëresh, e vû mbi gkaljen (galé, ital. „galea"), e e soli ndë nisizën (ishull) e ljikjerit e Ianies (Janinës), e atie u bën darêshëm të mbëdhâ, tek u mbljodhën gjith buljérët e Arbërit. Shkuar një muaj ndër harê e haidî, Sgkuri pat të véj ndë ushtret, e si e zun buljerët Frenk e Tokut, vatur bashk me një kopé ljuftarësh, gkënjien (gênjyenë) gjinden e Spatës, e muarën pa-hir vashën, e e prun me ta mbi gkaljen

Manëzi kordhës kumbisej,
Burr bëmash, jo fiâljësh.
Mbi ljikurën një arîu
Rij Ljeshi grund-ziu,
Me Muzakjin për krahu
E me trimin Enkjëljinës.
Kukji, Bérrëzi e Përljati.
Zoti i math i Zendës e madhe
Gjiukojn shtuara me tâ.
Arianithi mir-këshili

---

e ikën. Sgkuri u pruar nka ushtret atë menat, e pra çë nkë gjêt më ndë shpî nusen, pa thën gjë mos-njeriu, hipi mbi gkaljen e tij, e passi (ndoqi) Frënkjët e i arreiti afër Zantit, e atiê, përpara sivet e ushtërës e Tokut, çë pështroj rrëzën (ranishten), therti buljerët Frënk, çë i kishin viedhur nusen, e u pruar ndë shpî, me vashën, e i nderëm, tek u kish nisur me dhun. Pos çë Arbri u sos, Spatërat, me t' ierët buljer, ikën nd' Italin, e Palj Giovi, e tiera shkruaz (shkrimtarë) e motit, fljasën nkaljorit Spata, si një buljari i math e i urt. Thuhet edhe se shpia e Prenkut Spada i Romës u ljê nka ki nkaljor Spata". — *njohur kënkës*, d. m. th. se ishte vënë në këngë. Edhe sot një nga dëshirat më të mëdha të malësorit t' onë *,,âsht m' u vù në kângë"*. — *prei...*, për shkak. — 11. *Manëzi*, „nj' étërë buljâr i shkljuar, çë edhe ndë ljivadh i mblitur (të mbyllur), vráu një Turk, të mirëshit". Famigliet Gkropa e Manëzi ish farë e fis i Kastriotëve, dhe patnë njerëz qi u dalluan në luftë kundra Turqëve, siç e dëshmon edhe një letër e mbretit të Siqilisë Gjon i Aragonës: „*Per litteras Illustrissimi Ferdinandi* (Mbret i Napulit) *comendati sunt nobis Petrus de Pravatà, Zaccarias Croppa, Petrus Cuccia et Paulus Monisi, nobiles Epirotae, strenui et clarissimi et invictissimi Ducis Georgi Castriota consaguinei*, ecc. — *kumbisej*, mbështetej. — 14. *Ljeshi*, ,,Ljeshi Alezi (Gjergji) pas pak mot te punat thënë nka Bala, vrau Baderin Balabanin". — 15. *Muzakjin*, ,,Gjin Muzakji ish i shokji i Vlaikës, të motrës e Skanderbeut''. — 16. *trimin Enkjëljinës*, ,,Timi i Enkjëljinës ish Mazakji, i biri i së motrës e Skanderbeut, i dashur shum nka unkjëlji prei urtesîn e tij". — 17. *Kukji, Berrëzi...*, ,,Gjerkj Kukji, Nik Berrësi, Njanj Perljati, Krispi edhe tà buljer të ljert e të shkjuame ndë ljuft e ndë keshil''. — 18. *Zoti i math i Zendës*, „Ish Stefanoi i Baljcit, per mbi embër Cernojevich a Cernovich. Ki ish i kushëriu i Baljcit trétit, e degkës e Baljcënjëvet — Despota, çë zotroin mbi Zendhën të përposhëmen e mbi Maljin-Ziun. Këjo shpî mbéti ndë Arbrit njera ndë vit 1552, e prâ, perzën edhe ajo Turkjëshit, të shprasëmet kokje erdhën ndë Sicilien, e stisën katundin e Shënt-Enkjëlit i Musharit, tek mënon njera më naní fara e s' aj". — 19. *shtuara*, në këmbë. — 20. *Arianithi*, „Arianithi-Topia Goljemi, kljuar, si thot Barletii, edhe Komneni, Kommati, Komniati (Arianithes, Cominatus). Kljé thën *Topia i math* e zotroi mbi

Afër Mbretit mbi thron
Fialj të dishëme vij ndë mest
Drit e fanëme nd' errësîr.
Atjé Hameza i miégkuluami
Hahet vrerit; ndë e vërrefshe,
Gkëljar shkëmbit bumbulissur.
Ljêr ndë spness e Mbrétërîs,
U verbua ndë spness të verbër,
E nd' udh strëmbër u shpruar;
Por arreiti dita e kekje;
Me te huajin e piksi;
Nderies, zuljmës e géshi.
Mbrè, kush isht ai Zot-i math
Balj-i ljart, se gjith mushkjëshit
Çiohet siprë buljërîs,
Maje gkuri mbi ata réhje?
Nën te kukjin losnik
I shkëndien kumbura e arët...
Ish i urti Vrana-Konti
Vranai zëmëre e krah ljisi.
Sa gjykon, një kjint fâr
Çeljënjën kënkën e ljuftës

---

horët çë reshten nka Vojuza, njera te déiti i Artës. Arianithi u ndoth penk te Turkjit më par se të biljët e Njanj Kastriotit; por i shpëtoi di viét përpara se Skanderbeu, e smolji (çoi në këmbë) Ipirin, Kurveljen, Kaninën, Tepelenin, Nivizën e Himarën. — 22. *vij*, vinte. — 23. *e fanëme*, e mbarë. — 24. *Hamëza*, ish i biri i Stanizit Kastriotit, të vëlaut i Skanderbeut. Stanizi kljé kljnar Turkjëshit Karaguzi. — 25. *hahet vrerit*, hante veten, pse tradhëtija e kaluar i brente ndërgjegjen. — 26. *gkëljar*, posi, i ngjante. — *bumbulissur*, i goditur prej rrufesë. — 29. *u shpruar*, i u suall; na thomi: „mori rrugë të keqe. — 27. *ndë spness e Mbretërîs*, i lindur, me shpresë që të trashëgonte fronin e Skanderbeut, pse ky nuk ish martuar edhe. — 31. *e piksi*, e zuri. — 32. *e geshi*, e xhveshi. — 34. *gjith mushkjëshit*, që me gjithë çupa. — 36. *maje gkuri*, si një majë guri. — 37. *losnik*, mallotë. — 38. *i shkëndien*, i xixëllon. — *kumbura*, parzmak. — 39. *Vrana-Kont*, „Vranai. Barletii e kljuan *Vranacontes*, t'ier *Urana*. Fara e Vranenjëvet mënon njëra sot Palats-Adrian, por kan ndërruar të parën ljepush V ndë G, e nkë kljuhen më *Vranai, Vranesha*, por *Granai, Granesha*". — 41. *sa gjykon*, këtu me kupti-

Një kjint fljamur shiel era,
Një milj kordha ljën milin.
Ljëmoj kjimen ljankorit
Mirë-shpia pa-kuidés
Se te sit i gjeljbërojn
Réhjet Janies e t' ij.
Rin, ljikjerëthi të ndehet
Shésh i rrimët, i thiéluam,
E suvalheza e rrahuar
Çë te shprishet ndër këmb,
S' isht e bardh sa gjiri jt
Çë shtin ljinjën kjëntisur,
Gkëljar miégkulës të hol
Ndër di réhjez me bor.
Gjirit fritur shërtimashit,
Rin, spëtonjën rëkimet;
Era i merr e i siel zotit,
Zotit t' ënd çë i ndëljgkon,
E sit njomur me ljot
Fëshéh me dor è athun i fëshëh!
Por çë thom è çë kuitonj?
Trimat e Arbrit njera një
Bëjn këshil asaj nât,
Çë ndër tâ i huaji u klit.
Për-së-pari me thamasm
Rréth vërreiti ata të ljêrt,
E i magjèpsur ulji sît;
Pra, duar nkrikjëz ndë gji
Per këmb Mbrétit u përmis.

. . . .

---

min: po sa flet, po sa hap gojën. — *far*, fis. — 45. *ljëmoj*, lëmonte. — *ljankorit*, langoit. — 46. *Mirë-shpia*, „Gjerkj Mirë-shpia ish i Zoti i Ianies a Janinës. Pas çë vëdikj Skanderbeu e pas çë ra Kroja, Mirë-shpia iku me t' ierët e kjê vën për krie e buljervetë çë stisën Palats-Adrianin ndë vit 1482". — 49. *Rin*, Rina; mënt e Mirë-shpisë fluturuan tek e shoqja e tij e tek kodrat e gjelbëra të Janinës. — 50. *shesh' i rrimët*, që ësht si një shesh i kaltërt. — *i thielúam*, i këthiellët. — 54. *shtin*, shtyn. — 55. *gkëljar*, miégkulës..., linja e qëndisur mi gjirin e Rinës duket si miegullë e hollë në mes dy kodrave me borë. — 57,

Nga e tréta piés

KËNKA E ZOGKUT

. . . .

Naní ç' ërth ndë Valj-Kalj,
Zoti i Math i shkruati è i tha:
„Ets tek miégkula e Ljalës
„Pështron ilëthin të bardh
„Ilëthin bardh çë do jét
„Drit è gkaz stérvet t' an:
„E Kaurit te m' i thuash:
„ — Mbréti i Mbrétëvet të thot
„ — Ljësho dhrîn dhrîn të bardh,
„ — Çë m' u bî te kopështi jt:
„ — Paç pra kriet, edhe petkun
U pergjunj Bardheri è u nis,
E Kaurit i pru fialjën:
Kjenl-i-dhéut j' u truati,
e të biljzën i dhâ.
Vaiza kljaiti, rrahu gjirin
Shkuli kripët, u përljip;
Pra si e urt çë ajo m' ish

---

gjirit fritur shërtimashit..., këto dy vargje ndreqi: Rin, rëkimet spëtonjën (të shpëtojnë) gjirit (nga gjiri) fritur shërtimashit. — 64. *njera një*, d. m. th. të gjithë. — 65. *bëjn këshil*, bënin këshíll. — 66. *çë*, kur. — *i huaj*, dervishi, për të cilin bën fjalë e tërë këjo këngë e parë e pjesës së dytë. — *u klit*, u koll. — 68. *thamàsm*, çudí, habí. — 70. *duar nkrikjëz*, me duar kryq.

III. — Vargjet 1-21 janë nxjerrë nga fundi i këngës I të pjesës së tretë me emrin „Humbia e Kusarit", për t' a lidhur më mirë vijimin e këngës që vjen pas.

1. *erth*, nënkupto: Badheri „Balabani". Emri i tij, i pari, ish Badera (Bidera?) e pra Turkjit ja than Balaban. U ljê i Arbrèsh, ndë hor e Petës, nën Kastriotin, prindësh të vabëkjësh e rëmorësh (bujqësh). Çë vogkëljëth kljê marr ropî (rop). Ljuftoi pra, nen Kralin e Shkljerëvet, Wlad, kljuar ndër Turkjit *Drakul*, vien me thën Diali, pse sa Turkj i bijin ndë duar, akjë vrit me bushtërî të kekje. — 2. *Zoti i Math*, Sulltani. — 6. *stérvet*, e pallateve. — 9. *dhrîn*, hardhinë. — 10. *m' u bî*, mbiu. — 11. *paç pra kriet*..., Sulltani i jep urdhër Badherit t' i marrë të bijën Kaurit, duke mos i cënuar, për shkëmbim, as „kryet" as „petkun", gjënë. „Tek ài mot kishin zakon Davljetët të mirrin gkra ndër biljat e Mbrétëvet e Prënkjëvet e Krëstenjëvet të mundur, e edhe e ëma e Ma-

Kliti héljmin ndë zëmmër
Vét se u truati zogkuthit,
Zogkuthit i maljit.
„Zogk é zogk krie-zez,
„Ti jê e filëme è e vetëm u jam ;
„Te shkretira ti vaiton,
„Këtu u kljanj nat è dit :
„Ti po shokuthin kërkon,
„U të dashurin m' e sbora :
„Jemi bashk ndë kopóse
„Kljofshim bashk ndë ljefterî.
„Por u e miera e penkuame
„Së kam krah, së mund shpëtonj ;
„Ti me krahëzit e erës
„Rahën maljët edhè fushat
„Sa të daft dëshërimi...
„Mbrè, ndo gjéfshe shokun t' ënd
„E gkezimin e zëmmërës,
„Vafshe edhè te trimi jm,
„Te i gjèljburi, te i bukuri
„T' i rrëfiesh hèljmet t' ime,
„Malin t' im të pasosëmin
„Tuke i thën : — Herës zéz
„ — Çë perëndove nd' errësir,
„ — E u paps ljeth, ljeth
„ — Krisma e ljê e këmbës s'ate
„ — U pataks kopëshit Ljuljes

homedhit të ditit kljé një e Krështerë". — 17. *u përljip*, u vesh në zi. — 21. *zogkuthit*, „zogkuthi i maljit, thomse, kljê ndo-një maljësor i besëm e i shpéit, i dërguar nka Vasha Nikut, sa t' i kalëzoj drên të s' aj e t' i ljipëj ndihëm". Kështu shtie e thotë auktori ; po këjo e zogut të cilit i drejtohet vajza si kur të ishte njeri që kupton e flet, dhe përgjithërisht të folurit e çdo lloj frymori vërehet dëndur në këngët t' ona popullore, pse në 'to e gjithë natyra merr shpirt e ka ndienja e gojë si njeriu. — 30. *e penkuame*, e penguar. — 33. *rahën*, rreh. — 34. *sa të daft*, na thomi : sa të dojë. — 35. *gjefshe*, gjetsh. — 41. *herës zéz*, prej asaj orës së zezë. Kujton çastin e lamtumirit të vajzës me Nikun. — 42. *perëndove...*, d. m. th. u largove, u ndave prej meje, e unë s' të pash më. — 44. *krisma*, zhabllima, rraptima. — 45. *u pataks*, këtu me kuptimin : *u përplas*.

„ — Nëma e kékje é u bê shkretir ;
„ — Gkazi sosi ndë rëkjim,
„ — Fora e vashës ndë ljënkjim.
„ — Nata e gjékj tue ljigjëruar
„ — Tue u truar hënëzës,
„ — Hënëzës, martrizës
„ — Malit, besës edhe të rremës
„ — Nd' atë her të pa-harruam,
„ — Çë të ljëroi vëdekjes
„ — Edhe hëna ljipsiare
„ — Pështroi héljmit vo-balët
„ — Me napëzën e miégkulîs,
„ — E gjith brinjat u shurdhuan
„ — Vait e ljehmezës te s' aj.
„ — Dita e pâ krip-shprishur
„ — Pa kuidès, pa haidhî,
„ — Edhe prindit shkarxier
„ — Edhe vashazit kjeshuar ;
„ — Por ajo së të harroi,
„ — Por ajo me bes të théll
„ — Priti, priti parin vit,
„ — Priti ditin, edhe trétin
„ — Trétin të taksurëthin ;
„ — Pra çë shkoi i tréti vit
„ — Edhe priti e nëng u ljoth.
„Mori, i ëmblji trimi jm,
„Thomse rê ndë vëdékurit
„Te ljivadhi i pa-kuituam,
„E farmëkosur botës
„Mua të filëmen harrove ?

---

51. *martrizës*, dishmitare. — 52. *malit*, e dashurisë. — *besës*, pse djali kish dhënë fjalën se do t' a merrte për grua. — *të rremës*, e gënjeshtrës ; pse trimi nuk ish kthyer si pas premtimit. Vajza pra ka hënën si dishmitare të dashurisë, të besës e të rremës. — 54. *çë të ljëroi vëdekjes*, që të shpëtoi nga vdekja ; vasha kujton atë kohë, kur e shpëtoi Nikun nga prita e Kaurit. — 56. *héljmit*, nga idhërimi. — 59. *vait*, nga vai. — *ljehmezës*, e nga ngashërimi. — 62. *shkarxier*, e përbuzur, e poshtruar. — 63. *kjeshuar*, e përqeshur, e tallur. — 72. *ndë vëdékurit*, ndër të vdekurit, d. m. th. vdiqe. — 73. *i pa-kuituam*, që s' mban

„Por vdékur nkë jê,
„Zëmmëra jme thot, è dî ;
„Se vdekur ndë kljofshe
„Naní ardëshe tek û,
„Me ëndërëzën e natës
„Të më sgkljidhie besën.
„Po një natëz u pâsh
„Pâsh Drekjëzen nkaljuar
„Mbi një rrëmbëz hënëtare,
„E me dorëzën të bardh,
„Më dëftoi dhéun t' ënt,
„Dhéun t' ënt të ljumëthin ;
„E ndë mesët dritës e s' aj
„Sbljoi një pame pa-rrëfieme,
„Sbljoi një ditë fljamuráre ;
„E ndër fljamurat e nderies
„U t' u fala, trim' i trimavet !
„Ndë jê i gjal, psè së prire
„Te ki gji çë laftarisën,
„Te këjo zëmmër të thieme ?
„Pse nkë vien è më ljëshon ?
„Njo, se prindi edhè më shiti,
„Si një kjenkez kasapit ;
„Njo se kjeni më vërviti,
„E më heljkjën pa-hîr

---

mënt. — 74. *farmëkosur*, i helmuar. — *botës*, nga dheu. — 79. *ardëshe*, na thomi : do të kishe ardhur. — 80. *me ëndërëzën*, na thomi : në ëndër ; besimi i ëndravet dhe se të vdekurit vijnë n' ëndër ësht një nga bestytnitë më të përhapura ndër popujt. Besohet edhe se kush flet n' endër me të vdekurit, a i sheh këta, vdes shpejt. — 81. *të më sgkljidhie besën*, fjala e dhënë ësht aqë e shënjtë për Shqiptarin sa e bën rop këtë t' asaj. Ësht e famëshme kënga e *Konstantinit e Garentinës*, në të cilën Konstantini, për të mbajtur fjalën që i kish dhënë s' ëmës, ngrihet nga varri e i siell kësaj të bijën, Garentinën. — 83. *Drékjëzen*, e bukura e dheut, fati, ora. — 89. *pame*, pamje, vegim. — *pa-rrëfieme*, që s' rrëfehet me gojë. — 90. — *fljamuráre*, si pas ital. „imbadierata", e veshur në flamuj. — 94. *laftarisën*, rreh, rekton. — 93. *të thieme*, e thyer. — 96. *ljeshon*, liron. — 99. *më vër-*

„Ku as mal, as nder, as bês.
„Se ti zogk ime e fanëme,
„Do t' i shtosh é t' i kuitosh
„Këtë të sprasëme të truame,
„E të mos m' e harrofsh!
„ — Mara e rrédhur armikjëvet
„ — Vien e shkon ndër vendet t' ënde,
„ — Affër ndeje è ti s' e dî!
„ — Por sa era e maljëvet t' ënde
„ — I sivasët volizit,
„ — E sa spnesa e ndihmës s' atë
„ — I ngjalët zëmmërëzën,
„ — Po do vinj, edhè do rronj;
„ — Pra nd'era e maljëvet t' ënde
„ — Pra nd'e ljëft ndihma e jote,
„ — Sa të dish se nderia e Marës
„ — Po me dielin perëndon,
„ — Se atë mal çë i pari e ngau
„ — Moti é vdekia s' e ndërron,
„ — Vetëm karmin xarrisur
„ — Do két meje i shkréti kjen,
„ — Psè këjo thikez e fëshèhur
„ — Këjo thik çë kam ndë gjî
„ — Do më ruanj nder è bes
„ — Do më jap ljefterî! —"
Ajo foli e zogka e gjékj,
Shkundi krahët è këntoi
Gkaza-vaiti një kënkë
F gjith maljin kumboi;
Pra muar erën ndë drêkj
E mbi rêt më perëndoi.

. . . .

---

viti, m' u vërvit. — 101. *ku as mal...*, nënkupto: ku s' kam as mall... — 104. *të sprasëme të truame*, këtë porosinë e funtme. — 106. *e rrédhur*, e rrethuar. — 108. *ndeje*, teje. — 110. *i sivasët*, do t' i dhelinj, do t' i limojë. — 112. *i ngjallët*, do t' i ngjallë. — 114. *pra*, pastaj. — *nd' era*, nënkupto: në qoftë se e lëshon, e braktis. — 116. *sa të dish*, me kuptimin: dije se... — 117. *me dielin perëndon*, çduket me diellin, d. m. th. se nuk çduket kurr. — 118. *i pari e ngau*, kupto: ai që qe i pari që më zgjoi dashurinë. — 121. *meje*, prej meje. — 128. *gkaza-vaiti*, duke qeshur e duke qarë. — 130. *ndë drekj*, drejtë.

Nga e katërta pies

KËNKA E BERATIT

„Se Berat, se Berat
(këntoi Mara atë menat)
„Sa të varfër ti ljure
„Sa të véa tue shkuljur krip!
„Dit vramie, dit e zéz
„Mos u prirshie ndë jét;
„Nata è vdèkia të kjuloft
„Mos dieli të gkëzoft!
„Katër ankonashit e jétës
„Vijn skjipun lojé, lojé;
„Gjith spelëshit e maljëvet
„Russhin bishka këtú è këtié;
„Gjak nd' erë, gjak ndë ré
„Gjak nd' uj, gjak ndë dhé;
„Gkurë nka gkurë një shkjer mish
„Krie a lore njei trimi kish!
„Zonja Mamëz atë nat
„Pát një ëndër kékj e gkëljat
„Se j u duk i Zoti i verdh,
„Me gjith kurmin xarr-xarr,
„E kurorëzit mbi-shtrat
„I pështroi me shkjep të zî;
„Holkj unazën për martess
„E ja ndaiti mbë di piés;
„Një e mbaiti, një ja dhá,

---

1. *Se Berat:* o Berat. — 3. *të varfër*, bonjakë. — *ljure*, lé. — 6. *mos u prirshie*, mos u këthefsh. — 7. *të kjuloft*, të vëntë në gjumë. — 10. *skjipun*, shqiponja, sqyferë, orrla. — *lojé lojé*, tufë, tufë, plima. — 12. *russhin*, zbris nin. — *bishka*, bishë. — 15. *gkurë nka gkurë*, gur mbi gur. — *shkjer*, copë. — 17. *Mamëz*, Mamica, më e vogëla e motravet të Skënderbeut, e shoqja e Muzak Topisë, që u vra në luftën e Beratit. — 19. *i Zoti*, i shoqi. — 20. *xarr-xarr*, copë, copë. — 23. *unazën për martess*, unazën e martesës.

„Pra u humb è gjë ng' i thá.
„Nate e dit ajo vaitoi
„E nka varri s' e rrëzoi".
Ashtu Mara më këntoi :
Së këntoj po rëkoj
E m' e gjegji nka poljia
Zonja Ljen è m' e kjërtoi:
„E përlipëme, Zonja nusë,
„T' u çelj kënka somenat;
„Ndo-mos ŋj' ëndërëz të kékje
„A vdékurit ti pé ?
— As m' erth nj' ëndër të kékje
— As vdékurit u pash :
— Por kam zëmmërën të thier
— E pa-hir më hidhen ljot
— Sa do shoh e shoh mbë zi...
— Bobo, bobo ! Niku jn
— Kurë u nis m' u héljmua,
— Edhè unazene më désh !
— Vémi, mo, vémi ndë rahj
— Tek sbljonen gjith fushat
— Ndo se Niku na u pruart !
Ván të nximet mbi rahj
E vërejn drékj e shtrëmbër,
Sa me trastën é me astenin
Pân përderëzin se kljaj.
„Se i përderëz mavrî,
„Paç uratën, pse kljâ ?
„Ndo mos kafshën të viédhur,
„A kaljivëzën të diégkur,

---

31. *poljia*, dhoma, kthina. — 32. *zonja Ljen*, e ëma e Nik Petës e vjehrra e Marës. — 33. *e përlipëme*, e përlotme, shkon me „kenka". — 40. *pa-hir*, pa dashur. -- *më hidhen ljot*, më derdhen, më këputen lotë. — 41. *sa do shoh*, çdo gjë që shoh. — 45. *mo*, mëmë. 47. *na u pruart*, na këthehet. — 49. *drékj e shtrèmbër*, më të djathtë e më të mëngjër. — 50. *astenin*, këtu : shkopin; ka dashur të përkëthejë ital. „bordone". — 51. *përderëzin*, shtektarin, ital. „pelle-

„A it birëthi t' u sbuar
„Ndër këtà amahjez të shkrèt ?
— As kafshën, as kaljivën,
— As birethin u kljâ...
— Sît t' ime u bën ljum
— Çë prei Arbrit kulon...
„Folj, ti zë i fatit kékj,
(thirri vasha, se i zu pik)
„Çë bushtërî ti pê nd' ushtrë ?
„Si râ Arbrî ndë ljip ?
„Folj ! ndër fljamurat e ljuftës
„Kjiftin Petës e prosekse ?"
U përgjégj krie-ziu,
„Thom, u thom se diè-menat
„Atiè, ljart nka Muzëkât
„Gjegjshin gjëm e lumbardhat,
„Gjëmëşhit, lumbardhashi
„Gjith jéta më gjëmoi,
„Kamënoi dufekjevet
„Gjith maljet miégkuloi ;
„Sbardhëlimit tzabievet
„Gjîth fushat më shkëljkjein,
„Gjakut ushtorëvet
„Mbljonëshin ljumërat,
„Tzopëshit stilëvet
„Bënëshin urë è stisëshin,
„Shtronëshin sheshe ndë Valjkalj
„E mbi shéshet nkrihëshin malj,

---

grino". — 52. *mavrî*, i zi. — 55. *kalĵivëzën*, kasollen. — 56. *t' u sbuâr*, të humbi, t' u vra. — 57. *amahjez*, luftëra. — 61. *prei Arbrit*, për Shqipërinë. — *kulon*, rrjeth. — 63. *i zu pik*, i ra pika. -- 64. *bushtërî*, mizorí. — 67. *kjiftin*, sqyferin. — 69. *dié-menat...*, „këta të para trimbedhiét viérshe e përderëzit ndodhen përzier ndër *Kënkat e Pljekjëris* me nj' etër kënk, prun Palaz-Adrian më vorë (vonë) kur erdhën Kororenjët. — 70. *Muzëkat*, Myzeqea. — 71. *gjëm*, gjëmime. — *lumbardhat*, krisma lumbardhash, topash. — 74. *kamënoi*, tymi. — 79. *mbljonëshin*, mbusheshin. — 80. *tzopëshit*, nga copat. — 81. *stisë-*

„Si suvala e détit bie,
„E pra priret ndë thél,
„E si arat të bljerëme,
„Tunden erës çë i njom,
„Véin è vijn, tue shtitur
„Gji me gji, ushtor me ushtor.
„Por ndë herën çë ljëshon
„Punëtori e jép sanoin,
„E përparath kaljives
„Kapëshon buk è krip,
„U ndërrua sivona e ljuftës;
„Pse nka e dréita, si shkeptim,
„U shtu Mbreti è shpoi gkardhin,
„Gkardhin shkrèt i patërshorvet.
„Tek bij korda e rënd
„Bijn krerët si bréshëri,
„E më shkoi me trikjimî
„Tuke shkéljur me murgiar
„Të vdékur è ljavosur;
„Tek-ai çë ndë stamëngh
„Dukagjini, se e pá
„Si një shkëmb mbi armikjet rá.
„Véç, ndër pielët, me Badherin
„Iannitzarët u stënkuan,
„Shtuar kurmin me kurmin
„E ljavuttën me ljavuttën,

---

shin, ziheshin, mbyllëshin, nuk kalonte më uji. — 85. *ndë thell*, në thellësirë. — 87. *i njom*, i përkul. — 88. *véin è vijn*, shkonin e vijnin. — *tue shtitur*, duke shtytur. — 89. *gji me gji*, si pas ital. „petto a petto". — 90. *çë ljëshon*, nënkupto: që smbren buajt. — 91. *sanoin*, sanën, barin e thatë. — 95. *nka e dréita*, nga e djathta. — 96. *u shtu*, me kuptimin: *ra*. — *Mbreti*, Skanderbeu. — 97. *patërshorvet*, auktori përkëthen: „*alabarde*": armë e përbâme prej njaj shtîze e prej nji hekuri në poftë të spatës. — 98. *korda*, kordha. — 103. *tek-ai*, kurse. — *ndë stamëngh*, më të mëngjër. — 104. *Dukagjini*, „Dukagjinët ishin dî: Niku e Palji è zoterojn (zotronin) mbi horët prej Drinit, ndë Zadrimën të sipërmen, njera te sinorët e Shkljerëvet (Barletius). Ngkë njihet tzili i të di Dukagjinëvet kljê Krie-ushtrie te ljufta e Valj-Kaljit". — *se e pâ*,

„Gkëljar ljedhi hékurimmëti
„Te i pa-tunduri, te i dremi.
„Athun trimazit, t' urtit
„Pokjën kriet nd' atë ljeth,
„Se ndë trual rân stëluar.
„Atë-her dhiét nkaljor
„Dhiét drangor rân mbi shpor,
„Dhiét gjëm ndë drédhurî,
„E ndë mesët u pataksën,
„Réshtur stilët si stavar.
„Shtun, vran, peljekjisën
„Nkritin malj këtu, përtéi,
„Malj vdékurësh e ljavossurësh,
„Hapën dier të gjër,
„Shtruan një udhë kékj e gkëljat
„Si vuljak ndër të mbièlja.
„Ashtu Drini i Zi ndë dhimbrit,
„Pljot përrenjëshit e maljëvet
„Arren fritur è trëbuam,
„Përpjek' ujërat ljikjerit,
„I merr-xarr è ndân ndish ;
„Nkrihet ljart suvalja e bardh,
„Epréth rrëzavet gjëmon ;
„Por si ujërat e ljikjerit,
„Pas çë ndaitur u kthien
„Priren vrap è bënjën shésh,
„Si edhé ljumin pështronjën,
„Ashtu bëri kopéa e bushta,
„(Pâr të pakët ç' e shtitën)

---

i cili e pa Mbretin. — 106. *veç*, më nj' anë. — 107. *Jannitzarët*, Jeniçerët. — *u stënkuan*, u shtërnguan. — 108. *shluar*, duke bashkuar. — 110. *gkëljar ljedhi hékurimmëti*, po si një mur i hekurt. — 111. *te i pa-tunduri*, i patundshëm. — *te i dremi*, i tmerrshëm, i frikëshëm. — 113. *pokjën*, përpoqën. — 117. *dhiét gjëm ndë dredhurî*, dhjetë vetëtima në mes të stuhisë. — 119. *reshtur*, duke përmbajtur, duke larguar. — *stavar*, auktori përkthen : „*antenna*", shulicë. — 120. *shlun*, përmbysën. — 121. *malj*, këtu me kuptimin : grumbuj, vandak. — 123. *dier të gjër*, dyerë të gjëra. — 124. *shtruan një udhë*, sheshuan, rrafshuan. — 125. *vuljak*, hullí, brazë. — 126. *ndë dhimbrit*, në dimër.

„Se e mbljedhur è e shtuame
„Mprapa dhiétëvet u mblî.
„Mbreti ahiera e Dukagjini,
„Shprishur t' ierët, u pruarën,
„Epan bashk mbi Badherin
„Mbala, aprapa, këtei, përtei
„Peljekjisur è rasbisur.
„Kjeni i shkrét zu è u sbithi,
„Por pa i sgkëljidhur è i tër
„Brënta vaut u mbljoth;
„Gkëljar ariut ì Tomorit
„Se deljmeshit përzën
„Njerin vrét, jétrin shkjier
„E ndo i gkërrisur è i përgjakur
„Po pa-drê ndë zëmmërën madhe
„Priret shpatit, nkà dual,
„Tzitur gjaku e tzitur mishi.
„Pra çë u kris, Mbréti u holjkj
„Me gjith ushtërën ndë fush;
„Çélji ziarmërat e natës
„E ljavosurëvet dha malj..."
— Mos të zëft nëma e zéz;
(Thirri Mara, si një e lavur)
— Kjift' i Petës me u mbljoth
— A e prosekse ndër ljavosur? —
Ai u kjét, e s' u përgjékj,
U verdhua me sî ndë trual

— 127. *pljot përrenjëshit e maljëvet*, i mbushur plot nga përrenjt e maleve. — 129. *përpjek'*, ndesh, has, takon. — 130. *ndân ndish*, i ndan më dysh. — 134. *pas çë ndaitur*, të cilat passi që u ndanë. — *u klhien*, u tërhoqën. — 138. *pâr të pakët...*, si pa se ishin të pakët ata që e shtynin, që e ndeshnin. — 139. *se e mbljedhur è e shtuame*, pse e mbledhur dhe e shtërnguar. — 147. *pa i sgkëljidhur*, pa u zgjidhur, d. m. th. i mbledhur e i shtërnguar ashtu siç ishte. — 148. *vaut*, grykës. — 150. *se dieljmeshit përzën*, i cili, i përzënë nga barinjt. — 151. *shkjier*, shqyen. — 152. *e ndo...*, e sado që... — 155. *tzitur*, i ngîm, i ngopur. — 156. *pra çë u nkris*, passi që u ngrys. — *u holjkj*, u tërhoq. — 159. *dha malj*, si pas ital. „diè cura", mbassi „malj" ka edhe kuptimin „kujdes"; na përkëthejmë: mjekoj. — 162. *me u mbljoth*, u tërhoq edhe ai me ushtarët

E i bijn ljot pik pik.
Ndëljgkoi Vasha è me një ulërim
Drék udhës m' u russ,
Jo se u russ, m' u rrogkomis
E prei maljevet perëndoi.

. . . .

. . . .

NAMIK RESSULI

---

14. — ZEF KAMARDA (1831-1878)

a) Jetëshkrimi

Ishte djali më i vogël i At Jan Kamardës, vëlla i denjë i albanalogut të math At Dhimitrit dhe i helenistit të çquar At Nikollës.

Lindi në Pianë më 19 Tetor 1831. Studimet e para i kreu në Seminarin italo-arbresh të Palermit. Jetën e vet të shkurtër e kaloi në vëndin lindor në mes të kujdesisë së familjes e në mes të studimevet të flakta të gjuhës shqipe. Mori pjesë në Komitetin revolucjonar siqiljan të vjetit 1860. Vuajti shum vjet me radhë nga një sëmundje e rëndë, e cila, në moshën 47 vjeçare, më 6 Dhjetor 1878, e shpuri në varr, në mes të pikëllimit të të gjithëvet, të cilët vajtonin mirësinë dhe virtytet e tij të zgjedhura.

Bashkëpunoi me vëllanë At Dhimitrin në kërkimet gjuhësore dhe letrare ; mblodhi këngë popullore e përshkroi një lëndë të gjërë poetike tradicjonale të botuar pjesërisht nga vëllai At Dhimitri e sidomos nga Zef Skiroi, në vllimin e tij „*Canti Tradizionali*".

Ka qënë — si ç' ka shkruar Zef Skiroi — një poet shum delikat.

---

e Skënderbeut. —— 168. *drek*, drejtë. —— *u russ*, zbriti. —— 169. *u rrogkomis*, u rrëxua. —— *prei maljevet*, nga ana e maleve.

E në të vërtetën na kemi nga Zef Kamarda poezi fetare dhe profane plot me ndienja e me vargje të ndërtuara mirë, të gjalla, me një gjuhë dialektore të Pianës të vetëtishme, të fres-këta, por të kjarta dhe të larta.

Fatkeqësisht prodhimi poetik i Zef Kamardës nuk ësht i pasur; por ky i pakët që kemi prej tij, i siguron një vënd të mirë në historín letrare të Shqipërisë.

Ësht e denjë për kujtim të veçantë poezija për nder të Dora d' Istrias. Ka lënë një provë të mirë proze shqipëtare duke u kujdesur për përshkrimin e Ungjillit të Shën Matheut në dialektin e Pianës botuar në London më 1868 me shpenzimet e Princit Lucian Bonapartit.

Nga Zef Kamarda përmendim: 1) Një letër në vargje të 20 Dhjetorit 1871, dërguar mikut të tij At Vinçęnc Skiroit me të cilin, në vargje të mira, kërkon ndjesë pse nuk ka mundur të shkruajë më parë nga shkaku se ka qënë i sëmurë.

2) Përkthimín në vargje shqipe të poezisë së Eliade Roduleskut për nder të Dora d' Istria-s (Janar 1871).

3) Një këngë për mëvitjen e vdekjes së babait të tij, që ay e kujton me dhëmbshuri të thellë biri e që e vajton me shprehjet e dhëmbjes më të gjallë.

b) Nga shkrimet e Z. Kamardës

I.

At Vinçenc Skiroit

Ti kee likj, se kam mënuar
e saa kaa ngë të kam shkruar;
po mbi gjith ka t'më kesh besë
se akjë shumë nëng' i ftes.
Me të ftetë, u kam një kollë
çë më bën të thaat e t' hollë,
e gjith gjirin më kaa shkjerrë
edhe' truut po m' i kaa nzjerrë.
Po nanì çë jam mëë mirë,

I. — 1. *Likj:* e drejtë, arsye. — *ka t' më keesh:* do të më késh. — *ftes*: verb, *kam faj.*

5. *Me të ftetë*: me të vërtetë. — *shkjerrë:* shkye, grisë.

jam e nzier ktë dëtirë,
e të thom se, për saa vlenj,
për saa mëndë, dua t' t' shërbenj.
Ti më jep po ndeer e gzim
kuur dërgon 'ndo nj' urdhurìm;
se të njoh se jee njerii
çë do mikj' edhe' gjërii.
Jee kaa ata' çë më të ftetë
u dua mirë te kjo' jetë.
Ashtu' patshe ditë t' glata
edhe' kjozmë me lopata!
Rrofshe e shkofshe gjith' haidhiit!
Kuuj mos t' deet, i rafshin siit!

(Nga Z. Skiroi „*Canti Tradizionali*"
(Napoli 1923) faqe 316-318)

II.

Për nder të Elenë Gjikës

1. E paash një motrë t' voglëzë,
akj' të hjeshme, akjë t' ëmblëzë!
Si nj' ëngjëll e bukrëz'ëë.
Nai e sheh, ng' e harron mëë.
2. Kështenjoor isht kësheti;
siu i 'saaj i rrimt si deti;
mëë se xhiji e bardhëz'ëë.
Nai e sheh, ng' e harron mëë.
3. Pallumbesha akj' isht e mirë,
akj' e ëmbëlë e e dëlirë.
Embri i 'saaj po Lenëz'ëë.
Nai e sheh, ng' e harron mëë.

---

10. *Për saa mënd:* për sá të mundem.
20. *Kjozmë:* pasuní, nga verbi *qosë.* — *hajdhii:* gëzim.

II. — 1. *Nai:* në qoftë se, në se.
2. *Kështenjoor:* i kështenjët; — *xhiji*: xhili, gjili, lili, zambaku.
3. *Lenëzë*: zbunim i emnit *Lenë* = *Elena Gjika*, së cilës i kushtohet vjersha.

4. Gazi i 'saaj fiill perne sblon,
çë n' mest t' shegës sbardhëllon.
Ajo pakj, kuur flet, gjith'ëë.
Nai e sheh, ng' e harron mëë.
5. Isht e glatë e, gjith' saa janë,
asaaj hiret i rriin nd' anë.
Lumia ajo! Ng' i lipset gjëë.
Nai e sheh, ng' e harron mëë.
6. Ajo' s' dii saa gjithve e bukurë,
saa e ëmbëlë u kaa dukurë.
Po si e jëmá e bukrëz'ëë.
Nai e sheh, ng' e harron mëë.

(Nga Z. Skiroi „*Canti Tradizionali*"
(Napoli 1923) faqe 318-320)

III.

Mëvitja e vdekjes së prindit

1. Flëni, flëni gjithmonë,
eshtrat të prindit t' im! Ngaa vit, si sot,
vinj e ju lak me lotë.
Sot prier i diiti vit,
çë prindin t' im të dashurin u sbora.
Gjekj, m' e kujton këmbora
e klishëzës, çë bie me lip e klaa
të kujdesmin e Krishtit delimeer.
Klaaje me mua dhe ti, klishëza e jime,
at' prift çë, për saa ditë
i dhuroi Perëndia, me zëmbr' e ndeer,
otarin t' ënt shërbeu.
Klaaje e përziej me mua lotë e vajtime.

---

4. *Perne*: perlë, xhevahír; — *ëë* = ësht, âsht.
5. *Lipset*, mungon; *ng' i lipset*: nuk i mungon.
6. *s' dii*; s' din.

III. — **Strofa 1.** — *Prier*: sjell, kthen por këtu âsht nji italjanizëm: *volge* e d. m. th. *mbushet*; — *sbora*: humba; — *lip*: zí, it. *lutto*; — *delimeer*: barí (barí shpirtnuer, pse ati i poetit ishte famullitari i Pianës); — *otari*: altari, lteri.

2. Isht i lulevet moi,
çë gazin dheut ngaa vit kthen e dhuron,
aì çë mua më helmon.
Oo priil, oo priil, për mua ti male e fusha
jo' më vesh në të rii, jo' më stolìs!
Munge për mua jan' zogazit, çë zjarri
e drita e diellit zgjoi.
Oo priill, kuur prire ti, zëmbrën më ngrìs,
se më kujton po ditën
çë drita e siivet t' im' u fsheh te varri.

3. U fsheh e ng' e paash mëë
fakjen e kukje e siuthin e gjaliё
edhe' të fjelltit ballë.
U fsheh te varri e buza j-u mbëllii,
çë fjalë t' ëmbla e t' urta, për saa rroi,
pati për mua!... J-u mbiill e bën dii vjetë
çë ngë më thot mëë gjëë.
Ailimano'! më la e më harroi
e po kujtimi i 'tiij,
si gozhdë e parrëfieme, m' u vjet.
Flëni, flëni gjithmonë,
eshtra të prindit t' im! Ngaa vit, si sot,
vinj e ju lak me lotë.

4. Mbrazët ashtu' kërkonj
një t' jetrë herë atë, te shpiiza e vee,
të shoh, edhe' si hjee?
Të përpikjemi mëë shpëresa ëë sbjerrë
e t' ndaajëm bashk gëzimet e koposet,

Strofa 2. -- *I lulevet moi*: d. m. th. mueji i Majit; — *munge*: të heshtun, it. *muti*.

Strofa 3. — *Ng'*: nuk; — *siuthin*: zvoglim e zbunim i fjalës *sí* = sy; -- *fjelltin*: këthjelltin. — *mbëllii*: mbylli; — *m' u vjet*: më mbet.

Strofa 4. — *Koposet*: mjerimet, pikllimet; — *joset*: shkrìhet, shuhet; — *i mbrazët*: i kotë; këtu si adverb: *kotsisht, kot së koti.*

si bëëm për disaa vjetë t' gjellës t' ënë ?
Të të rrëfienj saa shkonj
hidhii, me kë ngë prisja, e si më joset
në helme trimëria,
isht dishirìm i mbrazët edhe' i lënë ?

5. Shpëresë u kam e besë
se shpirti, çë në kjell prëhet e rrii,
kaa t' kujtonet ndo herë e t' parkalesnjë.
Besë ashtu' kam se ti do t' lipsh ndo hiir
të madhit Zot të t' mjerëvet për mua.
Parkales ! Parkales !
për Zefin t' ënt, për të helmuamin biir,
të Birin e Mëriis,
çë për njerëzit isht hireshit krua !
Thuaji se ditë e natë
lotë u përtsiell ; se ballët t' im u vrëë ;
se kjo buzë e jimia ngë kjesh mëë.
Kam klaar e mosnjerii
m' i fshijti lotët ; ndihmë edhe' kam lipur,
e zëri i jim u sbuar te kjelli i gjerë !

(Nga Z. Skiroi ,,*Canti Tradizionali*"
(Napoli 1923) faqe 320-322)

ROSOLIN PETROTTA

Strofa 5. — *Kaa t' kujtonet :* do të kujtohet ; — *parkalesnjë :* të lutet ; — *hireshit :* hiresh ; — *përtsiell :* përpîn ; *u vrëë :* u vrâjt ; — *mosnjerii :* as kërkush, asnji njerí.

BISHT

15. — PJETËR KIARA (1840-1915)

a) Jetëshkrimi e veprat

Pjetër Ķiara lindi në Palazzo Adriano (Siqeli), më 26 Korrik 1840. Ishte i biri i Zefit dhe i Maria Dara-s, nip i familjes së shkëlqyer dhe të çquar të Darajvet.

Me qumështin e mëmës thithi dashurinë për Atdhenë dhe lidhjen e ngushtë me traditat e stërgjyshëvet shqipëtarë. Ndoqi gjurmët dhe shëmbëllën e kushëriut Gabriele Darës të Riut, dhe u rrit në një atmosferë atdhedashurije së lartë e me dëshirë të flakët që të ndihmojë me studime dhe me vepra zgjimin e kombit shqiptar.

Si nxënës në Seminarin italo-arbresh të Palermit, edukoi mëndjen për idealizmat më fisnike dhe këtu e pasuroi mëndjen e vet me një doktrinë klasike të shëndoshë.

Posa i kishte kaluar të njëzet vjetët kur fitoi doktoratën në drejtësi n' Universitetin e Palermit e në një kohë kur bashkëqytetari i tij Frano Krispi, krah për krah me Zef Garibaldin, i a kthente Siqelinë Italisë së bashkuar e të drejtuar nga Ay për të arritur qëllimet perandorake.

Më 1869 — endè shum i ri — botonte në Palerm, vllimin e vlefshëm „*Albania*", që me gjith se bën fjalë për një bashkëpunim të ngushtë greko-shqiptar (mendim i rrëxuar që kur lindi nga mos mirënjohja helenike) qëndron edhe sot si një burim për njohtime të vlefshme e sidomos për një atdhedashuri të lartë.

Ky, veprën e vet i a kushtonte „Shqipëtarëvet të Krujës ku leu Gjergj Kastrioti-Skënderbej, e Shqipëtarëvet të Leshit, ku u-shduk Shpirti i tij i madh".

Ishin kohë mjaft të vështira ato kur Pjetër Kiara — i shtyrë nga atdhedashurija e tij — me librën e vet ngrinte zërin për mprojtjen e Shqipërisë së trathtuar, të lënë më nj' anë dhe të shtypur.

Në Shqipëri rron një popull zemër-gjërë luftëtarësh — kështu shkruante në faqet 7-8 të parathënjes — *të cilët nuk lo-*

dhen kurrë së kundërshtuari me armë kundra zotërimit barbar që ushtronte perandori i Turqvet; nga këto male përhapet nepër Europë me zhurmën e bubullimës klithma e lirisë dhe e pa-mvarsisë...“

Ndruajtim një çast — shton pastaj në faqen 27 — *për-para se të hedhshim në letër mejtimet e më poshtme: por pastaj doli fituese dashurija dhe lidhjet që na afërojnë me një popull të dërmuar nga fatkeqësitë; e të prekur nga mejtimi që të përmbushim një detyrë (nuk e kam zakon të kthehem pas përpara gjëmbave të politikës) i u shtruam me kënaqsí ngacmimevet të një njeriu me shum influencë të madhe* [1]) *nga i cili Shqipërija pret përmbushjen e kërkesavet dhe shpëtim*“.

Dhjetë vjet më pas — më 1879 — Pjetër Kiara, i ngarkuar nga Krispi, kryetar i Qeverisë, bënte një udhëtim në Shqipëri edhe në vënde të tjera ballkanike.

Me këtë rasë botoi në fletoren e Shtetarit të madh „*La Riforma*“ atëherë të drejtuar nga Gabriele Dara i Riu një varg „Letrash“, ndështypjesh e shënimesh për vëndet e vizituara, por sidomos për Shqipërinë, të mbledhura pastaj të gjitha në vëllimin: „*L' Epiro — gli Albanesi e la Lega* (Palermo 1880).

Bashkëpunoi në „*Fiamuri i Arbërit*“ të Jeronim De Radës (1883-1887). Qé deputet në Parlament, mik i ngushtë dhe bashkëpunëtór i Frano Krispit.

Kushëriu Gabriel Dara i Riu, poemin e vet të famshëm i a kushtoi Pjetër Kiarës, punëtor i zellshëm i gjuhës shqipe e përkrahës i pa trëmbur i të drejtavet të kombit shqiptar, të shkelura gjer atëherë.

Atdhetari dhe shkrimtari i çquar italo-arbresh vdiq, po thuaj se në harresë, në Palazzo Adriano, më 11 Jenar 1915, në moshën 75 vjeçare.

Midis hartimeve të tija poetike zëmë në gojë atë q' ay i kushtonte „Luftëtarit t' Arbëresh“, vargje të frymzuara thellësisht nga dashurija e atdheut dhe nga fisnikërija që t' a therorizonte jetën e vet për 'të.

---

1) Frano Krispi, edhe ky Shqipëtar i Siqelisë ësht bashkëqytetar i Pjetër Kiarës.

b) Luftari t' Arbëresh

1 Aí mbaaj flumurin te grushti,
ç'ish kjindisur gjith me aar;
kish përposh, me hundë të haptë,
shumë të bukur një murdxaar.

2. Veej te lufta; e paan armikjët
e kjëndruan si bora të ftohtë,
se ngaa siit një zëmbrë ftoj
t'egrë si ain, si dielli t'ngrohtë.

3. Për në fushat, për në malet,
si një flutur, si era shkon:
etë, uu, shii, vapë, borë e dzaftë
ng'e skontapsën, ng'e vakton.

4. Dheun e math, ku mbledhur janë
t'horës e t'besës armikjët gjithë,
mat me siit, e i vret me truut,
si kuur drapëri kuarën drith.

5. Kët' fukjii, këtë zëmbër t'madhe
kush ja jep? Çë rrogë i dhanë?
Kush i zoti ç'e urdhuron?
T'shpejt ashtu kush isht ç'mbaan?

---

1. *Mbaaj*: mbante; — *murdxaar*: kál shale.

2. *Veej*: vente, shkonte; — *ftoj*: tregonte; — *ain*: shqiponjë.

3. *Dzaftë*: xaftë, erë e ftohët, murrâni; — *skontapsën*: f. greq. qi d. m. th. ndalon, pengon; — *vakton*: e bân të vokët.

4. *Horë*: këtu me kuptimin *atdhé*; — *kuarën*: korrë, kositë.

6. Një mendim, ç'isht besa e prindëvet,
ndier ngaa gjithë, djelmë, plekjë e trima;
dheu ku u rrit, ku t'parën herë
paa shkeptimë, gjegji bumbllima.

7. Këtá janë t'zotërat ç'i kan' huar
tsabje, zëmbrë e kavaliin;
për këtë rrogë mirë gjaku shprishet,
kuur te lufta ndera shtiin.

8. Shkluhë e thikë aí pat për mikjë,
horë e besë te zëmbra aí pat;
gjith lavosur, plot me sdramë,
lodhët dërsiiti ditë e natë.

9. Shtuara drekj, si lis i moçëm,
o te varri gjith krimbosur,
po kujtuar luftari kloft
me bekime e lotë paa sosur.

(Nga „*Canti Tradizionali*"
të Z. Skiroit faqe 326-328)

ROSOLIN PETROTTA

---

7. *Kan huar*: kanë uhajtun; — *tsabje*: pallë, shpatë, këllyç; — *kavaliin*: kál (nji siciljanizëm).

8. *Shkluhë*: pushkë; — *lavosur*: i plagosun; — *sdramë*: zdramë, plagë, varrë e kafshëvet.

9. *Shtuara*: në kambë; — *drekj*: dreq, drejt; — *krimbosur*: i brém prej krymbash.

BKSH

16. — ZEF SEREMBE (1843-1891)

a) Jetëshkrimi e veprat

Ky poet fatzí arbresh qe prej njij familjeje së mirë e të vjetër të Kolonís shqiptare të Strigarit (S. Cosmo Albanese) afër Kozencës në Kalabrí. Mësimet e veta i filloi e i vijoi deri diku në Kolegjin e Shen Adrianit në Shen Mitër dhe këtu tregoi nji hollim mendjeje e nji tríll poetik për të çfaqë mâ vonë ndiesít e zemrës së vet të trazueme. Nga nji sëmundje e randë veshi, nga ngushtimet e jetesës së vet e të familjes, qi dikur kishte qenë e pasun, i u desht me i lânë mësimet për gjymës dhe ktheu në katundin e lindjes për me i u gjetun ndihmë prindvet. Gjendja e vështirë ekonomike dhe dobsija e shëndetit e dishpruen shum, kaq sá dha edhe disá shenja dobsije mendore. Shkoi prandej nji jetë të mjerë dhe u dha mbas udhëtimevet për të gjetë shëndet e prehje shpirtnore ; kështu e shofim tue shetitë gadi krejt Italín ; vojti po thuejse në të gjitha kolonít arbreshe të Kalabrís e të Sicilís, udhëtoi nepër Francë dhe në Spanjë e mâ në fund shpirti i tij i paqetë e shtŷni deri në Brazil, ku, mbas porosís së Elenë Gjikës, gjeti nji pritje të përzemërt n' oborrin e Perandorit Don Pedros.

Mbas njij vjeti të qendrimit të tij n' Amerikë, i hoq zemra me kthyem prap në vendin e vet ; thuhet se mbassi mrrijti në Kadice, e bâni kambë rrugën prej këtij qyteti të Spanjës deri në katundin e vet të lindjes ndërmjet vuejtjesh të mdhaja trupore e morale. Gjatë këtij udhëtimi të vështirë humbi nji pjesë të madhe të dorëshkrimevet, ndër të cilat disa drama, nji poem të gjânë dhe përkthimin shqip të Psalmevet të Davidit. Përsërí në katund nuk e gjet qetsín e dishrueme, prandej mori për së dyti rrugën e Amerikës e në S. Paulo i sosi ditët e jetës në moshën 48 vjeçare në vjetin 1891.

* * *

Zef Serembe — si thotë Straticò [1]) — vjershonte aty-për-aty, i frymzuem nga rasat e ndryshme dhe mâ të shumtën e herës

1) Straticò — *„Letteratura albanese"*, f. 254.

nuk u kujdesue t' i shkruente. Vjershat e tija kanë masa të ndryshme: përgjithësisht ndjek gjurmët e poezís italjane, por ndër to shifet edhe ndikesa e poezís popullore italo-arbreshe. Këndon dashunín, miqsín, atdhén, besimin, fatin e ardhëshëm të Shqipnís, bashkimin e të gjith Shqiptarvet në luftën kundër pushtuesit t' Azís, përtrîmjen e popullit të Skanderbeut dhe ndiesít mâ fisnike të shpirtit të njeriut.

Historija e fatit të zymtë qi e ndoq gjatë jetës çfaqet kjartas në librin e vjershavet italisht, të botuem në vjetin 1883 në Kozencë me titullin „*Poesie italiane e canti originali tradotti dall' albanese*". Vjershat italishte të këtij vllimi — 5 gjithsejt — nuk kanë ndonji vleftë të madhe; vjershat shqipe — 32 copë — nuk janë të botueme në gjuhën shqipe, por të përkthyeme fjalë për fjalë nga auktori vetë me nji italishte të vrazhdë e të gabueshme.

Prej prodhimit të tij në gjuhën shqipe nuk do të kishim kurrgjâ të botueme, mos të kishte qenë i nipi i tij Kozmo Serembe, i cili në vjetin 1926 botoi në nji vllim prej 132 faqesh tridhetë e nandë hartime poetike të Zef Serembes me titullin „*Vjershe*".

Në këto vjersha ndiehet helmi i njij shpirti të trazuem; qán rinín e vet të kalueme n' errsinë e në pikllime dhe brehet me vehte pse nuk gjeti kërkund nji zemër bujare, qi t' i a lehtësonte vuejtjet e krajatat e jetës.

KARL GURAKUQI

b) Nga libri „Vjershe"

1) Fytŷra ime

I ljartë, e mê se i hoolë u jam i trash,
E jam i áksem posi nj'Akjiljee.
Jam ljeshëkështênjë e shteku më ka hjee:
Siet si pasadíel veen përnjë vash.

---

2. *i àksem*, i shkathët, i gjallë. — 3. *shteku*, e ndara, vija e flokevet. — 4. *pasadíel*, lule dielli. — *veeri...*, do të thotë se sytë rrotullohen andej e këtej

Vètulat jaanë ndëndura si shash
E të mbuljuuara tunden si me ree;
Hunda ê në maaljë si e frire, e ruuan me oree
Mbi buuzes atjè ku mustaku u ndrash.

E mjekra surrugjate: si me foorë
Dhëmbet rriën te çunja, veshi u shtie
I hoolë posi e hoolë ê imja doorë.

I drekjtë, i fortë, ngrêhet dzerku e rrië.
Se më dha Shëndeta statin burrënoorë:
Si jam mirë e kodînë tas nganjeerië.

2) Fati

Shkoova të paaret vjet me shumë haree
E jeta m'u diftuua si pasikjire,
E kjeshnej kieli e kijeshnej muua kyë dhee,
Përpara meeje mose gjênja mirë.

Nga malji u vrê dhe egëras gjëmoojti
U proora e pash se ish me pika pjot;
U hapë e zeeza ree dhe muua mbuljoojti,
E praa kështú më mundi e kekja shkjot.

Shkova per pylja e ree ndë një përuua
Akj se une i mjeer i têrë u shkjoora;
Në buuzë gazi e ndë zemër maali u shuua,
E gjith hadhiët e gjeeles ashtú boora.

---

kur shohin një vashë, ase pas një vashe. — *ndëndura*, të dëndura, të trasha. — *shash*, brushëz. — 7. *në maljë*, në majë. — *ruuan*, shikon. — *me oree*, me vrejtje. — 8. *mbi buuzes*, mbi buzën. — 9. *surrugjatë*, vezake. — 10. *dhëmbet*, dhëmbët. — *rriën*, rrinë. — *te çunja*, tek zhumbina, mishi i dhëmbëve. — 13. *statin*, trupin, kurmin. — 14. *tas*, tash. — *nganjeerië*, çdo njeri. — *e kodînë*, ital. „indovinare" e gjen e kupton; ndreq: „tas nganjeerië e kodinë si si jam miirë".

II. — 6. *U sproora:* u ktheva; — 9. *shkjot:* stuhí, furtunë; — 10. *u shkjoora:* u grisa, u çora; — 12. *hadhiët e gjeles:* gëzimet e jetës.

Eera më moori shpresat edhe vaanë:
E me gërshêrat vobësia më pret;
Ljuuljet e gjeles s'ime gjith u thaanë
E fati më përzê e bên të shkret.

3) Natje

Te nata shuumë e zeezë fjuturoojti
Meenda ime kjielëvet e ljeera
Ndaajti reet: e te një vendë pushoojti
Ku buron kooha e masen kjiela e dheera.
Mbi dielit meenda u ngre dhe ilet shkoojti
E u humbë te një deet me frunguleera:
Atjè s'u dogj, përteena po kaloojti
E gjeeti gazin e hadhiën te deera.
Përpaara vate . . . Duke ljoozur kjielet
Puthëçin ndër suvaalja dritëje e dliire
E mbitëçin me maalë ilet e dielet.
Hyri . . . e një drit meenden m'e suvaalji
Se m'armonië të thielte e fanëmiire
Natýra u tundë e Perêndiën tëfaalji.

NAMIK RESSULI

III. — 3. *pushoojti :* si pas ital. „posarsi". — 4. *buron koha :* nga nis koha, d. m. th. tek Perëndija. — *masen :* maten. — 6. *frunguleera :* tallaze të forta e të kuqe si flakë. — 11. *mbitëçin :* mbyteshin. — 12. *m' e suvaalji :* e pushtoi si një suvalë (tallaz). — 13. *të thielte :* të këthielltë. — 15. *tëfaalji :* çfaqi, tregoi.

KAPTINA VII.

Arbreshët e Greqìs

Se kur kanë zânë vend Shqiptarët në Greqí, nuk dihet me sigurí. Mendimet e studjuesvet të çâshtjevet të Ballkanit e sìdomos ata qi u mueren me studime rreth Shqipnís e Greqís, nuk janë aq fort në pajtim ndërmjet njêni tjetrit. Mâ i pari e mâ seriozi auktor qi na ka lânë shkrime të hollësishme mbi Arbreshët në Greqí ka qenë *Fallmerayer-i.* Ky shkrimtar në librin e vet me titullin «*Historija e Gadishullit Morè gjatë Kohës së Mesme*» [1]), tue u mbështetë në dishmít e histori-shkruesvet byzantinë, na thotë se Shqiptarët nisen të zânë vend në Peloponez e ndër ishujt e Egjeut në mes të shekullit XIV (1349).

Por nuk ka dyshim, sikurse mund të shifet prej auktorvet të mâ-vonshëm, se Shqiptarët kanë pasë ngulë banesat e veta në Greqí edhe përpara datës së caktueme nga Fallmerayer-i, sidomos në Thesalí, Etoli, Akarnani, Beoti, etj. madjè disa thonë se Shqiptarët u vendosën në Greqi nga fundi i shekullit të gjashtë [1])

Cili qe shkaku i kësaj shkuemjeje në Greqi? Shkaqet janë të ndryshme, por kryesori ka qenë sulmi dhe pushtimi i visevet shqiptare nga Gotët, Avarët, Slavët, të cilët si nji lum rrembyes shkatrruen pasunít e vendasvet, tue shkretnuem tokët e pronat e tyne. Nji shkak i dytë duhet të kërkohet në natyrën e njeriut, qi e shtýn këtê kurdoherë të zbresë nga veriu në jug, për të kërkuem krahina mâ të ngrofta e mâ të plleshme.

---

1) „Geschichte der Halbinsel Morea waehrend des Mittelalters" (Stuttgart 1836).

2) *Sathas,* historí-shkrues grek, «*Documents inédits relatifs à l' histoire de la Grèce au moyen âge*», Paris 1880.

Arbreshët e visevet greke, ndonse me nji sasí gadi 300.000, mjerisht, në pikëpamje të shkrimit të gjuhës shqipe e të prodhimit letrar shqip, janë shum të shterpë dhe këjo gjâ spjegohet nga se Grekët janë përpjekë me çdo mënyrë të pengojnë zhvillimin e gjuhës shqipe dhe kanë përdorë të gjitha mjetet për t'i shkombtarizuem. Pra, po të duem të bâjmë nji krahasim me Arbreshët e Italís, shofim me keqardhje se në fushën e kombsís e të punimit të gjuhës, Arbreshët e Greqís kanë dhânë prova shum të pakta; kurse Shqiptarët e Kolonivet arbreshe t'anës tjetër t'Adriatikut gjetën ndihmë e përkrahje nga populli italjan, ata të shtetit kufitar u ndoqen dhe u përbuzen; kurse pranë të parvet, jo vetëm se u mbajtën gjuha, zakonet, gojëdhanat dhe ndiesít atdhetare, por u zhvillue e u krijue edhe nji letërsi e pasun dhe e çmueshme, sikurse u pá në kaptinën e mâparëshme, me mzi pranë të dytvet takojmë ndonji fytyrë të rrallë qi u dallue në pikëpamje kombsije e veçanisht në fushën gjuhsore - letrare.

Vetëm dy vetë meritojnë të përmenden në ketë fushë veprimi, ndonse vlefta e tyne âsht mjaft e kufizueme: *Anastas Kullurjoti* dhe *Panajot Kupitori.*

*
* *

1. — Anastas Kullurjoti — fytyrë fisnike - ka lindun në vjetin 1722 n'Athinë, në lagjen *Pllaka,* qi âsht mâ e vjetra e atij kryeqyteti dhe ku gjinden Shqiptarë, qi flasin edhè sot shqip. I ati i Anastasit rá dishmuer për pa - mvarsin e Greqis tue luftuem kundra ushtris turke. Qysh në moshën e rè Anastasi kishte shkuem n'Amerikë e atje, mbassi kreu mësimet e veta, u muer me tregtí e tue pasë mbledhë nji shumë të mirë të të hollash, u kthye në Greqi plot me mendime të nxehta e të bukura për Shqipni. Themeloi nji fletore, nji shoqni e nji shtypshkrojë, të trija me emnin «*Zani i Arbnis*» («I Foni tis Allvanias»). Programi i tij qe: a) themelimi i njij partije shqiptare në parlamentin grek; b) hapja e shkollavet shqipe për Arbreshët e mbretnis greke; c) zgjimi i Shqipnis për t'u lirruem nga zgjedha turke. Shetiti të gjitha viset e Greqis, qi ishin

të banueme prej Shqiptarësh, ku u përpoq natë e ditë, punoi pá pushim, predikoi ndiesit atdhetare; mundimi i tij nuk shkoi kot, pse mrrijti të ndizte për nji kohë shkëndin e atdhedashunis ndërmjet bashkë - kombasvet të vet. Mâ në fund niset edhe për në Shqipni për t'u marrë vesht me Shqiptarët për shlirimin e atdheut, por Grekët, të cilët nuk e shifshin me sy të mirë veprimtarín e Anastasit, filluen t'i kundërshtojshin me të gjitha mënyrët; zunë të shpifin kundra tij, t'a shajnë, t'a përbuzin e t'a ndjekin. Kur mrrijti në Gjinokastër, qeverija turke, mbas kërkesës së konsullatës greke t'atij qyteti, e zuni dhe u a dorzoi Grekvet, të cilët e çuen të lidhun n'Athinë. Mbassi vuejti për nji kohë të gjatë nepër burgje, u la i lirë, por atëherë nisi prap për tê nji jetë idhnimesh e vuejtjesh; «s'bënte çap rrugës - thotë F. Konica - pa pjekur zuzarë qi e ndipnin duke e sharë», e nji ditë vdiq i harruem prej gjithkujt dhe thuhet se qe helmuem.

Përveç fletores «Zâni i Arbnis», kur doli nga burgu, botoi librin greqisht «Ankimet Shqiptare» («Allavanika parapona»); shtypi nji «*Abetare Shqipe*» dhe përktheu librin «*Klumësh për foshnja*», të dy këta libra të shtypun n'Athinë në vjetin 1882.

2. — *Panajot Kupitori.* — Mbas Anastas Kulluriotit, duhet të dijmë edhe pak gjâ mbí Arbreshin e Greqís, Panajot Kupitorin. Ky ká lindun n'ishullin Hydra të Greqís në vjetin 1821 dhe studjoi letërsí n'Universitetin e Athinës. Në vjetin 1876 u emnue profesor në Gymnasin e Athinës *Varvaqi* [1]); mâ vonë u bâ drejtuer i tij, ku fitoi nji emën të mirë mdis shokvet dhe në botën letrare greke. Përveç detyravet shkollore, nuk pushonte tue shpallë mendimet e veta mbí përmirsimin e fatit të Shqipnis e mbi ndriçimin e popullit shqiptar; mbante nji shkollë nate, ku u mësonte gjuhën shqipe me shkroja greqishte Shqiptarvet t'Athinës e të rrethevet.

---

1) *Varvaqi* ase *Barbaqi* ishte nji shqiptar i pasun nga Athina, i cili u dhuroi Grekvet ket gymnas.

Përveç vepravet greqishte dhe të njij fjalori me randësí latinisht - greqisht, u dha mbas studimit të gjuhës shqipe, tue pasë ndër mend me botuem nji *Studim historik e letrar mbi gjuhën e mbi kombsín e Shqiptarvet*, por të kësaj vepre mujti me botuem vetëm pjesën e parë: «*Mbi përemnin e vetës së tretë të shqipes simbas djalektit të Shqiptarvet të Greqis e sidomos t'atij t'ishullit Hydra* (1870); botoi edhe nji «*Alfabetare të gjuhës shqipe*»' (1879). Ka lânë edhe në dorëshkrim nji Fjaluer të shqipes, të cilin në vjetin 1926 e bleu Shoqnija historike dhe etymologjike e Greqís. Vdiq në vjetin 1881.

Tue qenë se nuk kemi ndonji shembull nga shkrimet shqipe te ..ëtyne dy Arbreshvet, po japim këtu disá copa nga folklora e Shqiptarvet të Greqís, për të pasë nji mendim mbí djalektin qi përdoret ndër ato vise: a) nji vjershë popullore satyrike; b) disá fjalë t'urta; c) katër prralla të vogla.

KARL GURAKUQI

---

a) Vjershë satyrike

Qir Karidhe çë shkruan fosnë,
Nani më pseftitë u sosnë.
  Shkruajte për Nidriotë,
Shkruaj edhe për Peçiotë.
  Kemi dhimarhë nj'Andrano,

Ç'i paguajmë mistho.
  Petetë se ishte zotë,
Po misthónë e merrë plotë.
  Ka ndë Peçë epirroi,
Epidhí ka katrë si.

1-5. — *Fosnë*: titulli i fletores „Drita"; me ketë vjershë i drejtohet drejtorit të gazetës „*Fos*". — *Nidriotë*: banorët e ishullit *Hydra*. — *Peçiotë*: banorët e ishullit *Specja*. — *dhimarhë*: kryetar bashkije.

6-10. — *Mistho*: taksë. — *petetë*: krenohet. -- *epidhi*: mbassi, tue qenë se.

Ishte trim' edhe i a thotë,
Pse vish llaze barbarjote.
Ka dhe hundënë t'ergjëndë,
Andaj ecën me di bëndë
Di puarezitë me bishtë

Ka të haxhi Nastratiftë.
Ka nji krie plot kuqjeta,
Karaman, gone me pjeta.
Kathe këshif çë do të theetë,
Arsizi plotë do të jeetë.

Çë kur u ngulë ndë Dhimarhi,
Kukë la rofè, skrupi,
Astako dhe sfiridha,
Gjirthelja dhe sinagridha,
Ahino dhe petalidhe,

Ahtapodh edhe ostridhe.
Nëkë la midhè kacige,
Pse çobantë i ka miqe.
Valt e blee ka monastiri,
Verë, rush ka patitiri.

Andaj nëkë çon njeri
Për të vërë epitropi.
Inëzotë të na e dhuronjë,
Vera kjo sa të shkonjë.
Arrenjënë këto Karidhe,
Pse verdhet arhontopulo efpatrídhe!

(Nga „*Appendice di Grammatologia comparata*"
të Dh. Kamardës, 1866, faqe 88-90)

11-15. — *Barbarjote*: nga *Barberia*, adjektiv vendi si *Nidriotë, Peçiotë*. — *bëndë-a*: rresht, rradhë; këtu: *ecë me kreni*. — *puarezitë*: prrallza.

16-20. — *Nastratiftë*: Nastradini. — *plotë kuqjeta*: âsht nji frazë qi e përdorin Arbreshët e Greqís për të treguem *nji njerí mendje-hollë e të zotin*. — *gone me pjeta*: brekushe me palë. — *kathe këshif*: çdo këshíll.

21-25. — *Dhimarhí*: bashkí. — *rofè, skrupi, astako, afiridha*, etj. janë emna greqisht peshqish.

26-36. — *Valt*: vajin, vojin e blém nga monastiri. — *patitiri*: mtî, vozgë. — *arrenjënë*: mjaftojnë. — *arhontopulo efpatridhe*: zotnija i vogël fisnik.

b) Fjalë t' urta

1. Ulku (1) qimen e ndërron, zakonë nuk e ndërron.
2. Ku përshtijnë shum, bënetë lum (2).
3. Kur vijnë mëntë ikëjnë dhëmbtë(3)
4. Peshku i math e ha të vogëlin (4)
5. Plesht që nukë të ha, mos e kruaj.
6. Dita e mirë që me natë njihet.
7. Zëre të verbërin, e merri (5) sytë.
8. Sy i lig të mos i ngasë (6)
9. Perndija të të ruanj nga të ligatë (7)
10. I a piva sytë.
11. Të marshinë të thellat e dheut (8)
12. Mi se të gjenj (9)
13. Mi (10) se të vish.
14. Ahera (11) të pish.

(Nga „Visaret e Kombit",
Vllımi IV, faqe 345)

---

1) I ligu përmirësohet vetëm në sipërfaqe, ndë thellësit e tij mbetet gjithmonë i lig.

2) Fjalët e shumta nuk dalin mâ të mira.

3) Kur i shkon koha njij pune, atëherë çdo mundim âsht i kotë.

4) Mos i bjer në qafë atij qi s' të nget.

5) Kur dikush kërkon prej të vobektit.

6) Urim: të mos i zâjë syni djemt.

7) Urim.

8) Mallkim, namë.

9) Thotë i grishuni kur ngre gotën.

10) I përgjegjet zoti i shtëpis.

11) Kundra-përgjegja.

c) Prralla nga Poros-i

Thëuzë edhe petrit 1)

Theuza rii mbë drizë e këndon e pa e e zu te haj i thotë thëuza: mos më ha, pse jam e vogël e do mos të frinj barkunë; po, ndë dotë frihesh, gjuai të mbëdhenj zoq, e petriti i thotë: se do jem shumë i marrë, ndë lëfsha të ngrënëtë çë kam ndë golje, (2) e të gjuainj tiatrë të ngrënë çë se shoh fare.

mithoa (3) thotë pse ca njerës, pse të çonjënë (4) më shumë, barënë edhe të pakënë çë kanë në dorë.

Arap

Një njeriu bleu një Arap e i ndotë pse se lan fare zot parë, pra ish i zi. E zëroi (5) ki te lan nga dita edhe te fërkon prë të zbardhei, po edhe nga të fërkuarit e shumë u sëmur.

pllareza (6) thotë pse jo që (7) ka njeriu nga të leritë, (8) vietetë njera të vdisë.

Pishqatorë

Ca pishqatorë gjuainë e shumë qero (9) gjuatinë e donjë peshk nëkë zinë. (10) u vreruanë (11) shumë e doinë t'ikëinë ngah atie edhe mbë një, një pesht i math, i gjuaiturë nga tiatrë peshk i madh, u ra mmërda (12) ndë barkë e ata, si e panë, u gëzuanë e iknë.

Pllareza thotë pse shumë herë ato çë s na jep mjeshtria, na e jep fati.

---

1) *Thëuzë* = thëllëzë, fëllëzë.
2) *goljë* = gojë; *golë* edhe sot në Jug e n' Itali.
3) *mithoa* = prralla; prej gr. *mithos.*
4) *çonjënë* = gjêjnë; e thotë edhe jugu.
5) *zëroi* = urdhëroi, porositi; prej *zë-ri.*
6) *pllareza* = prralla.
7) *çë* = që; edhe n' Itali.
8) *të leritë* = lindja.
9) *qero* = kohë; prej gr. *kajros.* — Meyer 224.
10) *nëkë* = nuk; n' Itali *nënk, nëngë, ngë* etj.
11) *u vreruan* = u mbushnë me vrer.
12) *mmërda* = brënda, *bërda* edhe sot nga Jugu.

Di njerës [1])

Di vetë ecëinë de një dhrom bashkë, e njëri ngah ata çoi një sëpatë; ge tiatri i falei (2) të mos thei, pse e çova, (3) po e çuam e si ecnë ca pak dhrom, e rbuarë (4) spatënë. e ai çë kish çuar sëpatënë thoi: «e rbuarm sëpatënë». e tiatri u përgjeq e i tha: «mos thuai pse e rbuarm; pse kur e çove, nëkë thoje «e çuam», po «e çova.»

pllareza thotë pse, sa s'kanë piesë të bëniënë në të pasurë, mite (5) ndë dëmë nëkë janë miq të vërtetë.

(Nga „*Elemente të Gjuhësisë e të Leteraturës shqipe*"
Çabej, 1936, faqe 175-176)

---

1) *Di* = dy; kështu edhe në Jug dhe n' Itali. — Dialektet e Greqisë, t' Italisë dhe të Jugut kanë lidhje të ngushta midis tyre.

2) *i falei* = i lutej.

3) *pse* = që, se.

4) *e rbuar* = e humbën, e buarnë; prej *rbier* = humbas.

5) *mite* = as; prej gr. *mete*.

BKSH

RENDI ALFABETIK I BASHKËPUNUESVET

Aleksander Xhuvani:

Kap. III. — Shkrimtarë të vjetër të Jugut . . Faqe
1. „ „ Nr. 5 *Grigor Gjirokastriti* . . . 88-93

Filip Fishta:

Kap. II. — Shkrimtarë të vjetër të veriut.
1. „ „ Nr. 6 *Gjon Nikollë Kazazi* . . . 65-68

Kap. IV. — Shkrimtarę të vjetër myslimanë.
2. „ „ Nr. 1. *Muhamet Çami* 95-107

Kap. V. — Prodhimi letrar përpara Lidhjes së Prizrendit.
3. „ „ Nr. 4 *Pjetër Zarishi* 142-152
4. „ „ Nr. 6 *Leonard de Martini* . . . 157-173

Justin Rrota:

Kap. I. — Dokumentet e para të gjuhës shqipę.
1. „ „ Nr. 1. *Formula e Pagzimit.* 4
2. „ „ Nr. 2. *Fjalorthi i A. Von Harff.* . 5-6
3. „ „ Nr. 3. *Ungjilli i Pashkvet* 5-8
4. „ „ Nr. 4. *Nëshkrimet e Pjanës* 8
5. „ „ Nr. 5. *Fjalorthi i Mazrrekut.* . . . 9

Kap. II. — Shkrimtarë të vjetër të veriut.
6. „ „ Nr. 1. *Gjon Buzuku* 13-23
7. „ „ Nr. 2. *Pjetër Budi* 24-39
8. „ „ Nr. 3. *Frang Bardhi* 39-45
9. „ „ Nr. 4. *Pjetër Bogdani* 46-61
10. „ „ Nr. 5. *Kuvendi i Arbënit* 61-65

BKSH

Kap. VI. —	Prodhimi letrar i Arbëreshvet t' Italisë.		Faqe
11. „ „	Nr. 1. *Lekë Matranga*		203-209
12. „ „	Nr. 5. *Jul Variboba (d)*. . . .		233-236
13. „ „	Nr. 11. *Anton Santori (d)*. . . .		284-286

Karl Gurakuqi :

Kap. IV. —	Shkrimtarë të vjetër myslimanë	
1. „ „	Nr. 2. *Shkrimtarë të dorës së dytë*	109-110
Kap. VI. —	Prodhimi letrar i Arbëreshëvet të Italisë	
2. „ „	Nr. 2. *Nikollë Figlia* a) . . .	210-211
3. „ „	Nr. 5. *Jul Variboba* a)	226
4. „ „	Nr. 16. *Zef Serembe* a).	345-346
Kap. VII. —	Arbreshët e Greqis	349-350
5. „ „	Nr. 1. *Anastas Kullurjoti* . .	350
6. „ „	Nr. 2. *Panajot Kupitori* . . .	351

Lumo Skendo :

Kap. III. —	Shkrimtarë të vjetër të jugut.	
1. „ „	Nr. 4. *Marko Boçari*	84-88

Namik Ressuli :

Kap. II. —	Shkrimtarë të vjetër të veriut	
1. „ „	*Njohtime të përgjithëshme* . . .	10-13
Kap. III. —	Shkrimtarë të vjetër të jugut	
2. „ „	*Njohtime të përgjithëshme* . . .	69-70
3. „ „	Nr. 1. *Theodhor Kavalioti* . . .	71-74
4. „ „	Nr. 2. *Mjeshtri Danjel*	75-76
5. „ „	Nr. 3. *Kostë Beratasi*.	77-84
Kap. IV. —	Shkrimtarë të vjetër myslimanë	
6. „ „	*Njohtime të përgjithëshme* . . .	94-95
7. „ „	Nr. 2. *Nezim Berati*	107-109

	Kap. V. —		Prodhimi letrar përpara Lidhjes së Prizrendit	Faqe
8.	„	„	*Kjohtime të përgjithëshme* . . .	111-112
9.	„	„	Nr. 1. *Theodhor Haxhi Filipi.*	112-116
10.	„	„	Nr. 2. *Naum Veqilharxhi* . .	116-118
	Kap. VI. —		Prodhimi letrar i Arbëreshëvet t' Italisë	
11.	„	„	Nr. 2. *Nikollë Figlia* b) . . .	211-214
12.	„	„	Nr. 5. *Jul Variboba* b) e c) .	227-232
13.	„	„	Nr. 10. *Jeronim De Rada* . . .	252-278
14.	„	„	Nr. 11. *Anton Santori* a, b, c, ç.	279-284
15.	„	„	Nr. 11. d. 2, 3).	286-290
16.	„	„	Nr. 13. *Gabriel Dara i Riu* . .	299-335

Rosolin Petrotta:

	Kap. VI. —		Prodhimi letrar i Arbëreshëvet t' Italisë.	
1.	„	„	*Njohtime të përgjithëshme* . . .	199-202
2.	„	„	Nr. 3. *Nikollë Brankati* . . .	215-223
3.	„	„	Nr. 4. *Zef Barça*	223-225
4.	„	„	Nr. 6. *Gjon Thoma Barbaçi* .	237-239
5.	„	„	Nr. 7. *Nikollë Keta*	239-244
6.	„	„	Nr. 8. *Gabriel Dara Plaku*. .	244-248
7.	„	„	Nr. 9. *Andrea Dara*.	249-252
8.	„	„	Nr. 12. *Dhimitër Kamarda* . .	290-298
9.	„	„	Nr. 14. *Zef Kamarda*.	335-340
10.	„	„	Nr. 15. *Pjetër Kiara*	341-344

Simon Shuteriqi:

	Kap. V. —		Prodhimi letrar përpara Lidhjes së Prizrendit.	
1.	„	„	Nr. 3. *Kostandin Kristoforidhi*	118-141

Zef Valentini :

	Kap. V. —	Prodhimi letrar përpara Lidhjes së Prizrendit.	Faqe
1.	„ „	Nr. 5. *Enjëll Radoja*	152-157
2.	„ „	Nr. 7. *Zef Ndokillija*	173-175
3.	„ „	Nr. 8. *Ndue Bltyqi*	175-180
4.	„ „	Nr. 9. *Thimi Mitkua*	180-184
5.	„ „	Nr. 10. *Pashk Babi*	194-198

BKSH

PASQYRA E LANDËS

KAPTINA I.

DOKUMENTET E PARA TË GJUHËS SHQIPE

Faqe

1 — Formula e Pagzimit (1462) . . . . „ 3
2 — Fjalorthi i Arnoldit Von Harff (1497) . . . . . „ 4
3 — Ungjilli i Pashkvet (shek XV) . . . . „ 5
4 — Nëshkrimet e Pjanës . . . . „ 8
5 — Fjalorthi i Mazrrekut (1633) . . . . „ 9

KAPTINA II.

SHKRIMTARË TË VJETËR TË VERIUT

Njohtime të përgjithëshme . . . . „ 10
1 — Gjon Buzuku — Meshari . . . . „ 13
a) *Parathanja e Librit.* . . . . „ 16
b) *Të mbytunt e botës nd' ujë* . . . . „ 17
c) *Gjyqi i Salomonit* . . . . „ 20
ç) *Gostari i pazemrë* . . . . „ 21
d) *E Gjykuemja për dekë.* . . . . „ 23
2 — Pjetër Budi. — Veprat (1618-1621) . . . . „ 24
a) *Detyra e të dhjetavet* . . . . „ 27
b) *Të mbraztit e jetës.* . . . . „ 29
c) *Këtu thomi mkat c' Adamit* . . . . „
e nc' Evës, përindët parë . . . . „ 32

Faqe

ç) *Thotë, se Adami, mbassi fëjei me Evën.* . . . „ 33
d) *E zotynë Adamit mbet e i tha se:* . . . . . „ 34
dh) *Të rrekumenduem e të poresitun Upeshkëpinjet* „ 35
3 — Frang Bardhi. — Fjalori (1635) . . . . „ 39
a) *Nga Parathanja e fjalorit* . . . . „ 41
b) *Kuvend burrash!* . . . . „ 44
c) *Të pyetunat e të responduemet Arbënisht:* . . „ 45
4 — Pjetër Bogdani. — Kryevepra (1685) . . . . . „ 46
a) *Urim Auktorit* . . . . „ 50
b) *Të prîmit' përpara letërarit* . . . . „ 53
c) *Pak astrologjí* . . . . „ 56
ç) *Disa çudí të Natyrës e të Mjeshtëris* . . . . „ 57
d) *Virtyti e burrnija e Malsorit* . . . . „ 60
5 — Kuvendi i Arbënit (1706) . . . . „ 61
Letra percjellse . . . . „ 62
6 — Gjon Nikollë Kazazi (1743) . . . . „ 65
a) *Jetëshkrimi* . . . . „ 65
b) *Lutjet e mëngjezit* . . . . „ 67
c) *Vepër pendimi* . . . . „ 68

KAPTINA III.

SHKRIMTARË TË VJETËR TË JUGUT

Njohtime të përgjithëshme . . . . „ 69
1 — Theodhor Kavaljoti . . . . „ 71
a) *Jetëshkrimi* . . . . „ 71
b) *Analyzimi i „Fjalorit“* . . . . „ 72
2 — Mjeshtri Danjel (1794) . . . . „ 75
a) *Jetëshkrimi* . . . . „ 75
b) *Vepra* . . . . „ 75
3 — Kostë Beratasi (rreth vj. 1800) . . . . „ 77
a) *Dorëshkrimi i veprës* . . . . „ 77
b) *Zonjë Shëmëri përpara Kryqsë* . . . . . . „ 80

Faqe

4 — Marko Boçari (1809) . . . . „ 84
a) *Dorëshkrimi i Fjalorit* . . . . „ 84
b) *Vrejtje psikologjike mbi Fjalorin e Boçarit* . „ 86
5 — Grigor Gjirokastriti (1824) . . . . „ 88
a) *Jetëshkrimi* . . . . „ 88
b) *Vepra e Grigorit* . . . . „ 89
c) *Nga Ungjilli i S. Llukas, krye XV; 11* . . „ 90
ç) *Gjuha* . . . . „ 91

KAPTINA IV.

SHKRIMTARË TË VJETËR MYSLIMANË

Njohtime të përgjithëshme . . . . „ 94
1 — Muhamet Çami (shek. XVIII) . . . . „ 95
a) *Jetëshkrimi* . . . . „ 95
b) *„Erveheja“* . . . . „ 95
c) *Mbrendija e novelës* . . . . „ 98
ç) *Vrejtje e Shenime* . . . . „ 102
2 — Nezim Berati (1754) . . . . „ 107
a) *Jetëshkrimi* . . . . „ 107
b) *Vjershat e Nezimit* . . . . „ 108
3 — Shkrimtarë të dorës së dytë . . . . „ 109

KAPTINA V.

PRODHIMI LETRAR PËRPARA LIDHJES SË PRIZRENDIT

Njohtime të përgjithëshme . . . . „ 111
1 — Theodhor Haxhi Filipi (shek. XVIII) . . . . . „ 112
a) *Jetëshkrimi* . . . . „ 112
b) *Alfabeti i Theodhorit* . . . . „ 113
c) *Nga përkthimet e Theodhor Haxhi Filipit* . . „ 114

Faqe

2 — Naum Veqilharxhi (1845) . . . . „ 116
a) *Jetëshkrimi e vepra* . . . . „ 116
b) *Shembull nga Abetori* . . . . „ 118
3 — Kostandin Kristoforidhi (1868). . . . . . . „ 118
a) *Jetëshkrimi.* . . . . „ 118
b) *Vepra e Kristoforidhit* . . . . „ 123
c) *Alfabeti i Kristoforidhit* . . . . „ 125
ç) *Orthografija e Kristoforidhit* . . . . . „ 126
d) *Copa të zgjedhuna* . . . . „ 126
4 — Pjetër Zarishi (fillimi i shek. XIX) . . . . . „ 142
a) *Jeta e veprat* . . . . „ 142
b) *Derës së Gjomarkut.* . . . . „ 147
c) *Nji derë paska gjith Arbnija* . . . . . . „ 149
5 — Enjell Radoja (1862). . . . . „ 152
a) *Jetëshkrimi.* . . . . „ 152
b) *Nga „Konqili i Dheut Shqypnis“.* . . . . „ 154
6 — Leonard de Martini (1868) . . . . „ 157
a) *Jetëshkrimi e veprimtarija e tij* . . . . . „
kulturore-shoqnore . . . . „ 157
b) *Veprimtarija letrare e kryevepra e tij „Arpa“* „ 160
c) *Nga prodhimi i de Martinit* . . . . . . „ 168
7 — Zef Ndokillija (1871). . . . . „ 173
a) *Jetëshkrimi.* . . . . „ 173
b) *Kangë* . . . . „ 174
8 — Ndue Bityqi (1874) . . . . „ 175
a) *Jetëshkrimi.* . . . . „ 175
b) *Nga prodhimi i Bityqit.* . . . . „ 178
9 — Thimi Mitkua (1878). . . . . „ 180
a) *Jetëshkrimi.* . . . . „ 180
b) *Nga „Bleta Shqipëtare“* . . . . „ 182
10 — Pashk Babi (1882) . . . . „ 184
a) *Jetëshkrimi.* . . . . „ 184
b) *Nga „Vakinat“ e Babit.* . . . . „ 185
c) *Nga drami „I biri i çëfutit“* . . . . . . „ 195

KAPTINA VI.

PRODHIMI LETRAR I ARBËRESHVET T' ITALISË

Faqe

Njohtime të përgjithëshme . . . . „ 199
1 — Lekë Matranga — Katekizma (1592) . . . . . . „ 203
a) *Ftesë e përshpirtëshme* . . . . „ 204
b) *Të falem, perëndeshë !* . . . . „ 205
c) *Të tetë të lumëtë.* . . . . „ 206
ç) *Të gjallunt e kurmit* . . . . „ 209
d) *Engjëli i t' inë Zot* . . . . „ 209
e) *Imprimatur* . . . . „ 209
2 — Nikollë Figlia (1691-1769) . . . . „ 210
a) *Jetëshkrimi dhe vepra e tij* . . . . „ 210
b) *Pjesë të zgjedhura* . . . . „ 211
3 — Nikollë Brankati (1675-1741) . . . . „ 215
a) *Jetëshkrimi* . . . . „ 215
b) *Pjesë të zgjedhura* . . . . „ 217
4 — Zef Barça (1753 ?) . . . . „ 223
a) *Jetëshkrimi* . . . . „ 223
b) *Njeriu ç' i harroshaem.* . . . . „ 224
5 — Jul Variboba (1762) . . . . „ 226
a) *Jetëshkrimi* . . . . „ 226
b) *Analizë e veprës* . . . . „ 227
c) *Vlera e veprës.* . . . . „ 229
d) *Pjesa të zgjedhuna nga „Gjella e* . . . . . „
Shën Mëris Virgjër" . . . . „ 232
6 — Gjon Thoma Barbaçi (1742-1791) . . . . „ 237
a) *Jetëshkrimi* . . . . „ 237
b) *O ti çae helme shkove* . . . , ... „ 237
7 — Nikollë Keta (1742-1803) . . . . „ 239
a) *Jetëshkrimi e veprat.* . . . . „ 239
b) *Nga shkrimet e Ketës* . . . . „ 240

Faqe

8 — Gabriel Dara Plaku (1765-1832) . . . . „ 244
a) *Jetëshkrimi* . . . . „ 244
b) *Ejani, gjinde...* . . . . „ 245
9 — Andrea Dara (1796-1872) . . . . „ 249
a) *Jetëshkrimi e veprat* . . . . „ 249
b) *E bukura, i varfëri dhe kali* . . . . „ 250
10 — Jeronim De Rada (1814-1903) . . . . „ 252
a) *Jetëshkrimi* . . . . „ 252
b) *Veprat* . . . . „ 256
c) *Analiza e vepravet* . . . . „ 257
ç) *Vlera e Milosaave* . . . . „ 261
d) *Nga „Milosaat“* . . . . „ 265
e) *Nga „Uno specchio di Umano Transito“* . . „ 275
11 — Anton Santori (1819-1894) . . . . „ 279
a) *Jetëshkrimi* . . . . „ 279
b) *Veprat* . . . . „ 279
c) *Analiza e vepravet* . . . . „ 280
ç) *Vlera e vepravet* . . . . „ 283
d) *Nga shkrimet e Santorit* . . . . „ 284
12 — Dhimitër Kamarda (1821-1882) . . . . „ 290
a) *Jetëshkrimi* . . . . „ 290
b) *Veprat* . . . . „ 293
c) *Zonjës Elenë Gjika* . . . . „ 297
13 — Gabriel Dara, I Riu (1826-1885) . . . . „ 299
a) *Jetëshkrimi* . . . . „ 299
b) *Analizë e veprës* . . . . „ 300
c) *Vlera e veprës* . . . . „ 305
ç) *Nga shkrimet e Darës* . . . . „ 309
14 — Zef Kamarda (1831-1878) . . . . „ 335
a) *Jetëshkrimi* . . . . „ 335
b) *Nga shkrimet e Z. Kamardës* . . . . „ 336
15 — Pjetër Kiara (1840-1915) . . . . „ 341
a) *Jetëshkrimi e veprat* . . . . „ 341
b) *Luftar t' Arbëresh* . . . . „ 343

Faqe

16 — Zef Serembe (1843-1891). . . . . „ 345
a) *Jetëshkrimi e veprat* . . . . „ 345
b) *Nga libri „Vjershe“* . . . . „ 346

KAPTINA VII.

ARBRESHËT E GREQIS

Njohtime të përgjithëshme . . . . „ 349
1 — Anastas Kullurjoti . . . . „ 350
2 — Panajot Kupitori . . . . „ 351

Rendi alfabetik i Bashkëpunuesvet . . . . . . „ 357

BKSH

BKSH

BKSH

BKSH